

# ENVER HOXHA

VEPRA

45



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

V E L L I M I

45

DHJETOR 1970 — PRILL 1971

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1985



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 45-TË

Në këtë vëllim përfshihen materiale të periudhës dhjetor 1970 — prill 1971, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Si në të gjitha Veprat e tjera të shokut Enver Hoxha, edhe në materialet e këtij vëllimi shohim forcën e thellësinë e mendimit teorik marksist-leninist për probleme të ndryshme të revolucionit dhe përvojën e pasur revolucionare si udhëheqës i shquar, militant i Partisë dhe i popullit në ndërtimin socialist të vendit tonë. Ato janë vetëm një pjesë e asaj trashëgimie të madhe teorike e praktike që na la shoku Enver Hoxha. Si themelues, organizator dhe udhëheqës i Partisë, Ai nuk pushoi së menduari dhe së punuari për ta kalitur e për ta revolucionarizuar ideologjikisht dhe organizativisht atë në mënyrë të pandërprerë. Idetë dhe mësimet e Tij të çmuara, caktimi i rrugëve të zhvillimit drejt të luftës heroike që udhëhoqi Ai për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë dhe të gjithë jetës së vendit, për të luftuar me efektivitet burokratizmin e liberalizmin, si dy rreziqe të mëdha që kanosnin diktaturën e proletariatit, preokupacioni i shokut Enver Hoxha dhe orientimet e Tij për forcimin e rolit udhëheqës të Partisë, për gjallërimin e jetës së brendshme të saj, për rritjen e vetëveprimit e të iniciativës

së organizatave-bazë të Partisë, për thellimin e vazhdueshëm të vijës së masave etj., janë objekt i disa diskutimeve, bisedave e fjalimeve të kësaj periudhe.

Problemet e zhvillimit ekonomik të vendit tonë dhe të revolucionarizimit të drejtimit të ekonomisë, zënë një vend qendror në materialet e këtij vëllimi dhe kjo është e kuptueshme. Këto materiale i përkasin periudhës kur populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë mbylli me sukses planin e vitit 1970 dhe bashkë me të edhe krejt pesëvjeçarin e katërt. Nga puna e bërë u përftua një përvojë e pasur në të gjitha fushat. Duke analizuar thellë arritjet e deriatëhershme autori bën përgjithësime me vlerë të madhe teorike e praktike që i shërbyen jo vetëm momentit që po kalonte vendi ynë, por që janë udhërrëfyese për çdo kohë. Si hallka kyç për realizimin e planit në çdo sektor të ekonomisë, udhëheqësi i Partisë thekson faktorë të tillë si organizimi e disiplina, që trajtohen shkencërisht në diskutimet në mbledhjen e Byrosë Politike më 21 dhjetor 1970, në mbledhjet e Sekretariatit të KQ të PPSH më 5 janar e 23 mars 1971 dhe në materiale të tjera.

Në bazë të porosive të shokut Enver Hoxha, për të revolucionarizuar më tej drejtimin e ekonomisë, ndërmarrjeve ekonomike dhe kooperativave bujqësore iu dhanë më shumë kompetenca, të cilat synonin që te punëtori e te kooperativisti të rrënjoset sa më thellë ndjenja, psikologjia, bindja se ai është zot i ndërmarrjes dhe i kooperativës.

Vëmendje e veçantë u kushtohet problemeve të bujqësisë. Bujqësia përherë është parë nga Partia e shoku Enver Hoxha si një degë bazë e ekonomisë,

arritjet e së cilës ndikojnë në ecurinë e gjithë jetës së vendit. Duke u ndalur posaçërisht në këto probleme, autori nënvizon se edhe në bujqësi kërkohet organizim i punëve dhe disiplinë e fortë si edhe në industri; se edhe në këtë fushë duhen futur kudo metodat shkencore të punës e të drejtimit. Pa organizim dhe disiplinë, thekson shoku Enver Hoxha, nuk mund të kemi bujqësi moderne. Ai vë në dukje se në mosrealizimet e disa rretheve në bujqësi, patën ndikuar për keq edhe konceptet e gabuara që kishin zënë vend te drejtuesit e Partisë e të pushtetit, sipas të cilëve rrethet e tyre ishin më tepër industriale, ndaj edhe vëmendja kryesore duhej përqendruar këtu, duke lënë pas dore bujqësinë. Analizat e thella kritike që u bënë autori këtyre dukurive negative në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 23 mars 1971, janë mësim me vlerë të ngahershme për të siguruar gjithmonë ecjen përpara të ekonomisë, të mbështetur fort në të dyja këmbët, në industri e në bujqësi.

Ngritja e mirëqenies së kooperativistëve dhe ngushtimi i mëtejshëm i dallimeve fshat-qytet kanë qenë një preokupim i vazhdueshëm i Partisë dhe personalisht i shokut Enver Hoxha. Interes të veçantë paraqesin për këtë problem shënimet e datës 1 shkurt 1971, ku në mënyrë të qartë e të prerë autori konkludon se në furnizim qyteti nuk duhet të jetë më i favorizuar se fshati. Siç argumentohet gjerësisht në vëllim, e vetmja rrugë për shtimin e të ardhurave të kooperativistëve, për ngritjen e mirëqenies së tyre, pra edhe për ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve fshat-qytet, është rritja e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Realizimi i detyrave, rritja e prodhimit e shtimi i të ardhurave janë rrugë të domosdoshme edhe për ta bërë atdheun sa më të fortë, në gjendje për të përballuar edhe situatat më të rrezikshme, mendim ky i sintetizuar në mënyrë lapidare edhe në fjalën e mbajtur në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës se «Atdheu nuk mbrohet vetëm me armë, por edhe duke rritur prodhimet».

Problemi i forcimit të pandërprerë të mbrojtjes së atdheut trajtohet në disa materiale të kësaj periudhe. Në to ndihet preokupimi i Partisë dhe i shokut Enver Hoxha për përsosjen e organizimit, për forcimin, për edukimin dhe për modernizimin e pandërprerë të ushtrisë sonë. Me rëndësi të veçantë është diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike më 8 dhjetor 1970, ku autori, ndonëse pa u zbuluar akoma veprimtaria armiqësore e grupit komplotist puçist të Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos, i kritikon rreptë këta për situatën e sëmurë që kishin krijuar në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes, për gabimet e tyre të përsëritura, për dobësitë e mëdha të punës së tyre në drejtimin e ushtrisë dhe për të metat në karakterin e tyre. Shoku Enver Hoxha parashtron një sërë idesh e porosisish shumë të rëndësishme dhe të vlefshme për përmirësimin e organizimit e të drejtimit të ushtrisë, për të forcuar më tej lidhjet e saj me popullin, për ta bërë ushtrinë një shkollë të vërtetë ku përgatitet ushtarakisht e politikisht për mbrojtjen e atdheut i tërë populli—ushtar.

Disa nga materialet e përfshira në këtë vëllim kanë të bëjnë me funksionimin, forcimin dhe me përsos-

jen e punës së organeve të pushtetit popullor dhe të administratës shtetërore. Theksi vihet sidomos në përsosjen dhe në rritjen e rolit të këshillave popullorë të çdo shkalle, në luftë me konceptet nënvleftësuese për ta. Interes të veçantë paraqet edhe fjala e mbajtur në Plenumin e 11-të të KQ të PPSH për ngritjen në një nivel më të lartë të shërbimit shëndetësor e sidomos të profilaksisë e të higjienës. Në të nënvizohet ideja se problemi i ruajtjes së shëndetit të popullit nuk u përket vetëm mjekut e personelit shëndetësor, por të gjithëve.

Në mjaft materiale të këtij vëllimi trajtohen gjerësisht edhe një sërë problemesh të tjera, si ato që kanë të bëjnë me përsosjen e figurës morale të rinisë, me kuptimin e drejtë të kritikës e të autokritikës, me thellimin e mëtejshëm të punës shkencore, të lidhjes së shkollës me prodhimin etj.

Problemet e rëndësishme të jetës së vendit, autori i trajton në lidhje të ngushtë me situatat ndërkombëtare. Në materialet e këtij vëllimi shohim edhe një herë qartë se me ç'vendosmëri demaskon shoku Enver Hoxha politikën dhe veprimtarinë agresive e luftënxitëse të dy superfuqive, se me ç'patos revolucionar i ka mbrojtur Ai marksizëm-leninizmin, interesat e popullit e të atdheut tonë nga shtrembërimet oportuniste e revizioniste.

Duke marrë në dorë këtë vëllim e duke e studiuar atë me vëmendje komunistët, kuadrot dhe të gjitha masat punonjëse të vendit tonë do të armatosen më tej për t'u bërë flamurtarë të zbatimit të mësimëve të pavdekshme të shokut Enver Hoxha.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



# RRITJA E KOMPETENCAVE TË BAZËS KËRKON NDRYSHIMIN E METODËS E TË STILIT NË PUNË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

7 dhjetor 1970

Jam i një mendimi me këto studime të përgatitura nga Komisioni i Planit të Shtetit dhe nga Instituti i Studimeve Ekonomike, si dhe me vërejtjet që ka bërë Këshilli i Ministrave e në përgjithësi edhe me ato që bënë shokët, të cilët morën fjalën në këtë mbledhje. Megjithatë kisha edhe unë për të theksuar disa vërejtje të përgjithshme.

Këto studime janë të mira, por ne duhet të kemi kurdoherë parasysh që të jemi më racionalë për kohën

---

1. Në këtë mbledhje u morën në shqyrtim studimet: «Për përmirësimin e drejtimit dhe zgjerimin e mëtejshëm të kompetencave të organeve shtetërore dhe ekonomike», «Për disa probleme të revolucionarizimit të drejtimit me plan të ekonomisë popullore», «Për përmirësimin e furnizimit materialo-tekNIK» dhe «Disa probleme të organizimit të strukturave organike».

që u kushtojmë studimeve, si dhe për numrin e njerëzve që ngarkojmë të merren me to. Kjo, natyrisht, varet nga karakteri i problemit dhe nga kualifikimi i njerëzve që ngarkohen për të bërë studimin.

Mendoj se nuk është kurdoherë e domosdoshme të konsultohemi për çdo problem me të tëra masat dhe me një mori të madhe kuadrosh. Kur themi të konsultohemi dhe të marrim mendimin e masave për një problem të caktuar, organizativ ose teknik qoftë, këtë punë është mirë ta bëjmë me njerëz të kualifikuar, me njerëz që janë në gjendje të japin mendime për problemin që duam të shqyrtojmë, se mund të thërresim në mbledhje edhe qindra shokë, por ndodh që nga këta flasin dhe japin mendime vetëm disa. Si rrjedhim mbledhje të tilla nuk japin ato përfitime që presim. Prandaj është më mirë të thërresim një numër më të kufizuar punonjësish e kuadrosh të aftë, me të cilët të bisedohet shtruar dhe atëherë të jemi të bindur se një mbledhje e tillë do të japë rezultate më të mira se një tjetër ku marrin pjesë shumë, por që nuk janë në gjendje të ndihmojnë. Në qoftë se problemi është i tillë që, pas një shqyrtimi të gjallë e konkret me kuadrot, është e nevojshme të merret edhe aprovimi i masës, për të vërtetuar drejtësinë dhe vërtetësinë e një vendimi, atëherë po, çështjen mundet dhe duhet ta shtrojmë për konsultim të gjerë me masat dhe me kuadrot. Por ka dhe shumë probleme që nuk e kërkojnë një gjë të tillë.

Pra, kur është fjala për studime si këto që mbështeten në eksperiencën e gjatë të Partisë dhe të pushtetit tonë, nuk ka pse të grumbullohet një numër i madh kuadrosh. Po të ishin shqyrtuar këto çështje në mënyrë



më të thelluar, sipas mendimit tim, mund të kishim mbaruar punë edhe me problemin e kompetencave të ndërmarrjeve, të cilave do të na duhet t'u kthehemi përsëri së afërmi, brenda tremujorit të parë të vitit që vjen: Në këto mbledhje, do të ishte mirë që të merrnin pjesë edhe shokët ekonomistë që punojnë në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë, se edhe këta janë specialistë dhe të mos na i bënin vërejtjet tani, si «kofini pas të vjelit». Mirë që materiali u është dërguar, po kur u thirrën gjithë këta njerëz, pse nuk u ftuan edhe ata? Shokët e aparatit tonë na kanë paraqitur një sërë çështjesh parimore, të cilat do të ishin sheshuar qysh në komision.

Masat që po marrim për harmonizimin dhe për zgjerimin e mëtejshëm të kompetencave të organeve shtetërore dhe ekonomike nga qendra në bazë, të mos konsiderohen sikur me to po bëjmë ndonjë ndryshim rrënjësor të organizimit tonë shtetëror për drejtimin e ekonomisë. Jo. Ne po marrim vendime për të zgjidhur disa çështje të caktuara, të cilat duhet t'i kishim thelluar me kohë dhe njëra pas tjetrës, me qëllim që të kishim arritur në mënyrë progresive zbatimin e tyre në jetë, në vend që këto çështje t'i linim të grumbulloheshin dhe të detyroheshim t'i zgjidhnim të tëra përnjëherësh, siç po veprojmë tani. Lidhur me këtë që po bëjmë, jo vetëm jashtë vendit, por as brenda tij, të mos krijohet kurrësi përshtypja sikur, me zgjerimin e kompetencave nga qendra në bazë dhe me krijimin e kushteve që këto kompetenca të kryhen me sukses dhe pa pengesa, tani ne po bëjmë ndonjë reformë. Me rritjen e prodhimit duhen përmirësuar edhe format e punës,

prandaj në fakt ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse thellojmë më tej demokratizimin e pushtetit, përmirësojmë drejtimin e pushtetit e të ekonomisë në bazë dhe i shkojmë më afër prodhimit. Komiteteve ekzekutive dhe ndërmarrjeve ekonomike po u japim më shumë kompetenca, me qëllim që iniciativa e tyre krijuese të rritet më tej, që planet të jenë sa më reale, që rendimenti në punë të vejë vazhdimisht duke u ngritur dhe kostoja të ulët, që rentabiliteti i ndërmarrjeve në interes të shoqërisë të shkojë vazhdimisht kreshendo dhe të krijohet kështu një fond gjithnjë e më i madh mjetesh financiare e materiale për zhvillimin e ekonomisë dhe për rritjen e mirëqenies së popullit.

Natyrisht, masat që po marrim përputhen plotësisht me metodologjinë e planifikimit tonë socialist, me drejtimin e centralizuar të ekonomisë nga ana e shtetit tonë socialist, me nevojën për të forcuar disiplinën proletare të planit dhe përllëgaritjen ekonomike socialiste.

Vendimet tona për forcimin e drejtimit të ekonomisë në bazë, burojnë si kurdoherë nga politika e Partisë për një zbatim më të thelluar të vijës së masave. Por, kur flasim që masat punonjëse të marrin pjesë sa më gjerësisht në drejtimin me plan të ekonomisë sonë, kuptojmë masat punonjëse të organizuara e të udhëhequra nga Partia dhe nga pushteti, pjesëmarrjen e tyre të vërtetë e të gjallë dhe jo në mënyrë formale. Po t'i shohim çështjet me syrin kritik, del se në këtë drejtim kemi bërë mjaft përparime, por kemi edhe shumë të meta. Prandaj, edhe kur i hartojmë planet ekonomike edhe kur i shtrojmë ato për diskutim me punëtorët, të qëndrojmë fort në zbatimin e vijës së

masave. Në të gjithë e dimë si veprohet për këto çështje nëpër ndërmarrjet tona; atje gjen shumë herë gjëra të mira, po has edhe në gjëra jo të mira. Direktivat e Partisë të shprehura në ligje, në vendime, në urdhëresa qeveritare, ose në udhëzime të Komisionit të Planit të Shtetit shpesh nuk zbatohen, gjykohen në mënyrë formale dhe burokratike si në rastin kur bëhet plani, ashtu edhe gjatë zbatimit të tij. Vihet pyetja: Mos vallë për këtë kemi të meta ne që punojmë në qendër? Mua më duket se edhe ne kemi të meta dhe duhet të bëjmë autokritikë për ta zbatuar më me sukses vijën e masave që kemi caktuar.

Thashë më lart se çështjet që po shqyrtojmë duhet t'i kishim zgjidhur më parë. Kjo vonesë ka ardhur edhe për arsye se te ne ekziston njëfarë konservatorizmi ndaj elementit të ri dhe kuadrove të bazës. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për drejtuesit dhe për inxhinierët e ndërmarrjeve, por edhe për punëtorët. Në parim ne mund të themi që s'duhet të jetë kështu, po, kur vjen puna në praktikë, në të gjitha shkallëzimet, ku më shumë e ku më pak, baza nuk çmohet si duhet. Mendimi im është, dhe këtë e them me plot gojën, se në bazë ne kemi kuadro të mrekullueshëm. Kur një kuadër, inxhinier, agronom apo i një specialiteti tjetër, ka një stazh pune prej dy ose më shumë vjetësh, pa përmendur pastaj kur ai ka pesë, gjashtë, ose shtatë e më shumë vjet, ai nuk duhet konsideruar kurrsesi më i ri, po një kuadër me eksperiencë. Kur një punëtor i organizuar në Parti ose jo, është i kategorisë së pestë e lart, ai është njëkohësisht një kuadër i kualifikuar me një eksperiencë të pasur e të madhe teknike, politike, ideo-

logjike dhe organizative. Derisa tani në ndërmarrjet tonë kemi një mori kuadrosh dhe punëtorësh të tillë, më duket e çuditshme dhe pyes: Si është e mundur që këta të mos arrijnë të kuptojnë thellë (nuk e kam fjalën këtu për filozofinë e madhe dhe ekonominë politike marksiste-leniniste) vijat e trasha të asaj metodologjie të thjeshtë të planifikimit që u dërgohet ndërmarrjeve, ku ata luftojnë dhe arrijnë suksese prej shumë vjetësh me radhë? Unë nuk mund ta marr me mend që ata të mos i kuptojnë këto gjëra. Por, edhe sikur të mendojmë për një çast se nuk i kuptojnë, përse nuk ua bëjmë të kuptueshme këto probleme? Partia dhe komitetet ekzekutive në rrethe kanë një detyrë të madhe që duhet ta kuptojnë mirë. Më parë se t'u mësojnë kuadrove dhe punëtorëve teorinë e madhe, ata t'u mësojnë atyre ato që thamë, çështjet kryesore e më të përgjithshme të planifikimit të ekonomisë dhe si bëhet konkretisht plani në ndërmarrje, që janë të domosdoshme për ta; t'u mësojnë atyre teorinë e ndërtimit të socializmit, ligjet e socializmit, duke i trajtuar ato thjesht e qartë, ashtu siç paraqiten e mishërohen në direktivat e Partisë, në ligjet, në vendimet dhe në urdhëresat e Qeverisë, në çështje për të cilat punohet e luftohet në ndërmarrje ose në kooperativë, si edhe në të gjitha problemet që punonjësit tanë hasin e përballojnë çdo ditë si prodhues apo si konsumatorë, si individë apo si kolektiv. Pasi t'u kemi mësuar këto, le t'u shpjegojmë edhe çështje të tjera të doktrinës sonë marksiste-leniniste. Unë kam përshtypjen se ne merremi shumë me gjëra të përgjithshme, anësore dhe harrojmë punën me bazën.

Kisha dhe një vërejtje për metodologjinë e planifikimit që do të hartojë Komisioni i Planit të Shtetit. Më duket se ajo, duke u ndryshuar, duhet të bëhet e kuptueshme dhe e mundshme për t'u zbatuar në praktikë, pa e rënduar as me teori të panevojshme, as dhe me procedura të komplikuar dhe që janë të njohura.

Megjithatë, në praktikë, ne shohim që tërë shokët e ndërmarrjeve ekonomike, punëtorë dhe kuadro, luftojnë dhe realizojnë planin, shtojnë prodhimin, kapërcejnë normat, bëjnë përpjekje të mëdha për të përmirësuar cilësinë, për të prodhuar gjëra të reja dhe, pavarësisht se në punë kanë edhe të meta, sukseset e tyre janë më të mëdha. Prandaj nuk mund të themi se këta njerëz nuk kanë dijeni për çështjet e ekonomisë, të planifikimit dhe të drejtimit të prodhimit në ndërmarrje.

Derisa çështja qëndron kështu, atëherë përse hezitojmë t'u japim atyre më shumë kompetenca? Sigurisht, në këtë drejtim ne duhet të mendojmë pak më thellë për çështjet që po zgjidhim e po vendosim sot, në mënyrë që gama e kompetencave të ndërmarrjeve të zgjerohet. Në qoftë se, për shembull, i japim të drejtë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit që të krijojë fondin rezervë në masën 1-2 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve të buxhetit të rrethit, të jemi të bindur që ai do ta përdorë atë drejt dhe me vend, sepse atje punojnë me ndërgjegje njerëzit tanë të klasës. Të njëjtën gjë duhet të themi edhe për zgjerimin e kompetencave në ndërmarrje. Ndërmarrjet duhet të kenë të drejta e kompetenca financiare edhe materiale më shumë se deri sot. Këtu është caktuar që

ndërmarrjeve t'u lihen disa kompetenca për çështje financiare, po kompetenca materiale si kundërpeshë të anës financiare, do t'u lihen apo jo? E them këtë se paratë ndërmarrja nuk do t'i bëjë qylafe, por me to do të blejë materiale. Atëherë lind problemi se ku do t'i gjejë kjo këto materiale? Të mos arrijë puna gjer atje sa ndërmarrjet ekonomike të thonë: «Ç't'i bëjmë këto para kur s'ka material?». Çështja është këtu, që qysh në planin e parë të parashikojmë afërsisht një shumë fikse, që ndërmarrjet dhe komitetet ekzekutive të arrijnë të krijojnë materialin e nevojshëm me fondet financiare që formohen nga tejkalimet e planit etj. dhe pastaj, nëse do të realizohet apo nuk do të realizohet kjo shumë, është tjetër punë. Pra kësaj ngritjeje me forcat e veta, të një shume që do të krijohet nga kursimet, komitetet ekzekutive duhet t'i përgjigjen edhe me përpjekjet për të siguruar materialet e nevojshme.

Kur ndërmarrja që varet nga komiteti ekzekutiv harton planin dhe për zbatimin e tij, ta zëmë, i duhet çelik, kërkesën, natyrisht, e bën në konsultim edhe me seksionin përkatës të komitetit ekzekutiv, duke u bazuar në disa normativa të caktuara. Më në fund, arrihet në konkluzionin se i duhen as më shumë e as më pak, por vetëm 10 tonë çelik. Këtë kërkesë, duke u udhëhequr nga kriteret e caktuara, ndërmarrja e bën shumë të shtrënguar. Është e padiskutueshme që plani i furnizimit nëpërmjet komitetit, do të shkojë në ministri, e cila ka gjithë situatën e furnizimeve në dorë dhe me këtë sy e rishikon këtë plan që i vjen nga baza. Mirëpo ministria mund të bëjë akoma shkurtime dhe, në vend që t'i japë 10 tonë çelik, i jep 8, domethënë 2 tonë më pak.

Komiteti ekzekutiv, duke e parë problemin me syrin e kursimit, sasinë e çelikut që i pranoi ministria, përpara se t'ia akordojë ndërmarrjes, do ta diskutojë, nëse do t'i japë asaj 8, apo 6 tonë. Po të veprohet kështu nuk do t'i lihet ndërmarrjes asnjëfarë marzhi i vogël, do të krijohen vështirësi dhe realizimi i planit do të rrezikohet. Unë nuk them që ndërmarrjet të jenë të pavarura, por që problemi të studiohet me kujdes dhe të veprohet si është më mirë.

Parimi zbatohet në të gjithë komponentët e tij, por jo të mbrojmë parimin për parim<sup>1</sup> se edhe çështja që ndërmarrjes t'i lëmë disa kompetenca, është shumë parimore. Nuk mund të mjaftohemi vetëm me rezervat operative, pse ndërmarrja, duke parë situatën e shtrënguar, duhet të krijojë edhe vetë një çikë rezervë nga mbeturinat e nga rrugë të tjera. Pra, nuk do të ishte e drejtë që, pas gjithë këtyre gërshërave që do të bien mbi furnizimet, të kthehet përsëri komiteti ekzekutiv dhe t'ua shkurtojë ato ndërmarrjeve edhe më tepër. Kështu do të na krijohen të tjera probleme.

Qeliza bazë e ekonomisë sonë është ndërmarrja. Këtu vendoset fati i politikës ekonomike të Partisë, këtu vendoset fati i zbatimit të planeve, këtu janë punëtorët, kuadrot inxhiniero-teknikë e drejtues që duhet

---

1. Armiku Mehmet Shehu, duke dashur të tregonte se e hante meraku për kursimin, ngrinte çështjen që planin e furnizimit materialo-teknik të ndërmarrjeve ta bëjë komiteti ekzekutiv i rrethit dhe jo vetë ndërmarrjet, duke e quajtur këtë gjë «një çështje parimore». Në fakt ai nuk ishte për orientimin e drejtë të Partisë që t'u jepeshin më shumë kompetenca ndërmarrjeve ekonomike, bazës.

të thonë fjalën e tyre gjatë hartimit e zbatimit të planit. Prandaj këtu, në ndërmarrje, duhet treguar një kujdes i madh për të shtuar të gjitha ato të drejta e kompetenca që lehtësojnë, zgjerojnë e thellojnë më tej iniciativën e vetëveprimin e punëtorëve e të punonjësve të tjerë, vijën e masave.

Të nxiten më shumë e t'u lihet fushë më e lirë iniciativës e mendimit krijues të masës për të caktuar e për të vendosur treguesit tekniko-ekonomikë të planit, rendimentin, normat e punës e të harxhimit të materialeve, për të shfrytëzuar e për të përdorur të gjitha rezervat e mundësitë e brendshme që ka ndërmarrja dhe kurdoherë sipas nevojave të ekonomisë etj. Karakter direktiv e të domosdoshëm për ndërmarrjen të kenë vetëm detyrat e kuotat kryesore që sigurojnë përpjesëtimet themelore të ekonomisë, që shprehin nevojat dhe mundësitë që ka ajo.

Shtimi i të drejtave dhe i kompetencave të ndërmarrjeve duhet parë si një masë shumë e rëndësishme, që ka për qëllim të arrihen rezultate sa më të mëdha në zhvillimin e shpejtë të prodhimit dhe të forcohet demokracia socialiste në rrugë marksiste-leniniste. E gjithë kjo synon që te punëtori të rrënjosen sa më thellë ndjenja, psikologjia, bindja se ai është zot i ndërmarrjes, se ai e drejton vetë ndërmarrjen, se fati i ndërmarrjes dhe i prodhimit për të shkuar përpara janë në dorë të vetë punëtorëve. Kjo është një edukatë e tërë që Partia duhet ta krijojë çdo ditë, çdo orë e çdo çast te çdo punëtor e punonjës.

Për tërë veprimtarinë ekonomike e prodhuese, për anën materiale e financiare të ndërmarrjes, të kemi



besim më shumë te kolektivi punonjës i saj, që nga drejtori dhe deri te punëtori më i thjeshtë, dhe jo vetëm te një drejtor apo specialist këtu në qendër, në ministri. Natyrisht, shtimi i të drejtave dhe i kompetencave të ndërmarrjeve, duhet të shoqërohet dhe të çojë medoemos në shtimin dhe në forcimin e ndjenjës së disiplinës, të rregullit, të organizimit dhe të përgjegjësisë nga ana e kolektivit të saj. Kështu duhet ta shohim këtë çështje, ndryshe gabojmë.

Praktikën e gjertanishme me përqendrimin e shumë kompetencave në organet qendrore e justifikojmë duke thënë se e bëjmë këtë për të ushtruar kontroll më shumë e më mirë, në një kohë kur kontrollin e bazës, kontrollin punëtor përpigemi ta sjellim deri në ministri, ku të kontrollojë çdo gjë. Ky kontroll punëtor a nuk mund të shohë si po zbatohet kompetenca për përdorimin e fondit rezervë prej 1-2 për qind të shpenzimeve të buxhetit të rrethit, ose për kursimin e materialeve nga pushteti në rreth ose nga ndërmarrja? Patjetër mundet. Unë mendoj se punëtorët mund ta ushtrojnë shumë mirë një kontroll të tillë.

Prandaj të kemi besim te punëtorët dhe tek të gjithë kuadrot e bazës, të cilët duhet t'i inkurajojmë dhe t'i edukojmë medoemos në këtë drejtim.

Inkurajimi më i madh dhe edukimi më me këmbëngulje i punëtorëve për ushtrimin e kontrollit është i domosdoshëm sepse, sidomos tani që po u jepen më tepër kompetenca komiteteve ekzekutive, ka rrezik që ato të bëhen ndaj bazës, ndaj ndërmarrjeve po aq dhe ndoshta ca më shumë sektare e konservatore, sa janë sot edhe ministrinë ndaj ndërmarrjeve vartëse. Fundi

i fundit ministritë ishin pak më larg dhe secila kishte në vartësi një numër të madh ndërmarrjesh, kurse tani, komitetet, po të mos kuptojnë drejt kompetencat që u jepen dhe zbatimin e vijës së masave, mund t'u marrin frymën ndërmarrjeve. Është e nevojshme të kuptohet mirë çështja që komiteti ekzekutiv të drejtojë e të ndihmojë, por edhe të mbështetet te baza, te ndërmarrjet, t'u japë atyre të gjitha ato kompetenca që gjykon se i shërbejnë vetëveprimit dhe zhvillimit të iniciativës së tyre. Kolektivat punonjës të ndërmarrjeve ai duhet t'i inkurajojë në këtë drejtim që ata të ecin përpara dhe të shohin e të binden vetë se u është siguruar me të vërtetë një udhëheqje aktive dhe revolucionare. Vetëm kështu kompetencat e reja që po u jepen komiteteve ekzekutive do të harmonizohen drejt edhe me ato kompetenca të reja, të zgjeruara që duhet t'u jepen medoemos edhe ndërmarrjeve.

Meqenëse në drejtimin e përgjithshëm të ndërmarrjeve pleksen një sërë faktorësh që bëjnë të pashmangshëm edhe gërshetimin e kompetencave të organeve qendrore me ato të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, unë jam dakord që në veprimtarinë e tyre të përditshme ekonomike e prodhuese ndërmarrjet të lidhen edhe me rrethin, edhe me qendrën, të kenë pra lidhje të dyfishta, të drejtohen nga qendra dhe nga rrethi. Prandaj është e domosdoshme të përcaktohen mirë dhe të zbatohen plotësisht kompetencat që rrjedhin nga këto lidhje, nga ky drejtim i dyfishtë, sepse ekziston rreziku që ministria të vazhdojë rutinën dhe të punojë me stilin e metodën e vjetër të punës edhe për ato kompetenca

që do të ushtrohen nga komiteti ekzekutiv. Kështu punonjësit e ministrisë mund të venë varda poshtë, mund të kërkojnë të shikojnë e të interesohen në ndërmarrje edhe për gjënë më të vogël, kollaj «nuk e harron mushka valarenë». Një gjë e tillë mund të ngjasë, po të vazhdohet me të vjetrën. Edhe çështja e përgjegjësisë duhet kuptuar drejt, se kur e merr dikush detyrën ose kompetencën, e mban vetë ai në radhë të parë përgjegjësinë. Ministria ka përgjegjësi, por për gjërat që ngjasin në ndërmarrje, kanë përgjegjësi sidomos rrethi e ndërmarrja. Kjo duhet bërë e qartë që të kuptohet mirë se për çfarë do të përgjigjet baza dhe për çfarë ministria.

Prandaj e theksoj se në respektimin e kompetencave në të gjitha shkallëzimet e drejtimit të ekonomisë, ka ardhur koha të bëhet një kthesë e madhe këtu në qendër, si nga kuadrot e lartë, ashtu edhe nga të mesmit. Pa pasur frikë dhe, natyrisht, pasi të merren masat e duhura dhe të bëhet sqarimi i plotë e i nevojshëm për këtë çështje, kalimi i kompetencave komiteteve ekzekutive dhe ndërmarrjeve të bëhet i menjëhershëm.

Në qoftë se ne kërkojmë rendiment dhe cilësi në punë nga klasa punëtore, edhe kjo, bile ca më parë e më shumë, ka të drejtë të kërkojë nga ne të njëjtën gjë. Me këtë dua të them se shokët e ministrive, të cilët pa dyshim janë të kualifikuar dhe kanë një eksperiencë të gjatë pune, duke u lehtësuar nga zgjerimi i kompetencave të bazës, duhet të merren më mirë e më shumë me çështje studimore të problemeve kryesore për ta ndihmuar më me efektivitet bazën. Ata duhet të bëjnë një kthesë të dukshme në këtë drej-

tim. Por në qoftë se ata e marrin këtë që po theksoj vetëm si një thënie të thjeshtë dhe do të vazhdojnë punën rutinë, atëherë ne, patjetër, do ta mbytim dhe do ta rëndojmë bazën; ndërsa komiteteve ekzekutive dhe ndërmarrjeve mund t'u lindë tendenca e *scaricabarile*<sup>1</sup>-s, për shkak të pengesave që mund t'u lindin nga paqartësitë dhe vështirësitë për të kryer detyrat dhe për të zbatuar kompetencat që u përkasin.

Dhënia e më shumë kompetencave komiteteve ekzekutive të rretheve dhe instancave të tjera më të ulëta, si dhe ndërmarrjeve ekonomike e institucioneve buxhetore, do të kërkojë patjetër që të gjithë të bëjnë një luftë të madhe për të ndryshuar, në radhë të parë, stilin dhe metodën në punë. E theksoj këtë sepse jo çdo gjë, si: makineritë, lënda e parë, mjetet e transportit, punëtorët e kualifikuar, kuadrot etj., që do t'u duhen për zbatimin e kompetencave, do të jenë gati, si në dollap, dhe do të gjenden kurdoherë me lehtësi. Jo, gjatë zbatimit të kompetencave të reja organet e pushtetit në bazë dhe ndërmarrjet do të hasin patjetër edhe vështirësi. Prandaj atyre do të duhet t'u punojë mendja dhe jo sapo të hasin pengesën më të vogël të kërkojnë menjëherë ndërhyrjen e ministrive edhe për ato të drejta e detyra, për të cilat duhet të luftojnë vetë.

Edhe shokët e ministrive, nga ana e tyre, kur të shkojnë poshtë, nuk duhet të përzihen në çdo gjë e t'i zgjidhin, gjithashtu, bazës çdo kërkesë, pse atëherë do të ktheheshim prapë në metodën e vjetër të punës. Në

---

1. Italisht — Këtu ka kuptimin e shkarkimit të përgjegjësisë nga vetja.

raste të tilla, kur u kërkohet ndërhyrja dhe kur kjo punë nuk u takon organeve të qendrës, të veprohet drejt: t'u thuhet komiteteve ekzekutive, ndërmarrjeve etj., se ata kanë ardhur në bazë për të studiuar këtë ose atë problem të rëndësishëm, për të cilin kanë nevojë të marrin mendimin e këtij ose të atij specialisti apo punëtori, kurse të tjerat janë çështje të bazës; ata mund t'i dëgjojnë, mund t'u japin edhe ndonjë këshillë, por jo t'u zgjidhin çështje që i takojnë vetë bazës, e cila tani ka kompetenca, ka fonde, materiale e punëtorë dhe nuk mbetet tjetër veç të luftojë që t'i zbatojë e t'i përdorë drejt.

Natyrisht, meqenëse u shtohen kompetencat, na duhet t'i ndihmojmë komitetet ekzekutive; edhe unë jam i mendimit se mund të bëhet ndonjë shtesë e domosdoshme në organikat e tyre ekzistuese, por këto shtesa të mos bëhen në mënyrë burokratike. Fakt është që ministrive tani u hiqet një barrë; ato lirohen nga mjaft kompetenca dhe nga lidhjet e shumta që mbajnë me ndërmarrjet për një mori çështjesh, pse të gjitha këto do t'u kalojnë rretheve. Prandaj komitetet ekzekutive kanë nevojë për më shumë kuadro, ndërsa ministrinë duhet të kenë kuadro nga më të kualifikuarit për natyrën e detyrave që kanë, por sigurisht më pak nga sa kanë sot. Por, në rast se ministrinë do t'i mbajnë të tërë kuadrot që kanë, mendoj se një pjesë prej tyre do të vazhdojnë punën rutinë, do të vijjnë vërdallë, poshtë e lart, në qendër e në bazë.

Ndonëse komitetet ekzekutive kanë nevojë për më shumë kuadro, për të përballuar detyrat e reja që u ngarkohen, shtimi i këtyre kuadrove duhet bërë me

kritere të shëndosha, i studiuar mirë e thellë dhe vetëm në ato raste kur është me të vërtetë i domosdoshëm. E theksoj këtë anë të çështjes, sepse shtimi i tyre me shumicë me vend e pa vend, edhe atëherë kur duhet, edhe kur nuk duhet, më shumë do të prishë punë sesa do të ndreqë. Po të veprohet kështu, do të krijohet rreziku që drejtimi i ndërmarrjeve, i ekonomisë në rreth nga komitetet ekzekutive, në vend që të revolucionarizohet, të bëhet më elastik e efektiv dhe t'i afrohet më shumë bazës, mund të burokratizohet dhe presioni i tutelës administrative ndaj ndërmarrjeve vartëse mund të bëhet më i fortë.

Me këtë sy duhet gjykuar edhe çështja e krijimit të ndërmarrjeve të reja e të shumta në rreth. Kjo duhet parë me shumë kujdes. Ne nuk duhet të shkojmë në rrugën që, porsa të krijohet ndonjë linjë apo aktivitet i ri prodhimi, ose porsa të lindë ndonjë nevojë për ekonominë, menjëherë të ngremë medoemos ndërmarrje të reja, sepse do të na kushtojnë shtrenjtë. Në vend të copëzimit në ndërmarrje të vogla, ne duhet të shkojmë drejt përqendrimit të tyre, drejt bashkimit të shumë ndërmarrjeve të ngjashme apo të të njëjtit prodhim në një ndërmarrje të vetme. Me këtë rrugë do të fitojmë shumë, edhe kuadro drejtues e administrativë do të duhen më pak, edhe tërë veprimtaria ekonomike e prodhuese e ndërmarrjes mund të ngrihet në një shkallë më të lartë.

*Në kundërshtim me këto argumente bindëse të shokut Enver Hoxha, armiku i kamufluar Mehmet Shehu u përpoq ta mohonte tendencën që ekzistonte për të krijuar ndërmarrje të reja edhe atje ku kjo gjë*

*nuk ishte e nevojshme. Duke iu drejtuar atij, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Po unë e shoh se një tendencë e tillë ekziston, se po flitet për 3 drejtori këtu e 5 atje. Kështu do të krijojmë edhe disa ndërmarrje e drejtori të tjera. Më duket se duhet parë një çikë më mirë kjo punë. Në këtë rrugë ne ikim nga parimi që kemi caktuar për thjeshtësimin e aparateve shtetërore dhe kalojmë në fryrjen e tyre, por, siç thashë, këto na kushtojnë shtrenjtë, prandaj duhet kujdes i madh. Fundi-fundit, Koço<sup>1</sup>, sa larg është Fieri me Gorishtin? Një orë me makinë. Po përse duhet të krijohet një drejtori tjetër e prodhimit të naftës në Vlorë, kur mund të rregullohet rruga e të shkohet atje edhe më shpejt. Ne mund të kemi atje shumë puse, por drejtori në Vlorë nuk ka pse të krijojmë. A dalin këto llogari kështu?

Atë drejtori, ose atë komitet, siç do ta quash ti, Koço, po e marrim me të gjitha funksionet, po i japim kompetenca akoma më të mëdha dhe nën drejtimin e ministrisë po e çojmë në Fier ku është nafta. Megjithatë unë mendoj se këtu nuk po bëhet ndonjë ndryshim për sa i përket organizimit dhe as nuk duhet të lëmë të ndryshojë gjë. Në këtë fushë ne kemi pasur një drejtim të shthurur, kemi pasur drejtimin nga lart. Unë e shtroj çështjen që të mos u japim përshtypjen njerëzve në bazë sikur ne po bëjmë një ndryshim në organizim, se në të vërtetë nuk po bëjmë kështu. Ky është

---

1. Koço Theodhosi, i cili propozoi në këtë mbledhje që, përveç Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës, të krijoheshin edhe dy drejtori prodhimi, një në Fier e një në Vlorë.

njëfarë përmirësimi, po jo një ndryshim i theksuar në organizimin e aparateve të dikastereve. Kështu duhen parë çështjet më duket mua, në parim, shtrënguar<sup>1</sup>.

Duhet të kemi kujdes që të jemi të shtrënguar edhe për numrin e kuadrove në komitetet ekzekutive, në ndërmarrjet që do të krijohen dhe në ministritë, se puna kryesore është në bazë. Që baza të forcohet gjithnjë e më shumë, atë duhet ta fuqizojmë kurdoherë me kuadro sa më të përgatitur. Në Kombinatin e Tekstileve në Berat janë zëvendësuar inxhinierët me inxhinierë, vajza të reja që kanë ndjekur shkollën dhe kanë punuar mirë. Tani që ne kemi të tilla ndërmarrje, përse duhet të mbushim me kuadro administratat e ministrive dhe drejtoritë e ndërmarrjeve?

Për çështjen e kuadrove në qendër e në rreth unë kam një mendim, të cilin ta shohim sa i drejtë është dhe nëse mund ta zbatojmë e si duhet ta zbatojmë.

Mendoj se detyra jonë kryesore për vitin e ardhshëm është zbatimi i planit të vitit 1971. Më vonë do të merremi me hartimin në bazë të planit pesëvjeçar për industrinë, transportin, tregtinë etj. (përveç bujqësisë planin e së cilës e hartuam më parë). Kjo punë

---

1. Me gjithë këto porosi tepër të qarta të shokut Enver Hoxha, armiqtë Koço Theodhosi e Abdyl Këllezi i dhanë Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës kompetenca që nuk i takonin, duke dobësuar e duke mënjanuar në këtë sektor udhëheqjen e centralizuar, gjë që krijoi fushë të lirë për të zhvilluar veprimtarinë e tyre sabotuese e armiqësore Lipe Nashi, Pirro Gushoja, Koço Plaku, Beqir Alia e bashkëpunëtorët e tyre, të dënuar më vonë nga gjyqi i popullit.



puqet me të gjitha këto masa që po marrim për zgjerimin e kompetencave të bazës.

Për këtë qëllim mendoj që një numër i madh kuadrosh nga dikasteret e ndryshme të industrisë, të bujqësisë, të tregtisë, të komunikacionit, të ndërtimit etj. të shkojnë për të punuar përkohësisht për pesë-gjashtë muaj, në të gjitha rrethet. Këta kuadro mund të jenë zëvendësministra, drejtorë apo specialistë të ministrive. Dhe atje në bazë të mos qëndrojnë si mbi kalë, por të gjithë këta të venë si të deleguar dhe të kryejnë funksione si nënkryetarë komitetesh, apo si shefa seksionesh të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimit etj. Përveç punës sqaruese që do të bëjnë për kompetencat e reja me kuadrot dhe me punëtorët, ata do ta ndihmojnë bazën edhe konkretisht me eksperiencën e madhe që kanë. Pra në aparatet e komiteteve ekzekutive do të kemi përkohësisht një dublim funksionesh. Mirëpo atje do të dalë problemi, ta zëmë, cilin do të bëjmë nënkryetar të komitetit ekzekutiv apo shef të seksionit të industrisë. Natyrisht, ne nuk do të bëjmë shef të industrisë një njeri që nuk merr vesh nga kjo punë, po do të zgjedhim një kuadër të zot që t'i njohë dhe t'i kuptojë çështjet e industrisë. Ku do të gjendet ky? Kur i deleguari nga qendra do të shkojë nëpër ndërmarje për të shpjeguar planin dhe hartimin e tij, atje ai do të zbulojë edhe kush është më i përshtatshëm për këtë qëllim. Pastaj ai që do të çmohet më i zoti, sipas rregullave të Partisë për kuadrin, do të propozohet dhe do t'i ngarkohet detyra. Përkohësisht, këtë detyrë ai do ta kryejë së bashku me të deleguarin që ka shkuar në

rreth për të punuar derisa atje të hartohet plani ose, po ta lypë nevoja, edhe më gjatë.

Pasi të jetë hartuar plani në bazë, i deleguari nga ministria duhet të vijë në qendër bashkë me planin. Pastaj mund t'i themi të shkojë prapë në bazë për ta zbatuar atë e për të vënë në jetë masat që lypsen të merren. Kjo do të jetë një provë tjetër për këta kuadro të qendrës nëse janë me të vërtetë organizatorë dhe e njohin apo jo bazën. Në rast se del që ndonjë nuk e njeh, atëherë e lëmë në bazë për qarkullim për të punuar së bashku me kuadrot, të cilët ai i ka kritikuar më parë nga lart se «nuk e kuptojnë teknikën», nuk ia kuptojnë atij «filozofinë dhe ekonominë politike të socializmit» etj. Kjo punë do të na shërbejë që kuadrot e qendrës të mësojnë e të ndihmojnë ata të bazës si t'i kuptojnë më mirë e më shumë çështjet teorikisht, ndërsa vetë kuadrot e qendrës do të mësojnë më thellë si t'i zbatojnë në jetë njohuritë e tyre teorike.

Mund t'u mbash konferenca gjithë ditën e gjithë natën punëtorëve dhe komunistëve, por këto s'kanë vlerë, po nuk i sqarove, nuk i binde dhe nuk i ndihmove konkretisht për ato detyra që ata kanë për të realizuar apo ato çështje që kanë për të zgjidhur. Këtë punë duhet ta bëjë mirë Partia dhe në këtë drejtim të interesohen shumë sidomos shokët që merren me sektorin e edukimit. Këta shokë, të mos u mësojnë njerëzve Historinë e Partisë vetëm si histori dhe kur vjen puna të mos dinë të flasin për normat, për koston, për rendimentin etj.

Unë them se po të veprojmë kështu me kuadrin, nuk na priset asgjë, përkundrazi bëjmë një punë

shumë të mirë. Kjo do të na ndihmojë të përcaktojmë më drejt sa kuadro do të na duhen në rrethe dhe si do t'i gjejmë ata në punë e sipër për hartimin e planit të ri pesëvjeçar. Atyre kuadrove të ministrive, që do të tregojnë zotësi të madhe teorike dhe praktike në punë gjatë qëndrimit në bazë, më vonë mund t'u themi të kthehen përsëri në ministri, së cilës ata do t'i duhen për studime, për përgjithësimin e përvojës së përparuar etj. Të tjerëve, që nuk do të tregojnë aftësi gjatë punës së tyre në rrethe dhe meqenëse teorinë mund ta dinë mirë, po nuk njohin praktikën, t'u themi të vazhdojnë të punojnë në bazë, pse kanë nevojë të kaliten.

Lidhur me bashkimin e arkave të kursimit me bankën, siç propozohet në një nga studimet, kjo është një punë që ne duhet ta diskutojmë. Por, siç dihet, banka ka të tjera funksione. Njerëzit kanë të drejtë që, kur të duan, të venë të depozitojnë në arkën e kursimit aq të holla sa kanë, dhe, kur u duhen prapë, qoftë edhe pas një dite, t'i tërheqin, kurse veprimtaria bankare ka një karakter tjetër më të madh. Edhe për sa i përket kuadrut, me këtë bashkim nuk përfitojmë gjë, se ai duhet të jetë prapë po aq, mbasi aktiviteti nuk do të pengohet. Arka e kursimit është një gjë e thjeshtë dhe shumë popullore, ajo shërben për veprime depozitare<sup>1</sup>.

Unë bashkohem me mendimin që dyqanet e kooperativave të shitblerjes në fshat të kthehen në dyqane të tregtisë shtetërore. Mirëpo me kaq nuk mjafton dhe kjo çështje duhet parë pak më thellë.

---

1. Të gjithë shokët u shprehën dakord që arkat e kursimit dhe të sigurimeve shoqërore të mbeteshin siç ishin.

Kooperativat e shitblerjes janë organizata tregtie të formuara me mjetet e anëtarëve të tyre, të cilat furnizohen nga tregtia jonë shtetërore. Ato janë nën kontrollin e anëtarëve të tyre. Në qoftë se këta nuk e luajnë mirë këtë rol kontrollues, këtu kemi të bëjmë me një të metë të punës së Partisë. Kjo formë e pronësisë nuk është shtetërore, por kooperativiste. Në qoftë se ne i kalojmë këto nga organizata kooperativiste në organizata të tregtisë shtetërore, atëherë tregtia shtetërore, në marrëdhëniet me fshatarësinë, do të jetë më pak e angazhuar e do të zhvillohet thjesht: na paratë, më jep mallin. Kur janë organizata masash, puna ndryshon. Partia punon dhe duhet të punojë parimisht me to, duke i bindur se ata, anëtarët e kooperativës, kanë një detyrë të madhe karshi klasës punëtore, e cila derdh djersë për ndërtimin e socializmit në sektorin e industrisë. Detyra e fshatarësisë ndaj klasës punëtore është furnizimi me disa sende ushqimore. Mundet që fshatari për shembull, vezët nuk i ka për t'i shitur se do t'i hajë vetë, por, duke ditur nevojën e klasës punëtore, një pjesë të tyre i shet edhe pse mund të mos ketë nevojë për para. Ai e bën këtë se e ndien politikisht si një detyrë duke menduar se, nëpërmjet organizatës së tij tregtare, jo vetëm blen prodhime që nxjerr klasa punëtore, por edhe i shet asaj sende ushqimore që i duhen, si: zarzavate, gjalpë e prodhime të tjera. Edhe sikur të shndërrohen kooperativat e shitblerjes në dyqane të shtetit, nuk është e thënë që nuk do të tregtohen më vezët, gjalpi, qumështi etj., por puna jonë në këtë fushë, sidomos në fshat, duhet të mbështetet në vullnetin e madh të masave. Ne po e

kritikojmë tregtinë me shumë të drejtë se, jo vetëm në fshat, por edhe në qytet, nuk i merr zarzavatet e ndër-marrjeve bujqësore që ka afër. Ne e kemi kritikuar dhe e kemi porositur tregtinë që ajo duhet të shkojë e t'i marrë prodhimet bujqësore edhe në fshatin më të thellë malor. Unë theksoj këtu faktorin popull, masë, që janë direkt të interesuar për tregtinë. Ndryshe është çështja kur u thuhet njerëzve se këto dyqane janë tuajat, se këtu keni edhe angazhime karshi shtetit. Këto angazhime nuk lidhen vetëm me paranë, por edhe me një sërë problemesh të tjera parimore, prandaj çështja duhet parë më mirë. Në qoftë se kështu është më mirë nga ana organizative, nga ana e drejtimit, nga ana ekonomike etj. dhe prodhimet na vijnë më shpejt, më shumë dhe më lirë në qytet, kooperativat e shitblerjes mund t'ia kalojmë tregtisë shtetërore.

Desha të bëj një pyetje: Kur shteti ka nevojë për furnizimin e qyteteve me vezë, për shembull etj., dua të di nëse Partia u është drejtuar ndonjëherë asambleve të kooperativave për të diskutuar me anëtarët e tyre problemin e furnizimit të klasës punëtore në qytete? A i ka sqaruar Partia fshatarët, se punëtorët, që kanë bërë dhe po bëjnë gjithë këto sakrifica, nuk kanë vezë, nuk kanë pula nëpër shtëpi? Është biseduar me ata se ç'duhet bërë për furnizimin e klasës punëtore? Ne duhet të ndalemi në fshat, të bindim njerëzit atje dhe, brenda javës, për shembull, të arrijmë rezultatet që dëshirojmë, domethënë të sjellim vezë në dyqan. FunkSIONJNË këto forma pune apo nuk funksIONJNË?

Ju, drejtuesit e tregtisë<sup>1</sup>, nuk keni bërë mirë që nuk ua keni shtruar këto çështje masave. Ne kemi bërë shumë gjëra të tjera me fshatarët, gjithnjë u kemi thënë atyre: «Oburrani, ngrehuni të bëjmë kanale!» dhe ata janë ngritur. Prodhimin, ne nuk ia marrim fshatarit pa para, por do t'ia blejmë bile dhe një çikë më shtrenjtë. Pra, kryesorja dhe më e rëndësishmja për këto dyqane nuk është çështja e emrit, por çështja e funksionimit të tyre, e veprimtarisë tregtare që ato duhet të ushtrojnë në fshat.

Po të mendohet se këto dyqane kanë për detyrë vetëm që të shesin në fshat mallrat e shtetit, kjo nuk është e drejtë, është e gabuar. Krahas shitjes së të gjitha atyre mallrave për të cilat ka me të vërtetë nevojë fshati, ato duhet të blejnë e të grumbullojnë medoemos edhe të gjitha ato produkte bujqësore e blegtorale që kanë për të shitur kooperativat ose kooperativistët. Dhe shitësit e këtyre dyqaneve nuk duhet të rrinë e të presin që këto produkte, po i sollën vetë kooperativistët, mirë, po nuk i sollën, le të mos i sjellin. Jo, ata lypset të interesohen, të venë derë më derë, te çdo familje kooperativiste dhe të kërkojnë e të blejnë prej tyre çdo gjë që ka nevojë shteti për të furnizuar popullsinë e qytetit, klasën punëtore, ose që i duhet ekonomisë popullore. Përveç kësaj, e gjithë veprimtaria e këtyre dyqaneve, si edhe e shitësve të

---

1. I drejtohet Kiço Ngjelës, në atë kohë ministër i Tregtisë, i pranishëm në këtë mbledhje, i cili, më vonë, u dënua nga gjyqi i popullit për veprimtari armiqësore.

tyre, duhet të jetë nën kontrollin e përhershëm të kooperativave bujqësore dhe të kooperativistëve. Shitësit duhet të lidhen ngushtë me kooperativën bujqësore dhe me kooperativistët, të dëgjojnë e të njohin mirë kërkesat e tyre dhe të përpiqen t'i plotësojnë ato, të hapin dyqanin e të shesin atëherë kur kooperativistët kanë mundësi më shumë të blejnë, kur kthehen nga puna e kanë kohë të lirë. Ata duhet të japin llogari për punën e tyre para kooperativistëve dhe duhet t'u shpjegojnë këtyre nevojat, kërkesat që ka klasa punëtore, popullsia e qytetit për produkte bujqësore e blegtorale.

Po të kuptohet kështu, dhe me dëmos kështu duhet shtruar puna e këtyre dyqaneve, atëherë me siguri ato do të shërbejnë si një hallkë që do të forcojë lidhjet, bashkëpunimin gjithnjë e më të madh midis fshatarësisë kooperativiste dhe klasës punëtore, midis fshatit e qytetit, për të plotësuar gjithnjë më shumë e më mirë nevojat e tyre reciproke.

*Botuar për herë të parë me disa shkurtime në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 128*

*Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbalet e mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

**DREJTUESIT E MINISTRISË SË MBROJTJES JANË  
PËRGJEGJËS DIREKT PËR GJENDJEN NË USHTRI  
DHE DUHET TË PËRGJIGJEN PARA PARTISË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**8 dhjetor 1970**

Ushtria kurdoherë ka pasur dhe ka për ne një rëndësi të jashtëzakonshme. Partia jonë, që po udhëheq me sukses ndërtimin e socializmit, ka shtruar detyrën e madhe që në ushtri të stërvitet, të edukohet politikisht, ideologjikisht dhe teknikisht i gjithë popullit-ushtar, në mënyrë që në çdo moment ai të jetë i gatshëm për të mbrojtur fitoret e socializmit dhe të fi-

---

1. Kjo mbledhje u zhvillua sipas propozimit që bëri shoku Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 26 tetor 1970, në të cilën ai tha: «Pasi ta analizoni këtë situatë në punë ju shokë të ushtrisë, mendoj dhe propozoj të bëjmë një mbledhje tjetër të Byrosë Politike, ku shokët e Ministrisë së Mbrojtjes, Beqiri, Petriti dhe Hitoja, të na raportojnë për rezultatet e kësaj analize dhe, mbi këtë bazë, të bëjmë këtu një diskutim tjetër për t'u dhënë një ndihmë edhe më të madhe këtyre shokëve». (Enver Hoxha, Veptra, vëll. 44, f. 376-377.)



tojë. Prandaj nuk mund të ketë detyrë më të lartë se kjo. Që nga fillimi dhe vazhdimisht Partia nuk ka kursyer asgjë për ushtrinë, për forcimin dhe për modernizimin e saj dhe mund të themi se në sajë të këtij kujdesi kemi arritur rezultate të kënaqshme.

Siç na rezulton nga të gjitha analizat që kemi bërë dhe siç na e vërteton realiteti, ushtria jonë është e përgatitur dhe vazhdon të përgatitet me ritme të kënaqshme për plotësimin e detyrës së saj të madhe. Kjo do të thotë se Partia në ushtri, kuadrot, i gjithë efektivit, qoftë ai aktiv, qofshin kuadrot rezervë, vullnetarët dhe mbarë populli, rëndësinë e ushtrisë e kanë kuptuar drejt, e duan atë dhe bëjnë përpjekje ta forcojnë gjithnjë e më shumë. Por një përgatitje më e mirë, që vjen duke u përsosur vazhdimisht, e, në radhë të parë, një përgatitje shpirtërore, politike dhe ideologjike më e shëndoshë e ushtrisë (siç e vunë në dukje gjithë shokët), varet kryesisht nga ne.

Të tërë kemi përgjegjësi përpara Partisë për këtë problem të madh. Në radhë të parë kemi përgjegjësi ne, Byroja Politike, përpara Komitetit Qendror dhe dëshiroj të theksoj këtu me këtë rast se ne kemi shumë kohë që nuk kemi raportuar para tij për punët në ushtri, si e në ç'gjendje është ushtria jonë. Prandaj është mirë që këtë ta bëjmë sa më parë. Vitin e ardhshëm, mendoj unë, ne duhet t'i paraqesim Komitetit Qendror një raport për gjendjen ushtarake<sup>1</sup> dhe ta

---

1. Kjo u bë në Plenumin e 12-të të Komitetit Qendror të PPSH, i cili u mbledh nga data 29 qershor deri më 1 korrik 1971, ku u shqyrtua raporti i Byrosë Politike të KQ të PPSH

plotësojmë kështu këtë mungesë, jo se Komiteti Qendror nuk është në korent për gjendjen e përparimet që janë arritur në ushtri, sepse anëtarët e Plenumit, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë marrë pjesë në zhvillimin e në ndërtimin e ushtrisë, në stërvitjet e saj etj., po çështja është t'i raportojmë si udhëheqje në tërësi.

Por shokët që janë ngarkuar nga Komiteti Qendror të punojnë në ushtri janë drejtpërdrejt në mënyrë të veçantë përgjegjës për mbarëvajtjen e saj dhe duhet të përgjigjen para Partisë, ashtu siç përgjigjen të gjithë shokët në sektorët e tjerë ku janë ngarkuar të punojnë, për të metat, për gabimet e boshllëqet që vërtetohen në punë, dhe këtë ata ta bëjnë mirë, ashtu siç e kanë zakon ta bëjnë komunistët. Shokët e ngarkuar me funksione të rëndësishme në ushtri, kanë pasur mjaft gabime e të meta, të cilat na janë bërë të njohura, herë aty për aty, herë me zor. Udhëheqja, Byroja Politike, në rrugë partie, ka mundur t'i zbulojë këto të meta e gabime dhe në interes të Partisë e të ushtrisë ka folur haptas me kuadrot ushtarakë, i ka kritikuar dhe do të vazhdojë të kritikojë hapur cilindo qoftë, kur në punën e njërit apo të tjetrit zbulohen të meta ose gabime. Kjo është bërë dhe bëhet me qëllim që t'i korrigojmë kuadrot.

E para e punës, është e domosdoshme që gabimet

---

«Mbi masat për përsosjen e mëtejshme të përgatitjes e të gatishmërisë luftarake të ushtrisë dhe të forcave vullnetare të vetëmbrojtjes popullore». Në mbyllje të punimeve të Plenumit, shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm. (Shih: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore (Përmbledhje veprash)», vëll. I, Tiranë, 1983, f. 555.

e të metat të mos lihen të trashen, përkundrazi, duhen bërë përpjekje që ato të zhduken, porsa nxjerrin majën e veshit dhe në asnjë mënyrë të mos lejohet të majisen, të fshihen dhe të përsëriten. Ka shokë komunistë që, me gjithë anët e mira që kanë, me gjithë vendosmërinë që kanë për Partinë, kanë edhe disa mbeturina në ndërgjegjen e tyre, të cilat i pengojnë të veprojnë si duhet, bëjnë gabime e i thellojnë ato, pa parë rrezikshmërinë e tyre në platformën e interesit të madh të Partisë dhe të popullit. Po ta kishin parasysh këtë, unë mendoj se shokët, natyrisht, do të tërhiqeshin përnjëherësh nga pozitat e gabuara. Shfaqje të kësaj natyre, që nisin në fillim si shfaqje të sferës individuale, personale, po të qëndrojnë pa u spastruar, me dashje ose pa dashje kalojnë në platforma politike.

Nga ana tjetër, kur analizojmë çështje të kësaj natyre dhe kritikojmë shokët, ose kur ata kritikojnë të tjerë në punë e sipër, duhet pasur parasysh dhe duhen bërë përpjekje për të qenë të thjeshtë, jo në shfaqje, po në jetën dhe në shpirtin e secilit, domethënë, të luftojë secili në vetvete ambicien, megalomaninë, prirjen për t'u dukur, mbeturina këto që nganjëherë i mbulojnë shfaqjet e jashtme. Prandaj, në qoftë se çdo shok lufton në veten e tij për t'i zhdukur ato dhe bën përpjekje të ruajë me të vërtetë thjeshtësinë e komunistit, ai, kur bën gabime duhet t'i presë me zemër të hapët e jo të ndrydhur kritikën nga shokët, t'i presë me bindjen e plotë se me to po shërohet, se shokët po bëjnë përpjekje ta shërojnë dhe jo ta godasin apo ta ulin. Dua të them që i kritikuari të mos dalë i vrarë dhe i tkurrur në një rast të tillë, po të dalë si një njeri i kri-

tikuar, të cilin shokët përpiqen ta ndihmojnë të ndreqet.

Tashti le të vijmë konkretisht në çështjen për të cilën jemi mbledhur. Shokët e ushtrisë, të komandës, e kam fjalën për ata të Ministrisë së Mbrojtjes, mendoj se kanë gabuar në punën e tyre të drejtimit. Drejtimi në Ministrinë e Mbrojtjes Popullore nuk ka qenë në nivelin që kërkohet, ai ka çaluar mjaft dhe kjo, në radhë të parë, për faj të Beqirit dhe të Petritit, por edhe të drejtorit të Drejtorisë Politike, Hito Çakos. Sidoqoftë, përgjegjësit kryesorë janë dy të parët. Unë mendoj se në punën e tyre, siç e vunë në dukje edhe shokët që folën, ka pasur prirje të theksuara kapadailleku, në kuptimin e përpjekjeve për të vënë në dukje veten se kush është më i zoti, njëri apo tjetri, kush është më i aftë nga ana ushtarake etj.

Po ta marrim çështjen nga ana e pozitës, qoftë në Parti, qoftë në komandë, është e qartë për të gjithë se nga kjo pikëpamje në ministri Beqiri është përgjegjësi kryesor. Tek ai duhet të ketë pasur njëfarë predispozicioni joshoqëror ndaj kritikave që i janë bërë herë pas here për mjaft probleme. Beqirit mund t'i jetë dukur sikur ndonjëri përpiqet të tregohet se është më specialist se ai në çështjet ushtarake dhe, me prepotencën e me të gjitha veprimet e tij, duhet të ketë dashur jo vetëm t'ia ulë pak hundën, për shembull, Petritit, po sikur të kishte mundësi, në qoftë se nuk gabohem, edhe ta mënjanonte apo ta largonte fare nga Shtatmadhoria, sepse detyra e shefit të Shtatmadhoriës në ushtri është një funksion kyç me shumë rëndësi, ai është dora e djathtë e ministrit të Mbrojtjes. Për këtë

arsye, bashkëpunimi më i ngushtë i ministrit është i domosdoshëm të realizohet në radhë të parë me shefin e Shtatmadhorisë, me të cilin ai duhet të bëjë konsultime për të gjitha çështjet. Sigurisht, ministri mund të ketë dhe ka lidhje edhe me zëvendësministrat e Mbrojtjes, por shefi i Shtatmadhorisë, që ka në dorë të gjitha drejtimit, është atje vartësi kryesor i ministrit.

Beqiri, ashtu sikurse cilido shok tjetër, ka pasur edhe ai të drejtë t'ia vinte në dukje të metat Petritit, për arsye se edhe ky ka mjaft të tilla, siç janë ato që kanë të bëjnë me karakterin e tij, të meta në punë, në planëzimet, në metodën e punës, në mënyrat subjektive dhe në influencimet individuale dhe gjëra të tjera të kësaj natyre, siç ia vunë në dukje shokët. Në rrugë partie dhe në rrugë shtetërore, individualisht dhe në mënyrë kolegjiale, Beqiri e kishte për detyrë t'ia vinte këto në dukje Petritit dhe, në qoftë se ky nuk i ndreqte, çështja mund të sillej fundi i fundit edhe më lart.

Ne shohim se në ushtri, përveç që bëhen lëvizje të mëdha kuadrosh në përgjithësi, atje lëvizen shpesh edhe kuadro kryesorë. Një punë e tillë tani është prerë, se i kemi theksuar Beqir Ballukut që t'u jepen fund lëvizjeve të pajustificuara, por ajo që dua të vë në dukje dhe që ka lidhje me këtë problem, është çështja se pikëpamjet e Beqirit për kuadrin shpeshherë janë kontradiktore dhe shumë të lëkundshme. Përse vjen kjo? Për shumë arsye, po vjen edhe sepse Beqiri, mendoj unë, e nënvleftëson kapacitetin e kuadrit. Por, duke nënvleftësuar të tjerët, ai mbivlerëson veten, abuzon kështu deri në njëfarë shkalle me autoritetin e tij. Mendimet e Beqirit për kuadrin, në mjaft raste janë

të cekëta, të sipërfaqshme dhe këto raste jo vetëm përsëriten, po janë të theksuara në karakterin e tij, prandaj në këtë çështje ai duhet të bëjë një kthesë të fortë.

Unë e dëgjova me kujdes të madh diskutimin që bëri sot këtu Beqiri. U duk sikur ai i shtron dhe i mbron problemet në mënyrë parimore e energjike. Por në realitet, në punën e tij nuk është vërtetuar plotësisht dhe kurdoherë një gjë e tillë. Siç e tregoi edhe konsulta që u bë në aparatin e Komitetit Qendror, siç e analizoi çështjen kolegji i ministrisë dhe siç e thanë edhe të gjithë të tjerët me radhë, Beqiri vuan nga shumë të meta në organizimin dhe në kontrollin e zbatimit me rreptësi të detyrave. Ne që kemi kontakte dhe një kohë të gjatë pune me të, e kemi konstatuar këtë të metë të tij. Unë kam mendimin se Beqiri, pasi merr detyrën që i jepet dhe duket sikur e vë në lëvizje, më tej, në shtytjen e saj përpara, në kontrollin e zbatimit të saj, në zbërthimin dhe në çuarjen e saj gjer në fund, pikërisht këtu çalon ai.

Me këto dhe me shumë të meta serioze në karakterin e tij, Beqiri ka krijuar një situatë të vështirë në udhëheqjen e Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë ka ndikuar edhe një gjë tjetër negative, qëndrimi i Petritit, fakti që edhe ky ka të meta serioze në personin e vet, pse është ca si «kavalier» dhe jo shumë i thellë në problemet, me sa më duket mua. Petriti ka vënë në dukje probleme, por duke i parë në një prizëm të sëmurë. Ai thotë se Beqiri e ka parë atë në të gjitha çështjet si një njeri krejt pa vlerë dhe se nuk ka fare konsideratë për zotësinë e tij. Pra Beqiri nuk e konsi-

deron Petritin në atë shkallë si veten e tij, se zotësinë e këtij ai nuk e vlerëson në atë nivel që mund dhe duhet të ketë shefi i Shtatmadhorisë. Kështu, kur vjen puna për të menduar kush mund të jetë shef i Shtatmadhorisë, Beqiri lehtë mund të propozojë një kandidaturë që t'u afrohet karakteristikave të natyrës së tij, domethënë, një njeri që as të mos kërkojë dhe as të mos përplasë me të.

Por ajo që është e rrezikshme në këtë punë dhe jo në rrugë partie nga ana juaj, Beqir e Petrit, është çështja se gabimet tuaja po përsëriten. Gabime mund të bëhen, po për ushtrinë dhe për Partinë ato janë fort të rrezikshme kur përsëriten. Kjo tregon se ju, jo se nuk i kuptuat kur i shtruat edhe i diskutuam në Byronë Politike 4-5 vjet më parë<sup>1</sup> gabimet dhe pikëpamjet tuaja të gabuara për sa u përket marrëdhënieve në mes jush, pse fakt është që atëherë ju i pranuat ato, por jeta provoi se nuk ishit të bindur, ose nuk ishit në gjendje, nuk kishit atë forcë komunisti t'i mposhtnit mbeturinat që ju shtynë në gabimet ku ratë më parë

---

1. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 18 mars 1966, në të cilën u shqyrtuan edhe marrëdhëniet midis dy drejtuesve kryesorë të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, Beqir Ballukut e Petrit Dumes, shoku Enver Hoxha i kritikoi rreptë këta për situatën e sëmurë që kishin krijuar në mes njëri-tjetrit e në dikaster, për shfaqje të arrogancës, për tendencën e tyre për t'u dukur dhe për një sërë të metash e dobësish në punë e në drejtimin e ushtrisë. Ata në këtë mbledhje bënë autokritikë dhe premtuan se do ta shëndoshnin gjendjen në ministri, por jeta tregoi se këtë e bënë sa për të kaluar radhën, për të fshehur qëllimet e tyre të errëta.

dhe ato nxorën kokën përsëri te ju. Për këtë arsye kritika ndaj jush nga ana e Byrosë Politike kësaj here duhet të jetë, sipas mendimit tim, shumë më e rreptë, pse tani ju keni bërë faj shumë herë më të rëndë nga i pari, prandaj edhe dënimin e meritoni ta merrni shumë më të rëndë se atëherë. Në atë kohë ne nuk morëm ndonjë masë ndëshkimore ndaj jush, por tashti mendoj që Byroja Politike t'u japë që të dyve një dënim dhe të reflektoni thellë, se është e dyta herë që po përsëritni të njëjtin gabim, duke i shkaktuar dëme çështjes së Partisë dhe të ushtrisë.

Natyrisht, ne kemi bindje, dhe kurdoherë e kemi pasur këtë bindje dhe besim te shokët, se ju do t'i ndreqni gabimet tuaja, po kjo masë të kuptohet se është për të mirën e Partisë, të ushtrisë dhe tuajën dhe ajo do t'ju ndihmojë t'i korrigjoni gabimet, në rast se do të reflektoni dhe do të përpiqeni të mos i përsëritni më. Po të na vijë më një gjë e tillë për të tretën herë në Byronë Politike, po të përsëritet prapë, është e kuptueshme dhe bashkohem plotësisht me mendimin e shokëve se atëherë do të marrim masa shumë më të rënda.

Vihet pyetja: Gjersa ju e dini mirë se Partia ka zgjidhur çështje akoma më të vështira se kjo juaja, përse ju e latë këtë çështje të trashej kaq shumë? Kanë të drejtë shokët kur thonë se ju të dy, Beqir dhe Petrit, u përpoqët këtu të linit përshtypjen se nuk erdhët tek unë për sheshimin e këtyre mosmarrëveshjeve, për arsye se, sipas jush, këto qenkeshin për gjëra korente, por edhe ju vetë e kuptoni se këto s'ishin të tilla. S'ka dyshim se mendime të kundërta për çështje korente



mund të ketë dhe duhet të ketë mcdoemos gjatë përpjekjeve që bëjmë për zgjidhjen e drejtë të problemeve, po këto tuajat nuk kishin karakterin e diskutimeve që bëjmë ne ngaherë me njëri-tjetrin. Karakteri i kundërshtimeve tuaja, sidomos i ju të dyve, nuk ka të bëjë me shfaqje mendimesh, ai është krejt i ndryshëm prej këtyre. Ju i keni thënë njëri-tjetrit pikëpamjet: Jo «ma bën apostafat këtë», jo «kërkon të më skartosh mua» etj. dhe këto ia thoni jo në kohën e duhur, por tani në fund. Nëse nuk ia thoshit dot njëri-tjetrit, përse nuk erdhët që të dy tek unë dhe ta zgjidhnim këtë çështje? Për ne është e qartë, more shokë, përse ju nuk erdhët, sepse, po të vinit tek unë, do të dilte pikërisht për të dytën herë se midis jush, dy shokëve kryesorë të Komandës së Përgjithshme, ka mosmarrëveshje e grindje joparimore për çështje pune, por që kanë degjeneruar. Të dy këta shokë, duke e ditur se kjo gjendje nuk është në rrugë të drejtë, kanë menduar «ta rregullojmë në mes nesh këtë çështje», pra, ta mbajnë të mbyllur. Një metodë pune e tillë është e shtrembër, prandaj duhet të braktiset menjëherë dhe në asnjë mënyrë të mos përsëritet. Ajo nuk do të përsëritet vetëm në qoftë se ecet në rrugën e drejtë të Partisë.

Ne nuk jemi dakord me vlerësimin që Petriti i bëri ushtrisë në mbledhjen e kaluar<sup>1</sup>. Atëherë ai na e bëri

---

1. Në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 26 tetor 1970, ku u diskutua për punën ideopolitike dhe për forcimin e jctës së brendshme të Partisë në ushtri. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 44, f. 359.)

të zezë gjendjen, kurse sot, në fillim të diskutimit, na e bëri shesh me lule, por në pjesën e mëpasme të diskutimit ai filloi edhe nga kritikata.

Kundërshtimet në pikëpamjet e shokëve ushtarakë në mbledhjen e Byrosë Politike u paraqitën në këto tri drejtime:

1) Në fushën e përgatitjes ushtarake dhe të gatishmërisë së ushtrisë.

2) Në efektivitetin e komiteteve të Partisë në ushtri dhe të marrëdhënieve të tyre me shtabet, komandantët e komisarët.

3) Në kuptimin dhe në zbatimin e rregulloreve, të urdhrave etj.

Natyrisht, Byronë Politike e shqetësoi shumë kjo gjendje e punëve në ushtri, prandaj ajo e bëri me të drejtë problem. Nga analiza që iu bë kësaj çështjeje, doli se në ministri ekziston një situatë jo e shëndoshë, që ne duhej ta sqaronim dhe e sqaruam. Shokët ushtarakë, që morën pjesë në konsultën e organizuar për këtë qëllim, me diskutimet e tyre, në vija të përgjithshme, u treguan optimistë në çdo gjë në lidhje me kundërshtimet e përmendura më lart, ata vunë në dukje anët pozitive të punës, vunë në dukje, gjithashtu, edhe anët negative.

Tashti ne duhet të mendojmë akoma më thellë për këtë çështje, sepse puna juaj në ushtri ka lënë gjurmë, ajo nuk është aq e thjeshtë, ju vetë e thatë se atje po flitet për marrëdhëniet tuaja. Kjo është shumë e rrezikshme, sepse nuk është çështja se në Shtatmadhori, sikurse në Qeveri ose në Byronë Politike, bëhen diskutime të frytshme e të zjarrta për problemet dhe në-

përmjet tyre dilet me të vërtetë në konkluzione të drejta, po është shumë shqetësuese kur në ministri dhe poshtë në reparte të gjithë thonë se Beqiri me Petritin s'janë në rregull, kanë mosmarrëveshje.

Unë mendoj se ne duhet të reflektojmë edhe për një çështje tjetër, për të cilën fola pak më parë, çështjen e mendjemadhësisë, e veshur kjo me petkat e thjeshtësisë, që shfaqet edhe në metodën e stilit e punës së këtyre shokëve. Mos ka influencuar vallë kjo gjendje edhe poshtë në reparte, në shtabe e në komanda?

Për sa u përket mbledhjeve të Këshillit të Mbrojtjes, këto janë bërë kryesisht me shtytjen tonë, asnjëherë ato nuk janë bërë me iniciativën e Beqirit ose të shokëve të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes. Dhe kup-tohet: Si është e mundur t'i paraqiten të tilla probleme Këshillit të Mbrojtjes nga ministri i Mbrojtjes, kur vetë ky, që është njëkohësisht anëtar i Byrosë Politike, nuk vjen herë pas here te Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë dhe t'i shtrojë atij probleme? E kam fjalën këtu për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të ushtrisë dhe jo për gjëra të vogla e të shkëputura, se për këto, natyrisht, është biseduar. Probleme kyç të ushtrisë, pra, nuk na janë servirur dhe të tilla probleme ka plot, juve ju dalin atje vazhdimisht përpara. Në qoftë se çështje të kësaj natyre do të na shtroheshin për diskutim, qoftë ballë për ballë, ose nga dy e tre veta, ne do të nxirrnim medoemos probleme për t'ia paraqitur Këshillit të Mbrojtjes. Mirëpo të tilla nuk na vijnë.

Kush e ka fajin për këtë? Mund të marrim edhe

ne ca faj, në kuptimin që Beqirit t'ia vinim të dyja këmbët në një këpucë, pavarësisht se disa herë nuk kemi mbetur pa thënë të bëjmë këtë ose atë. Por, Beqiri, që është i ngarkuar apostafat për çështjet e ushtrisë, që duhet të dijë ku i dhemb e ku i ther, çfarë duhet bërë e çfarë nuk duhet bërë, duhej të na shtronte probleme, kurse ai s'ka ardhur te ne as edhe për ato që i janë thënë.

Kisha shkruar një herë një punim të vogël për disa çështje të ushtrisë<sup>1</sup> dhe ia dhashë Beqirit t'i lexonte e t'i shikonte me syrin se ç'mund të bënim me to. Këtë shkrim unë s'e bëra kot dhe shoku Beqir e mori atë përnjëherësh, e këndoi, «e studioi» dhe më tha se aty nga gushti ose shtatori do të vinte të më raportonte, mbasi, sipas tij, gjer në atë kohë diçka do të kishte realizuar. Unë e kam pritur të vinte, sipas fjalës së dhënë, po akoma nuk më ka ardhur për këtë problem, për të cilin mendoj se po punohet, sepse në atë material flitet për çështjet e ushtrisë dhe të popullit-ushtar.

Kur në raportet që na jepen, pavarësisht nga sukseset e mëdha që kemi në ushtri, shikojmë të meta, siç është, për shembull, ajo që përgatitja taktike, teknike dhe fizike në reparte, që duhet të konsiderohet treguesi kryesor i ushtrisë sonë, nuk bëhet në nivelin e duhur, atëherë kemi të drejtën të mendojmë, përse e kemi ushtrinë, cili është qëllimi i saj? Në qoftë se

---

1. Në datën 5 mars 1970 shoku Enver Hoxha shkroi «Tezat për Shkollën e Lirë Ushtarake» të cilat armiku i kamufluar Beqir Balluku i mbylli në kasafortë. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 43, f. 1.)

në raportet si ky që na bën Rahmani<sup>1</sup> thuhet që ushtria çalon në këto drejtime, atëherë na shkon përnjëherësh mendja se ajo çalon në çështjet themelore.

I gjithë qëllimi i punës sonë në ushtri është përgatitja e trupës sa më afër kushteve të luftimit. Ju e ngrini këtë çështje dhe në këtë drejtim punohet. Për këtë qëllim kanë dalë edhe projekttezat e Këshillit të Mbrojtjes. Megjithatë ushtarëve nuk u mësohen sa duhet parimet, normat, rregullat bazë të luftimit etj. Në ushtri nuk shohim të zbatohen me rreptësi rregulloret, urdhrat dhe detyrat; te mjaft kuadro ekzistojnë akoma koncepte të gabuara, siç është, për shembull, ideja e gabuar se «vetëm ushtria e grumbulluar në kazerma ka disiplinë» ose ideja tjetër e sëmurë, liberale e likuidatore, sipas së cilës «ushtria mund të bëjë edhe pa rregullore».

Unë edhe më parë kam reflektuar për problemin rreth të cilit do të flas, por tani po e konkretizoj dhe mendoj se duhet ta shohim akoma më mirë dhe të nxjerrim përse i kemi këto dobësi. Mos vallë jeni larguar nga baza? Ose me organizimin aktual, duke krijuar gjithë këto njësi të mëdha ushtarake mos jeni larguar nga trupa? Natyrisht, këto duhen, sepse ushtria është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të hapet në kohë lufte, se ushtarët duhet të përgatiten mirë etj., por në qoftë se do t'i lëmë gjithë këta kuadro, që kemi grumbulluar në to, t'u marrin frymën shokëve poshtë, duke kaluar nëpër repartet si era apo duke ardhur rreth e rrotull shtabeve duke u krekosur, në vend që

---

1. Rahman Perllaku.

të venë e të ngulen për të mësuar konkretisht shtabet e reparteve e të nënreparteve, të punojnë e të jetojnë me ta, kështu bëjmë gabim.

Gjersa konstatojmë që shtabet e disa reparteve nuk janë në rregull, se kanë mjaft dobësi, pa folur për komandat e nënreparteve, duhen gjetur shkaqet përse këto komanda nuk janë në rregull. Nuk keni menduar ju për këtë, që është një problem me shumë rëndësi? Këta njerëz që kemi vënë atje nuk janë aq të rinj, ata kanë mbaruar Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, kanë vite që po shërbejnë në ushtri, atëherë si nuk qenkan ata në gjendje të drejtojnë si duhet një nënrepart, kur ne, gjatë luftës partizane, pa e njohur fare artin e luftës, kemi drejtuar batalione, brigada etj.? Unë do të flas pak edhe për rezervistët, po çështjen e kam këtu që, si është e mundur t'i konsiderojmë ne gjithë këta kuadro si njerëz fare pa vlerë dhe, për arsye se një pjesë prej tyre kanë arritur moshën rreth 40 vjeç, t'i skartojmë nga komanda e nënrepartit? Unë mendoj se edhe në rast lufte këta njerëz mund ta bëjnë detyrën e komandantit.

Organizimin ekzistues ne e kemi vendosur me plot bindje, mirëpo këtij organizimi duhet t'i përgjigjemi edhe me një metodë të re pune dhe jo të vazhdojmë me metodën e vjetër të kazermës. Përveç kësaj, ne hoqëm edhe gradat për arsyet që dihen. Mirëpo, ka nga ata që thonë: «Meqenëse tani u bëmë komandantë njësie ose punojmë pranë shtabit të njësisë, nuk e bëjmë më kabull të vemi të shohim si punon trupa poshtë». Dhe po të shohim, shokë, ç'kemi grumbulluar në njësitë e mëdha, na del se atje kemi

një mori kuadrosh me eksperiencë, të cilët, në rast se nuk ndërrojnë metodën dhe stilin e punës, në rast se nuk e kuptojnë si duhet heqjen e gradave, thjeshtësinë e kuadrove dhe demokratizimin e ushtrisë, duke i ruajtur format organizative që kemi, ata do t'u qepen më shumë zyra të shtabeve dhe do të merren me shkresa, në vend që të venë tek trupa. Nuk e them dot ekzaktësisht sa venë e si venë tek trupa shokët e njësive më të larta, por në qoftë se venë dhe punojnë mirë, atëherë nuk ka përse të jenë të dobëta shumë nga shtabet e reparteve ose të nënreparteve. Është e qartë, pra, se në këtë drejtim nuk po punohet si duhet.

Duke ruajtur në ushtri organizimin aktual, që u përgjigjet nevojave dhe kushteve të një ushtrie popullore, siç është kjo jona dhe, duke marrë parasysh dobësitë që u konstatuan veçanërisht në përgatitjen luftarake, në stërvitjen e trupës, mendoj se ne duhet të rishikojmë çështjen e komandave dhe të shtabeve të njësive të larta, si edhe organikat ekzistuese të vetë Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Këtë rishikim mendoj ta bëjmë me synimin që kuadrot të vendosen në një mënyrë të tillë që të mobilizohen totalisht në kryerjen e detyrave të caktuara dhe, sa të jetë e mundur, në asnjë rast të mos lëmë shteg pa arsye për një shpërndarje të panevojshme. Qëllimi i kësaj pune duhet të jetë, pra, që kuadrot që kemi t'i bëjmë shumë më rentabël, sepse nuk janë të gjithë kështu sot, kur shtrohet detyra për të përgatitur gjithë këtë masë të madhe të popullit-ushtar.

Bashkë me këtë organizim më të drejtë të ushtrisë, natyrisht, duhej ndërruar edhe metoda e stili i punës

nga ana e kuadrove të ushtrisë, mbasi edukimi i saj nuk është dhe nuk mund të bëhet më në format dhe në gjendjen që ishin para organizimit. Ishte e domosdoshme të vendosej një metodë dhe një stil pune krejt i ndryshëm nga i pari që t'i përgjigjet hapjes aktuale të ushtrisë. Natyrisht, përpjekje në këtë drejtim janë bërë dhe mund të themi se ka suksese, por mendoj se komandat e njësive të larta ushtarake që kemi krijuar na kanë absorbuar shumë veta dhe nga kuadrot më të mirë të ushtrisë.

Ka, gjithashtu, mundësi që në organikat e komandave e të shtabeve të kemi qenë ca dorë lirë dhe të mos kemi pasur parasysh nevojat e mëdha që na dilnin përpara. Në këto çështje, natyrisht, ne jemi udhëhequr kurdoherë nga qëllimi i mirë që të krijojmë komanda me kuadro të përgatitur, me eksperiencë, të aftë dhe pak a shumë të kompletuar. Kështu mund të kemi bërë, gjer në njëfarë shkalle, edhe në komandat e në shtabet e njësive më të ulëta.

Në analizën që u bë ka dalë qartë se ka shtabe të reparteve, komanda të nënreparteve, siç e thashë edhe më parë, që janë shumë të dobëta, prandaj na vihet detyrë e madhe që tani të gjitha këto t'i ngremë. Natyrisht, edukimi dhe plotësimi i tyre duhet bërë në mënyrë revolucionare, duke u përpjekur për të gjetur shumë forma, disa prej të cilave i kemi gjetur, i kemi diskutuar dhe po i diskutojmë, por kjo kërkon, mendoj unë, që nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore të bëhet, së pari, thjeshtimi i vetë aparatit të saj, ashtu siç po veprohet edhe në dikasteret e tjera, me qëllim që në ministri-të lëmë, në numrin e nevoj-



shëm, kuadro të zotë për drejtim, për studim e për operativitet dhe të heqim andej të gjithë ata që kanë zënë poste të panevojshme e paralele dhe t'i çojmë në bazë.

Po ku të çohen? Me kohë është krijuar mentaliteti se kuadrot që kanë punuar në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtatmadhori, që edhe nga mosha janë të kaluar, nuk janë të rinj, «janë të kalibrit të lartë». Kështu që, në qoftë se vjen puna ta marrim këtë masë, mendja na shkon menjëherë që këta të futen nëpër shtabet e njësive të larta të ushtrisë. Mirëpo një gjë e tillë do të sillte fryrjen e organikave të tyre edhe më shumë nga sa i kanë sot. Prandaj, edhe për komandat e shtabet e këtyre njësive Ministria e Mbrojtjes Popullore mendoj të bëjë një studim për të parë nëse duhet të vazhdojnë të ekzistojnë ato realisht në këtë periudhë, apo t'i ruajmë si forma nga më të përshtatshmet, që e kanë dhënë provën e drejtimit të nevojshëm dhe të domosdoshëm për kohën e emergjencës.

Çështja duhet të vihet kështu: Këto komanda e shtabe dhe gjithë këta kuadro të kualifikuar që kemi lart, janë rentabël të qëndrojnë aty në këto situata, kur kemi nevoja të mëdha për të ngritur dhe për të forcuar bazën? Këta kuadro, duke punuar në këto funksione, a e japin në të vërtetë atë ndihmë reale që mund të jepnin, po të shkonin të punonin në bazë, në komandat apo në shtabet e njësive? Kështu mund të themi me radhë për komandantët e për anëtarët e shtabeve të njësive dhe për kuadrot e tepërt që mund të kemi në këto njësi, duke i parë edhe nga mosha e tyre, të cilët mund të zbritnin në komandat dhe në

shtabet e reparteve, kurse kuadrot e këtyre të fundit në komandat dhe në shtabet e nënreparteve.

Me një shtytje të tillë, natyrisht joautomatike, por të studiuar me kujdes, ne do t'i forconim akoma më shumë nga sa i kemi sot komandat e shtabet e një-sive, por njëkohësisht do të forconim sidomos komandat e reparteve ku jemi më dobët. Me këtë ne do të kemi bërë edhe një gjë tjetër, që kuadrot, në fakt, t'i afrojmë me bazën, me ushtarët, me stërvitjen konkrete, me zbatimin konkret të detyrave. Kështu do t'i ndihmojmë e do t'i stërvitim më mirë edhe kuadrot e rinj dhe, brenda një periudhe të shkurtër shërbimi, të ngremë më lart nivelin dhe aftësitë e tyre. Në bazë, tani na mungojnë kuadro, se shumë nga ata kanë vajtur lart në majën e «piramidës», sepse nuk është menduar aq thellë për repartet e nënrepartet, ku kuadrot kanë një barrë të rëndë, për arsye se stërvitin jo vetëm ushtrinë aktive, por edhe rezervistët, edhe pjesën tjetër të popullit-ushtar.

Në këto kushte, na lejohet neve një luks i tillë? Na lejohet që kuadro me vlerë të vazhdojnë të qëndrojnë në krye të «piramidës»? Këtë e them jo se ata nuk kryejnë detyrën dhe kompetencat që u janë dhënë, po sidoqoftë janë larg bazës, prandaj mendoj se rentabiliteti i tyre nuk është ai që do të ishte nëse ata do të lidheshin konkretisht e më shumë me trupën, duke zbritur në bazën e «piramidës».

Këtej del edhe çështja e zhvillimit të lojërave me pjesëmarrje të madhe, të cilat janë të nevojshme, pse janë një pjesë përbërëse e gjithë veprimtarisë së ushtrisë. Vërtet këta kuadro dhe shtabet, që janë krijuar

për të drejtuar njësi të larta të ushtrisë sonë, në planet e punës së tyre duhet të parashikojnë edhe stërvitje të tilla, mirëpo neve na vihet detyra që stërvitjet taktike, stërvitjet e zjarrit etj., me një fjalë, gjithë edukimi i ushtrisë, të përsoset në bazë, në nënreparte e në reparte, që të dalim pastaj edhe në manovra të mëdha. Por, siç po na raportohet, kuadrot dhe shtabet në bazë në disa raste janë të dobëta. Konstatohet, gjithashtu, që në stërvitje të trupës shpesh mungojnë kuadrot drejtues të njësive të larta, shumë herë edhe të njësive më të ulëta, pa lëre pastaj të ministrisë. Një çështje e tillë meriton ta studiojmë, pse mund të jetë një masë plus dhe më konkrete që i shtohet dhe fuqizon masat e tjera konkrete që duhet të marrim për edukimin e kuadrove drejtues të njësive ushtarake, si për ushtrinë aktive, edhe për atë rezervë. Në qoftë se ne i ruajmë siç i kemi komandat e njësive të larta, t'i thjeshtojmë ato, në qoftë se jo, duhet të mendojmë për krijimin e njësive të tjera më efikase<sup>1</sup>.

Ushtrinë aktuale aktive, për arsyet që thashë, ne duhet ta konsiderojmë jo një ushtri kazerme, por një shkollë, nga e cila ushtari i thjeshtë, pasi kryen shërbimin ushtarak, të dalë një kuadër i përgatitur, të paktën komandant skuadre apo toge. Natyrisht, gjatë kohës në rezervë, ai do të vazhdojë të stërvitet e të

---

1. Kjo ide e shokut Enver Hoxha, e hedhur qysh në vitin 1970 nuk gjeti zbatim për shumë vjet, si pasojë e veprimtarisë armiqësore të grupit puçist të Beqir Ballukut, të Petrit Dumes e të Hito Çakos dhe më vonë sepse u zvarrit dhe u pengua nga kryekomplotisti, armiku i kamufluar Mehmet Shehu.

perfeksionohet më tej, por ushtari, me të mbaruar ushtrinë, duhet të dalë i përgatitur për qëllimin që thashë. Që t'i arrihet këtij qëllimi është e domosdoshme që rendimenti i kuadrove që kemi aktualisht në ushtri, të rritet dhe njëkohësisht të mendohet për të bërë një rishpërndarje më të drejtë të tyre.

Kjo çështje, mendoj unë, nuk duhet të bëhet duke krijuar perturbacione organizative, siç është bërë zakon në ushtri. Një herë ky studim të bëhet së pari vetëm nga tre-katër kuadro të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët të na e paraqesin, duke na nxjerrë çfarë del prej tij, është i drejtë apo nuk është, do të kemi përfitime prej tij apo nuk do të kemi, duhet t'i mbajmë këto komanda dhe shtabe ekzistuese të njësive të larta apo nuk duhet t'i mbajmë. Nëse del e nevojshme t'i mbajmë, të na thuhet si duhet t'i mbajmë, në rast se i prishim dhe i mbajmë në organikë rezervë, të jepen mendime si t'i gjallërojmë ato, me qëllim që gjithë këtë eksperiencë të madhe të fituar jo vetëm ta mbajmë në nivelin që është arritur, po ta përmirësojmë më tej me kurse, me stërvitje komando-shtabi që kuadrot, të cilët, në kohë të caktuara, do të marrin komandën e njësive, të mos shkëputen nga praktika dhe nga teoria e drejtimit të këtyre njësive të larta.

Këtë mendim unë e nxjerr jo vetëm nga sa thashë më lart, po, siç e theksova, ai del edhe nga metoda jo e përshtatshme e punës që ka Ministria e Mbrojtjes, metodë që është reflektuar edhe te kuadrot e njësive ushtarake e kështu me radhë më poshtë.

Kuadrot kryesorë drejtues në ministri i ka mbuluar rutina, ata merren më shumë me çështjet ko-

rente të ditës e shpesh me gjëra të vogla, që fare mirë mund t'i kryejnë ndihmësit e tyre dhe lënë pas dore, zvarritin studimet bazë ose lejojnë të studiohen përciptas problemet kyç, ndryshimet që duhen bërë dhe që i kërkon puna dhe koha sot e në perspektivë.

Kuadrot ushtarakë të të gjitha niveleve kanë mundësi të bëjnë një punë edhe më të mirë, po nuk orientohen e nuk drejtohen si duhet për shkak të dobësive e të metave të aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes, që nuk i jep bazës ndihmë të mjaftueshme. Në ministri ekziston mania e të shkuarit për inspektim në bazë, po kuadrot e qendrës atje nuk ngulen sa duhet, merren më shumë me gjetjen e gabimeve e me mbajtje shënimesh sa për të mbushur blloqet, konkluzionet i nxjerrin në këmbë dhe largohen shpejt, pa bërë në vend një analizë të thellë të problemeve, pa ndihmuar konkretisht, pa nxjerrë konkluzione të thella për forcimin e vazhdueshëm të punës. Shpesh ata bëjnë edhe mbledhje të shumta e të gjëra, po jo shumë të studiuara e jo të organizuara si duhet.

Ka, gjithashtu, një punë të dobët në koordinimin e punëve ndërmjet drejtorive të Ministrisë së Mbrojtjes, konfuzion, liberalizëm, «indipendencë» e spontaneitet, subjektivizëm, mungesë kolegjaliteti dhe familjaritet me njëri-tjetrin. Me gjithë kritikën e bërë nga ana e Byrosë Politike lidhur me përqendrimin e shumë kompetencave në personin e ministrit të Mbrojtjes, nuk janë marrë akoma masat e duhura në këtë drejtim.

Unë mendoj se gjersa ekzistojnë të tilla dobësi të mëdha në dikaster, këto pa dyshim reflektohen edhe

në punën e komandave dhe të shtabeve të njësive të larta me vartësit e tyre dhe me trupën. Me këtë metodë pune, ku mungojnë kërkesa e fortë e llogarisë, disiplina e çeliktë proletare në zbatimin me rreptësi të detyrave e në zhvillimin e mësimeve, në teori dhe në praktikë, nga njaft kuadro, e lidhur dhe e pleksur kjo me madhësinë dhe me gjerësinë e ushtrisë dhe me format e instancave të larta të njësive ushtarake, ku në përgjithësi janë grumbulluar kuadrot kryesorë ushtarakë që kanë mbaruar jo nga një, po mjaft prej tyre edhe nga dy akademi, nuk ka si të mos kultivohen megalomania, akademizmi, planet «e mëdha», nënvlef-tësimi i bazës, mungesa e përpjekjeve për zhvillimin dhe për thellimin e Tezave të Këshillit të Mbrojtjes dhe të eksperiencës që nxjerr baza, e cila na vjen lart shumë e zbehtë.

Të gjitha këto në disa kuadro na krijojnë, ku më shumë e ku më pak, njëfarë situatë jo të shëndoshë, kur kushtet ekzistojnë për një gjendje më të mirë. Natyrisht nuk është vetëm zgjidhja e kësaj çështjeje që do të na japë mundësi të ndreqim të gjitha të metat e gabimet që vërtetohen në punën e përditshme të ushtrisë, po mendoj se edhe ajo mund të jetë një faktor ndihmës, meqenëse ka të bëjë drejtpërsëdrejti me përgjegjësitë konkrete që u japim kuadrove, me kompetencat që ata duhet të marrin, me problemet aktuale të nevojave të para e të domosdoshme.

Çështja e stërvitjes, sikurse gjithë të tjerat në ushtri, ka rëndësi shumë të madhe. Kësaj, ju shokët e ushtrisë, aktualisht duhet t'i vini kujdesin më të madh, natyrisht, pa lënë pas dorë problemet e tjera. Stërvitja

e ushtrisë është e domosdoshme të bëhet në rrethana të vështira dhe t'u afrohet sa më shumë kushteve të luftimit. Gjersa ju e njihni vetë se kjo punë është e çalë, atëherë duhet të merrni masa dhe, sipas mendimit tim, t'i shkundni kuadrot, duke filluar nga ata të njësive më të larta e deri poshtë, për ralizimin e kësaj detyre me kaq rëndësi. Sigurisht, nuk ngjet kështu kudo, por, siç shohim në material, ka mjaft shembuj të tillë. I theksova këto me qëllim që të mos ngjasin e të mos përsëriten më raste të tjera, pse kjo është çështje shumë preokupante dhe jetike.

Shkëputja, fjala vjen, e këmbësorisë nga armët që e shoqërojnë dhe e mbështetin, e dimë fare mirë se krijon rreziqe jashtëzakonisht të mëdha. Një fenomen i tillë i palejueshëm as në ndonjë njësit partizan të kohës së Luftës Nacionalçlirimtare nuk është vërtetuar. Edhe atëherë, para se të nisej njësit për sulm, mitralierin, që kishte një mitraloz të vjetër, komandanti e udhëzonte si të zinte pozicionin më të përshtatshëm për ta ruajtur njësitin gjatë aksionit. Prandaj, si është e mundur të na ngjasë sot një gjë e tillë? Por ja që është e mundur tashti, në kohë paqeje. Mirëpo në rast lufte një neglizhencë si kjo është shumë e rrezikshme. Gjëra të tilla nuk duhen lejuar në asnjë rast. Ne e kuptojmë se kjo gjendje nuk është në të tëra repartet, kuptojmë, gjithashtu, se si në çdo sektor, edhe në ushtri, ka gjëra të mira, po ka edhe gjëra që nuk ecin, ka dobësi, të meta e gabime, prandaj të gjitha këto t'i shikojmë mirë dhe të marrim masa serioze për t'i zhdukur.

Sipas raportit del se në pikat e hapjes mjaft kua-

dro dhe ushtarë i mbulojnë plogështia dhe rutina. Si pasojë ata edhe në kontrollin e stërvitjes nuk kanë dalë mirë. Mirë flitet atje vetëm për qitjen. Po kjo, më duket mua, nuk mund të merret si një kriter i plotë për vlerësimin e stërvitjes, siç po shoh të konsiderohet në përgjithësi, gjersa aspektet e tjera të stërvitjes as që përmenden fare, ato ju i errësoni. Mund të qëllosh mirë tani në kohë paqeje, po në qoftë se sot nuk bën si duhet në kompleks tërë stërvitjen taktike, nesër nuk mund të qëllosh mirë, të kap frika ose të dridhet dora; në qoftë se sot nuk di si të marrësh një kodër apo si të tërhiqesh kur është nevoja, në qoftë se humbet gjakftohtësinë etj., në kohë lufte armiku të godit lehtë dhe të asgjëson. Prandaj të kesh parasysh vetëm qitjen për vlerësimin e nivelit të stërvitjes së ushtrisë, nuk është e mjaftueshme. Unë nuk e di sa preokupohen komandat dhe deri te ministria për këtë problem me rëndësi kaq të madhe. Prandaj, në qoftë se nuk e ka studiuar akoma këtë problem, Ministria e Mbrojtjes duhet ta marrë menjëherë në studim me tërë seriozitetin e duhur dhe të diktojë masat përkatëse që duhen zbatuar. Të gjitha këto gjëra unë i kam marrë në të dhënat që na keni servitur vetë. Ju mbase i shikoni të tëra këto çështje, po më ka rënë në sy që kur doni të bëni vlerësime thoni se repartet në qitje kanë dalë shkëlqyeshëm.

Një kujdes të veçantë duhet të keni për armët, të cilat të trajtohen me shumë kujdes dhe jo të ndodhë që ato të vihen ditë e natë në lëvizje vetëm për të provuar se brenda sa minutash mund të vihen në gatishmëri luftimi. Duke i përdorur pa vend, duke i vënë



në lëvizje pa arsye të justifikuara mirë, ato do të na prishen, do të konsumohen dhe atëherë ku t'i gjejmë për t'i zëvendësuar? Gjithashtu, në qoftë se në stërvitje u japim ushtarëve të qëllojnë pa normë, me breshëri, kompletet që kemi do t'i harxhojmë pa vend. Ka armë, mendoj unë, që duhen përdorur më dendur në stërvitje, natyrisht me krëk, por ka edhe të atilla që duhen konservuar e duhen ruajtur me kujdes të madh. Kjo nuk do të thotë aspak që të pengohet stërvitja, pse askush nuk ka mendimin që këto materiale t'i ruajmë të nisur nga mania për t'i pasur si stoli, për t'i parë sa të mira janë. Por stërvitjet të bëhen sipas programeve e normave të aprovuara, njerëzit tanë të mësojnë mirë armët, në radhë të parë, pushkën, po edhe kjo të përdoret në bazë normash të caktuara, kurse çështja e përdorimit të disa armëve speciale, duhet parë me shumë kujdes. Detyrë e përhershme me rëndësi për ne është që armët të mbahen mirë dhe të jenë në gatishmëri të plotë në çdo kohë, ditën dhe natën. Natyrisht, edhe kjo duhet të jetë e shkallëzuar, sipas terrenit dhe detyrave.

Në raportin e mbajtur përpara kuadrove, që e këndova edhe unë, në pjesën ku flitet për përgatitjen e kuadrove e të shtabeve, në mes të tjerash bëhet fjalë edhe për disa kurse të zgjatura nga 15 ditë e deri në tre muaj për përgatitjen e disa kategorive kuadrosh, sidomos të hallkave repart e nënrepart. Po atje nuk del qartë se me ç'kriterë bëhen këto kurse tremujore, në kurriz të cilës lëndë, si planifikohen, apo nuk planifikohen fare?

Problemi i kuadrit rezervist, siç thuhet edhe në

material, sipas mendimit tim, është nënvleftësuar dhe vazhdon të nënvleftësohet. Edukimi dhe përgatitja e oficerëve rezervë, sidomos atyre të nënreparteve, fillon që kur ata janë ushtarë aktivë dhe gjer në moshën 55 vjeç. Mirëpo nga ata që kryejnë shërbimin ushtarak ju mbani vetëm një sasi, të tjerët largohen, futen në rezervë. Këta ju i thërritni thjesht si ushtarë rezervistë dhe nuk tregoni ndonjë kujdes të veçantë për ta. Interesim ju tregoni vetëm për ata pak që keni mbajtur në shërbim aktiv dhe e bëni këtë pikërisht në një kohë kur për përgatitjen e kuadrit oficer rezervë, me ritmet që po ecim, do t'ju duhen shumë vjet. Por ushtrisë kuadro rezervistë i nevojiten me shumicë. Mua më duket se qëndrimi që po mbani ju për zgjidhjen e këtij problemi nuk është i drejtë. Vlerësimi i kuadrit nga ana juaj bëhet vetëm nga mosha, gjë që dhe kjo duhet pasur parasysh, por nuk është e tëra, pse bashkë me moshën duhet vlerësuar edhe zotësia ushtarake e rezervistit, e cila duhet të freskohet herë pas here, vazhdimisht dhe me seriozitetin më të madh, gjë që nuk po bëhet. Këtë mungesë e vërteton edhe puna e pamjaftueshme me kuadrot e shtabeve, sidomos me ata të repartëve, disa prej të cilëve nuk kanë përgatitjen e duhur. Ekziston një dobësi e theksuar në teknikën e punës së disa shtabeve, si në klasa, ashtu edhe në stërvitje dhe kjo ndodh pikërisht për atë që thashë më parë, se në disa prej tyre bëhet një punë e sipërfaqshme, e padingjitur dhe prej diletanti që nuk duhet të lejohet në radhët e kuadrove tanë.

Në edukimin dhe në stërvitjen e kuadrove të shtabeve dhe të forcave vullnetare, në reparte e poshtë,

ka shumë dobësi, nuk ka disiplinë mësimi e zbatimi. Shumë detyra që planëzohen, as që zbatohen fare. Edhe stërvitja e paraushtarakëve është e dobët.

Në përgatitjen e masës së madhe të kuadrove rezervistë mendoj se duhet të vendosen forma studimi dhe praktike të herëpashershme, të volitshme dhe të ndërtuara në mënyrë të tillë që këta kuadro të mba-hen gjallë për funksionet që do të kryejnë gjatë luftës.

Pikëpamja jo e drejtë që nxjerr veshët se «forca vullnetare janë këto, prandaj të mësojnë ç'të mësojnë», shpreh një koncept thellësisht të gabuar për luftën në përgjithësi, për luftën frontale dhe atë partizane, për rolin vendimtar të njeriut në luftim, qoftë ai në front, qoftë në prapavijë dhe për rolin e stërvitjes. Ky koncept shpreh, gjithashtu, nënvleftësimin e armikut, nënvleftësimin e njeriut dhe mbivlerësimin e armës. «Mjaft të dijë pushkën» thonë bartësit e të tilla koncepteve të dëmshme, çka do të thotë se njeriu është automat, pushka është «truri».

Kam përshtypjen se edukata e përditshme e kuadrove në punë, në zbatimin e programeve dhe të stërvitjeve nuk vlerësohet si duhet, nuk kërkohet llogari, nuk qëndrohet me rreptësi përpara zbatimit të detyrave, nuk mendohet dhe nuk vlerësohet si duhet se kryesorë janë mësimi dhe stërvitja e përditshme dhe jo vetëm rezultatet në qitje. Kjo punë me kaq rëndësi themelore konsiderohet dhe bëhet si një rutinë. Për komandat ka më shumë rëndësi kursi tremujor me skuadërkomandantët, sesa puna dhe edukimi i përditshëm i kuadrit. Mund të lejohet një gjë e tillë? Sigurisht që s'duhet të lejohet. Kursi të konsiderohet një

perfeksionim i mëtejshëm i kuadrit, po ai nuk mund ta zëvendësojë kursesi edukimin e përditshëm të tij.

Në ushtri edhe dokumentet e Partisë ose punohen përciptas, ose nuk punohen fare, kur ato nuk flasin për ushtrinë. Kjo do të thotë të nënvleftësosh edukimin marksist-leninist të kuadrove dhe të ushtrisë, të neglizhosh ngritjen e tyre ideopolitike. Kështu «politika në plan të parë» mbetet një formulë e thatë dhe është pikërisht kjo që shkakton gjithë këto dobësi në stërvitje dhe në qëndrime.

Edhe në shkollat ushtarake ka cektësi në punë. Praktika nuk njihet mirë, nuk bëhet sa duhet në këtë drejtim dhe shumë teza të rëndësishme të artit tonë të luftës nuk përpunohen e nuk zhvillohen më tej. Vetë pedagogët nuk bëjnë përpjekje këmbëngulëse të mjaftueshme për t'u ngritur. Edhe programet nuk janë të azhurnuara, mungon një kontroll i kualifikuar nga komandat dhe nga drejtoritë përkatëse të ministrisë.

Si konkluzion, mendoj, së pari, t'u rekomandojmë shokëve të ushtrisë, veçanërisht atyre të Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuesve të saj e të Shtabit të Përgjithshëm, të marrin të gjitha masat për të forcuar seriozisht punën në ushtri dhe në udhëheqje të saj, në të gjitha nivelet, pra duke filluar që nga kuadrot e komandës e deri tek ushtari më i thjeshtë në të gjitha repartet.

Shokët e udhëheqjes së ushtrisë të punojnë pareshtur për të ngritur lart moralin komunist të ushtarëve e të kuadrove dhe të mos dëgjojmë më për asnjë ushtarak, qoftë ky ushtar ose kuadër, që të na

bëjë veprime të pahijshme. I bëni, shokë, të ditur gjithë ushtrisë, ushtarëve e kuadrove, se Byroja Politike dhe Komiteti Qendror rekomandojnë që ata të ruajnë të pastër emrin e lartë të ushtarit të popullit, prandaj ushtarakëve, gjithë efektivit të ushtrisë sonë të lavdishme, që Partia u ka besuar një mision shumë të madh, politik dhe ideologjik, atë të mbrojtjes së lirisë së atdheut dhe të socializmit në vendin tonë, nuk u ka hije aspak të shkelin moralin komunist dhe, që të mundin të realizojnë detyrat që u ngarkon Partia në ushtri, është e domosdoshme të përvetësojnë si duhet të gjitha ligjet, rregulloret, Tezat e Këshillit të Mbrojtjes etj., të cilat t'i zhvillojnë së bashku, kuadro dhe ushtarë. Ushtarëve t'u futen mirë këto në kokë, teorikisht dhe praktikisht, pse vetëm në teori ato nuk kanë shumë vlerë, në qoftë se nuk ua zërthejnë edhe në praktikë dhe bile në kushte të vështira. Të gjitha këto ju i dini, shokë, por ka kuadro, si në bazë, ashtu edhe këtu lart, që tregohen të ngathët dhe të fjetur në këtë drejtim. Prandaj nga ana e Komitetit Qendror u thoni të gjithëve të shkunden dhe të kuptojnë qartë se detyra e tyre është të rrojnë, të hanë e të pinë, të punojnë dhe të mësojnë pa u lodhur bashkë me trupën, atje ku rron e stërvitet ushtari. U thoni atyre, gjithashtu, që mësimet t'i përgatitin sa më mirë për trupën dhe t'i zbatojnë tok me të dhe kur në zhvillimin e mësimit konstatohen të meta, të marrin masa menjëherë për t'i korrigjuar në vend dhe pastaj të kthehen në repart. Vetëm atëherë ta ndiejnë ata veten të kënaqur dhe të thonë se e kanë kryer detyrën ndaj Partisë dhe atdheut. Kjo është detyra e tyre kryesore.

U thoni, gjithashtu, gjithë ushtarëve dhe oficerëve që në kryerjen e çdo detyre të tregohen plotësisht të disiplinuar. Ushtria jonë e diktaturës së proletariatit duhet të karakterizohet kurdoherë nga një disiplinë e fortë dhe e çeliktë proletare, ndryshe nuk mund të përballohet armiku. Disiplina duhet të sundojë në çdo situatë në ushtinë tonë, ajo duhet të jetë kurdoherë një disiplinë e vetëdijshme, por e hekurt, prandaj në asnjë rast të mos lejohet që, nën maskën e demokracisë, të fshihen liberalizmi, lëshimet e gjëra të tjera të këqija. Këtë ua thoni hapur të gjithëve. Ushtria është ushtri, aty çdo ushtar shkon të kryejë shërbimin ushtarak, atje çdo detyrë duhet kryer në bazë të rregullores përkatëse, ashtu sikurse në bazë të rregullores bëhet edhe dëfrimi në kohën e lirë, shkohet në rregull në kinema, në sport, deri edhe në marrjen e fjalës me leje në mbledhje, kur dikush dëshiron të diskutojë dhe jo të flitet aty si në pazar. Në ushtinë tonë duhet të mishërohen të gjitha ato tipare të mira që jua përsëritim dhe që ju i dini shumë mirë.

Nuk mund të themi se ju nuk keni luftuar në këto drejtime, na kuptoni, ju jeni nga shokët me të cilët tok kemi luftuar prej një kohe të gjatë dhe së bashku po vazhdojmë, gjithashtu, të luftojmë, por, ja, ndodhi një situatë e vështirë dhe u bë mirë që kjo nuk shkoi më tej, pse Byroja Politike e kapi çështjen, e diskutoi atë në rrugë partie, kritikoi me radhë shokët që mbajnë përgjegjësitë kryesore, pastaj gjithë të tjerët. Me këtë rast duhet thënë se as ne nuk mbetemi të larë e krejt pa faj, por, pa i hedhur ujë verës, kryesorët kanë qenë shokët e Ministrisë së Mbrojtjes, të

cilët duhet të kenë kurdoherë parasysh që, kur shohin diçka që nuk ecën, të mos hezitojnë, po të flasin haptazi me shokët, si komunistë. Ne besojmë se këto çështje ata do t'i kuptojnë drejt, çdo gjë do ta shtrojnë kurdoherë haptazi me njëri-tjetrin dhe kemi bindjen se, duke vepruar kështu, nuk do të na ngjasin më gjëra të tilla.

Me punë, kurdoherë me unitet në mendime e në veprime dhe kur të keni zor, ngrihuni dhe ejani këtu t'i zgjidhim çështjet. Ja kështu të veprojmë për të mos rënë më në gabime, për të ndrequr situatën.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## ESHTË NDER I MADH TË JESH ANËTAR I PARTISË

*Nga biseda me shokun Fuat Çela*

14 dhjetor 1970

*Shoku Enver Hoxha e priti Fuat Çelën në selinë e Komitetit Qendror të Partisë dhe zhvilloi me të një bisedë të ngrohtë e të përzemërt.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Bëre mirë që erdhe për t'u takuar. Sa kohë ka kaluar që s'jemi parë? Si je me shëndet?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Jam shumë mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nga Vërzhezha vjen tani? Çfarë kemi andej?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Plot të mira kemi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si shkon atje, si jeton, si i ke njerëzit në familje?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Shumë mirë, nuk mund t'i numëroj të mirat dhe ndryshimet e jashtëzakonshme që kemi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Cilët njerëz ke në shtëpi?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Babanë nuk e kam, se më ka vdekur në marsin e këtij viti.



**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju paska vdekur babai? Të rroni vetë.

**SHOKU FUAT ÇELA:** Falemnderit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Gjer në çfarë shkalle ke arritur të përparosh në shkrim?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Mund të them se deri diku e kam përmirësuar shkrimin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ajo mësuesja që të ndihmonte për të mësuar shkrimin, në Vërzhezhë është tani?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Jo, ka ikur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pa na shkruaj pak në një letër, që të shikoj përparimet që ke bërë në shkrim.

**SHOKU FUAT ÇELA:** Më thoni ju shoku Enver se çfarë dëshironi të shkruaj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shkruaj: Sot erdha dhe u takova me shokun Enver Hoxha.

*(Fuat Çela i shkruan fjalët e sipërme.)*

Shumë mirë, rreshtat i ke shkruar të drejtë dhe fjalët të qarta.

Ke filluar të mësosh me metodën «Brail»?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Nuk kam filluar akoma, por do të shkoj në Shkollën e Shurdh-Memecëve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe unë nuk e di mirë se çfarë kërkesash ka kjo shkollë, por them se çdo gjë do të rregullohet ashtu si duhet. Ti tani duhet të shkosh te drejtoresha e shkollës. Merru vesh me të mirë e mirë dhe dëgjo çfarë do të të thotë ajo. Në qoftë se të thotë se për të mësuar metodën e të lexuarit, duhet një kohë e gjatë, dhe kështu duhet të jetë, ti mos u

bëj merak fare se në shkollë do të të mbajë Partia. Vazhdimi i shkollës ka rëndësi, sepse, po mësove të lexosh, do të të vijë libra, leksione dhe të gjitha materialet që shtypen me metodën «Brail». Ti, me këtë metodë, do të mësosh leximin me gishta, ashtu siç lexon një njeri me sy. Në qoftë se do të të thotë që mund të mësohet dhe vetë në shtëpi, ti vepro, si të duash, por mua më duket se do ta kesh të zorshme të mësosh, duke qenë i vetmuar. Prandaj merru vesh me pedagogët e shkollës dhe dëgjo çfarë do të të thonë ata. Po të jetë nevoja do të interesohe mi dhe në këtë. Çfarëdo që të të thonë në shkollë për të mësuar në atë kurs, bisedoje pastaj me sekretarët e mi.

**SHOKU FUAT ÇELA:** Unë nuk kisha ndonjë gjë konkrete për të biseduar me ju, por, meqë erdha në Tiranë, mendova të takohem edhe një herë me shokun Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit shumë, unë disa herë kam pyetur për ty.

A u pranove anëtar partie?

**SHOKU FUAT ÇELA:** Po u pranova. (*Shoku Enver e përqafton dhe e uron.*) Këtë që bëri Partia për mua, unë nuk mund t'ia shpërblej kurrë sepse nga një hiçnjeri që isha ajo më pranoi në radhët e saj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** A të vënë në korent që më përpara për rendin e ditës dhe për problemet që do të shtrohen në mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë?

Po ti a diskuton, a i thua mendimet e tua, pasi ke dëgjuar me kujdes diskutimet e shokëve? A kërkon shpjegime dhe a bën autokritikë ose kritikë për ata që bëjnë gabime?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Bëj, natyrisht ashtu siç i kuptoj unë çështjet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sigurisht, siç i kupton ti do t'i ngresh problemet. Kush t'i lexon materialet?

*SHOKU FUAT ÇELA:* M'i lexojnë edhe shokët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa veta jeni në organizatë?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Jemi 30 veta.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa shoqe keni?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Kemi 3 shoqe anëtare partie dhe 2 të tjera kandidate.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë pak shoqe pas-ki! Duhet të futen edhe të tjera. Megjithëqë në të gjitha punët të parat janë gratë, kur vjen rasti për të komanduar vihen burrat. Mbahet gjë ramazan andej?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Jo, nuk mbahet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* As plakat dhe pleqtë nuk mbajnë? Nuk thonë gjë ata për lëvizjen tonë kundër fesë dhe paragjytimeve fetare?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Të gjithë thonë: Paskemi qenë të mykur. Të rrojë Partia dhe shoku Enver që na hapën sytë!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po fejesat bëhen më me shpërblim, ç'ke dëgjuar ti për këtë problem?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Fejesa me shpërblim nuk bëhen më, por me mblesëri po.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe tani bëhen fejesa me mblesëri. Një ditë u takova me disa skraparllinj këtu në Tiranë. Ishte një nënë plakë me të birin dhe me nusen e tij. — Çfarë pune të bën djali, — i thashë plakës. — «Punon në Uzinën e Traktorëve», — më tha

ajo. Djali i saj punonte atje qysh para se të shkonte ushtar. «I kam gjetur një nuse, — më tha plaka. — E pashë nusen, ishte e bukur». — Po nga e ke nusen, — e pyeta plakën, — nga Tirana apo nga Skrapari? «Nga Skrapari e kam — m'u përgjigj ajo, — dhe të të them të drejtën, nusen e gjeta unë». — Po nuk bën ta gjesh ti, ai duhet ta gjente vetë. Megjithatë, dhe kështu si e paske gjetur ti, të mirë e paske. Të trashëgohen! — përfundova unë. Por unë, para se të më tregonte plaka, mendova se djali që punonte në uzinë do ta kishte gjetur vetë një vajzë atje, se në uzinë punojnë plot vajza të reja.

*SHOKU FUAT ÇELA:* Në këtë drejtim si dhe në luftën kundër mbeturinave të fesë më duket se ne kemi ecur përpara.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Komunistët që janë në organizatën tuaj dallohen në punë, apo ka edhe nga ata që vijnë rrotull nëpër zyra? Mos ka edhe kapadainj? Më thuaj të drejtën si janë shokët atje.

*SHOKU FUAT ÇELA:* Ne i kemi të mirë komunistët e organizatës sonë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kryetarin dhe nënkryetarin e kooperativës burra i keni, apo gra?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Nënkyetare është një shoqe.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo është një gjë e mirë. Po shoqe të tjera keni në udhëheqje të kooperativës? Po llogaritarin, për shembull, burrë e keni apo grua?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Llogaritari është burrë, kurse ndihmësja e tij është grua.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të bëni çmos që t'i zëvendësoni me shoqë, sepse ato janë më të ndershme, më ekonomiqare, më punëtore. Burrat t'i dërgoni që të punojnë në arë.

Po nga familja e Hysollarëve keni njeri atje?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Kemi, ata janë të thjeshtë e të mirë, janë të rrogosit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu duhet, që të mos mendojnë se meqë kanë luftuar baba e gjyshi, ata të rrinë dhe të rrojnë me meritat e të parëve të tyre. Ku punon tani?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Në bujqësi kam punuar si edhe më parë, por tani kam një muaj e gjysmë që punoj në shkollë, se kemi menduar të zbukurojmë ambientin e jashtëm të shkollës.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ku e keni shkollën?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Shkollën e kemi afër një rrapit, në fushën që është atje pranë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë e paski shkollën tek ai rrapit ku është sheshi për të luajtur nxënësit.

Si dolët andej me prodhimet bujqësore, keni bërë shumë apo pak grurë?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Të kënaqur nuk jemi, por dhe keq nuk jemi. Në disa parcela toke kemi marrë prodhime të mira, por në disa të tjera, si në zonën e malit morëm rendimente të ulëta.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pse ndodh ky ndryshim në rezultatet e brigadave, kur dihet se atje nuk ka lagështirë?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Këtë çështje po e studiojmë edhe ne shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po me misrin si jeni?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Pothuaj aty afër, si me grurin.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po pse e keni kaq të ulët prodhimin e misrit, apo nuk e keni nën ujë?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Nuk kemi shumë nën ujë, ata misra që janë nën ujë i kemi për foragjere.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë me prodhimin e bukës do të jeni një çikë shtrënguar këtë vit?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Jo, bukën e siguruam, por detyrat e planit nuk i kemi realizuar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* A do t'i siguron dot bukën dhe farën?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Bukën dhe farën i sigurojmë, por, siç thashë, nuk jemi mirë me detyrat e planit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po qumështin kooperativistët e marrin nga lopët e kooperativës, apo kanë lopët e tyre për këtë qëllim?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Më shumë e marrin nga lopët e kooperativës, se nga të tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet t'i kullotni në vende të përshtatshme që të merrni më shumë qumësht. Sa ditë-punë ke bërë këtë vit?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Për këtë vit, deri tani, kam bërë 320 ditë-punë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të lumtë, ke punuar shumë mirë.

*SHOKU FUAT ÇELA:* Jo, nuk kam punuar shu-

më, se nga kaq kanë bërë të gjithë kooperativistët tanë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Puna jote është ndryshe nga ajo e të tjerëve. Vërtet ke bërë 320 ditë-punë, po në kushtet që je ti, kjo do të thotë se ke punuar në mënyrë të shkëlqyer.

A vjen traktori në Vërzhezhë?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Po, vjen. Mbi 75 për qind të tokës në c punojmë me traktorë. Për sa i përket kooperativës ju njoftoj se në tani jemi bashkuar me Dobrushën, Storrën dhe Selanin. Qendra e kooperativës së bashkuar është Vërzhezha.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ke ndonjë nevojë apo kërkesë që të të ndihmojmë për gjëkafshë?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Nuk kam kërkesë për asgjë, jam shumë i kënaqur. Nderin që më është bërë nuk ia shpërblej dot Partisë me asgjë. Po të mos ishte Partia, unë do të isha barrë për familjen time, por Partia ishte ajo që mua, njeriut të verbër, m'i hapi sytë dhe më bëri anëtarin e vet, gjë që nuk mund ta besoja më parë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me të vërtetë është nder i madh të jesh anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Shokët e rrethit a të ndihmojnë në kryerjen e detyrave si komunist, e shfrytëzojnë ata shembullin tënd në punë, të thërresin në konferenca apo nuk të thërresin fare? Ti vetë ke qejf të vesh në këto aktivitete që organizohen?

*SHOKU FUAT ÇELA:* Vete sekretari i organizatës-bazë atje dhe ai, pastaj, na i thotë neve të gjitha

direktivat e Komitetit Qendror për detyrat që na dalin neve, komunistëve.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet të vesh edhe ti, jo në të tëra, por në disa konferenca që të dëgjosh, të mësosh dhe të flasësh, sepse ti i inkurajon të tjerët në punë. Prandaj, shokët, duhet të të caktojnë ose të të zgjedhin edhe ty që të shkosh në disa konferenca që organizohen.

Mirë Fuat, të uroj sukses dhe mirupafshim!

*Fotohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*



## ORIENTIMET E DREJTA JEPEN KUR NJIHET MIRË GJENDJA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 dhjetor 1970

Vërejtja ime e përgjithshme është se në përgatitjen e këtij raporti nuk i është arritur qëllimit. Ka përsëritje të çështjeve që janë thënë shumë qartë në plenumet e Komitetit Qendror, bile për mjaft nga këto probleme kemi bërë edhe plume të posaçme. Duhet të kemi kurdoherë parasysh që të mos përsëritim ato çështje që i kemi shqyrtuar një herë në plenumet e mëparshme, përkundrazi, për detyrat që nuk i kemi realizuar, të ndalemi, t'i studiojmë e të mobilizohemi me të gjitha mundësitë për t'i plotësuar edhe ato gjer në fund.

Në këtë projektraport flitet gjerësisht, për shem-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për ta ngritur në një nivel më të lartë shërbimin shëndetësor, sidomos profilaksinë dhe higjienën», që do të mbahej në Plenumin e 11-të të KQ të PPSH, i cili i zhvilloi punimet më 25 dhe 26 janar 1971.

bull, për ushqimin. Ne kemi bërë një Plenum<sup>1</sup> të tërë për fshatin, ku kemi diskutuar gjerë e gjatë edhe për këtë problem. Deri edhe me hollësira është marrë Plenumi si me strukturën e ushqimeve, me menutë e gjellëve etj. Prandaj t'i lihet në këtë raport një vend kaq i gjerë përsëri kësaj çështjeje, më duket se nuk është e drejtë.

Gjithashtu, herë të tjera kemi trajtuar gjerësisht edhe problemet e higjienës e të profilaksisë. Unë jam dakord që këto të dyja janë nga problemet më me rëndësi të shëndetësisë dhe, meqenëse do ta marrim në shqyrtim në Plenum këtë sektor, natyrisht mund të flasim edhe për to. Por, vërej se në raport nuk bëhet asnjë autokritikë dhe analizë konkrete për vetë shërbimin shëndetësor.

Shteti ka harxhuar dhe harxhon miliona për shëndetin e popullit. Ai ka ngritur spitale e qendra shëndetësore, duke i pajisur ato më së miri me aparatura moderne nga viti në vit dhe ka përgatitur vazhdimisht shumë kuadro. Po, si punojnë e si i shërbejnë ata popullit; ç'punë shkencore bëhet në institucionet shëndetësore; cilat janë sëmundjet më serioze që duhet të na preokupojnë në kohën e tanishme e për të tjera probleme kaq të rëndësishme, që kanë të bëjnë me shëndetin e njerëzve tanë, në raport nuk flitet asgjë. Pikërisht, në këto drejtime duhet t'i tërheqim ne tani

---

1. Është fjala për Plenumin e 10-të të KQ të PPSH (6-8 qershor 1963), ku shoku Enver Hoxha mbajti raportin: «Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturore të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj». (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 25, f. 8.)

vëmendjen Partisë dhe jo të kalohet përciptazi mbi to.

Nuk është aspak e mjaftueshme të na thuhet, për shembull, që rakitizmi të fëmijët në një rreth është kaq për qind, kurse në një rreth tjetër është më i ulët ose më i lartë. Kryesorja është se ç'po bëhet për ta luftuar këtë sëmundje. Në qoftë se, fjala vjen, shohim që kjo sëmundje apo edhe ndonjë tjetër diku është mjaft e theksuar dhe shqetësuese, atëherë ta bëjmë problem, duke menduar e duke propozuar që të veprojmë me tërë peshën e mundësive tona për ta luftuar atë etj. Dua të them se këtë anë, që nuk është e vogël, por përkundrazi shumë e madhe, ta kemi mirë parasysh dhe të mos e kufizojmë çështjen vetëm te një numër masash që duhet të merren nga shteti për arritjen e disa objektivave. Shteti ka dhënë e do të japë edhe fonde të tjera. Fakti është se në çdo buxhet dhe plan vjetor ai vazhdimisht i ka dhënë dhe i kushton kujdes të veçantë shëndetësisë. Tani puna është që Komiteti Qendror të informohet si përdoren këto mundësi, si janë shfrytëzuar e si po shfrytëzohen gjithë këto fonde, se në këtë raport lidhur me këto nuk na thuhet asgjë. Është shumë e drejtë ajo që u tha këtu se shumë gjëra mund t'i bëjë edhe populli vetë e të mos ketë nevojë për fonde të shtetit.

Çfarë po bëjnë mjekët dhe gjithë punonjësit tanë të shëndetësisë për gjithë këto probleme? Përpiqen ata për të bërë studime, apo kënaqen me një punë rutinë? Pra, tani, çështja është që të dimë se çfarë problemesh shkencore dhe teknike të shëndetësisë duhet t'i ngrihen Komitetit Qendror, që ky, pasi të vihet në

dijeni për to, të marrë masat përkatëse për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes.

Konstatoj se, kur vjen fjala për ruajtjen e shëndetit të popullit, theksi vihet vazhdimisht te shtretërit, kurse mua më duket se kjo nuk është e drejtë. Nuk është numri i shtretërve kryesorja që do të na përmirësojë shëndetin e njerëzve tanë. E them këtë se shtrimi nëpër spitale po praktikohet në shkallë të gjerë e pa kritere të shëndosha, saqë tjetrin, një çikë ta zërë një dhembje dhe e dërgojnë drejt e atje. Por edhe në spital, në vend që të rrijë aq ditë sa është e domosdoshme, qëndron shumë më gjatë, në kurriz të shtetit. Këto janë arsyet që është duke u zhvilluar jashtë mase tendenca «oburra të kemi sa më shumë, me qindra e mijëra shtretër nëpër spitalet tona», bile po kërkohet të kalojmë deri edhe në qendrat shëndetësore të fshatrave të veçanta, me shtretër. Po përse duhen gjithë këta shtretër? Mua më duket se në këto raste çështjet nuk shikohen drejt nga ana ekonomike dhe nuk merren parasysh mundësitë aktuale. Një njeri me një sëmundje të lehtë, të zakonshme, përse të mos rrijë i shtrirë në shtëpi? Në qoftë se është fjala për higjienën, të luftohet për t'ia siguruar atë sa më të mirë edhe në shtëpi, bile atje t'i vejë edhe mjeku, qoftë në qytet, qoftë në fshat.

Përveç kësaj, siç u tha edhe këtu, në vend që t'i mbajmë të sëmurët për ditë të tëra në spital, vetëm sa për të bërë analizat, a nuk është më e leverdishme të përgatitim laborante që t'ua bëjnë njerëzve analizat sa më shpejt dhe pa i shtruar fare?

Këto janë probleme shumë të rëndësishme, me të

cilat Komiteti Qendror, pasi të njihet, do të japë orientimet e nevojshme, ndërsa për t'i zgjidhur e për t'i vënë në jetë ato, në mënyrë sa më ekonomike, do të punojnë vetë punonjësit e shëndetësisë, që nga ministria deri në institucionet më të vogla në bazë.

Në sektorin e shëndetësisë ka shumë gjëra që duhen parë. E tillë është edhe ajo e specialiteteve, për të cilat flitet kudo. Shoku Haki [Toska] më foli për këtë problem dhe më dha disa mendime shumë të drejta. Ne, tani për tani duhet të synojmë që të kemi specialistë në spitalet më kryesore si në këto të Tiranës e të rretheve të tjera të mëdha. Për këtë të krijojmë mundësi specializimi këtu në Tiranë për mjekët e rretheve.

Prandaj, që të mund ta njohim si duhet situatën në këtë sektor dhe që Komiteti Qendror të japë një orientim sa më të drejtë në lidhje me pesëvjeçarin e ardhshëm, është e domosdoshme që të na paraqitet një pasqyrë sa më e plotë dhe reale e gjendjes. Thuhet, për shembull, se na duhet një mjek pediatër për kaq mijë banorë. Po nga do të dalin këta mjekë? Si mund ta vendosim një gjë të tillë pa bërë më parë llogari? Ne s'kemi akoma mjekë të përgjithshëm aq sa duhet e jo më të kalojmë kaq shpejt në kërkesa për më shumë specialistë të veçantë për fëmijë. Dakord që, në radhë të parë, ne duhet të kemi parasysh shëndetin e kalamëve, por problemin ta studiojmë mirë dhe të mos e shkëputim nga nevojat e përgjithshme. Vetëm kështu do të mund të marrim vendime të drejta. Kur t'i kemi tërë këto të dhëna, atëherë do të përqendrohemi

më mirë e do të marrim masat përkatëse dhe jo duke na i paraqitur çështjet të pastudiuara.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# PËRSOSJA E ORGANIZIMIT DHE FORCIMI I DISIPLINËS PËRBËJNË KYÇIN PËR REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 dhjetor 1970

Dëshiroj të them edhe unë disa fjalë për çështjen e planit.

Jam dakord me të gjitha vërejtjet e drejta që u bënë edhe në Qeveri edhe këtu në Byronë Politike, prandaj shumë gjëra nuk po i përsëris. Për sa i përket industrisë, është e vërtetë se dalim me plan të realizuar. Megjithatë, ne duhet të vëmë një kujdes shumë të madh në lidhje me përmirësimin e punës në sektorin e industrisë për rritjen e rendimenteve dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimeve, duke filluar që nga industria mekanike e ajo ushqimore, tek industria e veshmbathjes, si ajo e rrobave të gatshme, e

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe çështja e plotësimit të planit të vitit 1970 dhe detyrat e planit të shtetit për vitin 1971.

këpucëve e të gjitha të tjerat me radhë. Të nisemi kurdoherë nga parimi që me industrinë tonë të re t'i shërbejmë popullit sa më mirë, duke i dhënë mallra sa më të lira; të mos udhëhiqemi nga parimi i realizimit të planit globalisht dhe të krijohen stoqe. Stoku nuk është gjë tjetër veçse një inflacion i maskuar. Prandaj, në qoftë se mbushim dyqanet me mallra që na qëndrojnë pa qarkulluar dhe mendojmë se kështu e kemi mbuluar emisionin tonë monetar, atëherë gënjejmë veten. Për këtë klasa jonë punëtore dhe industria t'i vënë detyrë vetes që të prodhojnë mallra me cilësi sa më të mirë, të marrin për këtë qëllim masat e duhura organizative, të vendosin një disiplinë të rreptë në punë, të bëjnë përpjekje për ngritjen e rendimentit, të shfrytëzojnë në maksimum orarin e punës dhe të prodhojnë të gjitha llojet e mallrave të nevojshme që populli t'i tërheqë përnjëherësh.

Plani i vitit 1971 ka shkuar në bazë, atje i janë bërë vërejtje e ndryshime dhe tani na paraqitet në Byronë Politike për të parë ç'korrigjim tjetër i duhet bërë, pastaj plani do t'i dërgohet përsëri bazës, e cila do ta zbërthejë e do ta detajojë edhe më mirë. Por është nevoja të theksojmë se duhet të luftojmë tendencën e vënies së detyrave të vogla, që u duk në hartimin e këtij plani, për ngritjen e rendimentit dhe për uljen e kostos, ndërsa nga ana tjetër bëhen kërkesa të mëdha për investime, për fuqi punëtore, për furnizim materialësh, për makineri dhe për import. Mua më duket se dëshirat në të gjitha këto drejtime duhet të kenë një kufi. Ne e kemi për detyrë t'ua



bëjmë të gjithë sektorëve të qartë kufirin që shprehet me anën e kuotave të planit që japim në fillim. Këto kuota duhet të jenë një orientim joformal, por një orientim rreptësisht i përcaktuar për ministritë dhe për bazën, të cilat duhet ta dinë se më tutje këtij kufiri nuk mund të ecin, pse nuk ka asnjë mundësi, ose për arsye se mundësitë janë shumë të kufizuara. Si ministritë ashtu edhe baza duhet ta kuptojnë se, po të kishim mundësi më të shumta, do t'u jepnim kuota më të mëdha. Kështu qendra, duke u mbështetur në mundësitë ekzistuese për investimet e përgjithshme, jep kuotat. Në qoftë se cilido dikaster ose ndërmarrje, jashtë mundësive dhe kuotës së dhënë, i dyfishon investimet për vitin e ardhshëm, kjo nuk është aspak e drejtë, përkundrazi është krejt e gabuar, është një dëshirë irrealë. Është e natyrshme se, po kërkoje investime, medoemos do të kërkoje pastaj fuqi punëtore më shumë e, në qoftë se kërkon fuqi punëtore të tepër, do të ulësh rendimentin dhe nga kjo vjen rritja e fondit të pagave e të gjitha të tjerat me radhë.

Përveç të tjerave, mendoj që ne tani t'i rishikojmë këto çështje në bazë, një nga një. Por edhe sikur ta zëmë se shifrat që kemi dhënë për fuqinë punëtore, për rentabilitetin, për rendimentin e punës etj., janë të studiuara dhe të mbështetura në eksperiencën tonë shumëvjeçare, prapë jam i bindur se studimi nuk është real, ne kemi këtu për të bërë dhe duhet të bëjmë mjaft shkurtime. Është detyrë me rëndësi për ne që të gërmojmë seriozisht në këtë drejtim, ndryshe kemi rënduar ekonominë popullore dhe nuk kemi bërë sa duhet për të shfrytëzuar kapacitetin dhe

mundësitë e fuqisë punëtore pikërisht në interes të saj, domethënë në interes të socializmit.

Prandaj është e domosdoshme të kërkojmë nga punëtorët një disiplinë më të rreptë në punë, respektimin me rigorozitet të 8-orëshit të kohës së punës, të një 8-orëshi efektiv në punë, gjë që duhet ta vendosim medocemos. Në të njëjtën kohë është e nevojshme të kërkojmë llogari me rreptësi edhe për të gjitha çështjet e tjera, duke i bërë punonjësit e frontit të prodhimit të ndërgjegjshëm dhe përgjegjës për një disiplinë të rreptë teknike dhe të përpiktë në çdo drejtim tjetër. Por në qoftë se kjo çështje me rëndësi kaq të madhe lihet në fatin e vet, atëherë nuk mund të ecet përpara në mënyrë serioze. Gjatë kohës së punës duhet të ndalohet rreptësisht që një punëtor të shkojë pa arsye pune nga një repart i ndërmarrjes në tjetrin. Derisa asgjë nuk e lidh këtë punëtor me repartin tjetër, ai nuk ka përse të shkojë, ai shkon vetëm për të bërë muhabet. Mirëpo gjatë 8-orëshit të punës nuk duhen bërë muhabet, sepse në ndërmarrje s'duhet të mbahen njerëz që s'kanë punë. Në rast se punëtori ka diçka personale me shokun e vet, ose me ndonjë njeri tjetër, le të presë mbarimin e punës dhe le të bëjë pastaj muhabet me të sa të dojë, jashtë repartit, pse vendi i punës nuk është han me dy porta.

Unë nuk dëshiroj të flas për të gjitha çështjet, por dua të theksoj me këtë rast se ne duhet të forcojmë në të gjithë sektorët disiplinën e planit dhe kërkesën e llogarisë. Nuk na lejohet, për shembull, që uzina e Vlorës të mos prodhojë 1 200 tonë sodë kaus-

tike vetëm pse i mungojnë gurët, apo që krijohen 30 000 tonë kripë deficit për mungesë organizimi. Pse nuk janë transportuar gurët? Nuk është e drejtë të mos realizohet plani për këtë shkak. Një gjendje e tillë nuk duhet lejuar. Që bie shiu dhe shkrin kripa, kësaj nuk kemi çfarë t'i bëjmë, por të jetë guri dhe të mos punojë fabrika, kjo nuk është e drejtë. Si mund të kalojnë ashtu këto gjëra? Japim një milion e ca lekë valutë, sillen 4-5 makineri të reja shumë të nevojshme që duhen vënë sa më parë në shfrytëzim dhe duhet të ndërhyhet nga Kryeministria për të thënë se ndërtimi duhet të bëhet medoemos tani, kurse ju<sup>1</sup>, si pa gjë të keq, e vini në plan për vitin 1971. Si ndodh kështu? Mund të lihen gjëra të tjera ndoshta, që nuk duhen bërë hëpërhë, por jo këto për të cilat nuk pret puna. Të merren masa e të ndërtohen pa vonesë fabrikat moderne që kemi sjellë nga jashtë, se është krim për ekonominë tonë që ato të zvarriten për një vit të tërë. Deficite na janë krijuar, gjithashtu, në prodhimin e plehut azotik dhe në industrinë ushqimore, pa folur për cilësinë e mjaft prodhimeve industriale, e cila duhet të përmirësohet medoemos.

Në materialet që na janë paraqitur propozohet edhe për uljen e shifrave që kanë të bëjnë me zënien e peshkut. Mua më duket se ky propozim nuk duhet pranuar. Jo vetëm kaq, por mendoj t'i tejkalojmë shifrat e zënies së peshkut, duke punuar më shumë në drejtim të organizimit dhe të vendosjes së një disipline të fortë në punë. Është e lehtë ta ulim këtë

---

1. I drejtohet Koço Theodhosit.

shifër, por duhet të kemi parasysh se mish nuk kemi në sasi të mjaftueshme, shpendët nuk po na rriten me ritmin që kërkohet, atëherë, po të mos zëmë edhe peshk, çfarë bëjmë kështu? Ne kemi kaq vjet që flasim për peshkun, prandaj të vëmë detyra më të forta dhe të bëjmë përpjekje t'i plotësojmë ato, dhe detyrat jo t'i vëmë formalisht sa për t'i pasur në kartë. Po qe kështu më mirë të mos i vëmë. Prandaj të bëhen më shumë përpjekje edhe në këtë drejtim.

Jam dakord, siç u tha këtu nga shokët, për kriterin që duhet të ndiqet në ndërtimin e makinave të ndryshme nga uzinat tona, domethënë, të prodhohen ato që na nevojiten, në bazë të planit, të jenë në seri, të dalin të lira e të mira dhe jo prodho për të prodhuar, se ndryshe kemi prodhime jo të mira, gjë që na dëmton. Nga ana tjetër, më duket se duhet të mendohet më mirë që uzinat tona të prodhojnë më shumë materiale të konsumit të gjerë, sepse kjo ka një rëndësi të jashtëzakonshme.

Në lidhje me industrinë ushqimore, duhen caktuar detyra të forta e të palëvizshme gjatë vitit, sepse nevojat janë të mëdha, si për furnizimin e popullit, ashtu dhe për eksport, prandaj të merren masat e duhura që fabrikat të furnizohen me lëndë të parë dhe të realizojnë plotësisht planet që aprovojmë.

Jam dakord që të krijojmë e të lëmë rezerva. Që duhet të kemi rezerva, kjo është e drejtë, por që t'i krijojmë ato, mendoj se duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për të plotësuar e për të tejkaluar detyrat e këtij plani.

Gjithashtu, jam dakord me shkurtimin e kërkesave

që janë bërë si për investimet, ashtu edhe për numrin e fuqisë punëtore. Ky shkurtim ishte absolutisht i domosdoshëm. Këto kërkesa tregojnë se imagjinata dhe dëshira nuk mungojnë, por baza nuk i shikon realisht mundësitë e qendrës dhe nuk llogarit drejt mundësitë e realizimit të tyre. Ne duhet të këshillojmë Partinë se një veprim i tillë nuk është i drejtë dhe se në këtë rrugë nuk duhet ecur kurrë, për arsye se plani i ndër-tuar jashtë mundësive tona reale, materiale e financiare është një plan i fryrë e fiktiv. Kur kërkohet të bëhen shumë investime, kur kërkohen shumë objekte dhe këto janë jashtë mundësive tona, kuptohet atëherë se do të kemi objekte të shumta e të shpërndara, një pjesë e të cilave do të mbeten në themel dhe do të na krijohet kështu një inflacion, sepse për ndërtimin e tyre do të duhet shumë fuqi punëtore. Kjo do të thotë që objektet të mos realizohen, të mos merren prej tyre prodhimet e parashikuara dhe të rëndohet ekonomia. Atëherë ç'vlen një plan i tillë? Prandaj nga baza nuk duhet të mendohet për një plan të fryrë dhe irreal.

Gjithashtu, ne duhet të mendojmë për një përmirësim rrënjësor të rendimentit të punës duke rishikuar seriozisht një nga një komponentët e tij, siç janë: kualifikimi i njerëzve në profesionin e tyre, mekanizimi dhe disiplina në punë. Këto tri çështje veçanërisht duhet të ngrihen me forcë: e para, kualifikimi të organizohet seriozisht, e dyta, mekanizimi të ngrihet në një shkallë më të lartë që të shtojë prodhimin e të zëvendësojë fuqinë punëtore, dhe e treta, 8-orëshi të zbatohet medoemos e me rreptësi. Nuk duhet lejuar që 5 mijë punëtorë në Tiranë e sa të tjerë si këta në

rrethet e ndryshme të bëjnë punë të lehta me dorë, kur janë të gjitha mundësitë që ato të kryhen me mekanizma të thjeshtë. Kjo, më duket mua, e rëndon shumë ekonominë tonë, është e gabuar dhe nuk duhet lejuar të ecet në këtë mënyrë. Në qoftë se ka mundësi ta bëjmë një mekanizëm për ta shpejtuar një proces pune, ta planifikojmë e ta prodhojmë sa më parë. Kjo është diçka shumë serioze.

Siç u tha për çështjen e konfeksioneve edhe në sektorë të tjerë ne futim njerëz në punë pa asnjë përgatitje e kualifikim, të cilët, pa e merituar dhe pa dhënë atë rendiment që pritet, menjëherë marrin rroga të plota. Kjo nuk është e drejtë. Në qoftë se punëtorët nuk i kualifikojmë që të japin rendimentin e duhur, në qoftë se nuk mekanizojmë prodhimin dhe nuk vëmë një disiplinë të fortë në punë, në rast se nuk zbatohet me rreptësi 8-orëshi e nuk vihen në rrugë të gjitha problemet e tjera që kanë lidhje me disiplinën në prodhim, nuk mund të ngrihet si duhet rendimenti i punës dhe as që mund të kërkohet prodhim me cilësi të lartë.

Nuk e di nëse tregtia i shet konfeksionet të mbaruara. Qytetari e do rrobën sipas trupit, pasi e blen me para. Ai nuk mund të blejë një kostum të gatshëm kur është qepur keq. Pengesa që përmend ti, Kiço [Ngjela] se «duhet të krijosh në çdo dyqan rrobaqepësi» nuk është arsye që mund të justifikojë cilësinë e keqe të qepjes së konfeksioneve. Në qoftë se duam të kemi konfeksione, duhet të kemi kujdes në qepjen e mirë të tyre, dhe, kur e merr rrobën e gatshme ose këpucën në dyqan, duhet të të rrijë tamam, e jo të jetë

një numër më e madhe ose më e vogël. Në qoftë se duam të vijmë gratë për të blerë, rrobat të qepen mirë dhe sipas dëshirës së tyre. Për këtë qëllim i kemi krijuar rrobaqepësitë. Krahas këtyre kërkesat e popullit duhet t'i plotësojmë më së miri edhe industria e konfeksioneve. Por, në qoftë se do ta furnizojmë qytetin me konfeksione, pa marrë parasysh këto ekzigjenca, qytetari nuk të vjen për të blerë rroba të gatshme. Qepja e rrobave, pra të ngrihet në nivelin e një industrie të përparuar me tërë kuptimin e fjalës. Për këtë duhet të ngrihet rendimenti, të ulen çmimet, të zbatohet një disiplinë e fortë në përdorimin e metrazhit dhe në shfrytëzimin e orarit të punës etj. Në qepjen e rrobave kërkohet kujdes i veçantë, sepse për të bërë, fjala vjen, një pallto, punonjësit i duhet të paguajë jo pak nga të ardhurat e tij, prandaj kjo çështje të merret me seriozitet të madh. Të presin e të qepin gra e burra që e dinë zanatin, e jo çdo njeri i paprovuar në këtë punë.

Për sa i përket bujqësisë dëshiroj të them se nuk jam për uljen e planeve, por jam për atë që shifrat të mbeten ashtu siç janë parashikuar në këtë plan. Të tërë e shohim se ky është një plan cip më cip dhe do të ishte më mirë të kishte ca më tepër mundësi manovrimi, po këtë mundësi s'e kemi, prandaj realizimi i tij kërkon një mobilizim total nga të gjithë.

Mua më duket se nuk është e drejtë të ulim planin e patates, sepse kjo do të thotë që fshatari të mos hajë patate. Në qoftë se fshatarit nuk i vihet detyra të prodhojë e të përdorë më shumë patate, ai do të përdorë drithë më shumë. Prandaj ta bindim atë që

të prodhojë më tepër patate e t'i përdorë sa më shumë ato. Natyrisht, do të ishte gabim të insistonim në rast se do të merrnim, siç po ndodh tani në disa zona, 30, 40 e 50 kuintalë patate për hektar. Është e qartë se kështu patatja nuk ka leverdi. Në qoftë se jemi të bindur që toka jonë nuk prodhon mesatarisht 100 e 120 kuintalë patate për hektar, për të mos thënë më shumë, atëherë ta heqim atë, pse në vend të saj do të marrim më shumë grurë ose misër. Por, duke e llogaritur proporcionin e patates me drithin 4 me 1, në qoftë se patate marrim më tepër, atëherë ta lëmë se ka leverdi pasi, siç kemi thënë, patatja është gjellë dhe bukë. Kam përshtypjen se rrethet nuk e kanë marrë sa duhet seriozisht prodhimin e saj.

Edhe unë, gjithashtu, nuk jam i mendimit të shkurtohen sipërfaqet e mbjella, duke pranuar se gjoja do të rritim rendimentet 4 kuintalë për hektar, mbi rendimentin e planifikuar dhe të lëmë kështu toka pa mbjellë. Kjo është në kundërshtim me konceptin e drejtimit modern të bujqësisë, prandaj t'u pritet rruga tendencave të tilla. Ne duhet të mbjellim pa përjashtim të gjitha sipërfaqet, edhe ato që japin rendiment të ulët. Rëndësi ka të marrim sa më tepër prodhime.

Për bujqësinë nuk dëshiroj të hyj në të gjitha çështjet, pse ato u trajtuan dhe jam dakord me sa thanë shokët. Por të gjithë na shqetësojnë seriozisht deficitet e krijuara në bujqësi, prandaj duhen marrë të gjitha masat që plani i vitit 1971 të plotësohet me doemos dhe në të gjithë zërat.

Problem kryesor, kyç në bujqësi, që duhet të pre-



okupojë Partinë dhe organet ekonomike, është aktualisht organizimi dhe disiplina në punë. Fati i të gjitha problemeve të tjera që kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, si kodi agroteknik etj. varen nga organizimi dhe disiplina në punë; po nuk pati organizim dhe disiplinë në punë, nuk ka si zbatohet asnjë nga kërkesat e agroteknikës. Unë mendoj se në bujqësi ne jemi akoma larg nga zgjidhja e këtij problemi. Format organizative që kemi gjetur për ta zgjidhur atë kanë qëndruar në vend dhe në bujqësi ne nuk shohim, si në sektorët e tjerë, që të bëhen propozime për përmirësimin e organizimit të punës nga baza dhe nga organet përkatëse. Duket sikur baza këto forma të organizimit të punës jo vetëm i quan të përsosura e të vendosura një herë e përgjithmonë, por nuk e ndien nevojën që të vritet mendja për t'u bërë ndryshimet që rrjedhin nga eksperiencia. Do të thosha se edhe format organizative që ekzistojnë, ashtu siç janë, nuk zbatohen në mënyrë të përpiktë dhe jo rrallë injorohen e shkelen si pa të keq. Këtu, më duket mua, është edhe arsyeja që nuk ka iniciativa për përmirësim të mëtejshëm të formave e të metodave të punës dhe të organizimit të saj. Mirëpo kjo mungesë disipline përhapet si një sëmundje ngjitëse në të gjitha proceset e punëve bujqësore.

Në organizimin e kooperativave bujqësore ne sot kemi brigadën e çdo brigadë ka skuadrat. Skuadra është baza, pastaj kemi edhe udhëheqjen në sektor dhe shtabin, kryesinë e kooperativës. Si organizim ky është i drejtë. Ndoshta në bazë të eksperiencës mund që edhe këtu të bëhen ndryshime. Po të shohim se si

funksionon shtabi, del se ky në realitet është reduktuar në personin e kryetarit të kooperativës, i cili për ndonjë problem, sigurisht, pyet ndopak në këmbë agronomin apo ndonjë tjetër. Por fakt është se një kooperativë e madhe me ekonomi të shpërndarë, me sipërfaqe të mëdha toke e me një numër të madh anëtarësh, në realitet nuk funksionon si një ekonomi e organizuar si duhet dhe me një disiplinë të fortë. Po brigada si funksionon? Edhe këtu kemi në krye brigadierin, i cili, si rregull, është një shok ose një shoqe e mirë, por nuk mjafton me kaq. Brigada ka një mijë e një detyra. A funksionon brigada dhe skuadrat e saj si një repart i organizuar dhe me disiplinë të fortë për të kryer të gjitha detyrat që i janë ngarkuar? Se këto detyra nuk i ka vendosur vetë brigadieri, po ato janë rrahur e janë diskutuar më parë në shtabin e brigadës apo të kooperativës, ku janë caktuar edhe metodat e punës, mënyra e përgatitjes së materialeve dhe e sigurimit të mjeteve, vendet ku do të gjenden e me se do të transportohen, cila brigadë apo skuadër do të bëjë njërën punë e cila tjetrën etj. Në bazë të të gjitha këtyre detyrave organizohet puna për zbatimin e tyre. Dhe këtë nuk e bën dot vetëm brigadieri. Prandaj në brigadë duhet të ketë medoemos një shtab të tërë për zbatimin e detyrave. Nuk është fjala që ky shtab të paguhet, por me punën e tij, duke u mbështetur fuqimisht në brigadën, ai të luftojë me këmbëngulje për një organizim të fortë të punës, në mënyrë që anëtarët e brigadës, si ushtarë, t'i futen zbatimit të detyrave me disiplinë e ndërgjegje të lartë; e para, të punojnë medoemos 8 orë, e dyta, në këto 8 orë të punojnë në sek-

torët e caktuar, duke kontrolluar vetveten që asnjë pesëminutësh të mos kalojë kot.

Duhet organizuar, gjithashtu, më së miri edhe kontrolli i çdo detyre: për shembull ka punë që mund të bëhet brenda 2 orëve në një sektor ku janë caktuar të punojnë 10 veta, por edhe duhet kontrolluar që kjo punë të mbarojë pikërisht brenda 2 orëve dhe jo më tepër. Pastaj në organizim të parashikohet që këta, përnjëherësh, pa humbur kohë, të hidhen në një sektor tjetër ku i pret një detyrë e dytë konkrete, pra edhe kjo e llogaritur qysh më parë. Çdo punë duhet bërë e llogaritur me njerëz, me orë, me sektor dhe e kontrolluar me rreptësi. Në rast se një punë për t'u kryer kërkon 5 orë kohë, duhet menduar si do të përdoren 3 orët e tjera të punës që u mbeten kooperativistëve. Në qoftë se në këto 3 orë, për shembull, ata duhet të venë të shkoqin misër, të shkojnë menjëherë atje ku është misri, të bëjnë punë dhe jo t'ia marrin këngës ose të hedhin valle. Dëfrimi të organizohet jashtë orëve e ditëve të punës.

Këto punë duhen bërë me plan dhe për çdo veprim duhet dhënë llogari. Po kujt t'i jepet llogari? Shtabit të brigadës, të kooperativës. Kjo është e domosdoshme të bëhet. Të mos ndodhë që brigadieri t'i njoftojë vetëm në mëngjes anëtarët për të shkuar secili në punën që u ka caktuar, kurse ata venë në orën 8 ose 9 dhe futen, për shembull, të gjithë në arë, në kundërshtim me porosinë e brigadierit, kurse duhej, për shembull, që 10 prej tyre të merrnin qerret për të ngarkuar një sasi plehu për ta çuar në vendin e duhur dhe në orën e caktuar etj. Brigadieri, pra, duhet

të veprojnë me kohë, të llogaritë edhe njerëzit, edhe kohën për çdo punë dhe t'i përcaktojnë që në mbrëmje detyrat për të nesërmen, për shembull, duhet të ndajë në mënyrë të qartë detyrat midis atyre që do të çojnë plehun në arë, midis atyre që do ta shpërndajnë këtë, sa veta do të punojnë për hapjen e vijave kulluese, në cilin sektor etj., etj. Pastaj, kur brigada i ka mbaruar këto punë, brigadieri shkon në shtab, në kryesi, njofton për punën e kryer dhe kërkon udhëzime se ç'do të bëjë më tej. Vetëm kështu, me një organizim e disiplinë të fortë në punë, ka mundësi të zbatohet edhe agroteknika. Ndryshe do të kemi punë të shthurur, gjë që na sjell dëme jashtëzakonisht të mëdha në bujqësi.

Në teori, për kooperativat bujqësore ne kemi vendosur një rrugë ecjeje, një mënyrë organizimi pune, por mendoj se rëndësi ka të shikojmë se si po ecet në praktikë me vendosjen e disiplinës në punë në të gjitha hallkat e organizimit që kemi, në të gjitha etapat e procesit të prodhimit, në momentet e ndryshme që ngjasin në përlllogaritjen e proceseve të ndryshme të punës e të prodhimit, kush i bën e kush duhet t'i bëjë këto etj. Ato duhet t'i bëjnë të gjithë, duke filluar me radhë që nga anëtarët e kryesisë, përgjegjësit e sektorëve, të brigadave, të skuadrave. Por në këto hallka çështjet rrumbullakosen, shkohet qesim; njerëzit u përshtaten natyrës dhe mentalitetit të fshatarit dhe kjo pikërisht në një kohë dhe në një sektor si bujqësia ku konditat, më tepër se në çdo sektor tjetër të ekonomisë, kërkojnë një zbatim rigoroz të çdo detyre.

Duhet pranuar se fshati dhe bujqësia janë një

sektor i vështirë pune, atje ekzistojnë akoma të forta pikëpamjet mikroborgjeze dhe tendencat për t'i bërë punët tërkuzë. Pikërisht për këto arsye atje duhet disiplinë, të cilën është e domosdoshme ta forcojmë, pse ka edhe fshatarë me prirje për të bërë sa më shumë ditë-punë e me normë sa më të vogël dhe dita e punës të ketë sa më pak orë pune efektive. Këta fshatarë kanë prirje të lodhen sa më pak dhe të thonë se u lodhën shumë. Prandaj, Partia duhet të punojë për t'ua zhdukur këto prirje dhe jo vetëm me fjalime, por me një disiplinë të fortë në çdo proces pune. Disiplina të ndihmojë që të përballohet vëllimi i punës që duhet kryer dhe të punohet me cilësi të mirë. Vetëm me një organizim dhe shfrytëzim të mirë të ditës së punës do të kemi rezultate efektive në bujqësi dhe jo siç ndodh që punohet 5 ose 6 orë në ditë, koha tjetër ikën nga fillimi i punës me vonesë, nga koha që humbet duke pirë cigare, në biseda të kota etj.

Ne duhet të na shqetësojë fakti që një e treta e gjithë kooperativistëve realizon më pak se 200 ditë-punë në vit dhe këto jo ditë kalendarike, po të normuara. Kjo do të thotë se gjysmën e vitit ata nuk punojnë, gjë që nuk është e rregullt. A na lejohet neve një gjë e tillë? Jo, nuk na lejohet. Çështja është se në pjesëmarrjen e njerëzve në punë dhe në kryerjen efektive të punës gjatë 8 orëve kemi një rezervë shumë të madhe. Në qoftë se këtë çështje e vëmë në rrugë të drejtë, ne do ta ndryshojmë me siguri situatën. Thuhet se këto gjëra në bujqësi ekzistojnë, pse atje i ka vetë natyra e punës etj. Unë mendoj se duhet bërë një luftë më këmbëngulëse për çrrënjosjen

e këtyre koncepteve, si dhe të mjaft koncepteve e qëndrimeve të vjetra feudale e mikroborgjeze për punën, të trashëguara nga e kaluara. Prandaj, Partia ta sqarojë, ta bindë dhe t'i kërkojë fshatarit që t'i bëjë këto, pse është vetëm për të mirën e tij dhe për të mirën e gjithë shoqërisë sonë. Këtë problem nuk duhet t'ia lëmë spontaneitetit mikroborgjez.

Kur themi se në përgjithësi puna e fshatarit është e rëndë, kjo është e vërtetë, por kjo nuk do të thotë që puna të bëhet me të njëjtat norma që janë caktuar, këto duhet vazhdimisht të përmirësohen. Ne themi se fshatari punon, dhe kjo është e vërtetë po të flasim në përgjithësi, por puna që kryen ai nuk është plotësisht e kënaqshme, po ta shikojmë drejt me anë të një përlllogaritjeje normale e të leverdisë së mundshme, siç shohim çdo ditë, çdo muaj e çdo vit punën e punëtorit në fabrika, në ndërmarrjet industriale e bujqësore. Prandaj unë mendoj që edhe në bujqësi t'i rishikojmë normat. Derisa herë pas here ne i rishikojmë normat në fabrika, të vëmë rregull që edhe në bujqësi, në këtë degë me rëndësi të ekonomisë, s'ka pse të mos veprojmë po ashtu, pasi prej normave varen shumë prodhimi dhe vendosja e një disipline të fortë në punë.

Për të gjitha këto mendoj ta studiojmë konkretisht problemin dhe të marrim masa që të forcohen organizimi dhe disiplina e punës në prodhim në kooperativat bujqësore. Ta bëjmë edhe kooperativistin të mendojë dhe ta matë çdo gjë me prodhimin, ta ketë të qartë se ai punon kurdoherë për rritjen e prodhimit, sepse vetëm me prodhimin vlerësohet dita e punës,

ngrihet vlera e saj. Po e zgjidhëm në teori dhe në praktikë vlerën e ditës së punës në bazë të vlerës së prodhimit, që ka punën si faktor kryesor (pse ai ka edhe faktorë të tjerë që i nënshtrohen edhe këta punës), atëherë përparimet në bujqësi do të jenë më të mëdha. Por sot shihet se kooperativisti ditën e punës e mat vetëm me lekët që do të marrë. Këtë mendim ne duhet ta luftojmë. Për këtë a kemi përgjegjësi që të gjithë ne, që këtu nga Byroja Politike, Komiteti Qendror, Qeveria, ministritë, veçanërisht Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të rretheve? Kemi, kemi shumë bile dhe mua më duket se detyra jonë është që ta bëjmë bazën të ndërgjegjshme. Këtu pikërisht qëndron edhe përgjegjësia jonë. Në qoftë se nuk e ngremë bazën, kooperativën, në atë shkallë që kooperativistët vetë të bëhen me të vërtetë të ndërgjegjshëm për një punë të tillë të organizuar mirë e të disiplinuar për format e metodat e punës, që ata të shqetësohen e ta kuptojnë drejt këtë çështje, sado përpjekje që të bëjnë Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive, ato kurrë nuk do të mund ta kontrollojnë sa mbolli e sa nuk mbolli kooperativa, si punoi e si nuk punoi. Pra ne duhet të sigurojmë një organizim të tillë që t'i dalë mbanë kësaj pune.

Më duket se drejt po vepron Ministria e Bujqësisë, që i është futur një studimi lidhur me organizimin e kooperativave të bashkuara. Vetë nevojat e zhvillimit na kanë shtyrë ne që të bëjmë bashkimin e kooperativave bujqësore dhe këtë do ta bëjmë ashtu si e kemi planin, por mendoj të shikojmë më mirë në këto kooperativa çështjen e renditjes së kulturave,

natyrisht, sipas mundësive konkrete të secilës prej tyre. Po kështu të shikojmë specializimin e tyre dhe çështjet e tjera që duhet të çojnë në një shfrytëzim më të mirë të rezervave e të mundësive që krijojnë ato. Lidhur me këtë, edhe Banka Bujqësore duhet drejtuar mirë nga Partia në rrethe që të futet si duhet në ingranazhin e kooperativave bujqësore, jo vetëm me anë të kredive shtetërore, por njëkohësisht t'i vërë vetes detyrën që t'u mësojë atyre disiplinën financiare, rregullat e përdorimit të lekut, nga vjen leku, si mund të merren të holla më shumë, natyrisht, kuptohet duke prodhuar më tepër dhe që të shtohen prodhimet duhen bërë investime. Por për të investuar domatet që janë prodhuar me ditë-punë nuk u duhen dhënë gati pa para kooperativistëve, prandaj, para se t'i shiten në dyqan anëtarit të kooperativës, duhet llogaritur sa bëjnë. Kooperativisti duhet të dërsijë në punë, të prodhojë që të marrë lekë, me të cilët do të blejë edhe domatet, kastravecet etj. dhe jo të thotë se ata i prodhon vetë, prandaj mund t'i marrë edhe pa para. Ai vërtet punon për prodhimin e tyre, por për këtë është paguar me ditë-punë; prandaj asgjë nuk duhet të marrë pa para. Kështu Banka Bujqësore në lidhjet e saj me kooperativat bujqësore t'u rrënjosë këtyre ndjenjën e organizimit e të disiplinës nëpërmjet lekut, nëpërmjet sistemit bankar, që është një ndihmës shumë i madh për atë që kërkojmë ne, për vendosjen e disiplinës. Dhe disiplina financiare, po të zbatohet drejt, luan një rol të madh në këtë drejtim. Kur banka t'i thotë kryetarit të kooperativës se nuk i jep kredi derisa nuk ka shlyer detyrimet e mëpar-



shme, atëherë atij i vjen festja vërdallë. Kur banka i rekomandon kooperativës ku të investojë ose i kërkon kthimin e kredive të marra më parë, ndërsa kooperativa nuk ka fonde, se nuk ka pasur prodhime të mjafta, banka e vë atë kështu përpara përgjegjësisë dhe njëkohësisht e mëson si ta organizojë punën më mirë që të sigurojë prodhimet e parashikuara. Prandaj të mos ndodhë më si me Komitetin e Partisë të Rrethit të Gjirokastrës që në mbledhjen për shqyrtimin e planit pesëvjeçar të bujqësisë as që e thërret fare drejtorin e Bankës Bujqësore.

E përsëris edhe një herë se disiplina në çdo drejtim, në punë, në prodhim, në zbatimin e agroteknikës, disiplina financiare, janë çështje jetike për kooperativën. Veçanërisht disiplina në punë, është konditë *sine qua non* e çdo suksesi. Ky është një problem i madh partie dhe pushteti në kooperativë, është një problem teorik dhe praktik, por që duhet vënë në jetë jo si deri tani; prandaj të punohet që të bëhen medoemos ndryshime rrënjësore në konceptet e njerëzve, në radhë të parë, dhe pastaj në praktikë. Në praktikë, duhet vendosur një kontroll shumë i rreptë për zbatimin e disiplinës në punë dhe kudo. Në rast se për çdo punë në fshat nuk organizojmë nga pas edhe kontrollin politik, organizativ, teknik dhe financiar, ajo do të çalojë keq dhe do të vazhdohet të ecet në rrugë të vjetër, qoftë edhe me forma të reja. Prandaj format e reja t'i përgjigjen brendisë së re, revolucionare.

Disiplinën dhe kontrollin e vënë njerëzit dhe, në rastin që po diskutojmë, e vënë kooperativistët, me organizatën-bazë të Partisë të fshatit në krye. Nuk

mund të lejohet që në kooperativë disiplina e vërtetë proletare në punë e në drejtim të kuptohet vetëm me fjalët: «E vë asambleja», «e kontrollon asambleja» ose «e vendos mbledhja e përgjithshme», «e vendos brigadieri apo kryetari» etj. Këto thuhën, por fakti është që disiplina në punë në kooperativat bujqësore paraqitet akoma e dobët. Është e domosdoshme që masës t'ia përgatitësh problemin, t'ia shtrosh ta studiojë, ta diskutojë lirisht, ta ndreqë, ta pranojë ose ta hedhë poshtë dhe ta zëvendësojë me një të ri. Por kur vendoset çështja, përsëri kërkohet një organizim jashtëzakonisht i fortë, veçanërisht në bujqësi, me qëllim që ajo që u vendos të zbatohet si duhet.

Këtë drejtim dhe organizim jo në nivelin e dëshiruar që ekziston në kooperativat bujqësore ne duhet ta njohim dhe të marrim sa më parë masa që ta forcojmë. Në kooperativat të mos dëgjohet vetëm zëri i kryetarit. Kjo situatë duhet të marrë fund. Në kooperativë është e domosdoshme të ketë një udhëheqje të fortë, aktive, kolegjiale që të vendosë ajo dhe jo kryetari. Dhe ajo do të vendosë në frymën e vendimeve të asamblesë.

Në kooperativë na duhet një udhëheqje politike dhe teknike e zonja për organizimin dhe drejtimin e të gjitha punëve që të mos lejojë kurrfarë formalizmi e lëshimesh në veprimtarinë e saj. Por kjo udhëheqje, ky drejtim, ky shtab i përhershëm është e domosdoshme të ketë kompetenca e detyra të qarta, të ketë detyra kolegjiale dhe individuale të harmonizuara, të lidhura ngushtë me prodhimin dhe të inkuadruara në një disiplinë të rreptë pune për veten e saj, pse

kështu do të mund t'u kërkojë disiplinë të rreptë edhe të tjerëve.

Duhet rishikuar, pra, në mënyrë serioze i gjithë drejtimi që kemi sot, në të gjitha hallkat e kooperativës. Kooperativat të jenë organizata të fuqishme në hozrashot, si të thuash të vetëdrejtohen dhe këtë ta bëjnë mirë, drejt, sipas vijës së Partisë dhe normave të caktuara.

Ndihma e rrethit dhe e qendrës të dihet si u jepet, sa u jepet, kur u jepet dhe kujt i jepet. Çdo hallkë ka detyra dhe përgjegjësi, por vetë ne është e domosdoshme të kuptojmë se, po nuk forcuam bazën që kjo të ecë me këmbët e saj, të luftojë vetë me ndërgjegje të lartë, me kapacitete të shtuara me sa më shumë zotësi të fituara, atëherë nuk do t'ia dalim dot mbanë punës. Edhe sikur direktivat, udhëzimet të jenë të shkëlqyeshme, fara të jetë e mirë, traktorët të jenë të rinj dhe lopët të racës, prapë bujqësia nuk do të përparojë, në rast se ne nuk i vëmë rëndësi bazës.

Por, mund të thotë ndokush: «Ne u çamë duke vajtur në fshat». Kjo mund të jetë e vërtetë, mund edhe të jesh lodhur, por lopët ngordhin, nuk japin rendimentin e caktuar, gruri nuk rritet sa duam ne, se nuk bëhet mirë puna për kullimin e tokës etj., etj. Po përse nuk bëhen të gjitha këto? Për arsye se, siç thashë, një e treta e kooperativistëve realizon më pak se 200 ditë-punë në vit, që do të thotë se punon mesatarisht në vit vetëm rreth 150 ditë kalendarike, pra gati gjysmë viti.

Natyrisht, në kooperativa ne kemi edhe gjëra shumë të bukura, bile të lavdërueshme, mbi të cilat mbë-

shtetet plani ynë i guximshëm dhe real që po aprovojmë. Le të analizojmë, pra, me kujdes punën e mrekullueshme të atyre njerëzve të socializmit që janë një shembull i madh dhe do të shikojmë se këta kanë kuptuar mirë ç'është puna, si arrihet prodhimi, ç'është disiplina në punë e në prodhim, ç'është zbatimi i agroteknikës. Këta njerëz e urrejné dembelin, hileqarin, frikacakun në punë e prapanikun.

Rishikimi i organizimit të këtyre ekonomive të mëdha duhet të na preokupojë seriozisht. Ne, si rregull, duhet të përgatitim kuadro të aftë drejtues në fshat, por do të dërgojmë atje edhe kuadro që të jenë organizatorë të aftë pune dhe prodhimi, njerëz të zotë e me partishmëri nga gjiri i klasës punëtore, nga ndërmarrjet. Kooperativat e mëdha bujqësore, që të bëhen shembull për ekonomitë më të vogla kanë shumë nevojë për kuadro të tillë që do të ndihmojnë në vendosjen e disiplinës në punë, të disiplinës financiare etj. dhe do të nxjerrin bukën e tyre atje ku do të punojnë. Në një kohë që në kooperativat bujqësore ne humbasim prodhime e të ardhura të shumta, na duket sikur gjoja bëjmë kursime. Prandaj të mos mendojmë se kooperativat do të na rëndohen ekonomikisht me të tillë kuadro, përkundrazi ato do t'i shtojnë të ardhurat e tyre, do të kenë fitime më të mëdha duke pasur kuadro më të aftë.

Por organizimi nuk duhet të bëhet vetëm në këmbë e kooperativave, por në çdo sektor, në çdo brigadë e deri në çdo skuadër. Format e punës, mundet që nuk i kemi keq, por ka vend për plotësime, thjeshtime, spostime, për kombinim më të mirë dhe më të drejtë

të disa gjërave. Gjithçka duhet bërë kurdoherë me plan, pa humbur kohë të dobishme, pa krijuar konfuzion, pa i hequr njerëzit nga puna, pa dobësuar disiplinën, prodhimin, përkundrazi, të ruhemi sidomos nga punët me bujë, që të japin pak bukë.

Dua të shtoj me këtë rast se u kam dhënë një ide shokëve të bujqësisë për ta studiuar<sup>1</sup>. Qëllimin e kam të marrim disa masa për të krijuar një stabilitet në prodhimet bujqësore, për të evituar gjithë këto luhatje që na ngjasin, për të vendosur në bujqësi pikërisht një disiplinë të fortë në punë, një qarkullim më shkenkor në bimët, për të siguruar rendimente dhe prodhime bujqësore më të larta. Shokët, pra, kanë detyrën të studiojnë që një numër i madh i kooperativave bujqësore të fushave, që kanë tokat më të pasura, të kthehen në një formë organizative ndërmjetëse midis kooperativës dhe ndërmarrjes bujqësore me pjesëmarrjen në to të shtetit. Këto kooperativa do të vazhdojnë të jenë pronë kolektive e grupit. Shteti në to mund të ndihmojë me farëra, me traktorë, me kafshë dhe mjete pune, me investime prodhuese, të ndihmojë për forcimin e drejtimit të kooperativave me kuadro, organizatorë, teknikë e të tjerë. Kështu do të arrijmë të na shtohet sipërfaqja e tokave me të cilat mund të manovrohet për të stabilizuar prodhimin e madh bujqësor. Në këto kooperativa duhet të ruhen marrëdhëniet e shpërndarjes që rrjedhin nga prona e grupit dhe të mbetet oborri kooperativist, por format e drejtimit, të organizimit të punës e të shpërbllimit mund

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 44, f. 442.

të jenë të përiferëta ose të njëjlojta me ato të ndër-marrjeve bujqësore. Kooperativistët mund të shpërblehen sipas punës me pagë të garantuar në bazë të të ardhurave të kooperativës.

Me këtë formë organizimi ne mund të sigurojmë, për shembull, drithërat, mund të sigurojmë pambukun, mund të sigurojmë lulediellin, orizin, qumështin dhe të zhdukim atë mori kulturash bujqësore që kemi sot në çdo kooperativë, me një fjalë do të na krijohen më shumë mundësi të specializojmë fushat. Natyrisht, më parë se të vendosim, do të presim studimin që do të na bëjnë shokët e ngarkuar.

*Botuar për herë të parë me ndonjë shkurtim në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 144*

*Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## PUNA POLITIKE ËSHTË EFEKTIVE KUR PREK MENDJET E NJERËZVE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

24 dhjetor 1970

Personi, kërkesën e të cilit po shqyrtojmë sot, e ka kryer krimin si cub, sipas normave të vjetra të hakmarrjes. Lind pyetja: A nuk ka jetuar ky njeri këtu? Si nuk e ka prekur puna e Partisë sonë?

Shokët e Partisë dhe të rinisë atje, me sa duket, nuk kishin bërë një punë të mjaftueshme e të përshtatshme për edukimin e këtij njeriu me normat e moralit tonë socialist. Pasi u krye akti kriminal, ata menduan: «Vrasësin ta vrasim, sepse kemi edhe raste të tjera hasmërisht të vjetra dhe, po të mos e dënojmë me vdekje këtë, do të vazhdojë akoma zakoni i keq i hakmarrjes!». Kjo mënyrë gjykimi e veprimi nuk është një mjet efikas për edukimin e njerëzve.

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua, veç të tjerash, edhe kërkesa për faljen e jetës së një të dënuari.

Në disa krahina, ku ekziston akoma zakoni i hakmarrjes, i ruajtur në forma të fshehta, duhet të zhvillohet një punë politike këmbëngulëse. Me qëllim që të parandalohen krimet e mundshme, mund të shfrytëzohet, midis të tjerash, edhe miqësia që kanë njerëzit me njëri-tjetrin, për t'u bërë pajtime në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Mbasi ndodhi kjo vrasje për hakmarrje, na del se në ndonjë rreth kemi edhe raste të tjera grindjesh të kësaj natyre. Aktualisht këto grindje janë të heshtura, por nesër nuk dihet se ç'mund të na ndodhë me to. Këtu e ka burimin mendimi i gabuar i disa shokëve që përmenda më sipër se, po të mos e pushkatojmë këtë vrasës, do të na inkurajohen të tjerët dhe vrasjet do të vazhdojnë.

**Zgjidhja e këtij problemi serioz duhet të arrihet, në radhë të parë, nëpërmjet një pune politike shumë të theksuar e bindëse kundër hakmarrjes.** Po të shikojmë statistikën e viteve të fundit, del se në përgjithësi hasmëritë e vjetra janë pajtuar. Në qoftë se është tamam kështu, atëherë pse ka vrasje për hakmarrje? Ka se pajtimet e arritura janë formale dhe puna politike nuk ka bërë efektin e duhur për të prekur mendjet e njerëzve që vuajnë nga të tilla mbeturina. Ndryshe nuk ka si shpjegohet që ky djalë i ri të përfundojë në një krim kaq të rëndë për arsye se dikur i paskan vrrarë vëllanë e gjyshit! Pra, kryerja e krimit nga ana e këtij djali, normalisht nuk ka asnjë logjikë, prandaj shoqëria ka përgjegjësi për këtë njeri.

Krimi kurdoherë është vepër shoqërisht e rrezikshme që parashikohet nga ligji dhe konsiderohet faj i



rëndë, prandaj dhe duhet të dënohet. Por kriminaliteti duhet të shikohet në një prizëm më të thellë shoqëror lidhur edhe me punën sgaruese e bindëse që bën Partia, organizatat e masave dhe organet shtetërore. Kur kryhet një krim të mos mjaftohemi vetëm me vërtetimin e fakteve, të fajit dhe të rrethanave që e rëndojnë ose e lehtësojnë përgjegjësinë e kriminelit, por të gjejmë edhe shkaqet e vërteta të krimit.

Është ndryshe kur krimi ndodh në gjaknxehtësi dhe ndryshe kur kryhet me gjakftohtësinë më të madhe e me paramendim nga një djalë i ri. Ai arriti në krim pse ka mbetur i mënjanuar nga jeta shoqërore, nëpër mbledhje dhe në hekurudhë nuk ka vajtur si gjithë shokët e tij; ai nuk ka dashur të shoqërohet me të tjerë, por as të tjerët nuk e kanë aktivizuar atë. Në caktimin e dënimit të tij, krahas të tjerave, mendoj se duheshin marrë parasysh edhe këto të dhëna për jetën e tij.

Më duket që gjykata edhe për çështje të tilla, dënimin me 25 vjet heqje të lirisë duhet ta konsiderojë jashtëzakonisht të rëndë, se nuk është i drejtë gjykimi sipas të cilit: «Po nuk u pushkatua fajtori, nga opinioni prapanik do të konsiderohet i liruar».

Kur të na vijnë në Presidium çështje të tilla, rralëherë dhe vetëm për arsye të forta duhet të ndodhë dënimi me vdekje, por kjo mendoj se do të arrihet kur gjykatat tona të gjykojnë më objektivisht. Siç e kam thënë edhe herë tjetër, ne këtu në Presidium vihemi në pozita shumë të vështira për ndonjë vendim të gjykatës kur dënimi është me vdekje.

Po ta marrim çështjen nga ana thjesht juridike,

ndoshta në rastin konkret, nuk ka rrethana lehtësuese për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, se ka kaq vjet që i dënuari kërkon rastin t'i futë plumbin një njeriu. Por, ne këtu, lypset të gjykojmë se ai është në moshë të re, ka 4 fëmijë të mitur dhe është fshatar i varfër. Përveç këtyre duhet të kemi parasysh se motivet që e shtynë atë në krim, janë të vjetra. Te ky i ri, siç e theksova pak më parë, nuk ka ndikuar fare puna edukative që mund të jetë bërë, jo se ky ka qenë në kundërshtim me vijën e Partisë, por sepse me të nuk është punuar sa duhet që t'i ndryshonte edhe botëkuptimi i tij.

Në këto rrethana unë propozoj që t'i jepet dora dhe t'i falet jeta, jo se krimi nuk është i rëndë, por sepse ma merr mendja që ai, duke vuajtur dënimin e gjatë me heqje të lirisë, ka mundësi të edukohet.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor  
të RPSH, që gjendet në AQP*

## ESHTE PUNA E PARTISE AJO QË I BËN NJERËZIT TË MENDOJNË, TË KRIJOJNË E TË ZBATOJNË

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës në Tiranë,  
Gën Biao*

26 dhjetor 1970

*Pas përshëndetjeve të rastit, shoku Enver Hoxha  
ndalet në disa probleme të zhvillimit ekonomik të ve-  
ndit tonë.*

Vitin që vjen ne do të mbajmë Kongresin e 6-të të Partisë dhe kemi bindjen e plotë se ai do të jetë Kongresi ku do të bëhet bilanci i sukseseve të reja të mëdha në punën politike, organizative dhe ekonomike, në të gjithë sektorët e jetës së vendit tonë. Tani, megjithëse nuk i kemi të plota të dhënat, mendojmë se planet do t'i tejkalojmë në të gjithë sektorët, me përjashtim të bujqësisë, ku kemi deficite. Ne edhe në bujqësi kemi bërë përparime, pavarësisht se planin, për arsye objektive dhe subjektive, nuk e plotësojmë dot. Në këtë sektor kemi pasur edhe ca vështirësi natyrore, megjithatë, me një mobilizim më të madh dhe me punë të organizuar më mirë, mund të arriheshin rezultate më të mëdha. Vështirësitë natyrore ndi-

kojnë akoma së tepërmi te ne, se jemi vend i vogël. Kështu, kur bie shi, detyrohem të ngadalësojmë mbjelljet, kur bie brymë na prishen mjaft bimë, të cilat, po t'i lëmë për t'i mbjellë më vonë, nuk na bëhen. Sivjet, sidomos, e kemi pasur shumë vështirë me realizimin e planit të pambukut dhe të orizit në disa krahina, kryesisht për arsye subjektive, por mjaft vështirësi patëm edhe me drithërat.

Në bujqësi ne kemi edhe ekonomi të përparuara dhe të mira dhe mbi këtë bazë, duke marrë këto si shembull, Partia punoi për hartimin e planit të pestë pesëvjeçar. Por është e domosdoshme njëkohësisht të forcojmë edhe anën organizative, disiplinën në punë, disiplinën e prodhimit dhe atë shkencore. Atje ku të gjitha këto janë vënë në rrugë të mbarë, ka rezultate më të mira, përkundrazi atje ku këto çalojnë edhe prodhimi çalon.

Në përgjithësi, situata në vendin tonë është e shëndoshë, e mirë. Kudo ka një mobilizim të madh, një frymë të lartë revolucionare. Në punë njerëzit tanë kanë fituar një eksperiencë mjaft pozitive, që na shërben e do të na shërbejë çdo ditë e çdo muaj për mbarëvajtjen e të gjithë sektorëve të ekonomisë dhe të kulturës. Por për zhvillimin e gjithë sektorëve ne po u kushtojmë rëndësi edhe organizimit të mirë të punës, shfrytëzimit të mirë të të gjitha forcave në dispozicion, të kapaciteteve ekzistuese, qofshin këto njerëzore, mekanike apo të natyrës. Për këtë qëllim po punohet për të analizuar e për të shfrytëzuar në mënyrë të përsosur gjithë këta faktorë, si për prodhimin ashtu edhe për njerëzit.

Natyrisht, këtu ka fushë të gjerë veprimi. Megjithëse bëhet një punë e madhe dhe janë shënuar një varg suksesesh, prapëseprapë kërkohet çdo ditë e më shumë një veprimtari e kualifikuar politike dhe ideologjike me njerëzit. Është pikërisht puna e Partisë ajo që i bën njerëzit të mendojnë, të zhvillojnë mendimin, të zbatojnë dhe të krijojnë, por Partia jonë tregon kujdes që ata të mos bien në rutinë.

Kuptimi i thellë, njohja e mirë e problemeve dhe zgjidhja e tyre me sukses në jetë gërshetohen me kuptimin e vërtetë të demokracisë sonë socialiste. Demokracia nuk duhet të kuptohet si diçka që ka të bëjë me llafe e diskutime shkel e shko. Ajo kërkon nga cilido një njohje të thellë të çdo problemi, një zgjerim të njohurive, të cilat duhen zbatuar në jetë. Po të zbatohen si duhet këto njohuri, atëherë do të ketë patjetër krijimtari të madhe dhe gjatë këtij procesi do të shihet nëse puna u bë mirë ose u bë keq, pse vepron kështu njëri dhe përse vepron ashtu tjetri. Një punë të kujdesshme edukative Partia jonë e bën në bazë me tërë masën, por sidomos me kuadrat, me qëllim që baza të mos jetë diçka amorfe, pa jetë, sepse është ajo që krijon dhe zbaton. Në qoftë se pranojmë idenë që ajo është krijuesja e zbatuesja, është e domosdoshme që ajo të njohë dhe të mësojë çdo gjë, të kuptojë e t'i futet thellë çdo problemi. Këtu qëndron e gjithë dobia e kësaj çështjeje.

Parimet i kemi të drejta dhe luftojmë për t'i vënë ato në jetë, por në praktikë lindin edhe probleme. Për shembull, kur themi të planifikojmë me bazën, këtë vërtet e bëjmë, por disa herë në mënyrë

formale. Ndërsa atje ku një punë e tillë nuk bëhet në mënyrë formale, por me një kuptim të thellë ideologjik dhe politik nga ana e bazës, arrihen me siguri rezultate të larta.

Në ekonomitë bujqësore te ne ka me qindra brigada të përparuara. Edhe në rrethin e Tiranës, që përpara ka qenë mjaft i prapambetur në rendimentet e drithërave, tani ka shumë brigada të përparuara që kanë marrë nga 40, 50 deri në 60 kuintalë misër për hektar, nga 10-12 kuintalë për hektar që merrnin më parë. Para ca kohësh u bë një mbledhje me 140 brigadierë të këtyre brigadave të përparuara. Me farën e misrit hibrid kemi arritur të marrim këtu rreth 140-150 kuintalë për hektar në një sipërfaqe prej 50-60 hektarësh. Pra ndryshimet në krahasim me 10 vjet më parë janë të mëdha. Tani rrethi i Tiranës në çdo gjë ka bërë përparime të dukshme.

Natyrisht, këta janë disa shembuj që na nxitin të marrim eksperiencë, të përmirësojmë punën dhe të shtojmë forcat që në këtë drejtim të ecim gjithnjë përpara.

*Në fund të kësaj bisede, me rastin e largimit të ambasadorit kinez, shoku Enver Hoxha i uroi rrugë të mbarë.*

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## PA ORGANIZIM E DISIPLINË NUK MUND TË KEMI BUJQËSI MODERNE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 janar 1971

E pashë edhe unë projektin e Letrës<sup>2</sup> së Komitetit Qendror që flet për kthesën që duhet bërë në lidhje me përsosjen e organizimit dhe me forcimin e disiplinës së punës, e cila do t'u drejtohet punonjësve të bujqësisë. Në përgjithësi, unë jam dakord me përmbajtjen e saj. Megjithatë kam edhe disa vërejtje.

Në radhë të parë, shokët që e kanë përgatitur projektin e Letrës mendoj se duhet t'u ishin shmangur frazave të përgjithshme që nuk sqarojnë gjë. Kjo është theksuar kushedi sa herë, por fakt është se njerëzit tanë nuk mobilizohen sa duhet për të bërë më shumë kujdes në këtë drejtim. Për shembull, kur shpjegohen arsyet përse bujqësia jonë nuk ka

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua projekti i Letrës së KQ të PPSH mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe forcimin e disiplinës së punës në bujqësi.

2. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. VI, f. 9.

ecur me ritmet e dëshiruara, thuhet: «Përgjigjen për këtë çështje duhet ta kërkojmë në të metat e organizimit të punës», po nuk bëhet fjalë fare se cilat janë konkretisht të metat në organizim. Sigurisht, në këtë Letër nuk ka përse të numërohen dhe të shpjegohen të gjitha këto të meta një e nga një, po ato më kryesoret mund të përmenden.

Në projektletërën flitet, gjithashtu, edhe për disiplinën në punë që është akoma e dobët. Dihet se një nga hallkat kyç për zhdukjen e të metave e të dobësive në punë është forcimi i vazhdueshëm i disiplinës. Megjithatë, përveç tij, ka edhe gjëra të tjera. Duke bërë fjalë përse nuk e kemi edhe në bujqësi atë frymë discipline që kërkojmë, kjo çështje shpjegohet me konceptet e vjetra feudale e mikroborgjeze të fshatarëve për punën, të trashëguara nga e kaluara, kur punohej në tokën e beut, të agait, apo në parcela të vogla etj. Mirëpo kjo bie në kundërshtim me atë që shkruhet më poshtë, se «fshatari ynë gjithnjë e ka lagur tokën me djersë», gjë që do të thotë se ai edhe në të kaluarën ka punuar, prandaj një gjë e tillë duhet pasur parasysh që të ndreqet.

Në Letër vihen në dukje edhe pikëpamjet e disave që kërkojnë të mbjellin më pak sipërfaqe, duke menduar që prodhimin ta sigurojnë nëpërmjet rritjes së rendimenteve. Mua më duket se, ta shtrosh çështjen kështu, parimisht nuk është e drejtë, pa marrë masa për një organizim sa më të përsosur dhe pa vendosur një disiplinë të rreptë në punë, si kudo edhe në bujqësi, ndryshe nuk mund të kemi një bujqësi moderne. Është tjetër gjë se si po vihen në jetë aktualisht



detyrat që kemi përpara, por punën ne duhet ta organizojmë më mirë në kooperativat bujqësore, pse një gjë e tillë do të ndihmojë në ngritjen e rendimenteve të bimëve. Çdo punë me rendiment të lartë, si kudo, edhe në bujqësi, ka leverdi të madhe, si për kooperativat, ashtu edhe për shtetin tonë socialist. Por rritja e rendimentit varet në një shkallë të konsiderueshme nga mënyra se si janë organizuar punët në kooperativat bujqësore, nga planifikimi i drejtë e i koordinuar i të gjitha këtyre punëve dhe, në radhë të parë, nga përpjekjet që do të bëhen për zbatimin si duhet të vijës së Partisë e të kodit agroteknik.

Fshati ynë ecën në rrugën e socializmit dhe jo në atë të kapitalizmit, prandaj ai nuk ka si të mos i kushtojë kujdes zhvillimit të prodhimit në të gjithë treguesit e tij. Për ne çështja shtrohet kështu: «Në këto situata, a sigurojmë dot vallë rendimente të larta në të gjitha bimët që planifikojmë?». Ka drejtues që kërkojnë t'u lihet një sasi e caktuar toke, nga e cila mendojnë të marrin këtë apo atë rendiment në drithë, pambuk etj., por pa marrë më parë masat e nevojshme. Por ne nuk duhet të ecim në këtë rrugë. Jeta gjer tani na ka treguar se nuk mund të garantohet prodhimi pa një organizim të shëndoshë të punës, pa siguruar mjetet e duhura për punë dhe pa zbatuar si duhet agroteknikën. Një kërkesë si ajo që thashë, pa llogaritur faktorët që përmenda më sipër, do të mbetej vetëm dëshirë dhe asgjë më tepër. Ne synojmë të marrim rendimente të larta në çdo bimë, por, që t'ia arrijmë kësaj, duhet të shfrytëzojmë me efikasitet të gjitha mundësitë, pa nënvleftësuar e pa lënë pas

dore asnjë nga kushtet e domosdoshme që janë vendimtare për arritjen e këtij qëllimi.

Në Letër vihet në dukje se «drejtimi i punëve në kooperativë nuk duhet lënë në asnjë mënyrë në duart e pak njerëzve». Të thuash vetëm kaq, nuk do të thotë asgjë, prandaj shokët e bujqësisë mendoj se duhet ta kishin zhvilluar shkencërisht këtë çështje. Dokumenti që po përgatitim është një Letër me rëndësi që do t'i dërgohet bazës nga ana e Komitetit Qendror të Partisë, prandaj, si i tillë, ai duhet t'u japë kooperativistëve orientime të qarta e të plota për punët që duhet të kryejnë.

Disa shprehje me karakter propagandistik mendoj t'i lëmë siç janë, veç është e domosdoshme të theksohet që kooperativat bujqësorë në gjithë veprimtarinë e tyre duhet të karakterizohen si ndërmarrje të prodhimit bujqësor të zgjeruar, me të vërtetë moderne. Ky është një orientim i caktuar që duhet vënë mirë në dukje, pse mund të ketë mendime që kooperativa, meqenëse është pronë e grupit, nuk mund të realizojë shumë gjëra, ngaqë i kushtojnë shtrenjtë, pse për këtë qëllim ajo s'ka as kuadro të mjaftueshëm e të tjera justifikime si këto, pikërisht në një kohë kur ne duhet t'i shikojmë kooperativat si ndërmarrje moderne të prodhimit bujqësor. Në qoftë se ato nuk i bëjmë të tilla, nuk mund të ecim përpara me ritmin që synojmë e nuk mund të realizohet asgjë nga të gjitha këto që themi. Me një fjalë, dëshiroj të them se organizimi dhe niveli i punës drejtuese është e domosdoshme të ngrihen në një shkallë të atillë që t'i përgjigjen plotësisht orientimit të mësipërm.

Veçanërisht Ministria e Bujqësisë duhet të thellohet shumë në kuptimin e vërtetë të shprehjes «ndërmarrje bujqësore moderne e prodhimit të zgjeruar». Ç'duhet bërë që ne të kemi ndërmarrje të tilla? Për të realizuar këtë në jetë, është e nevojshme të vihen në lëvizje të gjithë njerëzit kompetentë të shkencës, të agroteknikës, të organizimit të prodhimit, të përpunimit të plehrave, të pedologjisë etj., etj., pra të gjithë ata që punojnë në këto fusha, me përjashtim të njerëzve të frazave. Mua më duket se tash ka ardhur koha që shokët ta vrasin më shumë mendjen për të dhënë orientime të atilla, zbatimi i të cilave do të na japë me të vërtetë ato që dëshirojmë.

Çfarë duhet bërë, sipas mendimit tim, për ta realizuar këtë? Ne shohim se në bujqësi nuk ka kudo një disiplinë të fortë në punë. Por disiplinë të fortë në punë e në prodhim nuk mund të ketë pa përcaktuar disa caqe se ku duhet të zbatohet kjo disiplinë, caqe këto, pa të cilat nuk mund të realizohet asgjë, jo vetëm në kooperativë, po as në fabrikë e kudo. Prandaj, pa humbur kohë, është me vend të rishikohet puna për forcimin e kryesive të kooperativave, të drejtorive të ndërmarrjeve bujqësore, të shtabeve të tyre. Në fakt, në çdo kooperativë ekziston një shtab që përbëhet nga kryetari, nënkryetari, agronomi, zooveterineri, llogaritari e të tjerë. Kjo është detyra e parë që duhet të vëmë në jetë kudo në bujqësi, në mënyrë që drejtimi i punëve të mos lihet vetëm në duart e disa njerëzve të veçuar. Për mbarëvajtjen e punës dhe për realizimin gjer në fund të të gjitha detyrave, kryesitë e kooperativave duhet të

marrin përsipër përgjegjësitë, kolektive dhe individuale. Drejtimi i punëve në ekonomitë e mëdha bujqësore të bëhet kolegjalisht e të mos mbetet në asnjë mënyrë në disa duar të kufizuara dhe ca më pak në duart e një njeriu të vetëm. Kryesia, pra, që të mund të arrijë rezultatet që kërkohen është e domosdoshme të veprojë si një shtab unik e të sigurojë drejtimin e plotë të të gjithë veprimtarisë së kooperativës bujqësore në planifikim, në zbatimin e detyrave, në kontrollin financiar etj. Vetëm mbi këtë kriter duhet ta forcojmë ne drejtimin e punës në kooperativat bujqësore, ndryshe nuk do të arrijmë që këto të kthehen në ndërmarrje moderne të prodhimit të zgjeruar bujqësor dhe të arrijmë rezultatet që dëshirojmë.

Forcimi i drejtimit të punës në bujqësi s'mund të bëhet kudo në mënyrë shabllone ose duke menduar për të çuar atje njerëz nga sektorët e tjerë. Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive të rretheve dhe Ministria e Bujqësisë e kanë për detyrë të interesohen që ekonomitë më të mëdha bujqësore të jenë kurdoherë rentabël dhe shembull për gjithë ekonomitë e tjera më të vogla të këtij sektori. Për këtë arsye del nevoja që t'u japin atyre kuadro të aftë drejtues dhe me eksperiencë të gjatë organizimi, por këta të nxirren, si rregull, nga vetë sektori i bujqësisë. Kështu, mbi bazën e drejtë të prodhimit duhet të kuptohet dhe të arrihet forcimi, për të cilin po bëjmë fjalë.

Është e kuptueshme se drejtuesit, në radhë të parë, kërkohet të jenë politikisht njerëz të mirë. Por, për të drejtuar një ekonomi të madhe bujqësore, nuk mjafton vetëm që kuadri të ketë qenë partizan i Lu-

ftës Nacionalçlirimtare, dua të them që të ketë garanci politike, por të jetë njëkohësisht edhe ekonomist i mirë. Pra drejtuesi i një ekonomie bujqësore duhet të jetë medoemos njeri politik, por të jetë i pajisur edhe me njohuri të thella ekonomike, të ketë eksperiencë dhe aftësi të mëdha organizative. Kjo të kuptohet mirë, ndryshe në zhvillimin e ekonomive bujqësore nuk mund të ecim përpara me ritmet që dëshirojmë. Në luftën për prodhimin, në radhë të parë është politika, pastaj, në radhë të dytë, vjen organizimi dhe ana profesionale. Kur të jenë siguruar këto kushte, atëherë i shërbehet më mirë prodhimit dhe krijohen mundësi për të kënaqur nevojat e popullit. Disa nga këto çështje që po përmend, janë vënë në dukje edhe në Letër, ku, sigurisht, nuk mund të shkruhen të tëra, por duhen pasur parasysh që diku të theksohen më shumë e diku më pak, të shprehura në mënyrë sa më koncize.

Ashtu siç fola për kryesitë e kooperativave, duhet vepruar edhe për të gjitha hallkat e tjera më të ulëta të drejtimit, siç janë ato të sektorit, të brigadës etj.

Për sa i përket zhvillimit perspektiv të kooperativave në përgjithësi, është e nevojshme të kuptohet qartë se ndryshime e diferenca midis fushës dhe malësisë do të ketë edhe për një kohë, pse tani jemi duke ndërtuar socializmin dhe nuk kemi vajtur akoma në komunizëm. Natyrisht, shteti mendon e do të kujdeset medoemos edhe për forcimin e zhvillimin ekonomik e kulturor të kooperativave malore, por aktualisht nuk mund të lëmë pa shfrytëzuar mundësitë e mëdha që ekzistojnë në fushë, të cilat do të na sigu-

rojnë të ardhura më të shumta dhe do të na japin dorë, kështu që me to të ndihmojmë edhe zonat malore më tepër se gjer tani. Sigurisht, të kemi gjithmonë parasysh që të mos e thellojmë diferencimin midis zonave në fjalë. Por hëpërhë ne nuk mund të lëmë pa u kujdesur për fushën për t'iu kushtuar, fjala vjen, majës së Çermenikës, ku sot kërkohet të bëhen investime të mëdha e me afat të gjatë kthimi. Për malësitë hapen më tepër perspektiva zhvillimi, kur fushat tona të rritin rendimentet e të japin nga 70-80 quintalë misër për hektar e nga 30-40 quintalë grurë. Tash ne edhe në malësi mbjellim misër, se kemi nevojë akoma për drithin e saj, por më vonë, kur këtë ta prodhojmë me bollëk në kooperativat e fushës, nuk ka përse ta mbjellim edhe në zonat malore, ku mund të rritim ato bimë nga të cilat do të kenë më shumë leverdi vetë kooperativat malore dhe gjithë republika.

Në përpjekjet për forcimin organizativ të kooperativave bujqësore, është e domosdoshme të mbajmë parasysh medoemos dhe kushtet atmosferike, pse ka raste që ato përdoren për të mbuluar të metat e dobësitë e njerëzve. Prandaj, puna duhet të organizohet në mënyrë të tillë që çdo gjë të parashikohet me kujdes, duke përfshirë edhe pengesat e dëmet që shkaktojnë në stina të caktuara në bujqësi forcat e verbra të natyrës, me qëllim që në kohën e duhur të merren të gjitha masat për përbalimin e tyre. Kur kjo është e pamundur, këto masa do të na ndihmojnë që pasojat të jenë sa më të pakta dhe kështu, pavarësisht nga pengesat e natyrës, të ecim gjithnjë përpara, drejt shtimit të prodhimit bujqësor e blegtoral. E

them këtë se, sipas mësimeve të marksizëm-leninizmit, është njeriu ai që me masat që merr, i ndryshon, i manipulon, i nënshtron dhe i kthen në dobi të vet forcave të natyrës. Duke ditur se në stina të caktuara na bien shira, ne nuk mund të rrimë pa bërë me kohë kanalet kulluese, apo kanalet ujitëse për periudhat kur ka thatësi. Kjo është alfa. Veç këto kanale del nevoja t'i bëjmë sipas kërkesave të agroteknikës, duke vënë në përdorim mekanizmat dhe krahët e nevojshëm të punës. Po të merren këto masa, pastaj le të bien sa të duan shira, ose le të bëjë thatësi.

Pra në një ndërmarrje moderne bujqësore, siç e thashë edhe më parë, çdo gjë duhet parashikuar mirë e të përgatitur me kohë çdo mjet të nevojshëm për të marrë menjëherë masa që t'i pritët rruga çdo veprimi të dëmshëm të forcave të natyrës. Pikërisht këtu është e domosdoshme dora e Partisë, udhëheqja e saj, mobilizimi i gjithë kolektivit.

Në një ndërmarrje moderne socialiste kërkohet që të mbizotërojë mbi të gjitha puna politike sqaruese, që çdo gjë të gjejë atje shpjegimin e vet teorik, marksist-leninist. Kjo lypset të jetë e qartë, se më duket nuk kuptohet mirë e sa duhet nga të gjithë. Puna politike, puna e Partisë, deri te shfaqjet teatrale, estradat etj. bëhet për njerëzit, për të ndikuar në përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës e për të ngritur nivelin e tyre kulturor. Ajo ndihmon njëkohësisht për të realizuar e për të tejkaluar prodhimin e planifikuar për të cilin interesohet çdo njeri, çdo familje e çdo kolektiv. Prodhimet bujqësore i pret klasa punëtore, i pret tërë republika, prandaj, duke marrë para-

sysh rëndësinë që kanë ato për jetën e popullit, është e domosdoshme që kjo punë të bëhet me një nivel sa më të lartë e në kohën e duhur dhe jo t'i lihet spontaneitetit.

Në Letër ka disa gjëra lidhur edhe me organizimin e punës. Organizimi, atje ku është i nevojshëm, duhet përcaktuar, rishikuar, korrigjuar dhe forcuar si në vija të përgjithshme, ashtu edhe në hollësi. Organizimin e punës, qoftë ky i përgjithshëm, qoftë në detaje, duhet ta pranojmë se nuk e kemi të përsosur, prandaj të mos kënaqemi me atë organizim që kemi sot. Në këtë fushë ne kemi shumë për të bërë dhe Partisë, në radhë të parë, i vihet detyrë ta rishikojë dhe ta zgjidhë sa më mirë këtë problem.

Në Letër flitet edhe për punën që bëjnë njerëzit. Sigurisht, faktori njeri këtu është kryesori, por duke përgatitur një dokument të rëndësishëm partie, që ka për qëllim forcimin e disiplinës në punë, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe shumë faktorë të tjerë. Pra, përveç punës së njerëzve, duhet pasur parasysh edhe puna e makinave dhe ajo e kafshëve. Që të tre këta faktorë ne nuk i kemi të harmonizuar në rregull dhe nuk i shfrytëzojmë ashtu siç duhet vepruar në një ndërmarrje bujqësore moderne. Neve nuk na lejohet të ecim më tutje pa marrë masa edhe në këtë drejtim, pse pa disiplinë të fortë në punë, pa norma, pa kontroll financiar, pa organizim, pra, pa të gjitha këto, nuk mund të ketë rezultate në prodhim. Të kuptohemi drejt, nuk është puna se ne po ecim fare pa disiplinë, pa norma, pa organizim e pa kontroll, por këto nuk janë akoma në atë nivel që dëshirojmë dhe



në këtë drejtim kemi akoma shumë e shumë gjëra për të ndrequr. Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, Ministria e Bujqësisë dhe vetë kooperativat bujqësore t'i shikojnë këto çështje me seriozitetin më të madh.

Dita e punës, për të cilën flitet në Letër, është forma e shpërblimit që i jepet anëtarit të kooperativës për punën që kryen, prandaj kjo duhet të lidhet dhe të përcaktohet nga rezultatet, nga normat etj., e, për këtë, mendoj që edhe në bujqësi duhet t'i rishikojmë ato.

Normat kolektive që janë vënë, diku tejkalohen, diku jo, në radhë të parë, sepse mungon një disiplinë e rreptë në punë. Ndodh që kooperativisti shkon dhe është i pranishëm në punë, por ka raste që atje ai nuk jep atë që pritet prej tij. Kjo vjen sepse ai nuk mobilizohet dhe nuk punon sa duhet, por edhe për arsye se kontrolli i realizimit të normave nuk bëhet në kohë. Kjo punë në bujqësi bëhet vetëm një herë në vit, kur vilet prodhimi, pra kur çdo gjë ka mbaruar. Prandaj, kur punohet me norma kolektive, është e domosdoshme të shikohet edhe mënyra se si paguhen ata që nuk janë të rregullt në punë. Kam përshtypjen se kur vjen fundi i vitit dhe ndahen të ardhurat, rrallëherë diskutohet për të shpërblyer më ulët atë që ka punuar keq dhe më pak, duke menduar pa të drejtë që, meqenëse ky ose ai anëtar i brigadës apo i skuadrës ka shumë kalamaj, të mos bëhet kjo ulje. Mirëpo në qoftë se dikush ka shumë frymë për t'i ushqyer, atij duhet t'i bëhet e qartë që të punojë më shumë, se askush nuk e pengon të punojë. Nuk

është aspak e drejtë që dembeli të shfrytëzojë punën e njerëzve të ndërgjegjshëm. Normat kolektive ne i vendosëm për anët pozitive që kanë, por në qoftë se dikush nuk punon ose punon pak, shkel disiplinën etj., është e domosdoshme që ai edhe shpërblimin ta ketë më të paktë nga ai që punon me ndërgjegje, pa hile, që është i disiplinuar etj. dhe duhet të shpërblehet më shumë. Në qoftë se nuk i zbatojmë rreptësisht në jetë këto forma të drejta organizimi pune, sado shumë që të flasim për disiplinën në punë, asgjë nuk do të na shkojë mirë, pse këto çështje janë të lidhura ngushtë me të gjitha ato që përmenda.

Ta kemi të qartë se një ndërmarrje pa plan, pa disiplinë plani, pa një buxhet të rreptë financiar, pa llogari dhe pa leverdishmëri në bimët që kultivon, nuk mund të quhet moderne. Kur t'i organizojmë si duhet dhe t'i futim në rrugën e drejtë kooperativat bujqësore, ato do të bëhen ndërmarrje të fuqishme hozrashoti dhe jam i bindur se do të kenë leverdishmëri e do t'i shërbejnë interesit të përgjithshëm e jo vetëm të grupit. Ne duhet t'i sqarojmë mirë kuadrot në këtë çështje dhe të vazhdojmë të influencojmë mbi ta. Duke vepruar pa një planifikim të rreptë, siç bëhet disa herë sot, ne rrezikohemi të mos plotësojmë siç duhet kërkesat për mish, drithë, luledielli etj. Këtëj del nevoja që për ta forcuar situatën, duhet të zbatojmë kudo planifikimin shkencor, llogarinë për çdo gjë, organizimin dhe kontrollin e zbatimit të detyrave në kooperativat bujqësore.

Unë tani nuk flas dot konkretisht, se nuk u jam futur në hollësi këtyre çështjeve, por nga të gjitha

raportet e informacionet që na vijnë, nxjerr konkluzionin se shpeshherë bëhen planifikime të pabalancuara, joteknike, jo të kombinuara si duhet me të gjitha të dhënat. Me këtë nuk dua të them se kooperativat tona sot nuk bëjnë fare plan, por mendoj që ky nuk hartohet pas një diskutimi të thelluar e të gjithanshëm. Ndodh shpesh që vetëm një nëpunës i seksionit të bujqësisë në komitetin ekzekutiv t'i thotë kooperativës të planifikojë kaç apo aq hektarë për një bimë të caktuar dhe puna mbaron me kaç për kooperativën. Kjo nuk është aspak e mjaftueshme. Në diskutimin për planifikimin e bimëve që do të mbillen duhet të marrin pjesë të gjithë specialistët e bujqësisë, të cilët, bashkë me kooperativistët, të kombinojnë forcat e shumanshme me të gjitha mjetet e mundësitë që kanë: farërat, makinat, kreditë që jep shteti, plehrat që nevojiten, tokat dhe bimët që kërkojnë më shumë ose më pak pleh etj., etj. Bile, para se të vijë puna e planifikimit, duhen parë e duhen njohur me kujdes e një për një të gjitha këto çështje e mundësi, në mënyrë që njerëzit t'i kenë problemet të qarta. Në qoftë se, për shembull, kooperativa nuk do të ketë nitrat në kohën e duhur, del nevoja të mendohet që më parë për ta zëvendësuar atë me diçka tjetër si, fjala vjen, duke e kompensuar këtë nevojë të tokës me një punim të thellë, apo duke i hedhur asaj një sasi urine kafshësh më shumë etj.

Të gjitha këto probleme, siç janë zbatimi me rreptësi i disiplinës në punë, i agroteknikës së përparuar etj. që gërksetohen me njëra-tjetrën, është e domosdoshme të studiohen kurdoherë pikërisht kështu

të koordinuara me leverdinë ekonomike, me mundësinë e tokës, me investimet e me krahun e punës, me mekanizimin, me kafshët, me plehun, me shkencën dhe me të gjithë faktorët e tjerë.

Disa nga këto që thashë, në vija të përgjithshme, mund të formulohen në Letër, në mënyrë koncize si direktiva të Komitetit Qendror. Në Letër të theksohet se fshatarësia jonë është patriote dhe revolucionare, por komunisti, kuadri, kooperativisti e çdo punonjës tjetër i bujqësisë, duhet t'i ketë të qarta detyrat që ka për të kryer për të mirën e tij, për të mirën e Partisë dhe të popullit.

Shumë gjëra që janë thënë në Letër, shtrohen drejt, por disa prej tyre duhet t'i theksojmë edhe një herë si detyra, qoftë për Ministrinë e Bujqësisë, ashtu edhe për rrethet e bazën, të cilat duhet të mbajnë përgjegjësi për realizimin e tyre. Por për to kemi përgjegjësi edhe ne të tjerët dhe për këtë na bie detyra të marrim që të gjithë masat e nevojshme.

Mua më duket se po na zvarriten shumë studimet që bëhen. Nuk është aspak me vend që ne të ecim në këtë rrugë, pse studimet e mira që kryhen në kohën e përshtatshme, ndikojnë shumë për shtimin sa më të shpejtë të prodhimit.

Njerëzit tanë janë të mirë, po gjatë punës ata hasin edhe në vështirësi të çfarëdolloji. Ka detyra që nuk zbatohen, ngaqë këto vështirësi dhe sa e sa pengesa të tjera, lihen zvarrë nga ana e atyre që duhet t'i zgjidhin. Prandaj, shokëve që shkojnë në bazë u bie barra të mendohen më thellë për kapër-

cimin me kohë të vështirësive dhe pengesave të ndryshme që mund t'u dalin përpara njerëzve tanë gjatë realizimit të detyrave. Këtu, një rol vendimtar, si në kapërcimin e vështirësive, ashtu edhe për kryerjen e mirë dhe të shpejtë të të gjitha detyrave, luan pikërisht ajo që thashë, organizimi i punës. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe që ne duhet ta kemi vazhdimisht parasysh dhe të mos e harrojmë asnjëherë.

Unë këto vërejtje kisha për Letrën, së cilës mendoj se mund t'i bëhet akoma ndonjë rregullim.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## NË MBLEDHJET TONA TË SHQYRTOJMË PROBLEME KYÇ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

7 janar 1971

Në përgjithësi, jam dakord me projektplanin e çështjeve që do të merren në shqyrtim gjatë vitit 1971 në mbledhjet e Plenumit, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror, si edhe me vërejtjet që bëtë ju. Por kam edhe vetë disa vërejtje.

Në radhë të parë, dua të them se në projektplan duhet të ishte vënë për t'u diskutuar edhe studimi për vendosjen e sigurimeve shoqërore në kooperativat bujqësore, gjersa materiali për këtë problem na është paraqitur qysh në nëntor dhe për përgatitjen e tij shokët kanë punuar kaq kohë.

Për sa i përket raportit «Mbi disa probleme të

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtuan projektplani i çështjeve që do t'u paraqiteshin organeve drejtuese të Partisë gjatë vitit 1971 si dhe projektvendimi për festimin e 30-vjetorit të Themelimit të PPSH dhe për thirrjen e Kongresit të 6-të të saj.

propagandës së prodhimit», që do ta përgatitë aparati i Komitetit Qendror, të kihet kujdes që të mos na paraqiten gjëra të përgjithshme.

Është mirë ta dimë që më parë arsye përse do ta marrim në shqyrtim këtë çështje. A është ky një problem i tillë që duhet të shqyrtohet medoemos këtu? Unë mendoj që ne të mos vëmë në plan problem për problem.

Propaganda e prodhimit është diçka me rëndësi të madhe, po nuk di si do të trajtohet në raport dhe çfarë gjërash do të nxjerrim prej tij, pse, siç është vënë në projektplan, lihet përshtypja e një diçkaje të përgjithshme.

Duhet të bëjmë shumë kujdes që t'i evitojmë materialet e përgjithshme, se ato nuk na japin shumë fryt, bile nganjëherë, na bëjnë të hallakatem dhe të mos përqendrohemi në problemet kyç. Në qoftë se i argumentojmë mirë dhe konkretisht problemet e propagandës së prodhimit, që janë të vazhdueshme, raporti duhet të vihet në projektplan dhe të merret në shqyrtim sa më parë, mbasi ndihet nevoja për të marrë masa që propagandën ta lidhim sa më ngushtë me prodhimin. Por, në qoftë se në raport do të na numërohen sa pllakate janë vënë e sa afishe; se janë bërë kaq mijëra propozime etj., kësaj nuk i thonë propagandë. Të kufizohesh vetëm me këto më duket se nuk është e drejtë.

Rëndësi të madhe për shtimin e prodhimit, për përmirësimin e cilësisë etj., kanë pa dyshim propozimet e shumta e të vlefshme nga masat e punëtorëve, teknikëve, inxhinierëve dhe gjithë punonjësve të ba-

zës. Njerëzit kanë mendimet e tyre për shtimin e prodhimit. Ata shpesh bëjnë edhe gjithfarë propozimesh të dobishme, siç ka ndodhur në NSHRAK-un e Tiranës, në uzinën «Enver» etj. Megjithatë, marrim vesh, siç e shohim edhe në organet e shtypit, se në këtë drejtim ka mjaft ekzagjerime. Shpesh thuhet se në këtë ose në atë rreth janë bërë me mijëra propozime! Cilido mund të mendojë: «Ç'janë tërë këto propozime? Si zbatohen dhe sa ndihen ato në fushën e prodhimit?». Kam përshtypjen se në këtë drejtim nuk mungojnë edhe prirjet për «gara», me vend e pa vend, që, natyrisht, nuk i shërbejnë punës, ngaqë edhe çfarëdolloj mendimi që japin punonjësit, merret si propozim, por, siç thashë, të gjitha mendimet që jepen, nuk mund të jenë të tilla.

Për propagandën e prodhimit më fliste një ditë edhe një shok i Qeverisë. Kur ai vizitoi një park automobilistik që është pararojë dhe një nga më të mirët e vendit, vuri re se atje kishin marrë zotime për rritjen e shumë treguesve, për të shtuar mekanizimin e ngarkim-shkarkimit, që ishte problem kryesor për ta etj., por asgjë nga këto nuk pasqyrohej në agjitationin figurativ. Përkundrazi, parku ishte mbushur gjithandej me «dule» dhe me parulla të tjera me qëllim zbukurimi. Kur ai i pyeti se ku duhet të drejtohet kryesisht propaganda me këto mjete figurative, ata dhanë një përgjigje të papërcaktuar. «Kjo që keni bërë ju, — u tha ai atyre, — vlen për të zbukuruar territorin dhe aspak për të përpunuar mendjet e njerëzve, prandaj nuk mund të themi aspak se është propagandë».



Jua tregova këtë bisedë për të vënë në dukje se edhe propaganda anësore ka rëndësi dhe si e tillë ajo duhet bërë me kujdes dhe pa ekzagjerime. Megjithatë, në qoftë se duhet ta vëmë në projektplan raportin «Mbi disa probleme të propagandës së prodhimit», unë nuk kam ndonjë kundërshtim.

Në projekt është parashikuar që Byroja Politike të shqyrtojë materialin e Komisionit të Arsimit pranë Komitetit Qendror «Mbi disa probleme aktuale dhe të perspektivës, që kanë të bëjnë me zgjerimin e arsimit të mesëm». A duhet ta diskutojmë ne në Byro këtë çështje, gjersa orientimet e dhëna janë të qarta? Po të jenë siguruar të dhëna të sakta dhe studimi të jetë bërë me shifra, atëherë ne mund të shqyrtojmë në Byronë Politike mundësitë e zgjidhjes së problemeve që i dalin arsimit brenda 10 apo 12 vjetëve. Në qoftë se ka ndonjë gjë të re për të vendosur, atëherë po, ndryshe s'ka përse ta shikojmë edhe një herë.

Studimi për gjendjen aktuale të klasës punëtore duhet të na japë një pasqyrë sa më të qartë të gjendjes së kësaj klase dhe të rolit që ka luajtur ajo në ndërtimin socialist të vendit.

Ky që pamë gjer tani ishte plani për Byronë Politike.

Tani të shohim planin e Sekretariatit të Komitetit Qendror.

Në përgjithësi, në planin e Sekretariatit ka mjaft probleme. Ne mund të vëmë në plan edhe të tjera, për të kontrolluar zbatimin e vendimeve, kurse në planin e Byrosë Politike ka fare pak, janë vetëm dy: njëri për punën e bërë për zbatimin e vendimeve dhe

tjetri për zbatimin e detyrave të planit, që është në fund. Të tjerat mendoj se duhen parë më imtësisht dhe krahas me planin e Qeverisë.

Domethënë, Byroja Politike merr dhe duhet të marrë jo shumë, por 2 ose 3 probleme që merr Qeveria, për të kontrolluar zbatimin e vendimeve. Ajo duhet të shohë, fjala vjen, si ka punuar industria në gjashtëmuorin e parë. Të tilla probleme kyç mendoj të vijnë në Byronë Politike, bile edhe më parë se të venë në Qeveri. Në qoftë se janë probleme të rëndësishme, pra që kanë të bëjnë me dhënie llogarie, se si po realizohen detyrat etj., ne mund t'i marrim në shqyrtim në Byronë Politike, sepse këtu janë të gjithë së bashku, edhe shokët e Byrosë Politike, edhe të Qeverisë. Meqenëse jemi dakord, mund edhe t'i bashkojmë të tilla probleme, por mund të mendojmë për të paraqitur edhe ndonjë çështje tjetër.

Unë mendoj se mund të analizohet puna njëkohësisht edhe nga ana shtetërore për disa momente kryesore që kanë të bëjnë me realizimin e planit, kur nga ana e Partisë shihet e nevojshme se duhet kërkuar llogari. Atëherë duhet të diskutojmë bashkërisht si është ky problem, për të caktuar masat e mëtejshme që duhen marrë. Çështja e tregtisë, për shembull, duhet të merret në shqyrtim deri edhe në detaje.

Problemet që parashikohen të merren në shqyrtim në Plenum janë të mira.

Këto vërejtje kisha unë, për të gjitha të tjerat jam dakord.

Për sa i përket projektvendimit për 30-vjetorin e Themelimit të PPSH dhe për Kongresin e 6-të të saj,

mendoj se ka shumë detaje, shumë hollësi. Aty në mund të vëmë në dukje që ky është një vit jubilar dhe kjo është e kuptueshme. Në këtë jubile Partia, gjithë komunistët, duhet të mobilizohen për realizimin e planit dhe të të gjitha detyrave që kanë përpara. Këto çështje në vendim mund të përmblihen në një paragraf. Epiqendra e udhëzimit tonë duhet të jetë që Partia dhe populli të vënë të gjitha forcat në këto drejtime. Njëkohësisht të punojë edhe propaganda. Por njerëzit t'i lëmë të punojnë, të mos u jepen të gjitha gjërat si në pjatë. Secili të përpiqet t'i zërbërthejë vetë direktivat, se Partia ka 30 vjet që është krijuar dhe komunistët duhet të kenë iniciativë, të mendojnë dhe t'i zgjidhin vetë problemet, jo çdo gjë me të shtyrë.

Puna ideologjike dhe politike e Partisë është çështje që duhet të kihet parasysh, në radhë të parë, pse kjo do të ndihmojë në mobilizimin e masave të popullit për realizimin dhe për tejkalimin e detyrave të planit. Aty duhet të flitet për propagandimin e rolit historik të Partisë, për thellimin e mëtejshëm të luftës ideologjike, për të vënë në dukje tiparet e njeriut tonë të ri, për rolin që luan aksioni si metodë për edukimin ideologjik të punonjësve. Të flitet, gjithashtu, edhe për zgjedhjet në Parti, të cilat duhet të bëhen luftarake. Të gjitha këto nuk është nevoja të vihen me detaje e me hollësi në vendim. Duhet të vihen, gjithashtu, diskutimi i direktivave të pesëvjeçarit, çështjet e agjitpropit e të emulacionit socialist, si dhe realizimet në lëmin e kulturës. Po kështu duhet të flitet edhe për punën e përgatitjes së Kongresit nga

ana organizative. Disa gjëra të tilla në vendim është mirë të përcaktohen qartë dhe prej këtej gjithë aparati dhe baza poshtë të nxjerrin vetë detyra se si dhe sa do t'u futen këtyre çështjeve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# ORGANIZIMI MODERN I BUJQËSISË — BURIM KRYESOR PËR SHTIMIN E TË ARDHURAVE TË KOOPERATIVISTËVE

*Nga biseda<sup>1</sup> me shokun Manush Myftiu*

14 janar 1971

Mënyra se si do të punojmë për zbatimin e orientimeve të Letrës së Komitetit Qendror të Partisë dhe si do t'i shoqërojmë ato me masa ka rëndësi të madhe. Puna që keni bërë ju shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës është e gjerë. Unë sot bisedova pak me shokun Haki për këtë çështje dhe mendoj se rezultatet e kësaj pune varen shumë nga fakti se si do t'i zbërthejnë shokët e bazës orientimet e dhëna,

---

1. Shoku Enver Hoxha kërkoi të takohej me shokun Manush Myftiu, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës, për t'u informuar për masat që ishin marrë lidhur me punimin e Letrës së Komitetit Qendror të Partisë mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe në forcimin e disiplinës së punës në bujqësi.

Në këtë takim morën pjesë edhe shokët Hysni Kapo e Haki Toska, në atë kohë sekretarë të Komitetit Qendror të PPSH.

sa do të thellohen ata në problemet që shtrohen për t'u zgjidhur.

Me sa dëgjova këtu shokun Manush, mendoj se masat që kanë parashikuar të marrin shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës për të vënë në jetë detyrat që ngrihen në Letrën e Komitetit Qendror, janë të mira, prandaj ato duhen zbatuar të gjitha. Por më duket se shumë nga detyrat, si në shtruarjen, ashtu edhe në zbatimin e tyre, duhen renditur me kujdes. Kjo është një çështje e tërë dhe komplekse, për të cilën është e nevojshme të punohet shumë dhe të merren masa organizative edhe nga komitetet ekzekutive e nga seksionet e bujqësisë pranë tyre në rrethe. Por, më parë se kushdo tjetër, për të gjitha këto probleme, të cilat duhet të jenë të shkallëzuara mirë, është e nevojshme të punojë më shumë baza, kooperativat bujqësore. E theksoj këtë se problemet duhen bërë të qarta, që të mos krijohet përshtypja sikur këto janë detyra aq të shumta e të rënda, saqë njerëzit të mendojnë se si do t'ia dalin gjithë kësaj pune.

Për zgjidhjen e problemeve të bujqësisë dhe të kooperativave, që shtrohen në këtë Letër, ose edhe në ndonjë tjetër që mund të bëjmë më vonë, duhet të synojmë që të arrijmë me të vërtetë një përmirësim cilësor real dhe jopropagandistik. Ky përmirësim nga ana cilësore do të arrihet duke marrë masa të shumanshme që duhet të shoqërohen me një sërë shpjegimesh nga ana politike, ideologjike, teknike, ekonomike, organizative etj. Në qoftë se do të kufizohemi vetëm me një shpjegim politik dhe propagandistik të problemit, nuk do të kemi rezultatet e duhura në bujqësi.

Ka ardhur koha, mendoj unë, që pasi të hartojmë planin e bujqësisë dhe të caktojmë renditjen e llojeve të bimëve, të bëjmë përpjekje që të arrijmë rendimentet dhe çdo objektiv tjetër që i vëmë detyrë vetes, ndryshe duhet të shtrojmë pyetjen: Përse nuk i realizuam? Kjo duhet të na shqetësojë shumë, se shpeshherë shkaqet e mosrealizimit të planit nuk nxirren mirë. Kur detyrat e caktuara për zhvillimin e bujqësisë nuk realizohen, s'është aspak e rregullt që mosrealizimin ta justifikojmë me disa arsye, që në fakt ekzistojnë. Prandaj këto detyra t'i analizojmë në tërësinë dhe në veçantinë e tyre, t'i ballafaqojmë me metodën e planifikimit që kemi përdorur, me masat që kemi marrë për t'i realizuar ato dhe me moszbatimin e tyre për shkaqe subjektive, për mungesa organizative. Në qoftë se nuk e bëjmë këtë analizë për të parë përse nuk u realizua plani, ashtu sikurse nuk bëjmë mirë edhe shtruarjen e detyrave kur hartojmë planin, atëherë do të na lindin kontradikta, të cilat vështirësojnë zgjidhjen e tyre.

Kam arritur në konkluzionin se ne duhet të punojmë seriozisht për të forcuar shumë drejtimin dhe organizimin në kooperativat bujqësore. Prandaj mendoj se detyra jonë kryesore është që, gjatë kohës për punimin e Letrës, të bëjmë përpjekje për të konkretizuar si duhet, në radhë të parë, frymën dhe direktivat e saj në çdo kooperativë.

Brenda secilës kooperativë, mendoj unë, realizimi i detyrave varet nga planifikimi i drejtë, në baza reale dhe shkencore, i zhvillimit progresiv dhe të harmonizuar mirë të bimëve që ka mundësi dhe që duhet të

rriten në territorin e saj. Në qoftë se nuk përpiqemi ta bëjmë këtë, do të kemi medoemos vështirësi. Kjo kërkon që në çdo kooperativë bujqësore të planifikojmë zhvillimin e saj në një drejtim të caktuar. Po në ç'bazë? Natyrisht, në bazë të të dhënave që kemi deri tani, nga të cilat një udhëheqje me mend në kokë do të përpiqet të nxjerrë konkluzione jo sipas dëshirës, por sipas realitetit që ekziston në kooperativën në fjalë. Kur në tokat e kësaj kooperative, edhe pa e bërë akoma studimin pedologjik të tyre, shohim nga eksperiencia se disa bimë që i kemi provuar na japin rendimente të mira, i mbjellim, kurse bimët e tjera, që aty nuk japin, askush nuk duhet t'ia imponojë për t'i mbjellë.

Planifikimi për mbjelljen e një lloj bime kooperativës duhet të shihet lidhur me leverdinë që ajo paraqit për ekonominë popullore, në tërësi, dhe për vetë kooperativën. Në qoftë se të dy këta interesa harmonizohen, atëherë mund të vendoset për ta mbjellë këtë ose atë lloj bime që dëshirojmë. Në qoftë se rrethi i rekomandon kooperativës të mbjellë në tokën e saj një bimë të caktuar, kur është provuar se toka e saj atë nuk e prodhon me leverdi, ai në asnjë mënyrë nuk duhet ta detyrojë, pse një gjë e tillë nuk është e drejtë, përkundrazi, është e gabuar. Mendoj që këtej e tutje t'i përcaktojmë drejt këto çështje, se, më duket, nuk i kemi parë mirë gjer tani.

Në rast se duam të kemi një bujqësi socialiste moderne, dhe për këtë po bëjmë të gjitha përpjekjet, shteti ynë duhet të llogaritet medoemos leverdinë ekonomike të saj, nga e cila varet niveli i jetesës i fsha-



tarësisë dhe i gjithë popullit tonë. Për t'ia arritur këtij qëllimi, nuk na lejohet të ecim me pikëpamje dhe me metoda të vjetra, po të vendosim e të zbatojmë me këmbëngulje metoda të reja moderne pune.

Në qoftë se vëmë detyrën që të shkojmë drejt ngushtimit të diferencës në nivelin e jetesës që ekziston në mes fshatit dhe qytetit, kjo nuk duhet trajtuar nga pozita mikroborgjeze, duke na treguar, për shembull, se gratë e fshatit duhet të vishen njëlloj si ato të qytetit. Thelbi i ndryshimit midis qytetit dhe fshatit nuk qëndron në mënyrën e veshjes e të mbathjes. Është e rëndësishme t'i bëjmë të ndërgegjegjshëm kooperativistët që të punojnë si klasa punëtore, të mësojnë nga stili i saj në punë, nga disiplina, rregulli e organizimi. Vetëm mbi bazën e një pune të tillë do të mund të plotësohen detyrat në bujqësi, do të shtohet prodhimi e, për rrjedhim, do të rriten të ardhurat e kooperativistëve. Prandaj, që të ketë edhe fshatari të ardhura sa punëtori, është e domosdoshme ta organizojë më mirë punën dhe të punojë ashtu si dhe ai. Pra, një nga faktorët e ngushtimit të dallimit në nivelin e jetesës fshat-qytet, që të mos ekzistojnë diferenca të mëdha midis të ardhurave të punëtorëve në ndërmarrjet shtetërore dhe të fshatarësisë në kooperativat bujqësore, është organizimi modern i bujqësisë. Pikërisht në forcimin e këtij organizimi duhet parë tani një nga burimet kryesore për shtimin e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe për ngritjen e nivelit ekonomik të fshatarësisë, për ndërtimin e shtëpive dhe për zbukurimin e pajisjen e tyre, për plotësimin gjithnjë e më mirë të nevojave të saj me ushqim e veshmbathje, për

pasurimin shpirtëror, domethënë, për ngritjen politike, ideologjike, kulturore e arsimore të kooperativistëve etj. Duke vepruar në këtë mënyrë, e mësojmë fshatarin të jetë revolucionar, i disiplinuar, i ndershëm, të punojë me llogari, të mos jetë hileqar në punë etj., ndihmojmë kështu për të ngushtuar më tej dallimin midis fshatit dhe qytetit.

Letra e Komitetit Qendror na vë detyrën e madhe që ta organizojmë si duhet dhe ta forcojmë planifikimin në bujqësi, që këtë çështje të mos e marrim të shkëputur nga të gjitha detyrat e tjera që vihen sot përpara bujqësisë sonë. Ky është një kompleks i tërë. Me planifikimin në bujqësi nuk duhet të kuptojmë vetëm caktimin e numrit të hektarëve që do të mbillen me këtë ose me atë lloj bime etj., po ai duhet të përfshijë medoemos agroteknikën, ujitjen, plehërimin dhe të gjitha shërbimet e tjera të domosdoshme që i duhen bërë bimës. Planifikimi në bujqësi është, pra, një përmbledhje e të gjitha detyrave që i caktohen këtij sektori dhe e masave që duhen marrë për realizimin e tyre; ai është një punë shkencore, që patjetër duhet ta kuptojnë drejt të gjithë si në teori, ashtu edhe në praktikë.

Tani, në praktikë, për këtë çështje ka kuptime të ndryshme. Ndodh shpesh që kryetari i kooperativës e ngarkon zooveterinerin apo agronomin për të siguruar plehra për bimët apo ushqim për kafshët ose për të organizuar transportimin e tyre, me një fjalë, e përdor atë si njëfarë furnitori. Kjo nuk është aspak e drejtë, as racionale. Një veprim i tillë është një përdorim i keq i kuadrove. Nga ana tjetër, ndodh që

kryetari e ngarkon agronomin me punë shkencore, duke i caktuar, ta zëmë, pesë hektarë tokë për t'i trajtuar në mënyrë moderne. As kjo nuk është e mjaftueshme. Puna shkencore duhet të planifikohet dhe të shtrihet në hapësira sa më të mëdha, në të gjitha sipërfaqet e tokave të punueshme. Ne duhet të luftojmë që puna shkencore të zhvillohet medoemos në gjerësi. Një njeri i shkencës nuk vlen në rast se nuk arrin të marrë, ta zëmë, në të gjitha parcelat e misrit të kooperativës së tij rendimentet e caktuara. Puna e një njeriu të tillë, pavarësisht se në parcelën prej pesë hektarësh që i është caktuar mund të ketë bërë një eksperiment shkencor, nuk vlen, po të jetë se në fushat e gjera, që i janë ngarkuar të mbulojë dhe ku luhen fati i prodhimit e mirëqenia e anëtarëve të kooperativës së tij e të popullit, nuk realizohen rendimentet e parashikuara. Ky njeri në këtë rast nuk jep veçse një kontribut fare të vogël.

Këtë e them sepse ne akoma nuk e kemi siguruar numrin e nevojshëm të kuadrove me arsim të lartë dhe nuk po kuptohet mirë domosdoshmëria e zbatimit të punës shkencore në sipërfaqe të gjera. Ka drejtues të ekonomive bujqësore e specialistë, bile edhe drejtues të rrethit që mbyllen në guaskën e parcelave eksperimentale. Ndërsa organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe e në bazë lejojnë që kuadrot të përdoren nga kryesia dhe nga kryetari i kooperativës për punë dhe për gjëra që nuk u takojnë. Zootekniku apo agronomi, kuadri me arsim të lartë apo të mesëm teknik, në asnjë mënyrë nuk duhet të caktohet të shoqërojë karrot apo të merret me ndonjë punë tjetër,

që fare mirë mund ta bëjnë punonjës të thjeshtë, jo të kualifikuar. Këta specialistë duhet të merren pikërisht me punë shkencore, drejtuese e organizuese që nuk i bëjnë dot të tjerët dhe ku ata duhet të tregojnë zotësitë, të zbatojnë dijet e tyre.

Është shqetësues fakti që planifikimi në bujqësi nuk bëhet me atë rigorozitet si në ndërmarrjet ekonomike shtetërore. Këtë ne duhet ta arrijmë me doemos edhe në bujqësi, pse këtu ka shumë më tepër të papritura dhe rreziqe natyrore e në drejtime të tjera. Në bujqësi kemi të bëjmë me biologjinë e bimëve dhe të kafshëve, kemi të bëjmë edhe me natyrën e njerëzve, me individë të caktuar, nga të cilët njëri punon, tjetri nuk punon ose punon mesatarisht; dikush punon më shumë, dikush më pak; dikush është i disiplinuar, një tjetër është i padisiplinuar etj. Gjëra të tilla ekzistojnë, ku më shumë e ku më pak, edhe në ndërmarrjet shtetërore, gjersa dalin edhe atje prodhime skarco. Por, fundja, një produkt i dobët industrial, ndonëse as ky nuk duhet të lejohet, mund edhe të përdoret përkohësisht ose të rikthehet në procesin e prodhimit për t'u ndrequr, kurse në bujqësi, po të priset misri ose të ngordhë kafsha nga moszbatimi me rreptësi i detyrave të planifikuara, çështja ka marrë fund, mbetesh pa bukë, pa mish etj. Prandaj planifikimi në këtë sektor duhet të jetë shumë rigoroz në të gjitha drejtimet, edhe për sa u përket qarkullimit, leverdishmërisë, zhvillimit të shumanshëm të bimëve, të pemëtarisë, të blegtorisë etj., sepse çështja e zhvillimit të këtyre nuk shikohet kudo me kujdesin e duhur.

Natyrisht, këto çështje nuk ndërrohen me një ditë,

por tani ka ardhur koha që në kooperativa të ecim drejt specializimit. Në një kooperativë që i ka tokat e dobëta nuk duhet të mbjellim një lloj bime që nuk jep rendimente të larta, po të mbjellim nga ato që janë të përshtatshme dhe që i rrit mirë toka e saj. Kurse tani planifikimin e bëjmë duke u nisur edhe nga parimi që, për të marrë edhe ca të ardhura më shumë në lekë, kooperativave, atje ku mundim, u planifikojmë edhe një pjesë sipërfaqeje, ta zëmë, për duhan, pa marrë parasysh nëse kjo bimë është e përshtatshme ose jo për tokat e saj, në vend që të mbillen në to bimë të tjera më me leverdi. Një kooperativë mund të mos ketë kushte për të mbajtur lopë për qumësht, por ajo mund të rritë fare mirë viça për mish, që t'i ushqejë brenda një periudhe të shkurtër dhe, kur të arrijnë majmërinë e duhur, t'i therë. Në tokat e saj, ku nuk mund të mbillen drithëra, mund të mbillen foragjere për të ushqyer kafshë për mish.

Ne nuk e kemi vënë akoma si duhet ujin në zjarr për zgjidhjen e plotë të disa problemeve të mëdha të bujqësisë. E dimë, për shembull, se numrin më të madh të lopëve si republikë e kanë oborret kooperativiste<sup>1</sup>. Megjithatë a e kemi shtruar ne vallë në Sekretariat ose në Byronë Politike këtë problem kaq të madh, për t'i dhënë zgjidhje? Jo, nuk e kemi shtruar. Kemi thënë që kooperativat duhet të kujdesen edhe për ushqimin e lopëve të anëtarëve, por nuk kemi menduar çfarë do të hanë ato. Është e pamundur të

---

1. Në vitin 1983 numri i lopëve të sektorit kooperativist, në krahasim me vitin 1970, u rrit 2,38 herë.

sigurohet ushqimi i një lope me 500 apo me 1 000 metra katrorë tokë të oborrit që ka rrotull shtëpisë anëtari i kooperativës. Edhe sikur tërë këtë tokë ai ta mbjellë posaçërisht për këtë qëllim, mendoj se nuk do ta sigurojë dot gjithë ushqimin për të cilin ka nevojë lopa gjatë vitit.

Ne do të gabonim po të mendonim se fshatari është i kënaqur se ka një lopë dhe për ushqimin e saj të mos bëhet asgjë. Përkundrazi në këtë rast, ndonjë i pandërgjegjshëm nxitet të dëmtojë pronën kolektive, duke u përpjekur ta futë lopën fshehurazi për të kullotur në arat e kooperativës. Pastaj ana më negative e kësaj është se kooperativisti me veprime të tilla edukohet keq. Meqenëse tani lopët e oborreve kooperativiste përbëjnë pjesën më të madhe të lopëve në republikë, problemi shtrohet që të gjejmë forma organizimi të tilla që t'u sigurohet atyre ushqim plotësisht i mjaftueshëm. Prandaj duhet të mendojmë seriozisht dhe të marrim masa që këto lopë të dobëta nga mungesa e ushqimit, që kanë sot fshatarët në oborret e tyre kooperativiste, t'i kthejmë në kafshë me të vërtetë prodhuese qumështi ose mishi. Ne nuk kemi menduar gjer tani për këtë problem të madh, pse e kemi pasur syrin më shumë te lopët e kooperativave, por këto përbëjnë akoma pakicën, megjithëse edhe për to nuk kemi menduar thellë dhe nuk kemi punuar sa duhet.

Është e domosdoshme që ta përmirësojmë dhe ta shëndoshim gjendjen në të gjitha drejtimet që përmenda. Unë mbase nuk i di në hollësi të tëra problemet e bujqësisë, por mendoj se gjatë përpjekjeve për

zbatimin e të gjitha këtyre detyrave që thashë, do të sqarohen më mirë edhe funksionet e reja të organizimit e të drejtimit të punëve në kooperativat bujqësore. Duke parë e duke vlerësuar drejt e me objektivitete se sa e madhe është kooperativa, sa sipërfaqe toke ka, çfarë bimësh mbjell, sa kafshë mund të mbajë etj., do të dalin edhe nevojat se sa zëvendëskryetarë duhet të ketë dhe të ç'profili lypset të jenë ata, sa ekonomistë, sa agronomë, sa zooteknikë, teknikë të mesëm e të tjerë. Natyrisht, kooperativa nuk mund t'i sigurojë dot menjëherë të gjithë këta kadro, por, duke studiuar konkretisht gjendjen e secilës kooperativë, duhet t'i llogaritim e t'i parashikojmë këto nevoja në organikë dhe të vëmë detyrën që t'i plotësojmë gradualisht, duke i përgatitur në mënyrë sistematike në Universitet dhe në Institutin e Lartë Bujqësor, kurse kuadrot dhe teknikët e mesëm t'i përgatitim me anë kursesh e shkollash çdo vit, me plan, duke e përballuar edhe këtë problem frontalisht, deri në zgjidhjen e tij të plotë, hap pas hapi dhe sipas nevojave.

Një problem më vete është edhe rentabiliteti në bujqësi. Edhe këtë ne duhet ta shohim mirë si shtet, duke u nisur nga interesi i përgjithshëm, po edhe nga interesi i veçantë i kooperativave. Rezultatet e punës t'i matim jo vetëm me sasinë e prodhimit që marrim, por edhe me lekët që harxhon kooperativa për të. Mund të ndodhë, për shembull, që për një bimë të caktuar kooperativa harxhon më tepër kohë dhe bën punë shumë më të rëndë se për bimët e tjera. Në këto kushte, edhe po qe se kooperativa mund ta realizojë prodhimin për këtë bimë sipas planifikimit, kur lloga-

ria nxjerr se për të ajo ka harxhuar shumë dhe shteti ia blen lirë, do të thotë se kjo bimë nuk ka leverdi të mbillet në këtë kooperativë. Në këtë rast nuk ka si të mos e mbajmë parasysh këtë çështje dhe, nga ana tjetër, do të duhej ta rishikonim çmimin e blerjes së prodhimit të kësaj bime nga shteti. Me këtë dua të them që të mendojmë dhe të mësohemi të harmonizojmë drejt, me përfitimin sa më të madh për të dyja palët, leverdinë ekonomike të shtetit me atë të kooperativës. Dhe kjo është e natyrshme, pse kooperativistët duhet ta shohin qartë dhe ta ndiejnë fort leverdinë e çdo lloj bime që u kërkohet të kultivojnë, sepse me të ardhurat që do të marrin prej saj, ata do të përballojnë nevojat e jetesës dhe të zhvillimit të kooperativës së tyre.

Kooperativistit ne duhet t'i llogaritim çdo gjë. Por kur i bëjmë llogaritë, ta shohim çdo gjë edhe te kooperativa bujqësore me po atë sy që shikojmë leverdishmërinë e ndër-marrjeve shtetërore. Prandaj ta porositim çdo kooperativë që të llogaritë leverdishmërinë e çdo bime që rrit, me qëllim që mbi këtë bazë ajo të mobilizojë forcat për realizimin e detyrave. Për shembull, ne i rekomandojmë një kooperative të ndërtojë një stallë për strehimin e lopëve, po sa kushton ky objekt dhe kur do të rikthehet vlera e tij, për këto nuk bëhet asnjë llogari. Ne nuk duhet të lejojmë të ecet kështu këtej e tutje, por t'i shohim më thellë e më me kujdes këto probleme. Po kush do t'i shohë? Në radhë të parë vetë kryesia e kooperativës, organizata-bazë e Partisë, si dhe gjithë kooperativistët. Në fillim kuadrot mund të mos jenë shumë kompetentë, po në punë e sipër do të aftësohen edhe për çështjet



që përmenda më sipër dhe atëherë të tëra problemet në kooperativë duhet të marrin e do të marrin me siguri kthesën që duam të bëjmë.

Pastaj dalin edhe probleme të tjera. Lind, për shembull, çështja e sektorëve të kooperativës. Ç'do të thotë sektor? Në qoftë se flasim për planifikim në kooperativat që mbjellin gjithfarë bimësh, këtu, në radhë të parë, duhet që forcat të jenë të organizuara sa më mirë, sepse drejtimi nuk mund të bëhet që nga qendra. Pra gjithë kjo ekonomi e madhe, siç është kooperativa e bashkuar, duhet ndarë në sektorë. Po sektori si do të caktohet? Në baza gjeografike, në bazë të llojit të bimëve, apo në bazë fshati? Unë mendoj që sektori nuk është e thënë të caktohet në bazë fshati. Fshati për kooperativën është vetëm një qendër banimi. Përpara kolektivizimit, ose edhe në fazën e parë të tij, para bashkimit të kooperativave, çdo kooperativist rregullisht punonte në tokat që kishte pranë fshatit. Tani që tokat janë bashkuar në një pronë të madhe kolektive dhe ne dëshirojmë të vendosim një organizim në përshtatje me përpjesëtimet dhe me karakterin e kësaj prone, anëtari i kooperativës duhet të vejë të punojë atje ku janë tokat. Por kur këto janë larg qendrave të banimit, për t'i lehtësuar kooperativistët, sektori mund të ngrejë atje ndonjë ndërtesë fjetjeje ose t'u sigurojë atyre mjetet për të shkuar në punë etj. Për sa i përket brigadës, kjo të shihet sipas nevojave të prodhimit, kushteve të terrenit dhe të bimëve që do të mbillen ose sipas kriterëve të drejtimit.

Ne duhet ta shohim karakterin e drejtimit dhe të ndihmës që duhet t'i japë sektori dhe vetë kryesia e

kooperativës brigadës në territorin ku punon ajo. Sektori dhe kryesia e kooperativës do të caktojnë numrin e njerëzve që duhet të ketë secila brigadë, po këtë të mos e bëjë *ex cathedra*. Ky numër duhet të dalë nga një planifikim i studiuar, i cili, më duket mua, do të ndihmojë edhe për zbatimin dhe për forcimin e disiplinës së punës. Plani i sektorit apo i brigadës duhet të jetë i qartë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punën, me shërbimet për bimët, me plehun, me mekanikën, me transportin, me investimet etj. Në bazë të këtij plani brigada llogarit njerëzit që ka dhe organizon punën e shpërndarjen e tyre sipas një grafiku kalendarik. Sot, fjala vjen, brigada e gjykon se është më mirë që forcat t'i ndajë më dysh, nesër mund të dalë nevoja që ato të ndahen në tri grupe, duke i caktuar çdo grupi punën që do të bëjë. Ky manovrim i shkathët i forcave, sipas rrethanave që paraqiten çdo ditë, duhet të synojë kurdoherë që brigada në tërësi, me një organizim e disiplinë të fortë pune, të realizojë detyrat e sektorit të vet. Në këtë drejtim është e domosdoshme të tregohen kujdes dhe iniciativë më e madhe, sepse nga ata varen vendosja dhe zbatimi i rregullit e i disiplinës në punë.

Për organizimin dhe për drejtimin e të gjitha punëve në bujqësi një rol të madh duhet të luajnë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit dhe seksioni i tij i bujqësisë. Por, në radhë të parë, është e domosdoshme që këto çështje t'i kuptojnë mirë dhe t'i zbatojnë me rigorozitet e me përgjegjësi të plotë organizata-bazë e Partisë dhe masa e kooperativistëve. Po t'i kuptojnë si duhet këto probleme komunistët e koo-

perativistët dhe po të organizojnë mirë punën, atëherë çdo gjë do të shkojë në rregull. Natyrisht, këto çështje duhet t'i kuptojnë drejt edhe komitetet ekzekutive të rretheve, deri edhe Ministria e Bujqësisë në qendër dhe të gjithë ata që kanë lidhje me bujqësinë, ndryshe nuk mund të arrihen rezultatet që priten.

Kemi mundësi ne ta bëjmë një gjë të tillë? Unë mendoj që kemi, vetëm se kërkohet disiplinë dhe, kur them disiplinë, këtë ta kuptojë thellë, në radhë të parë, baza. Disiplina që duhet vendosur në çështjet e bujqësisë të mos merret si një disiplinë formale dhe e njëanshme, por ajo të jetë një disiplinë e ndërgjegjshme dhe e tillë që të mos thyhet dot në asnjë hallkë.

Shtabi i kooperativës mund të mendojë, fjala vjen, se, gjersa nuk ka pleh në sasinë e mjaftueshme, sipas kërkesave të agroteknikës, ose gjersa nuk ka ujë për ujitje apo foragjere që të ushqehen kafshët prodhuese në bazë të normativave shkencore, atëherë është e domosdoshme që ai të parashikojë në plan masa për t'i zëvendësuar këto mungesa, në rrugë të tjera, në mënyrë që, në mos i arrihtë normat e duhura, të paktën t'u afrohet sa më shumë. Mungesat objektive ai duhet t'i plotësojë me mundësitë ekzistuese, duke shfrytëzuar plotësisht forcat e punës, mjetet mekanike e çdo gjë tjetër që ka në dorë. Kështu, për shembull, kur nuk ka pleh të mjaftueshëm për misrin, atëherë, të paktën, të merren masa që toka të punohet më thellë, për të zëvendësuar gjer në njëfarë shkalle mungesën e plehut. Në qoftë se nuk ka ujë në sasinë që duhet, të bëhen më shumë prashitje etj. Këto janë çështje që lidhen me planifikimin e me organizimin e punës dhe, në

këtë rast, një rol vendimtar luan kuptimi politik dhe ideologjik i problemit.

Në përgjithësi të gjitha këto probleme që ngrita, i preku shoku Manush. Unë bëra vetëm vërejtjen se cilës çështje duhet t'i jepet precedencë, me qëllim që të mos krijohet një përshtypje e gabuar dhe njerëzit të hutohen e të thonë se si do të dalin nga kjo situatë. Tani ne nuk duhet t'i prishim planet që kanë hartuar kooperativat për vitin 1971, po të punojmë për forcimin e tyre dhe t'u vëmë detyrë që t'i realizojnë ato medoemos. Kjo është detyra kryesore dhe më e ngutshme e ditës.

Gjatë luftës për realizimin e planit të mendojmë edhe për të përmirësuar metodologjinë e hartimit të tij. Po marr një shembull. Kooperativa ka planifikuar të marrë një rendiment të caktuar në prodhimin e grurit për hektar. Mirëpo tani ajo nuk mban llogari të hollësishme se sa i kushton ky grurë, sa punë harxhon për prodhimin e tij, cila është leverdia. Në qoftë se ekonomisti që ka ajo sot, nuk di ta bëjë këtë punë, të dërgohet që ta mësojë. Pra, gjatë zbatimit të planit të caktohen edhe rrugët konkrete dhe masat që duhen marrë për ta përmirësuar hartimin e tij për vitin e ardhshëm. Kështu nuk do të krijohet asnjë konfuzion ose ndërprerje. Natyrisht, në gjithë këtë punë nuk duhet të nisemi nga konceptet dhe nga metodat e vjetra, po të studiojmë, të mblidhemi të diskutojmë, pastaj të vendosim për ato gjëra që na duken më të mira. Të jemi kurdoherë në këmbë, të ndjekim rregullisht mobilizimin dhe shfrytëzimin e të gjitha forcave të afta për punë që ka në fshat, t'u kërkojmë rregull specialistëve e gjithë punonjësve të bujqësisë dhe të

vendosim kudo e në çdo gjë një disiplinë të fortë.

Në të gjitha ato hallka ku do të na duhen njerëz të zotë dhe organizatorë të fortë, të mendojmë dhe ta realizojmë edhe këtë detyrë, por, natyrisht, jo në çfarëdo kooperativë. Sidomos në kooperativat e mëdha ne mund të dërgojmë disa punëtorë të zotë, të cilët të ngarkohen me detyrë që të rrinë atje, ta zëmë, një vit, duke kërkuar nga secili që, gjatë kësaj kohe, të punojë për të edukuar dhe për të përgatitur dy-tre brigadierë. Ata duhet të jenë njerëz të dashur me kooperativistët, por, njëkohësisht, edhe të rreptë ndaj atyre që s'realizojnë detyrat. Këtyre punëtorëve të zotë dhe organizatorë që do të dërgojmë në kooperativa, të mos u kërkojmë shumë punë drejtpërdrejt në prodhim, njëlloj si gjithë anëtarëve të tjerë të brigadës. Nga ata ne të kërkojmë sidomos që të futin sa më shumë në shpirtin e kooperativistëve frymën e disiplinës dhe të kontrollit e të luftojnë ndër ta tendencat mikroborgjeze; të jenë gjithnjë pranë tyre, t'i mësojnë me shprehitë e një pune me disiplinë të rreptë e të organizuar mirë. Edhe ata nga ana e tyre mund të përfitojnë në drejtime të tjera, nga përvoja e kooperativistëve. Këto duhet t'u kërkojmë kryesisht këtyre punëtorëve të dërguar nga qyteti. Ata le ta kenë edhe shatën në dorë, po të kemi parasysh se, gjatë punës, do t'u duhet edhe të lëvizin që të kontrollojnë e të kërkojnë llogari, të nxitin dhe të ndihmojnë gjithë të tjerët që t'i kryejnë gjer në fund, plotësisht dhe me cilësi detyrat e ngarkuara për çdo ditë.

Për zbrërthimin e Letrës mendoj të mos dërgohen në bazë vetëm sekretarët e komiteteve të Partisë,

por edhe kuadro të tjerë të aftë dhe kompetentë, si shefi i seksionit të bujqësisë, specialistë dhe organizatorë të zotë e të tjerë. Pastaj në çdo kooperativë duhet të krijohen grupe për planifikim që të studiojnë dhe të përcaktojnë qartë e me hollësi se si do të zgjidhen me radhë të gjitha problemet që thamë.

Krahas këtyre duhet parë edhe çështja e një aktivizimi më të madh të Bankës Bujqësore. Ajo nuk ka për detyrë vetëm për t'u dhënë kredi kooperativave, por, nëpërmjet ekonomistëve të saj me eksperiencë, të bëhet një nga ndihmëset kryesore të Partisë dhe të pushtetit në rreth për forcimin organizativo-ekonomik të kooperativave. Banka Bujqësore t'i përvishet punës për t'i mësuar shtabet e kooperativave si të llogaritin, si të krahasojnë rezultatet dhe të drejtojnë ekonominë bujqësore, pse në këto drejtime kuadrot e kooperativave tona nuk i kanë akoma atë horizont të gjerë dhe aftësitë e nevojshme të punonjësve të bankës. Kështu Banka Bujqësore do të dalë nga ai rreth i kufizuar i punës që po bën. Në fakt, detyra që ka ajo është shumë më e gjerë, kurse puna që ka bërë gjer më sot nuk ka qenë e mjaftueshme. Ky institucion, pra, duhet të luajë një rol më të madh, pikërisht tani që po flasim kaq shumë për të llogaritur leverdinë e bimëve që mbjell kooperativa. Në këtë drejtim Banka Bujqësore mund të ndihmojë shumë. Për shembull, për forcimin e një dege të saj kooperativa kërkon, ta zëmë, 2 milionë lekë kredi. Banka, pasi bën llogaritë dhe nxjerr se prej tyre ka leverdi të madhe, e ka për detyrë t'ia sqarojë mirë këtë leverdi kooperativës dhe t'i japë asaj, po të jetë nevoja, edhe më shumë kredi.

Por puna e bankës të mos mbarojë me kaq. Ajo duhet të vazhdojë ta ndihmojë edhe më pas kooperativën, që kredinë e marrë ta administrojë si duhet dhe ta kthejë sa më parë në të mira materiale për republikën dhe për atë vetë.

Për të gjitha këto probleme të rëndësishme që po shtrojmë, duhet thirrur edhe ministri i Bujqësisë dhe të pyetet ç'mendon ai për to.

Natyrisht, nuk duhet shpejtuar për zgjidhjen e menjëhershme të të gjitha këtyre çështjeve, pse veprimet e nxituara nuk japin bukë, por të përpiqemi që brenda një periudhe pesë, gjashtë apo shtatëmuajore të arrijmë një përforsim të dukshëm në fushën e organizimit, të drejtimit dhe të planifikimit të punës dhe të prodhimit bujqësor. Me një fjalë, të kristalizojmë shumë gjëra që akoma nuk janë të qarta dhe të vendosim disiplinën në punë, në prodhim e kudo.

Këto nuk janë probleme që zgjidhen me një çelës apo vetëm me një mbledhje. Po të shpejtohem, punët do të bëhen shkel e shko dhe këtë ne nuk e duam, por as nuk duhet të ecim shumë ngadalë. Prandaj organizatave-bazë të Partisë dhe gjithë komunistëve, porsa ta marrin Letrën e Komitetit Qendror, t'u thuhet që ajo do të punohet në Parti dhe të udhëzohen ta lexojnë sa më parë e me vëmendje të madhe, të reflektojnë mirë mbi të dhe, pa pritur punimin e saj në organizatën-bazë, secili komunist të vetëveprojë menjëherë, të fillojë nga zbatimi i orientimeve që jepen në të.

Për mbarëvajtjen e gjithë punës që do të bëjmë, është e domosdoshme të kemi parasysh edhe eksperiencën e njërit dhe të tjetrit, e cila do të dalë nga

zbatimi i direktivave të kësaj ltre. Ne kemi nevojë për këtë eksperiencë, prandaj ajo të na jepet patjetër, por veç në mënyrë të organizuar. Kjo duhet bërë edhe për të gjitha çështjet e tjera që i përkasin Sekretariatit të Komitetit Qendror.

Nga tematika e mbledhjeve të Partisë në rrethe shoh se byrotë dhe komitetet e Partisë marrin në shqyrtim shumë probleme dhe nga më të ndryshmet. Kjo përbën një eksperiencë të madhe për Partinë tonë. Mirëpo mjaft nga këto probleme nuk na vijnë, ose na vijnë në mënyrë shumë globale. Ja, për shembull, në Gramsh parashikohet të merret në shqyrtim, në mbledhjen e plenumit, çështja e disa kontradiktave që shqetësojnë organizatën e Partisë të këtij rrethi. Tani, të katër ne, sekretarët e Komitetit Qendror, duhet të dimë se ç'janë këto kontradikta që ekzistojnë në organizatën e Partisë të Gramshit. Mirëpo konkluzionet e kësaj mbledhjeje nuk na vijnë që të gjykojmë nëse një gjendje e tillë është shqetësuese edhe për organizatat e Partisë të rretheve të tjera, me qëllim që t'i ndihmojmë e t'i udhëzojmë ato për të marrë me kohë një sërë masash për t'i kapërcyer vështirësitë.

Komiteti i Partisë i Rrethit të Krujës parashikon të marrë në shqyrtim këtë muaj çështjen e forcimit të përbërjes dhe të shtrirjes së Partisë, ose ai i Lezhës problemin e rritjes së mëtejshme të pjesëmarrjes në punë të kooperativistëve në bazë të vendimeve të Plenumit të Komitetit Qendror. Mirë, organizatat e Partisë të rretheve i shqyrtojnë këto probleme kaq të rëndësishme, po këtu në qendër ne nuk informohemi për t'u njohur se si është gjendja e tyre në këto or-



ganizata. Ose duam të dimë, fjala vjen, si po realizohen direktivat e Plenumit të 10-të të Komitetit Qendror të Partisë për çështjet organizative, që kanë një rëndësi të madhe, jetike për gjithë Partinë tonë. Meqenëse materialet e këtij Plenumi i kemi punuar në bazë, tani duhet të kujdesemi për të parë rezultatet, si po vepron e reagon Partia për realizimin e tyre, ç'gjëra kanë dalë, si i kanë kuptuar dhe si po i zbatojnë ato organizatat e Partisë; të shohim cilave çështje duhet t'u rikthehemi edhe një herë për të ndihmuar në zbatimin e tyre të plotë. Mirëpo në këtë drejtim shohim se nuk po na vjen asgjë.

Tani ne dërguam Letrën për bujqësinë. Por të kemi parasysh që, kur të caktojmë metodën e punës dhe detyrat që duhen kryer kohë pas kohe, këto të jenë sa më konkrete. Posa të punohet Letra, nesër mund t'i themi, fjala vjen, sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës: Ne duam të dimë në Sekretariat çfarë po bëhet në Tiranë për zbatimin e direktivave të kësaj Letre. Mund të thërresim në raport edhe një sekretar komiteti partie të një rrethi fushor dhe një tjetër të një rrethi malor për të parë çfarë problemesh kanë dalë nga punimi dhe nga zbatimi i direktivave të Letrës. Jo vetëm kaq, por në Sekretariat, sidomos nga ne, duhet të ketë vazhdimisht diskutime dhe shtruarje problemesh nga jeta e përditshme e Partisë për zbatimin e vendimeve, pa prituri që të bëhet mbledhje zyrtare.

Muajin e kaluar ne morëm në shqyrtim dhe vendosëm për zgjerimin e kompetencave të organeve të

pushtetit në bazë<sup>1</sup>. Për këto probleme caktuam detyra; tani mbetet që të caktohen afate për të na u raportuar se si janë duke u zbatuar këto detyra. Ne si Sekretariat nuk duhet të presim gjersa të na vijë raporti, por, duke qenë në dijeni si po zhvillohen punët çdo ditë për zbatimin e këtij vendimi, në rast se shohim që për disa çështje që kanë dalë ekzistojnë mendime të ndryshme, atëherë bashkërisht t'i diskutojmë këto dhe të marrim masa të mëtejshme. Ne kemi, gjithashtu, shumë probleme të agjitacionit dhe të propagandës së Partisë, të teatrit, të prozës, të poezisë, të shtypit, të universitetit, të shkollave etj., për të cilat duhet të diskutojmë herë pas here.

Ju, shokë sekretarë, që keni në vartësi instruktorë sipas sektorëve, është e domosdoshme t'u kërkonit atyre çfarë po bëjnë për këtë ose për atë problem. Kam përshtypjen se ata nuk bëjnë sa duhet përpjekje që të dallojnë cili problem është i ditës dhe kush ka rëndësi parimore, për të cilin duhet të raportojë përpara sekretarit të Komitetit Qendror. Mirëpo për këtë instruktori duhet të mendojë thellë dhe qysh më parë se çfarë do të shtrojë, sepse nuk mund të dilet në raport për gjëra të vogla, po për çështje të rëndësishme që i ka gjykuar se duhen ngritur para udhëheqjes së Partisë. Nga këshilltarët tanë ne nuk duam raportime të thjeshta, po raportime me konkluzione.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 1.

## MËSIMET E PARTISË TË SHPJEGOHEN DHE TË KUPTOHEN DREJT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 janar 1971

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme si pikë të parë kemi çështjen e punës drejtpërdrejt në prodhim të kuadrove në rrethet Dibër, Elbasan e Kolonjë.

Shokët që kanë ardhur nga rrethet merren edhe me bujqësinë në rrethin e tyre? Ti shoku sekretar i Kolonjës, për shembull, merresh edhe me çështjet e bujqësisë<sup>2</sup>?

**SHOKU PEÇO LIGORI:** Jo, shoku Enver, nuk merrem me bujqësinë.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën drejtpërdrejt në prodhim të kuadrove në rrethet Dibër, Elbasan e Kolonjë.

2. Shoku Enver Hoxha, si kurdoherë, edhe në këtë mbledhje, i kushton një rëndësi të veçantë bujqësisë. Ai interesohet për çështje nga më të ndryshme të këtij sektori dhe, këtë mbledhje e shndërron në një diskutim të lirë, në një bisedë frytdhënëse.

Ne dërgojmë në fshat kuadro për të bërë punën prodhuese dhe për të ndihmuar në forcimin e kooperativave bujqësore. Këtë gjë e shikojmë, për shembull, në Starje. Para disa vjetësh këtë kooperativë e kishim të dobët. Me masat që mori komiteti i Partisë, nga viti në vit janë bërë ndryshime. Sivjet kishin menduar të ndanin 13 lekë për ditë-punë, por ne mendojmë të mos ndahen kaq. Këtë e bëjmë me qëllim që të forcohet më mirë ekonomia e kooperativës, duke lënë më shumë të ardhura në fondin e pandashëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pse nuk jeni të mendimit ju që kooperativistët e Starjes të marrin nga 13 lekë për ditë-punë? Sa është caktuar fondi tranzitor, a derdhet ky fond, apo veprohet pa kriter? Na e shpjego një çikë këtë çështje.

*SHOKU PEÇO LIGORI:* Jo, shoku Enver, me kriter veprohet, po nga kooperativistët ka prirje për t'i ndarë të gjitha të ardhurat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* E di që ekzistojnë këto prirje, por duhet të ekzistojë edhe prirja tjetër që këto kërkesa të përcaktohen mirë nga udhëheqja për buxhetin e kooperativës. Nga të ardhurat që realizohen prej prodhimeve të llogaritet mirë se sa prej tyre do të caktohen për fondin e pandashëm të kooperativës dhe, pasi të përballohen shpenzimet, ato që mbeten të ndahen midis anëtarëve. Prandaj, unë pyes: U shkojnë kooperativistëve direktivat që dërgon Komiteti Qendror i Partisë dhe i kuptojnë thellë ata këto direktiva? Në qoftë se nuk arrijnë t'i kuptojnë drejt direktivat e Partisë, atëherë del që komiteti i Partisë nuk e ka bërë mirë punën. Kur lind nevoja, ne marrim

vendime që janë në interesin e kooperativistëve dhe është fakt se ata i gjejnë të drejta dhe i përkrahin vendimet e Partisë. Megjithatë, kur vjen koha e ndarjes së të ardhurave ka prirje që të ndahen të tëra ato dhe të mbetet kooperativa pa gjë. Kjo do të thotë që mësimet e Partisë të mos kuptohen drejt.

E keni marrë ju ndonjëherë në studim çështjen pse ndodh kështu? Apo mendohet vallë që në kooperativa çdo gjë duhet të zgjidhet me urdhra nga rrethi, duke u thënë: «Mos ndani kaq, mos bëni kështu, mos bëni ashtu» etj.? Problemet nuk mund të zgjidhen në këtë mënyrë. Kooperativistët kanë të drejtë të thonë: «Pse po na ndërhyini në punët tona?», «Pse ti, shoku i kryesisë së komitetit ekzekutiv apo ti, shoku sekretar i komitetit të Partisë, na jep urdhra për administrimin e mallit tonë?! Të ardhurat e kooperativës, që i realizojmë me djersën e ballit, ne, anëtarët dhe organizata-bazë e Partisë e kooperativës, do t'i ndajmë si të duam vetë».

Shokët e Partisë dhe të pushtetit të kenë shumë kujdes që të mos bien në pozita të tilla sa t'u thuhet nga shokët e kooperativës: «Pse po na ndërhyini në punët tona», por të përpiqen që të bëjnë një punë bindëse dhe këmbëngulëse për t'i sqaruar kooperativistët rreth kuptimit, qëllimit dhe synimit të udhëzimeve të Partisë, që direktivat e dhëna të mos i marrë era. Po të veprohet kështu, fondi i pandashëm dhe çështjet e tjera si pjesëmarrja në punë, disiplina etj. nuk kanë për të shkuar keq. Kur nuk punohet mirë e mungon disiplina kooperativistët kanë për të marrë më pak lekë në fund të vitit. Në këtë rast, kur nuk realizohen

të ardhurat, ata do të mendojnë që të mos lënë gjë në fondin e pandashëm, sepse nuk do t'u dalin llogaritë për nevojat e veta. Edhe kooperativistët, ashtu si punëtorët dhe nëpunësit, e llogaritin shpërblimin që do të marrin, me të cilin përveç nevojave të tjera të përditshme, duan të bëjnë, fjala vjen, një palë rroba për vete, për gruan ose për kalamanët. Fshatari me atë punë të paktë që bëri një vit më parë, llogarit se sa mori, pasi la në fondin e pandashëm, për shembull, 10 ose 8 për qind. Kurse sivjet, që ka punuar më mirë, prapë ai llogarit se, pasi të lihen në fondin e pandashëm aq sa edhe vitin e kaluar, atij i bie të marrë në fund të vitit më shumë lekë për ditë-punë. Pra, në kooperativat bujqësore, si kudo gjetkë, ecet dhe duhet të ecet medoemos me llogari e jo si të duan disa njerëz, por siç janë rregullat e Partisë, siç na mëson vija e saj. Dhe e përsëris se, për t'u zbatuar drejt direktivat e Komitetit Qendror njerëzit duhet t'i bindim që t'i kuptojnë këto direktiva.

Kooperativa bujqësore është një ekonomi e organizuar dhe fondi për të cilin flasim nuk mund të shërbejë si rezervë për të papriturat, siç u tha këtu. Atë ne e krijojmë për të priturat që parashikojmë, domethënë për zhvillimin e saj të mëtejshëm. Gjersa e krijojmë për këtë qëllim, duhet t'i themi mbledhjes së përgjithshme se do të lëmë 12 ose 13 për qind fond për hapjen e tokave të reja, duke ia bërë me llogari se sa do të na kushtojë kjo punë; do të blejmë kaq lopë, të cilat, gjithashtu, do të na kushtojnë aq ose kaq të holla. Po kështu do të bëjmë llogari për farërat, për veglat bujqësore etj. T'i pyesim kooperativistët

nëse ata duan t'i realizojmë këto. Sigurisht ata do të thonë se duan. Atëherë e kemi për detyrë t'i sqarojmë se kur t'i bëjmë të tëra këto investime, qysh vitin e ardhshëm do të kemi prej tyre kaq të ardhura dhe kaq fitime. Nga ky parashikim kooperativistët do të kuptojnë se vitin tjetër do të marrin, për shembull, 14,5 lekë për ditë-punë e jo 13 sa morën sivjet. Kështu do të binden se duhet medoemos të investojnë, se një gjë e tillë është në interes të tyre dhe se vetëm kështu mund të ngrihet niveli ekonomik. Fondi i parashikuar nuk është, pra, për të papriturat. Ai nuk mund të administrohet sipas qejfit të kryetarit apo të ndonjë tjetri nga anëtarët e kryesisë së kooperativës, por sipas situatës, sipas nevojave që paraqiten, sipas parashikimeve dhe llogarive, ndryshe nuk mund të ecet. Këtë kuadrot tanë duhet ta kenë mirë parasysh. Ndryshe Partia na mëson që masat ta vënë përpara përgjegjësisë kuadrin që nuk zbaton drejt direktivat e saj. Edhe në punën prodhuese ai duhet të japë shembullin e mirë. E ardhmja e socializmit nuk mund të varet nga dy-tre veta, nëse ata e japin apo nuk e japin shembullin para masave. U duhet thënë punonjësve, siç ka vënë në dukje ngaherë Partia që, në qoftë se ndonjë kuadër vepron keq, ta shohin çështjen e tij, le të jetë ai kush të dojë. Kuadri, cilido qoftë ai, kurdoherë duhet të punojë mirë dhe të jetë shembull në çdo drejtim. Në këtë çështje duhet të jetë e ndjeshme edhe puna politike e Partisë. Ju thatë se me qëllim që të ndihmoni kooperativat bujqësore, keni menduar të dërgoni kuadro në bazë për Letrën e KQ të PPSH lidhur me kthesën rrënjësore në bujqësi. Si i zgjodhët

kuadrot që do të dërgoni në bazë për këtë Letër? Pa na thuaj një çikë ta dimë se kjo na intereson shumë. Si i konkretizuat ato që thuhet në Letrën e KQ për bujqësinë. Tërë programin e punës suaj ju duhet ta pleksni me këtë punë.

*SHOKU PEÇO LIGORI:* E diskutuam këtë çështje në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në cilat organizata e diskutuat?

*SHOKU PEÇO LIGORI:* Në ato organizata ku mendonim të merrnim kuadro dhe në organizatat-bazë të Partisë të fshatit ku mendonim të dërgonim shokë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po si vendosët për këta kuadro që do të shkonin në këto organizata, kush vendosi dhe çfarë kriteri u mor për bazë, në ç'mbledhje vendosët për këta?

*SHOKU PEÇO LIGORI:* Këtë çështje e studioi byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit, duke marrë parasysh gjendjen e kooperativave tona dhe nevojat që kishin ato për kuadro.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Cilat ishin nevojat e kooperativave tuaja?

*SHOKU PEÇO LIGORI:* Disa kooperativa kishin nevojë për forcimin e tyre të mëtejshëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në çfarë drejtimi konkretisht kishin nevojë më shumë, për shembull, për agronomë, veterinerë apo specialistë të tjerë? Shpeshherë, shokë, si këtu në qendër ashtu edhe në komitetet e Partisë në rrethe, për të shpjeguar problemet që dalin, përdoren fraza të përgjithshme, si «kooperativat kishin nevojë për forcimin e tyre» etj. Nevojat e koo-



perativave në përgjithësi i dimë, po, kur thua që kooperativa kishte nevojë për agronom, ekonomist, llogaritar, kovaç e të tjerë, kjo nevojë është konkrete, e qartë. Pikërisht për këtë ne jemi të interesuar të dimë konkretisht përse kanë nevojë kooperativat bujqësore? Ju i keni studiuar këto probleme, prandaj mund të na thoni për çfarë kanë nevojë kooperativat, çfarë kriteresh ndoqët ju për t'i ndihmuar ato, sa kishit mundësi për t'i ndihmuar dhe sa i ndihmuat konkretisht.

*SHOKU PEÇO LIGORI:* Të 26 kuadrot që dërguam në kooperativat bujqësore, me përjashtim të katër shokëve që janë si organizatorë, të gjithë të tjerët janë ekonomistë, agronomë, veterinerë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Teknikët e lartë të bujqësisë që i dërguat në fshat ku ishin deri tani? Katër kuadrot që vajtën si organizatorë ç'punë do të bëjnë në fshatra?

*SHOKU PEÇO LIGORI:* Teknikët e lartë të bujqësisë ishin në aparatën shtetëror, kurse ata që shkuan si organizatorë, po t'i zgjedhë asambleja, mund të bëhen edhe drejtues të kooperativave bujqësore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Do të qëndrojnë atje vazhdimisht, apo i keni dërguar për një kohë të caktuar?

*SHOKU PEÇO LIGORI:* I kemi dërguar pa afat të caktuar; u thamë të punojnë atje derisa të ketë nevojë kooperativa, derisa ajo të forcohet dhe të përgatitë kuadrot e saj. Mandej në qoftë se do të paraqitet nevoja do të kthehen, në qoftë se jo do të qëndrojnë atje. Kjo masë na duket se ndihmon edhe në vetë formimin e kuadrove.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Patjetër që i ndihmon. Edhe punën në prodhim kryetari e bën me qejf kur punon në kooperativën e vet.

Edhe në Dibër, me përjashtim të Bulqizës që është zonë industriale, bujqësia është sektori kryesor i ekonomisë së këtij rrethi, prandaj kuadrot kryesorë, që janë në qytet, përveç atyre të arsimit, duhet të venë në bujqësi. Nuk duhet shkuar me mendimin se meqë Peshkopia është qytet, se kemi fabrikën e frutave, kemi këtë apo atë degë të prodhimit apo të shërbimeve aty të mbahen kuadrot më të mirë.

Në Bulqizë është një ndërmarrje minerare që i ka inxhinierët dhe specialistët e vet të domosdoshëm. Ata të qëndrojnë atje, kurse nga kuadrot e tjerë jospecialistë mund të mbahen vetëm një ose dy organizatorë të zotë, të tjerët të venë në bujqësi. Pa qenë kushtet mos u orvatni të krijoni medoemos idenë se jeni një rreth industrial. Prandaj, përveç Bulqizës, gjithë peshat tjetër e kujdesit për zhvillimin e ekonomisë së këtij rrethi të përqendrohet në bujqësi.

*SHOKU SINAN SARAÇI<sup>1</sup>:* Edhe thirrja përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë do të na vlejë si shkollë që do të na ndihmojë për të përmirësuar punën, prandaj vërejtjet, kritikën dhe këshillat që do të na jepen, ne do t'i kemi parasysh patjetër në punën tonë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* E di përse e bëra atë vërejtje për kuadrot e industrisë në disa rrethe të vogla, shoku Sinan? Sepse nganjëherë shokët bien në

---

1. Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

gabim, përpiqen ta zmadhojnë rëndësinë industriale të rrethit, ta paraqesin atë si një rreth industrial, pa qenë në të vërtetë i tillë. Kjo të çon drejt nënvleftësimit të bujqësisë.

Çdo rreth ka industrinë e vet, së cilës duhet t'i jepet rëndësia që i përket, po jo ama të bëhen përpjekje të panevojshme «për të vërtetuar» me statistika nevojën e qëndrimit të kuadrove dhe të njerëzve më të mirë në një industri që është e kufizuar, siç është, për shembull, industria në rrethin tuaj. Fabrika e vogël e frutave në qytetin e Peshkopisë nuk ka ndonjë arsye «të forcohet» me kuadër me arsim të lartë, duke u justifikuar se gjoja ky objekt përbën industrinë e rrethit. Nesër atje mund të ngremë edhe zdrukthëtarinë apo diçka tjetër që do të bëjë pjesë në industrinë e rrethit, por të gjitha këto objekte duhet të vlerësohen aq sa janë dhe duke i parë pikërisht me syrin që kuadro me arsim të lartë e të zotë t'i jepen edhe bujqësisë, që është dega më e rëndësishme e ekonomisë në këtë rreth.

Krejt ndryshe është puna me rrethin e Elbasanit. Ai ka me të vërtetë një industri të fuqishme, e cila vazhdon të zhvillohet si ajo e naftës, e metalurgjisë, e çimentos, e drurit etj. Për gjithë ato objekte që ka dhe për të tjerat që do të ngrihen në perspektivën e afërt, shokët e Elbasanit kanë të drejtë të thonë se rrethi i tyre është me të vërtetë industrial. Por kjo nuk do të thotë që edhe rrethi i Elbasanit ta lërë mënjane bujqësinë.

Kam përshtypjen se në disa rrethe të vogla nuk e kuptojnë drejt këtë çështje me rëndësi parimore,

prandaj kudo duhen rregulluar absolutisht shifrat. Shokët në disa rrethe me fabrika e uzina të kufizuara nuk ka pse të thonë se janë rreth industrial e me klasë punëtore pa qenë të tillë. Mos vallë edhe shitësit e dyqaneve, kamerierët e të tjerë e të tjerë, duhen llogaritur si klasë punëtore? Është fakt që kudo, nëpër qendrat e rretheve e të qyteteve ne kemi përqendruar kuadro të mirë, sepse punën atje e kemi konsideruar më të rëndësishme. Ndryshe qëndron puna me kooperative bujqësore. Në to nuk kemi kuadro të fortë. Pikërisht për këtë arsye na bie detyra të bëjmë tani një sforco të madhe për forcimin e tyre. Këtu u tha se në Ersekë shokët e Partisë po bëjnë një punë të madhe për të bindur kuadrot të shkojnë në kooperative meqenëse u është mbushur mendja qyp sikur duhet të rrinë në qytet. Po ç'punë kanë në qytet agronomët, zooteknikët dhe veterinerët? Jo vetëm këta, po edhe mjaft kuadro të tjerë me arsim të lartë, që janë organizatorë të zotë, s'kanë ç'duhen në qytetet e vogla, kur punën e tyre mund ta bëjnë fare mirë disa kuadro me arsim të mesëm. Pikërisht pse nuk është gjykuar drejt, bujqësia dhe blegtoria në disa rrethe kanë mbetur, si me thënë, në fatin e tyre. Kështu edhe në ndonjë rreth si Kolonja, është synuar, pa pasur asnjë bazë, të quhet një rreth industrial, ngaqë atje është ngritur ndonjë fabrikë ose punishte e vogël.

**SHOKU SINAN SARAÇI:** Ne shoku Enver, siç na këshilloni Ju kemi vepruar dhe veprojmë. Ne e dimë se Dibra është një rreth bujqësor, prandaj bujqësisë i kemi kushtuar kujdesin më të madh. Kështu do të veprojmë edhe në të ardhmen.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ne jemi të bindur se ju dhe gjithë shokët do t'i mbani parasysh si duhet këto çështje.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# T'Ë KUSHTOHET MË TEPËR RËNDËSI ZHVILLIMIT TË BLEGTORISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

18 janar 1971

Jam dakord me vërejtjet që bënë shokët për gjendjen e blegtorisë, e në veçanti të lopës, në rrethin e Elbasanit. Është e qartë se atje nuk është punuar mirë, prandaj kanë mbetur shumë prapa në këtë degë të bujqësisë.

Për çështjen që shqyrtojmë, kam nevojë për disa sqarime për zhvillimin e lopës në rrethin e Elbasanit. Lidhur me therjen e lopëve, shoku Jashar, mund të na thoni se kush e di kur duhet therur lopa dhe kur jo? Flas në praktikë se në teori e di edhe unë.

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU<sup>2</sup>:** Specialisti i

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua informacioni për zhvillimin e punimeve të plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit: «Mbi gjendjen e blegtorisë dhe masat për zhvillimin e mëtejshëm të saj», paraqitur nga Ministria e Bujqësisë.

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

bazës e shikon që lopa nuk ka dhëmbë prej disa kohësh, pra është plakur, dhe nxjerr përfundimin se duhet skartuar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ke lexuar apo jo për këtë problem, se është shumë i komplikuar.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Kjo çështje varet nga shumë faktorë, shoku Enver. Në qoftë se, për shembull, ne si rreth e kemi sasinë e duhur të lopëve që janë mjaft të mira, megjithëse kjo është shumë relative, një lopë që jep 300 litra qumësht në vit s'ka ç'na duhet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ç'janë 300 litra qumësht nga një lopë? Njëri nga Peshkopia më shkruante një letër ku thoshte se nga dhia merr 250 litra qumësht në vit.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Kjo duhet marrë në mënyrë relative, sepse atje në malësi kooperativisti edhe mund ta mbajë një lopë që jep 300 litra, kurse në një zonë tjetër, që ka lopë me 1 500 e 2 000 litra qumësht në vit, sigurisht që lopën me 300 litra nuk e mban.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këto janë probleme të vështira dhe të rënda për blegtorinë. Kur thuhet që malësori do ta mbajë lopën që jep 300 litra qumësht se s'ka ç'të hajë, duhet shikuar më parë a duhet mbajtur apo jo. Del problemi: A do të vazhdojmë ne të mbajmë lopë me një prodhim prej 250 dhe 300 litra qumësht në vit? Këtu ka probleme e detyra për zooteknikët. Për skartimet ekziston një rregull, ka një orientim që duke u mbështetur në aftësitë fiziologjike të gjësë së gjallë të kihet parasysh rendimenti i tyre. Skartimi ka

një plafond, një maksimale, një mesatare dhe një minimale, të cilat janë relative. Në qoftë se pranojmë për mesatare një lloj lope që jep 300 litra qumësht në vit, këtë lopë ne nuk kemi për ta skartuar kurrë, por në qoftë se masën e rendimentit të qumështit e përcaktojmë më të lartë, në bazë të cilësive fiziologjike, ajo vjen çdo vit duke e rritur prodhimin pas lindjes së parë gjersa arrin në një maksimale dhe, pasi qëndron ca kohë në këtë stad, rendimenti i saj pastaj vjen përsëri duke u ulur. Këtij rendimenti ne i caktojmë një kufi dhe kur llogaritim që nuk është rentabël, atëherë vendosim ta mbajmë apo të mos e mbajmë.

Tani ne mbajmë edhe atë lopë që na jep 300 litra, por këtej e tutje duhet të bëjmë një kthesë rrënjësore në këtë drejtim. Kur t'i përcaktojmë shkallëzimet që thashë në lidhje me rendimentin, duhet të kemi parasysh medoemos dhe anën ushqimore të gjësë së gjallë dhe trajtimin e gjithanshëm të saj. Ky problem nuk duhet shikuar në mënyrë të rastit, po i studiuar si duhet, në kompleks sepse edhe ushqimet sikur t'i llogaritësh mirë, prapë nuk do të marrësh atë që parashikon pse një rol me rëndësi luajnë edhe reflekset që krijohen te bagëtitë gjatë trajtimit të tyre.

Në prodhimtarinë e lopëve influencojnë, gjithashtu, edhe sëmundjet, si dhe trajtimi që u bëhet, për shembull mbajtja e tyre në hije apo në diell, qëndrimi në shumë në natyrë apo në stallë, orari i të ushqyerit etj. Të gjitha këto, natyrisht, duhet të kihen parasysh, por, po të mos kihet parasysh kryesorja, që është baza ushqimore, nuk mund të realizosh asgjë dhe nuk mund



t'i ndjekësh skartimet si duhet, në mënyrë shkencore. Skartimet nuk mund të bëhen në laktacionin e shtatë apo të tetë, por ashtu si janë rregullat. Nuk mund t'ia presësh kokën lopës, në qoftë se s'ke arritur t'i marrësh të gjithë viçat që janë parashikuar të japë ajo. Kur mëshqerra e re bëhet lopë dhe jep jo 300, por 1 300 e më shumë litra qumësht, atëherë lopa, që të jep vetëm 300 litra në vit, mund të theret.

Kur bashkë me lopët që kanë prodhimtari të lartë mbahen e ushqehen edhe ato me prodhimtari të ulët, një gjë e tillë do të na prishë ekuilibrin e ushqimit, do të na rritë koston e prodhimeve blegtorale etj. me një fjalë do të na pengohet, pra, ecuria në shumë drejtime. Kjo duhet kuptuar doemos dhe thellë nga të gjithë.

Dërgimi i zooteknikut nga qyteti në fshat me urdhër të komitetit ekzekutiv, për të bërë presion për «zgjedhjen» e lopëve që duhen skartuar, kur grumbullimi nuk ka mish për të furnizuar dyqanet, përbën një rreth vicioz, shumë të sëmurë dhe me pasoja shkatërruese për bagëtinë. Ne nuk e kemi në rrugë të drejtë këtë situatë, prandaj të mendojmë seriozisht, bile shumë seriozisht, sepse nuk i dilet kështu. Këtë problem ne, shokë, nuk e dimë sa ata që kanë studiuar në këtë fushë, megjithatë duhet ta shikojmë më mirë.

Për blegtorinë zhvilloi punimet e veta plenumi i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit. Mendimi im është se shokët në atë plenum mund të ishin thelluar ca më tepër në këtë problem kaq të rëndësishëm dhe të kishin marrë masa më shkencore për zhvillimin e mëtejshëm të lopës. Por e kundërta ka ndodhur

në këtë rast, plenumi u kufizua në disa autokritika të përcipta.

Unë jam dakord me çështjet e shtruara nga shoku Petraq Magjistari<sup>1</sup> në raportin që na është paraqitur. Por për problemin e blegtorisë, më duket, faj ka edhe vetë Ministria e Bujqësisë, kanë shumë faj, gjithashtu, edhe rrethet, që nuk i kanë thëlluar mirë direktivat e Komitetit Qendror të Partisë për zhvillimin e këtij sektori kaq të rëndësishëm të ekonomisë, sepse vënia në jetë e tyre kërkon një punë këmbëngulëse, jashtëzakonisht të thëlluar, të lodhshme, të vëmendshme, të vazhdueshme e jo të rastit; kërkon një punë jo për reklamë dhe shifra, po për të arritur rezultate sa më të mëdha.

Këtij problemi Partia i ka vënë prej kohësh një rëndësi të veçantë, prandaj edhe kemi bërë e vazhdojmë të bëjmë propagandë. Për zhvillimin e blegtorisë, në përgjithësi, dhe të lopës në mënyrë të veçantë, kemi marrë masa të rëndësishme. Shteti dhe vetë kooperativat bujqësore kanë investuar dhe vazhdojnë të bëjnë investime. Pas gjithë atyre masave që janë marrë, mund të themi se, në krahasim me të kaluarën, gjendja ka ndryshuar, kudo janë bërë përparime të dukshme. Por do të gaboheshim po të kënaqeshim me realizimet e arritura, pse jemi akoma prapa në këtë sektor të blegtorisë (e kam fjalën për zhvillimin e lopës).

Pse them që jemi prapa? Sepse shumë pikëpamje të vjetra për rritjen e bagëtive ekzistojnë akoma të gjalla në mentalitetin, në jetën dhe në punën e koope-

---

1. Në atë kohë zëvendësministër i Bujqësisë.

rativistëve tanë. Këtë të mos e harrojmë, ndryshe nuk do të kemi lopë, nuk do të kemi një interesim më të madh për rritjen e kafshëve të trasha.

Në gjendjen që ndodhen sot kooperativat bujqësore, bagëtitë e imëta atje ushqehen në mënyrë ekstensive, duke kullotur në natyrë, ashtu siç ushqeheshin edhe kur ekzistonin ekonomitë e vogla private e të prapambetura. Kjo ushtron një ndikim negativ edhe në të ushqyerit e kafshëve të trasha e veçanërisht të lopës. Ajo pengon sigurimin për to të sasisë së domosdoshme ushqimore, pengon krijimin e një koncepti shkencor për ushqimin e këtyre kafshëve.

Lopa, në kushtet e pronës së vogël individuale në vendin tonë, në përgjithësi zinte një vend fare të parëndësishëm. Ajo ushqehet dobët, sepse rritej vetëm për riprodhim, domethënë nëpërmjet saj synohej kryesisht të siguroheshin qetë e punës. Duke u nisur nga një qëllim i tillë, në ekonomitë e vjetra të fshatarëve të varfër dhe të mesëm, lopa rritej dhe ushqehet në mënyrë empirike, me çka të gjente përpara dhe ç'të mbetej. Mjerimi që kishte pllakosur bujkun tonë, nevojat e shumta dhe hallet e tij të pambaruara e të shpeshta, e shtynin atë të përpiqej që nga blegtoria të plotësonte vetëm disa nevoja imediate të familjes së vet dhe të nxirrte ndonjë të ardhur fare të vogël, duke nxjerrë ndonjë tepricë në treg.

Këto që përmenda, si edhe shumë të tjera, kanë lënë mbresa dhe janë ruajtur akoma të forta në mentalitetin e kooperativistit të sotëm, tek i cili, me gjithë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur dhe që kanë sjellë transformime revolucionare në të gjitha drejtimit

në jetën e kooperativave tona dhe të vetë kooperativistëve, ndikojnë negativisht në kooperativë, kështu që shumë gjërave nuk u shkohet deri në fund. Fshatari ynë është i zgjuar e revolucionar, por e kaluara e hidhur ka lënë mbresa të forta në ndërgjegjen e tij. Si rrjedhim, disa gjëra ai nuk i kupton akoma as në madhësinë ose në perspektivën e tyre dhe as në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën. Individualizmi i dikurshëm i fshatarit privat spikat në zgjidhjen e problemeve, gjithashtu, me mënyra individuale. Kooperativisti i sotëm nuk është shkundur akoma plotësisht nga mentaliteti i pronës së vogël të dikurshme, nga format dhe nga metodat e punës që përdorte në të, ai shpesh ndikohet dhe priret nga vetmia.

Partia ka hedhur parullën «T'i vëmë rëndësi zhvillimit të lopës», për realizimin e së cilës punohet e luftohet. Nga ana tjetër ekziston, gjithashtu, edhe një orientim i përgjithshëm «për numrin e lopëve që duhen rritur në çdo 100 hektarë tokë e punuar bujqësore». Parulla e tretë e drejtë dhe me rëndësi të madhe që është hedhur dhe për të cilën luftojnë Partia dhe kooperativistët, është «sigurimi i ushqimeve për kafshët». Këto orientime të drejta ekzistojnë dhe i udhëheqin vazhdimisht kooperativat tona në veprimtarinë e tyre të përditshme, e megjithatë duhet të pranojmë se ato nuk janë nxitur nga Partia për t'u thelluar si duhet në zbatimin e këtyre orientimeve. Ka kooperativa që për çdo punë ecin me plan, në mënyrë shkencore dhe duke llogaritur leverdinë ekonomiko-financiare. Por nuk ndodh kështu kurdoherë, pse ka edhe kooperativa që nuk ecin në këtë rrugë. Unë këto çështje i kam

theksuar dhe i theksoj jo rastësisht, por, kur them që nuk ecet me plan, në mënyrë shkencore dhe duke pasur parasysh leverdinë ekonomiko-financiare për çdo punë, orientimet e drejta të Partisë nuk mund të zbatohen si duhet në jetë, në qoftë se për zhvillimin dhe për rritjen e lopës do të vazhdohet të punohet në rrugën e spontaneitetit. Në këtë rast, siç thashë, ndikojnë pikëpamjet e vjetra, mungesa e dijenive për renditjen e kafshëve, sipas rëndësisë që kanë, sipas nevojës, sipas mundësisë ekonomike dhe bimëve që mbjell çdo kooperativë në tokat e saj. Nga këta e nga të tjerë faktorë duhet të nisët planifikimi i zhvillimit të lopës, llogaritja e leverdisë së saj ekonomiko-financiare.

Mirëpo në praktikën e kooperativave tona ne vëmë re se nuk veprohet kështu. Këtu mungon koordinimi i kulturave me foragjeret dhe me sasinë e kafshëve që mund të rriten, nuk llogaritet leverdia ekonomiko-financiare e investimeve të ndryshme që bëhen në kooperativë dhe të ardhurat nuk përcaktohen në bazë të një planifikimi rigoroz e në mënyrë shkencore. Si rrjedhim, kur vjen fundi i vitit bujqësor, nuk mund të nxirret e të dihet me saktësi leverdia që ka për kooperativën secili sektor i saj, nuk mund të bëhet llogaritja dhe krahasimi në para (vlerë) i të ardhurave dhe i shpenzimeve për prodhimin e përgjithshëm dhe, aq më pak pastaj, për çdo bimë më vete, për frutikulturën, për blegtorinë dhe sidomos për lopën. Kjo gjendje i pengon kooperativistët që të luftojnë më shumë, më mirë e në mënyrë më të organizuar për të pakësuar shpenzimet dhe për të shtuar të ardhurat, jo vetëm në përgjithësi, por edhe për çdo sektor të prodhimit dhe për

çdo proces pune të marrë veças. Me një fjalë, në kooperativë, ne nuk kemi akoma një veprimtari ekonomiko-prodhuese të planifikuar, të organizuar dhe të drejtuar mbi baza të shëndosha hozrashoti, ashtu siç e kemi në ndërmarrjet shtetërore. Pa e bërë këtë, në kooperativë nuk mund të arrihet planifikimi shkencor as për blegtorinë, as edhe për të gjithë ekonominë e saj.

Mungesa e një planifikimi shkencor në kooperativë është shumë më e theksuar, sidomos për blegtorinë. Të dhënat statistikore tregojnë se përqindja më e madhe e lopëve të vendit, duke përfshirë ndërmarrjet bujqësore, ndodhet në pronësinë personale të oborreve kooperativiste. Në këto rrethana vihet dhe duhet vënë pyetja: «Me se ushqehen këto lopë?». Sipërfaqja fare e vogël e tokës që i është lënë oborrit kooperativist nuk mjafton, edhe sikur kjo të përdoret e tëra për të siguruar ushqimin e lopës personale. Është, pra, e qartë se lopët ne vazhdojmë t'i trajtojmë keq, si në kohët e para.

Lopët e oborreve ushqehen dobët. Kjo bën që ato të japin pak qumësht, mish ose viça. Mirëpo përveç dëmit ekonomik, kjo gjendje sjell me vete edhe një të keqe tjetër të madhe. Megjithatë sipërfaqja e tokës së oborrit nuk siguron dot ushqimin e lopës, ky përballohet disi duke vjedhur andej-këtej në tokat e kooperativës. Në këtë mënyrë jo vetëm që lopa nuk ushqehet, po i shkaktohet një dëm i madh edhe ndërgjegjes, edukimit të kooperativistit. Në këtë gjendje ne nuk mund të marrim prej lopëve të oborrit rendimentet e dëshiruara. Prandaj këtij problemi duhet t'i gjejmë zgjidhjen e drejtë dhe të plotë, duke siguruar

ushqim të mjaftueshëm edhe për lopët e oborreve kooperativiste, për të cilat të mendojmë, gjithashtu, se ç'drejtim do t'u japim, do t'i rritim për qumësht, për mish, apo për mbarështim? Në këtë drejtim, deri sot ne s'kemi dhënë orientime të sakta.

Nuk është aspak e drejtë që Ministria e Bujqësisë ta lërë zhvillimin e blegtorisë në kooperativat bujqësore në fatin e vet, që ajo të mjaftohet vetëm me tri parullat e përgjithshme që ka hedhur Partia për lopën, për numrin dhe për ushqimin e saj, pa i zbërthyer ato me hollësi, pa përcaktuar çfarë lopësh duhen mbajtur, me se duhen ushqyer lopët e llojeve të ndryshme dhe si do të prodhohet ushqimi i tyre, në cilat toka dhe në cilat krahina të vendit do të rriten këto ose ato raca. Prandaj Ministria e Bujqësisë t'i futet sa më parë studimit të disa problemeve të veçanta për çështjen e lopës. Kjo do t'i lejojë asaj që kur ndonjëri nga punonjësit e saj të shkojë, për shembull, në rrethin e Elbasanit, të mos paraqitë atje vetëm listat, për të argumentuar se në krahasim me rrethet e tjera Elbasanit i janë dërguar kuadro të mjaftueshëm, po të japë edhe këshilla të ndryshme orientuese që në Shpat, fjala vjen, të mos mbahet ajo lopë që mbahet sot, por një lloj tjetër, ose në një zonë të caktuar nuk duhet të mbahet kjo lloj gjëje e gjallë, se bën ftohtë dhe ajo nuk mund të rrojë në ato kushte, por të mbahet një lloj tjetër që e duron të ftohtit etj. Kush do t'ua japë rrethëve këto udhëzime në vija të përgjithshme? Natyrisht, Ministria e Bujqësisë, punonjësit e saj. Ato këshilla që do t'u jepen rrethëve nga ministria apo nga punonjësit e saj, duhet të jenë orientime për zooteknikët e atjeshëm,

të cilët do të nxiten të bëjnë një punë me të vërtetë shkencore, sepse ata nuk janë të paaftë, por njerëz të zotë. Këtë e them për arsye se në shtypin qendror, si në gazetën «Zëri i popullit» dhe «Bashkimi» shpesh lexoj artikuj që kanë të bëjnë me problemet që po shqyrtojmë dhe shoh se këta kuadro të bazës i trajtojnë shumë mirë dhe me kompetencë këto probleme, bile këto që them unë janë gjëra shumë të thjeshta para mendimeve të specialistëve nga të cilat jam frymëzuar. Po e keqja është se shumë prej mendimeve të tyre të drejta, nuk u vihet fare rëndësi.

Prandaj është e domosdoshme të studiohet sa më parë dhe të jepet një orientim i qartë e shkencor për zhvillimin dhe për rritjen e llojeve të lopëve. Ky orientim sot mungon jo vetëm për oborrin kooperativist, por edhe për kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet bujqësore, ku ka shumë gjëra për të parë dhe për të ndrequr.

Sasia e foragjereve dhe e gjithë bimëve të tjera bujqësore, sipas shkencës dhe praktikës, duhet të përcaktojnë numrin e bagëtive, të lopëve dhe llojet e tyre që mund të rritë kooperativa. Në radhë të parë të kuptohet mirë dhe të zërthehet me hollësi në praktikë, sipas kushteve të veçanta të çdo ekonomie bujqësore, parulla e Partisë për numrin e lopëve që duhen mbajtur për çdo 100 hektarë tokë bujqësore. Në asnjë mënyrë të mos ngarkohet një kooperativë me një numër të madh lopësh, jashtë mundësive që ka ekonomia dhe pa përcaktuar mirë sasinë dhe llojin e caktuar të ushqimeve që ekonomia bujqësore do të prodhojë, për të siguruar ushqimin e rregullt të lopëve.



Me të drejtë thuhet se ekzistenca dhe prodhimi i çdo lloj bagëtie varen nga ushqimi. Po nuk pati ushqim, s'ka asgjë të gjallë. Kjo do të thotë që, për të siguruar qumësht dhe mish, duhet të sigurohet më parë ushqimi i bagëtisë; kurse te ne ngjet e kundërta: në radhë të parë vëmë numrin e krerëve, luftojmë ta realizojmë atë dhe në fund fare mendojmë për ushqimin e tyre. Ky nuk është aspak një qëndrim i drejtë dhe na sjell çrregullime.

Ka kooperativa që luftojnë për të arritur numrin e lopëve që duhen mbajtur për çdo 100 hektarë. Por kjo shifër caktohet *ex cathedra*, nga lart. Nga se jeni nisur ju, shokë të bujqësisë, kur kjo sipërfaqe toke prej 100 hektarësh është caktuar si njësi bazë matjeje për numrin e krerëve të lopëve që duhen mbajtur? Këtë njësi matjeje dhe sasinë e lopëve që duhet t'i përgjigjet asaj, ne e kemi rekomanduar para shumë vjetësh, kur bujqësia jonë ndodhej në kushte krejt të ndryshme nga të sotmet. Po vallë a ishte i drejtë dhe plotësisht i bazuar rekomandimi për të mbajtur një numër të caktuar lopësh e bagëtish të tjera për 100 hektarë, në një kohë që kooperativa s'e çante kokën fare jo vetëm për foragjere, por edhe misër e grurë mezi merrte 13-14 kuintalë për hektar? Pikërisht në këto kushte ne i vëmë vëmë kooperativës për detyrë të mbante për çdo 100 hektarë një numër të caktuar lopësh, që ishte arritur në një ekonomi të përparuar bujqësore. Kjo shifër pra ishte marrë shabllon nga jashtë. A është e drejtë të kërkosh të vihet menjëherë në jetë ajo që i takon perspektivës? Jam dakord se kjo duhet kërkuar në perspektivë, por duhet punuar me këmbëngulje që per-

spektiva të krijohet duke u nisur nga realiteti ynë, që të fillohet, në radhë të parë, nga baza ushqimore dhe pastaj të shtohen kafshët vetëm aq sa lejon kjo bazë.

Disa ekonomi që e kanë arritur shifrën e rekomanduar mburren me numrin. Por të mburresh vetëm me numrin, është gabim. Krerët e bagëtive për 100 hektarë nuk mund të caktohen *a priori*, njëlloj për të tëra kooperativat dhe për të gjitha llojet e gjësë së gjallë. Duhet pasur parasysh gjendja e çdo kooperative dhe, të nisur nga kjo, të bëhet një planifikim i drejtë i bimëve, duke llogaritur edhe leverdinë ekonomiko-financiare të tyre. Mbi këtë bazë mund dhe duhet të përcaktohet edhe numri e lloji i gjësë së gjallë që duhet të rritë çdo kooperativë, sepse numri i tyre nuk mund të caktohet me hamendje, përtej mundësive reale ekonomike të kooperativës, i shkëputur nga një planifikim shkencor i blegtorisë dhe i gjithë ekonomisë së kooperativës.

Çfarë lopësh duhet të rritë secila kooperativë në bazë të kriterëve të mësipërme? Kjo, mendoj unë, vazhdon të bëhet në mënyrë të pastudiuar, për arsye se nuk është i qartë qëllimi për të cilin mbahet lopa. Këtë nuk e them kot, por e nxjerr nga ato që tregoi vetë shoku Jashar Menzelxhiu, nga mentaliteti që ekziston në fshatarësinë tonë për rritjen e lopës e sidomos në malësi.

Lopa duhet të mbahet që të japë qumësht, mish ose viça, ndryshe s'ka pse të mbahet. Prandaj edhe ushqimi duhet të sigurohet sipas qëllimit që mendohet se lopa mund të japë rendimentin më të madh në kohën e caktuar, pikërisht ashtu siç vepron në rastin

e një fabrike, prodhimin e së cilës e hedhin në treg. Pra lopa duhet të mbahet sipas qëllimit që i vëmë.

Të gjithë e dimë se ka raca lopësh që mbahen për mish. Në këtë rast qumështi i saj është aneks, kurse në lopët që mbahen për qumështin është mishi aneks. Te lopët që i rritim për riprodhim edhe qumështi, edhe mishi janë aneks. Për çdonjërën nga këto lloje lopësh, sipas qëllimit që rritet, caktohet edhe sasia dhe lloji i foragjereve për të siguruar ushqimin e nevojshëm. Këto foragjere përfshihen në planin e kooperativës, mbi-llen dhe prodhohen prej saj në ato toka që zootekniku e di se japin më shumë për këtë qëllim.

Në rast se ne nuk i mbajmë parasysh këto çështje, mendoj që edhe në të ardhmen do të veprohet siç është bërë deri sot. Mirëpo ne nuk mund të ecim më pa llogari dhe me sentimentalizmin mikroborgjez të fshatarit, i cili do të mbajë lopë gati të ngordhura e sa për numër. Atij, edhe viçat që rriten për mish, i vjen keq t'i therë në kohën e caktuar për therje. Një qëndrim i tillë prish balancën e ushqimeve, sepse, duke i mbajtur më vonë nga parashikimi, viçat do të hanë në kurriz të krerëve të planifikuar për prodhim qumështi dhe mishi. Prandaj viçat që rriten për mish, duhen the-  
rur medoemos në kohën e caktuar dhe të mos na vijë aspak keq, kur i kemi rritur për këtë qëllim; ndryshe do të pakësohet racioni i të tjerëve që vijnë pas të parëve, por që nuk kanë arritur kohën e therjes. Mund të merret me mend ç'mund të ngjasë në kooperativat tona dhe, në fakt, kështu ngjet, ku të gjithë këta tregues planifikohen shumë dobët ose ecet pa llogari fare dhe në mënyrë sentimentale.

Planifikimi i foragjereve dhe i gjithë ushqimeve të tjera për bagëtinë, dhe veçanërisht për lopën për të cilën po flas, jo vetëm duhet të bëhet rigoroz, por edhe i studiuar, duke u nisur nga njësitë ushqimore që duhen siguruar për çdo lopë e viç gjatë çdo periudhe kohe të vitit. Sigurimi i ushqimit të mos bëhet sidokudo, por i kombinuar në mënyrë të atillë që të transformohet nga «makina» e gjallë, siç është lopa, në qumësht, në mish dhe në viç, në sasinë dhe në cilësinë e parashikuar.

Në këtë «makinë», shokë, ka rëndësi të jashtëzakonshme «tubi digjestiv», ndikimi i të cilit është i madh. Ky luan një rol të madh dhe prej tij del, si të thuash, një plan i caktuar teknik dhe ekonomik. «Tubi digjestiv» përcakton zgjedhjen e ushqimeve, ai përcakton masën dhe sasinë e ushqimeve, me fjalë të tjera ka të bëjë me problemin e racioneve. Këtej rrjedh, gjithashtu, edhe rentabiliteti i transformimit të njërive ushqimore në prodhime, domethënë, leverdia ekonomike e financiare e tyre.

Por puna nuk merr fund me kaq. Që lopa të japë sasinë dhe cilësinë e dëshiruar të prodhimeve, duhet të tregohet një kujdes i madh edhe për psikologjinë e saj. Kjo anë e çështjes ka të bëjë me shijen e ushqimit që i jepet lopës, me sigurimin e rehatisë në stallë, me gjimnastikën që i duhet bërë, me simpatinë ose antipatinë që i krijohet nga diçka e jashtme dhe i shkakton shqetësim e nervozizëm, me hijen ose diellin në verë apo në dimër etj., etj. Të gjitha këto duhen mbajtur kurdoherë parasysh nga rritësit e mirë e të vëmendshëm të lopës. Nga ana tjetër, edhe gjendja patologji-

ke ose parazitologjike e kafshës zvogëlon rendimentin e kësaj «makine». Në qoftë se me të nuk dimë të ve-projmë drejt e në mënyrë shkencore, nuk mund të arrijmë atë që kërkojmë.

Dëshiroj, pra, të theksoj se për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rritjen e lopës, nuk mund të shkohet më kuturu, siç ndodh shumë herë. Partia dhe udhëheqja në kooperativat bujqësore duhet të dëgjojnë me kujdesin më të madh zërin e veterinerëve, të zooteknikëve dhe të specialistëve të tjerë që kanë dijeni për këto çështje dhe të mos ndodhë asnjëherë, siç ngjet jo rrallë, që nuk u vihet veshi këshillave dhe vërejtjeve të tyre, duke u thënë: «Ore ti s'je në të, Partia na thotë drithin në radhë të parë». Të gjithë ata që flasin kështu, duket qartë që s'e kanë kuptuar drejt vijën e Partisë; ata nuk janë ekonomistë të mirë dhe nuk kuptojnë si duhet planifikimin socialist shkencor, derisa nuk dinë akoma se bujqësia s'përbëhet vetëm nga drithi dhe se ekonomia jonë nuk ka nevojë vetëm për drithë, por edhe për një varg prodhimesh të tjera. Drithi, natyrisht, është kryesori, por Partia nuk këshillohet të prodhojmë vetëm drithë, ndryshe do t'i kishim fshirë të gjitha prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale.

Ka drejtues në kooperativa që në mënyrë mekanike, duke menduar vetëm për drithin, kur vjen çështja e lopës, nuk e vrasin mendjen edhe për qumështin, për mishin dhe për viçin që ajo duhet të japë, por, siç kam dëgjuar, këtë çështje e rrumbullakosin dhe thonë vetëm se lopa na jep plehun për drithërat. Është e vërtetë që plehu na duhet, por na duhen më parë qumë-

shti, gjalpi dhe mishi për të ushqyer njerëzit. Njerëzit dhe kafshët ushqehen jo se kanë për mision të parë të bëjnë fekale. Këto janë mbeturinat e pavlefshme që nxjerr organizmi i njeriut ose i kafshës, ato përdoren edhe për plehërimin e tokës, për shtimin e pjellorisë së saj. Me shumë të drejtë organizohen fushata për grumbullimin dhe për përpunimin e plehut organik, por nuk mendohet gjatë se plehu shumë i vlefshëm i kafshëve do të shtohet, në rast se bagëtisë i jepet ushqimi i duhur, në rast se ashtu si misri e gruri do të vlerësohen edhe foragjeret për të cilat ka aq shumë nevojë bagëtia që të ushqehet.

Një mikroborgjez injorant mund të thotë: «Si është e mundur të vihen në një radhë drithi me foragjeret?!». Për të kuptuar se sa e kotë dhe pa vend është një habi e tillë, mjafton të shtrojmë këtë çështje: A është e drejtë që populli të mos ketë qumësht, të mos ketë gjalpë, të mos ketë mish, të mos ketë dhjamë e produkte të tjera që rrjedhin prej tyre, pa zënë në gojë pastaj sendet e fabrikuara të konsumit të gjerë, si: këpucët, çizmet etj.? E lejon Partia një gjë të tillë? Është e vërtetë se Partia ka thënë të prodhohet drithi, në radhë të parë, por njëkohësisht ajo porosit që të prodhohen në maksimumin e mundshëm edhe gjithë bimët e tjera, të zhvillohet edhe blegtoria, të kemi sa më shumë ullinj dhe nga të gjitha llojet e frutave. Dhe derisa mundësitë ekzistojnë, është e domosdoshme të organizohet puna në mënyrë shkencore që prodhimet bujqësore e blegtorale, për të cilat ka nevojë populli, ekonomia jonë, të prodhohen vazhdimisht dhe jo në mënyrë të çrregullt e të rastit. Jashtë mundësive nuk kërkohet

asgjë; por brenda mundësive ekzistuese puna duhet organizuar mirë që prodhimet bujqësore e blegtorale të shtohen çdo ditë e më shumë. Pikërisht këtu duhet të përqendrohen edhe lufta jonë, përpjekjet tona kryesore.

Është urgjente dhe e domosdoshme që shumë probleme që i kemi shtruar drejt, dhe për zgjidhjen e të cilave kemi arritur suksese, t'i thellojmë më tej, të kuptojmë më mirë lidhjet, shkaqet dhe efektet e zgjidhjes së tyre. Të forcojmë kudo drejtimin, por, për të korrur frytet e dëshiruara, këtë punë ta studiojmë mirë, të zhdukim gabimet dhe të metat e vërtetuara deri tani dhe të hapim perspektiva të reja pune e prodhimi. Një punë e tillë, e planifikuar dhe e organizuar shkencërisht, do të na hapë sytë për çështjet e organizimit e të shpërblimit të punës dhe për shumë çështje të tjera në kooperativat bujqësore. Ajo do të na saktësojë më mirë drejtësinë ose ato të meta që ka sot në punën e Partisë e të pushtetit për drejtimin e bujqësisë, për çështjet e prodhimit, të planifikimit, të financës, të llogarisë etj. në kooperativat.

Në çështjen e kooperativizmit ne kemi kaluar e po kalojmë nga një stad në tjetrin. Këto janë kapërcime cilësore. Përmirësimet dhe ndryshimet që bëjmë, i kërkon në mënyrë të natyrshme dhe absolute vetë zhvillimi i shoqërisë sonë socialiste, revolucionarizimi i prodhimit dhe i jetës në kooperativat bujqësore dhe në gjithë vendin. Nga pikëpamja e organizimit të punës e të prodhimit, fshati ynë socialist nuk mund të qëndrojë prapa qytetit; ai duhet të afrohet me qytetin dhe këtë afrim duhet ta bëjnë vetë njerëzit me punën e tyre,

me një organizim më të mirë të saj, gjë që kërkon në vetvete ngritjen ideopolitike të kooperativistit, revolucionarizimin e tij etj.

Afrimi i fshatit me qytetin nuk duhet kuptuar në mënyrë mikroborgjeze, sikur gratë dhe vajzat e fshatit, duhet t'i dredhin flokët njëlloj si ato të qytetit dhe t'i imitojnë ato në çdo gjë. Thelbi i dallimit midis fshatit dhe qytetit nuk qëndron këtu, po në konceptet dhe në mënyrën e punës së fshatarësisë sonë. Prandaj Partia duhet të punojë vazhdimisht për ngritjen ideopolitike të fshatarësisë, për ta bërë të ndërgjegjshme që të mendojë e të punojë në mënyrë revolucionare, që të jetë e disiplinuar, e rregullt dhe ta organizojë punën njëlloj si klasa punëtore. Vetëm kështu do të ecet me ritme të shpejta për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, do të shtohen të ardhurat e fshatarësisë dhe, si rrjedhim, do të vijë duke u ngushtuar gjithnjë e më shumë edhe dallimi që ekziston midis fshatit dhe qytetit. Afrimi i fshatit me qytetin, sipas mendimit tim, do të realizohet me zhvillimin dhe me revolucionarizimin e prodhimit në fshat, me organizimin e punës sipas shembullit të industrisë socialiste.

Si përfundim, unë mendoj që çështjet të cilat u diskutuan në këtë mbledhje të Sekretariatit të shërbejnë jo vetëm për shokët e Elbasanit, por për tërë kooperativat e vendit. Partia ta rishikojë më thellë çështjen e lopës dhe t'i japë një zgjidhje më të drejtë, të mos e nënvleftësojë këtë problem, por ta zbërthejë atë në të gjitha pjesët përbërëse, duke i dhënë secilës vendin dhe radhën që i përket. Pas kësaj pune ne do të



arrijmë me siguri suksese të reja si në zhvillimin e lo-pës, ashtu edhe në të gjitha degët e tjera të bujqësisë.

*Botuar për herë të parë  
me ndonjë shkurtim në  
librin: Enver Hoxha, «Ra-  
porte e fjalime 1970-1971».*

*Tiranë, 1972, f. 170*

*Botohet i plotë sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverbali  
i mbledhjes së Sekretariatit  
të KQ të PPSH, që gjendet  
në AQP*

# SIGURIMET SHOQËRORE PËR KOOPERATIVISTËT — HAP I RI PËR NGUSHTIMIN E DALLIMEVE NDËRMJET FSHATIT E QYTETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 janar 1971

Pavarësisht nëse do të vendosen apo jo sigurimet shoqërore për kooperativistët, sipas materialit që na paraqitet, natyrisht, duke i bërë edhe korrigjimet e duhura, studimi i bërë është i mirë dhe na vlen.

Shtrirja e sigurimeve shoqërore edhe për kooperativistët do të jetë një fitore tjetër e fshatarësisë sonë punonjëse dhe një sukses i rëndësishëm për sistemin tonë socialist. Kjo çështje, si një akt i madh me vlerë ekonomike, politike dhe ideologjike, do të jetë një nxitje e mëtejshme revolucionare për fshatarësinë tonë

---

1. Në këtë mbledhje, që mori në shqyrtim studimin për vendosjen e sigurimeve shoqërore në kooperativat bujqësore, shoku Enver Hoxha nuk mori pjesë, por ai e kishte përgatitur me shkrim diskutimin e tij, i cili u lexua gjatë zhvillimit të saj.

punonjëse, një hap i ri në afrimin e kushteve të jetesës së fshatit me ato të qytetit.

Në këtë problem ne duhet të na preokupojë shumë ana financiare, sigurimi i fondeve të nevojshme. Pra, duhet të gjykojmë mirë shkallën e arritjes së momentit ekonomik në të gjitha kooperativat e vendit, që ato të jenë në gjendje të derdhin fondet e nevojshme që u nevojiten për të siguruar dhënien e pensioneve. Kjo, mendoj unë, duhet të llogaritet në bazë të të ardhurave që shpërndahen për ditë-punë, në mënyrë që niveli i jetesës të mos ulet, përkundrazi ai të shkojë përherë në ngjitje; të parashikohen, gjithashtu, në çdo kohë, investimet e nevojshme për prodhimin dhe për riprodhimin e zgjeruar.

Ka propozim që pensionet dhe ndihmat e tjera të caktohen përnjëherësh, kudo dhe të njëjlojta. Edhe unë mendoj se, po të vendosim, ashtu duhet të bëhet. Por del nevoja që shteti në këtë fushë të subvencionojë. Ky subvencion duhet të matet në kuadrin e gjithë buxhetit shtetëror dhe veçanërisht në atë të investimeve të tjera të mëdha që rezervohen për bujqësinë.

Ne mund të ndjekim edhe një rrugë tjetër, atë që kemi thënë deri tani dhe që nuk është zbatuar: Siç shohim në raport, dhe siç do të them më poshtë, ne duhet të jemi më të rreptë në zbatimin e të gjitha direktivave që do të vendosim dhe përcaktimet që do të bëjmë mund të jenë të diferencuara për fushën dhe për malësinë.

Siç del nga raporti, fondi i ndihmës i caktuar mbi të ardhurat vjetore dhe mbi të ardhurat në natyrë nuk është derdhur plotësisht dhe fare pak është përdorur.

Edhe në shkallë republike ky fond mesatarisht është përdorur shumë pak. Nga të dhënat që jepen është karakteristike se rrethet më të pasura e kanë përdorur atë më pak, si, për shembull, Lushnja, Korça dhe Fieri. Sigurisht kjo ka ardhur mbasi direktiva ka qenë më tepër orientuese dhe e papërcaktuar me masa organizative dhe politike. Vetë kooperativat bujqësore akoma nuk kanë qenë ekonomikisht në gjendje t'i krijojnë këto fonde, sepse janë tërhequr më shumë nga sigurimi i ditëve të punës dhe i investimeve për riprodhimin e zgjeruar. Ato kanë menduar më pak se ç'do të bëhet më vonë me pensionet, kur anëtarët e kooperativës nuk do të jenë më të aftë për punë. Këto probleme të rëndësishme shoqërore, siç janë pensionet familjare, për pleqëri, për invaliditet etj., sigurimet për paaftësi të përkohshme në rast sëmundjeje, aksidenti, leje barre dhe lindjeje etj., është menduar të zgjidhen si më parë, në mënyrë patriarkale, sepse janë konsideruar si çështje personale e familjare dhe jo si probleme të rëndësishme shoqërore që duhen zgjidhur ashtu siç zgjidhen në një shoqëri të vërtetë socialiste. Prandaj mund të themi se ato që janë bërë deri tani, janë gjëra të vogla dhe fillestare. Tashmë ka ardhur koha që këtë problem ta aktivizojmë dhe ta vëmë në rrugë të drejtë.

Në caktimin e kriterëve për vendosjen e pensioneve e të ndihmave të tjera për kooperativistët të kemi parasysh eksperiencën nëpër të cilën kemi kaluar në këtë drejtim për sigurimet shoqërore e shtetërore të punëtorëve e nëpunësve, por pa i harruar specifikat e periudhave nga kemi kaluar.

**E para**, me punëtorët e nëpunësit kishim të bënim me sektorin shtetëror socialist të prodhimit dhe me nëpunës të aparateve dhe të administratave që kishin një rrogë bazë dhe një normë mbi të dhe asnjë të ardhur tjetër.

**E dyta**, numri i punëtorëve dhe i nëpunësve në fillim ishte relativisht i vogël, gjë që nuk e rëndonte ekonominë.

**E treta**, me gjithë këtë veçori, në fillim u caktua që mosha e daljes në pension për burrat të ishte 65 vjeç dhe për gratë 60 vjeç. **Këtë e bëmë me qëllim që të kishim më pak pensionistë e më shumë njerëz në punë, pse atdheu që sa doli nga lufta kishte nevojë të rindërtohej.**

**E katërta**, për shkak të kushteve të vështira ekonomike në fillim masën e pensionit e caktuam relativisht të ulët, 33 për qind të pagës dhe pastaj e rritëm gradualisht deri në 70 për qind, sa është sot. Natyrisht duhet të bëhen vazhdimisht studime e krahasime në raportin e pagave e të pensioneve, por ky është një problem tjetër.

Tash, kur të vijmë në përcaktimin e kriterëve të pensioneve të kooperativistëve mendoj të kemi parasysh:

**1. — Fondet kryesore për pensionet duhet t'i krijojnë vetë kooperativat bujqësore.** Subvencionin e shtetit duhet të jetë sekondar e terciar dhe, natyrisht, do të caktohet në bazë të mundësive që lejon buxheti i shtetit që edhe tani është i rënduar shumë nga gjithë ato ngarkesa që ka në kuadrin e të tëra investimeve.

Për periudhat e para mendoj se kooperativistit i

takon të paguhet nga subvencionet e shtetit dhe jo nga fondet e kooperativës.

2. — Kooperativat bujqësore janë pronë shoqërore e grupit, prandaj kooperativisti, që aktualisht ka oborrin për shfrytëzim personal dhe bagëtitë e shtëpinë pronë personale, s'mund të ketë të njëjtin trajtim në fushën e sigurimeve shoqërore shtetërore siç e ka punëtori i ndërmarrjes bujqësore, i cili s'ka tjetër të ardhur veç rrogës që merr.

3. — Kooperativisti s'ka rrogë të caktuar, siç e ka punëtori dhe nëpunësi. Pavarësisht nga modalitetet se si do t'i caktohet pensioni, për masën e pensionit kooperativisti nuk do të trajtohet si punëtori dhe nëpunësi, pse këtyre, sa më tepër afrohet koha e daljes në pension, aq më tepër u ngrihet rroga, pavarësisht se i lënë forcat fizike. Kurse kooperativisti, në vitet e fundit ku do t'i caktohet masa e pensionit, dobësohet fizikisht dhe mund të bëjë ditë-punë më pak se përpara etj., pa folur pastaj për faktorët atmosferikë që mund të influencojnë në përgjithësi në sigurimin e fondit të përgjithshëm.

4. — Megjithëse koha e vjetërsisë në punë për marrjen e pensionit do të fillojë nga krijimi i kooperativës, tani për tani numri i pensioneve të plota të pleqërisë do të jetë i vogël. Por, qoftë pensionet e plota që do të shtohen gradualisht, qoftë ato të pjesshmet, do të jenë shumë më të mëdha në numër nga numri i pensionistëve të punëtorëve e të nëpunësve.

5. — Megjithëse kriteret për pensionet dhe ndihmat e tjera që do të caktohen për fshatarësinë do të jenë të njëjlojta për gjithë vendin, pavarësisht nga for-

ca ekonomike e ndryshme e kooperativave, fondi që do të caktojë çdo kooperativë për to, nuk mund të jetë i njëllojtë, gjë që do t'i rëndonte ekonomikisht kooperativat më të dobëta.

Po t'i kemi parasysh këto që përmenda, investimet e mëdha që po bëjmë në çdo pesëvjeçar, si dhe mungesën e disa prodhimeve bujqësore e industriale të përdorimit të gjerë, të shikohet se mos bëhet shumë preokupant problemi i qarkullimit të monedhës.

Investimet e mëdha që do të bëjmë do të grumbullojnë një fuqi punëtore të madhe që për pesë vjet me radhë do të ndërtojë e do të mësojë, por nuk do të prodhojë. Kjo forcë e madhe njerëzish, do të paguhet, do të ushqehet e do të vishet. Mirëpo, në rast se nuk i përcaktojmë mirë që në fillim kriteret e pensioneve të kooperativistëve, mund të na ndodhë fenomeni negativ që kooperativisti, duke marrë pensionin në moshën 60-vjeçare nuk punon më në kooperativë, por vazhdon punën në oborrin personal. Sidoqoftë, del ose jo në pension, kooperativisti, në oborrin personal ai përsëri do të punojë. Çështja është se pension të pjesshëm do të marrë një shumicë fshatarësh që aktualisht konsumojnë, por që ligjërisht, meqenëse kanë mbushur moshën 60 ose 65 vjeç, nuk janë më të aftë për punë. Por, kjo gjë mund të përbëjë një barrë financiare, e cila mund të jetë e ndjeshme për ekonominë tonë, sidomos në këta 5 ose 7 vjetët e ardhshëm, sa të kemi fuqizuar industrinë dhe bujqësinë dhe të kemi stabilizuar akoma më mirë rendimentet e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Edhe caktimi i masës së pensionit ka rëndësi. Por

që ta caktojmë që tash atë për periudhën pas dhjetë a më shumë vjetësh, kjo mund të jetë si tepër e shpejtuar. Vetë zhvillimi do të na këshillojë për vendime më të drejta dhe për korrigjimin e ligjit bile edhe për sigurimet shoqërore shtetërore të punëtorëve e nëpunësve. Prandaj të mos i fluturojmë etapat me kalem, po t'i shkelim me këmbë dhe t'i krijojmë kushtet me punë. Tani t'i përcaktojmë gjërat shumë të përafërta që t'i realizojmë dhe jo t'i shpallim e të na dalin vesh-tirësi më vonë.

Çështja e pensionit të invaliditetit për kooperativistët është delikate, pse kërkon një kontroll më të fortë mjekësor. Për vetë natyrën e punës bujqësore, ky lloj pensioni duhet të jetë shumë i kufizuar, pse, po të futen në «sëmundje profesionale» çfarëdolloj sëmundjesh që mund të kapin njeriun, ose çdo aksident që nuk ka lidhje me punën, atëherë në bujqësi pensioni i invaliditetit s'do të ketë mbarim. Për këtë arsye kur flitet në raport për «sëmundje të përgjithshme» duhen përcaktuar mirë për t'u bërë i qartë dallimi i tyre prej sëmundjeve të mirëfillta profesionale.

**Mbi përcaktimin e vjetërsisë në punë për efekt pensioni:**

1. — Njohja si e vlefshme për pension e kohës së plotë të pjesëmarrjes në Lëvizjen Nacionalçlirimtare është shumë e papërcaktuar. Po të pranohet kështu, atëherë duhet të përfshihen automatikisht gati të gjithë fshatarët që në kohën e luftës ishin nga 15 vjeç e lart. Edhe pjesëmarrja në këshillat nacionalçlirimtarë duhet menduar mirë, kurse kohën e pjesëmarrjes me armë në radhët e reparteve partizane të Ushtrisë Na-



cionalçlirimtare, që e kemi pranuar për të tjerët, duhet ta njohim edhe për kooperativistët.

2. — Jam dakord që të njihet e vlefshme për pension koha e kaluar në shërbimin ushtarak aktiv. Po kështu, edhe koha e kaluar në punë me pagë si punëtor ose nëpunës në ndërmarrjet, në institucionet dhe në organizatat shoqërore.

3. — Edhe koha e paaftësisë së përkohshme për punë gjatë përdorimit të lejes së barrës dhe të lindjes duhet të njihet e vlefshme për pension.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TË NGRIHET NË NJË NIVEL MË TË LARTË  
SHËRBIMI SHËNDETËSOR, SIDOMOS  
PROFILAKSIA DHE HIGJIENA**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 11-të të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 janar 1971

Në fund dëshiroj të flas pak edhe unë për problemin e përmirësimit të mëtejshëm të shëndetit të popullit.

Ne, shokë, në këtë mbledhje me rëndësi të madhe të Plenumit të Komitetit Qendror, dëgjuam raportin e Byrosë Politike të mbajtur nga shoku Adil Çarçani. Edhe unë jam i një mendimi me të gjithë shokët që diskutuan në këtë Plenum se problemi që shqyrtuam është i një rëndësie të veçantë, ai ka të bëjë me ngri-

---

1. Më 25 dhe 26 janar 1971 u mbledh Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili shqyrtoi dhe miratoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për ta ngritur në një nivel më të lartë shërbimin shëndetësor, sidomos profilaksinë dhe higjienën», mbajtur nga shoku Adil Çarçani, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.

tjen në një nivel akoma më të lartë të shërbimit shëndetësor. Raporti i Byrosë Politike për këtë problem duhet t'u shërbejë Partisë, pushtetit, mbarë popullit dhe në mënyrë të veçantë gjithë institucioneve shëndetësore, me Ministrinë e Shëndetësisë në krye, për të organizuar më mirë se deri tani punën, sidomos për forcimin e masave profilaktike, higjienike e sanitare, të cilat do të ndihmojnë për mënjanimin në një shkallë sa më të madhe të sëmundjeve që prekin fëmijët, punonjësit, masat e popullit tonë.

Ky Plenum ishte shumë i nevojshëm të bëhej. Rreth raportit të Byrosë Politike diskutuan anëtarë Plenumi, shokë të tjerë partie dhe punonjës të paorganizuar në Parti, folën me kompetencë të plotë mjekë dhe drejtues të institucioneve shëndetësore, të cilët bënë sugjerime e propozime të vlefshme, të domosdoshme dhe shumë të mundshme për t'u realizuar. Ata kritikuan rreptë me të drejtë shumë mungesa e dobësi që ekzistojnë në këtë sektor jetik, të cilat do të ishte mirë të ishin luftuar e të ishin zhdukur me kohë. Që këto të mos përsëriten më në të ardhmen, është detyrë për të gjithë që këtej e tutje, si shtruarja e problemeve që kanë të bëjnë me shëndetin e popullit, ashtu edhe me marrjen e masave organizative që kanë lidhje me to dhe ndjekja e tyre, të bëhen në një formë më të gjallë e revolucionare. Një mënyrë e tillë pune do të na shërbejë për t'u shkuar çështjeve deri në fund, deri në zgjidhjen e tyre të plotë. E vërteta është se ka akoma probleme që ngecin, zvarriten e nuk zgjidhen në kohën e duhur, jo se nuk ekzistojnë mundësitë, por më shumë për mungesë organizimi, iniciative dhe për

mjaft të meta të tjera, që nuk janë aspak të pakapërcyeshme.

Kur të punojmë materialet e këtij Plenumi në Parti, në popull e veçanërisht në institucionet shëndetësore, si në spitale, klinika, çerdhe etj., të kemi kujdes që të ndihmojmë dhe të nxitim sa më shumë mendimin krijues të njerëzve. Gjatë kësaj pune, të mos kufizohemi vetëm me kritikën e të metave, të mungesave e të dobësive që kanë ekzistuar deri tani, por të mendojmë njëkohësisht për shfrytëzimin e të gjitha mundësive ekzistuese ose të tjera që mund dhe do t'i krijojmë vetë në të ardhmen për ruajtjen dhe për përmirësimin e mëtejshëm të shëndetit të popullit. E kam fjalën që punonjësit e institucioneve shëndetësore ose organet e tyre drejtuese, të mos anojnë më shumë në radhitjen e një sërë kërkesash për organet e pushtetit, por të reflektojnë që, atje ku ekzistojnë mundësitë, të krijojnë e të prodhojnë vetë shumë gjëra, duke hequr kështu nga listat e kërkesave ndaj qendrës dhe importit të gjitha ato që vërtet duhen, por që mund t'i bëjmë me forcat dhe me mundësitë tona.

Në vendin tonë ndërtohet socializmi, prandaj Partia dhe Qeveria u kushtojnë kujdes të dorës së parë mirëqenies dhe lumturisë së masave të popullit. Kjo mirëqenie e kjo lumturi nuk mund të kuptohen pa njerëz me shëndet të mirë. «Shëndeti në radhë të parë», thotë me të drejtë një fjalë e urtë e popullit. Të gjithë e kemi të qartë se çdo punë e Partisë dhe e pushtetit popullor, gjithë veprimtaria e tyre, përmban në vetvete atë synim të madh që njeriu te ne të gëzojë shëndet të mirë, që të jetë në gjendje të punojë dhe

të prodhojë në dobi të shoqërisë, të familjes, të vetvetes, të jetë i aftë të mbrojë kurdoherë nga çdo armik atdheun dhe fitoret e arritura, të jetojë i lumtur dhe i gëzuar. Ky është qëllimi më i lartë i Partisë. Dhe në këtë drejtim një transformim rrënjësor është bërë deri sot në vendin tonë dhe çdo ditë e vit që kalon sjell fitore të reja gjithnjë e më të mëdha, krijon kushte përherë e më të mira, si në përmirësimin e jetës së popullit ashtu edhe në forcimin e shëndetit të tij.

Në vendet ku sundon kapitalizmi ndodh krejt e kundërta. Atje, si për çdo gjë, edhe për çështjen e shëndetit, borgjezia vepron në interes të saj, të pronës private, duke shfrytëzuar masat punonjëse. Megjithatë, nën presionin e një lufte të ashpër, të gjatë e të vazhdueshme klasore nga ana e proletariatit revolucionar kundër borgjezisë kapitaliste, edhe në këto vende janë marrë disa masa shëndetësore dhe sigurimi shoqëror, por në fakt ato nuk e kanë atë karakter të vërtetë social, atë gjerësi, atë thellësi dhe kuptim të drejtë politik-ideologjik si te ne. Për pasojë këto masa nuk kanë as atë efekt të dobishëm ekonomik dhe shëndetësor në favor të masave punonjëse si në vendin tonë. Në vendet kapitaliste punëtori «skllav» i fabrikës, ose bujku «skllav» i tokës së fermerit, kur sëmuret, e ka zor të shohë derën e spitalit apo të klinikës, të furnizohet me barna, pa lëre pastaj të kurohet apo të bëjë një operation, sepse të gjitha këto i kushtojnë atij jashtëzakonisht shumë, i kushtojnë, siç thotë populli «qimet e kokës». Një sëmundje për punëtorin apo për fshatarin e varfër, qoftë edhe të mesëm, në cilindo vend kapitalist, sado i zhvilluar që të jetë ai, është me të vërtetë

një nga fatkeqësitë më të rënda në jetën personale dhe të familjes së vet, për arsye se atje mbi njeriun dhe nevojat e tij vihet fitimi, prandaj, duke filluar që nga vizita te mjeku, shtrimi në spital, një ndërhyrje kirurgjikale, duke përfshirë edhe ato urgjentet e më të domosdoshmet për të shpëtuar jetën e të sëmurit, shërbimi dhe deri të gjitha barnat, janë të tëra me para në dorë dhe shumë të shtrenjta. Shpenzime të tilla është e pamundur të përballohen nga masat e gjera të varfra të popullit. Prandaj, merret me mend ç'përfundim tragjik e pasiguri e pret njeriun pas një fatkeqësie të tillë. Këtë gjendje ne, më të moshuarit, e kemi pak a shumë më të qartë, se e kemi jetuar vetë deri në pragun e Çlirimit të atdheut. Duke mos pasur mundësitë për kurim, njeriu që sëmuret në një vend kapitalist, e ka të vështirë të shërohet. Kështu, në shumë raste, për mungesë asistence mjekësore, ai vdes, ose, edhe po të shërohet, shëndeti i tij gradualisht dobësohet, njeriu bëhet i paaftë, prandaj rrezikohet të mbetet pa punë e pa të ardhura, me një fjalë rron me një perspektivë të errët, në pasiguri, në varfëri e në kushte të vështira me gjithë familjen.

Shkenca mjekësore në disa nga vendet kapitaliste ka bërë përparime të mëdha, atje ka shkencëtarë, profesorë e mjekë të shquar, ka spitale dhe klinika të mëdha, por të gjitha këto mundësi nuk janë për njerëzit e thjeshtë, për punëtorët, për të varfrit, po vetëm për ata që kanë të paguajnë, pra për të pasurit. Jo vetëm në kontinente të tëra masat e popullit vuajnë nga sëmundje të ndryshme të përhershme dhe kohë pas kohe edhe nga sëmundje epidemike të rënda për

mungesë të mjekëve dhe të mjeteve të shërimit, po edhe në vendet më të zhvilluara kapitaliste, ku këto munde si ekzistojnë në një nivel të lartë, përfitojnë prej tyre kryesisht shfrytëzuesit, klasat sunduese që rrojnë në kurriz të punëtorëve e të fshatarëve. Realizimet e mëdha të mendjes së njeriut, si në çdo fushë edhe në atë të mjekësisë, në vendet kapitaliste përdoren për qëllime tregtare, për pasurimin e borgjezisë në fuqi. Në këto vende flitet shumë për humanizëm, po kjo është vetëm gënjeshtëri. Si mund të bëhet fjalë për humanizëm në vendet kapitaliste kur kriza dhe papunësia janë të pandara nga jeta e shoqërisë, kur masat e gjera të popullit vuajnë nga uria, pikërisht në një kohë kur kapitalistët hedhin poshtë, ose lënë të kalben gjithfarë produktesh që të mos u bjerë çmimi etj., etj., pa folur pastaj për masat shtypëse si vrasjet, arrestimet e burgosjet e punëtorëve, të fshatarëve e të njerëzve përparimtarë që luftojnë për përmirësimin e kushteve të jetesës në vendet e tyre, apo për agresionet barbare kundër lirisë e pavarësisë së popujve? Vetëm nga këto që thashë e që përbëjnë një pasqyrë shumë të kufizuar të të këqijave të jetës në vendet ku sundon borgjezia, s'është e zorshme të kuptohen shpejt falsiteti dhe demagogjia e deklaratave për «humanizëm» në sistemin kapitalist. Në vendin tonë, të mos zgjatemi, ndodh krejt e kundërta.

Në këtë Plenum të Komitetit Qendror shtruan e diskutuan shumë probleme të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe me ruajtjen e shëndetit të popullit. Këtej del e nevojshme të nxjerrim edhe detyra të shumta e të mëdha, të cilat duhet t'i kuptojnë

drejt dhe t'i zgjidhin një nga një në kompleksitetin e tyre Ministria e Shëndetësisë, Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit, spitalet, klinikat dhe të gjitha institucionet shëndetësore të vendit. Për këtë qëllim, ato duhet të bëjnë më parë analizën shkencore të punës së gjer-tanishme dhe të konkretizojnë detyrat e tyre për një përmirësim rrënjësor të shërbimit shëndetësor.

Problemet që kemi përpara për të zgjidhur duhen parë jo vetëm nga ana praktike, por, siç u shprehën këtu specialistët e mjekësisë dhe shokë të tjerë që morën fjalën, ato duhen studiuar sidomos nga ana shkencore. Organizimit më të mirë të punës në drejtim të studimeve shkencore e kërkimore, veçanërisht kundër sëmundjeve infektive, sëmundjeve të fëmijëve dhe atyre profesionale, duhet t'i jepet këtëj e tutje një rëndësi më e madhe. Për realizimin e këtij qëllimi është e nevojshme të bëhen më shumë përpjekje për të përfutuar sa më tepër edhe nga eksperiencia botërore e mirë, e madhe në fushën e shkencës mjekësore, duke e zbatuar e duke e plotësuar atë si duhet me eksperiencën tonë të fituar deri sot në kushtet e Shqipërisë.

Është e domosdoshme të merren masa të gjithanshme, sidomos për kualifikimin e kuadrove shëndetësore, që nga mjekët, ndihmësmjekët, mamitë, infermieret e deri te punonjëset më të thjeshta të çerdheve e të qendrave shëndetësore, numri i të cilëve vjen gjithnjë duke u rritur dhe shpërndarja e tyre shtrihet çdo vit e më shumë deri në fshatrat e zonave më të thella të vendit. Kualifikimi i vazhdueshëm i gjithë kësaj mase të madhe specialistësh e punonjësish që kemi sot në sektorin e shëndetësisë, në disa raste të



përgatitur me shpejtësi dhe jo në nivelin e duhur tek-niko-profesional, për arsye të nevojave të ngutshme që janë paraqitur, do të ketë disa vështirësi e kërkon një punë të madhe e të organizuar mirë, por nuk duhet të jemi pesimistë. Të dhënat tregojnë se shumica e tyre dërrmuese janë kuadro të mirë e të ndërgjegjshëm për detyrën shumë delikate që u është besuar, veç del nevoja të merren, pa vonesë, masa serioze për një kualifikim të mëtëjshëm. Duhet punuar në këtë drejtim jo vetëm për ngritjen e nivelit të kuadrit me arsim të lartë shëndetësor, po edhe për gjithë personelin tjetër, duke përfshirë edhe atë të çerdheve, me qëllim që të ngrihen të gjithë në lartësinë e detyrës së ngarkuar e ta kryejnë atë në një nivel të kulturuar dhe sa të jetë e mundur gjithnjë e më shkencor. Vetë kuadri mjekësor është e domosdoshme të bëjë përpjekje të vazhdueshme e të palodhshme individuale për të ngritur çdo vit e më lart nivelin e tij ideopolitik, shkencor e profesional, ndryshe detyra nuk mund të kryhet si duhet.

Sot ne kemi në radhët e punonjësve të shëndetësisë jo vetëm njerëz të zotë, të përgatitur mirë nga ana shkencore e profesionale, por edhe me një ngritje politiko-ideologjike të lartë, të lidhur ngushtë me popullin, të papërtuar asnjëherë, kurdoherë të gatshëm për t'i shërbyer atij sa më mirë dhe për të bërë çdo sakrificë për të. Janë këto veti me të cilat i ka pajisur Partia, që i bën ata të qëndrojnë në një nivel shumë më të lartë nga pikëpamja e ndërgjegjes dhe e misionit humanitar sesa mjekët e vendeve kapitaliste.

Por, për të forcuar akoma më shumë ndërgjegjen

socialiste dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në punë të mjekëve dhe të gjithë punonjësve të shëndetësisë sonë popullore, është e domosdoshme që Partia të zhvillojë një punë edukative më të organizuar, serioze, sistematike dhe të vazhdueshme me ta. Edukimi ideopolitik dhe kalitja revolucionare e njerëzve të shëndetësisë do t'i bëjë ata që të jenë të papajtueshëm me disa shfaqje intelektualiste që duken aty-këtu në radhët e tyre, siç janë: egoizmi profesional, familjariteti, liberalizmi, teknokratizmi etj. Lufta kundër këtyre shfaqjeve të huaja do ta ngrejë akoma më lart figurën e punonjësit të shëndetësisë popullore te ne.

Organet e shëndetësisë sonë kanë akoma shumë për të bërë në drejtim të një organizimi më të mirë të punës dhe për një përmirësim cilësor të dukshëm të shërbimit ndaj popullit. Për këtë qëllim është e domosdoshme të rriten në një shkallë më të madhe aftësitë organizuese jo vetëm të drejtuesve, por edhe të krejt personelit mjekësor. Në këtë drejtim organizatat-bazë të Partisë dhe, nën udhëheqjen e tyre, punonjësit e shëndetësisë, kurdoherë që konstatojnë shkelje të normave që rrezikojnë jetën e njerëzve, të ndërhyjnë energjikisht dhe t'i vënë në vend ato. Lëshimet dhe pakujdesitë në këtë drejtim duhen dënuar rreptë. Është detyrë e gjithë mjekëve dhe e punonjësve të shëndetësisë ta rritin më shumë kujdesin për njerëzit që paraqiten për t'u vizituar në ambulanca, në spitale ose në institucione të tjera shëndetësore, apo edhe për t'u shtruar. Njerëzit tanë, që drejtohen në to, duhet të gjejnë një ambient pritjeje të përzemërt dhe një gatishmëri shembullore në shërbim. Është i palejueshëm dhe

i huaj për ne qëndrimi arrogant dhe i ftohtë i ndonjërit prej personelit të këtyre institucioneve me të sëmurët, pakujdesia në dhënien e barnave, ose mungesa e një shërbimi të shpejtë e të ndërgjegjshëm ndaj tyre. Spitalet dhe gjithë institucionet tona shëndetësore, krahas kërkesave për zbatimin me rreptësi dhe me disiplinë shkencore të porosive të mjekëve nga ana e të sëmurëve, duhet të karakterizohen edhe nga një disiplinë e fortë në punë e personelit, nga përpikëria në detyrë dhe niveli i lartë i higjienës e i shërbimit, për t'u ardhur në ndihmë me devocion të sëmurëve, në mënyrë të veçantë fëmijëve, pleqve dhe të sëmurëve rëndë, që s'janë në gjendje të vetëshërbehën. Një qëndrim i ndërgjegjshëm dhe aktiv duhet ta karakterizojë personelin e shëndetësisë kudo ku ka grumbullime të mëdha njerëzish, në qytet dhe në fshat, në çerdhe, në kopshte, në shkolla dhe në lokalet ku përgatiten apo tregtohen ushqime për popullin, duke kërkuar nga të gjithë zbatimin me rreptësi dhe pa asnjë lëshim të normave higjieniko-sanitare dhe të pastërtisë në çdo gjë. Mendja, zemra dhe sytë e mjekëve duhet të jenë kudo ku është njeriu ynë, i cili dëshiron të rrojë e të punojë i gëzuar e i lumtur dhe ta japë jetën vetëm në emër të atdheut, të popullit e të Partisë.

Po është e domosdoshme të kuptohet mirë nga të gjithë se problemi i ruajtjes së shëndetit nuk është një çështje që u përket vetëm mjekëve dhe personelit të institucioneve shëndetësore, po një problem shumë kompleks dhe ka të bëjë me një edukatë të vazhdueshme, që duhet fituar me një punë të palodhshme e

këmbëngulëse nga të gjithë. Ai është një problem për të cilin është i interesuar vetë çdo individ, është një problem familjar, është njëkohësisht problem i madh shtetëror dhe shoqëror, ku vihet në jetë plotësisht parulla: «Të gjithë për një e një për të gjithë».

Çdo njeriu te ne i vihet detyrë të kujdeset që ta ruajë përditë shëndetin e vet po të jetë e mundur në atë nivel që të drejtohet sa më rrallë te mjeku për t'u vizituar, ose për t'u shtruar në spitale. Spitale tani ne kemi kudo dhe ato do t'i shtojmë, do t'i modernizojmë, do t'i specializojmë në një shkallë më të lartë dhe do të përpiqemi t'i ndërtojmë gjithnjë e më shumë afër masave. Por, me gjithë shpenzimet që do të bëjmë çdo vit e më shumë në këtë drejtim, dëshirojmë që ato të mos jenë kurrë plot, përkundrazi, me punën e gjithan-shme edukative dhe me masat profilaktike që do t'i rritim vazhdimisht, të bëjmë që numri i të sëmurëve të shtruar në to, të vijë vazhdimisht duke u ulur. Dhe kësaj do t'i arrihet kur çdo njeri do të zbatojë me këmbëngulje të gjitha masat profilaktike, të nevojshme për ruajtjen e shëndetit të vet, të familjes, me respektimin me rreptësi të rregullave higjienike kudo, në çdo ambient ku njeriu jeton dhe punon.

Por ne duhet t'i edukojmë njerëzit që te mjeku, apo në institucionet shëndetësore, të mos drejtohen vetëm kur sëmuren, po, herë pas here, të venë për t'u konsultuar e për t'u vizituar edhe kur e ndiejnë veten mirë, në mënyrë që çdo defekt në organizëm të zbulohet me kohë, para se ai të japë shenja shqetësimi e dhimbjeje. Kështu do t'u pritët rruga sëmundjeve. Organizimi i vizitave të punonjësve në periudha të

caktuara dhe mbajtja e rregullt e evidencave dhe e kartelave shëndetësore është me vend të fillojë gradualisht të organizohet dhe të zbatohet dhe kjo praktikë, me karakter profilaktik, të shtrihet kudo krahas me rritjen e numrit të kuadrove mjekësorë. Shumë të papritura të dëmshme për shëndetin mund të mënjanohen, në rast se zbatohet një vetëkontroll dhe vetëvendosje për zbatimin e normave, në rast se kujdesemi të bëjmë një jetë të rregullt dhe të mos abuzojmë, jo vetëm në disa drejtime që dihet prej të gjithëve se janë të dëmshme, si pirja e alkoolit, e duhanit, por edhe në shumë të tjera, siç është respektimi i regjimit të ushqimit, të jetesës, të punës etj. Është e qartë për të gjithë se shumë sëmundje profesionale dhe aksidente në punë mund të evitohen me një kujdes më të madh nga ana e çdo punonjësi, që ai të punojë e të jetojë më gjatë, i gëzuar dhe optimist. Në këtë drejtim organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave dhe përgjegjësit e punës e kanë për detyrë të jenë shumë ekzigjentë në respektimin me rreptësi të rregullave të sigurimit teknik dhe të të gjitha kërkesave të tjera, nga nënvleftësimi i të cilave rritet numri i atyre që preken nga paaftësia e përkohshme në punë ose bëhen invalidë.

Në shëndetin e njeriut ndikon shumë, gjithashtu, mbajtja e higjienës personale dhe e ambientit ku ai punon dhe jeton. Mirëpo ka akoma njerëz që nuk mbajnë pastër as trupin, as ambientin brenda e jashtë shtëpisë ose të vendit të punës. Natyrisht kjo ka të bëjë shumë edhe me nivelin kulturor të njerëzve, po këtë çështje ne s'mund t'ia lëmë spontancitetit. Partia, orga-

nizatat e masave, punonjësit e shëndetësisë dhe të arsimit etj. e kanë për detyrë të punojnë shumë në këtë drejtim. A duhet ta lejojmë ne, shoqe dhe shokë, papastërtinë që ekziston akoma në mjaft njerëz, në disa lokale dhe fshatra të vendit tonë? Partia dhe komunistët, punonjësit e arsimit e të shëndetësisë që jetojnë pranë tyre, e kanë për detyrë jo vetëm të bëhen shembull në mbajtjen e pastërtisë dhe në respektimin e normave të higjienës në veten dhe në familjen e tyre, në qendrat e punës e kudo, po njëkohësisht të punojnë pa u lodhur për të rrënjosur tek të gjithë, pa përjashtim, shprehinë për respektimin e disa kërkesave shumë të thjeshta në jetën e përditshme. E tillë është, fjala vjen, kërkesa që askush të mos ulet të hajë pa larë më parë duart. Ne duhet të rrënjosim, gjithashtu, tek të gjithë kërkesën e domosdoshme elementare që secili të lahet të paktën një herë në javë, që të lajë këmbët dhe ndërresat e brendshme të trupit medoemos të paktën dy herë në javë, në mos më dendur. Pa i bërë shprehë të jetës sonë të përditshme të tilla kërkesa si këto, aspak të vështira për t'u zbatuar, nuk do të kemi shëndet të mirë dhe nuk do të jemi sa duhet të aftë për punë.

Çfarë na mungon, shoqe dhe shokë, për t'i respektuar këto rregulla kaq të thjeshta të jetës së përditshme? A nuk kënaqet njeriu vetë kur pas punës, para se të çlodhet në familje, apo të dalë në shoqëri, të pastrohet, të lahet, të ndërrohet, të krihet, t'i ketë rrobat e këpucët të pastra? Çfarë do të na duhet të harxhojmë për këto kërkesa të domosdoshme të njeriut që jeton në socializëm? Asgjëkafshë, veç ujë, sapun

dhe më shumë përpjekje për t'u dhënë fund një herë e mirë atyre koncepteve prapanike që zotërojnë akoma në mendjen dhe në jetën e disave prej njerëzve tanë. Ç'është kjo pakujdesi për higjienën e pastërtinë? Ç'është ky dembelizëm në disa njerëz në drejtim të shëndetit? Duhet të vazhdojmë ne t'i lejojmë këto njolla në jetën e vendit tonë? Në asnjë mënyrë jo! Këto nuk janë çështje të vogla dhe personale, po probleme të mëdha shoqërore. Partia duhet ta marrë në dorë mirë këtë problem të rëndësishëm dhe ta zgjidhë deri në fund, sidomos tani që janë krijuar kudo kushte për rritjen e nivelit të higjienës dhe të pastërtisë. Ngritja e objekteve socialkulturore deri në kooperativat bujqësore më të largëta është një sukses i madh, po ato duhet të shfrytëzohen plotësisht, ashtu siç ndodh në disa fshatra të rrethit të Gjirokastrës, ku kapaciteti i banjave të porsangritura është bërë qysh tani i pamjaf-tueshëm nga frekuentimi i rregullt që u bëjnë atyre burrat dhe gratë, fëmijët, të rinjtë dhe të rejat dhe ky është një shembull që duhet ndjekur nga të gjithë. Dihet se mikrobet, që rrezikojnë shëndetin e njerëzve tanë, rrojnë e zhvillohen në papastërti, prandaj kësaj t'i hapim një luftë të pamëshirshme që bëhet vetëm me të larë, me pak punë, me ujë dhe me sapun.

Këtu u fol edhe për luftën që i duhet bërë prirjes së disa njerëzve për të mbushur shtëpitë me sa më shumë mobilie të rënda e voluminoze. Është e drejtë ajo që u tha se duhet të rrojmë e të vishemi thjesht, por ja që ka njerëz që synojnë të mbushin dhomat e shtëpisë me kolltuqe, me rafte e me dollapë të tepërt, që të vënë në dritare perde mbi perde që as hapen

fare, u marrin frymën njerëzve, pengojnë të hyjë dielli dhe të qarkullojë ajri i pastër në dhomat e tyre. Këto dëshira tregojnë jo vetëm mungesë thjeshtësie te këta njerëz, por njëkohësisht ato janë të dëmshme edhe për shëndetin e pjesëtarëve të familjeve të tyre. T'u bëhet e qartë, veçanërisht, njerëzve me të tilla prirje, që të arrijnë të kuptojnë nevojën që nëpër shtëpitë e tyre të hyjë sa më shumë ajër, dritë dhe diell, që dhomat të jenë të pajisura në mënyrë të hijshme, por thjesht. Të gjitha këto që përmenda, është nevoja t'i kuptojnë komunistët më parë, pastaj në shembullin e tyre masat e popullit.

Në të gjitha këto drejtime sidomos Shtëpia e Arsimit Shëndetësor duhet të zhvillojë një veprimtari të madhe propagandistike sanitare, jo vetëm në Tiranë, po në gjithë Shqipërinë. Ajo duhet të arrijë që të futë në shpirt të masave punonjëse, të fshatit e të qytetit, ato njohuri aq shumë të nevojshme për shëndetin e tyre që drejt u theksuan këtu, sidomos nga mjeku Zisa Cikuli<sup>1</sup>, që e trajtoi më shumë këtë problem në diskutimin e tij. Propaganda jonë shëndetësore duhet të tërheqë vazhdimisht vëmendjen e të sqarojë njerëzit tanë për çdo gjë që rrezikon shëndetin e masave punonjëse, që të luftohet në kohë çdo neglizhencë në drejtim të shkeljeve të porosive e të vendimeve të Partisë për zbatimin e normave të domosdoshme që kanë të bëjnë me ruajtjen e shëndetit. Në përhapjen e propagandës shëndetësore kërkohet të kontribuojnë të

---

1. Në atë kohë drejtor i Shtëpisë së Arsimit Shëndetësor në Tiranë.



tërë punonjësit e shëndetësisë, sepse kjo është një detyrë e tyre e dorës së parë. Prandaj, krahas punëve të tjera, ata nuk duhet të lënë pas dore për t'u dhënë masave ato njohuri shkencore mjekësore elementare, të domosdoshme që u duhen njerëzve për të vepruar vetë e për të marrë masat përkatëse për mbrojtjen e shëndetit të tyre. Kjo propagandë duhet të jetë shumë e efektshme, që punonjësit ta kuptojnë mirë nevojën për ruajtjen e shëndetit. Për t'ia arritur qëllimit propaganda duhet të jetë e thjeshtë dhe intensive, ta rrethojë njeriun kudo ku ai jeton dhe punon, ta bëjë të ndër-gjegjshëm për rreziqet që i kërcënojnë shëndetin, në rast se nuk kujdesemi për mbrojtjen e tij. Kjo propagandë të hyjë familje më familje, pjesëtarët e së cilës e kanë për detyrë të kujdesen të gjithë për njëri-tjetrin, pse me shëndet të plotë jeta në këtë celulë të shoqërisë do të bëhet e këndshme dhe e lumtur. S'ka njeri që të mos ketë provuar se sa shqetësime kanë pjesëtarët e familjes, kur njëri prej tyre vuan nga ndonjë sëmundje. Megjithëse te ne, kur sëmuret njeri, familja nuk ka asnjë preokupacion material, pse mjekimi është falas për të gjithë dhe punonjësit përfitojnë nga ndihma e sigurimeve shoqërore, prapë nuk mund të ketë gëzim e qetësi shpirtërore në familje kur ndonjëri vuan. Prandaj kuptohen detyrat që i takojnë në këtë drejtim edhe familjes si kolektiv i vogël.

Kur flasim për profilaksinë, kemi kurdoherë parasysh nevojën e marrjes të të gjitha masave të nevojshme praktike dhe shkencore që shmangin sëmundjet dhe ndihmojnë zhvillimin normal të organizmit të njeriut në të gjitha fazat e jetës së tij, duke filluar që

kur ky konceptohet, pastaj pas lindjes, gjatë kalimit në moshën e vogëlisë, në moshën e re, në moshën e pjekurisë, në atë të pleqërisë dhe derisa vdes. Për secilën nga këto faza ekziston edhe profilaksia përkatëse. Në çdo periudhë të jetës së njeriut ekzistojnë gjithfarë rreziqesh që i turren organizmit dhe prekin në mënyrë të veçantë, sidomos disa organe kryesore, dobësimi i të cilave ndikon shumë mbi të tjerat, gjë që shpejton procesin e konsumimit të tij fizik. Mund të thuhet lehtësisht se këto janë probleme shkencore, probleme mjekësie. Kjo është e vërtetë dhe, natyrisht, mjekët i kuptojnë më thellë se kushdo këto çështje, prandaj u bie atyre detyra të bëjnë përpjekje të gjithanshme për të gjetur metodat më të drejta e më efektive të kurimit, të përgjithshëm dhe të veçantë, për çdo rast. Megjithatë, edhe në këtë drejtim, mendoj unë, duhet të veprojmë profilaksia.

Në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror, përveç shumë të tjerave, në mënyrë të veçantë dhe me forcë, u ngrit edhe problemi i shëndetit të fëmijëve. Dëshiroj të flas pak edhe unë për këtë problem, pse ka një rëndësi të jashtëzakonshme për Partinë dhe për popullin. Të më falin mjekët që nuk jam në gjendje t'i shpreh aq mirë si ata mendimet për këtë problem të madh, siç foli veçanërisht pediatri Selaudin Bekteshi që është nga specialistët më të mirë.

Të gjithë e dimë se problemi i shëndetit të fëmijëve e ka preokupuar dhe do ta preokupojë vazhdimisht Partinë dhe pushtetin, të cilët, edhe në të ardhmen, do të marrin të gjitha masat e nevojshme e të gjithanshme për ngritjen në një nivel më të lartë të

shërbimit shëndetësor në këtë sektor kaq shumë të rëndësishëm. Shumë masa profilaktike e kurative janë marrë në dobi të shëndetit të fëmijëve dhe në këtë drejtim, si kudo, kemi pasur rezultate të mira. Fëmijët në vendin tonë, në përgjithësi, janë me shëndet të mirë, por ne kemi akoma shumë për të bërë për ta, pse konstatohen mjaft dobësi e të meta, kështu që nuk ka vend të kënaqemi me sukseset e arritura. Prandaj për të ardhmen na mbeten akoma detyra të shumta për të kryer. Unë nuk do të hyj në ato probleme të mprehta që qëndrojnë përpara shëndetësisë sonë e që shtruan këtu me të drejtë mjekët, sidomos ata të sektorit të pediatriisë, por dëshiroj të theksoj se ka probleme, zgjidhja e të cilave lidhet ngushtë me punën e punonjësve të shëndetësisë. Megjithatë të jemi të qartë të gjithë se ka, siç do ta përmend më poshtë, shumë probleme të tjera që ata nuk janë në gjendje t'i zgjidhin dot vetë, pa kujdesin e Partisë, të organizatave shoqërore, shtetërore dhe ekonomike dhe të të gjitha masave punonjëse.

Duke u bazuar në zhvillimin fiziologjik të organizmit të njeriut, shkencë mjekësore ka zbuluar ligjet specifike të këtij zhvillimi, format, proceset dhe lidhjet e këtyre proceseve në mes tyre, efektet, shkaqet, statet nëpër të cilat ato kalojnë, anët pozitive dhe negative që lënë pas, format e paraqitjes së tyre dhe mënyrat e ndryshme për ta mbajtur sa më gjatë në eficiencë dhe në kushte të mira organizmin e njeriut. Me këto që përmenda nuk kam aspak ndër mend të futem në probleme të shkencës mjekësore, për të cilat as jam kompetent dhe as që është koha dhe vendi

për t'i theksuar, po nuk mund të rri pa përmendur disa prej tyre, që është e domosdoshme t'i vë në dukje për t'i pasur parasysh dhe për të cilat e kanë për detyrë të preokupohen të gjithë. E kam fjalën sidomos për masat që duhet të marrim në këtë drejtim. Këto masa shkencore, mjekësore janë praktike, fare lehtë të kuptueshme, të mundshme për t'u realizuar nga të gjithë, por shumë herë lihen pas dore, nënvleftësohen nga disa, nuk dihen fare nga disa të tjerë, siç janë ato që kanë të bëjnë sidomos me nutricionin (të ushqyerit) sipas disa rregullave e sipas moshave, si dhe me zhvillimin e mirë fiziologjik e të harmonishëm të organizmit të njeriut.

Shumë drejt u tha këtu se origjina e shëndetit të mirë ose të keq të njeriut fillon që kur ky është akoma në barkun e nënës. Prandaj «barin e egër», sëmundjen, të përpiqemi ta parandalojmë apo ta zhdukim qysh kur orvatet «të mbijë», që të mos na mbytë fëmijën në vonë, përkundrazi të kujdesemi që ai të rritet i shëndoshë. Ashtu siç bën bujku që e spërkat me herbicide arën e mbjellë me grurë për të mbytur barërat parazitare, apo të dëmshme, që pengojnë zhvillimin e shëndetshëm të bimës që dëshirojmë të rritim, akoma më me përgjegjësi, ne duhet të marrim me kohë të gjitha masat e nevojshme profilaktike e higjienike për mëmën dhe fëmijën, qysh kur kjo e fundit konceptohet, sidomos pas muajit të katërt të shtatzënisë. Ç'ngjjet zakonisht në këto raste? Të gjithë në familje, që nga burri e deri te vjehrra janë të gëzuar që nusen e kanë shtatzënë. Gëzimi është i kuptueshëm dhe i ligjshëm, por e keqja është se në këtë kohë rrallë

ndryshon regjimi i jetës së zakonshme të gruas. Kjo, ashtu sikurse edhe më parë, punon njëlloj në shtëpi dhe, në më të shumtat e rasteve, vazhdon të ushqehet, gjithashtu, njëlloj.

Prandaj ne, që këtu, që në këtë stad, është e domosdoshme ta fillojmë luftën për njeriun e ardhshëm të shëndetshëm. Burri, vjehrra dhe vjehrri, gjithë pjesëtarët e familjes, duhet të kenë parasysh se gruaja shtatzënë mban gjallë jo vetëm veten, po dy jetë, prandaj u del detyrë ta lehtësojnë dhe, një pjesë të punës së saj në shtëpi, gjatë kësaj periudhe, ta marrin përsipër pjesëtarët e tjerë të familjes. Regjimi ditor i punës dhe i çlodhjes në këtë kohë ka një rëndësi të madhe për të. Në familje është e domosdoshme të merren masa e të krijohen mundësi edhe për një trajtim të veçantë ushqimor të gruas shtatzënë, sepse mungesa e ushqimeve, si dhe vazhdimi i një regjimi pune si zakonisht, janë shpesh shkaku i lindjes së fëmijëve para kohe, nën peshën mesatare, me rezistencë të ulët dhe nganjëherë me të meta fizike. Prandaj nuk duhet të lejojmë që akoma sot në vatrat tona të diktojnë kanunet primitive, ligjet e egra e zakonet e vjetra, sipas të cilave nusja duhet t'u rrijë pleqve e më të mëdhenjve në familje shtruar<sup>1</sup>, në këmbë dhe të hajë mbeturinat që teprojnë nga sofrat e burrave. Partia të mos e durojë më një trajtim të tillë kaq përrulës e jonjerëzor e aq më shumë kur nusja është shtatzënë, sepse kjo nuk është as çështje personale, as çështje vetëm

---

1. Këtu është përdorur në kuptimin e urtë, e bindur, e dëgjueshme.

familjare, po një çështje e madhe shoqërore, një çështje patriotike dhe kombëtare, pasi fëmijët janë e ardhmja e vendit. Dhe pikërisht nga trajtimi i drejtë i gruas shtatzënë, qysh në familje, varet shumë nëse do të na lindin fëmijë plotësisht të shëndoshë, apo të pazhvilluar mirë, raketikë ose me sëmundje të tjera. Prandaj në qoftë se i duam fëmijët të shëndoshë (dhe është e qartë se të gjithë kështu i duam), atëherë është e domosdoshme të mendojmë vazhdimisht për ta, duke filluar që kur ata janë në zhvillim e sipër në barkun e nënës. Nuk është aspak turp, siç mund të mendojnë disa prapanikë, kur nusja mbetet shtatzënë, përkundrazi, një gjë e tillë është gëzim i madh për familjen dhe për gjithë shoqërinë tonë, pse vjen një njeri në jetë, një ndërtues i ardhshëm aktiv i socializmit, për lindjen dhe për rritjen me shëndet të plotë të të cilit jemi të interesuar të gjithë. Prandaj të luftojmë që t'i zhdukim, kudo që ekzistojnë akoma, gjithë ato norma të shëmtuara të sjelljes që e kanë burimin në konceptet reacionare të mbetura nga e kaluara ndaj grave në përgjithësi e në mënyrë të veçantë ndaj nënave të ardhshme. Po të mos e bëjmë këtë, nuk e kemi kryer detyrën ndaj Partisë dhe popullit, nuk kemi punuar për të ardhmen e atdheut. Mua më duket se një «respekt» patriarkal prapanik ndaj prindit ose më të vjetërve në familje nuk është yni, ai është krejt i huaj për moralin e shoqërisë sonë socialiste dhe nuk ka vend të ekzistojë te ne. Ne e kemi për detyrë t'u shpjegojmë qartë prindërve për kujdesin që ka nevojë të ketë nusja shtatzënë, bija e tyre, nga gjithë familja. Unë jam i bindur se, po të punojë mirë në këtë drejtim

Partia, njerëzit tanë, që e dëgjojnë dhe e zbatojnë pa e bërë dysh fjalën e saj, nuk do të kursehen ta vënë në jetë këtë porosi që është për të mirën e brezave të ardhshëm të vendit tonë.

S'ka dyshim se vëmendja që kërkohet t'i kushtohet gruas shtatzënë në familje është detyrë të tregohet, gjithashtu, edhe në vendin e punës. Ka raste që në qendrat e punës, e sidomos në kooperativat bujqësore, gruaja shtatzënë vazhdon të punojë, gjithashtu, njëlloj, disa herë asaj nuk i sigurohen as lehtësitë që parashikojnë ligjet e shtetit dhe orientimet e qarta e të vazhdueshme të Partisë. Dhe të gjitha këto ndodhin para syve të organizatave-bazë të Partisë dhe të komunistëve.

A duhet ta lejojmë ne, shoqe dhe shokë, një gjendje të tillë ndaj asaj që krijon jetën, gruas shtatzënë, dhe foshnjës që rrit ajo në këtë periudhë të vështirë në trupin e vet? Duhet, pa diskutim, t'i sigurohen kudo gruas shtatzënë, në punë dhe në familje, kushte të veçanta higjienike, jetese, pune, çlodhjeje dhe ushqimi të përshtatshëm me gjendjen e saj fiziologjike. Ky, më duket mua, është një nga problemet kyç, të dorës së parë, që ka të bëjë me profilaksinë, me luftën për zhvillimin e harmonishëm fiziologjik të organizmit të njeriut për gjithë jetën e tij.

Prandaj është e domosdoshme që nënat e ardhshme të rrethohen kudo me një kujdes të veçantë nga të gjithë. Organizatat-bazë të Partisë të qendrave të punës dhe të kooperativave bujqësore, e nën drejtimin e tyre gjithë organizatat e masave, e kanë për detyrë të tregojnë një interesim akoma më të madh se deri

tani për një çështje kaq të rëndësishme dhe të mbajnë qëndrime të rrepta ndaj gjithë atyre drejtuesve që nuk zbatojnë plotësisht ligjet dhe udhëzimet shtetërore që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të grave shtatzëna. Me këtë nuk është fjala këtu vetëm sa për t'i dhënë gruas lejën e lindjes, kur i vjen koha, siç e parashikojnë ligjet, gjë që përgjithësisht respektohet kudo (megjithëse ka raste në disa kooperativa bujqësore që këto të drejta shkelen), po më tepër për shumë masa e kushte të tjera lehtësuese që është e nevojshme të sigurohen nga drejtuesit e qendrave të punës dhe nga organizatat e Partisë dhe të masave. Në mbrojtje të tyre duhet të ngrihet tërë kolektivi ku punojnë ato, në mënyrë që të përballojnë në gjendje sa më të mirë shëndetësore e pa asnjë shqetësim fizik dhe shpirtëror këtë periudhë të rëndësishme të jetës së tyre dhe të fëmijës.

Një shok diskutant sugjeroi këtu që, për kalamanët e lindur të dobët prej natyre, të krijojmë institucione speciale, ku ata t'i nënshtrohen një trajtimi të veçantë, derisa të marrin veten. Si çdo gjë tjetër, kur të jetë nevoja, edhe të tilla institucione ne mund t'i krijojmë, dhe diçka kemi bërë në këtë drejtim, por më duket se çështja nuk duhet shtruar kështu. Partia më parë duhet të punojë seriozisht me njerëzit, që të mos na lindin kalamanë të paformuar mirë, ose të na vijnë sa më pak të tillë. Dhe që të mos lindin kalamanë jo të shëndetshëm, përveç të tjerave, është e nevojshme të kuptohen e të zërthehen mirë të gjitha ato që u thanë këtu.

Shkenca mjekësore përcakton se në kohën e shtat-



zënisë gruaja ka nevojë, së pari, për një trajtim të veçantë ushqimor, prandaj duhen bërë përpjekje që ajo të marrë konkretisht çdo ditë një sërë lëndësh ushqyese, vitaminash e kripërash të domosdoshme për jetën e vet dhe për formimin sa më të plotë të fëmijës që është duke u zhvilluar në trupin e saj. Disa nga njerëzit tanë shumë herë i dinë fare mirë kërkesat për një trajtim të veçantë që ka nevojë lopa barsë, kurse për gruan shtatzënë as i njohin, as interesohen t'i dinë. Mund të lejohet kjo? Një qëndrim i tillë ndaj këtij problemi është me të vërtetë i turpshëm. Në qoftë se kujdesi për bagëtitë është me vend, bile duhet shtuar akoma më tepër që ato të prodhojnë sa më shumë, të mos harrojmë se fundi i fundit gjëja e gjallë është në shërbim të njeriut, në radhë të parë, të nënës dhe të kalamanit.

Nuk dëshiroj të flas me hollësi për të gjitha llojet e lëndëve ushqyese dhe të proteinave, të vitaminave, të kripërave etj., që ka nevojë të marrë gruaja shtatzënë, apo me fëmijë në gji, veç duhet thënë se ushqimet duhet të jenë të pasura në këto drejtime. Prandaj është detyrë që mëmës t'i sigurohen nga familja ose mensa e qendrës së punës, apo e kooperativës edhe mish, vezë, qumësht, djathë, kos, perime, fruta, ëmbëlsira dhe ushqime të tjera që përmbajnë një sërë lëndësh të shumë-illojshme e të domosdoshme për jetën e saj dhe për zhvillimin e mbarë të foshnjës.

Duhet pasur, gjithashtu, parasysh që për gruan sëmundjet gjatë shtatzënisë, duke filluar që nga gripi e deri tek tuberkulozi, për shembull, në të shumtat e rasteve, bëhen shkak për të lindur fëmijë me të meta

mendore e trupore, nga të cilat ata mund të mos shërohen asnjëherë gjatë gjithë jetës së tyre. Prandaj del nevoja e një kujdesi shumë të madh të të gjithëve, në familje dhe në punë, që gruaja shtatzënë, më përpara se kushdo tjetër, të ruhet nga çfarëdolloj sëmundjeje.

Partia të punojë, gjithashtu, që në familje në çështjet e ushqimit t'u jepet prioritet fëmijëve, prandaj të luftohen konceptet prapanike që ekzistojnë edhe në këtë drejtim, pse ndodh në disa raste që ushqimin më të mirë e substancial ua japin të rriturve, kurse për fëmijët e vegjël, për nusen shtatzënë, apo me fëmijë në gji, nuk kujdesen sa duhet. Mirëpo koncepti se «fëmijë është» dhe «me një copë bukë në dorë mund të kalojë», ka pasoja të këqija në shëndetin e tij. Të jetë e qartë se në rast se kujdesesh të ushqesh më mirë të rriturit dhe ushqimin e fëmijëve e lë pas dore, këta do të dobësohen e do të sëmuren. Sëmundjet e fëmijëve mënjanohen, kur kujdesi fillon me kohë për ta, siç e thashë, që kur gruaja është shtatzënë dhe duhet të zgjatë edhe pas lindjes, derisa ajo të vazhdojë të mbajë të voglin me qumështin e saj. Edhe në këtë kohë nëna duhet të ushqehet, gjithashtu, mirë që gjoksin jo vetëm të mos e ketë të thatë e të mos jetë në gjendje të ngopë foshnjën, por këtë të mund ta ushqejë në mënyrë të gjithanshme. Partia duhet të mësojë jo vetëm burrat, po edhe vetë gratë, nënat, për rëndësinë dhe domosdoshmërinë që ka për fëmijën dhënia e qumështit të gjirit deri në kohën që këshillon shkencat mjekësore, për orarin e ngrënies së fëmijës, të higjienës e të tjera çështje të kësaj natyre.

Shteti duke marrë parasysh se forcimi i shëndetit

të popullit e, në radhë të parë, i grave shtatzëna dhe me foshnjë në gji, si dhe i fëmijëve, është nga detyrat e tij të dorës së parë, është i gatshëm të ndihmojë akoma më tepër se deri sot. Rëndësi të veçantë duhet t'i jepet edhe përgatitjes së ushqimeve të ndryshme për kalamanët nga industria jonë, për të cilën u fol edhe këtu. Po këto ushqime duhet të përgatiten në kushte shkencore e higjienike të përshtatshme, në bazë të recepturave që rekomandojnë mjekët, të diferencuara për kategori të ndryshme fëmijësh, në sasi që të mbulojnë të tëra nevojat e vendit, pra të ketë mundësi që të shpërndahen kudo, deri në zonat e thella dhe sa të jetë e mundur me çmime më të lira. Ne duhet të shkojmë nga parimi që njerëzit me moshë të madhe, fundja, mund të mbeten disi mangut për zarzavate, mish, vezë e të tjera produkte ushqimore (gjë që Partia as këtë nuk do ta lejojë), por e kam çështjen që kalamanëve në asnjë mënyrë të mos u mungojë gjë, atyre, në radhë të parë, t'u sigurohet gjithçka që lejojnë mundësitë e vendit tonë. Kjo është një masë e domosdoshme që duhet pasur parasysh dhe Qeveria do të marrë vendime për zgjidhjen sa më parë të këtij problemi. Makineritë moderne, që nevojiten për ta pajisur industrinë tonë për këtë qëllim, do të porositen dhe ato do të vijnë, por nuk qëndron çështja vetëm te këto makineri që do të përpunojnë ushqimet e gatshme të fabrikuara posaçërisht për fëmijët. Ne duhet të sigurojmë me kohë dhe në sasi të parashikuara në planet tona lëndët e para të domosdoshme, me të cilat do të përgatiten këto ushqime, si: fruta, perime, cereale, bulmetra etj., të cilat do të prodhohen nga toka

jonë dhe me punën tonë. Dhe që të sigurohen të gjitha llojet e ushqimeve, si ato të fabrikuarat, edhe ato të freskëtat, që nevojiten, në radhë të parë, për nënat dhe fëmijët, po edhe për të tjerët, pra, për mbarëvajtjen e shëndetit të të gjithë njerëzve tanë, shihet qartë ç'dotyra të mëdha na presin dhe ç'përgjegjësi kemi që t'u futemi më thellë punëve të bujqësisë. Në këtë drejtim është e domosdoshme të kemi plane të qarta dhe të mobilizohemi me forca të shumëfishuara për zbatimin e tyre të plotë.

Në qoftë se ne nuk do t'i marrim e nuk do t'i zbatojmë masat që propozojnë me të drejtë mjekët pediatric për nënën dhe fëmijën, të jemi të ndërgjegjshëm se do të na shfaqen çrregullime në organizmin e foshnjës, gjë që do të shkaktojë jo vetëm dëmtime të skeletit dhe të muskulaturës së saj, por ato do të reflektohen akoma më rëndë në të ardhmen, kur ajo të rritet me funksionimin jo të rregullt dhe defektoz të organeve nga më të rëndësishmet, siç janë zemra, sistemi nervor, gjëndrat endokrine; të tilla çrregullime mund të ndikojnë negativisht, gjithashtu, në përbërjen e gjakut etj., etj. Mjekësia na sqaron se reumatizmi artikular akut, veset e zembrës dhe disa sëmundje të tjera tek të rriturit fitohen në shumicën e rasteve në këtë stad të jetës, ato janë të lidhura me disa vatra infektive që shfaqen te kalamanët si në grykë, në dhëmbë etj.

Ka prindër që, duke biseduar me ta se si mund të mënjanohen te fëmijët një sërë sëmundjesh, të cilat prekin të vegjlit, si: distrofinë, rakitizmin, avitaminozën, infeksionet etj., shumë gjëra mund të mos i kaptojnë. Por kur atyre dhe grave shtatzëna t'u shpje-

gohet konkretisht se, pa zbatuar si duhet porositë e mjekut, fëmija e ardhshme do të dalë me këto ose ato cene, që prindërit i kanë parë me sy në disa fëmijë të gjymtë, ose i kanë dëgjuar nga të tjerët, atëherë i bëjmë me të vërtetë të ndërgegjegjshëm që të kujdesen seriozisht si për gruan shtatzënë, ashtu edhe për foshnjën që lind dhe kështu do ta rritin atë me gjithë kujdesin e nevojshëm. Në këtë drejtim një punë të vazhdueshme duhet të bëjnë mamitë, gjithë personeli shëndetësor që punon në çerdhe e kudo, arsimtarët e të tjerë. Nuk lejohet që sidomos në fshat disa punonjëse të shëndetësisë, të arsimit dhe të sektorëve të tjerë, që kanë kryer shkollë të mesme apo të lartë dhe punojnë nëpër çerdhe, kopshte, shkolla e kudo, të kufizojnë veprimtarinë e tyre thjesht brenda kuadrit të punës, ose të institucioneve ku janë caktuar, duke vepruar kështu si «kali i arabasë». Këto shoqe duhet ta shtrijnë veprimtarinë e tyre edhe si aktiviste shoqërore, jashtë kuadrit të punës së tyre të përditshme, të mendojnë sidomos për t'u dhënë këshilla grave për higjienën, për pastërtinë, për rritjen dhe për ushqimin e fëmijëve etj.

Të tërheq vëmendjen diskutimi i shoqes së organizatës së gruas të rrethit të Shkodrës, e cila vuri në dukje se, në bazë të statistikave, përqindja e vdekjeve të fëmijëve femra në këtë rreth është më e lartë nga ajo e meshkujve. Jo vetëm në këtë rast që duhet punuar për t'u dhënë fund qëndrimeve të pakujdesshme ndaj foshnjave femra, por organizatat-bazë të Partisë duhet të lëshojnë alarmin edhe kur ndodh një vdekje e vetme e një fëmije për të analizuar përse nuk u morën

me kohë masat e nevojshme që ajo të shërohej, ç'duhet të kishin bërë komunistët që të shpëtohej, ç'duhet të kishte bërë vetë familja, personeli shëndetësor, të dalë nëse kjo fatkeqësi ndodhi për shkak të paditurisë së prindërve, apo për pakujdesi të njërit apo të tjetrit, të kërkojnë llogari më rreptë ndaj atyre që mbajnë përgjegjësi direkte për një ngjarje të tillë të padëshirueshme që shkaktoi humbjen e një njeriu. Që të mos na ndodhin fatkeqësi të tilla me fëmijët, shoqe dhe shokë, organizatat-bazë të Partisë duhet të jenë ditë e natë në ballë, të punojnë me prindërit për t'i bërë të ndërgjegjshëm që të kujdesen më mirë për ruajtjen e shëndetit të fëmijëve, duke aktivizuar në këtë drejtim kuadrot me arsim të lartë e të mesëm që përmenda pak më parë, e sidomos shoqet, të ndjekin e të drejtojnë, gjithashtu, vëmendjen edhe ndaj organeve shëndetësore që këto t'i kryejnë mirë e me ndërgjegje të lartë detyrat.

Organizatave-bazë të Partisë u del detyrë që ta udhëheqin vazhdimisht e më mirë punën bindëse e edukative me njerëzit në drejtim të kujdesit që duhet të tregohet për shëndetin e fëmijëve. Ato duhet të mobilizojnë të gjitha organizatat e masave, këshillat popullore, organet dhe punonjësit e shëndetësisë jo vetëm kur konstatohen raste sëmundjesh epidemike në fëmijët, për kufizimin e për zhdukjen e tyre sa më parë, po edhe në çdo rast tjetër, kur shohin se rrezikohet shëndeti i tyre.

Partia jonë është një parti marksiste, që i shikon çështjet drejt jo vetëm në parim, por edhe në praktikë. Për t'i vënë në jetë plotësisht të gjitha këto detyra, në

radhë të parë, duhet t'i kuptojmë drejt dhe të luftojmë për zbatimin e tyre, ndryshe, dashur padashur, duke u bërë qejfin pikëpamjeve reaksionare, asgjë nuk mund të realizohet.

Një gamë e tërë problemesh dalin, pra, në lidhje me ruajtjen e shëndetit të fëmijëve. Qeveria, siç thashë, në bazë të vendimeve të kësaj mbledhjeje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, do të marrë nga ana e saj të gjitha masat e nevojshme, po zgjidhja e drejtë dhe e plotë e këtij problemi kërkon preokupacionin e të gjithëve. Të kuptojnë mirë dhe qartë shokët punëtorë, në radhë të parë, se si duhen zgjidhur një nga një me radhë e në rrugë revolucionare detyrat që dalin dhe të mos qahet asnjëri që s'ka vend për të tërë kalamanët në çerdhe. Është e vërtetë se vend për të tërë s'ka, po, në qoftë se shokët punëtorë, në çdo sektor ku janë, mobilizohen si duhet në punë, shfrytëzojnë plotësisht orarin etj., s'ka problem që të mos zgjidhet. Në rast se për realizimin e prodhimit, sipas planit, është kërkuar diku një numër punëtorësh më shumë, kur atje njerëzit punojnë 6 orë e gjysmë ose 7 orë në ditë, në vend të 8 orëve që e kanë për detyrë, s'ka dyshim që në disa drejtime do të mbetemi pas. Po në rast se shokët punëtorë do të punojnë me të vërtetë dhe plotësisht 8 orë në ditë, atëherë në atë qendër pune ku është kërkuar të bëhet shtesa e fuqisë punëtore, do të dalë që jo vetëm punëtorët e rinj nuk do të nevojiten, por ka mundësi të shkurtohen edhe disa të tjerë. Dhe punëtorët e asaj qendre pune që do të bëjnë përpjekje të shfrytëzojnë si duhet kohën e punës,

të jenë të sigurt se plani do të realizohet me më pak shpenzime dhe atëherë Qeveria do të ketë mundësi të ngrejë atje jo një, por dy e tri çerdhe të tjera të reja dhe shumë gjëra të tjera në favor të punonjësve të kësaj ose të asaj ndërmarrjeje. Prandaj shokët punëtorë ta kuptojnë mirë se kërkesën për të punuar me rendiment të lartë Partia e bën vetëm në interes të mirëgenies së të gjithë punonjësve, në interes edhe të shëndetit të grave e të kalamanëve.

Edhe me kooperativistët Partia të punojë që ata t'i kuptojnë drejt këshillat për t'i çuar fëmijët që të gjithë në çerdhet e kopshtet, që janë ngritur për ta dhe të mos ndodhë që një pjesë e tyre akoma të mos i dërgojnë fëmijët në këto institucione. Vihet pyetja: Po organizatat-bazë të Partisë në kooperativa, çfarë bëjnë në këto raste? E kuptojnë ato qëllimin e lartë përse i ka ngritur Partia çerdhet dhe kopshtet në fshat? Në qoftë se organizatat-bazë të Partisë e kanë të qartë këtë qëllim, pse nuk veprojnë me të gjitha forcat për t'i shfrytëzuar plotësisht këto institucione në të mirën e kalamanëve dhe të shokëve e të vëllezërve të tyre kooperativistë? Është e domosdoshme që shokët komunistë të thellohen më mirë në kuptimin dhe në zbërthimin në jetë të direktivave të Partisë, t'i rrahin ato nga të gjitha anët në organizatat-bazë dhe të jenë vetë në vijat e para të luftës për zbatimin e tyre, pse ato lëshohen kurdoherë për një qëllim të lartë: të bëhet sa më e mirë jeta e popullit, të ruhet shëndeti i tij dhe, në radhë të parë, të rritet një brez i ri me një edukatë të shëndoshë socialiste dhe i kalitur sa më mirë fizikisht.



Shumë drejt u tha këtu se çerdhet e kopshtet vërtet u ngritën dhe atje po dërgohen fëmijët, por del nevoja që ato t'i zgjerojmë më tej dhe aq më shumë t'i perfeksionojmë. Kështu duhet të veprojmë kudo, për të arritur që të tërë kalamanët e fshatit, deri në moshën shkollore të venë në çerdhe e në kopshte. Këto institucione të bëhen mundësisht e sa më parë me ngrënie, e cila të kushtojë sa më lirë. Por të kihet parasysh që ngritja e çerdheve dhe e kopshteve me ushqim në kooperativat bujqësore të mos bëhet në asnjë mënyrë në kurriz të klasës punëtore, duke e lënë këtë pa mish, pa qumësht, pa zarzavate, pa fruta etj. Jo, këtë duhet ta kuptojnë mirë kooperativistët tanë patriotë, të cilët, të mobilizohen me të gjitha forcat për të realizuar, ashtu sikurse klasa jonë punëtore, planet e zotimet, duke i plotësuar e duke i tejkaluar ato në të gjithë zërat për mallra konsumi që kërkon fshati. Kjo është një detyrë e madhe patriotike, detyrë me rëndësi të madhe kombëtare dhe do të realizohet plotësisht, në rast se kuptohet drejt nga e gjithë fshatarësia jonë kooperativiste.

Për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve del nevoja të merren patjetër edhe një sërë masash të tjera. Fëmijëve duhet t'u bëhen të gjitha vaksinat e rekomanduara për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme epidemike që rrezikojnë jetën e tyre. Të luftohen, gjithashtu, disa zakone të këqija, si puthja e fëmijëve nga njëri e nga tjetri, zakoni i dëmshëm ky që hap rrugën për t'u transmetuar fëmijëve sëmundjet që mund të kenë të rriturit, ose zakoni i mbulimit të fytyrës me lloj-lloj shamish e shallësh najloni e stër-

najloni, vënia për të fjetur në dhoma të errëta e të paajrisura etj.

Më falni se u zgjata ca më tepër në çështjen e shëndetit të fëmijëve, po në këtë drejtim ka shumë gjëra që i kemi thënë e përsëritur, vetëm se nuk u është vënë rëndësi sa duhet. Kështu qëndron puna, për shembull, edhe me higjienën në shkolla, që shpesh lihet në radhë të fundit. Higjiena shkollore në çdo drejtim ka rëndësi të madhe, sepse ruan fëmijët nga zhvillimet defektoze; respektimi me rreptësi, ose mosrespektimi i saj, sipas rastit, ndikon për të mirë ose për të keq gjatë zhvillimit të organizmit të fëmijëve të kësaj moshe. Edhe qëndrimi jo i përshtatshëm në bankë, që ndokujt nuk i tërheq fare vëmendjen, ndikon shumë në shtrembërimin gradual e pa e kuptuar të shtyllës kurrizore, ku kalojnë të gjithë nervat, ndikon, gjithashtu, në dëmtimin e syve, në zhvillimin psikik dhe intelektual të nxënësve etj.

Pa folur për rëndësinë e madhe që ka për kalitjen e shëndetit të rinisë sonë shkollore zhvillimi i gjithanshëm i fizkulturës e i sporteve, pse për këtë është diskutuar herë të tjera, fëmijët duhet të marrin në shkollë edhe edukatën e domosdoshme higjieno-sanitare mbi pastërtinë individuale, shtëpiake, ushqimore, shoqërore etj. Në shkolla duhet të tregohet kujdes i madh e i veçantë për të zbuluar infeksionet e ndryshme të fëmijëve, të tregohet kujdes sidomos për higjienën e grykëve e të dhëmbëve, të cilat, siç na mëson mjekësia, janë vatra të sëmundjeve të rënda të zemrës e të veshkave, që, po të mos zbulohen sa nuk është vonë, e bëjnë njeriun invalid për gjithë jetën.

Derisa jemi të ndërgjegjshëm se ekziston një rrezik i tillë, atëherë të mendojmë ca më shumë për rëndësinë e shërbimit stomatologjik, në radhë të parë, në shkollë, të cilit, në përgjithësi, për arsye se edhe mundësitë deri tani i kemi pasur të kufizuara, nuk ia kemi vënë veshin sa duhet. Paskëtaj Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria do ta shikojnë më me kujdes këtë problem.

Çdo moshë, shoqe dhe shokë, ka nevojat dhe kërkesat e veta, por sidomos ajo e pubertetit është periudha e një ndryshimi cilësor në organizmin e njeriut, që karakterizohet me transformime të rëndësishme fiziologjike, fizike, psikike dhe intelektuale. Në këtë moshë shtohen shumë procese metabolike dhe bashkë me to, ndryshon trupi i njeriut, zhvillohet më tej procesi i rritjes. Në këtë periudhë të jetës fëmija ka nevojë të madhe për ushqime, sidomos me kalori, prandaj ata nuk duhen përcjellë shumë herë me një ushqim të varfër. Brenda mundësive, në këtë fazë, prindërve u bie detyra të kujdesen që t'i ushqejnë të rinjtë dhe të rejat më mirë se veten e tyre, domethënë, të mendojmë më pak për vete dhe ca më shumë për ta. Në atë moshë, kur fëmija është tepër i gjallë e plot energji, kur ka nevojë të kërcejë, të hedhë valle, të luajë me top etj. prindi jo vetëm nuk duhet ta pengojë në këto drejtime, pse janë jetike e të domosdoshme për zhvillimin e tij të harmonishëm fizik e psikik, por të përpiqet edhe ta ushqejë më mirë. Prandaj të tregohet më shumë kujdes nga të gjithë për ushqimin e fëmijëve, pse te këta qëndron interesi i atdheut, i Partisë, i familjes, ata janë e ardhmja jonë.

Nuk po zgjatem më shumë në këto çështje. Vërejtjet dhe sugjerimet që u bënë këtu, në përgjithësi, janë të drejta, prandaj organet përkatëse të marrin menjëherë masat për të zhdukur të metat e konstatuara.

Unë mendoj se ky Plenum i Komitetit Qendror do të na shërbejë shumë për t'i dhënë një shtytje më të madhe përpara jo vetëm shëndetësisë, po, siç thashë, duke u thelluar në punën për realizimin e detyrave që dalin për këtë sektor të rëndësishëm, do t'u jepet shtytje edhe sektorëve të tjerë ekonomikë e kulturorë, psc të gjitha janë të lidhura me çështjen kryesore që ka të bëjë me shëndetin dhe me lumturinë e njeriut në atdheun tonë socialist.

Ky Plenum i Komitetit Qendror bëhet tamam në kohën kur jemi duke hartuar planin e ri pesëvjeçar, kur po përgatitemi për të shkuar në Kongresin e 6-të të Partisë me një frymë të lartë revolucionare të përpshkruar, me një mobilizim të madh të popullit e të Partisë për realizimin e të gjitha detyrave. Partia dhe populli do t'i kuptojnë drejt këto probleme dhe shprehin bindjen e plotë se si kurdoherë do të mobilizohen për t'i zgjidhur deri në fund dhe s'ka dyshim se do të korrim suksese.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 187*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 187*

# MË SHUMË KUJDES PËR FURNIZIMIN E FSHATARËSISË

## Shënime

1 shkurt 1971

Lexova një vendim të Këshillit të Ministrave. Shokët e Qeverisë kanë menduar ta dërgojnë atë në bazë për të rregulluar anët financiare në kooperativa dhe shpërndarjen e prodhimeve. Duke e studiuar këtë vendim, pata përshtypjen se ai është shumë shtrëngues për kooperativat, prandaj jam i mendimit se një dokument i tillë nga ana e Këshillit të Ministrave nuk duhet të dërgohet<sup>1</sup>.

Natyrisht, duhet menduar për të perfeksionuar më tej marrëdhëniet ekonomiko-tregtaro-financiare në mes

---

1. Për të diskredituar vijën e Partisë e për të ngjallur pakënaqësi në popull, nën maskën e studimeve e të propozimeve në emër të Qeverisë, armiku Mehmet Shehu është përpjekur të sabotojë zbatimin e vendimeve të drejta të Partisë për furnizimin e fshatarësisë, duke synuar të thellojë dallimet ndërmjet fshatit e qytetit. Këtij qëllimi të keq do t'i shërbente edhe vënia në jetë e këtij vendimi, të cilin shoku Enver Hoxha nuk e pranoi.

organeve shtetërore të tregtisë dhe kooperativave bujqësore, por të kemi kujdes që këto të mos kenë karakter restriktiv<sup>1</sup> dhe të mos jenë të njëanshme, duke shikuar, në radhë të parë, interesin e shtetit, dhe në disfavor të kooperativave bujqësore e të zhvillimit të mëtejshëm të tyre në rrugën e ndërmarrjeve të përparuara socialiste.

Nga ana tjetër, ne nuk duhet të konfundojmë përmirësimin e marrëdhënieve tregtaro-financiare shtet-kooperativë bujqësore me masat organizativo-financiare e të prodhimit, brendapërbrenda në kooperativa. Ky organizim i brendshëm që kemi duhet të perfeksionohet sa më parë, pse, pa një përsosje të tillë, çdo masë që mund të marrim nga lart ose nga jashtë nuk do të gjejë zbatimin e duhur.

Tash duhet të kemi parasysh disa situata të reja, të cilat kërkojnë ndryshime, në radhë të parë, për furnizimin më të mirë me prodhime ushqimore nga shteti të fshatit, natyrisht, mbi bazën e shtimit të prodhimit bujqësor dhe të fuqizimit të pareshtur të ekonomisë sonë. Këtu të mbahen parasysh edhe mundësitë e prodhimit e të plotësimit të nevojave vetjake nga oborri kooperativist, por e theksoj mundësitë reale, sepse duhen bërë llogari të bazuara dhe jo t'i kalohet përciptazi problemit me mendimin e cekët «se fshatari prodhon produkte bujqësore e blegtorale në oborrin e tij».

**Pra, në furnizimin me sende ushqimore qyteti nuk duhet të jetë shumë më i favorizuar nga fshati. Treg-**

---

1. Nga frëngjishtja — shtrengues.

tia shtetërore duhet të preokupohet për të furnizuar si qytetin, ashtu edhe fshatin në bazë të fuqisë blerëse ekzistuese dhe që shtohet. Aktualisht shteti në këtë çështje kujdeset më shumë të furnizojë qytetin me sende ushqimore që të ruhet niveli i furnizimit të tij me ushqime edhe kur krijohen deficite në plotësimin e planeve, të plotësojë normativat e caktuara, duke sjellë edhe sasi të nevojshme nga importi. Po një kujdes i tillë duhet të tregohet edhe për fshatarësinë.

Fshatari, si edhe punonjësi i qytetit, punon, bile puna e tij është mjaft e vështirë. Ai harxhon energji, të cilat duhet t'i zëvendësojë, duke u ushqyer më mirë, gjë që duhet të na preokupojë shumë. Ai ka mangut pikërisht disa nga ato produkte që i prodhon vetë. Kur është fjala për të drejta të barabarta në mes fshatarit dhe qytetarit, nuk mund të qëndrojmë në këmbë, ajo që thuhet vetëm për fshatarin se duhet «të prodhojë më shumë që të hajë më shumë». Sigurisht ai që punon ha. Por, ashtu siç ka kooperativistë dhe kooperativa bujqësore që nuk i realizojnë planet, ashtu ka edhe qytetarë e ndërmarre shtetërore që nuk i realizojnë ato.

Çështja qëndron në atë që, me shpërblimin për punën e kryer që i jep punonjësit tonë shteti ose kooperativa, ai të ketë të drejtën të blejë njëlloj çdo gjë që ka krijuar puna e përbashkët dhe që sigurohen me mundësitë e ekonomisë socialiste. Kurse kur nuk ka mundësi të sigurohen sasi të mallrave të domosdoshme, shtrëngim e kursim të bëjë edhe fshatari, edhe qytetari.

Të kërkojmë arsyetime, për të vërtetuar disa feno-

mene të përkohshme që nuk i qëndrojnë parimit, është kohë e humbur, ndërsa të insistosh e të qëndrosh në to, pa u thelluar për të gjetur zgjidhjen e drejtë të problemeve, është gabim.

Për t'u shfajësuar, mund të thuhet, gjithashtu, se «popullsia në fshat është shumë dhe, në rast se e furnizojmë atë si popullsinë e qytetit që si numër është më e vogël, atëherë nuk na mjaftojnë prodhimet». Mirëpo kjo nuk e zhdok favorizimin e qytetarit.

Disa mund të thonë se «në qytete është klasa punëtore dhe ajo duhet të furnizohet më mirë». Ky nuk është parim i Partisë, nuk është parim proletar. Klasa punëtore nuk e pranon këtë privilegj për veten e saj që kërkohet t'i bëhet nga dikush, një gjë të tillë nuk e pranon as alcanca e klasës punëtore me fshatarësinë.

Në këtë çështje, mendoj unë, na ka ngatërruar oborri kooperativist dhe ai mund të vazhdojë të na ngatërrojë në rast se nuk e orientojmë drejt zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të tij. Në parim ne e kemi përcaktuar përse duhet të shërbejë oborri kooperativist. Si sasi toke kemi shkuar drejt zvogëlimit të këtij oborri kooperativist, i cili ka arritur në minimum. Po kështu ka ardhur duke u shkurtuar edhe numri i kafshëve personale të kooperativistit. Të gjitha këto veprime, mendoj unë, janë bërë drejt dhe kështu do të ecet drejt kufizimit gradual e shuarjes së oborrit kooperativist. Çështjen e oborrit nuk duhet ta studiojmë dhe ta zgjidhim nga traditat e vjetra mikroborgjeze të fshatarit për pronën private, për tokën në shërbimin personal, për çështjen e shkëmbimit të tregut të vogël fshatar, por në kushtet e reja që krijuan kooperativiz-



mi, ndërtimi i socializmit, puna e përbashkët, agroteknika moderne, prodhimi i madh i zgjeruar, marrëdhëniet socialiste kooperativë - shtet etj.

Ç'ngjet? Si në kohën kur oborri ishte më i madh, ashtu edhe tash që ky është i reduktuar, studimet ekonomiko-financiare për të, nga ana jonë, o janë të cekëta, ose nuk ekzistojnë fare. Shkohet me mendimin se «fshatari ka oborrin kooperativist si ndihmës, pran-daj s'kemi pse e vrasim shumë mendjen». Kjo është një llogari e gabuar.

Struktura e oborreve duhet të jetë e atillë që të përqendrohet në prodhimin e disa produkteve ushqimore që fshatari të mund t'i konsumojë për vete dhe jo të mendojë për t'i shitur. Kooperativisti gjithë aktivitetin e tij duhet ta zhvillojë në kooperativë, atje të punojë, të prodhojë dhe për çdo gjë të shpërblehet me të holla. Me këto të holla pastaj ai të vejë të blejë në dyqan sende për të cilat ka nevojë për jetesë aq sa i lejon buxheti i familjes. Oborri, pra, të jetë për të një ndihmë. Po të ecim në një rrugë të tillë të drejtë, duke e kthyer kooperativën në një prodhuese të madhe produktesh bujqësore e blegtorale dhe tregtia shtetërore të furnizojë në rregull dyqanet e fshatit e të qytetit, atëherë vetvetiu ecet me siguri drejt atij stadi që edhe oborri ta humbasë vlerën e ekzistencës së tij.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **BASHKIMI I KËSHILLIT POPULLOR ME KRYESINË E KOOPERATIVËS ËSHTË I GABUAR NË PARIM DHE NË PRAKTIKË**

**Nga një bisedë**

**13 shkurt 1971**

Shokët më dhanë një studim për bashkimin e këshillave popullorë të fshatrave me kryesitë e kooperativave bujqësore. Me këtë rast, ne shkëmbyem bashkërisht mendimet që kishim rreth kësaj çështjeje.

Problemi që ngrihet në këtë studim më duket se nuk është i drejtë as në parim, as në praktikë dhe shokët juristë duhet t'i kuptojnë mirë këto çështje, rreth të cilave dua të them edhe unë disa mendime.

Këshillat popullorë janë organe të diktaturës së proletariatit dhe baza politike e Republikës Popullore të Shqipërisë, të krijuar sipas Kushtetutës. Ata, pa përjashtuar këshillat e fshatit, formojnë një sistem të veçantë organesh në mekanizmin e shtetit dhe në parim, janë të një tipi me organin më të lartë të pushtetit shtetëror, me Kuvendin Popullor.

Sipas Kushtetutës, këshillat popullorë drejtojnë gjithë jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore etj.,

ata mbrojnë ligjshmërinë socialiste, të drejtat e qytetarëve dhe, në bazë të kompetencave që u janë dhënë brenda territorit të tyre, drejtojnë veprimtarinë e organeve administrative që kanë në vartësi, marrin vendime dhe lëshojnë urdhëresa të detyrueshme për zbatim nga të gjithë. Këto funksione shumë të rëndësishme, të garantuara nga Statuti ynë Themeltar, nuk duhet dhe nuk mund të zvogëlohen, të errësohen, ose të nënvleftësohen për këshillat popullorë në përgjithësi, dhe për cilëndo hallkë të tyre në veçanti. Nënvleftësimi i tyre është jashtëzakonisht i gabuar.

Veprimtaria ekonomike, kulturore, ushtarake dhe e çdo lëmi tjetër në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, drejtohet, organizohet dhe kontrollohet nga organet shtetërore, siç janë: Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor, Qeveria, ministritë, këshillat popullorë të të gjitha hallkave, komitetet ekzekutive të tyre etj. Këto janë organet më kryesore që ushtrojnë diktaturën e proletariatit. Me qëllim që këto organe të zbatojnë më mirë detyrat e ngarkuara nga Kushtetuta dhe nga ligjet e tjera, krijohen aparate të ndryshme të specializuara. Numri, format dhe strukturat organizative të këtyre aparateve mund të ndryshojnë kur lind nevoja, kur paraqiten kushte të reja, kur këtë e lypin interesat e përgjithshëm. Kjo tezë është njësoj e vlefshme edhe në rastin e krijimit ose të suprimimit të organizatave ekonomike, shtetërore e shoqërore. Por të gjitha këto ndryshime mund dhe duhet të bëhen kurdoherë pa revizionuar parimet themeltare të Partisë dhe të shtetit socialist, pa shkelur demokracinë socialiste.

Le të vijnë tash konkretisht te problemi që keni studiuar ju. Organet e pushtetit popullor nuk mund të përzihen me organet e administrimit të ekonomisë, siç mund të jetë drejtoria e një kombinati, e një ndërmarrjeje bujqësore ose kryesia e një kooperative bujqësore etj.

Ndërmarrjet industriale shtetërore, ndërmarrjet bujqësore ose kooperativat bujqësore, që të vetëveprojnë dhe të funksionojnë normalisht si njësi ekonomike prodhimi, duhet të kenë medoemos udhëheqjet e tyre, përndryshe ato nuk mund të administrohen, të zhvillohen, të përmbushin ato detyra ekonomiko-shoqërore, për të cilat janë krijuar. Në thelb kjo çështje nuk ndryshohet aspak nga fakti se për drejtimin e ekonomisë ekzistojnë edhe ministritë me kompetencat e veta; ajo nuk ndryshohet, gjithashtu, pavarësisht se çdo ndërmarrje shtetërore apo kooperativë bujqësore ka organizatë-bazë partie dhe në rrethin, në territorin e të cilit ato ndodhen, ka komitet partie, komitet ekzekutiv të këshillit popullor etj. E njëjta gjë duhet thënë edhe për të gjitha institucionet e tjera shtetërore ose shoqërore. Pra, cilatdo qofshin ndërmarrjet, institucionet, organizatat shtetërore, shoqërore ose kooperativiste, këto kanë nevojë për një udhëheqje që të qëndrojë vazhdimisht në krye dhe të mbajë përgjegjësi të drejt-përdrejtë për drejtimin e gjithë veprimtarisë që ato janë caktuar të zhvillojnë.

Nuk mund të përzihen kurrsesi në një gjë të vetme mbledhja e përgjithshme, përfaqësia ose kryesia e kooperativës bujqësore me këshillin popullor të fshatit, sepse këto janë forume të veçanta e të ndryshme.

Asambleja, mbledhja e të gjithë anëtarëve, është organi më i lartë i kooperativës; ajo ka për detyrë të aprovojë statutin e vet dhe rregulloren e brendshme të kooperativës, të zgjedhë kryesinë, të aprovojë planin perspektiv dhe vjetor ekonomiko-financiar, të aprovojë veprimtarinë vjetore të kooperativës, krijimin e fondeve dhe ndarjen e të ardhurave të realizuara gjatë vitit, normat e punës që duhet të zbatohen në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së kooperativës e çështje të tjera të rëndësishme për gjithë kooperativën.

Kryesia e kooperativës bujqësore është organi ekzekutiv i asamblesë së kooperativës. Për gjithë veprimtarinë e saj administrative organizuese, ajo jep llogari para mbledhjes së përgjithshme dhe përfaqësisë. Meqenësc kooperativa bujqësore është një ekonomi socialiste kolektive, shteti i jep asaj një ndihmë të gjithanshme e të fuqishme dhe vendos me të marrëdhënie të ndryshme ekonomiko-shoqërore. Cilatdo qofshin këto marrëdhënie — marrëdhënie ndihme nga ana e shtetit kooperativës apo detyrimi të kooperativës ndaj shtetit, me karakter prodhimi, financiar ose tregtar, të gjitha ato rregullohen nga ligje, dekrete, vendime apo urdhëresa që dalin nga organet e larta shtetërore. Gjatë veprimtarisë së saj, kryesia e kooperativës duhet të zbatojë aktet, normat e rregullat ligjore që kanë nxjerrë organet e pushtetit dhe, për zbatimin e të gjitha këtyre gjërave, ajo është e detyruar të japë llogari, jo para vetes, por para këshillit popullor si organ i pushtetit.

Mendimi, sipas të cilit gjoja këshillat popullorë të fshatrave nuk kanë kryer asnjë detyrë që u është cak-

tuar, nuk i përgjigjet realitetit. Për të argumentuar këtë mendim thuhet se kompetencat e tyre kanë qenë shumë më të vogla se ato të kryetarëve të kooperativave bujqësore që ushtrojnë pushtet më tepër. Por edhe argumentimi njësoj, si vetë mendimi, nuk është realist.

Është e vërtetë se në funksionimin, në punën e këshillave popullorë të fshatit ka pasur edhe dobësi. Por, shkak i këtyre dobësive nuk ka qenë aq mungesa e kompetencave, sesa fakti që në këto organe nuk janë zgjedhur kurdoherë e kudo njerëz të aftë, ashtu siç janë zgjedhur në kryesitë e kooperativave bujqësore. Megjithatë, që kur ne, me ligj, u shtuam këshillave popullorë të fshatit kompetencat në fushën arsimore, kulturore, shëndetësore, komunale etj. dhe kur në ta janë zgjedhur kuadro më të aftë, këta këshilla funksionojnë më mirë dhe po tregohen mjaft aktivë. Megjithatë këshilli popullor i fshatit nuk është në gjendje të drejtojë kooperativën. Kjo ndodhte dikur edhe me këshillin popullor të rrethit, prandaj të gjitha ndërmarrrjet i kishim lënë në vartësi të Qeverisë.

Që ne nuk duhet të kënaqemi me kaq dhe duhet të punojmë më shumë për aktivizimin e këshillave popullorë, kjo është një kërkesë e drejtë. Por të arrihet gjer atje sa disa persona, që pretendohet se janë «shokë të mirë» të thonë që deri më sot nuk paska ekzistuar pushteti në fshat, kjo nuk lejohet kurrsesi, mbase është një gjykim krejt i huaj dhe pa asnjë bazë. Sa u shtrua me këta shokë çështja e bashkimit të këshillit popullor të fshatit me kryesinë e kooperativës, shpejtuan menjëherë të nënvleftësojnë kryekëput rën-

dësinë e pushtetit të zgjedhur nga populli në mënyrën më demokratike dhe të mohojnë detyrat e funksionet e tij. Për pushtetin në fshat është denigruese të thuhet se këshilli popullor atje ka ekzistuar formalisht. Kjo do të thotë se gjatë kësaj kohe në fshat nuk paska pasur pushtet! Si është e mundur që ne nuk pas kemi pasur pushtet në fshat? Po të ishte kështu, atëherë del se pushteti ynë popullor paska sunduar mbi masat e popullit në mënyrë antidemokratike. Ç'janë këto mendime absurde dhe pa përgjegjësi? Tjetër është çështja që, si rezultat i punës së dobët, ka edhe kryetarë kooperativash, të cilët bëhen kapadainj dhe nuk e përfillin këshillin popullor. Me këta njerëz duhet punuar që të ndreqen, por jo të propozojmë t'i veshim edhe me funksione pushteti politik.

Pikëpamja që kërkon të bashkohet këshilli popullor i fshatit me kryesinë e kooperativës nuk është e drejtë në parim, nga njëra anë, se kështu unifikohet organi i pushtetit me organin drejtues të një organizate ekonomike dhe, nga ana tjetër, në vend të një pushteti unik e të pandarë, do të kemi dy lloj pushtetesh: këshillat popullorë të rretheve etj. si organe të pushtetit politik dhe kryesitë e kooperativave bujqësore, si organe të pushtetit politik dhe njëkohësisht si organe ekonomike. Në qoftë se pranohet pikëpamja për unifikimin e pushtetit politik me organin e drejtimit ekonomik, atëherë kudo, përveç rrethit, në qytete e në lokalitete, këshillat popullorë duhet t'i shkrijmë me drejtoritë e uzinave, të fabrikave, të minierave etj., që ndodhen në territorin e tyre. Mirëpo këtë gjë ne nuk mund dhe s'duhet ta bëjmë, sepse siç e shpjegoja më parë, kjo

nuk përputhet me parimet dhe me qëllimet e organizimit politik të shoqërisë sonë.

Kooperativa bujqësore nuk është organ shtetëror, por organizatë ekonomike. E gjithë veprimtaria e saj ekonomiko-shoqërore rregullohet në përputhje me statutin dhe me marrëdhëniet që ajo vendos me shtetin sipas ligjeve në fuqi. Kjo do të thotë se kooperativa bujqësore, e bazuar në pronën e grupit, drejtohet nga këshilli popullor, ashtu siç drejtohet, për shembull, edhe kombinati i tekstileve etj. Ne nuk kemi krijuar organizma shtetërorë paralelë që të kenë të njëjtat kompetenca dhe detyra. Në ushtrimin e funksioneve të tij, pushteti nuk do të japë të njëjtët urdhra që jep drejtori i fabrikës apo kryetari i kooperativës. Ai do të veprojë brenda sferës së atyre detyrave që i janë caktuar.

Drejtimin e bujqësisë nga ana e shtetit në kooperativa, ne ia kemi lënë me ndërgjegje këshillit popullor të rrethit. Po ky këshill drejton drejtpërsëdrejti edhe ndërmarrjet shtetërore që ndodhen në territorin e vet. Kjo ka arsyet e veta. Këtu, në këshillin popullor të rrethit, tani për tani ne kemi përqendruar kuadrot më të aftë, me përvojë drejtuese e organizuese, mjetet materiale e financiare për të ndihmuar bujqësinë etj. Pra, jo vetëm këshillat e fshatit, por edhe këshillat popullorë të lagjeve e të qyteteve nuk i drejtojnë drejtpërsëdrejti ndërmarrjet ekonomike që kanë në territorin e vet. Këtë funksion e kryen këshilli popullor i rrethit dhe në këtë rast nuk shkelet asnjë parim. Nëse, kur të kenë ndryshuar kushtet, po ta gjykojmë të arsyeshme e të mundshme, ne mund t'i zgjerojmë ko-



mpetencat e këshillave popullorë të lagjeve e të qyteve, ashtu siç mund të zgjerojmë edhe kompetencat e këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara.

Me zgjerimin e kompetencave të këshillave popullorë të bazës, ne mund të shikojmë nëse ka ardhur koha që kooperativa e Libofshës, për shembull, të mos varet më nga Këshilli Popullor i Rrethit të Fierit, por nga këshilli popullor i fshatrave të bashkuara, dhe jo të shtrojmë problemin që të njësojmë këshillin popullor të fshatit me kryesinë e kooperativës bujqësore. (!) Pra, çështja mund të shtrohet vetëm që ta forcojmë këshillin popullor të fshatit, që ai të jetë në gjendje të drejtojë bujqësinë në kooperativë duke e lehtësuar rrethin nga kjo punë dhe jo ta zhdukim këtë hallkë nga sistemi i organeve lokale të pushtetit. Këshilli popullor i fshatit është organi i vetëm shtetëror i ngarkuar nga Kushtetuta që të ushtrojë në masë të plotë pushtetin shtetëror në njësinë territoriale administrative të fshatit. Por, edhe kjo çështje, sikurse do ta shpjegoj më poshtë, duhet parë me shumë kujdes në kohën e sotme.

Sot Partia dhe shteti duhet të përpiqen për të forcuar drejtimin dhe organizimin e punës në kooperativat bujqësore, sepse janë të gjitha mundësitë që këto të ecin përpara. Te ne është urgjente, sidomos, problemi i përmirësimit të organizimit në fushën e prodhimit, të planifikimit, të llogarisë e të financës në kooperativë. Si do të zgjidhet ky problem? Ky do të zgjidhet me anë të një pune më operative nga këshilli popullor i rrethit, nga seksioni i tij i bujqësisë, të cilit, në qoftë se nuk ka kuadro të mjaftueshëm, mund

t'i shtohen. Tash ne nuk jemi në gjendje t'i japim, ta zëmë, Kooperativës së Bashkuar të Frakullës dy ose tre agronomë, zooveterinerë e të tjerë, në radhë të parë sepse këta kuadro nuk i kemi. Por, edhe sikur t'i kishim e t'i dërgonim, do të na duhej të tregonim kujdes që këta specialistë të mos na ktheheshin në burokratë, siç ka ndodhur me disa nga ata që punojnë në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Edhe me kaq specialistë sa kanë sot kooperativat, ne vëmë re se disa prej tyre përdoren për të bërë punë administrative. Po sikur këtyre t'u japim edhe funksione pushteti, atëherë merret lehtë me mend se ky fenomen do të bëhet më i theksuar, pra, edhe më i rrezikshëm. U deshën të kalojnë 25 vjet që ne t'u jepnim këshillave popullorë të rretheve kompetenca për të drejtuar ndërmarrjet që ndodhen në territorin e tyre dhe jo të gjitha. Tash që këto kompetenca ua dhëmë, ne po marrim edhe masa të ndryshme që këshillat e rretheve t'i gëzojnë e t'i zbatojnë realisht në jetë.

Ka ardhur vallë koha që në të gjithë republikën ta heqim bujqësinë nga vartësia e rrethit, kur dihet se kjo degë me rëndësi jetike për ekonominë përbën fushën e veprimtarisë kryesore të tij? Ta zëmë se organe të tilla të pushtetit do t'i krijojmë në kooperativat e bashkuara, mirëpo në këtë rast do të shtoheshin këshilla popullorë në rang lokalitetesh më shumë nga sa ka sot. Një gjë të tillë ne nuk mund ta bëjmë sepse, së pari, nuk është e nevojshme, së dyti, i heqim mundësitë rrethit për t'u marrë me problemin kryesor, së treti, shpërndajmë forcat që do të na krijojnë

medoemos burokratizëm më të theksuar në veprimtarinë e çdo kooperative.

Ajo që thuhet në studim se bashkimi i këshillit popullor të fshatit me kryesinë e kooperativës nuk vjen në kundërshtim me pronën e grupit, parimisht nuk është e drejtë. Nuk mund të ketë statut tjetër që të hedhë poshtë ose të mënjanojë zbatimin e Statutit Themeltar të Republikës. Nuk mund të ketë një organ që edhe të drejtojë në mënyrë operative ekonominë, edhe të kontrollojë vetveten me cilësinë e organit të pushtetit politik, gjë që do të shkaktonte mjaft anomali në praktikën e përditshme të punës.

Koha që kooperativat bujqësore të shndërrohen në ndërmarrje bujqësore do të vijë atëherë, kur të jenë pjekur kushtet politike, ekonomike dhe organizative, kur këtë shndërrim ta kërkojnë në mënyrë të natyrshme populli, Partia, i gjithë zhvillimi i rendit tonë ekonomiko-shoqëror. Por edhe atëherë nuk mund të përzihen këshillat popullorë me drejtoritë e ndërmarrjeve bujqësore, sepse edhe në këtë rast për zbatimin e ligjeve, të vendimeve etj., do të duhet që drejtori i ndërmarrjes të ndihmohet e të kontrollohet nga organi lokal i pushtetit dhe të përgjigjet përpara këtij organi për veprimtarinë e ndërmarrjes që drejton.

Këshillave popullorë të fshatrave u kemi dhënë me ligj të drejta dhe kompetenca të mëdha e të rëndësishme lidhur me kooperativat bujqësore. Është tjetër punë që, sot për sot, ato nuk janë në gjendje t'i zbatojnë, por, nesër, do të mësohen me siguri e do të dinë t'i vënë në jetë të drejtat dhe kompetencat e tyre. Kryetari i këshillit popullor të fshatit, që është

përfaqësuesi i pushtetit popullor, bën pjesë në asamblenë e kooperativës me cilësinë e anëtarit të saj, diskuton dhe, bashkë me të gjithë kooperativistët, marrin vendime për mbarëvajtjen e ekonomisë kolektive. Por, kur vjen puna për vendimet që merr asambleja, kryetari i këshillit ka të drejtë të thotë aty fjalën e tij edhe si përfaqësues i zgjedhur i organeve të pushtetit. Ai u shpjegon kooperativistëve ligjet, rregullat, urdhëresat shtetërore etj., dhe kërkon zbatimin e tyre, parashtron mendimin e tij për planin e prodhimit, për shpenzimet financiare, për veprimtarinë socialkulturore etj. Kryetari i këshillit nuk mund t'u imponojë mendimet e tij kryesisë dhe asamblësë. E, megjithatë, kur shikon se asambleja apo kryesia marrin vendime që janë në kundërshtim me ligjin, ai e thërret kryesinë në raport; në rast nevojë ai shkon edhe në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të lokalitetit ose të rrethit dhe kërkon ndihmë për respektimin e ligjit etj. Këto janë kompetenca të mëdha ligjore, të cilat i japin të drejtë, e lejojnë këshillin popullor të fshatit të ndihmojë e të kontrollojë organizimin dhe drejtimin e bujqësisë në kooperativat.

Këshillat popullorë të fshatrave nuk merren vetëm me ekonominë, me të cilën merren edhe komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, Ministria e Bujqësisë si dhe organe të tjera qendrore të pushtetit. Në njësitë e tyre administrative ato kanë edhe kompetenca të tjera, që nuk varen nga kryesia e kooperativës, siç janë ato që përmenda: në fushën e arsimit e të kulturës, të tregtisë, të shërbimeve komunale, të shëndetësisë, të financës, të mbrojtjes etj. Vendimet e

këshillit popullor të fshatit lidhur me ankesat e anëtarëve të kooperativës bujqësore kundër veprimeve të brigadierit, për shembull, janë të detyrueshme për këtë të fundit. Këshillat popullorë kanë detyra dhe luajnë një rol të rëndësishëm edhe për funksionimin dhe për mbarëvajtjen e gjykatave popullore të fshatrave. Kryesia e kooperativës, për vetë natyrën e punës së saj, nuk mund t'i kryejë si duhet të gjitha këto detyra.

Kështu pra, në këto kushte, nuk ka arsye as në parim, as në praktikë të përzihet kryesia e kooperativës, që është një organ i drejtimit ekonomik me këshillin popullor, që është një organ politik dhe me kompetencat e tij, të cilat errësohen në studimin tuaj.

Unifikimi i pushtetit popullor në fshat me kryesinë e kooperativës bujqësore, jo vetëm që është në kundërshtim me sistemin e organeve të pushtetit të ndërtuar nga baza në qendër, por, në të njëjtën kohë, do të ishte edhe një veprim krejt formal. Kjo do të thotë që të njëjtët njerëz të kryesisë së kooperativës bujqësore ne do t'i veshim edhe me funksionet e pushtetit politik që, natyrisht, qëndrojnë mbi funksionet e drejtimit ekonomik të kooperativës. Në një gjendje të tillë ne nuk do të bënim gjë tjetër, veçse do t'u jepnim kryesive dhe kryetarëve të kooperativave bujqësore kompetenca shumë më të mëdha se të sotmet. Kështu ata do t'i imponoheshin një organizate ekonomike socialiste të grupit, siç është kooperativa bujqësore, duke zbehur demokracinë kooperativiste. Ka kryetarë kooperativash, që edhe pa u veshur me funksione pushteti politik, tregohen kapadainj, lëre ç'do të ndodhte pastaj sikur të vishen edhe me funksione të tilla.

Me sektorin e kooperativës nuk duhet kuptuar vetëm fshati. Ndërsa sektori merret me administrimin e bujqësisë, të blegtorisë dhe të veprimtarisë tjetër prodhuese në një sipërfaqe të caktuar toke, dhe për këtë shkak, si të thuash, është qendra e punës së kooperativistëve (siç është të themi kombinati i tekstileve «Stalin» për punëtorët që banojnë në lagjen nr. 6 të Tiranës), fshati është qendra e banimit të tyre. Kooperativistët për të vajtur në punë mund të bëjnë edhe një orë e gjysmë rrugë. Në sektor çdo gjë lidhet me veprimtarinë prodhuese të kooperativistëve dhe jo me banimin e tyre.

Sipas jush, kryetari i kooperativës duhet të jetë edhe kryetar i pushtetit në fshat, kurse agronomi, zoolo-veterineri dhe të tjerët, që janë specialistë në kooperativë, të jenë këshilltarë! Këshilli ka funksione të tjera, që janë, në radhë të parë, funksione politike, kurse drejtimi operativ ekonomik i ndërmarrjes nga ana e drejtorisë dhe i kooperativës nga ana e kryesisë së saj është diçka tjetër. Këto janë dy çështje parimore të ndryshme, të cilat kurrsesi nuk duhen përzier. Ju thoni se kryesinë e kooperativës bujqësore e zgjedh populli, por edhe këshillin popullor, edhe gjykatën e fshatit, të tëra populli i zgjedh. Mirëpo ky fakt nuk do të thotë aspak se këto organe të ndryshme, që kanë kompetencat dhe detyrat e tyre të veçanta, të mbështetura në parimet dhe në ligjet tona, mund t'i bashkojmë në një organ të vetëm dhe kur të duam.

Mbledhja e përgjithshme e kooperativës bujqësore nuk është identike me zgjedhësit e këshillit popullor të fshatit. Ajo vërtet zgjedh kryesinë e koopera-

tivës, por përbëhet nga të gjithë anëtarët që kanë mbushur moshën 15 vjeç e lart, kurse, sipas Kushtetutës këshillat popullorë zgjidhen vetëm nga shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Në kryesinë e kooperativës bujqësore, sipas statutit tip, mund të zgjidhen edhe kooperativistë, të cilët nuk e kanë mbushur moshën 18 vjeç, kurse në këshillin popullor këta kooperativistë as mund të zgjedhin dhe as mund të zgjidhen. Ju nuk i kuptoni mirë karakteristikat e kooperativës bujqësore si ekonomi socialiste e bazuar në pronën e grupit, prandaj edhe nuk e keni të qartë, se, po e vumë këtë ekonomi nën drejtimin operativ të pushtetit, ajo e ndryshon karakterin e saj.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## SHOKUT E MIKUT I FLITET KURDOHERË ME ZEMËR TË HAPËT

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës në Tiranë,  
Liu Xhen Hua*

23 shkurt 1971

*Në fillim shoku Enver Hoxha takohet me ambasadorin kinez dhe i uron atij mirëseardhjen në vendin tonë. Pastaj ambasadori kinez falënderon shokun Enver Hoxha për pritjen e ngrohtë, duke thënë se kjo pritje ishte një nder i madh që i bëhej.*

*Duke vazhduar këtë bisedë shoku Enver Hoxha vuri në dukje:*

Ju vini për herë të parë në Shqipëri, prandaj dhe keni nevojë të njiheni nga afër me popullin dhe me Partinë tonë, me luftën e me përpjekjet që bëjmë ne për ndërtimin e socializmit. Them kështu, sepse kur e njohim mirë njëri-tjetrin, edhe bashkëpunimi e ndihma reciproke vëllazërore midis nesh, në të gjithë sektorët, do të jenë të frytshëm. Prandaj ka rëndësi çështja që të merrni kontakt me njerëzit tanë, t'i pyetni e të bisedoni me ta për të gjitha problemet që dëshironi të dini.

Gjatë kontakteve që do të merrni me punonjësit tanë, ju do të njiheni me punën dhe me jetën e popu-



llit shqiptar, me karakteristikat e tij të veçanta, me zakonet e me historinë, me zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit tonë, si dhe me forcimin gjithnjë e më shumë të fuqisë mbrojtëse të atdheut tonë socialist.

Ju vetë keni qenë ushtarak; të tërë ne ushtarakë kemi qenë dhe të tillë duhet të jemi gjithmonë, derisa të ekzistojnë imperializmi, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye. Vazhdimisht ne bëjmë përpjekje që të zhvillojmë ekonominë, industrinë, bujqësinë, por kurdoherë e kemi për detyrë të forcojmë, në radhë të parë, mbrojtjen e vendit tonë, të jemi vigjilentë dhe të gatshëm për të përballuar çdo sulm të armiqve. Jo vetëm për ne të brezit që kemi bërë luftën, por për të gjithë, duke filluar nga më i vogli e deri te më i madhi, krahas kujdesit për të mësuar agroteknikën, si të punojmë tokën, si të prodhojmë të mira materiale, është e domosdoshme të përgatitemi e të stërvitemi për të mbrojtur vendin duke e mbajtur barutin kurdoherë të thatë.

Ne asgjë nuk ju kemi fshehur dhe nuk do t'ju fshehim juve, sepse ju konsiderojmë shokë dhe miq dhe shokut e mikut i flitet kurdoherë me zemër të hapët. Përkundrazi, do të jemi shumë të kënaqur në rast se ju do ta njihni sa më mirë realitetin e vendit tonë dhe ne do t'ju krijojmë mundësitë që ta shihni atë.

Punët na shtohen vazhdimisht, por veçanërisht këtë vit do të kemi më shumë, mbasi do të thërresim Kongresin e 6-të të Partisë<sup>1</sup>, në pragun e 30-vjetorit të formimit të saj. Gjer atëherë do të kemi rastin të

---

1. 1 nëntor 1971.

bisedojmë përsëri me ju. Vetëm dëshiroj t'ju them, shoku ambasador, që me shokët e Komitetit Qendror, të Qeverisë dhe me mua, sa herë që do të dëshironi, mund të kërkonti të takohemi, të bisedojmë e të shkëmbejmë mendime. Kjo është e domosdoshme të bëhet midis nesh, për rrugën dhe për luftën e përbashkët kundër armiqve të jashtëm, e cila është dhe do të vazhdojë të jetë e ashpër. Bashkërisht, herë pas here, ne mund të shkëmbejmë mendime edhe për taktikat dhe për strategjinë tonë, për t'ua kundërvënë me sukses taktikave dhe strategjisë së armiqve.

Lufta që bëjmë ne brenda vendit për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë sonë, për spastrimin, vazhdimisht, të radhëve të saj nga elementët armiq e të lëkundshëm që nxjerrin kokën herë pas here, për forcimin e për kalitjen e diktaturës së proletariatit dhe të unitetit të Partisë me popullin, për zhvillimin e mëtejshëm dhe me sukses të ekonomisë, të industrisë, të bujqësisë, të kulturës etj., është me rëndësi të madhe. Të gjitha këto janë detyra që qëndrojnë përpara çdo partie marksiste-leniniste. Prandaj, për zgjidhjen e tyre ne kemi nevojë për ndihmën e njëri-tjetrit. Vizitat reciproke luajnë pa dyshim një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Por gjithnjë e më shumë na bëhet e qartë se për të përfituar sa më shumë nga njëri-tjetri, është e domosdoshme që të kemi midis nesh një bashkëpunim «pa ceremoni», «pa diplomaci»<sup>1</sup>.

---

1. Ndryshe sillej e vepronte udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës. Siç vë në dukje shoku Enver Hoxha: «Udhëheqësit kinezë nuk ftuan për vizitë ndonjë delegacion të Par-

Vazhdimisht armiqtë tanë luftojnë kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit e popujve. Por është e qartë se asnjë veprim armiqësor që drejtohet kundër partisë marksiste-leniniste dhe socializmit, në çfarëdo rrethane, maske dhe demagogjie qoftë, nuk mund t'u shpëtojë marksistë-leninistëve pa e zbuluar dhe pa e dënuar. Këtu qëndron forca e madhe e ideve dhe e gjykimit tonë marksist-leninist. Lufta e vendosur që është zhvilluar e po zhvillohet sot ndërmjet marksistë-leninistëve dhe tradhtarëve, armiqve të hapët ose të fshehtë, ndërmjet ideve ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit dhe atyre borgjeze e revizioniste përbën një eksperiencë kolosale për të gjithë revolucionarët e botës. Në këtë eksperiencë ne shikojmë se si marksistë-leninistët zbulojnë në kohën e duhur veprimet jo të rregullta, oportuniste dhe armiqësore të elementëve antiparti në shkallë të ndryshme dhe luftojnë për t'i shkatërruar ato. Zbulimi i tyre që në lindje është një tipar dallues i marksistëve të vërtetë. Një tjetër karakteristikë e tyre është që ata përpiqen t'i

---

tisë sonë për të studiuar eksperiencën e tyre. Edhe kur ka shkuar atje ndonjë delegacion, me kërkesën e Partisë sonë, më shumë i kanë bërë propagandë dhe e kanë çuar andej-këtej për vizita nëpër komuna e fabrika, sesa i kanë dhënë ndonjë shpjegim ose eksperiencë për punën e partisë. Dhe me kë e mbanin këtë qëndrim të çuditshëm? Me ne, shqiptarët, miqtë e tyre, që i kemi mbrojtur në situatat më të vështira. Të gjitha këto veprime ishin për ne të pakuptueshme, por edhe një sinjal që tregonte se Partia Komuniste e Kinës nuk donte të na jepte një pasqyrë të qartë të gjendjes së saj». (Enver Hoxha, «Imperializmi dhe revolucioni», botim i dytë, Tiranë, 1978, f. 381.)

shpëtojnë njerëzit që gabojnë, t'i ndreqin, t'i çojnë në rrugë të drejtë, t'u hapin sytë. Si rrjedhim i këtyre përpjekjeve, shumica korrigohet, por ndodh që ndonjë e vazhdon rrugën e vet të gabuar. Kur ky, me gjithë ato përpjekje që bën Partia për ta kthyer në rrugë të drejtë, e mbush kupën, atëherë vjen vendimi i drejtë, logjik dhe vendimtar i saj që gjykon ç'duhet dhe si duhet bërë në interes të klasës punëtore, për t'u dhënë grushtin përfundimtar armiqve të pandreqshëm. Natyrisht, një gjë e tillë nuk është e lehtë. Vetëm një parti e vërtetë marksiste-leniniste është e sigurt në veprimet e saj, ajo as nuk ngutet dhe as nuk bëhet nervoze, nuk hakmerret dhe nuk shpejtohet, por mendohet mirë kur duhet marrë kjo ose ajo masë, pse gjykon që çdo gjë duhet bërë në kohën e vet.

Si tani, edhe në të ardhmen ne do të korrим sukseese akoma më të mëdha në ndërtimin e socializmit. Gjatë kësaj rruge ne kemi zhvilluar e do të zhvillojmë një luftë të ashpër kundër elementëve armiq, të hapët ose të fshehtë, që përpiqen të pengojnë ecjen tonë përpara dhe luftën tonë ngadhënjimtare kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik. Lufta jonë, e marksistë-leninistëve, në të gjitha këto drejtime do të jetë kurdoherë fitimtare, pse me ne është e drejta, prandaj jemi e do të jemi kurdoherë më të fortë se të gjithë armiqtë tanë. Ne na do populli, na mbron, na ndjek në rrugën tonë, kurse armiqtë tanë popullin e kanë kundër, prandaj çdo gjë e mbështetin vetëm tek armët. Por populli është forca vendimtare, kurse armët, pavarësisht nga rëndësia që kanë, janë faktor i dorës së dytë. Ideologjia jonë është revolucio-

nare dhe fitimtare, ideologjia e tyre është reaksionare, është ideologji e disfatës, e vdekjes. Për të gjitha këto, imperialistët, revizionistët dhe të gjitha bishtrat e tyre, nën çdo maskë që të fshihen, janë të destinuar të dështojnë.

*Duke përfunduar këtë bisedë, shoku Enver Hoxha i shprehu ambasadorit kinez ndjenjat e larta të miqësisë së popullit tonë për popullin kinez.*

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

# NDAJ VEPRAVE TË NDRYSHME PENALE TË ZBATOJMË KURDOHERË DREJT FOLITIKËN E PARTISË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

24 shkurt 1971

Marrim në shqyrtim pikën e parë, projektin e Kodit të ri Penal<sup>1</sup>. Keni ndonjë gjë për të shtuar ju shokët e komisionit?

*Pasi folën shokë të komisionit dhe pyetën e diskutuan shokët e Byrosë Politike, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Unë nuk e kuptoj kështu si Kadriu<sup>2</sup> këtë çështje. Nuk ka pse të dënohet një person në qoftë se, pa

---

1. Kjo çështje nisi të diskutohet në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH të datës 26 tetor 1970, por u shty për t'u shoqëruar edhe me disa studime e shpjegime. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 44, f. 379.)

2. Armiku i kamufluar Kadri Hazbiu ishte kundër diferencimit në ndjekjen e veprave penale dhe, si rrjedhojë, për shtimin e goditjeve pa qenë nevoja, pra për shtimin e masave represive.

ra disa vjetësh ka folur keq për pushtetin, por që atëherë e gjer më sot ka ndryshuar mendim dhe s'ka bërë asnjëfarë propagande ose agjitacioni kundër pushtetit.

Ta zëmë se ky person, që para disa vjetëve foli kundër pushtetit, nuk u dënua atëherë, sepse organet kompetente ë thirrën dhe e këshilluan. Kjo që bënë organet tona është një punë e mirë, dhe sipas mësimeve të Partisë, prandaj kështu duhet të veprojnë ato edhe në raste të tjera të kësaj natyre. Në qoftë se i njëjti person, me gjithë këshillat e dhëna, pas disa vjetëve këtë faj e përsërit, në bazë të ligjit, organet kompetente e ndjekin penalisht dhe gjykata e dënon. Kjo nuk e pengon aspak zbatimin e politikës së Partisë për dënimin e krimit.

Sigurisht, në qoftë se personi që u këshillua atëherë, pas një kohe me fjalët dhe me veprimet e tij bëhet i rrezikshëm për shoqërinë dhe për pushtetin popullor, do ta dënojmë. Por për një tjetër, që ka thënë kundër pushtetit një fjalë këtu dhe një fjalë atje, pa qenë armik, natyrisht, do të bëjmë diferencim. Kjo politikë nuk bie ndesh me vijën e Partisë. Por në qoftë se edhe një person me prejardhje të mirë flet kundër pushtetit dhe kthehet në një element me rrezikshmëri shoqërore, atëherë kundër tij do të marrim masën e duhur e nuk mund t'i fërkojmë krahët.

Ti, Kadri, nuk e ke kuptuar mirë këtë problem. Nuk ka se si që një armik, gjatë një kohe, të flasë vetëm një fjalë kundër pushtetit. Në qoftë se armiku nga frika e ndëshkimit tonë të rreptë, vepron fshehtas, nuk do të mbetet pa u zbuluar nga populli e nga

organet tona, dhe, kur të ketë prova se ka zhvilluar veprimtari kundër pushtetit, do të ndiqet penalisht.

Unë mendoj që ndjekja penale për krimin e agjacionit e të propagandës duhet parë dhe duhet kuptuar drejt dhe jo ashtu siç thotë Kadriu që edhe për disa fjalë apo veprime të kryera para disa vjetësh, një person, të merret në ndjekje penale, edhe pse nuk ka kryer gjatë kësaj kohe ndonjë veprimtari tjetër. Në qoftë se pas kalimit të një kohe e zbulojmë autorin e kësaj vepre penale dhe shohim se ai ka ndryshuar rrugë dhe nuk e ka përsëritur herë tjetër atë, kjo është një rrethanë lehtësuese, që, natyrisht, do mbajtur parasysh në llojin dhe në masën e dënimit. Ai që kryen veprën penale kundër pushtetit do të gjykohet, duke u marrë parasysh prejardhja klasore, personaliteti i tij, qëllimi armiqësor, shkalla e fajit, situata politike etj. Kur dikush me veprimin që kryen del se ka degjeneruar dhe e ka mbushur kupën, kuptohet, kështu ai është shndërruar në armik klase dhe, në këtë rast, duhet dënuar si i tillë.

Këtu u thanë mendime edhe për hetuesinë dhe gjykatat. Këto janë organe që kanë detyra të ndryshme, por që lidhen ngushtë njëra me tjetrën. Ndërsa hetuesia kryen hetimin dhe nëpërmjet prokurorit e dërgon çështjen për gjykim në gjykatë<sup>1</sup>, kjo e fundit, në bazë të rregullave ligjore, materiale dhe procedurale, e gjykon çështjen dhe jep vendimin. Për vendimet e

---

1. Sipas Kodit të ri të Procedurës Penale, hetuesi e dërgon drejtpërdrejt çështjen në gjyq dhe jo nëpërmjet prokurorit, siç ishte në kohën kur flet autori.



formës së prerë nuk lejohet ankimi, por megjithëkëtë, kur personat e autorizuar me ligj shikojnë se një vendim nuk përputhet me ligjin ose me provat, ushtrojnë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ankesa e qytetarit kundër vendimit të formës së prerë u paraqitet personave të autorizuar me ligj, të cilët materialet nuk i hedhin në shportë, por, siç tha shoku Aranit Çela, i studiojnë me shumë kujdes, marrin të dhëna nga rrethet etj., siç veprojmë edhe ne me komitetet e Partisë kur persona të ndryshëm na paraqesin kërkesa ose ankesa.

Lidhur me vuajtjen e dënimit është e domosdoshme të mbahet parasysh që rregullat e vuajtjes së dënimeve të mos bien ndesh me parimet. Nuk është e drejtë, as parimore që edhe ata persona, të cilët kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të madhe shoqërore, ta vuajnë dënimin në qendrat e punës. E bukur «reformë» që na propozohet<sup>1</sup>! Në rendin tonë socialist në qendrat e punës, në kolektivat ku zien puna dhe shpirti revolucionar, punojnë e prodhojnë njerëzit e lirë. Është tjetër gjë, kur njerëzit që kryejnë ndonjë veprë penale jo shumë të rrezikshme dhe që mendohet se nuk e vlen të dërgohen në gjyq, për këta fare mirë mund të përdoren si mjete edukuese, kritika e rreptë në frymë shoqërore, aty në kolektiv, ose mund të merren masa administrative, si shkarkimi nga përgjegjësia etj. Mua më tërheqin vëmendjen të dhënat stati-

---

1. Kjo ide u fut në projektkodin penal nën presionin që bëri në komision e në Qeveri armiku M. Shehu, i cili ngulte këmbë që ajo të zbatohet, por iu hodh poshtë nga shoku Enver Hoxha.

stikore për veprat penale, të cilat, mendoj, se na ndihmuan për të shpjeguar dhe për të ilustruar problemet me rëndësi që diskutuam në këtë mbledhje të Byrosë Politike për projektin e ri të Kodit Penal. Unë mendoj se është shumë e arsyeshme dhe e domosdoshme që herë pas here t'i paraqiten Byrosë Politike të dhëna të tilla.

Por Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Punëve të Brendshme me anën e organeve të tyre duhet t'ua dërgojnë edhe rretheve të dhëna të tilla sipas linjës së tyre, me qëllim që si ne në qendër, ashtu edhe shokët e rretheve të nxjerrin prej tyre detyra politike.

Po të analizojmë numrin e veprave penale që kryhen në vendin tonë, në krahasim me vendet borgjeze e revizioniste, del se te ne ato janë shumë më të pakta. Megjithatë, edhe kaq sa janë, ne duhet t'i shohim me sy kritik e të veprojmë me kujdes. Me sa shoh unë, përvetësimet e ndryshme të pasurisë socialiste janë më të përhapurat. Kjo do të thotë se armiqtë, krahas goditjeve kundër sigurimit të Republikës sonë Popullore, aktualisht, synojnë të na luftojnë sidomos me dëmtimin e bazës ekonomike, duke nxitur vjedhjet, dëmtimet, shpërdorimet e pasurisë socialiste etj.

Jam dakord me mendimin që ta intensifikojmë propagandën tonë në këto drejtime, por të jemi realistë; për parandalimin e krimeve nuk mjaftojnë vetëm fjalët, por duhen marrë edhe një sërë masash të gjithanshme. Prandaj Partisë dhe pushtetit, në qendër e në bazë, si dhe ndërmarrjeve shtetërore u bie detyra të studiojnë, të organizojnë dhe të zbatojnë mirë masat

politike, organizative dhe të sigurimit për mbrojtjen e pasurisë socialiste.

Një punë më e dendur politike e ideologjike duhet bërë edhe në fshat, ku ka mjaft dëmtime, sidomos të ekonomisë pyjore. Sigurisht kjo punë duhet të shoqërohet edhe me masa të forta organizative për plotësimin e nevojave të fshatarit për sigurimin e druve të zjarrit, sepse mendoj që në dëmtimet në këtë sektor ndikojnë më shumë këto nevoja sesa prirjet për të dëmtuar pasurinë e përbashkët.

Për sa u përket veprave penale në drejtime të tjera, si në atë të cenimit të jetës së personit, shëndetit të njerëzve, kundër dinjitetit të personit, martesës dhe familjes, siç janë: shpifjet, fyerjet, shpërblimet për martesë, bashkëjetesat e ndaluara etj., shfaqje këto që janë kundër moralit e së drejtës socialiste, mendoj se propaganda dhe puna parandaluese duhen ngritur në një shkallë më të lartë. Këto shfaqje duhen vlerësuar drejt, të studiohen nga afër dhe seriozisht me qëllim që të zbulohen shkaqet e vërteta që i linden, për të bërë të mundur kështu ngritjen e opinionit shoqëror dhe ndërtimin e punës së efektshme parandaluese.

Nga ana e gjykatave, e prokurorive, e organeve të punëve të brendshme dhe e këshillave popullorë, mbështetur në vijën e drejtë të Partisë, gjer tani është bërë një punë shumë e mirë për pajtimin e grindjeve, për këshillimin e keqbërësve etj. Megjithatë në këtë drejtim puna e Partisë dhe e organeve të specializuara duhet të vazhdojë edhe më me intensitet, me qëllim që shifrat në këto drejtime të vijnë përherë duke u pakësuar. Kryerja e veprave penale, që janë

në kundërshtim me ligjshmërinë, me rendin tonë socialist, është shprehje e qartë e luftës së klasave që zhvillojnë armiqtë kundër nesh.

Politika që kanë ndjekur Partia dhe pushteti në luftën kundër këtyre shfaqjeve dhe veprave penale në tërësi është e drejtë dhe në këtë drejtim ne kemi suksese. Jam i bindur se, sido që nuk kemi statistika për gjendjen e kriminalitetit në vendet revizioniste, ndryshimi ndërmjet tyre dhe vendit tonë është i madh, mund të them, si nata me ditën. Megjithatë, ne në asnjë mënyrë nuk duhet të qetësohemi apo të kënaqemi, por të shumëfishojmë kujdesin për edukimin e njerëzve dhe të zhvillojmë një propagandë më të dendur kundër krimeve, në plan politik, ekonomik e shoqëror.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

**KURSET DHE SHKOLLAT PA SHKËPUTJE NGA  
PUNA TI MBAROJNË TË GJITHË ATA  
QË REGJISTROHEN NË TO**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**24 shkurt 1971**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si shkoni me punë ju shokë, që punoni në hidrocentral?

**SHOKU EMIN MYSLIU<sup>2</sup>:** Mirë, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Megjithëse ne kemi këtu raporte të paraqitura nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Shkodrës dhe nga Ministria e Ndërtimit edhe ju mund të na thoni diçka për situatën në hidrocentral.

*Pasi u diskutua për arritjet e kolektivit të Hidrocentralit të Vaut të Dejës dhe për vënien në shfrytëzim të turbinës së parë, shoku Enver Hoxha u interesua të dinte për kualifikimin e punonjësve të këtij*

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua puna e bërë për vënien në shfrytëzim të turbinës së parë në Hidrocentralin e Vaut të Dejës.

2. Në atë kohë drejtor i Hidrocentralit të Vaut të Dejës.

*hidrocentrali, për kurset që zhvillohen lidhur me këtë dhe si ndiqen ato, për specialitetet e ndryshme që fitojnë punëtorët në këto kurse etj. Mbas përgjigjeve që u dhanë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Unë pyeta për këto çështje, pasi konstatojmë se në kurse na hyjnë mijëra veta dhe mbarojnë shumë pak. Siç u tha këtu, punëtorët pa shkëputje nga puna, bëjnë gjashtë orë kurs në javë, tri herë nga dy orë. Me një fjalë punëtorët marrin pjesë në këto kurse aq orë në javë sa i paguan shteti. Pra, punëtorët e përfitojnë pagën nga shteti për këto gjashtë orë në javë që shkëputen nga prodhimi dhe, kur vjen fundi që të japin provimet, nuk mbarojnë të tërë. Por ne duam të dimë ekzaktësisht se sa punëtorë i frekuentojnë këto kurse dhe sa prej tyre përfitojnë në to profesionin e duhur, sipas specialiteteve? Kështu, kur të themi një ditë se na duhen, ta zëmë, 200 karpentierë, ndërmarra që ka zhvilluar kurset e ka dhënë kategoritë përkatëse, sipas specialiteteve, të jetë në gjendje të na i japë menjëherë. Konkretisht, ne kemi të drejtë të pyesim shokët e Vaut të Dejës: «Çfarë plani keni për përgatitjen e kuadrove për Hidrocentralin e Fierzës, për shembull, sikur ne, pas motmoti ose motmoti e gjysmë t'ju kërkojmë një numër kuadrosh e specialistësh të përgatitur? A jeni në gjendje të na thoni që këta ose ata specialistë i keni gati?». I them këto që, kur të fillojnë vepra të tjera të ngjashme, të mos e nisim përsëri punën me kuadrin nga abëcëja, se, po filluam kështu, humbasim kohë, humbasim para dhe puna, që kemi bërë gjer tani për përgatitjen e mjeshtërve, nuk duket hiçgjëkundi. Jo vetëm kaq, por numrin e punëtorëve, si

kudo, edhe në hidrocentrale ta kufizojmë sa të jetë e mundur më shumë, ndaj çdonjëri nga këta mund të mësojë jo një, por nga dy e nga tri profesione që të ketë mundësi të punojë në disa vende pune, sipas nevojës. Prandaj, ju shokët e Partisë të rrethit të Shkodrës duhet të përqendroni vëmendjen në këto drejtime, për tash dhe për perspektivën, të veproni me përgjegjësi dhe jo të ngrini duart. Kjo nuk do të thotë se në Hidrocentralin e Fierzës nuk do të hapim kurse dhe shkolla për përgatitjen e minatorëve, të sondatorëve e të specialistëve të tjerë. Jo, edhe atje duhet të hapim, por jo për të tëra mjeshtëritë të nisim nga e para. Disa nga mjeshtrit e Hidrocentralit të Vaut të Dejës duhet të shkojnë për të punuar në Hidrocentralin e Fierzës dhe jo të nxjerrin pengesa me lloj-lloj arsyetimesh.

U tha këtu se ka disa punonjës nga qyteti i Shkodrës, që kundërshtojnë të venë në Fierzë. Po ç'do të bëjnë tërë ata në Shkodër? Duhet punuar shumë, me të gjitha format për t'i bindur ata që vajtja atje është e domosdoshme, se Shkodra është qytet i madh me më shumë se 50 mijë banorë, kurse Bajram Curri ka më pak se katër mijë. Po ashtu, aty afër është edhe Puka. Atëherë nga do të vijnë tërë ata specialistë që kërkon ndërtimi i hidrocentralit? Po i hoqëm nga fshati banorët e Bajram Currit dhe të Pukës, atëherë mbaroi bujqësia në këto rrethe. Këtë situatë ta shikoni mirë. Puna atje sigurisht që është sakrificë për ta, por duhet ta kuptojnë drejt si një detyrë me rëndësi ndaj popullit dhe atdheut. Ne, nga ana tjetër, duhet t'u

përgjigjemi sa të jetë e mundur më mirë kërkesave, nevojave dhe halleve familjare të atyre që do të shkojnë atje.

Pra, ne edhe për çdo rast tjetër do të nisemi sipas llogarive që na janë dhënë nga drejtuesit e ndërmarrjeve, prandaj kur u kërkojmë të dhëna duhet të na përgjigjen saktë e me baza e jo të na thuhet: «Dale se nuk mund t'ju japim kaq, se nuk kemi mundësi». Të mos ndodhë që, kur është puna për të bërë kërkesa, të mos shikohen llogaritë, ndërsa në raportet të na paraqiten gjërat shesh me lule.

Po a kontrollohet vazhdimisht zbatimi i programit për përgatitjen e kuadrove dhe të specialistëve të prodhimit? A venë rregullisht punonjësit në kurse? A mësojnë mirë ata që shkëputen nga puna? Po inxhinierët apo të tjerët që japin mësim si pedagogë në këto shkolla e kurse, a shkojnë rregullisht në to? Unë e kam fjalën sidomos për ata që janë caktuar nga ndërmarrjet për të dhënë mësim, si pedagogë të jashtëm, me orë, jo për ata që janë efektivë, pedagogë të rregullt, sepse ata kuptohet që e bëjnë mësimin. Pra, kush interesohet për mbarëvajtjen e këtyre kurseve të kualifikimit dhe për shkollat pa shkëputje nga puna?

Na thuhet se punonjësit kanë shumë dëshirë të vazhdojnë shkollën e të ndjekin kurset, se pedagogët që japin mësim punojnë mirë, por, kur është gjithë kjo dëshirë e madhe për të mësuar, me «disa përjashtime të vogla», pse atëherë ka kalueshmëri të paktë siç përmendet edhe në raport? A mund të na thuhet gjë për këtë? Pse përfitimi është shumë i paktë, kur puno-



njësit e vazhdojnë kursin ose shkollën në rregull? Ne kemi edhe të dhëna të tjera, sipas të cilave, ka ndodhur që vetëm gjysma e atyre që regjistrohen, vazhdojnë dhe mbarojnë. Puna është që të mos na vënë në gjumë për këtë çështje.

Është e vërtetë që regjistrohen shumë në kurse e shkolla dhe, për këtë vit, jemi dakord që pjesëmarrja është e madhe, por problemi shtrohet se sa veta i mbarojnë ato. Këto mendime të Komitetit Qendror s'janë të sivjetme, por të vjetme dhe të parvjetme. Gjithmonë janë dhënë orë nga prodhimi për këtë punë. Megjithëse pjesëmarrja ka qenë e madhe, rezultatet kanë qenë të dobëta, prandaj nga kjo eksperiencë e hidhur ne themi që duhet të kërkohet më shumë.

Çështja është që njerëzit të venë në kurse e në shkolla, të mësojnë mirë dhe orët që marrin nga prodhimi t'i shfrytëzojnë për mësim dhe jo të bredhin e të shëtitin. Kuadrot që, përveç punës, i ngarkojmë plus edhe me detyrën e mësimdhënies, duhet ta kuptojnë politikisht detyrën e të shkojnë rregullisht për t'u shpjeguar nxënësve mësimet në të gjitha lëndët e përfshira në program. Jo vetëm kaq, por shpjegimin ata duhet ta bëjnë sa më interesant e me vlerë, në mënyrë që edhe nxënësit që vijnë nga malësia të kenë mundësi t'i kuptojnë mësimet, se vetëm vullneti i tyre për të mësuar, nuk mjafton. Aq më e domosdoshme bëhet kjo, kur ne akoma nuk jemi në gjendje të plotësojmë siç duhet me dispensa e libra qindra mijëra njerëz, me ose pa shkëputje nga puna. Edhe për një kohë ne mund të kemi mungesa për tekste. Atëherë, me të drejtë, mund të lindë pyetja: Ku do të mësojnë gjithë këta

njerëz? Këta do të mësojnë në ata pak libra që kanë dhe me kujdesin e pedagogut, i cili, ashtu si nxënësit, duhet të vejë në rregull.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## TË VENDOSIM RREGULLA TË FORTA PËR RUAJTJEN E SEKRETIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

24 shkurt 1971

Edhe unë mendoj se kujdesi për ruajtjen e sekretit ka një rëndësi të madhe parimore dhe edukative, prandaj atë duhet ta mbajmë vazhdimisht të ngritur, si në fushën ushtarake, ashtu edhe në të gjithë sektorët e ndryshëm të jetës së vendit tonë. Në këtë drejtim kemi akoma të meta. Në mjaft raste vërehen lëshime, që e kanë burimin në disa pikëpamje jo të drejta, siç janë: nënvleftësimi i armikut, zbutja e luftës së klasave, të folurit nga ndonjëri pa qenë aspak nevoja, përpara masave për probleme partie, shtetërore, mendimi i gabuar nga ndonjë i ngarkuar me këtë ose me atë punë sikur e ka për detyrë t'i thotë kujtdo çdo gjë që di vetë etj. Pikëpamje të tilla i bëjnë disa që të mos mbrojnë si duhet sekretet shtetërore.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth problemit «Mbi nevojën e ngritjes në një nivel më të lartë të vigjilencës revolucionare dhe masat që duhen marrë për forcimin e disiplinës në ruajtjen e sekretit shtetëror».

Ruajtja me kujdes të madh e sekreteve shtetërore dhe të Partisë duhet kuptuar mirë nga të gjithë, pse kjo është për të mirën e popullit dhe aspak për të keqen e tij. Ai nuk i dobëson aspak, përkundrazi i forcon lidhjet e Partisë me masat, rrit dashurinë dhe besnikërinë që ato ushqejnë për Partinë, i bën më efektive përpjekjet që bën ajo për të mirën e atdheut. Prandaj është jashtëzakonisht i gabuar dhe i dëmshëm qëndrimi që mban ndonjëri, kur me mendjelehtësi flet përpara të tjerëve për çështje me karakter sekret.

Duhet kuptuar mirë se nuk janë qelibar të gjithë njerëzit. Ka prej tyre që flasin në erë për luftën e klasave. Ka të tjerë që kanë kryer ose kryejnë faje të ndryshme dhe për këtë janë dënuar; ka dhe nga ata që nuk janë të formuar; ka aty-këtu edhe elementë armiq, të cilët punojnë bashkë me punonjës, por nuk njihen se janë të tillë. Atëherë, si mund të flitet në rrethe të tilla njerëzish? Ç'është kjo mungesë vigjilence? Ç'janë këto thashetheme, këto shkelje të rregullave e të normave të Partisë lidhur me ruajtjen e sekreteve? Ne duhet të shkundemi fort në këtë drejtim, shokë, të forcojmë pareshtur edukatën komuniste rreth këtij problemi. Puna në këtë drejtim nuk është aq e lehtë, as arrihet menjëherë dhe vetëm me rrugën e edukimit. Vetëm me parulla është e zorshme t'i arrihet qëllimit të ruajtjes së sekreteve, prandaj krahas punës edukative të jemi njëkohësisht edhe të rreptë ndaj gjithë atyre që shkelin normat dhe rregullat e vendosura nga Partia për sekretin. Në asnjë rast të mos jemi zemërgjerë dhe të familjarizuar, duke u nisur nga pikëpamja e huaj se këtë ose atë e kam shok, e kam të mi-

nistrisë ose të sektorit, prandaj mund të bisedoj me të edhe për ato çështje që atij s'i përkasin t'i dijë. Po të mendojmë e të veprojmë kështu, rregullat që kemi vendosur për t'u zbatuar, nuk kemi për t'i vënë kurrë në jetë.

Mua më duket se shumë gjëra për ruajtjen me rreptësi të sekreteve nuk i kemi studiuar me kujdes. Kështu, duke u nisur më shumë nga dëshira e mirë për të vënë në dukje sukseset e arritura në të gjitha fushat, disa shokë i merr përpara njëfarë entuziazmi dhe, pa u thelluar në pasojat, nxjerrin para të gjithëve të dhëna që nuk është nevoja të dihen në shkallë të gjerë. Për këtë gjendje faj kemi edhe ne në qendër, pse në gjithë këtë eufori, në këtë entuziazëm, ndonjëherë kemi rënë edhe ne. Armiku nuk e ka vështirë që, duke u bazuar në disa tregues që ne vetë i kemi botuar pa u thelluar, me një llogari fare të thjeshtë të gjejë diçka që i duhet për synimet e tij.

Për ruajtjen e sekretit mendoj se nuk është e mjaftueshme vetëm përgatitja e disa rregulloreve, mbasi nuk qëndron puna vetëm këtu. Por edhe në këto rregullore nuk thuhet qartë se i çfarë shkalle sekreti është ky ose ai dokument, mbasi jo të gjithë janë një-lloj. Mundet që një material është sekret, një tjetër është shumë sekret, një i tretë mund të jetë më pak sekret etj., mirëpo kjo çështje në materialet dokumentare dhe në veprime është injoruar. Prandaj çdo dikaster e qendër pune, duke filluar nga ne të qendrës, nga aparati i Komitetit Qendror dhe ai i Këshillit të Ministrave e gjer në bazë, të përcaktojë me kujdes, së pari, cilat materiale janë sekrete dhe cilat nuk konside-

rohen sekrete, që mund të përdoren e të shfrytëzohen pa kufizim nga të gjithë. Një gjë e tillë duhet studiuar mirë dhe me kompetencë të plotë nga çdo dikaster, duke pasur kurdoherë parasysh, në radhë të parë, interesat e lartë të atdheut, interesat e socializmit.

Nuk ka në botë asnjë shtet që të mos tregojë, për shembull, se në cilat zona i ka minierat e tij, një minierë naftë në një zonë, një tjetër diku gjetkë etj. Ne s'duhet të alarmohemi nga të dhëna të kësaj natyre. Ajo që ka rëndësi, shokë, është çështja që ne të përcaktojmë mirë cilat të dhëna gjeologjike të kësaj ose të asaj miniere duhet të mos bien në asnjë mënyrë në dorë të armikut. Kur të kemi përcaktuar qartë këto, atëherë të organizojmë punën e të marrim të gjitha masat që këto të dhëna të mos dalin nga dikasteri ose nga drejtoria e minierës, veçse në bazë të disa rregullave, në mënyrë rreptësisht të kontrolluar dhe t'u jepen vetëm personave që kanë të bëjnë me to, të parashikohen edhe përgjegjësitë për zbatimin e kësaj kërkesë. Do të ketë edhe materiale për njohuri gjeologjike që do të qarkullojnë me disa të dhëna të padëmshme për këtë ose për atë minierë, ta zëmë, për naftën, se nuk mund të bëhet dot pa një gjë të tillë, por puna është se duhen vënë rregulla shumë të shtrënguara se cilat duhet të jenë këto të dhëna dhe si duhet të qarkullojnë ato. Disa prej tyre, për shembull, mund të njihen nga kushdo, pse s'përbëjnë asnjë sekret, të tjera mund të qarkullojnë në një kuadër më të kufizuar, fjala vjen në mes gjithë punëtorëve të naftës; për të dhëna të tjera mund të vihen në dijeni vetëm një numër shumë i kufizuar punonjësish e speciali-

stësh të këtij sektori etj. Një gjë të tillë ne nuk mund ta ndalojmë absolutisht për të tëra çështjet, për arsye se pa një pjesë të tyre, pa dokumentet përkatëse, punëtorët, teknikët dhe specialistët e naftës nuk kanë si punojnë. Pra për punën e tyre ata e kanë të domosdoshme të mbështeten në të dhënat gjeologjike që pasqyrohen në disa dokumente. Prandaj, specialistët e sektorit të gjeologjisë, pas kërkimeve e studimeve që bëjnë dhe pasi i përgatitin të dhënat e dokumentet e duhura, vjen koha që këto ua japin edhe punonjësve të shfrytëzimit për t'u njohur me to, pse këta, pasi t'i studiojnë, do të mbështeten në to, do të punojnë me ndihmën e tyre. Për këta, pra, këto dokumente nuk ka si të jenë sekret, ato do të jenë vazhdimisht në duart e tyre, janë materiale që u duhen dhe do t'u duhen çdo ditë në punë.

Mirëpo për administrimin e të tilla materialeve me karakter sekret është e domosdoshme të ketë disa rregulla se si duhen marrë në dorëzim, si duhen ruajtur, si duhen përdorur e si duhen shfrytëzuar dhe jo t'i jepen kujtdo për t'u njohur me to, as t'u mbahen sekret atyre që e kanë të domosdoshme t'i kenë. Nga këto materiale sekrete do të lindë medoemos nevoja të nxirren edhe disa çështje, nga të cilat mund të botohen edhe në gazeta e në revista. Kjo kërkon që nga ana e shokëve me përgjegjësi të mendohet mirë e me kujdes qysh më përpara se cilat materiale duhen lejuar për botim. Për këtë qëllim është e nevojshme të përcaktohen medoemos disa kritere, pse nuk mund të lejohet të shkruajë për to çdo njeri, as nuk ka përse të shkruhet për ato çështje që kanë karakter sekret, e që

nuk duhen botuar. Çështjen e kam që njerëzit tanë kompetentë, duke u nisur kurdoherë nga qëllimi që t'u vihet në ndihmë atyre që mësojnë në shkolla e kurse ose specialistëve të të njëjtit sektor pune që veprojnë në krahina të tjera, është e domosdoshme të mendojnë thellë e të përcaktojnë çfarë të dhënash e materialesh mund të botohen. Edhe në revistat shkencore del nevoja të ruhem, të mos nxjerrim të dhëna të tilla, njohja e të cilave nga një masë e gjerë njerëzish, na dëmton. Prandaj e theksoj, të kemi shumë kujdes të mos i japim armikut asgjë të gatshme që ka të bëjë me sekretin, sidomos nëpërmjet revistave, gazetave, radios etj.

Për sa thashë më sipër jam i mendimit që kjo çështje të studiohet e të ristudiohet, me qëllim që armikut t'i këputim çdo burim zyrtar nga i cili ai mund të pajiset me të dhëna drejtpërsëdrejti. Duke marrë e duke zbatuar rreptësisht këtë masë, atij do t'i mbetet vetëm rruga e spiunazhit, i cili për të, në vendin tonë, është shumë i kufizuar nga vigjilenca e patriotizmi i lartë i popullit. Prandaj armiqtë përpiqen që burim kryesor informacioni të kenë kurdoherë shtypin dhe radion tonë. Për t'ia prerë këtë burim armikut, kemi për detyrë që të bëjmë sa më tepër kujdes në sektorët e shtypit. Kryesorja është të bëhet mirë klasifikimi se cilat të dhëna duhet të japim në shtyp e në botime publike dhe cilat nuk duhet të japim, cilat duhet të japim me përbindje dhe cilat nuk duhet t'i japim fare. Natyrisht, të mos kuptohet sikur tani s'duhet të kujdesemi për cilësinë e botimeve dhe të lejojmë të dalin materiale «kashtë».



Meqënëse kemi për detyrë të rritim në maksimum kujdesin për ruajtjen e sekreteve, është e nevojshme të shikohet edhe çështja e shifrave. Natyrisht, këto nuk duhet t'i nxjerrim në shtyp, ku mund të botohen me përqindje. Kurse në mbledhjet e këshillave popullorë e të komiteteve ekzekutive të rretheve, në aktive e në mbledhje të tjera mund të përdoren shifra pse pjesëmarrësit e këtyre mbledhjeve janë nga njerëzit tanë më të mirë. Jam i mendimit që këtyre, me përjashtim të disa shifrave, të cilat përbëjnë me të vërtetë sekret të madh shtetëror dhe Qeveria duhet t'i ruajë me kujdes e me përgjegjësi të plotë, të tjerat të mos u fshihen. Prandaj them se duhen përcaktuar cilat janë sekrete dhe nuk duhet të dalin, që jo vetëm agjencurat e huaja të mos mundin t'i shtien në dorë, por as ndonjë kurioz, i cili përpiqet të mbledhë andej-këtej të dhëna që nuk është aspak nevoja t'i dijë.

Çfarë i duhet tjetrit të interesohet e të llogotitë poshtë e lart për gjithfarë kuriozitetesh që nuk i hyjnë në punë? Një frymë e një qëndrim i tillë krijojnë terren shumë të përshtatshëm për të na marrë armiku sekretet. I shtyp apo nuk i shtyp ti, armiku i gjurmon ato, bile i gjen pa shumë vështirësi, se ka edhe ndonjë punonjës të pakujdesshëm, i cili bisedon me gruan, duke menduar se «Gruaja ime është patriote, ka qenë partizane, tani punon në bankë etj., etj. dhe atje ka në dorë shumë gjëra», pra sipas këtij arsyesimi jo të drejtë «përse të mos dijë ajo edhe këto që di unë?!». Kjo nuk është e lejueshme, pse nesër gruaja shkon e i bisedon poshtë e lart me shoqe të tjera dhe kështu del në shesh sekretit, që bie në dorën e armikut. Këto

çështje duhet të vihen në vend, në radhë të parë, duke vendosur kritere e rregulla, po edhe nga ana edukative.

Ndonjë mund të thotë që çështje të tilla ne i kemi studiuar dhe kemi nxjerrë rregulla, mirëpo në anuarët<sup>1</sup> që janë botuar gjer tani vërtetohet e kundërta: çështja e ruajtjes së sekretit në ta s'është mbajtur parasysh. Nëpërmjet tyre armiku na merr fare lehtë edhe të dhëna sekrete. Kjo kërkon të mendojmë se si t'i nxjerrim në të ardhmen këta anuarë, pa qenë nevoja të jepen shifra të tilla, të cilat na dëmtojnë, pavarësisht se ndonjëri niset nga motiv tjetër, për t'u mburrur me shifra konkrete, përpara botës së jashtme lidhur me sukseset që kemi arritur në zhvillimin e ekonomisë sonë! Çështje të tilla, para se t'i publikojmë, e kemi për detyrë t'i gjykojmë me kujdes të madh, politikisht dhe ekonomikisht, pastaj të vendosim ç'gjë duhet botuar dhe cilat nuk duhen botuar.

Anuarët t'i përgatitim e t'i shfrytëzojmë vetë për nevojat tona të brendshme, për punë nga komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive. Kështu jemi dakord, por të botojmë anuarë me të gjitha të dhënat për botën e jashtme, duke u nisur nga mendimi i gabuar se në këtë mënyrë luftojmë propagandën e Perëndimit për gjoja prapambetjen e Shqipërisë, këtë nuk duhet ta lejojmë. S'ka dyshim që armiqtë përpiqen të dinë jo vetëm nivelin e përgatitjeve tona ushtarake, po ata duan të dinë edhe potencialin tonë ekonomik, sepse përpiqen të na luftojnë jo vetëm ushtarakisht, por të na bëjnë edhe bllokadë ekonomike. Prandaj ata synojnë të dinë që ta-

---

1. Vjetarët statistikorë.

ni për sa vjet kemi rezervë buke, yndyrna, veshmbathje etj. Bën llogari armiku në çdo drejtim, prandaj të tëra çështjet, duke përfshirë edhe ato me karakter ekonomik, kanë karakter sekret, pra s'na lejohet të jemi liberalë.

Është e domosdoshme që armikut në asnjë mënyrë të mos i jepet asgjë nëpërmjet organeve tona zyrtare. Ka gojë të njerëzve që flasin, sepse jo të gjithë janë të formuar. Me gjithë punën e madhe që bën e do të bëjë Partia edhe në të ardhmen për edukimin e njerëzve tanë me një vigjilencë të lartë, andej-këtej do të ketë fjalë e thashetheme, nëpërmjet të cilave armiku mund të nxjerrë disa të dhëna për të cilat lufton t'i shtjerë në dorë. Prandaj këto probleme preokupante, siç janë ruajtja e sekretit, edukimi i masave me frymën e patriotizmit, rritja e vigjilencës së njerëzve, ne duhet t'i theksojmë e t'i ritheksojmë dhe t'i mbajmë vazhdimisht në rendin e ditës.

Këto kanë rëndësi të madhe, prandaj duhet treguar kujdes i veçantë, në rrugë shtetërore, nga të gjitha dikasteret, po edhe në rrugë partie.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

**MË SHUMË TË PREOKUPOHET PARTIA  
PËR PËRHAPJEN E KULTURËS DHE PËR  
SHFRYTËZIMIN E KOHËS SË LIRË  
NGA PUNONJËSIT**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 shkurt 1971**

Jam dakord me propozimet dhe me sugjerimet mjaft të vlefshme që u bënë lidhur me marrjen e një sërë masash nga ana shtetërore dhe e Partisë për punën e institucioneve kulturore dhe të shfrytëzimit të dobishëm të kohës së lirë nga punonjësit. Për zgjidhjen drejt të problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe me aktivizimin më të gjerë të institucioneve kulturore dhe për shfrytëzimin e kohës së lirë nga punonjësit, duhet punuar dhe duhen marrë masa me iniciativë jo vetëm në qytet, por edhe në fshat.

Fshati në asnjë rast s'duhet të harrohet. E thek-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme të punës së institucioneve kulturore dhe të shfrytëzimit të dobishëm të kohës së lirë nga punonjësit.

soj këtë çështje, për arsye se në diskutimet dhe në shtrimin e detyrave lidhur me problemet që po shqyrtojmë, e harrojmë fshatin. Edhe në rastin konkret sot këtu u fol shumë që duhen bërë këto ose ato gjëra për qytetin, po për fshatin s'u tha gjë. Prandaj ne duhet t'i kthejmë sytë edhe nga fshati, sepse ashtu si të gjithë, edhe kooperativistët e kooperativistet që punojnë e lodhen, kanë nevojë të dëfrenjë e të pushojnë. Në qytete ka klube të ndryshme, kinema, teatër, estradë, parqe, stadione dhe institucione të tjera për edukimin, për argëtimin dhe për çlodhjen e punonjësve, po në fshat çfarë ka? Atje ka vetëm një vatër kulture, që edhe ajo shpesh lihet pas dore. Kjo nuk është aspak e rregullt. Prandaj me rastin e punës që do të bëjmë për rishikimin e planit të ri pesëvjeçar, siç e thanë shumë drejt shokët Ramiz [Alia] dhe Manush [Myftiu] dhe me mendimin e tyre jam edhe unë që, për zhvillimin e kulturës në shumë sektorë, kuotat dhe orientimet e dhëna t'i rishikojmë edhe një herë me kujdes, të ndreqim disa gjëra që nuk janë parë me këtë sy që po diskutohet sot dhe problemeve që kanë të bëjnë me jetën e punonjësve dhe me rritjen e prodhimit t'u japim një shtytje përpara.

Në fshatrat tona ka nevojë të punohet më shumë për ngritjen e nivelit kulturor. Një mësues ose një drejtor shkolle në fshat, fare lehtë mund të ndihmojë vatrën e kulturës, duke zhvilluar biseda e veprimtari të ndryshme me kooperativistë, që mbledhen në qendren e kooperativës. Këtë gjë, me kërkesën e organizatës-bazë të Partisë, mund ta bëjnë edhe njerëzit e tjerë të mësuar të kooperativës siç janë: agronomi,

ekonomisti, zooveterineri e të tjerë. Këta njerëz, duke zbatuar direktivën e Partisë, përpilojnë një program pune të përbashkët për ngritjen e nivelit kulturor të bashkëfshatarëve të tyre. Programin që bëjnë mund ta konsultojnë edhe me kryetarin e kooperativës, me të cilin bien dakord edhe për datat, orët etj. A nuk e bën dot drejtori i shkollës, mësuesi apo agronomi një gjë të tillë? Fshatarët, sigurisht, nuk do të angazhohen tërë ditën me leksione, por një herë në muaj, treçerek ore, mund t'u flasë agronomi, një herë tjetër mësuesi i historisë, mbas një muaji një mësues tjetër për një problem që mendohet se shërben për edukimin dhe për mobilizimin e kooperativistëve etj.

Dua të pyes, për shembull, nëse ka mbajtur ndonjë mjek ose mami që kemi në fshat, ndonjë konferencë kulturore për probleme të shëndetësisë apo për higjienën? E bëj këtë pyetje se shëndetësia ka dhe anën e saj kulturore. Kohët e fundit për shëndetësinë u mbledh edhe një Plenum i Komitetit Qendror<sup>1</sup>. Nuk mjafton të na thuhet se «po bëjnë». Kjo është një fjalë goje, po unë pyes pikërisht për iniciativa të marra pas këtij Plenumi. Nuk duhet të pritet që njerëzit të lëvizin pasi të bëhet aktivi i Partisë dhe pastaj detyrat të shtrohen në organizatën-bazë. Por, menjëherë, sa lexon gazetën dhe njihet me materialet e Plenumit, për shembull, secili të gjykojë vetë se e ka për detyrë të interesohet e të flasë për problemin që ngrihen në ato që lexoi.

---

1. Plenumi i 11-të i KQ të PPSH, që i zhvilloi punimet më 25 dhe 26 janar 1971. (Shih në këtë vëllim f. 188.)

Ka shumë artikuj që shkruhen në shtypin e përditshëm e periodik, studimi i të cilëve, veç të tjerave, është edhe pajisje me kulturë. Çdo njeri duhet të bëhet i ndërgjegjshëm që ta mësojë popullin vetë, me iniciativë, pa qenë nevoja që ta porositë ngaherë Partia. Partia e ka thënë që me atë shkallë kulture që ka çdo njeri të jetë propagandist i saj. Dikush lexon një material interesant në gazetë; atëherë, në mbrëmje, shkon në shtëpinë e kulturës dhe bisedon gjysmë ore me fshatarët që gjen aty, rreth asaj që ka lexuar. Kjo është një formë e përhapjes së kulturës, krahas shumë të tjerave, siç janë ato që përgatiten për të referuar me konspekte e me studime. Të gjitha këto kanë rëndësinë e tyre, por s'duhën bërë me hosten.

Siç dihet, kultura është kompleksi i dijenive për realizimet në prodhim, në teknikë dhe në zhvillimin shoqëror e intelektual të njerëzimit. Një njeri, sado i aftë që të jetë, nuk është në gjendje të zhvillojë me masat tërë veprimtarinë kulturore, por për këtë punë duhen shumë veta. Organizatori duhet të drejtojë dhe të vërë në lëvizje njerëzit në disa ditë të caktuara. Një organizator për kulturën nuk mjafton dhe s'mund ta kryejë vetëm detyrën e përhapjes së kulturës në masat. Ky do të qe një gjykim burokratik, se një njeri nuk është e mundur t'i bëjë të gjitha. Puna kulturore nuk po zhvillohet siç duhet, jo për arsye se u mbyll shkolla e mesme e kulturës, por sepse nuk janë aktivizuar si duhet mësuesit që janë epiqendra e kësaj pune. Në qoftë se nuk kuptohet kështu kjo çështje, punët në këtë drejtim nuk do të na shkojnë mirë. Në përhapjen e kulturës duhen aktivizuar të gjithë njerëzit me shko-

llë, si: mësuesi, agronomi, inxhinieri e të tjerë. Edhe ai që nuk ka ndonjë shkollë të madhe, por që ka dëgjuar një bisedë interesante apo ka marrë pjesë në një konferencë shkencore, mund të aktivizohet për ato çka dëgjoi që t'ua transmetojë shokëve të tij në arë, pra edhe ky njeri mund të përdoret si përhapës i kulturës në masat.

Të mos e gjykojmë ngushtë veprimtarinë e institucioneve kulturore, duke i parë ato si qendra joprodhuese. Në fakt, po të shikohen thjesht nga pikëpamja e shpenzimeve që bëjnë edhe e të ardhurave që realizojnë (pa folur për kinematë etj., nga të cilat realizohen disa të ardhura), në këtë prizëm ato janë joproductive, por janë shumë produktive për sa i përket shëndetit të njerëzve tanë, për zhvillimin e intelektit të tyre, për krijimin e një fryme dhe të një humori optimist për punë, për gëzimin e jetës nga ana e punonjësve etj.

Partisë i bie barra që të gjithë punonjësit tanë, pa përjashtim, t'i edukojë me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë dhe gjatë orarit të punës ata të mobilizojnë të gjitha forcat e tyre mendore dhe fizike që ta kryejnë si duhet punën e ngarkuar. Por unë mendoj që edhe për kohën pas punës duhet të interesohemi, po këtë çështje ta shikojmë në dy drejtime:

E para, të kemi kujdes që jashtë orarit të punës të mos i ngarkojmë njerëzit me gjëra të kota. Të kup-tohemi mirë, të kota janë edhe disa mbledhje aspak të nevojshme. Partia vërtet thotë që komunistët të venë në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë, punëtorët dhe nëpunësit në mbledhjen e organizatës së bashki-



meve profesionale; të rinjtë në mbledhjen e organizatës së tyre etj., por, në qoftë se një njeriu i duhet të bëjë dhjetëra mbledhje në muaj, kjo nuk është e drejtë. Në një rast të tillë cilido mund t'i ankohet Partisë se çdo ditë, në kohën e lirë, e thërresin në mbledhje. Kjo ankesë do të ishte e drejtë, se nuk mund të mbyten njerëzit me mbledhje, vend e pa vend. Kështu nuk ka thënë kurrë Partia. Këto gjëra kanë rëndësi të kup-tohen drejt. Ndodh që mbledhjet bëhen shumë e për lumë, prandaj në këto raste, është më mirë të bëhen më pak e të jenë me nivel më të mirë, më frytdhënëse. Ju jeni edhe anëtare partie<sup>1</sup>, atëherë do të bënit mirë ta ngrini këtë çështje në organizatën-bazë të Partisë. Atje t'u thoni troç: «Ku po shkojmë, more shokë, me këto mbledhje?». Po të bëhet kjo nuk thuhet disiplina ose ndonjë rregull i Partisë. Ndryshe, punëtorët mbyten me mbledhje dhe ky nuk është një qëndrim i drejtë. Një pjesë e punëtorëve të kombinatit, tash për tash, mund të jenë vajza dhe kanë kohë më shumë, po, pasi të martohen dhe të bëhen me nga dy-tre kalamanë në shtëpi e ndoshta nuk do të kenë as vjehrrën, si mund të qëndrojnë në mbledhje për orë të tëra, fjala vjen, për një fletërrufe?! Edhe burrat, të cilët do të punojnë, ta zëmë, në një ndërmarrje tjetër, do të jenë të angazhuar në mbledhje njësoj si gratë. Si do të bëjnë ata sidomos në dimër kur, sapo mbaron puna, vjen mbrëmja dhe një fëmijë, që mund

---

1. I drejtohet shoqes Luçiana Bullari, në atë kohë nënkryetare e komitetit profesional të Kombinatit të Tekstileve në Berat, e pranishme në këtë mbledhje.

ta kenë në çerdhe, pret që të venë ta marrin në një orë të caktuar, tjetri me çelësin e shtëpisë në qafë pret të kthehen prindërit, kurse i treti bredh rrugëve? Të gjithë duhet të mendojmë e të bëjmë ç'është e mundur si t'i çlirojmë punëtorët nga ngarkesat e shumta që kanë.

Unë jam dakord me propozimin e shokut Manush, i cili tha se meqë në Berat kombinati është larg, do të ishte më mirë që qendra e kulturës të bëhet në lagje. Në kombinat mund të bëhen vetëm mbledhjet e punës ose ndonjë veprimtari që shikohet e arsyeshme.

Ti shoqe na shprehe disa mendime të drejta kur the që duhet bërë kështu, ose nuk është drejt ashtu. Edhe ne këtë duam dhe jemi të një mendimi me ty: Kur shkohet në piknik pjesëmarrësit atje, po të kenë qejf, le të hedhin edhe valle. Edhe në pushimet e shkurtra gjatë punës mund të kërceni, se jeni të rinj. Por ama kur shkohet në aksion, siç vajtët ju për të vënë kabllin, atje duhet punë dhe bile me temp ushtararak. Është gjë e mirë që punëtorët venë për të lexuar në bibliotekat dhe në dhomat e studimit të kombinatit, të cilat, me sa na treguat ju, i paskeni të mira, si dhe fakti që ata blejnë edhe vetë libra. Por, do të ishte me interes të dinim, për shembull, nëse kanë lexuar romane të ndryshme artistike të shkrimtarëve tanë dhe sa u kanë shërbyer ato në jetë? Kur kanë lexuar, fjala vjen, historinë e një vajze, që doli nga një botë e mbyllur e shtëpisë, ku nuk kishte fare haber nga jeta dhe filloi të bëjë një jetë të re, të gjallë, më të kulturuar e kështu me radhë, lind pyetja: «Sa u ka vlejtur ajo që kanë lexuar, a u ka lindur

dëshira që edhe ato vetë të veprojnë siç kishte bërë vajza për të cilën flitet në roman?». Pra, nga romani që lexojnë a nxjerrin mësim për jetën, për sjelljet e zanatin e tyre? A ua ka ndriçuar ai shpirtin dhe ndërgjegjen? A kanë adaptuar nga romani momente të përshtatshme, të mira, që t'u kenë shërbyer në jetë?

Ta zëmë se njëri del nga shtëpia dhe, sido që Partia thotë të kujdesemi për fëmijët, nuk e ka mendjen atje, po shikon punën e tij. Bëjnë ç'bëjnë kalamanët nëpër rrugë e nëpër lulishte, ai qëndron indiferent. Kur lexon një roman ku bëhet fjalë se si duhet të sillemi me fëmijët, se si ata duhet të jenë të pastër e të rregullt etj. atëherë diçka mëson: po t'i shikosh fëmijët që sillen keq ose rrinë të papastër, fillon t'u flasësh, t'i këshillosh e, në rast nevojë, bisedon edhe me prindërit e fëmijëve. Unë në këtë kuptim e kam fjalën, kur them se si duhet të shërbejnë romanet që lexohen.

Ose të marrim një aspekt tjetër të jetës. Dikush mund të ketë rënë në dashuri, po derisa ta përfundojë me fejesë, sigurisht e mban të fshehur që të mos hapen fjalë nga gojët e liga. Këto koncepte fanatikësh duhen luftuar me anën e shembullit personal, duke dalë me shokun në shëtitje. Në këtë rast, ndonjëri mund të pëshpëritë se këta të dy janë si të fejuar, se i ka parë në shëtitje, por shpejt fanatikut do t'i mbyllet goja, pse njerëzit me qëndrim të drejtë e të vendosur do t'i bëjnë llafazanët të heshtin. Dhe në këtë drejtim, për t'u hapur horizont të rinjve e për t'u zgjeruar botën shpirtërore, do të ndihmonte shumë edhe leximi i librave.

Arti jo vetëm që duhet të përdoret si mjet edukimi në përgjithësi, por të shërbejë sidomos për edukimin politik të masave. Kjo, nuk mjafton të kuptohet vetëm në parim, por të luftohet që të zbatohet edhe në praktikë. Do t'i bëja një pyetje, për shembull, shokës Tefta<sup>1</sup>: «A këndojnë solistët popullorë të rrethit tuaj edhe këngë të rretheve e të krahinave të tjera të vendit, si, për shembull, të Shkodrës, të Mirditës, të Pukës, të Gjirokastrës, të Shqipërisë së Mesme etj., apo këndojnë vetëm këngët dibrane?».

E dini pse po ju pyes për këtë gjë? Që të mos ketë shfaqje lokalizmi dhe të kufizoheni vetëm në këngët e trimave të rrethit tuaj dhe të heroizmave që bëhen në ato anë, duke ngushtuar horizontet e njerëzve që mund t'u krijohet përshtypja e gabuar sikur: «Ne kemi qenë», «ne kemi luftuar», mirëpo kanë luftuar të gjitha krahinat e Shqipërisë, që kanë nxjerrë shumë trima e heronj. Në të gjitha rrethet ka këngë trimash dhe heronjsh, prandaj fryma e këngëve të popullit duhet të hyjë kudo. Atyre që janë solistë amatorë t'u rekomandoni që të këndojnë jo vetëm këngët e krahinës apo të rrethit të tyre, por edhe këngë nga rrethet e tjera. Unë nuk flas për këngët e Luftës Nacionalçlirimtare, të cilat duhet t'i këndojë i gjithë populli, por e kam fjalën edhe për të tjerat.

Ne që jemi nga krahinat e Jugut i dëgjojmë me shumë qejf këngët e Veriut, sepse muzika e tyre është e gëzuar dhe nuk është monotone. Sigurisht që muzika

---

1. Tefta Cami, në atë kohë sekretarë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

dhe këngët e krahinave të Jugut, neve na pëlqejnë shumë. Por, po t'u këndojnë këto edhe heroizmave të shqiptarëve të Veriut, me siguri që do t'i tërheqin edhe banorët e këtyre krahinave, të cilët do të mësohen me to dhe do t'i pëlqejnë. Kjo nuk është thjesht çështje gustoje, por një çështje politike.

Krahinat e rrethet mund të këmbejnë jo vetëm këngët e muzikën, por edhe traditat e zakonet e mira, se dhe këto janë kulturë. Ajo zonë, për shembull, ku zotëron pastërtia, influencon në ato zona që janë më prapa. Të gjithë e dimë se ju, dibranët, keni një traditë shumë të mirë për pastërtinë. Që nga Maqellara e këtej janë të pastër, atëherë si është e mundur që kërkesa për pastërtinë dhe higjienën të mos buçasë në tërë Dibrën? Pastërtia është në gjak të dibranëve. Nga eksperiencia shekullore del se dibrani s'rronte dot pa pastërti. Ai ka lyer me gëlqere edhe shkallët e shtëpisë, gruaja dibrane s'rrinte dot pa pastruar shtëpinë. Pra ju, duke përdorur traditën e krahinave që dallohen për pastërti, duhet të influenconi për ta përhapur më shumë atë edhe në zonat e tjera.

Të kthehemi edhe një herë te mbledhjet, një pjesë e të cilave, siç thamë, nuk janë aspak të nevojshme. Këtë porosi Partia e ka dhënë vazhdimisht, por ne nuk po bëjmë përpjekjet e duhura për ta zbatuar plotësisht në jetë dhe fajin për këtë gjendje kudo e kanë, më duket, udhëheqjet, në të gjitha nivelet. Organizatat-bazë të Partisë, organet e pushtetit, bashkimet profesionale dhe organizatat e tjera të masave në rrethet nuk orientojnë kurdoherë drejt për këtë problem dhe nuk punojnë si duhet në bazë të direktivës që ka

caktuar Partia. Ato mbledhje që janë të domosdoshme, natyrisht, duhet të bëhen, por të jenë sa më operative, sa më me përmbajtje dhe të shkurtra, duke pasur parasysh përfitimin si për problemet që shtrohen, ashtu edhe nga pikëpamja e kohës. Në qoftë se nuk e kemi parasysh dhe nuk e llogaritim kohën e mbledhjes, atëherë, kjo e fundit, nuk ka për t'u zhvilluar drejt. Në përcaktimin e kohës duhet të mendohen thellë si ai që do të flasë, ashtu edhe ai ose ata që drejtojnë mbledhjen. Në qoftë se ai që bën raportin ose shtron problemin në mbledhje nuk përgatitet seriozisht: qysh më parë për t'i thënë çështjet drejt dhe haptas, në qoftë se edhe diskutimet nuk zhvillohen sipas këtij orientimi, mbledhja nuk ka si jep fryt, fjalët e tepërta, të papërqendruara dhe shpeshherë shumë të zgjata nuk do të shmangen.

E kam thënë dhe e kam theksuar edhe herë të tjera prirjen që vihet re te disa për t'i zgjatur diskutimet pa qenë nevoja. Mendohet shumë gabim nga disa se kush flet pak, sipas tyre nuk flet gjë, ndërsa kush flet shumë, folka bukur! Në të vërtetë nuk është kurdoherë kështu, sepse një problem preokupant mund të diskutohet shkurt, bile edhe brenda pak minutave, pa qenë aspak nevoja për perifrazime të mërzitshme e të stërgjata.

E dyta, është çështja që ne, pa dëmtuar punën të mendojmë se si ta kalojmë me sa më shumë përfitim kohën e lirë punonjësit tanë, të cilëve, brenda kushteve tona ekonomike, t'u krijojmë mundësitë që të edukohen, të dëfrenjë dhe të çlodhen sa më mirë. Në këtë drejtim ekzistojnë shumë mundësi që nuk shfrytëzohen

në favor të punonjësve. Kur këta të shikojnë që u ngrit një kinema, u ndërtua një pishinë, një park, një sallë leximi e ngrohtë etj., mendoj se nuk është aspak nevoja t'u bëhet apostafat mbledhje për t'u rekomanduar që të venë t'i shikojnë ato në mënyrë të organizuar. Përse të normohet kështu jeta e tjetrit? Partia nuk lejon të normohet jeta familjare as e një anëtarit partie, as ajo e çdo punonjësi. Se ç'është bënë punëtori, kooperativisti, nëpunësi e të tjerë gjatë kohës së lirë në shtëpi, si do ta kalojë ai atje kohën e lirë, kur do të dalë në shëtitje etj., këto në asnjë mënyrë nuk mund të planifikohen nga të tjerët. Punëtorët nuk janë ushtarë të kazermave dhe as Partia e askush tjetër nuk ka të drejtë t'ua programojë atyre kalimin e kohës së lirë. Çdo njeri, sipas dëshirës, mund ta organizojë vetë mënyrën e kalimit të orëve të pushimit. Partia na mëson të bëjmë një jetë të ndershme dhe të kulturuar, gjë që do të thotë që secili të kryejë detyrat, duke punuar 8 orë sa është caktuar nga shteti, pastaj të punojë edhe pak pas këtyre 8 orëve që të ndihmojë në punët shtëpiake. Por pas punës ai duhet edhe të shëtitë, të vejë në kinema, në kafene, të lexojë, të luajë me fëmijët e t'u tregojë përralla, të ushtrojë ndonjë sport etj. Janë një mijë e një gjëra me të cilat mund të merret njeriu mbas pune. Partia në asnjë mënyrë nuk mund të bëjë një listë se si të veprojnë njerëzit në kohën e lirë. Të mos i futim punonjësit në kuadrate, po t'u krijojmë kushtet e t'u themi që, po të duan, le të shkojnë në aktivitetet që u pëlqejnë. Thuhet që njerëzit shëtitin për orë të tëra nëpër rrugë, dhe kjo nuk është e drejtë, por ama të mos harrohet

se mjekët e këshillojnë si të domosdoshme për të gjithë shëtitjen për 1 ose për 2 orë në ditë. Kjo është e qartë, por e shtroj çështjen në përgjithësi që të mos zbatohen gjërat kallëp. Një punëtor, të cilit i buçasin veshët 8 orë rresht nga zhurma e makinës ku punon a nuk ka nevojë që të shëtitë të paktën 1 orë në ditë, për të thithur ajrin e pastër, për të qeshur e për të kënduar?! Siç e thashë edhe më parë, këto nuk duhet të merren shabllon, se pastaj përsëri do të biem në gabime. As prindërit nuk kanë të drejtë t'ia bëjnë programin vajzës ose djalit, duke i porositur që «në këtë orë të vini të hani bukë, në këtë orë të bëni punët e shtëpisë e në këtë orë të shëtitni ose të vini në kinema etj.». Mund të ndodhë që vajza të rrijë në shëtitje më shumë se ç'duhet dhe prindërit, sigurisht, do të shqetësohen, por ata duhet të kuptojnë se nuk e ndalojnë dot atë me anë të një regjimi ditor të detyruar, por duke punuar me takt e me durim me të.

Partia, shteti, për të edukuar dhe për të dëfryer punonjësit vënë në dispozicion institucionet kulturoro-artistike, propagandojnë frekuentimin e vendeve ku mund të vallëzohet, të lexohet, të shikohen filma, shfaqje teatrale, estradë etj., etj. Këtij qëllimi i shërbejnë reklammat që bëhen në forma të ndryshme, bisedat midis vetë punonjësve, diskutimet që organizohen për probleme letrare etj. Këto forma pune mundet dhe është e nevojshme të praktikohen, por kohën, siç thashë, secili e programon vetë, pa qenë nevoja t'i thuhet çdo ditë të shkojë këtu ose atje. Pra do të ketë edhe vajtje kolektive, por nuk ka përse punonjësi të vejë në kinema përherë pikërisht atëherë kur t'i thonë



shokët e organizatës profesionale. Ai mund të shkojë për të parë filma edhe kur të dëshirojë vetë. Partia do t'u bëjë thirrje njerëzve për punë vullnetare, për shembull, për të ndërtuar një urë, një rrugë ose një shtëpi, dhe punonjësit tanë e kanë treguar me prova se janë gati të shkojnë kudo ku i thërret detyra, por ama kur janë të lirë të mos i ngatërrojmë, le t'i rregullojnë vetë këto punë.

Ne duhet të bëjmë e do të bëjmë edhe në të ardhmen shumë gjëra, si për qytetin, ashtu edhe për fshatin, si: kinema, klube, parqe, terrene sportive dhe gjithçka tjetër të nevojshme e të mundshme për edukimin, çlodhjen dhe argëtimin e punonjësve e të rinisë sonë, por frekuentimi i tyre do të bëhet kurdoherë sipas dëshirës së secilit.

Unë them që organizimi i punës për përhapjen e kulturës në masat nga ana e Partisë dhe e shtetit është një problem me shumë rëndësi, por kjo është vetëm njëra anë e çështjes. Ana tjetër me rëndësi është që njerëzit të mësohen të bëjnë vetë përpjekje për të planifikuar kohën në mënyrë sa më të frytshme, që të mundet kështu të ndihmohen për të zhvilluar më tej horizontin dhe njohuritë e tyre kulturore dhe, po të jetë e mundur, koha të mos u shkojë kot. Çështja, pra, shtrohet në parim që Partia t'i mësojë njerëzit jo duke i porositur të bëjnë këtë ose atë, por t'u krijojë mundësitë që të dëgjojnë një konferencë, të shikojnë televizorin, të shkojnë në teatër, në bibliotekë etj. Të vihen ata në dijeni që në bibliotekë kanë ardhur këta ose ata libra nga më të ndryshëm që atyre u interesojnë, të cilët kushdo mund t'i zgjedhë në ka-

talogët. Duke i informuar në këtë mënyrë, secili do të ndihmohet e do të orientohet ç'të lexojë në sallën e bibliotekës ose në shtëpi. Pavarësisht nga studimi i librave të shkollës ose i atyre që i duhen detyrimisht secilit për kryerjen sa më mirë të detyrave dhe të funksioneve të ngarkuara, Partia duhet t'i nxitë njerëzit të zhvillojnë më tej edhe kulturën e tyre të përgjithshme që të mos mbeten në nivelin që kanë. Pra, më shumë duhet të preokupohet Partia për shfrytëzimin e të gjitha formave që kanë të bëjnë me përhapjen e kulturës dhe me shfrytëzimin e kohës së lirë nga ana e njerëzve tanë, sepse më duket që për këto probleme nuk mendohet si duhet.

Këtu u numëruan raste se ka nga njerëzit tanë që bëjnë 12 orë punë e mbledhje në ditë plus 2 orë që u duhen për të ngrënë, arrijnë 14 orë. Sikur t'u shtojmë këtyre edhe një orë për shëtitje, bëhen 15 orë. Po a nuk ka të drejtë dhe nevojë punonjësi të rrijë një orë me gruan dhe me fëmijët, të gëzohet me ta, t'u thotë një fjalë, të bëjë një shaka ose të vejë për vizitë te një shok? Po me punët shoqërore, me studimin individual, kur do të merret ai? Pastaj kur i mbetet të flejë? Bëhen konkretisht këto llogari nga shokët përgjegjës apo nuk bëhen? Të gjithë pa përjashtim jemi futur në këto brazda. Prandaj duhet vepruar me shumë kujdes në këto çështje.

Nuk është e domosdoshme, fjala vjen, të vijë në mbledhje gjithë kolektivi për të gjykuar një fletërrufe, që e ka vënë dikush për të kritikuar mungesën e disiplinës së një punonjësi. Atë që është i padisiplinuar dhe për të cilin u vu fletërrufeja, ta thërresë më mirë e

t'i kërkojë llogari drejtori i fabrikës, i cili, në rast nevoje, të zbatojë masat disiplinore që parashikojnë rregullat në rrugën shtetërore. Nuk mund të mblidhen për 3 orë të tëra 150 veta që t'i mbushin mendjen një të padisiplinuari se ka thyer disiplinën në punë! Sekretari i Partisë ose përgjegjësi i bashkimeve profesionale të një qendre pune janë plotësisht kompetentë të thërresin veç ose së bashku e t'i kërkojnë llogari atij që thyen disiplinën. Pse atëherë u dashka medoemos të mblidhet tërë kolektivi për të vënë në vend një njeri të padisiplinuar? Prandaj, shokë, të mos abuzojmë në direktivat e Partisë, por t'i kuptojmë dhe t'i zbatojmë drejt ato. Nën maskën e demokracisë së Partisë të mos abuzohet duke mbajtur punëtorët pas pune nga 4 orë të tjera në mbledhje për gjëra që mund dhe duhet t'i zgjidhin përgjegjësit. Orët e lira pas pune të punonjësve janë shumë të shtrenjta, ato janë prapë në interes të punës, për mësimin dhe për jetën e tyre. Kjo është një çështje partie që duhet parë me kujdes të madh.

*Botuar për herë të parë me disa shkurtime në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 222*

*Botohet i plotë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

# **TË TREGOHET KUJDES PËR KUALIFIKIMIN E PUNONJËSVE DHE PËR VENDOSJEN E NORMAVE KOLEKTIVE NË BUJQËSI**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 shkurt 1971**

Studimi që ka bërë Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste është shumë i mirë, prandaj mendoj se do të jetë me vend që këtë t'ua japim edhe shokëve të Byrosë Politike, në mënyrë të veçantë atyre që drejtojnë sektorët ekonomikë, si dhe punonjësve drejtues të Komisionit të Planit të Shtetit. Të gjithë këta do ta marrin këtë material jo vetëm për një të lexuar, por me qëllim që ta studiojnë dhe të reflektojnë mbi të për masat që nevojiten për zgjidhjen e gjithë këtyre problemeve parimore ekonomike që ngrihen në studimin e Institutit. Kjo është e domosdoshme të bëhet, pse duhen marrë një sërë masash për të mënjanuar

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth studimit të paraqitur nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH «Mbi nevojën për të përmirësuar dhe forcuar më tej lidhjet midis prodhimit dhe konsumit».

ose për të mos lejuar që të acarohen më tej disa fenomene negative jo të kënaqshme që vihen re në ekonominë tonë, në sferën e qarkullimit të mallit e të parasë.

Në përgjithësi, unë jam dakord të shikohen edhe të metat që konstatohen në punën e organeve të tregtisë, për zhdukjen e të cilave kam sinjalizuar më parë.

I vërtetë dhe real është fakti se një ndër shkaqet kryesore të kontradiktës që vepron në ekonominë tonë të mallrave dhe që dëmton lidhjet midis prodhimit e konsumit është mosrealizimi i planit të prodhimeve bujqësore. Prandaj bujqësisë ne duhet t'i vëmë gjoksin më mirë se deri tani, për arsye se në këtë sektor ka shumë rezerva të pashfrytëzuara. Unë nuk dëshiroj të flas sot për këto rezerva, as për masat organizative që duhen marrë për shfrytëzimin maksimal të tyre, të cilat në bujqësi kanë rëndësi të veçantë, por dua të shtroj një çështje që mendoj se shokët e Institutit të Studimeve Ekonomike dhe të Komisionit të Planit të Shtetit duhet ta kenë parasysh në studimet e tyre.

Çështjen e kam në lidhje me një mungesë kujdesi që vihet re në punën tonë për kualifikimin e punonjësve të bujqësisë. Për kualifikimin e punëtorëve dhe të nëpunësve ne me të drejtë jemi interesuar dhe interesohemi vazhdimisht, bile fill e për pe dhe kjo është e domosdoshme. Për këtë qëllim kemi hapur kurse e shkolla, kemi vendosur kategorizime, nga ato më të ulëtat dhe deri në të shtatën. Krahas rritjes në kategori punëtorit i shtohet edhe shpërblimi për punën që bën, pse kjo presupozon edhe rritjen e rendimentit në punë dhe të cilësisë së prodhimit. Prandaj para se të

ngrihet në kategori, punëtori duhet të japë provim. Kualifikimit të punëtorëve, pra ne i kemi kushtuar rëndësi, që punëtori të dijë të vërë në veprim dhe të zotërojë mirë të gjitha ato mjete që shoqëria i ka vënë në dorë, me qëllim që vazhdimisht të shtohet sasia dhe të përmirësohet cilësia e prodhimit. Paga e punëtorit ose e nëpunësit është caktuar me kriteret e drejta socialiste, duke marrë parasysh ndryshimet midis punës së rëndë dhe asaj të lehtë, midis punës së kualifikuar dhe të thjeshtë etj. Mbi bazën e sasisë dhe të cilësisë së punës, si edhe të madhësisë së shpërblimit të saj, janë caktuar edhe normat e punës (të prodhimit).

Sigurisht është vepruar mirë dhe në interes të prodhimit që janë marrë masa për kualifikimin e punëtorëve me anën e kurseve dhe të shkollave, me shkëputje ose pa shkëputje nga puna; gjatë kohës së përgatitjes në kurse e shkolla punëtorëve u paguhet edhe rroga, plotësisht ose pjesërisht dhe këtë praktikë ne duhet ta vazhdojmë me doemos edhe në të ardhmen. Por, krahas kësaj pune, ne nuk kemi treguar të njëjtin interesim edhe për kooperativistët, prandaj këtej e tutje të mos e lëmë më pas dorë këtë problem me rëndësi të madhe. Edhe për fshatarin kooperativist janë caktuar norma, por këto nuk janë studiuar mirë, prandaj ai nuk nxitet për tejkalimin e tyre. Në kooperativa paga është pothuaj e njëjllotë kudo si për një vajzë ose për një djalë të ri që punon shumë dhe jep rendiment të lartë, ashtu edhe për një burrë ose për një grua të moshuar që punon më pak, si për atë që ka bërë një kurs kualifikimi, apo ka mbaruar një shkollë, edhe për atë që s'ka vajtur fare as në kurs, as në shkollë, si për atë që s'merr vesh

nga punët e bujqësisë, ashtu edhe për një që është mjeshtër dhe i njohur për eksperiencën e tij të gjatë në bujqësi, në blegtori, në pemëtari. Të gjitha këto të meta e boshllëqe në punën që ka të bëjë me kualifikimin e punonjësve të kooperativave bujqësore, kanë bërë që edhe shpërblimi i punës në to të mos jetë fort i drejtë. Mënyra aktuale e shpërblimit në punë nuk e nxit fshatarësinë as për punë, as për kualifikim. Kooperativistëve që u shërbejnë lopëve, për shembull, u janë caktuar 20 ditë-punë në muaj për punën që bëjnë në këtë sektor. Por, kur kërkojmë të dimë arsyet, përse kemi caktuar kaq ditë-punë dhe jo më shumë apo më pak, kjo nuk na argumentohet. Pavarësisht nga diferencat individuale në kualifikim, pavarësisht nga kushtet e punës dhe nga fakti nëse disa kooperativistë punojnë ditën, kurse disa të tjerë natën, ata që punojnë në blegtori ose gjetkë, pa përjashtim paguhen të gjithë njëllëj. Po janë vallë të drejta dhe socialiste këto kritere, shokë?! E nxit një mënyrë e tillë shpërblimi rritjen e prodhimit në kooperativat bujqësore dhe është kjo një formë e përshtatshme për të shtuar dëshirën e punonjësve të bujqësisë për ngritjen e kualifikimit të tyre teknik në bujqësi? Në këto kushte si mund të kërkohej pastaj që bujqësia të bëhet moderne, që shkencat të zbatohet si duhet në këtë degë kaq të rëndësishme të ekonomisë sonë popullore?

Flasim shumë për agroteknikën, shokë, por nga ana tjetër nuk kemi marrë masat e nevojshme që fshatarët të mësojnë zbatimin e metodave shkencore në punët dhe në shërbimet bujqësore. Vërtet është hapur në disa vende ndonjë kurs njëmuajor, por kam përshty-

pjen se në këtë drejtim puna atje është bërë shkel e shko. Kjo është një rrugë e gabuar. Prandaj është e domosdoshme të marrim masa efikase sa më parë që të jetë e mundur për përmirësimin e gjendjes në të gjitha këto drejtime. Ne nuk mund të kemi dhe nuk do të kemi bujqësi moderne në qoftë se nuk punojmë për kualifikimin e punonjësve të bujqësisë dhe nuk nxitim prodhimin bujqësor me masat që përmenda. Si është e mundur që, ndërsa klasën punëtore e nxitim dhe i krijojmë të gjitha kushtet për t'u kualifikuar në punë dhe për t'u shpërblyer më shumë, fshatarësisë nuk ia krijojmë të tilla kushte dhe nuk e nxitim në këto drejtime?

Në teori të tërë e pranojmë se prona kooperativiste është një formë e pronësisë socialiste, por kur vjen puna në praktikë, ky fakt harrohet dhe çështja trajtohet sikur prona kooperativiste të mos ishte socialiste.

Për pronën shtetërore llogaritim, kur i thonë fjalës, edhe santimin dhe shumë mirë bëjmë, se kështu duhet. Por kjo nuk do të thotë aspak që të mos tregohet i njëjti kujdes edhe për pronën kooperativiste, zhvillimi i së cilës nuk i duhet lënë në asnjë mënyrë spontaneitetit.

Pa e organizuar bujqësinë sipas formave moderne të prodhimit socialist, ku çdonjëri të nxitet të punojë sa më shumë e më mirë dhe të shpërblehet me drejtësi sipas punës e jo të trajtohen të gjithë rrafsh, njëlloj, është zor të mendohet për të arritur ato përparime dhe për të plotësuar ato detyra të mëdha që shtron Partia përpara kësaj dege të rëndësishme jetike të ekonomisë sonë.



Shokët sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve e shikojnë se në praktikë zbatimi i normës kolektive në bujqësi nuk e nxit prodhimin. Si rrjedhim, të gjithë ata kooperativistë që janë në gjendje të punojnë shumë, për t'i bërë bisht normës kolektive, ose për ta zbatuar atë formalisht, kërkojnë dhe mbledhen në një brigadë, kurse të tjerët, më të dobët, lihen në anën tjetër për të punuar më vete. Dhe megjithëse një fenomen i tillë duket fare sheshit, përsëri vazhdohet të flitet se norma kolektive është më e përshtatshme, se është kështu, apo është ashtu! A, jo shokë, nuk duhet vepruar në këtë mënyrë!

Normat e punës, qofshin këto kolektive apo individuale, janë që të dyja socialiste dhe duhen zbatuar në bazë të kriterëve që ka caktuar Byroja Politike. Aktualisht, është krijuar vallë në kooperativat tona ajo gjendje dhe ajo ndërgjegje që lypsen për të vendosur në praktikë normën kolektive të punës? Organizatat-bazë të Partisë në kooperativa dhe çdo komunist në fshat janë në atë gjendje dhe në atë lartësi të detyrës sa të përcaktojnë se kur dhe në cilat procese të punës duhet përdorur norma kolektive? Me këtë sy të shihet kjo çështje dhe jo të thuhet kot që zbatimi i normës kolektive në kushtet aktuale është më i mirë nga ai i normës individuale. Unë mendoj se, një qëndrim i tillë rrjedh nga frika që kanë shokët se, po të thonë të vërtetën, kujtojnë se do t'u bëhet ndonjë vërejtje, ata pandehin se vetëm norma kolektive është socialiste, kurse norma individuale të çon në revizionizëm e në kapitalizëm, pasi revizionistët normës individuale i vënë theksin dhe e përkrahin, prandaj, po

të shprehet ndonjë mendim në favor të përdorimit të saj, ka rrezik t'i kundërvihesh politikës së Partisë etj.

Partia, siç thasnë, kurrë nuk e ka mohuar karakterin socialist të normave, si të atyre individuale, ashtu edhe të normave kolektive, por ajo ka lëshuar direktivat dhe ka përcaktuar kriteret që duhen ndjekur në përdorimin e drejtë të tyre. Veç për zbërthimin e këtyre kriterëve e të direktivave të Partisë duhet punuar një çikë më tepër e me kokë, që ato të mos shtrembërohen. Prandaj shokët s'ka përse të nxitohen për të bërë përgjithësime pa vend dhe normën kolektive ta futin edhe atje ku nuk duhet.

Përse të kemi dy mënyra kategorizimi dhe nxitjeje të prodhimit, një për klasën punëtore dhe një për kooperativistët? A nuk duhet ta frymëzojë klasa punëtore aleaten e saj edhe në këtë drejtim, që të punojë me tiparet dhe rregullat e klasës punëtore? A nuk duhet ta mësojë ajo fshatarësinë që një kooperativist i zellshëm të mos mbajë në kurriz një tjetër që është dembel dhe i pandërgjegjshëm? Sigurisht duhet ta frymëzojë dhe ta mësojë që të bëhet edhe ajo luftëtare për të punuar me këmbëngulje në këtë drejtim. Pra edhe kooperativisti, ashtu si punëtori, është e domosdoshme dhe e drejtë të shpërblehet sipas punës dhe kualifikimit individual. Edhe fshatarët duhet të shpërblehen sipas mundit e djersës së ballit që derdhin dhe jo të paguhen të gjithë njëllorj. Po të punojmë që edhe në kooperativat bujqësore të vihet më mirë dhe plotësisht në jetë parimi socialist «secilit sipas punës», ashtu siç zbatohet ky parim në ndërmarrjet shtetërore, atëherë do të shohim se si kualifikimi i kooperativistë-

ve do të ngrihet, gjë që do të ndikojë shumë për realizimin e planeve të prodhimit në bujqësi. Një mënyrë shpërblimi e tillë do të jetë një nxitje e mirë për rritjen e vrullit në punë në kooperativat tona. Duke parë diferencimin në shpërblimin e punës, sipas aftësisë dhe kualifikimit, kooperativisti do të interesohet më tepër për të ndjekur kurset, shkollat që, më vonë, të bëhet edhe brigadier etj., etj.

Në kooperativat vihet re që një brigadier, edhe kur është i zoti, nganjëherë hiqet padrejtësisht dhe zëvendësohet si pa gjë të keq me një tjetër, sepse kështu u dashka qejfi disave. Në pamjen e jashtme, formale, kjo justifikohet gjoja me votimin demokratik, po në të vërtetë, prapa një mase të tillë fshihen përkrahja, hatëri, lidhjet e farefisnisë, që s'kanë asgjë të përbashkët me demokracinë kooperativiste. Veprime të tilla nuk na ndodhin në ndërmarrjet shtetërore, në fabrika, në uzina, në kantieret e ndërtimit etj. Në fabrikë brigadieri nuk mund të shkarkohet në asnjë mënyrë nga detyra pa pasur arsye të forta që ta justifikojnë një masë të tillë. Në këtë rast, në mbrojtje të tij ngrihet në këmbë gjithë kolektivi i fabrikës, gjithë organizata e Partisë. Kështu duhet vepruar edhe në fshat, ku, po nuk u vlerësuan aftësitë e secilit dhe po u konsideruan të tërë njëlloj, s'mund të rriten kuadrrot e kooperativave bujqësore.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Raporte e fjalime 1970-  
-1971», Tiranë, 1972, f. 229*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Raporte e fja-  
lime 1970-1971», Tiranë, 1972  
f. 229*

## EDHE BUJQËSIA KËRKON ORGANIZIM TË PUNËVE SI INDUSTRIA

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 mars 1971

Edhe unë dëshiroj të them diçka për këto çështje. Jam dakord me vërejtjet analitike që bënë këtu shokët rreth vlerësimit të punës së këtyre tri rretheve që morëm në shqyrtim, pothuajse një vit pas vizitës sime. Çështja ka të bëjë jo vetëm me zbatimin e disa këshillave që dhashë vjet unë në këto tri rrethe, por edhe me plotësimin e detyrave të rëndësishme të planit tonë pesëvjeçar, lidhur me zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, që ka shtruar Partia përpara popullit dhe vendit tonë.

Është fakt se në këto rrethe shifrat e rezultateve që janë arritur dhe realiteti tregojnë se kudo ka mo-

---

1. Në këtë mbledhje u analizua puna e komiteteve të Partisë të rretheve Kukës, Tropojë e Pukë për zbatimin e detyrave të shtruara nga shoku Enver Hoxha gjatë vizitës së tij në këto rrethe në maj të vitit 1970.

bilizim në punë, ka suksese dhe përparime, por, po të futemi thellë në studimin konkret të shifrave e të çdo problemi, do të vërejmë se ka edhe mjaft detyra të parealizuara e të meta të palejueshme, që kishte mundësi dhe duhej të mos ekzistonin.

Unë mendoj se udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rrethin e Kukësit dhe të Pukës është më mirë në krye të punëve sesa në Tropojë. Si sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit, shoku Izet Dyrmishi, ashtu edhe sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Pukës, shoku Pali Miska, bashkë me anëtarët e tjerë të udhëheqjes së Partisë në këto dy rrethe, janë shokë të ngritur, «të çallëstisur», ata i kuptojnë mirë problemet dhe bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur, ndërsa e kundërta ndodh me udhëheqjen e Partisë dhe të pushtetit në rrethin e Tropojës, për arsye se ajo ka qenë shumë e dobët. Ne menduam se sekretari i parë i Komitetit të Partisë, që dërguam gati një vit më parë në këtë rreth, do ta forconte situatën, mirëpo, siç konstatojmë, puna atje përsëri vazhdon të jetë e dobët.

Po përse ekzistojnë kaq të meta në këto tri rrethe ku jeton një popull patriot dhe shumë i lidhur me Partinë, ku kemi organizata partie të vendosura, të shkathëta e besnike ndaj parimeve marksiste-leniniste? Është fakt se organizatat e Partisë në këto tri rrethe nuk kanë vuajtur aq nga sëmundje politiko-ideologjike, sesa nga niveli i ulët i anëtarëve të tyre. Megjithatë niveli i komunistëve atje, në krahasim me përpara, nuk ka qëndruar në vend, prandaj jam i bindur se ky nivel nuk është shkaku që justifikon këto të meta të

shumta në punë, si edhe mosrealizimin e mjaft detyrave, gjë që ka krijuar ato vështirësi që duheshin kapërcyer patjetër. E theksoj se organizatat e Partisë në këto tri rrethe, me atë popull patriot e të lidhur ngushtë me Partinë, ishin në gjendje t'i kapërcenin shumë prej vështirësive, në rast se udhëheqja e Partisë në to dhe Komiteti Qendror do të dinin t'i ndihmonin e t'i mobilizonin më mirë dhe më drejt masat për realizimin e detyrave të ngarkuara.

Kur unë ose shokë të tjerë udhëheqës kemi shkuar në rrethe të ndryshme për t'u takuar me popullin, kudo bie menjëherë në sy entuziazmi i madh i masave, të cilat te ne, përfaqësuesit e Partisë, shohin Partinë dhe pushtetin e tyre, shohin vijën, politikën dhe qëllimet e drejta të Partisë dhe të pushtetit popullor. Populli ka besim të madh e të patundur te Partia dhe pushteti i tij. Dhe ky është një besim i dalë nga bindja, nga eksperiencia dhe jo i krijuar në mënyrë mistike, pse gjatë gjithë ekzistencës së tyre Partia dhe pushteti popullor u kanë dhënë masave prova të shumta konkrete.

Ne sot kemi realizime të mrekullueshme kudo, në Veri e në Jug, në fshat e në qytet, në industri e në bujqësi, në arsim e në kulturë, në zhvillimin shoqëror e kulturor, në zhdukjen e mentaliteteve prapanike etj. Këto suksese janë arritur me një punë të palodhur, mobilizuese, bindëse dhe me durim të Partisë dhe kanë qenë një mbështetje e fuqishme për zbatimin e politikës së saj të drejtë. Populli ynë ka parë dhe është bindur që shpëtimi, çlirimi i tij nga të gjitha prangat që e pengonin të ecte përpara, ngritja e nivelit të tij

ekonomik e kulturor do të arriheshin dhe janë arritur me punë dhe me luftë, me djersë e me sakrifica të panumërta, pa të cilat nuk mund të arriheshin rezultatet që aq shumë ia kanë përmirësuar jetën. Ky përmirësim i jetës së masave tona punonjëse ka ecur në rrugën e ngritjes së vazhdueshme. Në këtë drejtim shumica e njerëzve tanë janë të kënaqur, por sidoqoftë, duke e gjykuar realisht rrugën e zhvillimit tonë, ne nuk jemi të kënaqur, pse përmirësimin e kushteve të jetesës së popullit duhet ta matim me realizimin e pikësnyimeve që kemi caktuar në sektorët e ndryshëm.

Ka raste që ne nuk i realizojmë kurdoherë detyrat e caktuara në planet tona, gjë që krijon boshllëqe në përmirësimin e jetës ekonomike dhe kulturore të punonjësve. Duhet kuptuar mirë nga të gjithë se ky është një minus për ne, prandaj theksoj se është e domosdoshme që këto tri rrethe të përqendrohen më seriozisht në problemet e bujqësisë. Të kuptohet drejt, kjo nuk do të thotë se Partia nuk i jep rëndësi zhvillimit të industrisë në rrethet e Veriut, por shihet që bujqësisë atje nuk po i jepet rëndësia që i përket, krahas me industrinë. Ka shokë drejtues që, duke menduar se në industri punon klasa punëtore etj., etj., gati 3/4 e kujdesit ia vënë këtij sektori, kurse bujqësinë, pa të cilën nuk mund të ecim përpara, e lënë pas dore. Kjo gjë duhet të bëhet mirë e qartë për të gjithë, sepse ka njerëz deri në udhëheqje dhe natyrisht pastaj edhe më shumë në popull që këtë çështje nuk e kuptojnë si duhet. Shumë punonjës e shikojnë këtë problem vetëm në prizmin e të ardhurave personale, por është e domosdoshme që këtë ta kuptojnë drejt edhe në parim,

në radhë të parë, në prizmin e interesit të përgjithshëm.

Nuk them se është gabim që çështja e të ardhurave të shikohet edhe nga ana e interesit personal. Fshatari preferon dhe përpiqet të shkojë të punojë më mirë në miniera ose në sharra, sepse e di që trajtimi material atje është më mirë se në bujqësi, se në një ndërmarrje shtetërore ai do të marrë më shumë të ardhura sesa në kooperativën bujqësore. Këtë të vërtetë ne as nuk duhet, as nuk mund ta fshehim. Pra nuk mund të mos e kemi parasysh interesin personal. E them këtë se ka njerëz, në udhëheqje dhe në bazë, që çështjen e interesit personal nuk e gjykojnë drejt dhe në vijën tonë. Partia, natyrisht, interesit të përgjithshëm i vë theksin në radhë të parë, por ajo nuk lë në harresë as interesin personal kur ky është një pjesë përbërëse e të parit. Duke zgjidhur drejt çështjen e interesit të përgjithshëm, te ne zgjidhet mirë edhe ajo e interesit personal.

Në goftë se dikujt nuk i bie në sy fakti që në disa kooperativa për shumë vjet me radhë fshatarët vazhdojnë të marrin pak të ardhura për ditë-punë, për mungesë organizimi e të meta të tjera subjektive dhe nuk punon me të gjitha forcat për ta përmbysur këtë gjendje, kjo do të thotë t'i vësh kazmën bujqësisë.

Në goftë se i themi fshatarit «puno këtu, se kështu të them unë, se kështu të thotë Partia», kjo është një propagandë në hava. Partia nuk flet kështu. Për Partinë populli është gjëja më e shtrenjtë dhe pikërisht për t'i siguruar atij të drejtat civile demokratike, për një jetë të denjë njerëzore, ka luftuar dhe lufton



ajo. Këto të drejta e liri demokratike të popullit Partia duhet t'i ruajë deri në një dhe të mos lejojë kërrkënd t'ia marrë nëpër këmbë. Në qoftë se kemi nxjerrë ndonjë ligj, si ai i pasaportizimit, me të cilin i pengojmë nënshtrësit të vijnë nga fshati sipas dëshirës për të banuar ose për të punuar në qytete, me shpresë se këtu do të realizojnë më shumë të ardhura dhe të rrinë pa punë, këtë e kemi bërë me ndërgegje që ata të mos braktisin bujqësinë, këtë degë të rëndësishme të ekonomisë sonë popullore.

Në socializëm çdo punë realizohet me organizim, në mënyrë të planifikuar, e normuar, natyrisht aspak si në një kazermë, por siç duhet të ndodhë në një vend socialist, për interesin e masave të gjera të popullit. Prandaj, që të mos na krijohet konfuzion ose papunësi, i kërkojmë fshatarit të qëndrojë në fshat. Por njëkohësisht e kemi për detyrë që kooperativistit jetën t'ia bëjmë të kulturuar njëllor si në qytet, që ai të gjejë punë në fshat dhe të shpërblehet sipas punës që bën, ashtu siç ndodh edhe me punëtorin në qytet. Ky është synimi kryesor i Partisë sonë.

E kemi kryer ne si duhet këtë detyrë në drejtim të fshatit? Dua të them i kemi vënë të gjitha forcat, dijen dhe mundin tonë për t'i organizuar kooperativat, bujqësinë tonë në përgjithësi, në mënyrë të atillë që ajo të bëhet moderne, me të vërtetë e përparuar? Jo. Ç'kuptojmë ne me bujqësi të përparuar? Me këtë kuptojmë zhvillimin e bujqësisë në një nivel të atillë që të merret nga toka maksimumi i mundshëm i prodhimeve për çdo bimë, që blegtoria të sigurojë rendimente të larta në të gjithë zërat dhe të ketë kështu prodhime të

bollshme për fshatarin, për qytetarin dhe për nevojat e ekonomisë, që vazhdimisht të rriten të ardhurat e kooperativistëve, që munda dhe djersa e tyre të shpërblehen për punën që bëjnë dhe këta të rrojnë çdo vit e më mirë. Ne, shokë, nuk i kemi bërë të gjitha përpjekjet e mundshme në këtë drejtim.

Po t'i krahasojmë investimet që kemi bërë në industri me ato të bujqësisë, mund të themi pa u gabuar se proporcionet kanë qenë të drejta. Partia nuk i ka vënë asnjëherë rëndësi më të madhe industrisë në dëm të bujqësisë, ajo nuk e ka harruar bujqësinë, përkundrazi për zhvillimin e saj janë bërë investime të mëdha. Të gjithë e dinë ç'punë kolosale kanë bërë Partia dhe populli, duke tharë kënetat e moçale, duke sistemuar toka, sa fonde janë shpenzuar për të rritur shkallën e mekanizimeve etj., etj. Megjithatë bujqësia jonë qëndron akoma pas, për arsye se ne si Parti dhe si pushtet organizimit të punëve bujqësore në të gjitha hallkat, nuk i kemi vënë atë rëndësi që i kemi vënë industrisë. Unë mendoj dhe dëshiroj të theksoj se e kemi për detyrë ta plotësojmë sa më parë këtë boshllëk, që paskëtaj fytyrën ta kthejmë më shumë nga bujqësia dhe të vëmë të gjitha forcat për ngritjen dhe për forcimin e kooperativave bujqësore në të gjitha drejtimet.

Kur themi të kthejmë fytyrën nga bujqësia, këtë të mos e kuptojmë në mënyrë shabllone, siç kuptohen disa herë shumë direktiva të Komitetit Qendror. Të mos vemi më tutje, po le të marrim disa nga çështjet që dolën këtu. Sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit tha se ky rreth i ka realizuar

direktivat e Komitetit Qendror për sa i përket numrit të gjedhëve për hektar. Mirëpo gjendja e gjedhit në këtë rreth tregon se direktiva e Komitetit Qendror të Partisë është kuptuar keq. Komiteti Qendror nuk ka thënë asnjëherë që krerët për hektar të realizohen sa për numër. E ç'na duhen neve kafshë të tilla që janë si kërmë, nga të cilat jemi shumë larg të marrim rendimentet në mish e në qumësht për të cilat po luftohet? Kjo tregon shumë qartë se direktiva nuk është kuptuar drejt. Prandaj, po qe se e kuptoni kështu edhe atë që shpreha që «ta kthejmë më shumë fytyrën nga bujqësia», mund të arrini në përfundimin e gabuar që ne tashti mund ta lëmë mënjanë industrinë, pasi do t'i vëmë forca bujqësisë.

Kur Partia shtron problemin «të kthejmë fytyrën nga bujqësia», këtë e lypin interesat e popullit, interesi i bujqësisë, interesi i industrisë dhe interesi i ekonomisë sonë në tërësi. Tani duhet t'i kthejmë më mirë sytë nga bujqësia, se atje kemi lejuar shumë neglizhenca që kanë penguar arritjen e përparimeve më të shpejta dhe me një ritëm akoma më të madh, si, për shembull, në punimin e mirë të tokave, në rentabilitetin e bimëve etj.

Ia kemi bërë ne tokës të gjitha punimet që kërkon ajo? Jo, shokë. Këtu mund të sillen arsye të ndryshme, jo s'kemi pasur mekanizma, s'kemi pasur kuadro, s'kemi pasur këtë, s'kemi pasur atë etj. Çështja nuk qëndron vetëm te mungesat që përmenda. Këtë e them se në të kaluarën ka pasur në vendin tonë fshatarë që nuk kishin shumë dituri, megjithatë kanë marrë nga toka, bile në sipërfaqe jo të vogël, rendimente të larta.

Sot, në rendin kooperativist kemi, gjithashtu, brigada të dalluara që, duke punuar në mënyrë të shkëlqyer, marrin rendimente rekord, jo në 5 ose në 10 hektarë po në disa dhjetëra hektarë. Atëherë si mund të flasim që nuk paskemi njerëz që të njohin bujqësinë, që njerëzit tanë nuk dinë agroteknikën etj., etj.?

Unë nuk jam i mendimit se tani kemi arritur përsosmërinë, pasi shkenca bujqësore është një fushë e gjerë dhe shumë nga njerëzit tanë bujqësinë nuk e konsiderojnë si një nga profesionet më të vështira. Puna e minatorit që futet nën tokë është me të vërtetë e rëndë. E koklavitur është, gjithashtu, puna e punëtorit në uzinë, në ndërtim etj., megjithatë, shokë, puna e tyre është më e lehtë se ajo e kooperativistit, i cili që të bëhet një bujk i mirë duhet të punojë e të mësojë tërë jetën. Tornitorit, që të mësojë zanatin, i mjaftojnë ta zëmë 9 muaj kurs dhe duke punuar 3-4 vjet me torno ai arrin të marrë një kualifikim të caktuar. Kurse bujkut nuk i arrin kaq kohë për t'u bërë mjeshtër i mirë i zanatit të vet. Këtij i duhet vazhdimisht të mësojë shumë gjëra, të përvetësojë njohuri nga më të ndryshmet, që nga pedologjia e tokës, që është kryesorja e ku do të hedhë farën, i duhet të mësojë biologjinë e bimës, të dijë si mbin, si rritet, si sëmuret, si e ha krimbi dhe si luftohen sëmundjet dhe parazitët që e prekin, pastaj si shtohet dhe sa shtohet ajo, sa e do dhe kur e do diellin, për sa ujë ka nevojë e kur ka nevojë e shumë e shumë probleme të tjera që është e vështirë t'i numërosh të tëra përnjëherësh. Vallë a mësohen lehtë dhe brenda një ose dy vjetëve gjithë këto gjëra?

Të njëjtat vështirësi ka blegtorja. Blegtori që të bëhet mjeshtër duhet të njohë, gjithashtu, mirë llojin e kafshës që do të rritë, të dijë si e sa do të hajë, si e kur duhet të pijë, të kujdeset për strehimin dhe për shëndetin e saj etj. Bagëtia, kjo «makinë», që do të prodhojë qumështin, mishin etj. nuk është njëlloj si tornoja, organizmi i saj është shumë më i ndërlikuar, është si trupi i njeriut që, edhe doktori, megjithëse anatominë e njeh shumë mirë nga shkolla dhe nga eksperiencia, kur sëmuret, për t'i bërë diagnozën, jo vetëm ka nevojë ta shikojë, po i duhet t'i bëjë edhe disa analiza të sëmurit, pastaj t'i thotë ç'sëmundje ka. Bile shpesh ndodhin raste që edhe pas gjithë këtyre përçapjeve ai nuk është i sigurt dhe nuk e përcakton dot sëmundjen. Po për lopën, për delen, ose për çdo kafshë tjetër, zanat i lehtë është të dish nevojat dhe sëmundjet e tyre? Ja, pra, përse bujqësia, që nga shumë njerëz konsiderohet e thjeshtë, është një nga profesionet më të rënda dhe jo ashtu si thonë disa: «Mjaft t'i biesh shatës e lopatës».

Vetë ne, shokë, duke pasur koncepte dhe pikëpamje të tilla e kemi nënvleftësuar bujqësinë, prandaj, në radhë të parë, këto koncepte e pikëpamje duhet t'i luftojmë ideologjikisht, politikisht, po edhe teknikisht. E dyta, të ngulim këmbë me durim që kooperativistët tanë këtë mjeshtëri me rëndësi të madhe ta dashurojnë me gjithë shpirt. E treta, të përsosim organizimin në ndërmarrjet bujqësore dhe në kooperativat bujqësore, që punonjësit e këtij sektori këtë dashuri për zanatin ta tregojnë me punë, t'u bëjnë bimëve dhe bagëtime të gjitha shërbimet që rekomandon shkenca,

që t'u shohin «hajrin», duke marrë sa më shumë prodhime, të realizojnë kështu të ardhura gjithnjë e më të mëdha, t'u ngrihet vlera e ditës së punës. Atëherë do të shikoni shokë të Mirditës, të Pukës dhe të Kukësit se, për t'i bindur kooperativistët që t'ju vijnë në sharra e në miniera ç'propagandë të fortë do t'ju duhet t'u bëni dhe kjo kuptohet pse, kur fshatarësia të sigurojë ato që ka nevojë dhe dëshirë, atëherë s'ka arsye përse të largohet nga bujqësia. Partia po punon që vendi të ketë bollëk, që të gjithë kooperativistët në të ardhmen të marrin, kudo, më shumë lekë se deri tani për ditë-punë nga sa merr sot kooperativa më e mirë dhe këtë bollëk do ta krijojnë industria dhe bujqësia. Për këtë lufton Partia.

Tani për tani, me qëllim që ta zhvillojmë e ta zgjerojmë me ritme më të shpejta prodhimin bujqësor e blegtoral, kooperativistët duhet të bëjnë edhe ndonjë sakrificë, të pranojnë edhe ndonjë ngushtim, por në këtë drejtim vihen re disa teprime. E them këtë se ka disa kryetarë kooperativash që nuk punojnë si duhet me kokë dhe, në vend që t'i investojnë drejt fondet që kooperativistët i sakrifikojnë, duke shkurtuar të ardhurat për ditët e punës, ndërtojnë vend e pa vend objekte socialo-kulturore, ose ndonjë shtëpi kulture që kushton me miliona lekë. E përse bëhen këto? Që kooperativisti i kooperativës së bashkuar, i cili banon një orë e gjysmë apo dy orë larg qendrës së kooperativës, të vijë atje për të dëgjuar një këngë, kur ai fare mirë mund ta dëgjojë atë në klubin apo në vatrën e kulturës në fshat duke vendosur, po të jetë nevoja, televizorin që nuk kushton më shumë se

katër mijë lekë një copë. Sikur edhe në çdo fshat të kooperativës së bashkuar të vendoset nga një televizor, 4-5 aparate nga këta nuk do të kushtojnë më tepër se njëzet-tridhjetë mijë lekë, prandaj nuk ka arsye përse të shpenzohen shuma kaq të mëdha. Nga na dolën kështu të tillë kryetarë kooperativash, të cilët, fondet që sigurohen nga puna kolektive, i shpenzojnë sikur ua ka lënë trashëgim babai? Kjo nuk është aspak e mirë, sepse ka kooperativistë që kujtojnë se kështu mendon Partia, gjë që s'është e vërtetë. Mendime dhe veprime të tilla të gabuara këtyre kryetarëve ua ushqejnë edhe disa sekretarë komitetesh partie ose kryetarë të pushtetit në rrethe.

Që të na ecin punët mbarë në kooperativat tona, Komiteti Qendror, shokë dhe shoqe, dërgoi Letrën<sup>1</sup>, ku theksohet nevoja e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe në forcimin e disiplinës së punës. Këtë Letër tashmë ju e keni studiuar dhe duhet ta studioni e ta detajoni akoma më tej se ka rëndësi të madhe. Plani ynë i ri pesëvjeçar në bujqësi do të realizohet, në qoftë se nga organizatat-bazë të Partisë dhe nga udhëheqjet e kooperativave kuptohet mirë vija e Partisë për bujqësinë, në qoftë se do të kuptohet e do të zbatohet deri në një e në detaje, në mënyrë krijuese e jo si deri tashti, përmbajtja e Letrës, në qoftë se do të mbahet vazhdimisht lart entuziazmi për zbatimin e vendimeve dhe të propozimeve që kanë bërë masat e kooperativistëve për ngritjen e rendimeve, për shtimin e sipërfaqeve të tokave të reja që

---

1. Shih në këtë vëllim f. 105.

do të hapen e do të zihen me bimë, për rendimentet e makinerive e veglave bujqësore, për uljen e kostos etj., etj.

Shokët e Komisionit të Planit të Shtetit po na thonë se entuziazmi i parë i madh, lidhur me përpjekjet për rritjen e prodhimit, sikur ka filluar të bjerë pak, ka filluar të qarkullojë mendimi për pakësimin e planit të tokave dhe për ngritjen e rendimeve.

A mund të na thuash, shoku Pali, ç'tregon realizimi i hapjes së tokave të reja? Këto janë disa të dhëna që unë po i mbaj shënim. Ai që punon në miniera është pukjan ose mirditor, njëlloj siç është dhe ai që punon në kooperativë. Realizimi i hapjes së tokave të reja, sipas mendimit tim, tregon që njerëzit e duan tokën, bazën nga ku do të nxirren prodhimet, se ndryshe nuk i hapnin. Kjo mendoj se është një gjë me rëndësi.

*SHOKU PALI MISKA:* Për sistemimin e tokave, ne jemi mbrapa, dhe prandaj këtu bëj autokritikë. Kjo prapambetje vjen për arsye të punës jo të mirë të organizuar nga ana jonë, sepse siç thatë dhe ju shoku Enver, pukjani e ka hapur tokën, pra pukjani mund të kishte bërë dhe sistemimin e saj. Ne duhej ta kishim racionalizuar më mirë forcën punëtore të krahut në fshatin tonë, mirëpo në këtë drejtim nuk kemi punuar mirë dhe po e shikojmë se gjithnjë e më tepër kjo po na bëhet një detyrë aktuale për sot dhe për perspektivën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të mendosh për të pakësuar hapjen e tokave të reja dhe ta kompensosh



këtë me ngritjen e rendimenteve, është diçka fiktive, sepse ne s'kemi akoma stabilitet në rendimentet. Fakti që vitet e fundit kemi pasur njëfarë rritjeje në rendimentet, nuk duhet të na bëjë të mendojmë se ka ardhur koha të mos preokupohemi për shtimin e sasisë së hektarëve të tokës, se s'paskemi nevojë për hapje tokash të reja. Të mendosh kështu, shokë, do të thotë së pari të gënjesh veten. Ne duhet të luftojmë sa më shumë edhe për sasinë e tokës, edhe për të marrë prej saj rendimente sa më të larta. Mundësitë për realizimin e këtyre synimeve ekzistojnë, për këtë u dhanë prova të shumta në të gjitha mbledhjet, ku morën pjesë punëtorët e fshatarët, të cilët vërtetuan me shifra se këto mundësi, siç janë mekanizimet dhe fuqia punëtore, ekzistojnë, ekziston, gjithashtu, edhe vullneti i madh i njerëzve tanë për realizimin e detyrave. Atëherë përse lindin të tilla mendime? Disa nga këto, siç është ai i qarkullimit bujqësor, janë të vërteta dhe shkencore, sepse dihet që, në qoftë se mbjellim 15 vjet rresht pambuk në të njëjtën tokë, është e qartë se nga ajo nuk ka si të marrim rendimentet që dëshirojmë. Po edhe të mos mbillet fare pambuk, lulediclli etj., kur ekonomia dhe populli kanë nevojë për vaj e pambuk dhe t'i blesh këto me valutë, as ky nuk është qëndrim i drejtë. Nuk vlejnë, gjithashtu, as justifikimet që e kanë burimin në mungesën e mobilizimit të të gjitha mundësive materiale e njerëzore. Dhe me atë organizim e disiplinë në punë që kemi sot nëpër kooperativa, të jemi të sigurt se nuk i mobilizojmë dot të tëra këto mundësi.

Kur flasim për forcimin e disiplinës në punë në

kooperativat tona, natyrisht, duhet të forcojmë, në radhë të parë, punën politike. Por puna politike është e nevojshme të orientohet në objektiva të caktuar e jo kuturu, synimi i saj është të shpjegojë qëllimin e këtij objekti, të sqarojë format organizative të punës që janë vendosur, ose që do të vendosen, si dhe faktin se ku duhet të mbështeten e të punojnë kooperativistët për të realizuar detyrat që na janë vënë përpara. Po bëhen vallë kështu këto punë? Jo, nuk bëhen kështu, puna politike bëhet e përciptë, e përgjithshme dhe më shumë për bujë. Një punë politike e tillë e përgjithshme dhe pa objektiva të caktuar nuk jep rezultate. Në kooperativa ne duhet të forcojmë në mes të tjerash dhe mbi çdo gjë disiplinën në punë, të marrim për këtë qëllim masat më të përshtatshme organizative, të përsosim format e punës dhe politikisht të përpiqemi për ngritjen e ndërgjegjes së kooperativistëve për punën, të krijojmë tek ata një dashuri e pasion të madh për punën. Pavarësisht se fshatari ynë është patriot dhe ka shumë cilësi të tjera të mira, po pasionin për punë ai nuk e ka aq të zhvilluar, prandaj të mos gënjehemi në këtë drejtim. Këtë pasion atij ne duhet t'ia zhvillojmë gjithnjë e më tepër. Është për këto arsye dhe për të tjera që ne nuk kemi arritur dot akoma që të marrim pjesë në punë të gjitha forcat në kooperativë. Duke u bazuar në të dhënat statistikore, kjo pjesëmarrje është deficitare. Jo vetëm kaq, por edhe ata që dalin, nuk punojnë të gjithë me pasionin që duhet në zanatin e tyre. Shpesh flitet për ditë-punë, flitet për normat etj., por të gjitha këto, sipas mendimit tonë, janë larg asaj që duhet të jetë në realitet.

Është e domosdoshme që në kooperativat ne të vendosim norma të bazuara në matje, pasi pa norma, shokë, nuk mund të ecet në bujqësi. Kur punojnë kooperativistët tanë, nuk mendojnë të gjithë më shumë për prodhimin, si sasi dhe cilësi, nga i cili varet çdo gjë, por më parë e më shumë mendojnë për ditën e punës, ose lidhur me normën ata mendojnë që, duke u lodhur sa të jetë e mundur më pak, të futin ditë-punë më shumë, duke bërë norma sa më të vogla. Në këtë mënyrë kuptohet vetvetiu se rezultatet e prodhimit nuk mund të jenë ato që priten për arsye se puna nuk është e kualifikuar, se sasia e punës e bërë për bimët është fiktive, pasi ka munguar përpjekja, ka munguar zbatimi i agroteknikës, ka munguar disiplina në punë. Pra, bashkë me rëndësinë që ka puna politike, po aq rëndësi ka edhe organizimi i punës, sidomos organizimi i normimit të punës.

Ç'do të thotë të plotësohet norma? Kjo do të thotë të kryesh punën në sasi, në cilësi dhe në kohën e caktuar. Pra, normën e përbëjnë sasia, cilësia dhe koha. Këto janë një unitet, i cili realizohet në të tria këto pjesë përbërëse, përndryshe nuk mund të quhet normë e vërtetë. Në kooperativat tona bujqësore përdoren norma, fliten edhe fjalë të mëdha për to, po kur shikohet nga afër ky problem, atëherë konstatohet sa të meta, sa neglizhenca, sa rumbullakosje, sa veprime të padrejta politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht ka në to.

Vihet përpara çështja se në bujqësi është vështirë të vendosen norma ekzakte, të kontrollohet si duhet zbatimi i tyre dhe, duke u shfajësuar me këtë «arsye-

tim», lihen mënjanë llogaritjet e nevojshme e të domosdoshme, gjë që çon në egalitarizëm për të lehtësuar punën e brigadierit, për të suprimuar normistin, për të mos kontrolluar punën dhe për të dalë pa llogari e pa kosto në një ekonomi kaq të madhe e kaq të koklavitur. Harrojmë se me normën në llogaritim sasinë dhe cilësinë e punës, pra sigurojmë prodhimin e ardhshëm, matim, gjithashtu, shpërblimin e vërtetë që i përket çdo kooperativisti për punën që kryen. Po ta kontrollojmë këtë normë në të tre komponentët që përmenda, ne e kemi bërë kooperativistin të ndërgjegjshëm dhe e kemi detyruar që për interesin e tij të mos shohë më si objektiv vetëm ditën e punës, por edhe rezultatet e ardhshme të kësaj dite pune, domethënë, prodhimin në sasi dhe në cilësi që varet nga sasia, cilësia dhe koha e punës që bën.

Normat janë të domosdoshme për punën dhe për mbarëvajtjen e gjithë kooperativës. Natyrisht, ato janë të domosdoshme edhe për vetë kooperativistin si individ. Norma organizon punën e përgjithshme të kooperativës dhe atë të individit, sepse të dyja palët janë shumë të interesuara që norma të ekzistojë sa më e drejtë, sa më e përshtatshme, e verifikueshme dhe vazhdimisht e ndryshueshme në disa periudha të caktuara, pse koha dhe përfitimi nga përvoja kërkojnë që patjetër të bëhen ndryshime. Caktimi i normave duhet të bëhet si rezultat i një studimi të thellë dhe të vazhdueshëm. Çështja pra qëndron në përcaktimin e drejtë të ditëve të punës për çdo bimë ose sektor tjetër të aktivitetit bujqësor dhe të ndiqet çdo vit, ose dy herë në vit, realizimi i normave që duhet të reali-

zohen nga kooperativistët brenda ditës së punës ose një numri ditësh pune të caktuara. Në qoftë se nuk përcaktojmë normat në mënyrë sa më ekzakte për çdo punë, nuk do të jemi në gjendje as të parashikojmë, as të përcaktojmë si duhet numrin e ditëve të punës që na duhen për bimët e ndryshme, për skuadrat, për brigadat, për sektorët. Çështja e përcaktimit të ditëve të punës, që del nevoja të përdoren në faza të ndryshme të proceseve të punës, është me shumë rëndësi, ajo është një çështje kryesore studimi të kujdesshëm, llogarie dhe kontrolli të vazhdueshëm. Për këtë qëllim nuk mjafton një përcaktim i përafërt, duke i vënë një procesi ta zëmë 15 ditë-punë, një tjetri 4 ditë-punë ose 8 ditë-punë etj. Nuk është e drejtë të veprohet kështu me fshatarin tonë kooperativist, patriot e me besim të madh te Partia. Ne kërkojmë që ai t'i pranojë këto që bëjmë, pa i shpjeguar kush i ka nxjerrë ato dhe pa arsyetuar me të që të bindet. Ai i pranon ato, se kështu kemi vendosur ne, edhe kur ai përcaktim bëhet në mënyrë shabllone ose kopjohet nga dikush, pa u kujdesur njeri që të shqyrtojë bën apo s'bën për kushtet tona.

Koeficientet e përafërta të ditëve të punës që përdoren disa herë për bimët duhet të vihen në provë, të vërtetohen, të korrigjohen, ashtu siç duhet të korrigjohen edhe normat dhe jo të procedohet duke u ngritur herë pas here pa u studiuar. Përse t'i ngremë normat pa i studiuar? Jo vetëm në bujqësi, po edhe në industri e kudo gjetkë, para se t'i ngremë, të mendojmë thellë, duhet apo s'duhet t'i ngremë normat,

të diskutohen më parë ato dhe pastaj në rast se po, të bëhen të gjithë të qartë pse duhet t'i ngremë.

Derisa çështjes së normave në bujqësi u është vënë pak rëndësi, natyrisht, ngritja ose ulja e tyre e herëpashershme nuk mund të jetë bërë e studiuar dhe s'mund të jetë e drejtë. Një anomali e tillë në normat, në ndërtimin e tyre, në llogaritjen e ditëve të punës të nevojshme për çdo bimë dhe më në fund në shqyrtimin e rezultatit final të prodhimit, të frytit të punës, ne na pengon për të ndërtuar në fshat një ekonomi moderne socialiste, na pengon të vendosim atje një disiplinë të vërtetë në punët organizative, agroteknike dhe financiare, pse çdo gjë ka tendencë t'i shpëtojë disiplinës, llogarisë, cilësisë, kërkesës së lartë. Derisa nuk ekziston norma, dita e punës mbetet një njësi matjeje pa caqe të përcaktuara discipline, sasie, cilësie, kohe dhe rezultati final është i dyshimtë.

Normat jo vetëm duhet të caktohen drejt dhe të kontrollohen në zbatimin e tyre në parcela o në stalla, por është e nevojshme që ato të bëhen edhe të diferencuara kooperativë me kooperativë, të këqyren me kujdes edhe brendapërbrenda kooperativës. Analizimi i normës për sasi, cilësi dhe kohë varet nga disa kushte të terrenit, të veglave të punës, të stinës. Në kushtet aktuale të tokës normën mund ta kesh caktuar, për she-mbull tre metra kub, po nesër të bie një shi i madh që vështirëson gjendjen dhe s'të lejon të realizosh atë normë, për arsye se toka rëndohet, mirëpo mosmarrja parasysh e kushteve të reja e dëmton kooperativistin që punon aty. Ky, pra, është një proces që vazhdi-

misht duhet ndjekur, vëzhguar, kontrolluar dhe ndrequr. Të tëra këto çështje duhen pasur parasysh nga studiuesit dhe normëpropozuesit.

Çështja e normave kolektive dhe e atyre individuale, siç e kemi thënë, duhet vënë sa më parë në rrugë të drejtë, pse këtu, shokë, kemi bërë gabime, që varen kryesisht te rrethet, pasi nuk ka direktiva nga ana e Komitetit Qendror që normat kolektive të zbatohen me vend e pa vend. Ju, shokë të rretheve, i keni rrumbullakosur këto çështje, si rrjedhim në mjaft raste janë ulur emulacioni, hovi në punë, sepse këto lloj normash nuk kanë qenë të përshtatshme dhe nuk është ngulur këmbë që norma kolektive të zbatohet në rrugën që ka këshilluar Komiteti Qendror. Prandaj duhet të gjendet sa më parë rruga e drejtë, pse, po të veprohet sikurse sot me normat kolektive, mund të kalohet në egalitarizëm, gjë që influencon në uljen e pjesëmarrjes në punë dhe ndihmon parazitizmin.

Norma në vetvete mund të nxitë përpjekjet e kooperativistëve për kualifikim, gjë që lidhet edhe me prodhimin, edhe me interesin personal. Por, ashtu si trajtohet aktualisht në kooperativë norma, mendoj unë, edhe këtë stimul e ka humbur.

Ndryshe nga industria ku kualifikojmë dhe kategorizojmë punëtorët, në bujqësi ne kategorizojmë punën dhe, në qoftë se nuk gabohem, këtë e ndajmë në katër kategori. Po edhe këto katër kategori në shumë kooperativa nuk dallohen ku e kanë kufirin, ose s'kanë kufi fare. Por në çdonjërin nga këto kategori ka punëtorë bujqësie me pak përvojë e me shumë përvojë, me shkollë e pa shkollë, me kurs apo pa kurs, me

vjetërsi në punë ose fare të rinj, por që të gjithë paguhen njëllë, nuk shpërblehet, pra, secili si duhet dhe sa duhet, sipas sasisë dhe cilësisë së punës që bën. Kjo nuk është aspak e drejtë. Prandaj duhet rishikuar sa më parë ky problem, pse këtu e kanë burimin kërkesat për largim nga punët bujqësore, të cilat vazhdohet të mos vlerësohen.

Në qoftë se nuk i shikojmë si duhet këto gjëra në organizimin e kooperativave bujqësore, nuk mund të mobilizojmë të tëra forcat dhe fuqinë punëtore, nuk mund të krijojmë atë disiplinë që kërkon Partia, nuk mund të kërkojmë atë stimul në punë që do ta nxitë kooperativistin të punojë si duhet. Kooperativisti do të punojë mirë dhe me kohë të zgjatur, kur ta dijë që ajo kohë e tepërt do t'i paguhet me siguri, sepse është caktuar për këtë punë njeriu që do t'i shkruajë dhe do t'i kontrollojë këto gjëra. Po t'i organizojmë mirë këto punë, do të shohim atëherë se si kooperativistët do të rrinë në punë jo më 8 orë, por, kur ta lypë nevoja, edhe 10 orë e më shumë, pse do të shohin në punë kombinimin e interesit personal me interesin e përgjithshëm. Kur ta kemi vendosur drejt këtë çështje, kooperativistët do t'i zbatojnë këshillat dhe porositë e Partisë për rritjen e prodhimit dhe misrin, fjala vjen, do ta prashitin aq herë sa do të ketë nevojë, e jo si tani që mezi i bëjnë një prashitje, pse do të shohin që puna dhe djersa do t'u shpërblehet, nuk do t'ua përvetësojnë ata që nuk punojnë ose që punojnë fare pak. Prandaj, në qoftë se i organizojmë punët si duhet, gjë që kemi mundësi ta bëjmë, po t'i shikojmë çështjet drejt dhe të përpigemi që fshatari t'i kuptojë



dhe t'i mbrojtë mirë, këtë plan të ngjeshur që kemi ndërtuar do ta realizojmë, ndryshe ai nuk do të realizohet dhe atëherë të jemi të ndërgjegjshëm se do të kemi vështirësi ekonomike dhe politike.

Kur nuk bëhet në rregull furnizimi i mishit në qytete fillojnë pëshpëritjet, kur mungon vaji fillojnë gjithashtu, shprehjet e pakënaqësisë. Mirëpo, shokë, nuk duhet abuzuar me durimin e njerëzve tanë. Populli ynë është i thjeshtë, patriot, por populli do të ushqehet, të vishet, të plotësojë nevojat e jetës së tij të përditshme. Pastaj nuk janë vetëm qytetarët, shokë, të cilëve u mungon vaji apo mishi, po edhe kooperativistët. Është vallë e drejtë që fshatarit t'i mungojë vaji, t'i mungojë mishi, ose të mos marrë bukë në furrë ashtu si edhe qytetari, sa të ketë nevojë? (Natyrisht jo për pulat e derrat.) Jo, nuk është e drejtë. Atëherë çfarë duhet të bëjmë? Duhet plotësuar medoemos detyrat nga punëtorët edhe nga fshatarët njëkohësisht.

Ne nuk do të shkojmë nga rruga që punëtorëve t'u presim tani furnizimin, që të mund t'ua shtojmë një çikë fshatarëve. Jo, por t'u themi punëtorëve që fshatarësia aktualisht bën sakrifica, prandaj të mendojnë ta organizojnë më mirë punën që të ulin koston, të prodhojnë sa më shumë e sa më lirë mallra, kurse fshatarësisë t'i themi që edhe ajo të mobilizohet më shumë, të organizojë punën më mirë, të punojë me disiplinë e kulturë të lartë, të ngrejë rendimentet dhe të sigurojë më tepër të ardhura. Ne do t'i japim fshatarit mallra e ushqime më shumë, që të blejë çdo gjë që ka nevojë dhe këto t'i marrë të gjitha njëjloj si edhe qytetari. Fshatarësia e ka njëjloj si qytetarët mundë-

sinë e ndjekjes së shkollave, përfitimin e ndihmës mjekësore falas, furnizimin e artikujve ushqimorë, siç janë makaronat, orizi e sheqeri, apo artikujt industrialë, veshmbathjen etj. Gjithë pikën e dobët ne tani e kemi te disa prodhime bujqësore e blegtorale, siç janë drithërat, yndyrnat dhe mishi që i prodhon fshatari. Kemi ne mundësi të prodhojmë më shumë nga këto? Kemi, si s'kemi? Çështja është që ta trajtojmë sa më mirë këtë pasuri të madhe bujqësore e blegtorale që kemi, të luftohet për ta zhvilluar më tej dhe për të marrë prodhime të bollshme. Por kjo luftë nuk bëhet si duhet kudo. Në Mirditë nga pakujdesia kanë ngordhur mjaft bagëti dhe kjo është një humbje e konsiderueshme ekonomike dhe politike. Ju, shokë të Partisë të rrethit të Mirditës, duhet t'ju vrasë ndër-gjegjja për këtë gjendje. Si është e mundur të na vejë dëm gjithë kjo pasuri e popullit? Një gjë e tillë në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar dhe jam i bindur se ju i keni të gjitha mundësitë të dilni nga kjo situatë. Prandaj, shokë merrni të gjitha masat për të bërë punimin sa më të mirë të tokave që të rritet rentabiliteti i tyre. Për këtë qëllim është i domosdoshëm që edhe mobilizimi i njerëzve, i mekanikës, i oficinave dhe i kafshëve të shërbimit në punët e bujqësisë të jetë i plotë dhe në lartësinë e duhur. Partia, pushteti dhe klasa punëtore në rrethe të bëjnë të gjitha përpjekjet që traktorët të vihen me kohë në efikasitet dhe jo t'i paraqiten raporte Sekretariatit se nuk janë në gatishmëri. Të luftohet me këmbëngulje e deri në fund për këtë çështje dhe të mos na flitet më për të tilla mungesa. Ne duam që traktorët që ju dërgohen, në

një mënyrë ose në një tjetër, të vihen në punë dhe të kryhen me ta plotësisht të gjitha detyrat që parashi-kojnë planet e shtetit.

Çështja tjetër që duhet shikuar është leverdishmëria e drithërave, e blegtorisë, e pemëtarisë, e pyjeve etj. Ne kemi thënë që të jemi të lirë në planifikim, por që të jesh i lirë, do të thotë të mendosh gjerë, jo vetëm përbrenda rrethit, po të shikosh interesat e mëdhenj të republikës, të të gjithë popullit shqiptar, pra të shikosh në perspektivë. Nuk duhet nisur nga synimi i lehtësimit tuaj për të zhdukur disa vështirësi në mobilizimin e fuqisë punëtore nga fshati etj., etj. dhe të pakësoni kështu hektarët e tokave ose diçka tjetër; prandaj kooperativistëve t'u siguroni të gjitha ato për të cilat kanë nevojë, por njëkohësisht t'i siguroni edhe shtetit të gjitha ato që i duhen ekonomisë popullore në tërësi.

Partia, shokë, nuk duhet të harrojë situatat politike që jetojmë. Ne jemi një vend i rrethuar nga armiq, nga shtete borgjeze, kapitaliste e revizioniste. Tendenca aktuale e imperializmit amerikan dhe e aleatëve të tij është që, në shtetet rreth e rrotull dhe afër nesh, të vendosen diktatura fashiste. Edhe në Jugosllavi, siç e dini, situata është e turbullt. Armiqësinë dhe kontradiktat e armiqve rreth e rrotull vendit tonë, si në mes njëri-tjetrit, ashtu edhe kundër një vendi socialist si Shqipëria, nuk duhet t'i harrojmë kurrë. S'ka dyshim që kontradiktat do të gjallërohen edhe në mes imperializmit amerikan dhe revizionistëve sovjetikë. Midis tyre, natyrisht, ka aleanca që zhvillohen, po ekzistojnë edhe kontradikta që edhe ato, gj-

thashtu, zhvillohen. Imperializmi amerikan, për shembull, shikon një rrezik nga ana e socialimperializmit sovjetik në Mesdhe, prandaj fuqinë imperialiste sovjetike në këtë rajon përpiqet ta kundërbalancojë. Për ne nga të dyja palët ekziston një rrezik i madh. Një konflagracion, në çdo qoshe të botës, qoftë në mes imperializmit amerikan dhe imperializmit sovjetik, qoftë në mes vendeve satelite të këtyre dy superfuqive, ose edhe një provokacion kundër nesh nga ana e tyre, mund të na shkaktojë vështirësi serioze. Prandaj ne duhet të punojmë shumë që në çdo situatë të jemi të fortë, të jemi të armatosur politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht, të luftojmë edhe për shtimin e rezervave tona. Por ato, shokë, nuk mund të rriten duke mos realizuar planet, sidomos në drithëra, në bimët vajore e në bimët industriale. Pastaj populli ka nevojë të vishet, gjithashtu, ka nevojë të vishet ushtria, kështu që duhet të kemi rezerva edhe për veshmbathje.

Nuk është e drejtë të mendohet, gjithashtu, që të ulim planet e caktuara në zëra të ndryshëm, të ulim, fjala vjen, pambukun, të ulim prodhimin në këtë ose në atë bimë dhe, nga ana tjetër, të shtojmë investimet me qindra milionë në sektorin e ndërtimeve etj. Kështu më duket nuk ka asnjë logjikë dhe nuk mund të ecet. Udhëheqjet e Partisë e të pushtetit në rrethe nuk e kanë sa duhet të qartë çështjen e politikës së madhe shtetërore, nuk reflektojnë thellë sa duhet në këtë drejtim. Ato jo vetëm e kanë detyrë të reflektojnë thellë, po në çdo hap që hedhin ta kenë të kristalizuar mirë në kokën e tyre çështjen e mbrojtjes. Kjo do të thotë të realizojnë planet, të hedhin sa më shumë

kuintalë me drithë në depot e shtetit, të ngrenë kurdoherë e më lart nivelin e jetesës së masave, që populli të forcohet politikisht dita-ditës. Kjo arrihet me luftë, me përpjekje, me djersë pse është e vërtetë që tani jemi në paqe, po veç në një paqe të paqëndrueshme, në situata që mund të marrin papritur një kthesë të rrezikshme, prandaj, në këto drejtime duhet të mendohemi shumë.

Është e domosdoshme të ngulim këmbë, shokë, për ngritjen e nivelit agroteknik të punonjësve në kooperative, ndryshe nuk realizohet gjithë ai prodhim që parashikojmë dhe nuk plotësohen të gjitha nevojat e ekonomisë.

Ju shokë të Partisë të rrethit të Kukësit, të Pukës dhe sidomos të Tropojës mos ekzagjeroni, duke menduar se jeni rreth industrial, se «industria është në radhë të parë» te ju, prandaj «bujqësia nuk çon kandar», se një mendim i tillë në praktikë të çon në gabime, sikurse çoi ish-kryetarin e Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Mirditës, dhe ish-sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të këtij rrethi, që ka edhe ky faje të rënda, pse, siç më thanë, këto janë shprehje të dala nga ana e tij. Nuk është industrial rrethi i Tropojës. Për 25 vjet me radhë Tropoja s'kishte pasur as furrë. Atje tani u ndërtua një e tillë dhe një mulli, u ngrit, gjithashtu, një uzinë e vogël riparimesh dhe një zdrukthëtari e kufizuar, por t'i quani këto «industri» dhe të lini mënjanë bujqësinë, që është sektori kryesor i ekonomisë për rrethin tuaj, është të shohësh ëndrra me sy hapur.

Ju keni interpretuar shtrembër fjalët që kam thënë

unë që «qyteti Bajram Curri të bëhet i bukur». Kur vizitova vjet rrethin e Tropojës shfaqta mendimin se tani që do të ndërtohet hidrocentrali i Fierzës, mund të mendohet nëse duhet të ngrihen në këtë qytet disa banesa për punonjësit e kësaj vepre, por më parë të shihet se mos për të vajtur andej e deri në hidrocentral do të duhen shumë autobusë për punëtorët. Në rast se nuk sigurohen dot mjete transporti, atëherë shtëpitë le të ndërtohen më mirë në Fierzë, ku të krijohet për punëtorët një qytet i vogël me shkollë, dyqane, kinema, ambulancë, shtëpi lindjeje etj., se nga Bajram Curri e deri atje ata nuk mund të venë në këmbë, as lejohet të shkojnë të lodhur dhe me vonesë në punë. Prandaj kjo çështje të mendohet mirë që në fillim.

As ju shokë të Kukësit s'duhet ta konsideroni industrial rrethin tuaj. Ai nuk është akoma i tillë, se vetëm një uzinë keni hëpërhë. Janë çështje tjetër studimet që po bëhen për zhvillimin e rrethit në perspektivë, sipas të cilave atje do të hapim e do të shfrytëzojmë miniera të tjera. Megjithatë edhe atëherë në asnjë mënyrë nuk do të shkojmë nga rruga që të braktisim bujqësinë. Komitetit Qendror i tërheq vëmendjen fakti se nga 16 ndërmarrje që ka gjithsej rrethi juaj, 7 prej tyre nuk e kanë realizuar planin gjatë muajve janar-shkurt të këtij viti, prandaj ca më tepër duhet të rritet kujdesi i organizatës së Partisë të rrethit tuaj për realizimin e planeve në tërë sektorët e ekonomisë.

Shoku Adil [Çarçani] shumë drejt e tha që kur është fjala për vendosjen e normave të forta në buj-

qësi, të tilla duhet të vendosen në të tërë sektorët, pra edhe në miniera e në industri. Të gjitha rrethet ta kenë parasysh këtë çështje. Është e nevojshme të bëhet për këtë qëllim një evidencim i saktë i gjendjes së fuqisë punëtore në rreth, gjë që nuk e kanë në rregull as të tri rrethet e Veriut që janë sot në raport përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror dhe as ndonjë rreth tjetër në Shqipëri. Unë u interesova ca në Vlorë për këtë problem dhe më ra menjëherë në sy kjo gjendje. Është e domosdoshme të mbahen kudo evidenca për fuqinë punëtore, për lëvizjet dhe zhvillimin e saj, që të dihet ku janë tani forcat e punës, ku mund të shkojnë një pjesë, të cilit seks e moshe janë, ç'kualifikim kanë etj. Ky është një problem i madh që më duket se po e trajtojmë si nëpër këmbë.

Kur tërhiqen forcat e punës nga fshati për në ndërmarrjet shtetërore, kryesitë apo kryetarët e kooperativave bujqësore i dërgojnë njerëzit pa ndjekur kritere të shëndosha, bile ka raste që veprojnë me hatëre. Kështu ndodh që farefisi i njerëzve të udhëheqjes së kooperativës venë në miniera, ku marrin nga 500 e 600 lekë në muaj. Në qytetin e Kukësit ka lloj-lloj njerëzish, 40 e 50-vjeçarë, njerëz me shkollë e pa shkollë etj., që drejtohen për punë në ndërmarrjet shtetërore. Sot, ngaqë nuk e kemi të organizuar mirë këtë çështje, ndodh që një djalë i ri 20-vjeçar shkëputet pa vështirësi nga fshati dhe vete futet kamerier në qytet, ku, pasi punon disa vjet, pra pasi ka zënë vend, ai nuk largohet dot lehtë për të punuar, për shembull, në Kalimash, se thotë «kam mësuar zanat», ose «jam bërë mekanik», thotë një tjetër. Kjo ndodh

se për këtë problem me rëndësi nuk është bërë një studim, ai nuk është parë në perspektivë, siç duhen parë me kohë një varg problemesh të tjera.

Në vendin që do të mbytet nga liqeni i hidrocentralit të Fierzës duhen prerë të gjitha pyjet. Mirëpo e keni vënë ujët në zjarr që tani për këtë problem ju, shokë të rrethit të Kukësit, se për ta shfrytëzuar këtë pasuri do të duhen sharra, punëtorë etj.? Nga do t'i nxirrni këta? Ti, shoku sekretar, në materialin që i ke paraqitur kësaj mbledhjeje të Sekretariatit të Komitetit Qendror, kur thua se do të priset qyteti i vjetër dhe në vend të tij do të ndërtohet i riu, le të nënkuptohet sikur do të vijë dikush t'jua bëjë këtë punë. Ta keni të qartë se qytetin e ri do ta ndërtoni vetë ju me materialet që do të shfrytëzoni nga i vjetri dhe me lëndën e drurit, bile edhe tullat që do t'ju nevojiten do t'i prodhoni në rreth. Vetëm hekur dhe çimento do t'ju japë shteti. Edhe punëtorët specialistë, si: muratorët, karpentierët e gjithë të tjerët që do t'ju duhen për minierat, bujqësinë, blegtorinë etj., të gjithë do t'i gjeni dhe do t'i përgatitni vetë në rrethin tuaj. Se si do ta zgjidhni këtë problem, këtë e dini ju.

Këto çështje janë shumë të rëndësishme dhe të koklavitura që duhen zgjidhur, prandaj udhëheqja e rrethit nuk ka kohë të merret me gjëra të vogla. Në qoftë se ju u futeni cikërrimave dhe nuk ngarkoni me përgjegjësi për zgjidhjen e problemeve korente njerëzit e caktuar, nuk do t'ia dilni dot për të zgjidhur problemet kryesore; kështu për çështjet kryesore, menjëherë t'u jepni direktivat e nevojshme vartësve dhe të kontrolloni mirë zbatimin e tyre. Ju dhe shokët e tje-



rë duhet të vini rregulla të rrepta në rreth për ata që merren me studimin e fuqisë punëtore, që të dinë në çdo kohë gjendjen se ku punojnë gjithë njerëzit e aftë për punë, ç'nivel kanë, sa të rinj ju vijnë për punë këtë ose atë vit etj. Të mendoni që të zgjidhni çështjen se sa punëtorë do t'ju duhen për të spastruar liqenin e ardhshëm, të llogariten në mënyrë të studiuar sa familje duhet të largohen nga fshatrat që do të mbytet liqeni i ardhshëm, ku do të venë etj. Mirëpo lëvizja e këtyre njerëzve përbën një problem të madh për rrethin, prandaj ajo duhet bërë e menduar mirë dhe me plan. Pa u qëndruar gjithë këtyre punëve në krye, me një organizim sa më të mirë, me një metodë e stil pune revolucionar, problemet nuk do të zgjidhen si duhet.

Siç thashë, shokë, mos u merrni me gjëra të vogla me pak rëndësi, shumë nga këto ua lini kuadrove më të ulët t'i zgjidhin, i ngarkoni ata me detyra dhe u kërkoni llogari, sepse janë njerëz me eksperiencë. Pastaj duke i vënë para përgjegjësisë, ata do të ecin përpara. E përse duhet të preokupoheni aq shumë ju për Uzinën e Shkrirjes së Bakrit kur atje ka disa kuadro drejtues që duhet të përgjigjen për të tëra çështjet? Po për minierat, që janë vërtet qendra të rëndësishme ekonomike, ku ne kemi kuadro drejtues e teknikë të aftë, përse të preokupoheni ju çdo ditë për punët e tyre? Mos harroni pastaj se ata kanë edhe prapavijat e tyre të organizuara mirë, nëpërmjet të cilave mund të jepen ndihmë edhe për fshatin. Shefi i arsimit të rrethit duhet të përgjigjet edhe ai për punën arsimore e kështu me radhë mund të themi për

gjithë të tjerët, të cilët i aktivizoni, i ngarkoni me detyra, i ndihmoni e u hapni perspektiva dhe pastaj i thërritni për të dhënë llogari si i kanë kryer detyrat. Po t'i organizoni punët në mënyrë që secilit t'i bëhet e qartë detyra që duhet ta kryejë dhe t'i ndihmoni e t'i kontrolloni si duhet në këtë drejtim, atëherë udhëheqjes së Partisë në rreth do t'i mbetet kohë të thellohet e të merret me problemet e mëdha, siç është bujqësia, të vejë fshat më fshat e t'u rrijë mbi kokë këtyre çështjeve kaq shumë të rëndësishme.

Pra, asgjë nuk duhet të bëhet në mënyrë anarkike e pa llogaritur çdo gjë me rreptësi, në sasi dhe në kohë, të mos merren në asnjë mënyrë nga fshati njerëz pa plan dhe të na rrënohet kështu bujqësia. Për të gjitha këto arsye kërkohet vazhdimisht disiplinë e rreptë në punë si në bujqësi, ashtu edhe në gjithë sektorët e tjerë. Në përgjithësi, çështjen duhet ta vini kështu: rrethi duhet të plotësojë të gjitha nevojat e veta, prandaj nuk është e drejtë të pritni ndihmë nga lart, me përjashtim të atyre çka cakton plani qendror. Ato që u cakton plani qendror rretheve duhet t'u jepen nga ministritë përkatëse, njëkohësisht të gjitha ato që u përkasin t'i plotësojnë brendapërbrenda, se e kanë detyrë t'i realizojnë dhe asnjë orvatje të mos bëhet për t'i kërkuar nga lart, se atëherë nuk merret vesh ku shkojmë.

Ne, shokë, kemi besim se të gjitha të metat që ekzistojnë te ju do të vijnë gradualisht duke u zhdukur. Të meta të kësaj natyre ka jo vetëm në rrethet tuaja, por edhe në rrethe të tjera, bile edhe në ato më përvojë më të madhe e me kuadro më të shumtë se

tuajt. Por ne nuk dëshpërohemi se ekzistojnë këto të meta, çështja është të përmirësohet e të forcohet akoma më tej puna organizative e Partisë dhe e pushtetit. Po të bëhet kjo dhe të vendoset kudo rregull, disiplinë, të kërkohet llogari deri më një, pa bërë lëshime, atëherë këto të meta do të kapërcehen, detyrat që kemi përpara, të cilat nuk janë të lehta, do të realizohen me sukses, pse me përpjekje ato janë plotësisht të realizueshme. Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë ka bindjen, shokë, se organizatat e Partisë në rrethet tuaja do ta kryejnë me sukses këtë detyrë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 237*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 237*

## **NDAJ NJERËZVE PARTIA VEPRON KURDOHERË ME URTËSI, TAKT E DURIM**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**23 mars 1971**

Kam edhe unë disa mendime për punën jo të shëndoshë të udhëheqjes së Komitetit të Partisë të Rrethit të Mirditës.

Nga organet e Partisë e të pushtetit në rreth, nga Qeveria, si dhe nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë janë bërë një sërë analizash të ndryshme. Edhe kjo mbledhje e Sekretariatit të Komitetit Qendror na sqaroi mjaft gjëra, na vuri në dukje realitetin e hidhur për gjendjen e vështirë që është krijuar në këtë rreth, por na tregoi edhe rrugët për ta kapërcyer këtë gjendje. Te Komiteti Qendror i Partisë ka ekzistuar kurdoherë besimi që organizata-bazë e Partisë në Mirditë është e shëndoshë, populli i këtij rrethi është patriot, i lidhur ngushtë me Partinë e besnik i saj dhe ai e do

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për disa probleme të punës së Partisë në rrethin e Mirditës.

punën. Këto konsiderata të Komitetit Qendror për popullin mirditor janë të bazuara, pse ai vetë e ka treguar këtë me fakte, gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të socializmit dhe luftës kundër armiqve të pushtetit popullor, pra, si në luftën me armë, ashtu edhe me punë.

Prandaj, në qoftë se dikush thotë që populli i Mirditës nuk e do punën, nuk punon, kjo s'është aspak reale. Ne mund të themi bile se dashuria e mirditorit për punën është një nga karakteristikat e tij dalluese, për arsye se ai në masë merr pjesë në punë të vështira. Mirditorët futen pa hezitim e pa u trembur nëpër miniera, ku i realizojnë mirë detyrat që u ngarkon vazhdimisht Partia. Kjo do të thotë se ndërgjegjja e tyre qëndron në një nivel politik mjaft të lartë dhe këtë e ka krijuar puna e palodhur e Partisë. Nga e gjithë kjo ne duhet të nxjerrim konkluzionin e rëndësishëm se organizata-bazë e Partisë e rrethit të Mirditës është e shëndoshë dhe luftarake. Jam i mendimit se këto karakteristika të popullit të Mirditës, janë një-lloj si për burrat, ashtu edhe për gratë, sepse këto janë, gjithashtu, po aq trimëresha sa shokët e tyre. Të dyja palët janë të zgjuara, kuptojnë ku është e mira dhe ku është e keqja dhe e dinë se e mira nuk bie nga qiejt, por ajo krijohet me punë e me përpjekje në rrugën e Partisë.

Në qoftë se si kudo, kemi edhe në Mirditë të meta, këto t'i kërkojmë, në radhë të parë, në mungesat që ekzistojnë në organizimin e punës nga ana e drejtuesve të Partisë dhe të pushtetit, sidomos nga ana e atyre që udhëheqin në rreth. Në industri, qoftë në fa-

brika, qoftë në miniera, vihen re disa thyerje disiplinë. Për shembull, kur punëtori shkon ditën e diel apo ndonjë ditë tjetër pushimi në familje, kthehet ca me vonesë në punë, bile, nganjëherë e humbet fare ditën e punës. Po, në përgjithësi, në qoftë se nuk gabohem, sa më tepër që kalon koha, të tilla mungesa dhe thyerje disiplinore vijnë duke u pakësuar. Kjo tregon se mirditorët kanë arritur t'i kuptojnë çdo ditë e më shumë direktivat e Partisë, të organizojnë punën më mirë, t'i kapërcejnë vështirësitë dhe të realizojnë detyrat që u janë ngarkuar. Është fakt se qoftë në Rubik, qoftë në Kurbnesh, në Spaç e kudo gjetkë në këtë rreth, direktivat e dhëna për rikonstrukcionin e fabrikave e të makinave, për ngritjen e kuadrove në përgjegjësi, për përgatitjen e specialistëve e minatorëve, si dhe për detyra të tjera, janë zbatuar me sukses dhe në kohën e duhur.

Duhet njohur se puna organizative e Partisë në Mirditë brenda në miniera e në fabrika është më e kualifikuar, kurse jashtë, mbi tokë (e kam fjalën për bujqësinë), është më pak e kualifikuar. Ata që punojnë në bujqësi nuk janë më pak të disiplinuar e të predispozuar për punë, as më pak të kualifikuar e të hovshëm sesa ata që punojnë në miniera. Mirditorët edhe më përpara janë marrë me bujqësi e me blegtori. Bagëtitë e imëta nuk kanë qenë të panjohura për ta, se ata kanë jetuar me to. Të gjitha këto tregojnë se blegtorja prej kohësh ka luajtur një rol me rëndësi në ekonominë e këtij rrethi. Atëherë, pse ju, shokë të Mirditës, keni arritur që ta neglizhoni punën në këtë sektor? Mësimi dhe edukata jonë tani, natyrisht, janë

larg asaj të baballarëve dhe të gjyshërve tuaj. Ne jemi më të përparuar dhe, megjithëse nuk kemi arritur akoma ndonjë nivel shumë të lartë shkencor, dimë më mirë nga ata. Përse keni rënë në këtë gjendje të papëlqyeshme në sektorin e blegtorisë, ju, që keni si eksperiencën e të parëve, ashtu dhe edukatën e Partisë? A e shikoni se çfarë patriotizmi ka në popull? Njerëzit tanë të thjeshtë kanë vullnet të madh, po të shikojnë që edhe udhëheqësit dhe komunistët i futen mirë punës. Populli ynë është xhevahir. Gratë, që në Mirditë përbëjnë shumicën e krahëve të punës në bujqësi, jam i bindur se në mos ua kalojnë burrave, punojnë njëlloj sa ata. Prandaj pikëpamja që ka ekzistuar te disa shokë, qofshin këta kuadro, komunistë ose të paorganizuar në Parti, sipas së cilës «nuk mund të mbahet bujqësia me gra», është një pikëpamje prapanike dhe krejt e gabuar.

Kudo në Shqipëri gruaja mban një peshë të rëndësishme në punët e bujqësisë. Në Mirditë për më tepër, ku burrat punojnë thujtë të tërë në industri e në miniera, gati krejt punët e bujqësisë i bëjnë gratë. Prandaj pikëpamja e huaj se «bujqësia me gra nuk shkon», kur ajo po e provon në jetë se është njëlloj e zonja ta udhëheqë e ta drejtojë bujqësinë sa edhe burri, shpreh nënvleftësimin e një force aq të madhe, siç është ajo e gruas dhe influencon në braktisjen e bujqësisë, gjë që pa dashje çon njëkohësisht edhe në dëmtimin e industrisë.

Unë nuk i akuzoj shokët se me pikëpamjet që kultivonin kanë dashur të atakojnë ndërtimin dhe forcimin e industrisë në Mirditë, dhe për pasojë, gjithë

ndërtimin industrial të vendit tonë, por pikëpamjet përgmuese për gruan të çojnë në përfundimin se ajo s'ka asnjë vlerë. Atëherë, vihet pyetja: Përse bëhet nga Partia gjithë kjo propagandë për të si një faktor i rëndësishëm për ndërtimin e socializmit, se ajo është e njëjlojtë me burrin dhe e zonja të punojë e të drejtojnë çfarëdo punë si edhe burri?!

Orientimi dhe puna e organizatës së Partisë të Mirditës, ku janë futur më shumë gra në radhët e Partisë, janë të drejta, përderisa ato në bujqësi përbëjnë atje shumicën e krahëve të punës. Po do të ishte, gjithashtu, e drejtë që edhe në udhëheqje të kooperativave të vihen më shumë gra. Për mendimin tim, është pa baza pikëpamja që u hodh këtui se kooperativën s'mund ta udhëheqë një grua me arsim shtatë ose tetëvjeçar. Pa nënvleftësuar rëndësinë që ka shkolla, në qoftë se një shoqe komuniste, pavarësisht se mund të ketë kryer vetëm shkollën shtatëvjeçare, është energjike dhe e zonja si organizatore, unë do të preferoja më shumë këtë, sesa një shok komunist me të njëjtin nivel, sepse shumica në kooperativat e Mirditës janë gra. Komunistët duhet ta kuptojnë drejt vijën e Partisë, të mos jenë njerëz me pikëpamje të mykura që të pëshpëritin pa vend andej-këtej: «More, po si u katandisëm ne të na komandojnë gratë!». Përkundrazi ata ta kenë për nder që bujqësinë e udhëheqin gratë, se në fakt në Mirditë thuhet se ato kanë mbetur në fshat, jo se burrat (që jetojnë e punojnë në kooperativa) rrinë duarlidhur, por për faktin se shumica e tyre janë hedhur në miniera, nga nxjerrin për atdheun minerale nga më të vlef-



shmet. Në Mirditë pra, burri është zot i punës poshtë, nën tokë, dhe kjo i përshtatet edhe konstruktit të tij fizik, mbasi atje gruaja nuk punon dot, zotësinë e saj kjo e tregon mbi tokë.

Me këto nuk dua të them se ndonjë shok, organizator i mirë, energjik dhe që e kupton mirë vijën e Partisë, të mos jetë kryetar kooperative. Të gjithë jemi dakord që në udhëheqje të ketë kudo edhe burra, edhe gra. Ju, shokë të Mirditës, duhet të ecni kurdoherë me kujdes për sa i përket punës me kuadrot. E them këtë se atje është bërë një politikë e gabuar dhe këtë Partia nuk e lejon jo vetëm te ju, po as kurrkund, në asnjë rreth. Çështjen e kam që të jeni shumë të kujdesshëm e të mos ndodhë më si gjer tani që çdo sekretar i ri që vjen aty, me dashje ose pa dashje, me qëllim ose pa qëllim, duke mos i studiuar mirë, ose duke i studiuar përciptazi situatat, punën e fillon me ndërrimin e kuadrove, sidomos të kryetarëve të kooperativave. Është e mirë kjo punë, shokë? Jo, nuk është aspak e mirë të ndërrohen njerëzit shpesh. Vetëm kur të jeni të bindur se kuadrit i keni dhënë gjithë ndihmën e nevojshme dhe shihni se megjithatë ai nuk po e çon punën përpara, atëherë duhet zëvendësuar. Por kur në kooperativë nuk veni për të dhënë ndihmën e duhur dhe kuadrot i lëvizni pa bërë përpjekjet e nevojshme për t'i ndihmuar, pa i instruktuar mirë dhe qartë si të punojnë, mua më duket se një gjë e tillë nuk ndreq as kooperativën, as fabrikën, as minierën, as pushtetin, as organizatën-bazë, përkundrazi, një praktikë e tillë e dobëson punën kudo.

Një sekretar partie, në rast se është njeri i mirë,

i aftë dhe i sakrificës, organizata nuk e lë pa zgjedhur, ajo e do dhe, po të jetë nevoja, e mban tërë jetën në udhëheqje. Edhe po të rekomandohet nga lart, nga Komiteti Qendror, sipas nomenklaturës, për t'u zgjedhur një kuadër si sekretar i komitetit të Partisë të rrethit, konferenca e Partisë në rreth do të zgjedhë atë që ka dhënë prova, që e ka njohur në punë dhe e do. Në qoftë se nga rrethi ndonjëri rekomandohet të shkarkohet si sekretar organizate-bazë, kësaj duhet t'i thuhet një për një arsytet, për të cilat duhet të bindet, ndryshe, ajo ka të drejtë të mos e pranojë rekomandimin dhe të mbajë si sekretar atë që ka pasur më parë, kur e do. Ka ndonjë të keqe për Partinë në këtë rast? Aspak! Një gjë e tillë është jashtëzakonisht e shëndoshë dhe në rrugë partie. Ata që i kryejnë mirë detyrat, pra, nuk duhen lëvizur vend e pa vend, siç ka ndodhur te ju, në Mirditë, që brigadierët i ndërroni njëri pas tjetrit, si pa gjë të keq. Po pse ndodh kështu? Sepse dikush hiqet për hatër të filanit, ndonjëri pse nuk i pëlqen kryetarit, tjetri se nuk i pëlqen sekretarit të organizatës-bazë; një grua hiqet sepse nuk e lejon burri të jetë brigadiere; për ndonjë grua tjetër dikush i shpif vjehrrit diçka të paqenë e shumë gjëra të tjera të këtij lloji.

Çështja e pjesëmarrjes së gruas në punët bujqësore në rrethin e Mirditës ka një rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj organizata-bazë e Partisë atje duhet ta mbështetë atë jo vetëm politikisht e ideologjikisht, por të kujdeset për t'i krijuar gradualisht të gjitha kushtet e mundshme që t'ia lehtësojë punët. Edhe ekipi i Ministrisë së Bujqësisë që ka ardhur në

rrethin tuaj e ka për detyrë të mendojë e t'ju ndihmojë në këtë drejtim. Vetëm kini parasysh se nuk do të jenë organet qendrore të Partisë dhe të shtetit që do t'ju zgjidhin konkretisht problemet që dalin lidhur me lehtësimin e punës së gruas.

Natyrisht, Partia dhe shteti do t'ju ndihmojnë, po ama është përfaqe të zezë që të keni vetëm tri çerdhe në të gjitha kooperativat e rrethit. Më falni që po ju them, por kjo gjendje që varet kryesisht nga ju, nuk ju nderon aspak, shokë. Ca më tepër nuk duhet të ishte e tillë gjendja po të kemi parasysh, veç të tjerave, edhe vështirësitë e mëdha të terrenit të Mirditës. Sekretarja e organizatës-bazë të Partisë të Kooperativës së Bashkuar të Oroshit, shoqja Marta Lleshi, na tha këtu se ka gra në këtë kooperativë që e kanë punën tri orë larg. Mirëpo ato kanë kalamanë në shtëpi që u qajnë, disa prej tyre kanë vjehrrin apo vjehrrën që ua mbajnë, po ka dhe të tjera që s'kanë. Gjer sa burrat mirditorë nga dy e tre në familje punojnë në miniera, kuptohet sa e domosdoshme është pjesëmarrja e grave të tyre në punët bujqësore. Mirëpo shumë nga këto ku t'i lënë fëmijët? Ku është këtu solidariteti kooperativist për ngritjen e çerdheve? Mua më duket se jo një, po dy çerdhe mund e duhet të ngrihen në çdo kooperativë të Mirditës, me atë shpërndarje të shtëpive që kanë atje fshatrat. Ky është një problem jo vetëm thjesht shoqëror, por dhe ekonomik me rëndësi të veçantë, pse moszgjidhja e tij pengon pjesëmarrjen si duhet të gruas në prodhim, e cila është faktori kryesor i mbarëvajtjes së bujqësisë sonë. Prandaj në këtë drejtim juve ju bie detyra të

merrni iniciativën për ta zgjidhur këtë çështje<sup>1</sup>. Po të duhet t'ju ndihmojë diçka shteti, edhe kjo do të realizohet, por kryesorja është që ju të mobilizoheni për ta zgjidhur gjer në fund këtë problem në dobi të bujqësisë.

Ka disa gjëra që ndoshta nuk figurojnë në statutin e kooperativës bujqësore apo në rregulloren mbi shpërblimin e punës së kooperativistëve, por vendimet e kolektivit, të bazuara në logjikën e fortë të Partisë, u japin zgjidhje të drejtë. Ju, shoqja Martë [Lleshi], si sekretare partie duhet të mendoni konkretisht për zgjidhjen e problemit që ngritët lidhur me punën e grave në bujqësi dhe për këtë mund të shkoni edhe në komitetin ekzekutiv të rrethit e t'u thoni: «Pa na e rregulloni këtë punë, se kështu s'dilet. Nuk duhet të shpërblehen njëlloj si personi që ngrihet në orën katër të mëngjesit dhe ai që ngrihet në orën shtatë». Është kështu apo jo? Kjo duhet zgjidhur se ka kooperativistë që ankohen me të drejtë për punën që bëjnë dhe për shpërblimin që marrin. Normat e punës nuk mund të jenë njëlloj si atëherë kur kooperativistja duhet të bëjë tri orë rrugë për të vajtur në arë dhe kur ajo e ka punën te pragu i shtëpisë. Aq më keq kur ajo për shkak të terrenit të thyer dhe mungesës së kafshëve, në kundërshtim me orientimet e Partisë, është ngarkuar me bar për të siguruar ushqimin e bagëtive. Pra, është e domosdoshme të mendohet se si duhet të jetë norma e një gruaje që punon në këto kushte të vësh-

---

1. Më 1984 në rrethin e Mirditës kishte 50 çerdhe, nga të cilat 46 në kooperativat bujqësore.

tira dhe norma e një tjetre që e ka punën më të lehtë dhe më afër. Pse nuk bëtë një mbledhje të përgjithshme të anëtarëve të kooperativës, që është organi më i lartë i ekonomisë kolektive socialiste, dhe atje ta shtronit mënyrën e rregullimit të kësaj çështjeje, duke arsyetuar, siç e thamë më lart?! Në bazë të këtyre argumenteve, si dhe gjithë të tjerave që i përmendëm kur kritikuaam shokët e rrethit tuaj për organizimin e dobët të punës në kooperativa, për mosplotësimin e ditëve të punës, për trajtimin jo të drejtë të çështjeve, për pagesat etj. ju duhet të ndërtoni tërë punën tuaj në bazë. A ju ka bërë kërkesa dhe sugjerime populli se si duhet t'i shikoni detyrat, që për këtë ose për atë problem të mos veprohet kështu, po ndryshe, me qëllim që të rriten të ardhurat? A i lejoni ju kooperativistët që të shprehin mendimet lirisht? Po të shtrohej problemi kështu, ata do të thoshin se ajo mënyrë shpërblimi nuk është e drejtë, prandaj duhet rregulluar. Në qoftë se kryetari i kooperativës thotë që këto kritere nuk përfshihen në normën e caktuar, atëherë kooperativistët, duke u mbështetur në kushtet konkrete, vendosin vetë shpërblimin për mbledhjen dhe për transportimin e barit, sepse kooperativa është e tyre, prodhimi, gjithashtu. Kështu, për shembull, për punën që bën gjatë ditës ajo brigadë, e cila kryen një proces më të vështirë, i caktohen 2 ditë-punë, që paguhen nga të ardhurat e përbashkëta të kooperativistëve. Por kuptohet se që të mos ulen të ardhurat si kooperativë duhet punuar me forca të dyfishuara që të realizohen dy, tri e pesë norma. Mbledhja e përgjithshme e kooperativistëve doemos duhet t'ua shpër-

blejë drejt punën shoqëve, që, siç thotë populli, «u bie bretku në punë».

Në rast se për të lehtësuar punën e grave lind nevoja t'i jepet bujqësisë një ndihmë në mekanizma, edhe kjo duhet të bëhet, veç të studiohet konkretisht një për një në çdo rreth natyra e terrenit të çdo kooperative, shokë. Prandaj ia thoni plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit se nuk është aspak serioze dhe në vijën e Partisë qëndrimi i mbajtur gjertani në lidhje me ndihmën e pamjaftueshme që i është dhënë gruas, roli i së cilës në shoqëri dhe sidomos në bujqësi, si kudo, edhe te ju, është i madh.

Një problem tjetër që doja të prekja ka të bëjë me ngarkesën e gruas. Partia, vazhdimisht, ka këshilluar që gratë të mos ngarkohen. Mirëpo kooperativa e Oroshit, siç na tha shoqja Martë, ka edhe sektorë të vështirë, ku kafshët nuk shkojnë dot. Një rrugë, ose një vijë sa për të kaluar mushka atje mund të hapet, po kooperativës i mungojnë kafshët e ngarkesës. Megjithatë, në këto kushte nuk mendon njeri se si do të zgjidhet ky problem. Neve, shokë, na ka mbetur në mendje lopa dhe as mendohet si duhet që kooperativat të kenë edhe kafshë për ngarkesë dhe t'u vihet detyrë që të kujdesen për t'i shtuar ato. Gjersa kryesia e kooperativës ose rrethi e dinë gjendjen, që disa nga tokat e kësaj kooperative janë me orë të tëra larg dhe ca më keq akoma atje s'ka as rrugë për kafshë, ata duhet të mendohen për këtë problem, pse gratë që caktohen për të punuar në sektorë të tillë pune detyrohen të ngarkohen rëndë sa u këputet mesi, gjë që u shkakton komplikacione të mëdha fizike. Prandaj, në

vend që rrethi t'i kërkojë shtetit kredi për të blerë, ta zëmë, 200 lopë, le të blejë ca krerë më pak, që pjesën tjetër të kredisë ta përdorë për të blerë mushka për ngarkesë, si dhe disa pela për riprodhim. Ka, pra, një sërë problemesh për zgjidhjen e të cilave duhet menduar me kohë e sipas kushteve që paraqiten:

Disa pikëpamje jo të drejta që ekzistojnë në kuadrot, e sidomos në kuadrot udhëheqës në Mirditë, medoemos dhe sa më parë duhet t'i likuidoni, se janë të gabuara. Po të mos i kenë kuadrot të tilla pikëpamje, mendoj që ato nuk do të ekzistojnë as në popull. Ja, për shembull, thuhet sikur burrat që punojnë në miniera i pengojnë gratë të marrin pjesë në punët e kooperativës. Unë jam i bindur se nuk duhet të jetë ashtu. Minatori që punon vetë me disiplinë, që futet në thellësitë e tokës, që realizon planin, që e ndien ç'është puna, që është patriot dhe di ç'është atdheu, ç'është socializmi, nuk mund t'i thotë bashkëshortes të lidhë duart e të mos punojë në kooperativë. Por si të punojë, këtë duhet ta organizojnë organizata-bazë e Partisë dhe kryesia në kooperativë, duke i krijuar gruas lehtësitë dhe kushtet e domosdoshme për punë. Nuk ka pastaj asnjë arsye përse të mos marrë pjesë gruaja në punë, sepse shpërblimi, që ajo do të tërheqë për ditët e punës, do të rritë të ardhurat e familjes. Burri do të jetë shumë i kënaqur, kalamanët e saj do të jenë, gjithashtu, shumë të kënaqur e në radhë të parë, do të jetë ajo vetë shumë e kënaqur. Tash në vendin tonë kemi të bëjmë me gra që nuk janë të mbyllura si dikur gratë e disa krahinave; ato nuk janë as pa mend në kokë që të rrinë kot në shtëpi,

ca më tepër gratë e vajzat e Mirditës që vazhdimisht kanë punuar. Unë kam pasur rastin disa herë të takohem me vajza dhe me gra mirditore dhe kurdoherë kam mbetur i kënaqur sepse ato flitnin fare lirisht me mua dhe jepnin mendime të drejta. Gra dhe vajza të tilla janë në gjendje të luftojnë dhe luftojnë me vendosmëri për vijën e Partisë dhe për të drejtat e tyre, por, shokë, ato duhen organizuar, sepse pikërisht mungesa e organizimit ka shkaktuar këto vitet e fundit këtë gjendje të rëndë në bujqësi në rrethin tuaj.

Të them të drejtën, si të gjithë shokët edhe unë u alarmova kur mësova për situatën e krijuar në Mirditë. Drejt e tha shoku Adil se edhe shokët e Qeverisë, të Ministrisë së Bujqësisë etj. kanë gabimet e tyre që nuk kanë shkuar sa duhet në Mirditë dhe nuk e kanë zbuluar dot më parë këtë situatë të vështirë. Ata nuk kanë marrë masa dhe nuk kanë dhënë ndihmën e nevojshme, me një fjalë, nuk kanë bërë kontrollin e duhur etj. Po kështu kanë faj edhe shokët e aparatit të Komitetit Qendror, të cilët kanë ardhur në Mirditë, kanë marrë kontakt me njerëzit, por më shumë janë marrë me ju, shokët kryesorë, që ua keni lustruar gjendjen dhe këta ju kanë transmetuar direktivat shabllon, pa u hyrë thellë problemeve, pa gërmuar një çikë më tepër të njiheshin me hallet dhe me problemet që preokuponin Partinë dhe popullin dhe të na vinin me kohë në dijeni për gjendjen reale të problemeve. Këtë ata nuk e kanë bërë sa duhet. Po të na kishin sinjalizuar, s'kishte pse të binim nga qiejt, kur mësuam për ato dobësi që janë vërtetuar në Parti dhe në pushtet në rrethin tuaj.



Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit është një komunist i vjetër, që ka luftuar, e ka dashur, e do dhe nuk e tradhton kurrë Partinë. Por ai ka bërë edhe gabime që duhet t'ia vini mirë në dukje. Unë mund t'ia them edhe vetë kur të kem rastin ta takoj dhe me zemër të hapët do ta këshilloj që t'i njohë ato ndershmërisht. Me gjithë gabimet që ka bërë, ai duhet të ketë parasysh se Partia nuk e hedh poshtë atë, pse ai është vrarë me armiqtë dhe s'bëhet kurrë me ta. Në goftë se ai u ka bërë lëshime të tjerëve, këto gabime i ka bërë nga karakteri i tij i butë, prandaj i thoni, gjithashtu, atij se Partia nuk e akuzon për grupazh.

Gabime ka bërë edhe ish-sekretari i parë, i cili duhet t'i shikonte më qartë këto shfaqje e qëndrime, të ishte më parimor e më i rreptë në kërkimin e llogarisë, se ishte udhëheqësi i byrosë së Komitetit të Partisë dhe i dëgjohej fjala. Por fakti është se ky është treguar shumë i butë dhe liberal ndaj të metave, fajeve e gabimeve që bënin shokët e tjerë. Disa nga anëtarët e byrosë e të plenumit të Komitetit të Partisë kanë ngritur herë pas here zërin, kanë bërë edhe kritika, por, ish-sekretari i parë, megjithëse nuk i ka mbytur, prapëseprapë ka bërë lëshime. Mirëpo të tilla qëndrime i kushtojnë shtrenjtë Partisë.

Ti shok, si sekretar i parë që ishe, duhet të kishe shkuar më tepër në bazë për ta njohur sa më mirë atë dhe nuk duhet të kufizoheshe vetëm në disa probleme siç është ai i pranimeve në Parti apo në seminarin për studimin e Historisë së Partisë. Me këtë rast, ti, ndoshta ke pyetur edhe për problemet e kooperativës, po s'ke qëndruar atje edhe një javë të tërë, po

të ishte nevoja, që të bisedoje me fshatarët se çfarë hallesh e nevojash kishin, si duhej rregulluar kjo ose ajo punë etj., etj.

Organizata-bazë e Partisë në Orosh, për shembull, gjatë 2 vjetëve, sipas orientimeve të qarta që janë dhënë, mund të ketë pranuar në Parti, ta zëmë 7 veta, nga këta 4 shoqe dhe 3 shokë, të cilët i ka përgatitur me kujdes. Po edhe sikur të jetë bërë ndonjë gabim në këtë drejtim, ju mund ta kapnit atë se pranimet ju vijjnë për aprovim edhe në Komitetin e Partisë. Cilët persona pranoi në Parti organizata e Oroshit? Pranoi gra të mira, punëtoare, të ndershme, me origjinë të varfër dhe që nuk kanë asnjë njollë. Me kaq nuk merr fund kjo çështje, por ju duhej të shikonit se si jetojnë e punojnë komunistët dhe masat e popullit. Kjo është kryesorja. Të shkonit në shtëpitë e fshatarëve, që të njiheshit nga afër me preokupacionet e tyre, pa shikuar vetëm anën formale e të jashtme të çështjeve, siç keni bërë. Kur të shikonin fshatarët sekretarin e parë bashkë me sekretaren e organizatës-bazë të Partisë, atëherë do të bëheshin shumë herë më të fortë.

Pas zbulimit të kësaj gjendjeje në organizatën-bazë të Partisë e në organet e pushtetit të rrethit të Mirditës, unë mora andej një letër anonime, ku thuhej se në këtë rreth qenka krijuar një taraf, një grupazh me njerëz të Komitetit të Partisë. Sipas letrës, njerëzit e Partisë paskan organizuar një fraksion apo grupazh, për të rrëzuar kryetarin e komitetit ekzekutiv. E shikoni, shokë, ç'problem i krijohet Partisë? S'ka dyshim se ai që ka bërë letrën është njeri i sëmurë nga koka, është një intrigant që kujton se do ta gënjejë Partinë

duke dërguar një letër anonime. Ai është njëkohësisht edhe i frikshëm, por që përpiqet të futë spica në Parti. Mirëpo këto nuk i kalojnë Partisë. Partia vepron kurdoherë me urtësi, ajo nuk tregohet e vrazhdë me anëtarët e saj dhe me popullin, e tillë ajo sillet vetëm kundër armiqve, kurse ndaj shokëve vepron me takt e durim të madh. Partia përpiqet t'i shpëtojë të tërë e jo më të mos shpëtojë shokët që kanë luftuar për Partinë dhe për popullin në të kaluarën, që luftojnë tashti dhe që do të luftojnë edhe nesër, derisa të vdesin. Por ndodh që njerëzit bëjnë edhe gabime, të rënda ose më pak të rënda. Partia përpiqet t'i shërojë të gjithë. Po e shihni ç'bën armiku? Ai punon dhe pret të krijohen të tilla situata. Prandaj kini kujdes, shokë, jini vigjilentë! Çështja është që të keqen ta zbulojmë në kohë dhe të mos e lëmë të trashet.

Shumë mirë e tha shoku Mark Dudi<sup>1</sup>, se si ca kohë përpara ai vetë pati bërë një lëshim, duke lejuar të pranohej në plenum një shok që kishte masë ndëshkimore dhe nuk e meritonte të zgjidhej. Pastaj meqë bëri një herë lëshim, do të bënte medoemos më pas edhe një tjetër, bile më të madh. Por është pozitive se ai e kuptoi gabimin. Edhe tashti ai e gjykon, gjithashtu, drejt çështjen për këtë element dhe thotë që është aktiv, i zoti, por i mungon partishmëria. Nga ky rast ai nxjerr mësimin se njerëzit duhet t'i mësojmë që të kenë kurdoherë partishmëri. Ky njeri, që është futur në Parti pa e merituar, duke mos pasur partishmëri,

---

1. Në atë kohë ishte zgjedhur sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Mirditës.

nuk vlen për anëtar partie. Ai mund të jetë me kapacitet, po ndoshta është dallaveraxhi. Prandaj kur pranojmë një njeri në Parti, në radhë të parë, të kërkojmë tek ai partishmërinë sepse kjo të çon kurdoherë në rrugë të drejtë. Çdo çështje në Parti duhet parë, pra, me partishmëri, edhe kur komunisti gabon, edhe kur nuk gabon. Kuadrot, komunistët dhe të gjithë njerëzit tanë duhet të flasin, ta ngrenë zërin dhe të ngulin këmbë, sepse kështu mbrohen Partia dhe populli e jo duke thënë «amin» për çdo gjë që shtrohet nga ndonjëri me më shumë përgjegjësi, ta thuash atë që ndien se kështu të duan më shumë Partia dhe populli. Të gjithë kështu duhet të bëjnë. Kritika do të jetë tërë jetën një armë e shëndoshë në duart e Partisë dhe të popullit për ndreqjen e të metave në punë. Edhe në komunizëm përsëri do të ketë kritikë. Megjithëse në atë sistem shoqëror njerëzit do të jenë më të kulturuar e shumë më të edukuar se tash, prapë mund të bëjnë ndonjë gabim. Për shembull, kur të vejë ndonjëri në dyqan dhe të shikojë shumë orë të bukura, megjithëse i duhet një, do të kërkojë dy. Në këtë rast këtij njeriu shoqëria do t'i bëjë një vërejtje, duke i thënë: «Pse more dy orë kur vetëm një e tillë të duhet?». Kjo vërejtje, edhe atëherë kur çdo gjë do të gjendet me bollëk, do të jetë kritikë në adresë të atij që lakmoi të ketë dy orë të bukura e jo më tani. Veçse duhet pasur parasysh që kritika të jetë gjithmonë parimore, e drejtë, konstruktive dhe e bazuar.

Kur gabon, komunisti duhet të bëjë autokritikë me zemër të hapët. Atyre që e kritikojnë për ta ndrequr, t'ua dijë për të mirë, të mos ua mbajë kritikën «vath

në vesh», por t'u jetë mirënjohës. Në radhë të parë, t'ia dijë Partisë që i mëson anëtarët e saj të jenë parimorë e të mos bëjnë lëshime.

Ka te ju edhe një shfaqje tjetër që duhet ta kritikoni në plenum dhe në organizatat-bazë të Partisë, siç është mania e bujës, e mburrjes për të dalë me shifra sa më të mëdha edhe kur këto s'janë ekzakte. Kjo nuk është një karakteristikë vetëm e rrethit tuaj. Ka edhe në rrethe të tjera shokë që bëjnë gjëra të tilla, bile nxitin t'u dërgojnë korrespondenca me këtë frymë edhe organeve qendrore të shtypit për t'i botuar. Kur kam lexuar një mbrëmje shkrimin e një korrespondenti të tillë, jam çuditur. Në njërin nga këto shkrime thuhej se «po të doni të shikoni një kooperativë model, ku çdo gjë, që nga organizimi, financa e në të tëra drejtimet e tjera është në rregull, shkoni në Kutal të Përmetit». Sipas korrespondentit, çdo porosi që ka dhënë Komiteti Qendror i Partisë me letrën e vet, atje qenkësh realizuar me kohë. Artikulli, që është shkruar në dy kolona me gjithfarë mburrjesh, më në fund, vë në dukje shkurtimisht se megjithatë, në këtë kooperativë ka edhe të meta «të vogla», të tilla si ajo që çdo ditë 60 veta nuk dalin në punë (!) etj. Të tilla shkrime, që vihen re në disa raste, na sjellin dëme të mëdha, shokë, prandaj në organizatat-bazë t'u biem me «hithra fytyrës» atyre që i shkruajnë, duke u nisur nga këto prirje të huaja.

Duhet të luftoni, gjithashtu, lënien e zbatimit të vendimeve dhe të direktivave spontaneitetit, siç keni bërë ju, shokë të byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Mirditës. Ju duhet t'i kishit luftuar pikëpamjet

e bajraktarizmit të kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit, të cilat janë dukur herë pas here në punën e tij, gjë që nuk mund ta themi për shokun Mark Dudi. Ky ka të meta të tjera, siç është butësia e tij në kërkesën e llogarisë, prandaj në të ardhmen t'u kërkojë më shumë llogari vartësve. Veç Marku nuk ka të metat e bajraktarizmit, ai është njeri i thjeshtë, jofodull dhe shumë mirë që është kështu, të tillë e do atë Partia. Po në kërkimin e llogarisë të jetë më i ashpër, të jetë edhe i rreptë kur është nevoja dhe llogari të kërkojë fort.

Partia na mëson të jemi kurdoherë trima, jo vetëm kundër armikut, po edhe kundër të gjitha shfaqjeve të huaja dhe gabimeve, si dhe atyre që i bëjnë ato. Dhe të kemi parasysh se kjo nuk është një punë e lehtë. Kur bën gabim ndonjëri, ai duhet të kritikohet në rrugë partie. Po kritikove, je trim, po nuk kritikove, s'je trim, përkundrazi tregon se ke akoma në veten tënde një kompleks mbeturinash që të pengojnë të kritikosh me guxim, cilindo që ka gabuar, qoftë ky shoku yt, sekretari i Partisë, ose kryetari i komitetit ekzekutiv, ministri apo kushdo qoftë tjetër, sepse përpara Partisë dhe direktivave që lëshon ajo, të tërë jemi njëjloj.

Ne drejtuesit Partia dhe populli na kanë zgjedhur për të kryer detyrat. Ai që nuk i kryen ato duhet të kritikohet. Po nga kush? Në radhë të parë nga shokët që ka afër, pastaj nga të tjerët më lart. Në qoftë se dikush, me gjithë ndihmën e dhënë, me gjithë këshillat dhe kritikën që i janë bërë, nuk i ndreq gabimet, atëherë detyrimisht duhen marrë masa që në vend të

tij të vihet një tjetër. Kjo është rruga e Partisë dhe në këtë çështje, sikurse në çdo tjetër, duhet të jemi trima.

Shokët, mendoj unë, duke filluar nga ish-sekretari i parë nuk mund të themi se nuk u kanë bërë fare kritika atyre që kanë gabuar. Po këto ama kanë qenë të buta, kanë qenë si të thuash si njëfarë «spërkatje me ujë trëndafili», në vend që atyre t'u kërkohej fort llogari për ato qëndrime që mbante njëri a tjetri, për ato marrëdhënie jo në rrugë partie, duke shkuar nga një tryezë në tjetren dhe kohë e pa kohë. Të kuptohemi, punëtori i Partisë, apo nëpunësi i pushtetit popullor edhe në një lokal do të vejë; do të ketë rast që edhe të pijë një gotë për shëndetin e njërit apo të tjetrit, veç jo në kohën e punës dhe për t'u dehur. Ai do të vejë edhe nëpër kooperativa, po jo të bredhë tërë ditën poshtë e lart, pa një qëllim. Pas punës, mund të vejë ta zëmë, një herë në javë, në klub për t'u takuar e për të bërë një bisedë me një shok, grup shokësh o punonjësish, me të cilët ka nevojë të konsultohet për një problem. Por, në qoftë se shihet që një punëtor partie apo i pushtetit popullor nuk sillet korrekt e që vjen kot vërdallë nëpër lokalet publike, ai duhet të thirret e të japë llogari për sjelljet e tij jo të përshtatshme.

Edhe kur jepen shifra, të kërkohet llogari kur këto nuk janë të sakta, të qortohet rreptë ai që i nxjerr pa kujdes dhe të paralajmërohet që të mos e përsëritë më pakujdesinë në dhënien e tyre. Në raste të tilla, kur këto veprime kryhen qoftë edhe nga ana e kryetarit të komitetit ekzekutiv, mund të mblidhet

komiteti ekzekutiv e deri këshilli popullor i rrethit, të cilit t'i raportohet se si dhe kush e ka mashtruar Partinë në rreth, qoftë ky kryetar i komitetit. Një qëndrim i tillë i bën shumë mirë vetë kryetarit, se nuk e lë t'i përsëritë më ato gabime. I tillë duhet të jetë në përgjithësi qëndrimi që duhet mbajtur ndaj gabimeve të shokëve dhe të kujtdo dhe jo të biem në familjaritet, duke u nisur nga pikëpamja e gabuar se meqenëse jemi shokë e vëllezër, t'i bëjmë lëshime njëri-tjetrit. Një gjë të tillë kurrë s'duhet ta lejojë Partia. Jo, shokë, para Partisë dhe popullit jemi të tërë njëloj. Populli na do, na ka zgjedhur, na ka dhënë besim, po kur gabojmë, sipas shkallës së gabimit, të lëvojë kritika, e cila të jetë kurdoherë e drejtë, parimore.

Qëndrimi oportunist ndaj gabimeve të shokëve është i keq, është i dëmshëm. Te ju ai ka kaluar vetvetiu nga shoqëria në punë, në zbatimin jo të drejtë të direktivave. Në një ambient oportunist krijohet një situatë jo e shëndoshë midis shokëve, ku as më kritikon, as të kritikoj, as më kërkon llogari, as të kërkoj llogari; unë bëj ç'të dua e ti bëj ç'të duash dhe festen e vëmë mbi sy. Mirëpo punën e merr lumi. Duke shkuar një herë në mot në kooperativë, duke u mjaftuar dhe duke u kënaqur vetëm me ndonjë fjalë apo këshillë, pa u hyrë thellë problemeve, pa luftuar me rreptësi të metat e gabimet dhe pa marrë masat për t'i ndrequr ato, punët nuk do të na venë mbarë dhe atëherë «Ku ishe? — Hiçgjëkundi!». Jo, shokë, problemet nuk zgjidhen kështu, po në rrugën që na mëson Partia.

Çështja bëhet akoma më e rëndë, kur, siç ka ndo-



dhur te ju, ekziston tendenca e fshehjes së të metave. Të metat e gabimet nuk duhen fshehur kurrë, as kur nuk realizohen planet e detyrat. Kjo çështje nuk duhet parë në frymën subjektiviste, duke menduar që këtë të metë të mos e them se është e lidhur me mua, pse po ta them, ajo më ul. Të ulet apo nuk të ulet personaliteti, këto janë çështje partie, prandaj për të mirën e saj e ke detyrë ta thuash. Edhe kur ka diçka që ndihmon të të ngrihet personaliteti, natyrisht, në këtë rast ca me modesti, prapë edhe atë thuaje, pse i shërben çështjes, po kurdoherë në rrugën e Partisë.

Gjersa këto mësimet të Partisë i ka ditur ish-sekretari i parë si është e mundur që ai këshillonte Komitetin Ekzekutiv dhe kryetarin e tij të mos flitnin përpara Këshillit Popullor të Rrethit për të metat që ekzistonin? Po është kështu, do të thotë se flasim në vesh të shurdhër. Ne kurdoherë kemi folur që të japim llogari përpara popullit, t'ia themi atij të tëra. Por shokët e Mirditës na e lidhkan këtë me punimet e Kuvendit Popullor. Së pari, nuk duhet ta barazojmë këshillin popullor të rrethit me Kuvendin Popullor. Së dyti, dihet se në raportet që paraqit para Kuvendit Popullor ministri i Financave, kryetari i Komisionit të Planit, ose Kryeministri, kur raporton në emër të Qeverisë, ka edhe kritika, po, natyrisht, ato nuk mund të bëhen në këtë organ të lartë si në organizatën-bazë, si në komitetin e Partisë, apo në këshillin popullor. Atëherë përse një sekretar partie e bën një rekomandim të tillë? Ai e di që ka përgjegjësi për gjithë këto të meta që janë vërtetuar në rreth, atëherë përse i fsheh që ato të mos dilnin në pjacë? Është me rëndësi

parimore që këtë çështje, në radhë të parë, ta kuptoni drejt dhe të bëni autokritikë.

Ne mendojmë se ajo që ka ndodhur në rrethin e Mirditës, është episod i një pune të dobët të udhëheqjes së rrethit, ku disa persona, veçanërisht dy prej tyre, ish-sekretari i parë i Komitetit të Partisë dhe kryetari i Komitetit Ekzekutiv me disa anëtarë të tjerë të byrosë dhe të Komitetit Ekzekutiv, kanë lejuar të bëhen gabime në ekonomi, sidomos në bujqësi, të shfaqen pikëpamje të gabuara si ato që «nuk mbahet bujqësia me gra», «ne jemi rreth industrial, prandaj bujqësia s'çon kandar» etj. Të tilla pikëpamje kanë ndikuar të krijohen situata të vështira në unitetin e mendimit dhe të veprimtimit të organizatës-bazë të Partisë dhe të pushtetit në rreth, sidomos në byro dhe në Komitetin Ekzekutiv. Si rrjedhim, edhe marrëdhëniet e byrosë së Komitetit të Partisë me Komitetin Ekzekutiv nuk kanë qenë të shëndosha, të hapëta, të sigjerta. Natyrisht, këto, deri në njëfarë shkalle, janë reflektuar edhe në bazë. Portashmë këto dobësi u panë, u kritikuan dhe do të kritikohen akoma nga ana juaj në organizatat-bazë. Mbetet vetëm që të merrni masa për t'i ndrequr këto të meta në ekonomi dhe veçanërisht në bujqësi, me qëllim që të kapërcehet sa më shpejt kjo gjendje e vështirë.

Bujqësia nuk mund të vihet në rrugë, duke shpresuar vetëm në ndihmën që do t'u jepet nga lart. Pushteti do t'ju japë ndihmë, po jo për çdo gjë. E para e punës sepse kjo varet nga mundësitë që ka ai. Prandaj juve vetë ju bie barra të organizoni sa më mirë punën në rreth dhe të dini të përfitonit edhe nga ndihma që

do t'ju vijë. Por, që të ngrihen rendimentet e grurit e të misrit, që të rritet e të përmirësohet blegtoria, që të bëhen me shumicë frutat e zarzavatet etj. kryesorja është që të mendoni e të punoni më mirë vetë ju, të forcohet kudo puna organizative në kooperativa, në të gjithë gamën që përmendet në Letrën e Komitetit Qendror. Për sa u përket ndihmave që do t'ju jepen si rreth, fjala vjen disa traktorë, këta do t'ju dërgohen, po dijeni, jo aq sa keni kërkuar, sepse jo vetëm që nuk kemi aq shumë, por as vendi nuk ju lejon ku t'i shfrytëzoni. Mos mendoni, gjithashtu, që duke i kërkuar Partisë pleh kimik, do të mbushet tërë Mirdita apo Kukësi me të pa asnjë kufizim. Do të dërgohet pleh si kudo edhe në Mirditë, edhe në Kukës, edhe në Pukë, shokë, po aq sa parashikon plani, se nuk kemi aq shumë sa mund të kërkohet. Edhe me rrethet e tjera po kështu veprojmë, prandaj çështjet duhen parë realisht. Në këto kushte, me kaq pleh sa disponojmë, duke bërë edhe më shumë përpjekje se gjer tani në drejtime të tjera, keni mundësi të merrni, të themi, 25 kuintalë misër për hektar, nga 20 që keni marrë gjer tani? Atëherë ia filloni punës me të gjitha forcat, shokë, pse jo vetëm që pleh më shumë nuk do t'ju jepet, por mund të ndodhë që t'ju jepet diçka më pak në rast se shohim, për shembull, që në një rreth, ku tash merren 50 kuintalë misër për hektar, duke i dhënë ca pleh më shumë, janë mundësitë të realizohen 90 kuintalë për hektar. Jemi të bindur se në këtë rast asnjë nuk do të ketë kundërshtim, që plehu të dërgohet më parë atje ku mund të merren 90 kuintalë drithë për hektar, sepse

e dinë që shteti këtë prodhim të tepërt do ta vërë në depo për një kohë të keqe, ose, po të na ndodhë një fatkeqësi natyrore dhe të mbcten pa bukë, Partia atëherë do t'u japë drithë. Kështu duhen menduar këto çështje, prandaj të bëni të gjitha përpjekjet vetë, në radhë të parë, pa edhe Partia e Qeveria do t'ju ndihmojnë në këtë drejtim. Rëndësi ka që çështjet të shtrohen drejt e të luftohen pikëpamjet për të kërkuar çdo gjë nga shteti. Të luftohet, gjithashtu, ajo prirje që është dukur në disa kooperativa të rrethit tuaj për të mos i kthyer kreditë në rregull shtetit.

Duhet kuptuar drejt nga të gjithë që kreditë që jep shteti të kthehen në kohë, pse këto ai i jep që të zhvillohet ekonomia. Shteti prapë do të vazhdojë të japë kredi, por çdo kooperativë duhet të zotohet dhe të punojë që këto t'i shfrytëzojë drejt dhe shtetit t'ia kthejë ato në afat. Kjo do të thotë që çdo kooperativë, me kredinë që merr nga shteti, në radhë të parë, të sigurojë bukën e vet. Mirëpo disa kooperativa në Mirditë bukën nuk e sigurojnë për mungesat e dobësitë e këtij apo të atij kuadri, dhe gënjejnë veten duke ndarë kreditin e shtetit për ditë-punë, saqë qysh sot rrethi kërkon 5 mijë quintalë drithë nga Qeveria. Ky nuk është një qëndrim komunist.

Çështjen që ngriti fshatari mirditor nga Simoni, që shtetit taksat e detyrimet i laheshin menjëherë, edhe kur ekzistonin ekonomitë bujqësore individuale, unë e marr edhe nga një anë tjetër që fshatari ynë as pushtetit të tij nuk dëshiron t'i ketë borxh. Mos harroni, shokë, se ai është djegur nga borxhet në të kalua-

rën. Edhe tani, megjithëse e di mirë që pushteti është i tij, prapë ia ka frikën borxhit, pse në ndërgjegjen e tij është rrënjosur thellë denbabaden, mendimi që njeriu nuk duhet të bjerë borxh, se kujton të kaluarën kur fajdexhiu i rrëmbente tokën, shtëpinë, bagëtinë dhe çdo pasuri tjetër.

Dëshirën e fshatarit, që shtetit të mos i ketë borxh asnjë santim, ta kemi, pra, mirë parasysh. Por, që fshatarësia të mos i ketë borxh shtetit duhet punuar, duhet organizuar mirë puna dhe për këtë të këshillohemi me masat. E them këtë se disa herë nuk këshillohemi si duhet me fshatarët, për shumë gjëra ata nuk pyeten fare. Po a janë të drejta këto qëndrime? Jo, nuk janë aspak të drejta, prandaj të hiqet dorë prej tyre, se Partia nuk na mëson kështu. Ne duhet ta pyesim fshatarin për shumë gjëra, bile, për çdo gjë, pastaj tok me të të ecim përpara.

Duke e mbyllur këtë çështje, dëshiroj të shpreh edhe unë mendimin si shokët se masat e marra nga byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Mirditës dhe Qeveria janë të drejta, prandaj Sekretariati dhe ne, shokët e Byrosë Politike, që marrim pjesë në këtë mbledhje, jemi, gjithashtu, dakord me to.

Edhe një herë ju këshillojmë dhe jemi të bindur se këto që kanë ndodhur do të bëhen mësim për ju, për ne dhe për gjithë Partinë, prandaj t'i viheni punës dhe gjëra të tilla të mos përsëriten më, sidomos në kuadrot drejtues të Partisë e të pushtetit. Përveç kësaj të merren të gjitha masat e nevojshme që të metat e dobësitë që vihen re në bujqësi edhe në rrethet e tje-

ra, të zhduken, me qëllim që sa më parë të ecë përpara edhe ky sektor, ashtu siç po ecën industria.

*Botuar për herë të parë  
me shkurtime në librin:  
Enver Hoxha, «Mbi problemin e gruas», Tiranë,  
1973, f. 422*

*Botohet i plotë sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverbali  
i mbledhjes së Sekretariatit të  
KQ të PPSH, që gjendet në  
AQP*

# DISA ASPEKTE TË PUNËS SË ORGANIZATAVE TË BRPSH PËR PËRSOSJEN E FIGURËS MORALE TË RINISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

24 mars 1971

Nuk dua të përsëris problemet e rëndësishme që ngritën shokët si dhe mendimet që u shfaqën rreth tyre, me të cilat, në përgjithësi, jam dakord edhe unë. Vetëm dëshiroj të theksoj edhe një herë, se kur shqyrtojmë probleme të ndryshme që na dalin në lëmin e edukimit të brezit të ri, qoftë edhe kur diskutojmë për shfaqje negative që vërehen në ndonjë rast, duhet të vëmë kurdoherë në dukje veçoritë që karakterizojnë rininë, vetitë pozitive të saj dhe, duke u nisur nga këto konsiderata, të nxjerrim drejt edhe detyrat për një thellim e përmirësim të mëtejshëm të punës me rininë.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe mbi disa aspekte të punës së organizatave të BRPSH për përsosjen e figurës morale të rinisë.

Siç e kemi theksuar vazhdimisht rinia jonë dallohet për cilësi të larta moralo-politike. Te ne rritet dhe edukohet një brez i ri i shëndoshë. Kurse ato shfaqje negative që manifestohen në disa të rinj, janë pasqyrimi i «njollave» të huaja që ekzistojnë akoma në shoqërinë tonë në tërësi, të cilat nuk duken vetëm në disa të rinj, por edhe në më të rritur e të moshuar.

Sigurisht shfaqjet negative e të huaja për rininë tonë duhet të na preokupojnë, por jo të na çojnë në vlerësime konservatore e patriarkale për rininë, në injorimin e veçorive e të kërkesave të sotme të zhvillimit të saj. Detyra jonë është të luftojmë për ta mbrojtur rininë nga helmi i ideologjisë borgjeze e revizioniste duke i përballuar me guxim kontradiktat e problemet që dalin në këtë fushë. Prandaj edukimi i rinisë, kultivimi i virtyteve të mira dhe luftimi i ve-seve të këqija është një çështje, së cilës duhet t'i kushtojmë kujdesin e duhur.

Rinia nga natyra e saj është më e ndjeshme dhe më e prekshme se njerëzit e moshave më të rritura. Këtë fakt duhet ta kemi gjithmonë parasysh, aq më tepër, pasi formimi i saj është në proces e sipër. Në i dimë karakteristikat psikologjike të fëmijëve, të cilët, që kur fillojnë të flasin, imitojnë nënën, babanë, më vonë mësuesin e të tjerë. Kështu, në këtë proces zhvillimi, krahas rritjes në moshë, ecën edhe edukimi i të rinjve me shembullin e më të rriturve. Sigurisht, të rinjtë, kur imitojnë, kanë kërkesa më shumë se fëmijët, fillojnë e zgjedhin. Në këtë proces ata i tërheq veçanërisht ajo që ka vlerë më të madhe shoqë-



rore. Por, në këtë mes, ka edhe të rinj, që tërhiqen nga pamja e jashtme e gjërave, nga veshja etj., nga ajo që atyre u duket «origjinale», të cilën, duke e parë, për shembull, në një shfaqje televizive përpiqen ta imitojnë, pa bërë gjithmonë dallimin se çfarë është pozitive dhe mund të merret e çfarë është negative dhe duhet luftuar. Ky fenomen nuk duket vetëm në të rinjtë e sotëm. Ai ka qenë edhe më parë dhe është karakteristik për çdo moshë të re.

U fol këtu, për shembull, për problemet që nxjerr shikimi i filmit të huaj. Unë nuk jam dakord me mendimin se dëshira për të parë një film të tillë është një përrulje e njerëzve tanë para të huajve. Këtë fenomen duhet ta shikojmë të lidhur ngushtë me faktin që ne akoma prodhojmë pak filma në vend dhe nuk arrijmë të kënaqim kërkesat e popullit, sidomos të rinisë. Prandaj detyra jonë është të prodhojmë më shumë filma dhe të një cilësie më të lartë. Pastaj, me sa di unë, ne nuk sjellim çfarëdo filmi, mundohemi të zgjedhim sa është e mundur nga filmat përparimtarë. Ajo që duhet bërë më mirë me të rinjtë është që të zhvillohen diskutime rreth filmave që shikohen. Në të njëjtën kohë me ta duhet të bëhen më shumë shfaqje artistike, teatrale, muzikore dhe të punohet më mirë për propagandimin, leximin e diskutimin e librave të mirë. Në këtë mënyrë tek ata mund të formohet një shije më e shëndoshë ideoestetike dhe do të kuptohen më drejt edhe filmat e huaj ose programet e huaja televizive.

Gjithashtu, u përmend këtu edhe problemi i sportit e ndonjë shfaqje negative që vërehet në këtë fu-

shë. E keqja është se shfaqje të një tifoza të sëmurë nuk ekzistojnë vetëm në disa të rinj, por edhe në disa të moshuar, nga të cilët ka që, megjithëse janë me kulturë, bile edhe shokë partie, shpeshherë, me sjelljet e me qëndrimet e tyre jo të përshtatshme, bëhen një shembull i keq për të rinjtë. Të gjithëve na pëlqen të shohim një lojë të bukur futbolli. Është e qartë që gjatë ndeshjes shumë njerëz mund të kenë edhe një simpati ose preferencë të veçantë për një skuadër. Kjo simpati ose preferencë mund të jetë e lidhur me rrethin ku banon ose institucionin ku punon njeriu. Por kjo nuk do të thotë aspak se ai duhet të arrijë deri atje sa të mos jetë në gjendje të arsyetojë drejt dhe të humbasë kontrollin mbi vetveten. Kjo nuk ka asnjë kuptim dhe nuk i shërben kurrkujt. Prandaj, të gjithë duhet të tregojmë kujdes që, sidomos në rini, në vend që të zhvillohet tifoza, të zhvillohen të gjitha llojet e ndryshme të sportit, ku të rinjtë dhe të rejtat të marrin pjesë më gjerësisht.

Me këto që thashë nuk kam aspak ndër mend të shfaqësoj ata të rinj, tek të cilët manifestohet ndonjë sjellje e keqe, e çfarëdo natyre qoftë, ose të shfaqësoj, gjithashtu, disa që, duke kërkuar të jenë «origjinalë» në veshje, në mbajtjen e flokëve etj., bëhen qesharakë për ambientin tonë të shëndoshë shoqëror, të popullit e të vetë masave të rinisë. Shfaqjet e huaja negative Partia dhe rinia i kanë luftuar e do t'i luftojnë. Por, me këtë rast dua të tërheq vëmendjen se, po nuk i kuptuam si duhet problemet e rinisë, po nuk mbajtëm parasysh moshën, veçoritë psikologjike, kërkesat e shëndosha të kohës, do të bëjmë gabime, do të

fillojmë «të qahemi» e «të ankohemi» pa të drejtë, për të gjithë rininë, do të na dobësohet besimi tek ajo, do të vëmë tutelë mbi të, do të biem kështu në pozita të dëmshme patriarkale e konservatore. Mirëpo kjo është një çështje me rëndësi të madhe parimore e jetike. Çështja e rinisë është një çështje e madhe partie, sepse rinia është kurdoherë forca përtëritëse e atdheut tonë socialist, e ardhmja e tij. Sa më e pastër dhe e shëndoshë të jetë figura moralo-politike e rinisë aq më i fortë do të jetë vendi ynë socialist.

Në këtë frymë Partia dhe organizata e rinisë duhet, pra, të tregojnë një kujdes më të madh për edukimin e rinisë. Unë nuk dua ta kritikoj, por vetëm dëshiroj t'i jap një këshillë organizatës së rinisë. Organizata e rinisë punën e saj duhet t'ia përshtatë kohës, domethënë ta ndërtojë atë duke marrë parasysh transformimet e shoqërisë sonë dhe në veçanti ndryshimet në jetesën, në botëkuptimet dhe në shijet e të rinjve, që nuk janë më siç ishin këtu e dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet përpara. Është fakt se shijet estetike, për shembull, ndryshojnë jo me dekada, por edhe me dy e me tre vjet. Këtë ne e shohim në jetë. Të gjithë jemi dëshmitarë se si të rinjtë zhvillohen, lexojnë, studiojnë, diskutojnë, venë nëpër aksione, pasurohen me eksperiencë të re, zgjerojnë rrethin e njohurive etj. Partia u hap atyre gjithmonë horizonte të reja. Edhe puna e organizatës së rinisë duhet t'i përgjigjet akoma më mirë këtij zhvillimi, këtij realiteti.

Kam folur edhe herë të tjera që organizata e rinisë nuk duhet të punojë me metoda e forma pune të vjetra. Kur themi, për shembull, që mbledhjet e

saj të jenë të gjalla, revolucionare, me debate e ballafaqime mendimesh, kjo nuk do të thotë që ato të bëhen të gjata, të mërzitshme e plot formalizma. Edhe anëtarët e Partisë, megjithëse kanë një pjekuri më të madhe dhe shkojnë në mbledhje me preokupacione për problemet që duhet të zgjidhin, prapëseprapë ngjet që nuk i ndjekin kurdoherë me kujdesin e duhur mbledhjet e tyre kur bëhen shumë të gjata e të mërzitshme. Aq më tepër këtë duhet ta mbajmë parasysh për rininë, e cila nuk e ka dhe nuk mund ta ketë atë durim që kanë komunistët dhe më të rriturit nëpër mbledhje. Është gabim që shtrimi i çështjeve në mbledhjet e organizatës së rinisë të bëhet si në organizatën e Partisë, duke injoruar faktin se kemi të bëjmë me të rinj, të cilët kanë edhe kërkesa të veçanta që burojnë nga vetë natyra e tyre, mosha, niveli etj.

Ne shohim që brezi ynë i ri ecën në rrugën e drejtë, vepron mirë dhe unë mendoj se organizata e rinisë e ndihmon në këtë drejtim. Po të mos harrojmë se edukatën rinia e merr në gjithë jetën, në luftën dhe në punën e përditshme që zhvillohet te ne, gjë që e ndihmon shumë brezin e ri të shkojë përpara, të mendojë kaq drejt dhe të veprojë kaq mirë. Në këtë vështrim, sado mirë që të zhvillohen mbledhjet e organizatës së rinisë, nuk mund të lihen pas dore edhe forma të tjera të përshtatshme për edukimin e të rinjve dhe të të rejave.

Kështu, ne shikojmë se të rinjtë kanë qejf të shëtitin grupe-grupe dhe të bisedojnë me njëri-tjetrin lirshëm. Unë them se këto shëtitje dhe biseda të natyr-

shme janë forma të mrekullueshme dhe shumë adapte komunikimi që duhen inkurajuar. Të tilla forma le t'i praktikojnë të rinjtë ku të duan dhe kur të duan ata, kur kthehen nga puna ose nga shkolla, në bulevard, në dritën e shtyllës elektrike, në park, buzë liqenit, në një pasticeri etj. (në berrari nuk rekomandoj). Në këto takime ata do të bisedojnë për problemet që i preokupojnë. Të rejat dhe të rinjtë tanë janë njerëz të formuar e të edukuar nga Partia dhe mendojnë drejt politikisht e ideologjikisht. Ata kanë mendime dhe diskutojnë rreth problemeve të zhvillimit socialist të vendit.

Dihet se në jetë, përmes bisedave në grupe të tilla, bëhet edhe ndonjë kritikë për punën e organizatës së rinisë, për këtë ose atë komunist, pedagog, kryetar të kooperativës, drejtor të ndërmarrjes, inxhinier e të tjerë, sipas vendeve ku punojnë ose mësojnë të rinjtë. Duke i diskutuar lirshëm në rrethin e tyre këto mendime që kanë, nesër të rinjtë nuk do të rezervohen t'i ngrenë edhe përpara organizatës së tyre ose para Partisë. Përveç kësaj, të rinjtë dhe të rejat kanë edhe mendime për librin e lexuar, për vjershat që bëjnë vetë ose lexojnë nga të tjerët, për ngjarjet politike, kulturore, sportive etj., etj. Këtu dalin një mori gjërash nga më të ndryshmet. Këto lloje bisedash interesante mua më duket se nuk vlerësohen sa duhet, pse konsiderohen sikur s'të japin bukë, sikur s'kanë të bëjnë me jetën e përditshme të rinisë dhe nuk ndihmojnë në edukimin e saj. Në fakt, sikurse thashë, këto forma praktikohen nga vetë të rinjtë.

Shpesh, po nuk bëjnë diçka masive, neve na du-

ket sikur s'kemi bërë gjë. Format masive që i bëjmë «me trumbetë», ndiqen nga të rinjtë, sepse ata e duan organizatën e vet dhe dëshirojnë të dëgjojnë diçka interesante në mbledhjet dhe në aktivitetet që zhvillohen. Po ç'ndodh shpeshherë? Të rinjtë venë në mbledhjet e organizatës së tyre, por jo rrallë gjejnë atje një situatë zyrtare, jointime, prandaj edhe nuk flasin dot si në rrethin e tyre të ngushtë shoqëror, megjithëse u thuhet: «Diskutoni shokë, ta bëjmë organizatën-bazë të rinisë luftarake, thuajeni mendimin tuaj haptazi për çdo problem!». Por përsëri ndodh që ata nuk flasin, për shkak se në këto mbledhje ka shumë formalizëm e zyrtarizëm. Nuk mendohet sa duhet që aktiviteti i organizatës së rinisë në të gjithë sektorët të zhvillohet në ato forma që i përshtaten më shumë rinisë e që janë të pranueshme prej saj, dhe, në këtë proces të ushqehen, të nxiten, të drejtohen dhe të edukohen ata me politikën dhe me ideologjinë e Partisë. Mbledhjet e rinisë dhe aktivitetet e tjera të saj duhet të jenë të tilla, ku të rinjtë të kenë kënaqësi, të hedhin e të shkëmbejnë mendimet për probleme nga më të ndryshmet.

Me kalimin e kohës të rinjtë e zgjerojnë rrethin e tyre shoqëror si dhe rrethin e njohurive, të interesave e të dëshirave. Në grupe të veçanta ata bisedojnë dhe kjo është e dobishme. Puna është që bisedat në këto grupe të mos jenë boshe, pa përmbajtje, por atje të flitet për probleme nga më të ndryshmet. Të rinjtë, natyrisht, edhe për sportin duhet të diskutojnë, po në të njëjtën kohë të flasin edhe për politikën, edhe për shkencën e teknikën, edhe për letërsinë e artin

etj., etj. Prandaj ata duhet të përzihen me njëri-tjetrin në mënyrë të tillë që të kenë mundësi të bisedojnë për të gjitha gjërat që e interesojnë rininë: për një roman që kanë lexuar, për një shfaqje teatrale ose film që kanë parë, për një ndeshje sportive, për një emision të radios që kanë dëgjuar, për miqësinë dhe dashurinë e shëndoshë midis të rinjve etj. Biseda të tilla nuk do të jenë kurrë të dëmshme, përkundrazi ato do të plotësojnë disa boshllëqe të punës edukative që mbehen nga puna e organizuar dhe e programuar, ku mundësitë janë të kufizuara për të kënaqur deri edhe kërkesat e veçanta e individuale të të rinjve. Që t'i arrihet sa më mirë kësaj, jo vetëm organizata e rinisë, por të gjithë e kanë për detyrë të japin ndihmën e tyre.

Jeta tregon se ka mjaft prindër e aktivistë shoqërorë që bisedojnë me rininë për probleme të ndryshme jo vetëm kur kërkohen prej saj ose kur ngarkohen me këtë detyrë, por takohen shpesh me të rinj, qoftë edhe kur u vijnë në shtëpi si shokë e shoqe të fëmijëve të tyre, gjejnë kështu rastin dhe bashkëbisedojnë me rrethet e tyre shoqërore, marrin pjesë në bisedat që zhvillojnë ata, duke ndihmuar me mendimet dhe me eksperiencën e tyre të pasur. Kjo është një gjë e mirë dhe unë besoj se ka mundësi ta bëjnë edhe shumë të tjerë, komunistë, punëtorë, intelektualë, aktivistë shoqërorë, të cilët, jo me titujt që kanë, por si shokë të dashur të të rinjve, të gjejnë mundësinë e të rrahin mendime me ta në grupet e vogla, ku të rinjtë bisedojnë me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë do të njihen më mirë edhe dëshirat, kërkesat e preokupa-

cionet e të rinjve e kështu jo vetëm do t'i mësojnë ata, por edhe do të mësojnë prej tyre. Forma të tilla duhen inkurajuar dhe ato, siç thashë, nuk është e domosdoshme të zhvillohen me solemnitet, në salla apo në vende të caktuara për mbledhje, por mund të bëhen edhe në shtëpitë e vetë të rinjve. Kjo do t'i bëjë ata që të mos jetojnë të shkëputur nga njëri-tjetri, apo të presin të takohen e të diskutojnë kur të vijë mbledhja e organizatës. Në këtë mënyrë vetvetiu pasurohet përmbajtja e punës edukative me të rinjtë dhe zhvillohet një jetë më e dendur, aktive dhe revolucionare, ku ata mësojnë, ngrenë vazhdimisht nivelin e tyre ideopolitik dhe zgjerojnë horizontin kulturor. Në këtë rrugë organizata e rinisë, do të ketë më tepër mundësi të njohë cilët janë aktivistët e saj më të mirë. Tashti është vështirë që të dallohen shumë veta në shkallën që kërkohet, pse shpesh mbahet vetëm një listë me të rinj që janë sekretarë organizatash e aktivistë të tjerë, por duhet ditur se veç këtyre ka dhe nga ata që janë shumë aktivë në diskutimin e problemeve jashtë mbledhjeve të organizatës, por që nuk njihen si duhet. Këta të rinj, jo vetëm duhet të njihen, por dhe të udhëhiqen e të ndihmohen.

Këtu u ngrit edhe çështja se si të rritet më tepër roli i organizatës së rinisë në qendrat e prodhimit dhe në kooperativat bujqësore. Është e drejtë që rinia duhet të thotë fjalën e saj dhe të luftojë për zgjidhjen e të gjitha problemeve që ka qendra e punës apo kooperativa bujqësore. Por ka rëndësi se si do ta kryejë ajo këtë rol. Të marrim si shembull zhvillimin e lopës. A e ka marrë në dorë rinia këtë sektor të rëndësi-



shëm? Unë mendoj se po. Pothuaj kudo shohim të reja që janë rritëse viçash, mjelëse të dalluara etj. Ato e ndiejnë nderin dhe përgjegjësinë që kanë duke mbajtur gjithë këtë pasuri nën kujdes, prandaj dhe punojnë për të kryer sa më mirë shërbimet ndaj lopës, për trajtimin e mirë të saj, për sigurimin e bazës ushqimore, për rendimentin e lartë të qumështit etj. Kjo është një gjë e mirë. Po si mund të ngrihet akoma më lart roli i të rejave dhe i të rinjve që punojnë në sektorin e blegtorisë? Në radhë të parë duke qenë shembull çdo i ri dhe e re atje ku punon. Por kjo s'mjafton. Roli i të rinjve dhe i të rejave duhet rritur në të gjitha drejtimet dhe në zgjidhjen e problemeve. Kështu, për shembull, kur shohim se po neglizhohet për bazën ushqimore, se mësimet në kursin zooteknik nuk po zhvillohen më, gazeta s'shkon në stallë etj. të rinjtë duhet të marrin të gjitha masat që varen prej tyre, pa i lënë çështjet t'i shtrojnë në mbledhjen e organizatës së rinisë. Kur të rinjtë nuk arrijnë ta zgjidhin ndonjë problem me forcat e tyre, atëherë ta ngrenë zërin fort pranë kryesisë së kooperativës e po qe nevoja edhe para organizatës së Partisë, me qëllim që problemeve t'u shkohet deri në fund. Sa më aktivë të jenë të rinjtë në punën e përditshme, në mbledhjen e brigadës, të asamblesë, të kolektivit, aq më tepër rritet roli i tyre në mbarëvajtjen e punës.

Si të gjithë punonjësit, edhe të rinjtë, kudo që punojnë, udhëhiqen nga direktivat e Partisë, por, si njerëz me më pak eksperiencë jete dhe pune, ata kanë më shumë nevojë edhe të mësojnë, të dëgjojnë porositë e kryesisë së kooperativës apo të drejtorisë së

ndërmarrjes, të agronomit, zooteknikut apo inxhinierit, të mësojnë edhe nga organizata e rinisë se si të mbajnë vazhdimisht zgjuar e të ri shpirtin e tyre, si të ngrenë gjithnjë nivelin politik e ideologjik, si të jenë të zellshëm në përvetësimin e teknikës e të shkencës etj. Kur organizata e rinisë e shikon anëtarin e saj që nuk shkon në punë, i shpjegon ç'është disiplina, i sqaron anën politiko-ideologjike të disiplinës. natyrisht edhe anën ekonomike të këtij problemi. Organizata e rinisë në këtë mënyrë ia përshtat punën e saj veprimtarisë konkrete të të rinjve atje ku ata punojnë, në brigada, në reparte.

Në goftë se bëhet punë paralele, duke folur edhe në organizatën e rinisë për të njëjtat gjëra që shtron edhe Partia me tërë kooperativistët dhe ngrihen të njëjtat probleme që shtron edhe brigadieri, atëherë rinia mërzhitet. Organizata e rinisë ka shumë punë për të bërë me rininë në drejtime të tjera. Ajo ka plot çështje ideologjike, shoqërore, shkencore, artistike etj., për të cilat duhet të ndihmojë Partinë.

Ndoshta unë nuk jam në dijeni si duhet për gjithë veprimtarinë e organizatës së rinisë, por dëshiroj të shpreh mendimin tim dhe mendimet, siç dihet, janë të lejueshme. Rinisë është e pamundur t'i vihen caqe në punë, t'i caktohen kufij, t'i jepen detyra me racion, duke i thënë «deri këtu e ke të drejtën për të vepruar». Jo, asaj nuk duhet t'i thuhet «kjo s'është puna jote», «ajo s'të takon ty». Nuk duhet të ketë racione, as kufij në veprimtarinë e rinisë. Fuqinë e saj ne duhet ta përdorim në mënyrë të tillë që të vëmë në rrugë edhe probleme të tjera që preokupojnë Partinë,

por që s'ecin, kanë mbetur në vend, janë të vështira për t'u zgjidhur. Kështu rinia do të shpërthejë me forcën e saj sulmuese, me energjitë e saj të pashtershme, me iniciativën e saj krijuese, me shpirtin e saj luftarak. Në këtë drejtim duhet bërë një punë e madhe që kjo çështje të kuptohet drejt, pa shkuar në anën tjetër që t'i japim rinisë të kryejë ato detyra, të cilat u janë ngarkuar pushtetit, kooperativës ose organizatës së bashkimeve profesionale.

Unë e kam thënë edhe tjetër herë që duhen kombinuar detyrat midis organizatave të bashkimeve profesionale, rinisë dhe gruas, pa i rënduar të rinjtë, të rejat ose gratë me punë paralele, të përsëritura, të panevojshme dhe shabllone, me disa formula të përgatitura nga lart që u dërgohen shokëve në bazë.

Disa herë më vijnë letra me të cilat njoftohem për iniciativat që marrin kolektivat e ndryshëm. Ka prej këtyre iniciativave, që më duket se nuk janë fryt i mendimit të bazës, por diktohen nga lart, sipas formulave të përgatitura, për bujë dhe me qëllim që të dalin në gazetë. Këto punë nuk duhen bërë kështu. Sidomos rinia duhet të mos pranojë metoda të tilla pune jo të drejta.

Çështja e edukimit moralo-politik të rinisë duhet të na preokupojë me të vërtetë shumë. Rininë e kemi të pastër, megjithatë duhet ta edukojmë vazhdimisht me kujdes, para së gjithash duke e bindur. Kjo anë e problemit theksohet përherë në shkrimet e relacionet që bëhen, por vallë a punohet që të rinjtë të binden gjithnjë dhe nga të gjithë për detyrat që u shtrohen? A realizohet kjo çështje ashtu siç duhet në

praktikë, në punën dhe në jetën e përditshme? Unë mendoj se jo sa duhet. Vërtet të rinjtë, për arsyet që dihen, mund të bien më shpejt në gabime, por me siguri ata edhe ndreqen më shpejt. Disa shfaqje negative, natyrisht, lindin nga mungesa e një pune të shëndoshë edukative dhe kjo është e kuptueshme. Por nuk qëndron shkaku vetëm këtu. Organizatat e rinisë dhe Partia bëjnë të gjitha përpjekjet që të mos ketë shfaqje negative në të rinjtë, në anëtarët e Partisë dhe në popull, por ja që ekzistojnë akoma mbeturinat e ideologjisë e të moralit të vjetër, që vazhdimisht po i luftojmë e do t'i luftojmë me vite e dhjetëra vite; ekziston, gjithashtu, presioni i madh i jashtëm i borgjezisë dhe i revizionizmit, që duan të frenojnë ecjen tonë përpara.

Të gjitha këto çështje duhet t'i kuptojmë dhe t'i shpjegojmë drejt në Parti e në rini dhe në të gjithë ata që punojnë për edukimin e brezit të ri si dhe të luftojmë me këmbëngulje për t'i zgjidhur në rrugën revolucionare marksiste-leniniste të Partisë.

Këto ishin disa çështje që doja të theksoja në këtë mbledhje për çështjen e rinisë.

*Botuar për herë të parë në broshurën: Enver Hoxha, «Mbi disa aspekte të punës së organizatave të BRPSH për përsosjen e figurës morale të rinisë», Tiranë, 1971*

*Botohet sipas broshurës: Enver Hoxha, «Mbi disa aspekte të punës së organizatave të BRPSH për përsosjen e figurës morale të rinisë», Tiranë, 1971*

## NJË KONGRES REVIZIONIST PËR QËLLIME REVIZIONISTE

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

25 mars 1971

Më 30 mars revizionistët sovjetikë do të mbliidhen në kongresin e tyre të zakonshëm. Ky është kongresi i pestë që hrushovianët po bëjnë pasi uzurpuan pushtetin në Bashkimin Sovjetik. Ashtu si në të kaluarën, edhe tani krerët sovjetikë po zhvillojnë një fushatë të madhe propagandistike për të trumbetuar pikëpamjet dhe tezat e tyre revizioniste, për të mburrur veprimet e tyre kundërrevolucionare brenda e jashtë. Ata përpiqen që tradhtinë e tyre ta veshin me frazeologji marksiste, që revizionizmin ta shesin për leninizëm.

Por propaganda mbetet propagandë dhe demagogjia demagogji. Kongreset e revizionistëve sovjetikë kanë qenë një shkallëzim i mëtejshëm në rrugën e thellimit të revizionimit të marksizëm-leninizmit, të largimit nga mësimet e traditat e Revolucionit të Tëtorit, të braktisjes së eksperiencës revolucionare të Partisë Bolshevike. Edhe Kongresi i tanishëm i 24-t nuk mund të jetë tjetër veçse një kongres kundërre-

volucionar, antisovjetik, antimarksist e antisocialist.

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ka degjeneruar prej kohësh në një parti borgjeze, që shpreh dhe mbron interesat e klasës së borgjezisë së re sovjetike. Nga një parti që luftonte për ndërtimin e socializmit, ajo është shndërruar në një parti që udhëheq procesin e rivendosjes së kapitalizmit, nga një parti që ndiqte një politikë proletare internacionaliste, është transformuar në një parti shoviniste, që u shërben qëllimeve hegjemoniste e imperialiste. Nga një parti pararojë e revolucionit botëror, ajo është shndërruar në një qendër të kundërrevolucionit.

Fakti që ajo mban akoma emrin komuniste dhe në radhët e saj ndodhen edhe punëtorë, nuk e ndryshon karakterin e saj klasor borgjez, nuk e ndryshon natyrën e saj joproletare. Në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet politikën dhe vijën e çdo partie nuk e kanë përcaktuar kurrë emri dhe përbërja e saj. Në partinë e sotme të ashtuquajtur komuniste të Bashkimit Sovjetik ligjin nuk e bëjnë klasa punëtore dhe përfaqësuesit e saj, por një grup renegatësh, të cilët, duke spekuluar me emrin dhe me traditat e lavdishme të Partisë së Leninit e të Stalinit, i diktojnë gjithë partisë vijën e tyre tradhtare e antimarksisteleniniste. Të gjitha organet udhëheqëse të partisë kanë rënë në duart e përfaqësuesve të klasës burokratiko-teknokratike. Janë aparatçikët ata që vendosin e përcaktojnë për çdo gjë, që nga vija e përgjithshme e deri te punët më të vogla. Janë burokratët që, në emër të partisë, mbytin dhe shtypin anëtarët e thjeshtë, që normat leniniste të ndërtimit të jetës së partisë i kanë zhve-

shur nga përmbajtja e tyre revolucionare dhe i kanë shndërruar në norma për ta lidhur partinë pas qerres së tyre, në norma për zëvendësimin e disiplinës së ndërgjegjshme proletare me disiplinën e verbër ndaj autoriteteve revizioniste. Partia në Bashkimin Sovjetik nuk është më shprehja e ndërgjegjes së klasës punëtore dhe pararoja e saj në luftën për çështjen e komunizmit, por një instrument në duart e sundimtarëve të Kremlinit në luftën kundër klasës punëtore dhe ideologjisë së saj.

Revizionistët sovjetikë edhe zyrtarisht e kanë likuiduar partinë e klasës punëtore si të tillë dhe e kanë zëvendësuar me të ashtuquajturën «parti të të gjithë popullit». «Partia e të gjithë popullit» nuk është «vazhdim i partisë komuniste të klasës punëtore», siç pretendojnë revizionistët. Ajo s'ka më asgjë të përbashkët as me klasën punëtore, as me popullin sovjetik. Një hendek i madh i ndan ata. Emërtimi i ri është një fasadë për të maskuar ndryshimin e karakterit të partisë dhe për të justifikuar vijën e drejtimin e saj regresiv. Duke e paraqitur si parti të të gjithë popullit, ata duan që, nga njëra anë, të ndalojnë luftën e klasës punëtore kundër borgjezisë dhe, nga ana tjetër, të justifikojnë dhunën kundërrevolucionare të borgjezisë kundër klasës punëtore e popullit sovjetik.

Jeta vërtetoi se në kushtet kur klasat shfrytëzuese janë likuiduar si klasa, rreziku i restaurimit kapitalist vjen, në radhë të parë, nga degjenerimi i partisë dhe nga uzurpimi i udhëheqjes së saj nga elementët oportunistë e revizionistë. Kurse degjenerimi i partisë është baza e degjenerimit të të gjithë rendit shoqëror socialist.

Kursi revizionist, që zyrtarisht u formulua në Kongresin e 20-të dhe u kristalizua më tej me Hrushovin, u materializua në ndryshimet rrënjësore që u bënë gjatë sundimit të Brezhnjev-Kosiginit në të gjitha fushat e jetës. Periudha pesëvjeçare që ka kaluar nga Kongresi i 23-të, është periudha e transformimit të thellë borgjez brenda vendit dhe e kalimit në imperializëm në politikën e jashtme.

Ndryshimi i karakterit të partisë dhe i vijës së saj nuk mund të mos çonte në ndryshimin e natyrës së pushtetit politik dhe të të gjithë rendit shoqëror socialist në Bashkimin Sovjetik. U likuidua diktatura e proletariatit dhe vendin e saj e zuri diktatura e borgjezisë e maskuar prapa etiketës së «shtetit të të gjithë popullit». Ky transformim kundërrevolucionar në fushën e superstrukturës politike e ideologjike çoi gradualisht edhe në minimin e bazës ekonomike të socializmit.

Reforma ekonomike e Kosiginit kishte për qëllim të zhdukte kontradiktën e krijuar midis pushtetit politik kapitalist dhe bazës socialiste ekonomike, të rive ndoste marrëdhëniet kapitaliste në ekonominë sovjetike. Thelbi i të gjitha ndryshimeve të reformës është ndryshimi i qëllimit të prodhimit. Borgjezia e re sovjetike, me anën e reformës, krijoi një sistem të tillë organizimi e drejtimi në të cilin qëllimi kryesor i prodhimit bëhet nxjerrja e fitimit kapitalist. Fitimi u kthye në moto dhe në forcë kryesore lëvizëse e prodhimit dhe e gjithë ekonomisë. Prona e përbashkët socialiste u shndërrua në një lloj kapitalizmi shtetëror. Shteti i sotëm sovjetik si një kapitalist kolektiv i



administron mjetet e prodhimit në emër dhe në interes të borgjezisë së re sovjetike.

Në qoftë se në shoqërinë klasike borgjeze shfrytëzimi i punonjësve kryhet nëpërmjet përvetësimit të mbivlerës, sipas sasisë së kapitalit që disponon secili kapitalist, në shoqërinë revizioniste ajo përvetësohet në bazë të shkallës hierarkike që borgjezi revizionist zë në sistemin e burokracisë shtetërore, në aparatet e drejtimit e të administrimit të ekonomisë, ose në piedestalet e krijuara për të zgjedhurit e shkencës, kulturës, artit etj.

Fati i punëtorit sovjetik nuk është më i lehtë nga ai i kolegut të tij të Perëndimit, ngaqë prona e madhe në Bashkimin Sovjetik nuk mund të shitet ose të lihet në trashëgimi familjare, siç është e mundshme në vendet e tjera borgjeze. Për proletarin s'ka aspak rëndësi nëse mbivlerën që ai prodhon e uzurpon një borgjez i individualizuar, apo një shtresë e tërë borgjeze, që e rindan midis pjesëtarëve të saj. Në të dy rastet shfrytëzimi është i njëjlojtë, po aq kapitalist e po aq barbar.

Kasta e re burokratike që ka shtënë në dorë frenat e shtetit e të ekonomisë, i përdor pozitat e zëna për të siguruar privilegje në kurriz të klasës punëtore dhe të masave punonjëse. Të ardhurat e burokratëve, të teknokratëve e të intelektualëve borgjezë janë me dhjetëra herë më të mëdha nga ato të punëtorëve e të kolkozianëve sovjetikë. Përveç pagave të larta nominale, ata përvetësojnë të ardhura të mëdha në formën e shpërblimeve, honorareve, shtesave të shumëllojshme personale etj.

Stimuli material, që përbën themelin e reformës ekonomike, e ka zëvendësuar parimin e shpërblimit sipas punës dhe ka krijuar një fushë të gjerë për përvetësimin e punës e të djersës së punonjësve nga borgjezia e resunduese. Për hir të rublës, njerëzit e degjeneruar, që janë pjellë e sistemit revizionist, nuk lënë gjë pa bërë, nuk ndalen as përpara akteve më të ulëta. Burokratët kryejnë një mijë e një mashtrime për të rritur shifrat e realizimit të planit, që t'u rriten edhe atyre shpërblimet. Të tjerë ngrenë çmimet për të siguruar fitime të larta për ndërmarrjen dhe, si rrjedhim, shpërblime më të mëdha edhe për vete. Spekulantët e devizave të huaja dhe akaparatorët e mallrave të rralla janë kthyer në sundimtarë të vërtetë të tregjeve të qyteteve të mëdha. Ryshfeti ka fituar kudo të drejtën e qytetarisë.

Shtresa e privilegjuar sovjetike në gjithë veprimtarinë e saj udhëhiqet nga interesat egoistë, kujdeset për forcimin e pozitës ekonomike dhe sundimit të saj politik. Midis saj dhe popullit sovjetik ekziston një kontradiktë e thellë e papajtueshme. Kjo kontradiktë klasore antagoniste është kontradikta kryesore e shoqërisë së sotme sovjetike.

Në Bashkimin Sovjetik po zhvillohet një proces i gjerë shturjeje, dekadence e degjenerimi në të gjitha fushat. Po zhduken një nga një vlerat morale e shpirtërore socialiste, të krijuara me aq mundim e me aq luftë nga Lenini e Stalini dhe nga gjithë bolshevikët e komunistët e ndershëm.

Pasojë e rivendosjes së kapitalizmit është përhapja e gjerë e ideologjisë borgjeze. Egoizmi dhe individuali-

zmi, karrierizmi e servilizmi, rendja pas interesit personal etj. po shkallmojnë nga themelet ndërgjegjen e njerëzve në Bashkimin Sovjetik. Në mënyrë shkatërruese po shfaqen në rini mënyrat e degjeneruara të jetesës së botës kapitaliste. Nga veprat e artit e të kulturës është zhdukur tanimë patosi revolucionar dhe në to mbretëron fryma pesimiste, boshllëku ideologjik etj. Ndërsa janë bërë të modës rrymat dekadente borgjeze perëndimore, janë braktisur dhe po merren nëpër këmbë traditat e mëdha proletare që kanë pasur më parë arti dhe kultura sovjetike.

Po rikthehet ajo kohë e Rosisë cariste kur populli lëngonte nga shovinizmi rusomadh, nga dallimet raciale e nacionale, nga mungesa e lirive demokratike, pogromet dhe nga arbitrariteti burokratik. Mos vallë rastësisht u ringjallën sllavjanofilët e poçvenikët dhe literatura e tyre po mbush faqet e gazetave e të revistave? Mos vallë vetëm si rezultat i propagandës së huaj lindi përsëri problemi çifut, ai i kombësive të vogla, nacionalizmi ukrainas etj.?

Krerët revizionistë, kohë pas kohe, kritikojnë këto apo ato fenomene negative, shpallin këtë ose atë masë për të kufizuar vagabondazhin dhe kriminalitetin midis të rinjve, kërkojnë t'u vihet fre grabitjeve nëpër ndërmarrje dhe të kufizojnë tregun e zi që po lulëzon në të katër anët. Por realiteti nuk ndryshon dhe as ka për të ndryshuar. Të tilla fenomene degjenerimi, si këto që po vihen re tani në Bashkimin Sovjetik, nuk janë fenomene të izoluara e të përkohshme. Ato janë pjellë e sistemit kapitalist që po restaurohet në Bashkimin Sovjetik. Ato janë tipike për çdo shoqëri bor-

gjeze dhe do të zhduken bashkë me zhdukjen e saj. Çfarëdo përpjekjesh propagandistike që të bëjnë sundimtarët e Kremlinit, ata nuk mund ta zhdukin atë ndjenjë të madhe pasigurie, frike e vetmie që ekziston në njerëzit, atë varfëri të madhe shpirtërore e ideologjike, atë indiferentizëm të dukshëm dhe atë pasivitet të theksuar ndaj politikës zyrtare.

Këto kohët e fundit në Bashkimin Sovjetik vihet re një tendencë e përgjithshme për «shtrëngimin e vidhave», të cilën krerët sovjetikë mundohen ta paraqesin si një «kthim në pozita revolucionare». «Pravda», «Komunist» dhe i tërë shtypi sovjetik kërkojnë pa pushim «disiplinë», «rregull», «bindje ideologjike» etj. Në të vërtetë, kjo fushatë ka për qëllim të mbytë pakënaqësinë e masave, të shtypë çdo kundërshtim të tyre. Në pamjen e parë duket sikur masat shtrënguese synojnë liberalët, kurse në realitet ato drejtohen, në radhë të parë, kundër forcave revolucionare, kundër lirisë së mendimit e të organizimit të klasës punëtore. Ato kanë për qëllim të forcojnë diktaturën revizioniste dhe të pakësojnë telashet e udhëheqjes renegate.

Për asnjë «kthesë nga e majta» të udhëheqjes sovjetike nuk mund të bëhet fjalë. Analiza më e vogël, ose edhe thjesht shqyrtimi realist i gjendjes, do të çonte në zbulimin e përgjegjësisë së klikës së Brezhnjev, Kosiginit, Podgornit e të tjerëve, do të tregonte se është ajo që e ka katandisur Bashkimin Sovjetik në gjendjen e sotme, se burimi i gjithë të këqijave janë këmbëngulja dhe ndjekja me kokëfortësi nga ana e kësaj klike e politikës së tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit, revolucionit e socializmit. Këtë kthesë re-

vizionistët s'do ta bëjnë kurrë vullnetarisht. Vetëm klasa punëtore, e udhëhequr nga pararoja e saj revolucionare marksiste-leniniste dhe e mbështetur në mësimet e Leninit e të Stalinit, pasi të përmbysë regjimin revizionist, do ta nxjerrë Bashkimin Sovjetik nga kaosi në të cilin e kanë zhytur tani revizionistët dhe do ta rivërë atë në rrugën e drejtë të socializmit e të komunizmit.

Largimi nga marksizëm-leninizmi, restaurimi i kapitalizmit brenda nuk mund të mos i çonte Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe shtetin sovjetik në ndjekjen e një kursi shovinist e imperialist në lëvizjen komuniste e në marrëdhëniet ndërkombëtare. Udhëheqja e sotme sovjetike ka shkallmuar parimet e internacionalizmit proletar dhe i ka zëvendësuar ato me parimet borgjeze të diktatit e të presionit, të shtypjes e të shfrytëzimit të popujve. Me vendet satelite ajo ka vendosur marrëdhënie të tipit kolonialist, i mban ato të pushtuara ushtarakisht dhe u imponon atyre vullnetin e vet për çdo gjë. Ndaj partive revizioniste ajo përpiqet të ruajë sundimin e saj prej feudali absolut, t'i përdorë ato si gurë shahu në fushën e kombinacioneve të saj diplomatike.

Këtë politikë shoviniste e hegjemoniste sundimtarët e sotëm të Bashkimit Sovjetik mundohen ta kamuflojnë me lloj-lloj demagogjish, duke u betuar natë e ditë për «besnikërinë» e tyre ndaj internacionalizmit proletar, «solidaritetit» socialist, «unitetit» vëllazëror etj.

Por populli sovjetik, ashtu si dhe gjithë popujt e botës, nuk gjejnë nga fjalët. por nga veprat. Dhe

veprat e udhëheqësve të sotëm sovjetikë janë një provë e madhe që zbulojnë fytyrën e tyre të vërtetë prej shovinistësh e imperialistësh.

Çekosllovakia është një njollë e madhe turpi në historinë e re të revizionistëve sovjetikë, e cila nuk mund të fshihet me fjalë e me teori boshe. Gushti i 1968-s zbuloi në sytë e gjithë botës jo vetëm kalbësirën e revizionizmit, por edhe tërë esencën e tij reaktionare e agresive. Ai tregoi se revizionizmi tanimë mbahet në këmbë vetëm me forcën e tankeve dhe të bajonetave, se diplomacia e demagogjia ia kanë lënë vendin dhunës kundërrevolucionare<sup>1</sup>.

Agresioni kundër Çekosllovakisë zbuloi se vendet e Evropës Lindore, ku sundojnë revizionistët, i kanë humbur lirinë e pavarësinë e tyre dhe janë kthyer në një lloj kolonish. Teoria e «sovrانيتit të kufizuar» e Brezhnjev, që doli pas pushtimit të Çekosllovakisë, lindi jo rastësisht, por mbi këtë bazë, mbi bazën e grabitjes së lirisë e të sovranitetit të vendeve të tjera, të sundimit dhe të nënshtrimit ndaj imperializmit revizionist sovjetik. Ajo është shprehje e politikës së vjetër imperialiste cariste të ekspansionit dhe të hegjemonisë të veshur me uniforma të reja. A mund të quhet Çekosllovakia e sotme një vend i pavarur e sovran kur ajo është e pushtuar nga ushtria sovjetike dhe ku klika sunduese e Husakut i është imponuar vendit me bajonetat e të huajve? A mund të quhen

---

1. Shprehje e këtij kursi agresiv dhe e përdorimit të dhunës kundërrevolucionare është edhe pushtimi i Afganistanit nga socialimperialistët sovjetikë më 27 dhjetor 1979.

të lira vendet revizioniste të lidhura me Bashkimin Sovjetik kur fati i tyre vendoset në Moskë dhe kur ato si për çështjet e brendshme, ashtu edhe për ato të jashtme janë të detyruara të zbatojnë direktivat që vijnë nga Kremli?

Por kjo politikë shoviniste e kolonialiste, që është pjesë e sistemit shfrytëzues kapitalist, nuk shtyp vetëm vendet revizioniste dhe nuk kërcënon vetëm të tjerët. Ajo i godit edhe më rëndë popujt e Bashkimit Sovjetik, të cilët humbasin për vete lirinë dhe i nënshtrohen shtypjes nacionaliste.

Krahas shtypjes politike dhe nënshtimit ushtarak, revizionistët sovjetikë kanë ndjekur dhe ndjekin ndaj vendeve satelite një politikë të shfrytëzimit ekonomik. Nën pretekstin e bashkëpunimit e të ndarjes ndërkombëtare të punës, ata u kanë imponuar këtyre vendeve një zhvillim të njëanshëm, në përshtatje me ekonominë e metropolit sovjetik. Këto vende varen për çdo gjë nga Moska, për makineri e lëndë të parë, për kredi e tregje shitjeje, për progresin teknik dhe teknologjinë e re. Vështirësitë dhe gjendja e rëndë ekonomike që po kalojnë ato tani, janë pasoja të politikës kolonialiste që ndjek Bashkimi Sovjetik ndaj tyre.

Diktati politik, pushtimi ushtarak dhe shfrytëzimi ekonomik të zbatuar nga udhëheqësit sovjetikë dhe vetë vija antimarksiste e klikave në fuqi kanë shkaktuar kudo në vendet revizioniste konflikte të mëdha politike, ideologjike e shoqërore. Një dëshmi e gjallë janë ngjarjet e fundit në Poloni. Shkaku i këtyre ngjarjeve, siç është bërë tanimë e qartë, ishin pakënaqësia e madhe e punëtorëve ndaj pushtetit revizionist, mosdurimi ndaj

padrejtësive dhe shfrytëzimit ekonomik, revoltimi ndaj gjendjes së rëndë dhe pa perspektivë të ekonomisë polake. Ato zbuluan tërë falsitetin dhe demagogjinë shumëvjeçare të Brezhnjevit e të miqve të tij për «sukseset, përparimet dhe hovet» në zhvillimin e vendeve të së ashtuquajturës «bashkësi socialiste».

Udhëheqësit sovjetikë as i kanë thënë dhe as do t'i thonë popullit përse u përmbys Gomulka, përse u ngrit në këmbë klasa punëtore polake kundër pushtetit revizionist në fuqi dhe ç'po ndodh në të vërtetë në Poloni. Por ngjarjet polake nuk janë një çështje që mund të mbyllet në një sirtar me çelës. Ato nuk kanë të bëjnë vetëm me Poloninë, as edhe vetëm me marrëdhëniet Poloni-Bashkimi Sovjetik.

Lufta e klasës punëtore polake shënon një fenomen të ri për vendet revizioniste, një moment kthese me rëndësi revolucionare. Në dhjetor në Poloni u bë ndarja midis klasës punëtore dhe pushtetit revizionist në fuqi, filloi organizimi i veçantë i klasës punëtore, që iu kundërvu partisë revizioniste dhe organizatave të saj; për herë të parë punëtorët, nga njëra anë, dhe revizionistët, nga ana tjetër, u ndeshën ballë për ballë si dy klasa tanimë të formuara antagoniste. Ngjarjet polake janë shprehja e një procesi që zhvillohet në të gjitha vendet revizioniste, duke përfshirë edhe Bashkimin Sovjetik, e që aktualisht në Poloni arriti intensitetin më të madh. Ato janë, si të thuash, pararendëset e betejave të mëdha klasore revolucionare, që do të shpërthejnë në mënyrë të pashmangshme kudo dhe në një të ardhme jo të largët.

Kampi revizionist është një anije, së cilës i hyn



ujët nga të gjitha anët dhe ajo nuk mund të arrijë të hyjë në asnjë port shpëtimi. Gjendja e pashpresë, grindjet dhe përleshjet e vazhdueshme në gjirin e tij nuk mund të qetësohen, as të zhduken. Krerët sovjetikë përdorin si leva Traktatin e Varshavës dhe KNER-in për t'i mbajtur në fre partnerët, por pikërisht janë këto instrumente të egra e barbare shtypjeje e shfrytëzimi që i shtojnë kontradiktat e që nxitin grindjet. Politika shoviniste rusomadhe është një burim i përhershëm i konflikteve midis vendeve revizioniste. Pa hedhur poshtë këtë politikë, këto vende nuk mund të gëzojnë kurrë lirinë e pavarësinë e vërtetë, nuk mund të vendosin kurrë marrëdhënie të drejta e të barabarta midis tyre dhe Bashkimit Sovjetik. Prandaj kundërshtimi i vendosur i kursit shovinst e hegjemonist të udhëheqësve sovjetikë është për të gjithë revolucionarët e popujt një detyrë e madhe patriotike e internacionale.

Jo më e mirë paraqitet gjendja edhe në marrëdhëniet e udhëheqësve revizionistë sovjetikë me partitë revizioniste në vendet kapitaliste. Këta e kanë gjithnjë e më të vështirë t'u imponojnë atyre diktatin e vet. Duke u shndërruar në pjesë përbërëse të aparatit politik të shtetit borgjez, partitë revizioniste të Perëndimit mbrojnë tani më shumë interesat nacionalë të borgjezisë të tyre, të cilët nuk janë identikë me ata të Bashkimit Sovjetik. Me gjithë përpjekjet e mëdha të sundimtarëve të Moskës për t'i mbajtur partitë e tjera nën kontroll dhe për t'i kthyer ato në një shtojcë të politikës së jashtme sovjetike, çdo ditë e më shumë dalin në pah divergjencat e kundërshtimet midis tyre,

të cilat shpesh marrin një karakter të hapët e polemik.

Të gjitha këto tregojnë për dështimin e vijës tradhtare hrushoviane, për sthurjen e plotë të kampit revizionist dhe për krizën e thellë në të cilën është futur revizionizmi modern.

Pesë vjet më parë, në Kongresin e 23-të, oratorët revizionistë u mburrën për politikën e tyre «antiimperialiste» dhe deklaruan se ata «nuk do të qëndrojnë indiferentë» ndaj veprimeve të SHBA-së, se do t'i bëjnë zap agresorët etj. Këto po bëjnë edhe tani, në prag të Kongresit të 24-t.

Bashkimi Sovjetik revizionist jo vetëm që prej kohësh ka hequr dorë nga lufta kundër imperializmit, por ai është shndërruar vetë në një fuqi imperialiste. Socialimperializmi është produkt i rivendosjes së kapitalizmit në një vend të madh siç është Bashkimi Sovjetik. Pikërisht ky përbën edhe karakteristikën themelore të politikës së jashtme sovjetike. Qëndrimet dhe veprimet e Bashkimit Sovjetik në arenën ndërkombëtare trajtohen e vlerësohen nga mbarë opinioni publik si qëndrime e veprime të njëjës nga dy superfuqitë që lufton për hegjemoni dhe për ndarjen e për sundimin e botës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aleanca sovjeta-amerikane përfaqëson forcën kryesore kundërrevolucionare në marrëdhëniet ndërkombëtare. Marrëveshjet e shumta që Bashkimi Sovjetik ka përfunduar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sidomos ato që kanë të bëjnë me ruajtjen e monopolit të armëve bërthamore, kanë influencuar e kanë përcaktuar edhe një politikë të përbashkët kundërrevolucionare ndaj vendeve të tjera. Fakt është se ata janë

bërë aleatë aktivë dhe i trajtojnë e bëjnë pazarllëqe bashkërisht e në interes të tyre për të gjitha problemet ndërkombëtare që lindin në botë.

Sigurisht, në marrëdhëniet sovjetico-amerikane ka edhe kontradikta, të cilat revizionistët sovjetikë, për të mashtruar opinionin publik, kanë shumë qejf t'i reklamojnë. Por këto nuk janë kontradikta midis socializmit e imperializmit, por kontradikta midis dy fuqive imperialiste, që bashkëpunojnë e grinden me njëra-tjetrën. Për cilindo do të ishte një iluzion me pasoja shumë të dëmshme sikur të shpresonte në ndihmën e njëres ose të tjetres fuqi imperialiste në luftën e tij për liri, pavarësi e përparim shoqëror.

Sundimtarët e Kremlinit llogotitin mjaft për zgjidhjen paqësore të problemeve ndërkombëtare, sikur janë për paqen e sigurimin e popujve. Me këto ata synojnë t'i vënë popujt në gjumë dhe të marrin në dorë monopolin e arbitrazhit ndërkombëtar për problemet që dalin. Por popujt nuk mashtrohen. Burimi i konflikteve të sotme është imperializmi në tërësi si sistem, është politika e tij agresive. Dhe në këtë sistem sot bën pjesë të pandarë edhe imperializmi i ri revizionist sovjetik, i cili tanimë ka marrë të gjitha tiparet e imperializmit klasik. Kur krerët e Bashkimit Sovjetik bëjnë sikur janë për paqen e sigurimin në këtë ose në atë zonë, ata kanë parasysh një paqe në dëm të popujve, një paqe për interesat e imperialistëve. «Sigurimi evropian» apo Traktati Moskë-Bon, që revizionistët sovjetikë i reklamojnë si dy aksione për sigurimin e paqes në kontinentin tonë e në gjithë botën, synojnë në realitet sigurimin e perandorisë së re sovjetike, ruajtjen e ekui-

librit sovjeto-amerikan, nënshtrimin e popujve evropianë dhe drejtimin e agresionit në Azi.

Ndërsa bashkëpunojnë me imperializmin, me borgjezinë dhe me reaksionin, revizionistët sovjetikë gjithë t'han e luftës së tyre e kanë drejtuar kundër gjithë partive dhe forcave marksiste-leniniste në botë.

Fushata e tërbuar antimarksiste, i demaskon edhe më tepër përmbajtjen reaksionare të klikës sunduese sovjetike, demagogjinë dhe veprimet e saj. Si në të kaluarën, ashtu edhe tani ajo është e destinuar të dështojë. Revizionistët i presin disfata të reja e më të mëdha. Rruga e tradhtisë, e kundërrevolucionit dhe e agresionit është rruga që çon drejt greminës së pashmangshme. Nga ky fund i palavdishëm nuk mund t'i shpëtojë revizionistët asnjë manovër e demagogji.

Kongresi i 24-t, ashtu si edhe kongreset e mëparshme hrushoviane, është një kongres i përgatitur nga revizionistët për qëllimet e tyre revizioniste. Nga ai nuk mund të pritet asgjë e mirë. Qëllimi i tij është të sanksionojë vijën oportuniste e socialimperialiste të Brezhnjev-it e të Kosiginit dhe njëkohësisht të kamuflojë e të lustrojë dështimet që revizionistët sovjetikë kanë pësuar në politikën e brendshme e të jashtme. Ai do të mundohet të ligjërojë proceset e transformimit kapitalist të shoqërisë sovjetike, të inkurajojë politikën shoviniste ndaj vendeve të tjera, të nxitë luftën kundër marksizëm-leninizmit, të aprovojë dhe të përkrahë bashkëpunimin me imperializmin amerikan për ndarjen e botës midis dy fuqive të mëdha.

Marksistë-leninistët dhe gjithë revolucionarët e botës e hedhin poshtë këtë kongres, që përfaqëson një ak-

sion të qartë kundërrevolucionar. Atë duhet ta hedhë poshtë edhe populli sovjetik, i cili nuk duhet ta lërë veten të mashtrohet më gjatë nga sundimtarët e tij revizionistë. Ai duhet ta kuptojë se burimi i të gjitha të këqijave që ai heq, dështimet e mëdha të Bashkimit Sovjetik, rënia e autoritetit dhe e prestigjit të tij në botë e kanë burimin në vijën revizioniste, në vijën që përpunohet e stërhollohet në kongreset hrushoviane. Nuk është më koha për pritje dhe meditime. Sa më thellë zhvillohet procesi i transformimeve kapitaliste, aq më imperative bëhet detyra e klasës punëtore, e popullit sovjetik dhe e luftës së tyre për përmbysjen e revizionizmit. Revizionistëve u duhet dalë ballë për ballë. Popujt sovjetikë janë popuj me tradita të mëdha revolucionare, që i kanë treguar gjithë botës se edhe në momente shumë të rënda të historisë së tyre kanë ditur se ç'duhet të bëjnë. Ne jemi të bindur se me siguri do të vijë shpejt ajo ditë kur mbi Bashkimin Sovjetik do të valojë përsëri flamuri i Leninit e i Stalinit, flamuri i lavdishëm i Revolucionit të Tetorit.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 71 (7048), 25 mars 1971*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 3*

## KËSHILLAT POPULLORË TË NDIHMOHEN PËR T'I ZBATUAR DREJT KOMPETENCAT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

30 mars 1971

Nuk dëshiroj të flas këtu për parimet mbi bazën e të cilave janë caktuar kompetencat e këshillave popullorë, mbasi për to është folur mjaft herë dhe më duket se ato janë të qarta. Dua vetëm të theksoj me këtë rast se përgjegjësi për moszbatimin e plotë të kompetencave nga ana e këshillave popullorë të fshatrave dhe të fshatrave të bashkuara kanë komitetet ekzekutive, po bashkë me to edhe komitetet e Partisë të rretheve. Për mendimin tim, komitetet e Partisë mbajnë përgjegjësi më shumë, mbasi ato, krahas së drejtës që kanë për të kërkuar llogari dhe për të kontrolluar zbatimin e direktivave të Partisë, kanë edhe detyrën e madhe për t'i dhënë ndihmë bazës.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua lidhur me raportin «Mbi punën e bërë për njohjen dhe zbatimin e kompetencave nga këshillat popullorë të fshatrave dhe të fshatrave të bashkuara në rrethin e Lezhës dhe të Beratit».

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të këshillave popullorë si organe të diktaturës së proletariatit dhe bazë politike e Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe detyrat e mëdha që u takojnë të kryejnë, ndryshe nga sa mendojnë disa shokë, kompetencat që u janë dhënë atyre janë të kuptueshme dhe plotësisht të zbatueshme nga njerëzit e bazës, mbasi, sipas mendimit tim, këta, pa folur për patriotizmin dhe ndershmërinë e tyre, janë të ngritur nga ana politike dhe kulturore.

Prandaj, në qoftë se shohim që kompetencat nuk po zbatohen, do të thotë se këshillat popullorë i pengon diçka. Dhe unë mendoj se ata i pengojnë më shumë shokët drejtues të rrethit, qofshin këta të komiteteve të Partisë, apo të komiteteve ekzekutive me instruktorët përkatës, të cilët, siç duket, e nënvleftësojnë rolin e këshillave popullorë të fshatrave apo të fshatrave të bashkuara dhe aftësitë e njerëzve që janë zgjedhur në ta.

Nuk është ndonjë filozofi e madhe të zbatohen kompetencat nga këshilli popullor i fshatit ose i fshatit të bashkuar, për sa u përket furrave, çerdheve, shkollave etj., etj. Këto organe të pushtetit popullor, brenda kompetencave që kanë, e dinë shumë mirë se, pa u marrë vendim nga ana e tyre, kurrkush nuk mund të veprojë. Mirëpo, që të zbatohen mirë kompetencat, këshilli popullor duhet të ketë edhe një buxhet të vetin, pjesa më e madhe e të cilit sigurohet nga fondet e dhëna prej kooperativës bujqësore dhe pjesa tjetër nga shteti. Mjetet monetare këshilli popullor i administron sipas planit që ka, për shembull, për punët komunale, për shëndetësinë, për arsim-kulturën, për

tregtinë etj. Kështu kryetari i këshillit dhe vetë këshilli popullor i fshatit e dinë fare mirë përse duhen shpenzuar këto fonde, mbasi shumat e të hollave në dispozicion të tyre nuk janë miliona, por vetëm disa mijëra lekë, me të cilët duhet riparuar, fjala vjen, shkolla, duhet ndërtuar ndonjë çezmë, ndonjë kënd sportiv etj. Por kjo kërkon që ata ta njohin mënyrën e dokumentimit financiar të shpenzimeve që bëjnë, sipas parashikimeve në buxhet, pra, për qëllime të caktuara, sipas nevojave të fshatit. Ato nuk mund të përdoren pa kriter, sipas dëshirës së kryetarit të këshillit popullor, apo të sekretarit të organizatës-bazë të Partisë. Në qoftë se ndonjëri nga anëtarët e këshillit popullor, të cilit i është dhënë ky besim, shpërdoron pasurinë e popullit, pra kryen një faj, atëherë ai duhet të nxirret në gjyq, kurse për gabime që nuk formojnë vepra të dënueshme nga ligji, sipas rastit, ai mund të nxirret para popullit dhe të kritikohet, t'i hiqet vërejtje ose, sipas shkallës së gabimit, zgjedhësit kanë të drejtë dhe ta shkarkojnë nga detyra.

Ka raste që në dhënien e kompetencave për këshillat popullorë të fshatrave vihen re ngurrime, gjë që nuk shpjegohet ndryshe veçse me mosbesimin që ekziston akoma ndaj tyre. Lind pyetja: «Përse kryetarin të kooperativës bujqësore të bashkuar i besohet të drejtojë punën në disa fshatra me sipërfaqe të mëdha toke, me qindra e mijëra kokë bagëti dhe me pasuri të tjera materiale dhe monetare, siç ndodh në Berat e gjetkë, ndërsa kryetarin të këshillit popullor, që është, gjithashtu, njeriu i Partisë, nuk i besohet të drejtojë disa sektorë të interesit të përgjithshëm, siç janë çer-



dhet, kopshtet etj.? Pastaj, ne duhet të kemi parasysh cilët janë këshilltarët? Ata janë nga njerëzit tanë më të mirë, të zgjedhur me vullnet të popullit, janë të rinj e të reja, gra e burra që dallohen në luftën për ndërtimin e socializmit. Ka midis tyre edhe të moshuar me eksperiencë që mbase nuk dinë të thonë shumë llafe, por janë të pjekur dhe kanë dhënë prova të shumta në shërbim të popullit e të Partisë.

Këshillit popullor të fshatit kompetencat i janë dhënë nga ligjet, vendimet, urdhëresat dhe nga këshilli popullor i rrethit, përveç të tjerave, edhe me qëllim që të lehtësohet puna e asamblesë dhe e kryesisë së kooperativës. Në këtë mënyrë këto të fundit do të kenë mundësi të përmbushin më mirë detyrën e madhe, siç është ajo e realizimit të prodhimit bujqësor e blegtoral dhe të mos shpërndahen në shumë aktivitete të tjera, siç janë problemet komunale, të tregtisë, të arsim-kulturës, të shëndetësisë etj., etj.

Kudo në vendin tonë, me shumë të drejtë, flitet vazhdimisht kundër burokratizmit që, veç të tjerave, të çon edhe në shkëputjen e lidhjeve me masat dhe në këtë drejtim vihen re mjaft përmirësime. Megjithatë, në shumë raste, shihet se jo të gjithë shokët rrinë gju më gju me popullin, se problemet që lindin për t'u zgjidhur nuk shtrohen e nuk diskutohen kurdoherë në rrugën e bindjes dhe me durim një herë, dy, tri, katër dhe, po të jetë nevoja, edhe më shumë herë. Për kapërcimin e pengesave që na dalin në punë e sipër, ne duhet të inkurajojmë medoemos iniciativën dhe shpirtin krijues të masave, të tërheqim mendimin e tyre. Kur flasim haptazi me popullin, kur qajmë hallet bash-

kërisht e me ngrohtësi me të për çdo problem që na preokupon, atëherë do të shohim se si do të valojë muhabeti shtruar dhe ky do të jetë një diskutim i vërtetë popullor.

Mirëpo nuk veprohet kurdoherë kështu. Ka raste që, duke mos i zbatuar mirë direktivat e Partisë, harrohet puna bindëse me njerëzit dhe kalohet në veprime arbitrare ndaj tyre. Kështu, për shembull, ka ndodhur që një pjesë nga të ardhurat që i takojnë kooperativistit atij i janë ndaluar padrejtësisht se ka vendosur kryesia që familjet të blejnë krevate, pjaña, pajisje shtëpiake etj. Kush ua dha disa shokëve këtë të drejtë, që të futen deri në llogaritë personale e familjare të fshatarit?! Partia asnjëherë nuk ka këshilluar t'u ndalohen nga zyra e llogarisë të ardhurat kooperativistëve për të blerë orendi shtëpiake, sipas dëshirës së njerit apo tjetrit, por ka rekomanduar të punohet me ta që t'u mbushet mendja se këto orendi janë të nevojshme, pra të binden për t'i blerë vetë dhe kjo punë të mos bëhet me urdhra.

Është e domosdoshme që organet e bazës të kenë kompetenca, por ato kanë nevojë të ndihmohen e të kontrollohen për t'i zbatuar ato drejt dhe plotësisht në jetë. Tani në kooperativa është bërë një punë e mirë për ta mobilizuar popullin në ndërtimin e çerdheve, kopshteve e veprave të tjera me karakter socialkulturor. Mirëpo mos kujtoni se puna ka mbaruar me kaq. Duhet punuar që këto institucione që u ngritën të frekuentohen e të shfrytëzohen plotësisht në të mirën e masave. Një kujdes i veçantë u duhet kushtuar sidomos rregullit, disiplinës në punë dhe pastërtisë në çer-

dhe, në kopshte, në shkolla dhe në ambientet e përbashkëta, si: mensa, furra, dyqane, banja, lavanderi etj.

Është turp për njerëzit tanë të ketë sot pisllëk në fshat dhe është e pakuptueshme papastërtia që vihet re sidomos në disa fshatra. Disa mundohen ta justifikojnë këtë me mungesën e ujit. Kjo është e papranueshme. Të gjithë e dinë se në të kaluarën në Gjirokastër nuk kishte fare ujë. Njerëzit atje i përballonin nevojat me vështirësi të mëdha dhe me rrezik për shëndetin, pse ujin e siguronin dimrit duke e grumbulluar atë nga shiu nëpër sterna. Kështu, verës uji ishte me krëk, ai zinte shpesh krimba të kuq dhe qytetarët, para se ta pinin, e kullonin në napa. Megjithatë pastërtia nuk mungonte në asnjë shtëpi.

Të gjithë e mbajnë mend, gjithashtu, varfërinë e tmerrshme të masave në të kaluarën. Njerëzit flinin pa krevat, në dysheme, hanin në një sahan të vetëm gjithë pjesëtarët e familjes, të shëndoshë e të sëmurë bashkë, se ashtu ishin kushtet për shumicën e popullit në ato kohë të vështira. Megjithatë, në disa krahina, çdo mëngjes, para se të niseshin fëmijët për në shkollë, nënat u lanin duart e fytyrën pa marrë parasysh se u çaheshin lekura nga të ftohtit dhe u dhimbte. Kishte, gjithashtu, mësues të kujdesshëm që, sa futeshin nxënësit në klasë, puna e parë që bënin ishte të kontrollonin pastërtinë. Mbaj mend një herë se si një shokut tonë i qe këputur një pullë e xhaketës dhe mësuesi nuk e pranoi në mësim, po e dërgoi në shtëpi për ta qepur dhe pastaj e lejoi në klasë. Në sajë të punës së madhe të Partisë gjendja ka ndryshuar edhe në fshat

si nata me ditën. Megjithatë nuk mund të themi se çdo gjë shkon ashtu siç dëshiron Partia. Vihet pyetja: «Përse nuk ua vret syrin dhe ndërgjegjen papastërtia disa familjeve, prindërve, mësuesve apo individëve të veçantë? Po organizatave të rinisë?». Nuk kanë asnjë vlerë njohuritë që u jepen nxënësve në shkollë mbi matematikën, gjeografinë etj., kur mësuesit nuk i edukojnë ata, në radhë të parë, me ndjenjën e pastërtisë, të ruajtjes së shëndetit, të jetës së kulturuar, që të rriten me mendje dhe trup të shëndoshë, pse vetëm kështu atdheu do të lulëzojë dhe do të ecë përpara.

Javën e kaluar bëra një vizitë në Petrelë dhe pyeta sekretarin e organizatës-bazë të Partisë se kush rrinte në ndërtesën që ishte aty pranë. «Është çerdhja», — më tha ai, — dhe shkuam bashkë për ta parë. Po çfarë të shikoje, shokë? Një papastërti në të gjithë ambientin. Së pari, këtë e tregonte vetë paraqitja e jashtme e ndërës prej grave që punonte aty. Pashë pastaj fëmijët duke ngrënë si mos më keq. Në çerdhe kishte gjithsej 12 fëmijë. E pyeta gruan, përse ishin të vegjlit në atë gjendje? «Jam vetëm, — m'u përgjigj, — se shoqja tjetër gatuan», megjithëse për të ngrohur qumështin u duheshin vetëm disa minuta. Dy kujdestaret, të cilave nuk u duhej më tepër se një çerek ore për ngrohjen e qumështit dhe gjysmë ore për të përgatitur makaronat, nuk gjenin kohë t'u lanin duar e faqe kalamanëve, të pastronin odën ku rrinin ata etj. Ja pra, pse lejohej kjo gjendje në lidhje me pastërtinë?

Pastaj u takova me drejtorin e shkollës dhe e pyeta: «Po ty, shoku drejtor, çfarë të pengon të kujde-

sesh pak për çerdhen, të shikosh atje pastërtinë sidomos në rrobat, në fytyrat e në duart e fëmijëve?». «Keni të drejtë, shoku Enver», m'u përgjigj, por ama vura re se drejtori nuk e kontrollonte as në shkollë pastërtinë.

Sot kohët vërtet kanë ndryshuar shumë, pushteti popullor ka ndërtuar e ndërton nga të katër anët shkollla, kopshte, çerdhe etj., po, për t'u frekuentuar dhe për t'i mbajtur pastër ato, del se duhet bërë akoma shumë punë edukative, bindëse e sqaruese nga ana e Partisë, e këshillit popullor të fshatit, e rinisë, e gruas, e Frontit, e mësuesve e të gjithëve. Kjo punë nuk mund të bëhet dosido, por në mënyrë të organizuar mirë. Me këtë dua të them se vetë ju, shokë, si kryetarë të komiteteve ekzekutive punoni, por, për të pasur sukses në punë duhet të kërkon mobilizimin e të gjithëve. Për këtë është e domosdoshme që, së pari, secili të bëhet i ndërgjegjshëm për kryerjen e detyrave që i janë ngarkuar; pastaj t'i jepet edhe ndihma e të ushtrohet kontroll i rreptë për zbatimin e tyre.

Për sa u përket mungesave në njohjen dhe në zbatimin sa duhet të kompetencave, ato, sipas mendimit tim, nuk kanë aq shumë lidhje me kapacitetin e këshilltarëve, apo me ngritjen politike dhe organizative të tyre. Jam i bindur se ata kanë aftësi, por hasin në burokratizmin e bajraktarizmin e disa njerëzve që pretendojnë se i dinë dhe i zbatojnë ligjet, kurse në fakt i shkelin vetë ato.

Kur analizojmë gabimet që janë vërtetuar në rrethet e Beratit dhe të Lezhës lidhur me zbatimin e kompetencave dhe rritjen e autoritetit të këshillave popu-

llorë, të vjen me të vërtetë keq. Ne nuk mund të themi që në këto dy rrethe nuk ka edhe anë të mira, por problemi shtrohet kështu: «Përse të ekzistojnë këto gabime gjersa ka mundësi të mos ndodhin?». Prandaj, shokë, në punën tonë të kemi parasysh që të mos ecim me disa slogane, por të bëjmë të gjitha përpjekjet që në praktikë të përmirësojmë metodën dhe stilin e punës. Të mos i mbulojmë të metat tona, duke deklaruar se kemi stil e metodë të mirë pune, por të kapen si duhet të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me jetën në fshat, siç janë zbatimi i kompetencave të organeve të pushtetit, lufta kundër arrogancës së ndonjë kryetari kooperative bujqësore etj., etj. Duke punuar në këtë mënyrë kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit do të gjejë një mijë mjete që, si përfaqësues i pushtetit në rreth, të shohë vetë dhe konkretisht punën që bëhet në të gjitha fshatrat, jo për një ditë, as për një javë, as për një muaj, por gjatë gjithë vitit. Në këtë mënyrë duhet punuar për zhdukjen e të metave të asaj natyre që u përmendën këtu.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Për pushtetin popullor»,  
f. 475*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për pushtetin  
popullor», f. 475*

## ATDHEU NUK MBROHET VETËM ME ARMË, POR EDHE DÛKE RRITUR PRODHIMET

*Fjala në plenumin e Komitetit të Partisë  
të Rrethit të Lushnjës<sup>1</sup>*

6 prill 1971

Të dashur shokë e shoqe,

Në emër të shokëve të Byrosë Politike dhe timin ju përshëndes për sukseset që keni arritur në lëmin e bujqësisë dhe në gjithë sektorët e tjerë dhe ju uroj rezultate të mëtejshme më të mëdha në të ardhmen. Njëkohësisht, dëshiroj me këtë rast, t'ju tërheq vëmendjen edhe për disa boshllëqe në realizimin e planeve tuaja, që u vunë në dukje si në raport dhe në diskutime.

Jemi shumë të gëzuar që morëm pjesë në punimet e këtij plenumi, ku dëgjuam raportin e byrosë së Komitetit të Partisë të mbajtur nga shoku Rrapi Gjermani<sup>2</sup>. Edhe diskutimet rreth raportit na u dukën të

---

1. Në këtë plenum u diskutua rreth raportit «Mbi masat për zbatimin e detyrave të vitit 1971 në bujqësi, të para në frymën e Letrës së Komitetit Qendror».

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

mira, të dobishme dhe instruktive, pse ato pasqyronin drejt realitetin që ekziston te ju.

Ato që na tërhoqën më shumë vëmendjen ishin, së pari, mungesa e mburrjeve tek anëtarët e plenumit. Përkundrazi, te cilido vumë re shqetësimin për përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe kjo është një nga karakteristikat më të mira të komunistëve tanë. Së dyti, qoftë në raport, ashtu edhe në diskutimet, u prekën një sërë problemesh që ziejnë në Parti, në masat e gjera të kooperativistëve dhe të popullit. Edhe kjo është një gjë shumë e mirë. Së treti, është çështja që ju, tok me masat, me Partinë në krye, duke u bazuar në direktivat e Komitetit Qendror dhe në eksperiencën tuaj, po bëni përpjekje për t'u gjetur zgjidhje këtyre problemeve, po mendoni për rrugën më të mirë që duhet ndjekur për këtë qëllim, çfarë formash pune duhen adoptuar në prodhim, në shkencë e në teknikë. Këto janë çështje me rëndësi të madhe.

Kur Partia i shtron, i diskuton dhe i rreh problemet me masat për t'u gjetur zgjidhje të drejtë, atëherë edhe rezultatet janë të mira. Kam bindjen se organizata e Partisë e rrethit të Lushnjës, e shëndoshë ideologjiksht, e fortë organizativisht dhe në gjendje për t'u bërë një vlerësim të lartë politik problemeve, do ta çojë punën vazhdimisht përpara. Ju i prekët problemet në nivelin e duhur, ndaj jam i gëzuar që «ma hëngrët bukën», prandaj ju kërkoj ndjesë për përsëritjet që mund të bëj gjatë fjalës sime.

Para së gjithash, dëshiroj të shpreh kënaqësinë e madhe për punën që ka bërë Partia, si kudo edhe në rrethin tuaj, për përgatitjen e kuadrove me eksperiencë



dhe me zotësi të mëdha në punë. Është kënaqësi kur sheh që anëtarët e Partisë, me kalimin e kohës, fitojnë eksperiencë dhe bëhen të aftë për të marrë vetë në dorë zgjidhjen e çdo çështjeje. Partia na mëson se komunisti, derisa të ketë frymën, duhet të punojë, por njëkohësisht të kujdeset edhe për përgatitjen e kuadrove të rinj, për t'i ndihmuar e për t'i shtyrë këta përpara që të kaliten, të edukohen, të mësojnë dhe të bëhen sa më shpejt në gjendje për të marrë në duart e tyre punët që vijnë vazhdimisht duke u shtuar. Kështu, Partia, duke u përtërirë gjithnjë me gjak të ri, do të ecë përpara, kurdoherë e re, e fortë dhe e pastër.

Të tëra problemet që shtron për zgjidhje Partia, të çfarëdo natyre qofshin ato, kanë qëllimet dhe caqet që duhen arritur, kanë politikën e tyre, e cila nuk duhet reduktuar në një formulë të thjeshtë, siç ndodh në mjaft raste, duke e kthyer atë në disa slogane të mërzitshme. Ka shokë që thonë: «E dimë, kemi dëgjuar shumë herë që imperialistët janë agresivë dhe luftënxitës, që revizionistët sovjetikë janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, që të dyja palët janë aleate në mes tyre, prandaj s'është nevoja të na përsëritet». Në realitet, thelbin e çështjes ata e dinë, por kjo nuk është e mjaftueshme, pse gjithë jeta e vendit është e lidhur ngushtë me çështjet politike, prandaj këtë aspekt të veprimtarisë sonë në asnjë rast nuk duhet ta injorojmë. Mirëpo, të tërhequr nga problemet e kohës, ndodh nganjëherë që lihen pa prekur fare këto çështje që kanë një rëndësi të përhershme. Mos kujtoni se me këtë që do të them, kam për qëllim t'ju kritikoj ju që gjatë

diskutimeve nuk folët fare për çështjet politike, pse jam i bindur që organizata-bazë e Partisë e rrethit tuaj e ka parasysh se çdo problem duhet lidhur kurdoherë me politikën, se politika në çdo rast duhet të dalë në plan të parë. Gjendjen ndërkombëtare secili e ka për detyrë ta ketë kurdoherë parasysh.

Pa ju mbajtur shumë unë do të përpiqem t'ju flas shkurtimisht. Republika Popullore e Shqipërisë zë një vend në këtë planet, ka peshën e vet në botë. Ajo qëndron e patundur dhe e tillë do të qëndrojë edhe në të ardhmen, pavarësisht nga përpjekjet që bëjnë e mund të bëjnë armiqtë, si deri tash, edhe në të ardhmen, për ta përkulur atë. Republika Popullore e Shqipërisë ka, gjithashtu, një peshë politike dhe ideologjike të rëndësishme, ka një politikë të saj të brendshme dhe të jashtme. Pa folur për politikën e brendshme, politikën e jashtme të Shqipërisë, dashkan apo nuk dashkan armiqtë, nuk mund të mos e llogaritin, pavarësisht se e përbuzin, ose hiqen sikur bëjnë veshin të shurdhër ndaj qëndrimeve që ajo mban. Kur ndodh diçka në botë, veshët të tërë i mbajnë hapur dhe ndjekin me vëmendje të madhe çfarë do të thotë vendi ynë për këtë ose për atë problem ndërkombëtar. Kjo ndodh jo se Shqipëria ka ndonjë potencial të madh ekonomik apo ushtarak, por për arsye të vijës së saj të drejtë ideologjike, të peshës së saj politike vazhdimisht në rritje.

Fjala e fuqishme e Partisë së Punës të Shqipërisë përhapet çdo ditë në eter me anë të radios; ajo përhapet kudo me anë të shtypit, të librave, nëpërmjet delegacioneve, politikës e diplomacisë sonë dhe prekmassat e popujve të botës. Kësaj fjale armiqtë e revo-

lucionit dhe të socializmit nuk kanë ç't'i bëjnë dhe pikërisht këtu është pika e dobët e tyre, sepse gënjeshttrat që përhapin për të vënë në gjumë popujt, që në botë të mos ketë revolta, kryengritje, greva etj., u demaskohen. Prandaj ata e urrejnë dhe e luftojnë me të gjitha mjetet Partinë tonë, pse dëshira dhe qëllimi i tyre është që askush të mos u hapë sytë popujve, klasës punëtore, fshatarësisë së shtypur etj., të mos u tregojë rrugën që duhet të ndjekin për t'u hedhur në revolucion dhe për të këputur zinxhirët e skllavërisë imperialisto-revizioniste, pse vetëm kështu mund ta zgjatin sundimin e tyre mbi popujt. Pra, pavarësisht se armiqtë bëjnë sikur nuk dëgjojnë dhe nuk e peshojnë fare vendin tonë, e vërteta është se fjala e Partisë së Punës të Shqipërisë, qëndrimet dhe lufta e saj ata i preokupojnë shumë.

Situata ndërkombëtare zhvillohet vazhdimisht në favor të revolucionit dhe në dëm të imperialistëve, të revizionistëve, të socialdemokratëve etj. Megjithatë ne e kemi të qartë se këta, pavarësisht se politikisht e ideologjikisht dobësohen dita-ditës, pavarësisht se kudo ku kanë hapur vatra lufte, pësojnë disfata ushtarake, akoma s'janë thyer. Sidoqoftë në botë tendenca e përgjithshme është që pozitat politike e ideologjike të imperialistëve, të revizionistëve etj., vijnë çdo ditë duke u dobësuar. Edhe brenda vendeve të tyre pozitat e imperialistëve dhe të revizionistëve bëhen gjithnjë e më të lëkundshme, por akoma jo të humbura. Kjo do të thotë se popujve do t'u duhet të bëjnë edhe në të ardhmen një luftë të rreptë dhe të organizuar shumë mirë, gjersa të thyhet dhe pastaj të dërrmohet për-

fundimisht kjo fuqi e tmerrshme që vazhdon t'i shtypë e t'i shfrytëzojë ata. Kuptohet se një fuqi e këtillë nuk mund të shembet përnjëherë e se do të duhet të kalojnë disa kohë. Se si do të bëhet kjo punë, ngjarjet do ta tregojnë, se ku do ta pësojnë më përpara disfatën armiqtë e popujve, imperialistët, në Evropë, në Azi, në Afrikë apo gjetiu, këtë do ta shohim, po do të ndodhë me siguri, siç na mëson Lenini, atje ku hallka e kapitalizmit botëror është më e dobët. Disfata do të sjellë disfatën, pas çdo goditjeje armiqtë do të përpiqen të rimarrin veten, popujt do t'i godasin përsëri, e kështu do të luftohet pa pushim gjer në shkatërrimin e tyre të plotë.

Partia na mëson se revizionizmi modern dhe socialdemokracia janë pjella dhe aleatë të kapitalizmit. Megjithatë, midis shteteve të ndryshme kapitaliste e revizioniste ekzistojnë divergjenca, siç janë edhe ato midis imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik, këtyre armiqve të egër të njerëzimit. Është e vërtetë se revizionizmi modern sovjetik hrushovian u ka sjellë një dëm të madh socializmit dhe lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare, për arsye se në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e ish-demokracisë popullore të Evropës Lindore revizionistët modernë morën fuqinë në dorë. Jo vetëm kaq, por edhe në shumë nga shtetet kapitaliste u likuiduan partitë komuniste, të cilat tashmë janë transformuar në parti revizioniste. Por, me gjithë goditjen e rëndë që mori nga armiqtë, lëvizja komuniste ndërkombëtare nuk u likuidua, ajo qëndroi e papërkulur dhe tani klasa punëtore, revolucionari, marksizëm-leninizmi po i ngjitin shkallët një

nga një, po forcohen dita-ditës në luftën që bëjnë kundër armiqve dhe me siguri do të fitojnë. Kjo do të ndodhë kështu jo pse e themi dhe e dëshirojmë ne, po se është një domosdoshmëri historike, siç e kanë përcaktuar shkencërisht Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Prandaj, sado pengesa t'u vihen revolucionit dhe luftës çlirimtare të popujve, në asnjë mënyrë nuk mund të ndalohej ecja e tyre përpara, popujt do t'i mposhtin armiqtë. Kjo është vetëm çështje kohe.

Ardhja në fuqi e revizionistëve në disa nga vendet socialiste nuk mund t'i sillte asnjë konsolidim pushtetit që ata uzurpuan. Partia jonë ishte e para që e pa drejt këtë çështje. Ajo, në bazë të analizës marksiste-leniniste të ngjarjeve, e mori me mend me kohë çfarë do të ngjiste në Bashkimin Sovjetik, në të gjitha vendet ku sundojnë revizionistët, si dhe në partitë revizioniste të vendeve kapitaliste.

Në vendet ku është tradhtuar ideologjia marksiste-leniniste revizionistët përpiqen të mbajnë maska; ata bëjnë deklarata boshe për leninizmin, por leninizmi i tyre është vetëm një bluf. Në fakt, në këto vende është krijuar një shtresë e re borgjezie që ka hedhur kudo farën e përçarjes dhe e ka likuiduar partinë e klasës punëtore. Prandaj, ai unitet i vërtetë leninist që ekzistonte përpara midis Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të Evropës Lindore, tash nuk mund të ekzistojë. Atje nuk ka unitet as midis kombësive që përbëjnë secilin prej këtyre shteteve, mbasi unitet jashtë rrugës marksiste-leniniste nuk mund të ketë në asnjë rast.

Ju keni dëgjuar se ç'po ndodh në Jugosllavi, ku ka kohë që është vendosur kapitalizmi. Përveç të kë-

qijave të tjera që sjell me vete rendi borgjez, atje janë duke lulëzuar shovinizmi dhe përçarja midis kombeve. E njëjta gjendje është krijuar tani në Bashkimin Sovjetik, ku është vendosur, gjithashtu, kapitalizmi. Largimi nga pozitrat e marksizëm-leninizmit dhe shovinizmi rusomadh kanë sjellë atje zhvillimin e madh të ndjenjave kombëtare antiruse, grindje midis njërës komb e tjetrit, grindje brenda në udhëheqjen revizioniste sovjetike, e cila mbahet në fuqi për arsye të shumta e, në radhë të parë, me forcë.

Revizionizmi hrushovian ka vendosur në Bashkimin Sovjetik diktaturën fashiste. Po kështu ka ndodhur edhe në shtetet e tjera revizioniste. Prandaj, kontradiktat që lindin e zhvillohen në të gjitha këto vende, sa më tepër që kalon koha, u shkaktojnë krerëve revizionistë shqetësime të rënda, të cilat ata përpiçen t'i kapërcejnë me metoda antipopullore. Deri kur do të vazhdojë një situatë e tillë? Sigurisht, që ajo nuk mund të durojë për një kohë të gjatë. Profetë nuk mund të bëhemi, por, si në çdo vend kapitalist, edhe në këto vende gjendja s'ka si zhvillohet pa tronditje. Jeta ka vërtetuar se në vende të tilla kontradiktat shtohen e thellohen çdo ditë e më shumë, derisa vjen një kohë dhe do të pëlçasin patjetër. Kështu do të ngjasë edhe në Bashkimin Sovjetik.

Kontradiktat ekzistojnë edhe në marrëdhëniet midis Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera ku sundojnë revizionistët. Katastrofa që ndodhi në Çekosllovakia<sup>1</sup>,

---

1. Është fjala për pushtimin e Çekosllovakisë nga revizionistët sovjetikë më 21 gusht 1968.

mund të ngjasë një ditë në secilën nga pseudodemokracitë popullore. Prandaj, kudo në këto vende janë marrë masa nga më të rreptat kundër popujve.

Të gjithë jemi në dijeni si u rrëzua Gomulka në Poloni<sup>1</sup>. Këtë tradhtar revizionist nuk e përmbysën rrugaçët, Vatikani, Vishinski apo propaganda e radios «Evropa e lirë», po klasa punëtore e Baltikut, e cila u ngrit jo vetëm kundër Gomulkës, por kundër gjithë udhëheqjes dhe partisë revizioniste polake. Punëtorët polakë të Baltikut sulmuan komitete partie, dogjën ndërtesa të partisë, siç ndodhi në portin e Shçëçinit, shkatërruan dhe likuiduan sindikatat revizioniste, krijuan këshillat e tyre revolucionarë, duke paralizuar pushtetin dhe organet e policisë revizioniste. Moska dhe Varshava u drodhën nga këto ngjarje, prandaj dërguan tanket për t'i goditur punëtorët, po këta s'u trembën, sulmuan me guxim përpara.

Përse i rrethuan me tanke qytetet e Baltikut krerët revizionistë? Sepse gjithë revizionistët, polakë, sovjetikë, gjermanë, bullgarë, çekë e të tjerë u frikësuan shumë kur panë të ngrihej në këmbë klasa punëtore polake. Nga të dhënat që disponon Partia jonë, kur u zhvilluan këto ngjarje, rrugët e Varshavës dhe të qyteteve bregdetare ishin mbushur me policë e ushtarë, që zunë universitetet, fabrikat, ambasadat dhe bllokuan gjithë bregdetin me ushtri, për arsye se revizionistët kishin frikë nga lëvizja revolucionare, se

---

1. V. Gomulka u shkarkua nga posti i Sekretarit të Parë të KQ të Partisë revizioniste Polake dhe nga Byroja Politike më 20 dhjetor 1970.

mos kjo përhapej thellë, në brendësi të vendit dhe atëherë, për të mbajtur rendin në fuqi, do të dilte nevoja për përdorimin e forcave sovjetike. Mirëpo, një ndërhyrje ushtarake nga ana e Bashkimit Sovjetik në Poloni do të ishte krejt ndryshe nga Çekosllovakia. Aty me siguri mund të kërciste pushka, gjë që do të ishte një katastrofë e rëndë për prestigjin e revizionistëve sovjetikë.

Kontradikta të forta e të gjithanshme ekzistojnë në marrëdhëniet e armiqve tanë, si midis vetë vendeve revizioniste, ashtu edhe midis Bashkimit Sovjetik dhe fuqive të ndryshme imperialiste. Sipas koniunkturave që krijohen, këto kontradikta herë acarohen, herëherë duket sikur shuhen, po fakt është se ato ekzistojnë bile vijnë vazhdimisht duke u thelluar dhe s'ka si ndodh ndryshe.

Dihet sa shumë daulle ranë kur u nënshkrua më parë traktati midis Moskës dhe Bonit dhe pastaj ai midis Bonit e Varshavës<sup>1</sup>, po tani ato kanë pushuar. Juve ju kujtohet, gjithashtu, ç'zhurmë të madhe bënë imperialistët kur trupat sovjetike ndërhyjnë në Çekosllovakia. Të gjithë e ngritën dhe vazhdojnë ta ngrenë zërin akoma kundër Bashkimit Sovjetik për këtë çështje. Po sa i ndryshëm ishte qëndrimi i tyre në ngjarjet e Polonisë?! Reaksioni ndërkombëtar me këtë rast nuk u ndie fare. Si shpjegohen këto qëndrime? Është e

---

1. Traktati midis BS dhe RFGJ u nënshkrua në Moskë më 12 gusht 1970, ndërsa «Traktati për normalizimin e marrëdhënieve midis RP të Polonisë dhe RF të Gjermanisë» u nënshkrua në Varshavë më 7 dhjetor 1970.



qartë se në Çekosllovakia u rrëzua Dubçeku, miku i imperialistëve, prandaj propaganda e tyre u aktivizua aq shumë, ndërsa kur klasa punëtore në Poloni u ngrit në këmbë, imperialistët, qofshin këta amerikanë, anglezë, francezë apo gjermanë, preferuan më mirë të fitonin klika e Gierekut me revizionistët e Bashkimit Sovjetik, sesa punëtorët, gjë që do të ishte një gjëmë e madhe për të dyja palët, prandaj ranë në heshtje.

Po punëtorët në Poloni a i kanë hedhur armët vallë? Pavarësisht se revizionistët sovjetikë, për të forcuar pozitat e klikës së Gierekut, i dhanë kësaj kredi që të mund të anulonte vendimet që kishte marrë Gomulka për ngritjen e çmimeve dhe për uljen e rrogave, punëtorët polakë nuk i hodhën armët. Me masat që morën, të frikësuar nga lëvizja e klasës punëtore, revizionistët arritën ta zbutin përkohësisht gjendjen, por kjo nuk ka për të shkuar gjatë<sup>1</sup>. Është e qartë për të gjithë se revizionistët sovjetikë nuk do të vazhdojnë të japin kredi për të ushqyer njerëzit e klikës së Gierekut, kur mezi ushqehen për vete. Ata nuk mund të pranojnë për shumë kohë që Polonia, prodhimet e veta të mishit t'ua shesë anglezëve dhe vetë të hajë mish sovjetik, në një kohë që në dyqanet e Moskës, të Leningradit etj. ka vargje të pambaruara njerëzish për këtë produkt. Natyrisht, në këtë situatë revizionistët sovjetikë i ka zënë halli, prandaj i dhanë disa ndihma

---

1. Koha e vërtetoi plotësisht këtë parashikim të shokut Enver Hoxha. Punëtorët polakë e vazhduan luftën e tyre klasore, duke rrëzuar edhe Gierekun, në ngjarjet e vitit 1980, si paraardhësin e tij, Gomulka.

Gierekut, mbasi parashikuan që, po të mos ia jepnin, zjarri do të hynte në shtëpi.

Siç e përmenda, shumë bujë bënë dhe po bëjnë revizionistët sovjetikë për nënshkrimin e Traktatit Bon-Moskë. Propaganda e tyre përpiqet të krijojë opinionin se, me marrëveshjen e arritur midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë Perëndimore, qenkan krijuar gjoja kushtet për nënshkrimin e një pakti të sigurimit evropian, kështu që s'do të ketë më luftë në Evropë. Por këto janë gënjeshtër, popujt nuk do t'i lejojnë ujqit t'u dalin për zot që t'u ruajnë lirinë dhe pavarësinë e tyre.

Lidhur me këtë problem, në Evropë, vetëm Republika Popullore e Shqipërisë ka mbajtur qëndrim të drejtë. Ajo është kundër marrëveshjes për të ashtuquajturin sigurim evropian dhe punon për demaskimin e traktateve Bon-Moskë dhe Bon-Varshavë. Kur ne hodhëm poshtë propozimet për këtë marrëveshje, shumë njerëz në botë u habitën, nuk e kuptonin qëndrimin e Qeverisë sonë. Por s'kaloi shumë kohë dhe ambasadorët e disa vendeve filluan t'u afrohen e t'u thonë ambasadorëve tanë se sa të drejtë kishim ne për qëndrimin e mbajtur që në fillim ndaj sigurimit evropian. Një ambasador finlandez i tha hapur ambasadorit shqiptar se i shtyu Bashkimi Sovjetik për ta bërë këtë propozim dhe tash e marrin me mend se asgjë nuk do të realizohet. Të njëjtën pikëpamje kanë shfaqur ambasadorë belgjianë, francezë dhe shumë të tjerë, të cilët njëkohësisht kanë shprehur edhe admirimin e tyre për parashikimin e drejtë të vendit tonë për këtë çështje etj.

Duke e parë problemin drejt, në prizmin marksist-leninist, për ne është e qartë se për të arritur në ratifikimin e këtij traktati si shpërblim Bashkimi Sovjetik i ka bërë lëshime kancelarit të Gjermanisë Perëndimore, Brand, në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane. Prandaj ambasadorët e revizionistit Ulbriht, kur janë një për një me ambasadorët tanë u shtrëngojnë dorën këtyre për vijën tonë «të fortë». Ata përsëritin se s'ka si vija jonë etj., por, sa shohin që u afrohet ndonjë diplomat sovjetik, largohen. Nga këto qëndrime ne kuptojmë se revizionistët e Moskës, për lëshimet që Bashkimi Sovjetik u bën udhëheqësve të Gjermanisë Perëndimore, jo më për çështjen e Berlinit Perëndimor, por për vetë Gjermaninë, janë në thikë e në pikë me ata të Gjermanisë Lindore. Ky qëndrim i revizionistëve sovjetikë ka hasur, pra, në kundërshtimin e udhëheqjes revizioniste gjermane të grupit të Ulbrihtit.

Për ne është e qartë se Ulbrihti është po aq revizionist sa të tjerët, por njëkohësisht edhe nacionalist. Pikërisht nga këto pozita e kundërshton ai politikën e klikës së Kremlinit, pavarësisht se është i detyruar të brohorasë për Kongresin e 24-t të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe për çdo veprim tjetër që ndërmerr Moska. Kjo duket nga shumë të dhëna që ka Partia jonë.

Kohët e fundit Ulbrihti pati organizuar një ekskursion gjahu, ku kishte thirrur të gjithë ambasadorët e akredituar në Republikën Demokratike Gjermane. Gjatë pushimit, duke iu drejtuar ambasadorit sovjetik, në prani të gjithë të tjerëve, i tha hapur se sovjetikët

janë duke e bërë çorbë unitetin e kampit socialist. Sovjetiku, në shenjë proteste, u largua nga ekskursioni, por s'kaluan shumë ditë dhe Ulbrihtin «e ftuan» në Moskë për të bërë një «vizitë». Gazetarët perëndimorë shprehën gjoja çudinë, bënë sikur s'dinin asgjë për arsyet e kësaj vizite të papritur, po, në fakt, ata e patën mësuar me kohë nga vetë revizionistët cili ishte shkaku. Pas «vizitës» që bëri në Moskë, Ulbrihti u vu në heshtje dhe kështu u mbyll kjo punë.

Ne e kemi dëgjuar edhe vetë Ulbrihtin kur ishim njëherë me të në Moskë<sup>1</sup>, para se të pritëshin marrëdhëniet tona me sovjetikët. Ai iu drejtua sovjetikëve për kredi, bile kërkoi që kjo t'u jepej gjermanëve pak shpejt, duke i kritikuar se «ju ka mbuluar burokracia», siç i tha ai Mikojanit. Ky hapi sytë dhe pyeti Ulbrihtin: «Ku është burokracia, te ju, apo te ne?». «Te ju, te ju», përsëriti Ulbrihti, ky tradhtar revizionist në gradën e fundit, por njëkohësisht me ndjenja të forta nacionaliste, që nuk pranon të shkelen interesat e vendit të tij dhe u sjell herë pas here telashe revizionistëve sovjetikë.

Qëndrimi i tij i bën gjermanoperëndimorët të mos e ratifikojnë Traktatin Moskë-Bon. Në këtë drejtim Vili Brandit i bëjnë presion demokristianët, të cilët kërkojnë të shkatërrohet muri ndarës i Berlinit dhe deklarojnë se, po të mos realizohet hyrja e dalja lirisht nëpër Berlinin Perëndimor, pa lejen e Gjermanisë Lindore, traktati nuk do të ratifikohet nga ana e tyre.

---

1. Shih: Enver Hoxha, «Hrushovianët» — Kujtime, botim i dytë, Tiranë, 1982, f. 165-166.

Për ta kuptuar këtë lojë me Berlinin Perëndimor, shokë, i cili ndodhet në qendër të Gjermanisë Lindore, po jua konkretizoj pak. Kjo është, si të thuash, njëlloj, sikur të lejosh të kalojnë lirisht në çdo kohë nëpër Shqipëri, ditën dhe natën, kur të duan, si të duan e qysh të duan, automobilat dhe të gjitha mjetet e tjera të komunikacionit të Jugosllavisë, që njerëzit e Titos të futen lirisht nëpër vendin tonë, me një fjalë të bëjnë si të duan.

Në një mënyrë ose në një tjetër qeveria sovjetike është gati t'u bëjë lëshime reaksionarëve të Gjermanisë Perëndimore, mirëpo Ulbrihti e ka të qartë se, po u bë një gjë e tillë, atëherë mori fund Republika Demokratike Gjermane; nuk ka për të kaluar shumë kohë dhe ajo, dashur padashur, do të bashkohet me Gjermaninë Perëndimore. Ndonjë vit apo dy mund të lejohet njëfarë demokracie pastaj, nën maskën e vullnetit të popullit e me anë votimesh, bëjnë bashkimin derisa të forcojnë gjendjen reaksionarët gjermanë, të pastrojnë edhe partinë «komuniste» të Doçlandit dhe në fund dinë vetë ç'bëjnë, veprojnë si Hitleri kur erdhi në fuqi më 1933.

Partia jonë e ka thënë me kohë mendimin e saj të drejtë për zgjidhjen e këtij problemi dhe vazhdon të qëndrojë po në atë pozitë, prandaj gjermanët e Lindjes, prapa skenave, u shtrëngojnë dorën njerëzve tanë. «E tillë është edhe vija jonë, — thonë ata, — prandaj qëndroni!». Ne u themi atyre: «Qëndroni ju, pa ne as kemi lëvizur, as do të lëvizim nga vija jonë».

Po me çekoslllovakët, mos vallë i rregulluan marrëdhëniet revizionistët sovjetikë? Në asnjë mënyrë! Po-

pulli çekoslovak i konsideron dhe vazhdimisht do t'i konsiderojë ashtu siç janë, pushtues, revizionistët sovjetikë, që s'kanë hiç ndër mend të largohen nga Çekosllovakia. Përkundrazi sovjetikët atje po blejnë toka, ngrenë pallate dhe janë duke u vendosur me familje. Ka lagje ku apartamente të tëra banohen nga oficerë sovjetikë. Popullit çekoslovak, që i sheh këto veprime, i ka ardhur në majë të hundës. S'ka dyshim se koha do të bëjë punën e vet, do të vijë dita që gjendja do të shpërthejë. Ekzaktësisht nuk dihet se kur do të bëhet kjo, natyrisht, kur të piqen kushtet. Sa më lart të ngrihet fryma revolucionare e popullit çekoslovak, aq më të shpeshta do të bëhen edhe goditjet e tij kundër pushtuesve sovjetikë. Me këto doja t'ju vija në dukje se sa të mëdha janë kontradiktat midis revizionistëve.

Në vendet ku revizionistët sovjetikë janë shtruar si në shtëpinë e tyre, sa më shpejt që të organizohen partitë komuniste marksiste-leniniste dhe sa më të forta të bëhen këto, aq më parë do të organizohen forcat revolucionare të popujve dhe do të fillojë lufta për përmbysjen e revizionistëve. Po a ka vallë parti marksiste-leniniste në këto vende? Elementë përparimtarë e revolucionarë, që kundërshtojnë revizionizmin ka me siguri, por nuk dimë të jenë organizuar akoma.

Në vendet klasike kapitaliste, si në Francë, Itali, Belgjikë, Angli etj. partitë revizioniste janë diskredituar, ato vetëm emrin kanë «parti komuniste», sepse asgjë të përbashkët nuk kanë me partitë e vërteta të tipit leninist. Në to ekziston një shturje e plotë. Vijnë anëtarët në mbledhje apo s'vijnë, paguajnë kuotat apo

s'i paguajnë, e blejnë apo jo gazetën, janë apo s'janë ata me vijën e partisë, aq u bën udhëheqjeve të tyre tradhtare. Krerëve të këtyre partive, sa kohë që janë dakord me sovjetikët, u jepen fonde pa kursim. Kur në ndonjë rast detyrohen të shprehen kundër qëndrimeve sovjetike, këta u presin çekun dhe vetëm kur vijnë në rrugën e tyre, çeqet u lëshohen përsëri. Ose, kur ndodh që ndonjëri nga udhëheqësit e këtyre partive mban qëndrim me ndonjë nuancë sadopak të ndryshme ndaj vijës së Moskës, atëherë atë e bëjnë «të sëmurë».

Vallë ç'ka Valdek Rosheja, udhëheqësi kryesor i partisë revizioniste franceze, që prej shumë kohësh nuk po del fare në skenë? Ai është një revizionist i poshtër, po, si duket, nuk u vjen në çdo rast për shtat krerëve të tjerë revizionistë të partisë së tij, prandaj ka rreth një vit e gjysmë që është deklaruar se është i sëmurë. Ka të ngjarë që Rosheja të jetë i sëmurë, por ata i përhapin këto fjalë sepse duan të nxjerrin në vend të tij njëfarë Zhorzh Marshe, që është qind për qind me revizionistët e Moskës.

Ja, të tilla marrëdhënie ekzistojnë midis revizionistëve. Revizionizmi, është armiku ynë i pabesë e dinak që, për të gënjyer popujt dhe klasën punëtore, maskohet me terminologjinë e marksizmit. Këtë maskë ai e ka mbajtur dhe vazhdon ta mbajë dhe kjo e bën të jetë shumë i rrezikshëm dhe ta dëmtojë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, prandaj ne duhet t'ia çjerrim atë, që popujt dhe komunistët e botës të njohin si duhet fytyrën e tij të vërtetë.

Dihet se armiqtë tanë kryesorë janë imperializmi

amerikan dhe socialimperializmi sovjetik. Të dyja palët kanë edhe kontradikta me njëra-tjetrën, por aktualisht këto nuk janë akoma shumë të thella, prandaj të mos gënjehemi nga çjerrjet e revizionistëve sovjetikë, pse këto janë vetëm maska e parulla për të gënjyer naivët. S'ka dyshim që kontradiktat më vonë mund të thellohen dhe do të thellohen, ato bile mund t'i çojnë deri edhe në luftën në mes tyre. Por, në koniunkturat e sotme, qoftë nga frika që kanë imperialistët dhe revizionistët nga njëri-tjetri, por sidomos nga frika e revolucionit, ata janë më shumë të prirë nga bashkëpunimi reciprok, mbasi e dinë mirë që, në rast të një lufte në mes tyre, do të shpërthejnë kryengritje të mëdha nga ana e popujve dhe do të humbasin. . .

Ndaj luftës shumëvjeçare të popullit vietnamez kundër imperialistëve amerikanë, Partia dhe Qeveria jonë mbajnë një qëndrim shumë korrekt. Ne jemi me të, e mbështetim, jemi për mbrojtjen e Vietnamit të Veriut, për çlirimin e Vietnamit të Jugut dhe për bashkimin e gjithë Vietnamit. Kur vjen rasti ne ua themi pikëpamjet tona udhëheqësve vietnamezë. Atyre u kemi deklaruar vazhdimisht se ne i mbrojmë dhe do t'i ndihmojmë me sa fuqi që të mundemi, deri në fund.

Kohët e fundit imperialistët amerikanë dhe reaksionarët e Sajgonit hëngrën një dru të fortë në Laos, ku kishin futur forca të mëdha, me qëllim që t'u pritnin furnizimet që u shkonin nga Veriu luftëtarëve të Vietnamit të Jugut, nëpërmjet rrugës «Ho Shi Min», por u detyruan të tërhiqeshin para kohe nga lufta e rreptë e patriotëve laosianë. Ushtritë kukulla u dërrmuan, humbje të rënda pësoi edhe aviacioni amerikan.



Vietnamezët kanë fituar një eksperiencë të madhe në luftën kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shokë. Ata dinë të luftojnë me sukses, sidomos kundër avionëve bombardues, kundër helikopterëve, kundër të gjitha mjeteve moderne amerikane të luftës.

Kemi të dhëna se Bashkimi Sovjetik është duke menduar tash «të ndihmojë» edhe Laosin. Sa janë të vërteta këto të dhëna, sipas të cilave sovjetikët kanë deklaruar se, po të futen amerikanët prapë në Laos, do të hyjnë edhe ata, nuk e dimë, por kjo nxjerr në shesh synimin që në Indokinë përpiqet të infiltrohet edhe Bashkimi Sovjetik. Ja edhe një rast tjetër që vërteton ato që thotë Partia jonë se këtu kemi të bëjmë me një aleancë amerikano-sovjetike jo vetëm politike, por edhe ushtarake, kemi të bëjmë me përpjekje të përbashkëta për ndarjen e zonave të influencës dhe për t'i ardhur në ndihmë shoqi-shoqit. Natyrisht, kjo nuk bëhet në atë formë dhe aq hapur, siç bëjnë Shtetet e Bashkuara me Izraelin, po në një mënyrë shumë më të stërholluar. Me këtë bëhet edhe një herë e qartë për të gjithë ajo që thashë se, pavarësisht nga kontradiktat që kanë midis tyre imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë, të dyja palët i japin edhe ndihma njëra-tjetrës.

Të gjithë e dimë që Pakistani nga pikëpamja territoriale është një shtet i ndarë në dy pjesë, që në kohën e ish-ministrit të Jashtëm të imperializmit britanik, Bevin. Kur Anglia mendoi t'i jepte gjoja lirinë Indisë, Bevini që ishte një nga udhëheqësit më reaksionarë të partisë laburiste dhe ministër i Jashtëm, sugjeroi dhe u arrit të krijohen atëherë dy shtete, India

dhe Pakistani. Meqenëse në ish-koloninë angleze të Indisë kishte popullatë myslimane edhe nga Lindja, edhe nga Perëndimi i Indisë, u krijua kështu shteti i Pakistanit, që u vendos të lidhej nëpërmes Indisë, territori i së cilës ndan kështu Pakistanin Perëndimor nga ai Lindor. Tani, njëfarë Muxhibur Rahmani, njeri i amerikanëve dhe i Indira Gandit, që hiqet si demokrat, popullor e çfarë të duash, i bëri thirrje popullit të Pakistanit Lindor të ngrihej në luftë për «pavarësi». Natyrisht, në pamje kjo është një deklaratë e drejtë dhe tërheqëse, pse në udhëheqje të Pakistanit është një feudal i madh, Jahja Khani. Mirëpo ky tregohet dashamirës dhe mik me Kinën, ndërsa me Bashkimin Sovjetik dhe Indinë nuk i ka punët hiç mirë, se i shikon qartë dallaveret që luajnë këto dy vende për çështjen e Kashmirit. Me inkurajimin e Rahmanit imperialistët amerikanë, revizionistët sovjetikë dhe reaksionarët indianë përpiqen t'i vënë zjarrin Pakistanit Lindor. Për këtë qëllim Podgorni, nga salla e Kongresit të 24-t të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i bëri një letër Jahja Khanit që të mos burgosë «demokratin» e famshëm Rahman, të mos pengojë dëshirën e këtij që populli i Pakistanit Lindor «të rrojë i lirë», që kryengritësit të mos pengohen, po të lihen të veprojnë lirisht e gjithfarë profkash të tjera. Siç thonë disa agjenci lajmesh, Bashkimi Sovjetik e bën këtë nga frika se mos Pakistani Lindor kthehet në një vend të rrezikshëm. Në fakt, në këtë vend janë amerikanët që po futin fitilin dhe, për të mbuluar qëllimet e tyre, shpifin sikur atje gjoja po përpiqet të hedhë ganxhat Kinë. Ja, pra, edhe një rast tjetër që tregon se si imperiali-

stët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë ndihmojnë shoqi-shoqin në ndarjen e zonave të influencës, në shtypjen e popujve, në përgatitjen e vatrave të luftës etj.

Në Lindjen e Mesme, në fakt, nuk po luftohet kundër armikut të popujve arabë, Izraelit. Përkundrazi, atje ka filluar lufta me njëri-tjetrin, midis arabëve. Në këto kushte përfiton Izraeli, duke mbajtur fort kufijtë që ka pushtuar deri në bregun e Nilit në vitin 1967, me gjithë deklaratat boshe të presidentit egjiptian Sadat. Është e vërtetë se revizionistët sovjetikë e kanë mbuluar Egjiptin me armë, po avionët dhe raketat që ata kanë dërguar në këtë vend i mbajnë në duart e tyre, ndërsa prodhimet egjiptiane dërgohen në Bashkimin Sovjetik.

Në vend të luftës kundër agresorëve sionistë, në vendet arabe bëhen gjithfarë përpjekjesh për të zhdukur revolucionin palestinez. Udhëheqësit e këtyre vendeve, të nxitur nga revizionistët sovjetikë, synojnë të bëjnë paqe me Izraelin, mirëpo luftëtarët arabë palestinezë u janë bërë ferrë nëpër këmbë, ata nuk dorëzohen. Për të arritur paqen, siç dëshirojnë revizionistët sovjetikë dhe udhëheqësit e disa vendeve arabe, duhet shuar më parë lëvizja e palestinezëve. Janë revizionistët sovjetikë të parët ata që kërkojnë ta shuajnë këtë lëvizje. Këtë kërkon edhe presidenti egjiptian Sadat; këtë e kërkon edhe agjenti i imperializmit mbretit Hysein; këtë kërkojnë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Izraelin. Këtu është gjithë qëllimi i këtij komploti dhe bashkëpunimi imperialisto-revizionist për ndarjen e zonave të influencës në këtë pëllg. Të tërë janë rreshtuar, në një mënyrë ose në një tjetër, për të

mposhtur palestinezët që të mund të vendosin «paqen» në Lindjen e Mesme, ku Izraeli të mbajë fort pozitën e tij, Egjipti të qëndrojë ku është, të bëhet e mundur hapja e kanalit të Suezit për të siguruar ca të ardhura, ndërsa sovjetikët «paqedashës» të qëndrojnë në këtë vend «për ta mbrojtur». Për këtë sulmoi Izraeli i ndihmuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pastaj në botën arabe u futën sovjetikët, duke sjellë dhe flotën e tyre në Mesdhe, ku kanë krijuar rivalitete të mëdha me NATO-n. Mirëpo pushteti i amerikanëve në këtë pakt agresiv nuk është aq i konsoliduar, anëtarët e tij përpiqen t'i shpëtojnë tutelës dhe hegjemonisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat, në të kundërtën, përpiqen t'ua shtrëngojnë darën aleatëve të tyre dhe të mos i lënë të lëvizin...

Flota sovjetike lëvrin në Mesdhe, ashtu siç ka lëvrirë dhe lëvrin për shumë vjet me radhë flota e NATO-s. Me flotën e tyre revizionistët sovjetikë kërcënojnë herë në mënyrë të hapët, herë të maskuar vendin tonë dhe vende të tjera të kësaj zone.

Pavarësisht nga koniunkturat, Partia na mëson të jemi kurdoherë vigjilentë, pse, po të na gjejnë rastin, të tërë këta armiq janë të gatshëm të na shqyejnë. Prandaj na bie detyrë të qëndrojmë fort në vijën tonë të drejtë, të punojmë për forcimin politik, ideologjik, ekonomik dhe ushtarak të atdheut, pse vetëm kështu armiku e ka vështirë dhe i duhet të mendohet shumë përpara se të orvatet të na prekë.

Në koniunkturat aktuale shumë vende janë të kënaqura nga politika e Republikës Popullore të Shqipërisë, sepse kjo drejtohet kundër armiqve të popujve

dhe të paqes në botë, imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë. Shqipëria, i vjen mirë ose jo njërit apo tjetrit, ka një vijë të drejtë politike dhe ideologjike. Në parimet ajo s'lëshon as majën e thoit, kurse tregti është e gatshme të bëjë dhe, në fakt, bën me të gjithë ata që dëshirojnë, në bazë të parimeve që shpeshherë i kemi deklaruar dhe që ne, nga ana jonë, i respektojmë me rreptësi.

Kërcënimi i Jugosllavisë nga ana e socialimperializmit sovjetik përbën rrezik edhe për vendin tonë, pse, po të sulmohet ky vend, nëpërmjet tij do të sulmohej edhe Shqipëria. Të gjithë e kemi të qartë se në Jugosllavi sundon titizmi, armik i betuar i marksizëm-leninizmit, që ka vendosur kapitalizmin dhe është lidhur ngushtë me imperialistët dhe gjithë kapitalistët. Mirëpo Titoja nuk dëshiron që vendi i tij të pushtohet nga të tjerët. Ai edhe Bashkimin Sovjetik e ka paralajmëruar që Jugosllavinë të mos e sulmojë dhe, për të qenë në gatishmëri, në kohën e ngjarjeve të Çekoslovakisë, kur vendi i tij kërcënohej për t'u sulmuar, mobilizoi popullin për luftë. Ne ishim të mendimit se Bashkimi Sovjetik nuk do ta sulmonte Jugosllavinë, pse kjo do të ishte katastrofë për të. Megjithatë, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare bënë deklaratën, që ju e njihni të gjithë, sipas së cilës, po të sulmohej Jugosllavia populli shqiptar do t'u vinte në ndihmë popujve të saj. Popujt jugosllavë e pritën me simpati qëndrimin tonë të bazuar në një politikë shumë të drejtë.

Udhëheqësit jugosllavë na kanë propozuar shumë herë të shkëmbehen diplomatë në rang ambasadorësh

ndërmjet dy shteteve tona. Më në fund, kur ne e gju-kuam me vend, u përgjigjëm pozitivisht<sup>1</sup>. Por, kur po binim dakord për këtë punë, botuam një artikull të gjatë<sup>2</sup> për t'u treguar udhëheqësve revizionistë jugosllavë se vërtetë në rrugë shtetërore normale ne edhe tregti bëjmë, edhe diplomatë shkëmbejmë, por politika dhe ideologjia jonë është ajo që ka qenë, s'ka ndryshuar aspak. Dhe ata e kanë të qartë këtë çështje.

Politika jonë i ka ndihmuar shumë popujt e Jugosllavisë, veçanërisht shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi dhe që luftojnë për të drejtat e tyre brenda kuadrit të shtetit federativ jugosllav, sidomos kundër prangave të shovinizmit serbomadh. Marrëdhëniet tona shtetërore me Jugosllavinë i ndihmojnë shumë shqiptarët që jetojnë atje. Ato kanë hapur rrugën që në mes Shqipërisë dhe Kosovës të vendosen marrëdhënie arsimore e kulturore<sup>3</sup>. Siç keni dëgjuar, Universiteti i Tiranës po i jep tash një ndihmë të madhe Universitetit të Prishtinës. Profesorët e pedagogët tanë venë atje për të mbajtur leksione, sepse mungojnë kuadrot shqiptarë. Mirëpo, kur njerëzit tanë venë për të mbajtur leksione, këto ngjarje kthehen në mitin-

---

1. Qeveria e RPSH dhe qeveria e RSFJ ranë dakord të ngrenë nivelin e përfaqësive të tyre diplomatike në rang ambasade dhe të shkëmbejnë ambasadorë më 5 shkurt 1971.

2. Shih: «Dëshmi të falimentimit të plotë të vijës revizioniste të vetadministrimit jugosllav», «Zëri i popullit», 20 nëntor 1970.

3. Këto marrëdhënie kulturore e arsimore që filluan të vendosen në atë kohë, më vonë u ndërpre në mënyrë arbitrare nga pala jugosllave.

gje të vërteta. Në mënyrë të veçantë, kur shqiptarët e Jugosllavisë dëgjojnë se do të mbahen konferenca në gjuhën shqipe, nga kuadro të dërguar nga Tirana, auditorët mbushen me studentë e profesorë shqiptarë që dëgjojnë me vëmendje të jashtëzakonshme, ndërsa studentët e profesorët me kombësi serbe, në shenjë proteste, ka pasur raste që i kanë bojkotuar këto manifestime. Shqiptarët e Kosovës, sidomos pedagogët e Universitetit të Prishtinës, u thonë kolegëve të tyre serbë se s'kanë ç'u bëjnë manifestimeve, prandaj po të duan, të rrinë e të dëgjojnë, po të mos duan, mund të largohen. Leksionet duhen mbajtur nga personeli i ardhur nga Shqipëria, pse pa këtë ndihmë nuk janë në gjendje ta mbajnë dot në këmbë universitetin e tyre.

Kohët e fundit dërguam në Kosovë një numër filmash nga tanët. Edhe me këtë rast shpërthyen manifestime të fuqishme patriotike nga ana e shqiptarëve me rastin e shfaqjes së tyre. Kur në filmin «Ngadhënjim, mbi vdekjen» masat panë se si u mundën gjermanët dhe u ngrit flamuri i Shqipërisë, edhe shqiptarët ngritën në sallë flamurin. Sa nuk u ça tavani i kinemasë nga brohoritjet e papërmbajtura «Rroftë Shqipëria», «Rroftë flamuri» etj. Autoritetet titiste nuk kishin ç't'u bënin këtyre manifestimeve entuziaste dhe me një frymë të lartë patriotike.

Lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë mund ta propozojnë në të ardhmen edhe qeveritarët e Athinës<sup>1</sup>. Për ne kjo s'është e papritur, sepse,

---

1. Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Greqinë u shpall më 6 maj 1971.

që kur u çlirua atdheu, s'kemi pasur asnjë kundërshtim në këtë drejtim. Përkundrazi, kanë qenë reaksionarët shovinistë grekë ata që e kanë penguar një gjë të tillë, duke pretenduar aneksimin e «Epirit të Veriut» dhe duke deklaruar se janë në gjendje lufte me Shqipërinë etj.

Respekti që gëzon Shqipëria në popuj të tjerë e ka burimin te vija e drejtë e Partisë sonë. Forca e socializmit, e shtetit dhe e Partisë sonë, i detyron armiqtë të na respektojnë. Në botën ku sundojnë ujqit imperialistë dhe revizionistë, po të jesh i fortë, të tërë të respektojnë, po të panë të ligështuar, të marrin nëpër këmbë. Pikërisht sepse kemi qëndruar dhe jemi të fortë, prandaj armiqtë na ngrenë kapelën. Megjithatë, neve nuk na lejohet të biem në gjumë, përkundrazi, të hapim sytë vazhdimisht, se armiqtë janë shumë dinakë. Prandaj vigjilencën, si kurdoherë, edhe në të ardhmen, ta mprehim në kulm, të ndjekim me vëmendje koniunkturën politike dhe kurrë të mos u bëjmë lëshime armiqve. Këto qëndrime konsekuente armiqte e vendit tonë tashmë i kanë të qarta, prandaj prestigji i Shqipërisë në botë ka ardhur vazhdimisht duke u rritur.

Këtë pasqyrë të situatës ndërkombëtare e bëra për të treguar politikën e drejtë revolucionare të Partisë dhe të shtetit tonë dhe për të mos harruar për asnjë çast se rreth e rrotull kemi shtete armike, revizionistë dhe kapitalistë.

E gjithë bota, jo vetëm miqtë dhe popujt që na duan dhe ushqejnë një simpati shumë të madhe për Partinë e Punës dhe Republikën Popullore të Shqipë-



risë, por edhe shumë elementë përparimtarë borgjezë, njerëz realistë, të ndershëm dhe objektivë, ushqejnë respekt për qëndrueshmërinë e politikës së Qeverisë Shqiptare, për vendosmërinë tonë në mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut, për frymën e lartë revolucionare dhe për sukseset e mëdha që kemi arritur në ndërtimin e socializmit, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona.

Kur deklarojmë se socializmin ne po e ndërtojmë me forcat tona, nuk mohojmë ndihmën e miqve. Por vendimtare janë përpjekjet e mëdha, lufta dhe sakrificat e popullit tonë, pa të cilat nuk mund të garantohen jeta dhe e ardhmja e tij. Komunistët e kanë për detyrë t'i mësojnë popullit se kryesorët dhe vendimtarët janë puna, munda dhe djersa jonë, janë pasuritë dhe mjetet tona, se çdo hap që bën secili, çdo punë dhe detyrë që kryen ka të bëjë me sigurimin e atdheut, me mirëqenien e masave. Prandaj, para se të fillojë nga puna, çdo njeri të mendojë thellë ideologjikisht dhe politikisht dhe të vërë të gjitha forcat për të kryer sa më mirë detyrat. Edhe kur shkon për të pushuar të reflektojë, nëse e realizoi apo jo detyrën, e shfrytëzoi si duhet ditën e punës apo një pjesë të kohës e kaloi në mënyrë jo të frytshme. Në rast se sheh që ka boshllëqe, të mendojë çfarë dëmi i madh u bëhet atdheut, ekonomisë, mbrojtjes së vendit nga një qëndrim i tillë. Të nesërmen e në të ardhmen, të bëjë më shumë përpjekje për ta plotësuar si duhet detyrën. Po të mendojë e të veprojë kështu secili, atëherë mund të themi se ka menduar e ka vepruar me të vërtetë si komunist.

Ne komunistët shqiptarë jemi dhe, për një kohë të gjatë, do të jemi akoma në luftë e në përpjekje me armiqtë, me pengesa e me vështirësi të çfarëdolloji, të cilat luftojmë që t'i kapërcejmë, prandaj jemi edhe komunistë. Kjo gjendje e veçantë e vendit tonë na vë detyrën të jemi si kurdoherë të fortë e të patundur, në radhë të parë, në politikë dhe në ideologji. Por të fortë duhet të jemi ne edhe ekonomikisht e ushtarakisht. Për këtë në çdo sektor të punojmë me të gjitha forcat. Ai që punon në bujqësi, fjala vjen, të mendojë se industria nuk mund të përparojë pa kryer detyrat për prodhimet bujqësore e blegtorale, ashtu sikurse pa zhvillimin e industrisë nuk mund të lulëzojë atdheu e nuk mund të zhvillohet as bujqësia. Kështu mund të flasim me radhë për gjithë sektorët e tjerë, duke përfshirë arsimin, kulturën, shëndetësinë etj. Dihet se pa shkollë asnjë sektor nuk mund të ecë përpara, ashtu sikurse pa një ushtri të fortë rrezikohen liria dhe pavarësia e vendit dhe çdo sukses i arritur deri tani në ndërtimin e socializmit. Të gjithë sektorët, pra, lidhen ngushtë me njëri-tjetrin dhe pikërisht pse Partia i ka parë në këtë mënyrë, prandaj kemi ecur gjithnjë përpara. Megjithatë ka pasur raste që planet në ndonjë degë a sektor nuk i kemi realizuar, për arsye se çështjet nuk janë menduar mirë, se ka pasur punonjës, komunistë, kuadro ose drejtues, që atje ku kanë punuar e djersitur nuk i kanë kuptuar thellë problemet politikisht, ideologjikisht, teknikisht dhe organizativisht. Këtu duhet gjetur burimi që çështjet nuk janë zgjidhur drejt e rezultatet, në disa raste, nuk kanë qenë ato që kërkoheshin.

Megjithatë, në përgjithësi, ne kemi bërë punë dhe vepra të mëdha, të cilat nuk është vendi t'i përmend në këtë mbledhje, sepse të tërë i dimë, se i kemi menduar e i kemi ndërtuar së bashku. Është një fakt i pamohueshëm se ato që kemi realizuar, janë bërë brenda një kohe shumë të shkurtër. Kjo tregon forcën dhe pjekurinë e Partisë dhe të popullit tonë, heroizmin, vendosmërinë e sakrificat e tyre, besimin e madh në të sotmen dhe në të ardhmen e atdheut, e cila do të jetë e ndritur. Të gjitha këto janë të kristalizuara në vijën e drejtë të Partisë. Njerëzit tanë nuk kishin që në fillim ato zotësi e dituri që fituan gradualisht me kohë, në sajë të përpjekjeve të tyre të palodhura, por me rritjen e pandërprerë të fuqisë politike dhe ekonomike të vendit, u ngritën edhe ata vetë.

Në Kongresin e 6-të të Partisë ne do të shkojmë me plan të realizuar; bile të tejkaluar në zërat kryesorë të sektorit të industrisë, të ndërtimeve etj. Por duhet thënë me keqardhje se në bujqësi nuk arritëm t'i plotësojmë disa detyra e për disa zëra do të paraqitemi me plan të paplotësuar. Natyrisht, në Kongres ne do t'i vëmë në dukje të gjitha, sukseset dhe të metat, por edhe rrugën që duhet të ndjekim për realizimin e plotë të planit të ardhshëm.

Plani i ri pesëvjeçar u përpunua me kujdes. Diskutime të gjera, sipas rekomandimeve të Komitetit Qendror, u bënë deri në bazë, ku masat u ngritën peshë në këmbë për t'i rrahur problemet mbarë e prapë dhe për të gjetur rrugët më ekonomike që duhen ndjekur për realizimin e detyrave. Diskutimet e bëra dhe hovi revolucionar e vendosmëria e punonjësve tanë janë ga-

ranci që plani i ardhshëm, megjithëse me detyra të ngjeshura e të guximshme, të realizohet plotësisht.

Mund të ketë njerëz që, të nisur nga një gjykim i cekët, të pyesin: Përse s'e bëjmë më të lehtë këtë plan? Një gjë të tillë nuk na e lejojnë as situatat, as nevojat. Ne, komunistët, nuk duhet të mendojmë për asnjë çast që të përgatitim një plan të tillë e t'i vëmë vetes detyra të lehta. Përkundrazi, duhet të punojmë për një plan të ngjeshur, por që duke tendosur e duke mobilizuar, në radhë të parë, të gjitha forcat dhe energjitë tona, pastaj edhe të mbarë popullit, të jetë i realizueshëm. Kur plani është real, kur janë studiuar mirë të tëra mundësitë në bazë të fakteve, të përpjekjeve të njerëzve tanë në uzina, në fabrika, në kantiere, në ara, apo në parcela të veçanta, me një mobilizim të plotë, plani jo vetëm mund të realizohet, por edhe të tejkalohet. Kur punëtorët, kooperativistët, specialistët, inxhinierët, agronomët e të tjerë, i kanë bërë mirë llogaritë, i kanë rrahur si duhet mendimet dhe me prova kanë vërtetuar se mund të ngrihen këto ose ato objekte, se në bujqësi e blegtori mund të merren rendimentet e parashikuara, atëherë s'mbetet gjë tjetër veçse të mobilizohen totalisht forcat, të bëhen të tëra përpjekjet që gjithë këto mundësi ekzistuese të kthehen në realitet.

Ashtu si në planet e kaluara, edhe në planin e ri asgjë nuk është e tepërt, çdo gjë është e nevojshme, e domosdoshme, bile shumë e domosdoshme që të realizohet. Por «me frymë të shenjtë» asgjë nuk bëhet. Plani, ta kemi të qartë, i lehtë nuk është, po me forcat e bashkuara të mbarë popullit dhe me udhëheqjen e drejtë

të Partisë, ne do ta realizojmë e mund të bëjmë çdo gjë.

Këtë pesëvjeçar ne do të ngremë metalurgjinë e zezë, që do t'i kushtojë shumë vendit tonë, shokë. Po a mund të bëjmë dot pa këtë objekt kaq të kushtueshëm? Sigurisht që jo. Asnjë popull që lufton për zhvillimin me vrull të ekonomisë së vendit, nuk mund të bëjë pa metalurgji. Edhe ne, derisa e nxjerrim në vend mineralin e hekurit, derisa kemi përgatitur një klasë punëtore të aftë dhe të zonjën që ta marrë përnjëherësh në dorë ndërtimin e kësaj vepre të madhe, megjithëse mjaft të vështirë, me anën e së cilës do të prodhojmë në vend çeliqet tona dhe të shpëtojmë kështu një herë e mirë nga importi i tyre që na gllabëron një pjesë të mirë të të ardhurave tona, atëherë si të mos e ndërtojmë metalurgjinë? Pa të ndërtimi i shpejtë ekonomik i vendit do të ecte me vështirësi. Metalurgjia është «buka» e gjithë ekonomisë. Një vend nuk mund të ketë ekonomi të shëndoshë pa metalurgjinë e vet, prandaj ajo është aq e domosdoshme për ne. Detyra jonë është ta ndërtojmë, bile sa më parë, këtë vepër, shokë. Ne mendojmë për sot dhe për nesër, të forcojmë sa më parë pozitat tona, për sigurimin e së ardhmes së popullit tonë.

Kështu si mendon për metalurgjinë, Partia ka menduar edhe në drejtime të tjera, në radhë të parë, për mbrojtjen e vendit, për forcimin e ushtrisë, për garancinë e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut. Agjencitë përrëndimore të lajmeve pohojnë se ushtria shqiptare është jashtëzakonisht e fortë, bile një nga këto agjenci njoftonte, s'ka shumë kohë, se një sulm sovjetik mbi Shqipërinë, me anë të flotës që ka në Mesdhe, do të

pësonte humbje të madhe, mbasi ushtria shqiptare është e armatosur me armë moderne. Ku e dinë këtë armiqtë tanë? Ju dëgjuat sot në mëngjes një zhurmë të mprehtë në qiell. Ishin avionët tanë modernë që fluturojnë në mbrojtje të hapësirës sonë ajrore. Që kemi të tillë avionë e kanë diktuar forcat e NATO-s, prandaj agjencitë e lajmeve vazhdojnë të transmetojnë se Shqipëria ka avionë modernë që u kalojnë përsipër anijeve të tyre me shpejtësi të madhe. Partia me kohë ka marrë dhe vazhdon të marrë masa për mbrojtjen e atdheut. Ajo mendon vazhdimisht që të mos vihemi para vështirësive, në situata të ndërlikuara ndërkom-bëtare dhe të rrezikohet jeta e popullit. Prandaj, çdo gjë që mendon Partia për t'u ndërtuar është e nevojshme, me vend, e kohës. Bile ka edhe sektorë ku kemi akoma boshllëqe, por tani për tani nuk mund të bëjmë më tepër. Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria janë çdo objekt që parashikojnë të ngrihet e shqyrtojnë më parë në mënyrë metikuloze<sup>1</sup>, llogaritin gjithçka me kujdes të madh, që ndërtimi ynë socialist të mos ngarkohet më shumë nga sa janë mundësitë, që të mos thyhet shtylla e kurrizit dhe të mbetemi në baltë. Prandaj, na duhet ta balancojmë mirë çdo sektor, të mendojmë thellë gjer ku do ta zhvillojmë bujqësinë, sa industrinë, sa industrinë e rëndë dhe sa të lehtë, për arsye se të tërë sektorët duhet të shkojnë në harmoni, të ecin së bashku përpara që të mos pengojnë njëri-tjetrin.

Disave mund t'u duket se plani i ri pesëvjeçar i bujqësisë është i ngjeshur. Po, ashtu është, i ngjeshur,

---

1. Nga frëngjishtja — shumë të kujdesshme.

veç rendimentet që parashikon ai të realizojmë, mund të merren, pse në fakt janë arritur, bile, ka raste, që janë tejkaluar nga njerëzit tanë. Kur shohim që një kooperativë ka marrë 12 kuintalë pambuk për hektar, ndërsa tjetra afër saj dhe në të njëjtat kushte tokësore e klimatike, ka marrë më pak se ajo, si na mëson Partia? Gjersa mundësitë ekzistojnë, të përpiqemi të marrim sa e para.

Një ndër detyrat që na vë përpara Partia neve, komunistëve, është t'i bëjmë të qartë popullit që secili, kur i përvishet një pune, të mos mendojë vetëm për shtëpinë e vet, për gruan, fëmijët etj., por të mendojë në radhë të parë, për popullin, për atdheun, për rreziqet që mund t'u vijnë këtyre, nga të cilat do të vuajnë edhe të afërmit e tij. Prandaj, të gjithë të bëjmë përpjekje që të fitojmë kohë dhe të punojmë me të tëra mundësitë për të qenë të fortë politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. Një qëndrim i tillë për ne është i vetmi qëndrim i drejtë në këto situata, shokë.

Ju diskutuat në plenum për gjendjen e rrethit tuaj, kurse unë në përgjithësi dëshiroj të flas një çikë për gjendjen e vendit tonë. Në muajt janar dhe shkurt ne bëmë analizën e realizimit të vitit bujqësor 1970 për gjithë vendin. Vitin e kaluar ne prodhuam 4 për qind më shumë drithëra se më 1969; 3 për qind më shumë pambuk; 14 për qind më shumë luledielli; qumësht morëm 14 300 tonë më shumë; ndërsa mish 1 000 tonë etj. Si rezultat, kooperativat bujqësore mesatarisht ndanë këtë vit 145 lekë më shumë të ardhura për çdo krah pune, se një vit më parë.

Po plani si u realizua? Në disa zëra pati mosrealizime, që i kanë shkaktuar vështirësi ekonomisë sonë popullore, megjithëse Partia dhe Qeveria nuk lejuan, po morën masa që të mos prekej mirëqenia e popullit. Tani ne parashikojmë të hedhim së shpejti në kantieret e reja të ndërtimit me mijëra punëtorë të rinj për të ngritur hidrocentrale, fabrika e objekte të tjera të rëndësishme që populli pret të ndërtohen. Ne duhet të shtojmë prodhimet jo vetëm që të sigurojmë rezervat, por edhe që të furnizojmë të gjithë këta punëtorë, që do të marrin rroga e duan të hanë bukë, mish, qumësht, vaj etj. Ata duan veshje e mbathje, duan strehim etj., ata vetëm konsumojnë dhe nuk prodhojnë, pse prodhimet e objekteve që do të ndërtojnë, do t'i marrim aty nga vitet 1976-1977. Pra, na vihet detyra që të bëjmë përpjekje maksimale që planet e këtij viti jo vetëm t'i realizojmë, por edhe t'i tejkalojmë. Lufta, shokë, nuk bëhet vetëm me armë, me pushkë, topa, avionë, tanke etj., ajo kërkon edhe bukë, vaj dhe ushqime të tjera. Prandaj, një pjesë e prodhimeve tona duhet të futet vazhdimisht në depo, në rezervat e shtetit. për t'i pasur për kohë të keqe. Mirëpo, në qoftë se nuk mendojmë që tash për rezervat, asgjë nuk do të kemi në depo kur të na nevojiten.

Mund të ketë ndonjë që fare lehtë të kënaqet me të ardhurat që merr nga puna e vet në kooperativë. Mirëpo Partia nuk mendon kështu, shokë. Ajo do që populli të jetojë mirë, pa privacione, që në treg të ketë çdo gjë dhe në çdo kohë, që popullit të mos i krijohen as vështirësi dhe as pakënaqësi. Për këtë duhet punuar dhe duhet prodhuar. Kur njerëzit tanë shkojnë



për të blerë në dyqan dhe nuk gjejnë vaj, nuk gjejnë mish, apo qumësht, një ditë, dy, tri apo pesë ditë, mund të mos thonë gjë, sepse i kemi të mirë, patriotë dhe e kuptojnë drejt një mungesë të përkohshme, kur ua shpjegon Partia. Kurse në rast lufte puna është krejt ndryshe: ushtri e popull atëherë duan të hanë, të vi-shen etj. Prandaj, na vihet detyra të mendojmë që tani për të realizuar plotësisht planet, pse vetëm kështu krijohen mundësi për të vënë edhe në rezervë çdo gjë të domosdoshme. Këtë ta kemi kurdoherë parasysh, shoqe dhe shokë, që nesër në situata të rrezikshme, që mund të na krijohen, të mos na dalin vështirësi të tilla që popullit t'i kushtojnë sakrifica të panevojshme dhe të vuajë. Kjo nuk ka si të ndodhë, po të realizojmë vazhdimisht planet. Prandaj të mendojmë me kohë për rreziqet eventuale, të forcohemi në çdo drejtim, pse, sa më mirë të punojmë dhe të forcohemi tani, aq më lehtë do t'i përballojmë rreziqet. Kështu është edhe në fushën politike ose në ideologji.

Siç e dimë, revizionistët dhe borgjezia botërore i janë vërsulur Shqipërisë me të gjitha mjetet e propagandës, me radio, televizion, shtyp etj., me qëllim që të ndikojnë e të çoroditin mendjen e njerëzve tanë. Prandaj Partia duhet të punojë shumë për edukimin e shëndoshë të të gjithëve, burrave dhe grave, të rinjve e të rejave. Kurrë të mos kënaqemi e të na zërë gjumi, duke kujtuar se kemi bërë mjaft dhe se me punën politike një, dy, dhjetë apo 20-vjeçare që është bërë e kemi spastruar krejt ndryshkun në mendjen e njerëzve tanë. Në asnjë mënyrë s'duhet ta flemë mendjen, pse, siç dihet, çështjet ideologjike janë mjaft të ndërlikua-

ra. Edhe në qoftë se duket sikur mbeturinat shuhen brenda një brezi, mund të rikthehen përsëri në brezin tjetër, ndoshta jo në masë, në të tërë njerëzit, po në elementë të veçantë, të cilët, po të gjejnë kushte të përshtatshme, i përhapin dhe infektojnë e rrezikojnë me to shoqërinë tonë. Mirëpo këtë e nxitin edhe kapitalizmi e revizionizmi, që luftojnë me një mijë e një mënyra të ndikojnë mbi vendin tonë e të turbullojnë mendjen e njerëzve tanë. Ky rrezik ekziston për ne. Partia punon për edukimin e masave me ideologjinë e vet, por edhe armiqtë punojnë dhe mund të helmatisin disa njerëz, ndaj të cilëve duhet të jemi vigjilentë që t'i shpëtojmë dhe të mos i lëmë të molepsin të tjerët. Prandaj, puna politike dhe ideologjike me masat duhet të jetë e paprerë. Kurrë të mos mendojmë se u zhdukën mbeturinat, që nganjëherë janë mjaft të forta e të rrezikshme. Edhe në rast se janë zvogëluar shumë për asnjë çast të mos i nënvleftësojmë, por t'i shohim drejt në sy dhe t'i luftojmë gjer në fund.

Çështja tjetër që doja të prekja ka lidhje me atë që shtruat këtu dhe e shtruat mirë, me realizimin e detyrave që ngre Letra e Komitetit Qendror, e cila tashmë është punuar kudo në Parti. Nevoja e dërgimit të kësaj Letre lindi për arsye se në analizat që po bënim, shihnim se, krahas sukseseve në zhvillimin ekonomik të kooperativave bujqësore, kishte edhe shumë të meta e gabime. Organizatat-bazë të Partisë dhe kryesitë e kooperativave, në shumë raste, nuk arrinin të dilnin dot jashtë një pune rutinë të vendosur prej kohësh. Format e punës në përgjithësi, për kohën e tyre ishin të drejta. Mirëpo, kur situatat zhvillohen, duhen

bërë medoemos korrigjime, përmirësime, ndryshime, pse nuk mund të ecet kurdoherë me format e vjetra, edhe kur kushtet ndryshojnë. Po çfarë korrigjimesh e përmirësimesh duheshin bërë? Të tilla korrigjime e përmirësime shihej nevoja të bëheshin në organizim e në drejtim, ashtu siç bëjmë herë pas here edhe në sektorë të tjerë. Në kooperativat bujqësore vëreheshin të meta, merreshin edhe masa, bile nganjëherë disa masa merreshin edhe arbitrarisht. Por duhet pranuar, shokë, se disa probleme kyç, që në kooperativa kërkonin zgjidhje të ngutshme, siç është, për shembull, çështja e normave, e disiplinës në punë, ajo që ngrini ju tash lidhur me qarkullimin bujqësor shkencor, e funksionimit të organizatave të Partisë në bazë fshati, e plot probleme të tjera, nuk i vinin për dijeni Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë, as nga ana e komiteve të Partisë, pa lëre pastaj nga baza.

Le të marrim çështjen e funksionimit të organizatës së Partisë. Ne e ngritëm atëherë organizatën e Partisë në bazë fshati duke u mbështetur në vetë praktikën. Mirëpo, tash, gjendja e re e krijuar në fshat kërkon që puna të ndërtohet ndryshe, po për këtë nuk na ka ardhur ndonjë sugjerim nga baza. Gjithashtu, askush nuk i ka propozuar Komitetit Qendror të Partisë që, në kushtet aktuale, asambleja e kooperativës nuk ka mundësi të funksionojë, për arsye se me bashkimin e shumë kooperativave që përfshijnë në gjirin e tyre me mijëra anëtarë, nuk është e mundur të mblidhen kaq shumë njerëz në një vend, bile s'ka as lokal. Ishte, pra, e domosdoshme të mendohej dhe të gjendeshin forma të tjera të reja organizimi dhe të na sugjerohej

që këto t'i vinim në jetë. Me këtë dua të them se ka pasur një sërë problemesh që mundej dhe duhej të na ngriheshin nga baza. Kjo detyrë duhet pasur parasysh që të kryhet më mirë në të ardhmen, pse nuk mund të pretendohet që Letra e Komitetit Qendror, tash, do t'i zgjidhë të tëra problemet. Edhe në të ardhmen ka e do të ketë shumë probleme të tjera që duhen parë, të cilat e keni për detyrë t'i zgjidhni ju, t'i zgjidhë baza, t'i zgjidhim të tërë tok, nëpërmjet diskutimeve të gjera në masë.

Drejt shtrohet në raportin që u mbajt këtu në plenum se shumë probleme baza i ka ngritur dhe ato kanë ardhur deri në rreth. Ju tani do t'i diskutoni ato, do të bëni debate, disa çështje mund t'i çoni prapë në bazë ku të kërkonti edhe një herë mendimet e kooperativistëve. Prandaj bëni kujdes që këto mendime të na vijnë lart, natyrisht, mendime me të vërtetë të shëndosha, ato që u vijnë për shtat situatave aktuale të krijuara dhe stadii më të përparuar të zhvillimit të kooperativave tona bujqësore. Ky stad nuk lejon të mbajmë të njëjtat forma organizimi dhe drejtimi që kemi pasur deri tani. Në qoftë se mendojmë të ecim me të njëjtat forma organizimi dhe drejtimi, si në kohën kur kooperativa përbëhej vetëm nga një ose dy fshatra, ne do ta dobësojmë dhe gradualisht do ta shkatërrojmë ekonominë kooperativiste socialiste, kooperativistët do t'i bëjmë të pakënaqur, nuk do të shkojmë dot në kohën e duhur në pronën e përbashkët të të gjithë popullit e do të frenojmë zhvillimin socialist të bujqësisë. Një gjë e tillë nuk mund të lejohet.

Letra e Komitetit Qendror të Partisë doli pikërisht

në një kohë kur problemet e organizimit dhe të drejtimit në kooperativat tona bujqësore marrin një rëndësi të jashtëzakonshme. Le të shohim pak rëndësinë e madhe të çështjes së drejtimit, të shtabit.

Të gjithë e dinë se shtabi i ushtrisë në kohë lufte, në qoftë se përbëhet nga njerëz të paaftë, të merr në qafë, të dorëzon tek armiku, por bën që ta dërrmohet armikun, të çon në fitore dhe të çliron, kur në përbërjen e tij ka njerëz trima, të zotë dhe me talent. Shtabi i Partisë, gjithashtu, të nxjerr në dritë, ose të shkatërron. Kujtoni ç'i bëri Bashkimit Sovjetik tradhtari Nikita Hrushov. Ai, pasi erdhi në udhëheqje dhe mori fuqinë në dorë, brenda një kohe të shkurtër shkatërroi socializmin në Bashkimin Sovjetik. E shihni, pra, ç'rëndësi të madhe ka udhëheqja?

Kështu qëndron puna me shtabin në çdo punë, në çdo sektor, pra, edhe në kooperativë. Edhe këtu nga shtabi varen në një shkallë të madhe zhvillimi, përparimi, apo frenimi dhe shkatërrimi i ekonomisë kooperativiste. Prandaj kërkohet që në udhëheqje të kooperativës të ketë njerëz të aftë, të sakrificës që të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin dhe me masën kooperativiste, në unitet të çeliktë marksist-leninist, të ndriçuar nga politika e drejtë dhe nga ideologjia e shëndoshë e Partisë. Shtabi i kooperativës duhet të ketë një kuptim të lartë partie mbi demokracinë kooperativiste. Anëtarët që e përbëjnë atë të bashkëpunojnë ngushtë pa smirë, pa iu imponuar e pa fyer njëri-tjetrin. Në qoftë se midis anëtarëve të shtabit njëri është zgjedhur kryetar i kooperativës, kjo është bërë për disa cilësi dhe aftësi të veçanta që ka ai dhe që masa ia ka

vlerësuar, prandaj e ka caktuar në atë vend. Por, edhe anëtarët e tjerë të shtabit kanë vlerat e tyre, bile, në total, më shumë se ato të kryetarit. Prandaj këtij nuk duhet t'i rritet mendja, ai të mos mendojë se di më shumë se të tjerët, por të marrë parasysh mendimet e tyre, të kuptojë mirë se të tërë së bashku bëjnë shtabin, atë organ drejtues që mendon e vepron për ta çuar kooperativën përpara. Kjo kërkon atë që thashë, që të gjithë anëtarët e shtabit të jenë në unitet, të ndajnë mirë punën me njëri-tjetrin, të marrin përgjegjësi kolektive dhe individuale, të mendojnë si e qysh të veprojnë për të kryer detyrat, jo në mënyrë formale, jo duke vazhduar një punë rutinë, edhe kur kushtet e krijuara kërkojnë të punohet ndryshe, sepse rutina është tmerrsisht e dëmshme.

Në kooperativat ju keni bërë një punë të mirë me krijimin e sektorëve të bujqësisë, të blegtorisë, të planit, të financës etj. Prandaj, duhet kujdesur që sektorët të ecin si duhet, siç e theksoi drejt kryetari i kooperativës bujqësore të Krutjes. Tani që jemi duke krijuar këto organe, të mos vazhdojmë «këngën e Mukës» si përpara, që kryetari imponohet dhe kërkon të bëhet si thotë ai, pa dëgjuar dhe pa marrë parasysh fare mendimin e bashkëpunimit e vartësve në sektor, pa i arsyetuar e pa i argumentuar këto mendime. Gjëra të tilla duhet të marrin fund.

Si kudo edhe në bazë, për problemet kyç, duhet tërhequr sa më shumë mendimi krijues i punonjësve, duke vepruar siç bëjmë në qendër për përgatitjen e planit. Më parë Komiteti Qendror i Partisë jep direktivat, të cilat i merr Qeveria dhe, pasi i zbërthen, ia

jep Komisionit të Planit t'i përpunojë. Këtu diskutohet gjerësisht, njerëzit shfaqin mendime mbarë e prapë, gjersa arrihet në pikëpamje të përbashkëta, të cilat i vijnë udhëheqjes që të vendosë përfundimisht përrugën më të drejtë që duhet ndjekur. Kështu, pra, këtë punë e përfundojmë së toku, pasi ka shfaqur secili mendimin e vet. Këtë e bëjmë jo për të parë kush ka mend më shumë, pse dihet që mendja më e mirë është ajo e të gjithëve, po për të tërhequr mendimin e veçantë, pse, nga rrahja e mendimeve të çdo individi do të dalë një punë më e studiuar. Mund të qëllojë për shembull, që mendimi i njërit për një problem të jetë i arsyeshëm dhe të aprovohet, po për një tjetër, ta zëmë për një problem financiar, ky njeri jep një mendim të përciptë, kështu që, në vend të tij, spikat më fort, shquhet pikëpamja racionale e llogaritarit, i cili është mësuar kurdoherë të ecë me llogari, fije e për pe, në çështjet financiare. Prandaj, është në interes të ekonomisë kolektive që të merret parasysh pikëpamja e tij.

Si kudo, edhe kooperativa bujqësore duhet të ecë me llogari, pse ka rëndësi të madhe që planet jo vetëm të realizohen, por të realizohen për çdo zë me leverdi, me shpenzime sa më të pakta. Atje ku planet realizohen me shpenzime të tepërta, llogaritari, pa penguar aspak punën e të tjerëve, duhet të ngrejë zërin. Detyra e llogaritit në kooperativë është krijuar jo për të frenuar zhvillimin e saj, po që të bëjë të qartë nëse kjo ose ajo punë, nëse kjo ose ajo bimë ka leverdi. Ai me llogari duhet të provojë se, duke iu futur, fjala vjen, mbjelljes së një bime, vërtet vitin e parë kooperativa mund të dalë me humbje, po vitin tjetër të ar-

dhurat e saj, në krahasim me shifrat e parashikuara do të tejkalohen. Dikush tjetër mund të parashtrojë një variant të ri, sipas të cilit, me këto shpenzime, të investuara për një bimë tjetër, ta zëmë në mbjelljen e patates, mund të realizohen më shumë të ardhura meqenëse, në një parcelë aty janë marrë, fjala vjen, 180 kuintalë për hektar. Për këtë ai propozon që kooperative brenda vitit t'i futet mbjelljes së kësaj bime. E kështu me radhë rrihen mendimet për bimët që parashikohet të futen në plan. Çështjet diskutohen kolektivisht, thirret brigadieri, bëhet llogaria e ditëve të punës që kërkon bima që do të mbillet, e humbjeve në ditë-punë që ka pasur vitin e mëparshëm brigada për arsye të disiplinës së dobët etj. Flasin kështu të tërë, vihen përpara përgjegjësisë ata që s'kanë realizuar detyrat, ngarkohen njerëzit me detyra konkrete për tokën, për shërbimet, për koston, për normat që duhet të praktikohen, për rendimentet që duhen siguruar e pa të cilat nuk mund të realizohen fitime etj. Po nuk u veprua kështu, nuk mund të ecë përpara, siç duhet ekonomia e kooperativës.

Kooperativa, si një ekonomi e madhe socialiste, nuk mund të mendojë vetëm për sot, por edhe për perspektivën. Për këtë qëllim, kur e gjykon me leverdi, tërheq një shumë nga fondi i paprekshëm për të blerë, për shembull, një sasi lopësh të racës. Që të realizohet ky objektivi, secili kooperativist duhet të bëjë përpjekje që të realizojë medoemos detyrën atje ku është caktuar, me qëllim që kooperativa të sigurojë prodhimet dhe të ardhurat e parashikuara. Edhe kur kooperativa ka, ta zëmë, 5 mijë pula, nuk duhet të kënaqet duke



marrë nga 80 kokrra vezë në vit, apo më pak prej secilës, siç ndodh tani në shumë prej tyre, po më tepër. Prandaj, punonjësit e sektorit të shpendëve, përpara se të vijnë te shtabi i kooperativës, të mendojnë mirë për këtë problem. Në qoftë se, për të marrë prodhime më të mira nga pulat, përveç përpjekjeve të tyre duhet, ta zëmë, që në pulari të instalohet ujët, të sigurohen njomishtet për ushqim etj. t'ia kërkojnë këto shtabit dhe ky t'ua sigurojë me plot përgjegjësi dhe të mos pengojë punën në këtë sektor, ashtu sikundër duhet të kërkojë me rreptësi realizimin e detyrave që u janë ngarkuar vartësve.

E kam fjalën që shtabi i kooperativës apo i sektorit etj. të funksionojë me një rregull e organizim sa më të përsosur, ku të gjithë të mbajnë jo vetëm përgjegjësi kolektive, por edhe individuale. Kështu, ato që vendosen për blegtorinë, siç thashë më lart apo edhe për gjithë sektorët e ndryshëm të veprimtarisë ekonomike të kooperativës, duhet të sigurohen nga kryesia. Kjo, nga ana e vet, të kërkojë llogari gjer në një ndaj të gjithë atyre që mbajnë përgjegjësi përpara Partisë, shtabit dhe kooperativistëve për realizimin e detyrave që u takojnë sektorëve, brigadierëve, skuadërkomandantëve, punonjësve të stallave etj., etj., duke filluar, si në rastin e blegtorisë, që nga mbjellja e jonxhës, tërfilit, sorgumit, silazhit e deri te shërbimet zoovetërinare, përpunimi i mirë i bulmetit etj.

Nga shtabi duhet të kontrollohen të gjithë se si kryejnë detyrat, deri te mjelësja e lopës. Kur shihet se kjo nuk mjel mirë, të mësohet. Kur është ndihmuar dhe ka mësuar, t'i kërkojen arsyt përse s'i ka vënë

në jetë mësimet dhe të udhëzohet përsëri edhe një herë si të punojë. Shkenca ka të fshehtat e saj, shoqe dhe shokë, prandaj të mos duken si çështje aq të thjeshta këto gjëra, pse duke mos ditur, nuk mund t'ia marrësh bagëtisë tërë qumështin në masën e duhur e me yndyrën që ka, pse nxjerrja e saj ka teknikën e vet. Pa ditur t'i biesh gjirit të lopës në një mënyrë të veçantë, gjalpi që futet në disa zgavra të tij nuk del. Kështu, edhe lopa dëmtohet, edhe ekonomia kooperativiste merr më pak prodhim. Shkenca zooteknike merrret deri edhe me humorin e kafshës. Ai që është përgjegjës i blegtorisë në kooperativë dhe ka mësuar për këto çështje, duhet t'ua mësojë me radhë, dita-ditës, në punë e sipër, punonjësve të blegtorisë që ka në vartësi, bile t'u bëhet rrodhe, të mos i lërë rehat, kur ata nuk mbajnë parasysh të gjitha mësimet e domosdoshme që ndikojnë shumë në rritjen e prodhimit të qumështit. Këtë ai e ka për detyrë ta bëjë, me qëllim që punonjësit e blegtorisë të punojnë si duhet, pse kjo është në interesin e tyre, të kooperativës, të Partisë dhe të republikës. Mbase ai t'i ketë kryer si duhet detyrat, pavarësisht nga lodhja, do të ndiejë kënaqësi të madhe kur të shohë se mjelësja nga dita në ditë përparon në punë dhe planin e qumështit jo vetëm e realizon, por edhe e tejkalon; ose kur rritësja e pulave i mbush shportat plot me vezë, ndërsa pulat e destinuarra për treg i çon me peshën e duhur dhe të majme. Të gjithë do të thonë në këtë rast: I lumtë brigadierit! ose zooveterinerit që i mëson dhe i ndihmon pareshtur blegtorët dhe, kur me të drejtë vëren neglizhencën nga ana e tyre, i kritikon dhe u kërkon llogari. Ndihma e

vazhdueshme, vendosja e disiplinës dhe e rregullit, kërkesa e rreptë e llogarisë dhe organizimi i mirë i punës kanë rëndësi të madhe e vendimtare për rritjen e prodhimit.

Shkenca është e gjerë dhe e ndërlikuar në çdo fushë. Për ta përvetësuar atë duhet mësuar me këmbëngulje, ndryshe nuk mund të realizohen detyrat. Komunistët nuk janë të tërë të mësuar, por ata e kanë detyrë të dorës së parë të mësojnë pa u lodhur, vazhdimisht e me durim të madh. Në një institucion shkencor, ku ka disa kuadro me arsim të lartë që merren, fjala vjen, me studimin e përdorimit të izotopeve në bujqësi, mund të punojë, ta zëmë, në administratë edhe një komunist, të cilit i mungojnë njohuritë shkencore në këtë fushë. Organizatës-bazë të këtij institucioni mund t'i lindë nevoja ta ngarkojë, për një kohë, këtë anëtar partie, që të punojë me këta kuadro specialistë. Po ç'detyrë mund të marrë ky si komunist, kur të tjerët do të flasin e do të diskutojnë vetëm për probleme shkencore e teknike, që për të janë fare të pakuptueshme dhe s'i mëson dot? Apo vetëm sa të dëgjojë? Po të jetë njeri me iniciativë, aty ka punë edhe për të. Ai duhet të punojë për njohjen e për zbërthimin e orientimeve të Partisë me punonjësit, mund t'u bëjë propagandë fshatarëve me gjuhë të thjeshtë për t'i bindur, fjala vjen, që të shfrytëzojnë izotopet për të luftuar me to «dakusin» e ullirit, duke i bërë këta shterpë. Një punë të tillë ai mund ta bëjë fare mirë, në vend që të futet vetë në fizikën dhe kiminë e madhe, gjë që s'e bën dot.

Ose të marrim një komunist tjetër të tillë që

mund të jetë punëtor i thjeshtë dhe anëtar i organizatës-bazë të një fabrike. Megjithëse ky mund të mos jetë i kualifikuar në çështjet teknike, organizata e Partisë e cakton atë të bëjë pjesë në byronë teknologjike, bashkë me disa inxhinierë të paorganizuar në Parti e me stazh të gjatë pune. Çfarë mund të bëjë ky komunist në byronë teknologjike? Natyrisht, duhet të mendojë dhe të bëjë përpjekje për t'i gjetur punë vetes në këtë detyrë suplementare që e ka ngarkuar Partia. Pavarësisht se nuk ka dijeni sa inxhinierët, ai mund të ndihmojë byronë të përgatitë planin e punës, të japë kontributin e vet në ato drejtime që do të mundet, t'u futet më tepër çështjeve teknike, të aftësohet dhe, kështu, me punë, me fjalën e tij të ngrohtë fiton respektin dhe besimin e inxhinierëve. Këta do të thonë: «Ky njeri, vërtet nuk ka dijeni nga shkenca dhe teknika, por është një udhëheqës i vërtetë partie, organizator, me vullnet të madh. Ai na ndihmon të kapërcejmë vështirësitë që na dalin, na gjendet afër për çdo gjë. Me një njeri të tillë ne mund të ecim përpara». Dhe kështu rriten dashuria e respekti i tyre për të e për Partinë që e ka në gjirin e vet. Ja, pra, si duhet vepruar. Komunistët duhet të çajnë kurdoherë përpara, të jenë shembull iniciative, sakrifice dhe disipline në punë, për të gjithë dhe në çdo gjë.

Një nga detyrat e udhëheqjes së Partisë në rreth është puna që duhet të bëjë ajo për gjallërimin e organizatave-bazë, sidomos nëpër fshatra, për të rritur tek ato frymën e iniciativës, për të organizuar mirë punën dhe të mos kufizohen duke pritur çdo gjë nga lart. Veç kësaj, si në bazë ashtu edhe këtu në rreth, sho-

kët kryesorë t'u japin kompetenca të plota vartësve, sekretarëve të komitetit të Partisë, nënkryetarëve të komitetit ekzekutiv, këta shefave të seksioneve, shefi i seksionit inxhinierit, agronomit, veterinerit, zooteknikut e të tjerëve me radhë. Dhe kjo të bëhet në mënyrë të tillë që secili nga këta, kur lindin probleme, kur një punë nuk shkon mirë, të ketë iniciativë, të thërresë kë të dojë për zgjidhjen e saj dhe të vendosë drejt në rrugën e Partisë. Me këtë dua të them që vartësit të mos mbahen të ndrydhur, të mos lëvizin dot këmbët dhe për çdo gjë të pyesin shefin, ky zëvendëskryetarin ose sekretarin e tij. Po përse të pyeten eprorët, kur vartësi është në gjendje ta kryejë vetë një punë?

Unë mendoj se kryeagronomi i seksionit të bujqësisë mund të thërresë fare mirë me iniciativën e vetre ose pesë kryetarë kooperativash që të konsultohet me ta për një problem. Bile, po të jetë nevoja, të shkojnë bashkërisht në terren, ku t'i udhëzojë, t'i sqarojë dhe t'i aktivizojë në punë që të realizojnë detyrat, pa qenë nevoja të pyesë shefin e seksionit, pse për atë e ka ngarkuar Partia. Në rast se eprori kërkon që ta pyesin për çdo gjë, do të thotë se ai priret nga mania për t'u ndërhyrë të tjerëve në punë që ata mund t'i kryejnë, të mos u lërë vartësve kompetenca dhe, së fundi, të bëhet pengesë duke frenuar punën. E theksoj këtë se disa kanë një mani të tepruar që të gjitha gjërat të shkojnë nga dora e tyre. Po përse të mendojnë e të veprojnë kështu këta njerëz, mos vallë Partia ka vetëm ata që punojnë? Jo. Partia nuk mbështetet vetëm te disa kuadro që ka vënë nëpër vende drejtuese, por tek të gjithë anëtarët e Partisë dhe punonjësit e pa-

organizuar në Parti, prandaj ajo edukon secilin që, duke njohur mirë vijën brenda saj, të mendojë dhe të veprojë me iniciativë. Edhe në rast se i qëllon të gabojë, dhe gabimet nuk përjashtohen te njerëzit që punojnë, sekretari le t'i kërkojë shpjegime e ta kritikojë. Ai të bëjë autokritikë, por të thotë edhe se ndonjë gjë të keqe aq të madhe s'bëri. Eprori ta mësojë njëkohësisht që, kur merr një iniciativë, të reflektojë thellë. Në rastin konkret ta udhëzojë se si duhej të vepronte, t'i tregojë, pra, rrugën e zgjidhjes në vijën e Partisë. Ne duhet t'i mësojmë komunistët të luftojnë me guxim në këtë drejtim. Kështu na porosit Partia dhe jo të jemi të fjetur.

Lidhur me riorganizimin në kooperativa ju duhet të përpiqeni për të gjetur format më të përshtatshme. Edhe ne, duhet t'ju ndihmojmë, sidomos në disa drejtime. Ja, për shembull, çështja e financimit në kooperativa nuk është një punë e lehtë, po ashtu si dhe agroteknika e, në përgjithësi vetë bujqësia, është një art më vete, kërkon t'i kushtohet rëndësi e dorës së parë. Kujdes duhet t'i kushtohet, gjithashtu, çështjes së mësimi të shkencave bujqësore në të gjitha fushat. Partia duhet të luftojë pikëpamjen e gabuar, jomarksiste, të disave që bujqësinë nuk e quajnë zanat dhe bëjnë çmos të largohen nga ky sektor, gjoja se ajo nuk jep ndonjë profesion. Këto janë pikëpamje shumë të shtrembra. Në qoftë se ka profesion më të rëndë, më të zorshtëm e po aq edhe të lavdishëm, është bujqësia. Tornitori arrin të mësojë brenda 7 muajve të bëjë detale të ndryshme, po, që të mësosh si duhet bujqësinë, nevojiten vite e vite të tëra. Të merresh me bujqësi, nuk

do të thotë të marrësh thjesht shatën apo belin, t'i biesh me këmbë e ta futësh në tokë, siç mendojnë disa. Jo, shokë. Bujqësia është një fushë e gjerë veprimtarie shumë e rëndësishme që bazohet në shkencë. Nëse beli duhet futur në tokë, duhet ditur qysh më parë në ç'tokë e fut, duhet njohur ç'tokë është kjo, sa thellë duhet punuar dhe pse, përse duhet bërë qilizme etj. Këto gjëra nuk mund t'i dijë ai që zhvillon një bujqësi, si të thuash, rudimentare. «Pedologjia e tokës» është një shkencë e tërë dhe «hartat pedologjike», është një gjë tjetër. Të përgatitësh mirë hartat pedologjike, është një punë që kërkon dijeni, megjithëse; fundi i fundit, vetë ato s'të thonë gjë. Rëndësi ka të dish si të këndosh mbi to, si të analizosh shtresat që përbëjnë tokën e shumë gjëra të tjera të domosdoshme. Mirëpo me njerëz të pakualifikuar nuk kryhen këto punë.

Vajta një ditë në katundin Petrelë të rrethit të Tiranës. M'u mbloodhën rreth e rrotull disa gra. Në bisedën që bëra u thashë se bujqësia mund të vejë mbarë kur njerëzit që merren me të zgjerojnë njohuritë e tyre për tokën, për bimët, për shërbimet që u duhen bërë atyre. U thashë se, që të marrësh nga toka prodhimet që dëshiron, duhet të njohësh shtresat e saj, prej çfarë lloj balte është përbërë; sa thellë hyn rrënja e kësaj ose asaj bime që do të mbillet në këtë lloj balte; depërton aty ajri apo jo; sa thellë duhet bërë qilizma në këtë lloj toke, pse, po të bëhet më shumë nga sa duhet, i nxjerr tabanin dhe atëherë duhet t'i hedhësh humus, që do të thotë të bësh një shpenzim të panevojshëm. Por, edhe humus po t'i hedhësh, në

rast se mbjell fasule, kjo, ta zëmë, s'mbin, pavarësisht se e ke bërë qilizmë. Një gjë e tillë komprometon në sytë e kooperativistëve qilizmën, krijon tek ata mosbesim dhe kështu do të thonë se as nga kjo s'u fituak gjë. Me këtë dua të them se profesioni i bujqësisë nuk është i lehtë, ai ka të bëjë me tokën, me bimët dhe kafshët. Por, këto të fundit kanë një jetë të tërë aq interesante sa edhe ajo e njeriut, prandaj bujqësia nuk është siç mund të mendojë ndonjë mendjelehtë. Vetëm lopën po ta marrësh, kjo është si një fabrikë, e cila ushqimin që ha e kthen në qumësht, në mish e në gjalpë. Mirëpo, kur në një makinë një vidhë e vetme nuk punon, ajo ndalon, nuk prodhon. Te kafsha «vidha» janë organet që e përbëjnë, nervi, stomaku, zorrët etj. Të gjitha këto duhen njohur e duhen mësuar në të gjitha hollësitë nga blegtori ynë, pavarësisht se i di veterineri. Anatominë dhe fiziologjinë e kafshës duhet ta dijë mirë edhe mjelësja, edhe stallieri, edhe bariu që i kullot kafshët e që është ditë e natë me to, edhe ai që mbjell e rrit foragjeret me të cilat ushqehen bagëtia etj. Pra, bujqësia duhet vlerësuar më shumë, ajo kërkon që punonjësit e saj të kualifikohen vazhdimisht. Duhet parë arsye pse ka njerëz që duan të largohen nga ky sektor. Dikush nga ju, gjatë diskutimit, përmendi si arsye të ardhurat. Kjo duhet të na preokupojë, shokë, të mos e marrim lehtë duke u kufizuar me një thirrje të thatë që u bëhet herë pas herë fshatarëve kooperativistë për t'u hedhur në punë. Natyrisht, të gjithë kooperativistët duhet të mobilizohen në punë, po me mend në kokë, për të realizuar atë që dëshirojmë, ngritjen e rendimenteve, rritjen e pro-



dhimeve bujqësore e blegtorale. Për t'ia arritur kësaj, ata duhet të bëjnë ditë pune të normuara aq sa kërkohet dhe jo shkel e shko, ndryshe nuk mund të merren të ardhura më shumë. Kjo ka rëndësi se, kur sheh kooperativisti tornitorin që merr pesë ose gjashtëqind lekë në muaj, kurse vetë ai merr më pak, atëherë do të ndodhë ajo që i riu kooperativist, porsa kryen shërbimin ushtarak ku ka mësuar, ta zëmë për shofer, të përpiqet për të qëndruar në qytet. Vetëm me thirrje e vetëm duke ia zbukuruar me fjalë jetën e fshatit, ai nuk bindet të qëndrojë në fshat, pse në marrëdhënie pune me shtetin siguron më shumë të ardhura. Prandaj me punë të rritim prodhimet bujqësore e blegtorale se kështu do të marrin edhe kooperativistët më shumë të ardhura.

Kështu ngjet edhe me disa vajza fshatare që kanë tendencë të martohen në qytet, pa të jetë ç'të jetë burri, mjaft që të ketë rrogë, pse e shikojnë që në fshat ka edhe veprime jo të drejta, si: ndërhyrje, arrogancë, fjalë e thashetheme. Edhe kur një vajzë apo një grua e bëjnë brigadiere ndodh që i qepin fjalë. Lëre pastaj kur ka burra që punët e lodhshme të bujqësisë ua lënë më shumë grave e vajzave për t'i kryer, pavarësisht se me fjalë thuhet që punën më të rëndë në kooperativë e bëjnë burrat. Kjo nuk është tamam kështu, sepse nëpër ara më shumë gra e vajza sheh, ndërsa burrat merren me punët më të lehta ose sillen klubeve a rrinë nëpër qoshe. Dje, duke ardhur për këtu, kur kaloja në Gosë<sup>1</sup>, pashë arave, anës së rrugës se, ndërsa

---

1. Fshat në rrethin e Durrësit.

gratë mbillnin duhan, mjaft burra qëndronin në tro-  
tuaret e drejtorisë së ndërmarrjes, duke bërë muhabet.  
Si mund të themi atëherë që burrat u janë qepur pu-  
nëve të rënda? Ose, mund të konsiderohet e rëndë pu-  
na në karrocë, vetëm se karrocierit i kërkohet të ngar-  
kojë e të shkarkojë thasët? Tre thasë merr gjithsej një  
qerre, shokë, këta ai nuk e ka shumë të vështirë t'i  
çojë nga depoja në karrocë, së cilës pastaj ia hipën  
dhe ecën kaluar me orë të tëra, në një kohë që gruaja  
punon e dërsin në arë.

Jo, shokë, duhen parë më me kujdes dhe sa më  
drejt këto gjëra, se mospërfillja e tyre dhe pakujdesitë  
na krijojnë situata të vështira në kooperativa, pa folur  
pastaj për shumë padrejtësi flagrante që bëhen disa  
herë në rrugën e miqësive, siç ndodh kur ndonjë bri-  
gadier u shkruan më shumë ditë-punë kushërinjve,  
miqve, shokëve etj., etj. Kudo të vihet rregull për nor-  
mat e ditët e punës. Është e domosdoshme që këto  
çështje të trajtohen me kujdesin më të madh, se kanë  
rëndësi jetike për kooperativën, për kooperativistin,  
kanë rëndësi për atë që e jep edhe për atë që e merr  
shpërblimin, pse prej tyre varet jeta e atij që ka pu-  
nuar, por edhe interesi i kolektivit, i kooperativës. Ai  
që i shkruan normat duhet të jetë kërkues, por edhe  
i drejtë. Edhe në këtë punë duken shpejt ndershmëria  
dhe morali i njeriut. Kush regjistron ditët e punës,  
brigadieri apo cilido qoftë, duhet të jetë njeri i nder-  
shëm e i drejtë. Por, për të qenë i tillë, ai duhet të  
respektojë normat, të kontrollojë me objektivitet dhe  
me këmbëngulje zbatimin e tyre të plotë me cilësinë  
që kërkohet. Për t'i kontrolluar ato mirë, brigada dhe

skuadrat duhen organizuar në baza moderne, të punohet që ligjet e Partisë të njihen dhe të zbatohen, në mënyrë që të mos vendosë vetëm njëri, po të krijohen mundësi që aty të kontribuojnë të tërë.

Për sa i përket efektivitetit të brigadës, nëse këtë do ta bëni me njëqind apo me pesëdhjetë veta, vendosni vetë sipas nevojave e kushteve, si të jetë më e arsyeshme. Ajo që ka rëndësi është që punonjësit e brigadës, në radhë të parë, të jenë njerëz të ngritur politikisht, ideologjikisht e teknikisht, të punojnë me ndërgjegje dhe të zbatojnë në jetë me ndershmeri e me rreptësi të madhe ligjet, rregullat dhe normat e statutit të kooperativës. Edhe ata që drejtojnë brigadën, shtabi, brigadieri, zëvendësi i tij apo përgjegjësi i skuadrës, nga njëra anë, duhet të jenë shumë kërkues për zbatimin e detyrave nga secili dhe, nga ana tjetër, gjatë punës, të mos lejojnë në asnjë rast anarki, konfuzion dhe padrejtësi, duke u justifikuar se brigada mund të jetë e madhe. Njëkohësisht ata duhet të jenë të drejtë e të dashur me punonjësit që kanë në vartësi. Natyrisht, kur je pak e kontrollon më mirë punën, kurse në një kolektiv më të madh kontrolli dobësohet. Mirëpo, në rast se punon që brigadën ta ngresh në një nivel me të vërtetë të lartë ideologjik dhe politik, edhe po të jetë ajo me shumë njerëz, punët prapë do të ecin mirë. Prandaj, se si duhet organizuar brigada, kjo varet nga përbërja, nga terreni, nga llojet e bimëve dhe nga puna që do të bëhet me njerëzit.

Qarkullimi i bimëve është një punë që duhet bërë medoemos. Më e drejtë, sipas mendimit tim, është që qarkullimi bujqësor të bëhet më mirë në bazë koope-

native, sesa në bazë brigade ose sektori. Në qoftë se mendojmë t'i ngremë brigadat në bazë të qarkullimit bujqësor, kjo nuk më duket një arsye e shëndoshë.

Sektorin e kooperativës ne po e krijojmë mbasi janë zgjeruar shumë punët e shtabit të secilës kooperative, tash që këto janë zmadhuar. Në kushtet aktuale shtabi nuk është në gjendje të lidhet aq lehtë me brigadën. Veç kësaj, në sektor synojmë të kemi një shtab të veçantë, të specializuar, mbasi këtu, rregullisht, do të mbillet pak a shumë, një lloj bime, kështu që edhe punonjësit specializohen më mirë. Sektorit i jepen mjete dhe materiale. Ai ngarkohet me përgjegjësi përpara kooperativës. I jepen kompetenca dhe specialistë për kryerjen e detyrave që i caktohen. Kjo mënyrë organizimi krijon mundësi që shtabi i madh i kooperativës të zgjidhë problemet kryesore strategjike dhe taktike dhe të mos merret me cikërrima. Sa sektorë dhe ku duhen ngritur këta në secilën kooperativë, kjo më duket se është një çështje që mund dhe duhet të vendoset në bazë. Rëndësi ka pikëpamja që sektori del i nevojshëm të ekzistojë dhe, nga sa kuptova, të këtij mendimi jeni edhe ju.

Nuk e them për t'ju bërë qejfin, por dëshiroj të shpreh me këtë rast besimin që kam unë tek organizata e Partisë e rrethit të Lushnjës. Përshtypjet personale për punimet e plenumit tuaj ia thashë shokut Rrapi gjatë pushimit të drekës. Shumë shokë që diskutuan, qofshin këta kryetarë kooperativash, qofshin sekretarë organizatash-bazë, më lanë një mbresë të madhe për ngritjen e tyre ideopolitike, për seriozitetin në paraqitjen e problemeve, për horizontin e për-

gjithshëm, për shqetësimin që ndienin ata për zgjidhjen e problemeve dhe për pjekurinë e tyre. Unë kam genë edhe herë të tjera në rrethin tuaj, po, në krahasim me më parë, bie shumë në sy ngritja e Partisë. Në mbledhjet e Sekretariatit dhe të Byrosë Politike të Komitetit Qendror ne vëmë re vazhdimisht se Partia dallohet kudo nga një ngritje e madhe dhe e pandërprerë. Edhe në Lushnjë, si kudo, kjo ngritje është e dukshme. Megjithatë kisha edhe nja dy vërejtje për ju.

E para, organizata e Partisë t'i vërë më shumë veshin ndjekjes së shkollave.

E dyta, organizata juaj gjer më 1 janar 1971 kishte gjithsej 2 403 komunistë, nga të cilët në fshat 1 175 ose 48,90 për qind, ndërsa në qytet 1 228, baras me 51,10 për qind të tyre. Si proporcion një gjendje e tillë s'është aspak e rregullt, prandaj duhet ndrequr. Lushnja duhet ta konsiderojë veten rreth bujqësor, bile ta ngrejë kokën lart, të mburret, të shkëlqejë kurdoherë dhe si të tillë ta shohë e gjithë Shqipëria.

Komiteti Qendror i Partisë gëzohet për rezultatet e mira që ka arritur rrethi juaj në shumë zëra, duke dalë nga të parët, në krahasim me rrethet e tjera. Kjo, natyrisht, na kënaq dhe për këtë ju përgëzojmë, jo se ju duam në mënyrë të veçantë nga rrethet e tjera, por për përpjekjet më të shumta që keni bërë. Megjithatë, në qoftë se nuk gabohem, edhe pse kushtet i keni të mira, prapë ka zëra ku në shkallë republike ju lëkundeni nga radha e pestë deri në të pesëmbëdhjetën. Prandaj, gjatë vitit 1971, si rreth, duhet të bëni një kthesë të fortë në të gjitha drejtime, si në kooperativat ashtu edhe në ndërmarrjet bujqësore dhe të zini vendin e

parë. Ne kemi besim për këtë dhe ky është një besim i bazuar, për arsye të njerëzve tuaj, të organizatës së Partisë, që është në gjendje të udhëheqë me sukses të gjitha masat punonjëse të rrethit në këta objektiva, si dhe për arsye të kushteve që ju janë krijuar e të masave që keni marrë e do të merrni vetë. Prandaj theksoj se besimi që shpreh është i bazuar.

Çështja tjetër që doja të prekja ka të bëjë me forcimin e organizatës së Partisë dhe me shtimin e radhëve të saj me gjak të ri, sidomos me shoqe. Me këtë rast dëshiroj të vë theksin mbi një shfaqje jo të mirë që s'është karakteristike vetëm për rrethin e Lushnjës. Akoma një shumicë e madhe shoqesh, nuk më kujtohet mirë numri, nuk kanë mbaruar shkollën 8-vjeçare, edhe pse rrjeti i shkollave 8-vjeçare ka marrë një përhapje të gjerë në të katër anët e vendit. Duhet bërë një punë e madhe që e gjithë rinia të vazhdojë shkollat 8-vjeçare, si dhe shkollat e kurset e bujqësisë.

Mos harroni atë që përmenda, se bujqësia është një profesion i lavdishëm, shumë i rëndësishëm, por njëkohësisht i vështirë. Prandaj të gjithëve, jo vetëm fshatarëve, kooperativistëve, por edhe punonjësve të qytetit t'u rrënjosisim mirë në mendje që të kuptojnë si një e një që bëjnë dy, se pa bujqësinë nuk mund të rrojnë as fshati, as qyteti. Çdo qytetar të ketë respekt të madh për fshatin dhe për bujqësinë. Aktualisht, të gjithë duhet të kthejnë sytë nga fshati. Këtë e theksoj në mënyrë të veçantë për Lushnjën. Qyteti juaj duhet të mendojë vazhdimisht si ta ndihmojë sa më mirë bujqësinë. Kjo nuk do të thotë të braktisni industrinë, së cilës edhe në të ardhmen ne do t'i vëmë po

aq rëndësi sa edhe gjer më sot. Por, e vë më shumë theksin te bujqësia, për arsye se ka raste që nuk i është kushtuar ai kujdes që kërkon Partia, bile, nën maskën e parullave gjoja revolucionare dhe marksiste, ndodh në ndonjë rast, si në rrethin e Mirditës, që bujqësia është braktisur. Atje është nënvleftësuar roli i grave që punojnë në fshatrat e këtij rrethi, ku shumica e burrave punojnë në miniera. Te shokë me përgjegjësi në Parti dhe në pushtet, në Mirditë, kanë ekzistuar pikëpamje të gabuara, si: «Ç'i duhet bujqësia rrethit tonë, ky është rreth industrial», «gratë nuk mund të drejtojnë dot bujqësinë» etj. Si pasojë e koncepteve të tilla, në themel të gabuara, në Mirditë është katandisur gjendja sa të merren deri 15 kuintalë grurë për hektar. Kjo është për të qarë, shokë. Prandaj, Byroja Politike u bëri një kritikë të rreptë bartësve të këtyre koncepteve dhe mori masa për ta përmirësuar gjendjen<sup>1</sup>.

Mos vallë edhe Kukësi, ku kemi vetëm një uzinë dhe ndonjë minierë mbi baza hozrashoti, u bë rreth industrial? Jo, shokë. Atje punojnë vërtet disa grupe gjeologësh dhe, siç tregojnë shenjat, ky rreth mund dhe do të ketë një të ardhme shumë të madhe në këtë drejtim, po është akoma larg të quhet industrial. Ai është një rreth bujqësor me pyje të mëdha. Atje ekzistojnë mundësi të shumta për të hapur toka të reja, për të mbjellë më shumë grurë, misër, perime e sidomos patate apo fruta, si dardhë, mollë e veçanërisht kumbulla. Atje mund të rriten shumë mirë bagëtitë,

---

1. Shih në këtë vëllim f. 326.

kryesisht lopët dhe delet e bukura «ruda» etj., etj. Atëherë, përse të qarkullojnë atje të tilla koncepte të dëmshme?!

Në rrethin e Tropojës është kultivuar, gjithashtu, mendimi se qyteti Bajram Curri duhet bërë si Tirana, mbasi 25 kilometra larg tij do të ndërtohet hidrocentrali i Fierzës, ku do të banojnë familjet e teknikëve e të inxhinierëve që do të punojnë në këtë kantier të madh, si dhe të atyre që do ta shfrytëzojnë atë më vonë, pas 6-7 vjetësh, kur të përfundojë vepra. Shumë bukur, ne mund t'i ngremë tri-katër ndërtesa banimi për ta, por shokët e Partisë të këtij rrethi, vëmendjen dhe fytyrën duhet ta kenë kurdoherë nga bujqësia dhe të mos rrojnë me ëndrra.

Për sa i përket industrisë atë do ta zhvillojmë më tej, me ngritjen e veprave të reja e më të mëdha industriale, të cilat do t'i realizojmë medoemos. Por më shumë kujdes dhe forcë duhet t'i vëmë bujqësisë, pse, me gjithë investimet e mëdha që kemi bërë, me gjithë sukseset që kemi arritur, kemi akoma shumë për të bërë. Për këto arsye gjatë pesëvjeçarit të ri në bujqësi do të bëjmë investime të tjera, por njëkohësisht fytyrën do ta kthejmë më shumë se kurrë gjer më sot nga ky sektor jetik, me qëllim që të bëhet me të vërtetë një bazë e fuqishme e gjithë ekonomisë së atdheut tonë. Ne do të luftojmë me të gjitha forcat për të realizuar objektivat që kemi caktuar në bujqësi. Shteti do të investojë për bujqësinë, do t'i vijë më shumë në ndihmë me kredi sektorit kooperativist, do të rritë më tej prodhimin e plehrave. Investime do të bëhen, gjithashtu, në bonifikime, për ndërtimin e kanaleve



ujitëse, për sigurimin e farërave të zgjedhura, për shtimin e përmirësimit racor të lopës etj. Të gjitha këto bëhen, pra, për të ardhmen më të mirë të kooperativave dhe të gjithë republikës, për të ardhmen e lumtur të mbarë popullit tonë. Me tërë këto masa të rëndësishme organizative, që do të marrë Partia në bujqësi, pesëvjeçari, që porsa ka filluar, do të karakterizohet jo vetëm nga ndërtimi i kolosit të madh të siderurgjisë në Elbasan, i hidrocentralit të Fierzës e shumë objekteve të tjera industriale, por veçanërisht edhe nga zhvillimi i mëtejshëm dhe i vrullshëm i bujqësisë.

Në luftën për realizimin e detyrave të mëdha që kemi përpara, si kurdoherë, të kemi besim në vijën e drejtë të Partisë, në unitetin e çeliktë të radhëve të saj. Të punojmë e të mësojmë pa u lodhur, shoqe dhe shokë, me të gjitha forcat e trupit dhe të mendjes, me popullin dhe për popullin, në ara, në fabrika, në shkolla e kudo, duke shfrytëzuar për këtë qëllim, në maksimum dhe në mënyrë sa më racionale kohën.

S'ka shumë që në Shqipëri kishte ardhur një gazetar i huaj, njeri i shquar, kandidat për akademik, për të bërë një film për vendin tonë, me të cilin arriti një sukses në botën e jashtme. Na bëri përshtypje se, me gjithë moshën e kaluar, gjatë qëndrimit këtu, ai nuk linte t'i humbiste një minutë kot. Jo vetëm punonte, por edhe mësonte. Bile, edhe kur hipte në makinë, përpiquej të mësonte shqipen. Për këtë ai aktivizonte edhe gruan, përkthyesin shqiptar e shoferin që ta ndihmonin. Kurse te ne në përgjithësi pak njerëz shikon në rrugë me libër në dorë, apo të këndojnë një gazetë, goftë edhe kur udhëtojnë me automobil ose me tren,

për orë të tëra. Gjatkë, në tren ose në autobus, kur diskutohet detyrohet të presë, kur vete për t'u vizituar të mjeku në ambulancë apo për t'u takuar me një shok në park, njerëzit s'e kalojnë kohën kot, po hapin librin, gazetën apo revistën. Edhe kur njeriu shkon në shtëpi, si mbaron bukën, hap pastaj gazetën, librin apo dëgjon radion. Kushdo llogarit orët për të fjetur dhe për pjesën tjetër të kohës së lirë i vë vetes detyrën që të mësojë përditë dhe me vullnet, pse në vendet kapitaliste ky është ushqimi, është buka e kalamaneve, e vetes dhe e gruas së tij.

Te ne, shokë, që ndërtojmë socializmin duhet të kemi zell të madh për të mësuar vazhdimisht. Të gjithë duhet të lexojnë, të studiojnë se në këtë drejtim nuk bëhet në atë shkallë që dëshiron dhe na mëson Partia. Nuk është puna të lexosh një roman, pse kjo është gjëja më e vogël, po letërsi politike, ideologjike, libra që kanë të bëjnë me ngritjen profesionale të njerëzve tanë. Këndova një ditë një kritikë që bëhej në shtyp për disa libra që dërgohen këtu në Lushnjë dhe nuk shiten. Kjo është e vërtetë dhe ndodh për arsye se librat shpërndahen pa kriter e vetëm për t'i shitur dhe jo sipas nevojave të rretheve apo përbërjes së punonjësve. Nuk dua të diskutoj tani për mënyrën e shpërndarjes së tyre, por dëshiroj të di nga ju nëse për një numër librash që janë botuar për probleme të bujqësisë e të blegtorisë, të perimeve apo të pemëtarisë, për mbjelljen e patates, të orizit, të duhanit, të pambukut, të ullirit, për rritjen e lopëve etj. a ekziston vallë ai interesim që kërkon Partia nga kooperativistët dhe kooperativistet për t'i blerë dhe për t'i kënduar?

«Jemi të lodhur, thonë disa, dhe s'kemi mundësi të lexojmë». Sigurisht njerëzit tanë që punojnë shumë edhe lodhen, njeriu që punon nuk ka si të mos lodhet. Por Partia na këshillon që, sado të lodhur të jemi, kur kthehemi në shtëpi, pasi të kalojmë një pjesë të kohës së lirë me pjesëtarët e familjes, t'i vihemi punës për të kënduar gazetën, librin, për të mësuar prej tyre vazhdimisht, me vullnet dhe durim të madh.

Bëhet një gjë e tillë te ne? Këndohet gazeta, lexohen libra? Sigurisht, nga një masë gjithnjë më e madhe njerëzish punohet edhe në këtë drejtim, por, siç thashë, kemi akoma mjaft për të bërë. Ka njerëz që lexojnë shumë pak ose nuk zënë fare libër me dorë. Mund të lejohet një qëndrim i tillë, në mënyrë të veçantë nga komunistët? Na informojnë se gazeta lexohet në brigadë pesë minuta në mëngjes të çdo dite. E si mund të bëhet një gjë e tillë? Kjo është një punë krejt formale, sa për të shkuar radhën. Mua, personalisht, më duhet të paktën mbi një orë për të lexuar në shtëpi vetëm shtypin, gazetat kryesore. Atëherë, si është e mundur që brigadieri brenda pesë minutave t'u lexojë gazetën anëtarëve të brigadës? Prandaj të luftojmë formalizmin në këtë drejtim dhe të bëhen përditë më shumë përpjekje si në punë, ashtu edhe në të mësuar.

Partia është e sigurt se të gjitha boshllëqet e të metat në punën dhe në jetën tonë do t'i përmirësojmë, po natyrisht këto nuk bëhen përnjëherësh. Mos ma merrni për të keq, sidomos ju shoqe, për kritikën që ju bëra lidhur me mësimin. Shoqet unë nuk para i kritikoj, jo se nuk duhen kritikuar kur gabojnë. Në asnjë mënyrë. Në raste të tilla, si të gjithë duhen kriti-

kuar njëlloj edhe ato. E vërteta është se vajzat dhe gratë, kudo që janë, punojnë më shumë. Megjithatë ka burra që mbajnë qëndrime jo të drejta, denigruese ndaj tyre, sidomos me thashethemet, me fjalët e ulëta e shpifjet që përhapin në adresë të tyre, ose u hanë ditët e punës, ndërsa për vete shkruajnë më shumë ditë-punë. Këto Partia duhet t'i luftojë, bile me rreptësi të madhe. Por më lejoni të theksoj se Partia nuk dëshiron që shoqet, kur nuk e kanë arsimin e dëshiruar, të rrinë pa shkollë ose pas punës në shtëpi të mos mësojnë fare, të mos hapin një libër, të mos lexojnë as shtypin apo të mos dëgjojnë radion, pavarësisht se janë shumë më të ngarkuara e të lodhura. Për të gjitha këto dobësi të një pjese të tyre ne duhet t'ua heqim veshin, bile fort dhe shoqeve të mos u vijë aspak keq. Përkundrazi, kjo këshillë t'u vlejë për të bërë përpjekje të shumëfishuara në këtë drejtim. Ato duhet ta kuptojnë drejt problemin se nga puna dhe kualifikimi i përditshëm e sistematik i të gjithë njerëzve tanë, i burrave e i grave, i të rinjve e të rejave, varën kryesisht ndërtimi dhe begatia, e ardhmja e atdheut që ato, si të gjithë, e duan me gjithë hovin e shpirtit të tyre.

Duke përfunduar, shoqe dhe shokë, ju uroj edhe një herë nga zemra të dilni faqebardhë në realizimin e detyrave!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ORGANIZATAT-BAZË TË PARTISË EDHË NË FSHAT TË NGRIHEN NË BAZË PRODHIMI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 prill 1971

Ndryshimet që mendohet t'i bëhen ndërtimit të Partisë, në përgjithësi, janë të drejta, prandaj unë jam dakord që organizatat-bazë të Partisë të ngrihen në bazë prodhimi, në brigadë, sektor e në kooperativë.

Dëshiroj të theksoj që sektori është një pikë drejtimi organizativo-ekonomike e kooperativës bujqësore dhe jo qendër burokratike zyrtare, ku grumbullohen zyrat, banesat etj. Po të kuptohej sektori kështu, nuk do të ishte nevoja të bëheshin ndryshime, por do të organizohej puna në bazë fshati, ashtu sikurse ka qenë më parë. Qenia e organizatës-bazë të Partisë në sektor duhet të kuptohet në prizmin që tërë veprimtaria e saj të jetë e lidhur me bazën, me prodhimin. Të gjithë komunistët e kooperativës bujqësore është e domosdo-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa ndryshime që duheshin bërë në ndërtimin e Partisë.

shme ta kenë të qartë, në parim dhe në praktikë, pikë-pamjen se puna e tyre është në bujqësi, në blegtori, në pemëtari, me një fjalë në prodhim.

Për sa i përket çështjes se prej sa anëtarësh do të përbëhen organizatat-bazë, pra sa të mëdha duhet të jenë ato, kjo të shikohet konkretisht. Po qe se ka pak anëtarë, komunistët e disa brigadave mund të bashkohen në një organizatë etj. Mendoj se është menduar mirë që për probleme të kësaj natyre të vendosin komitetet e Partisë të rretheve.

Edhe në qendrën e kooperativës së bashkuar apo në fshat, ku ekzistojnë aktivitete ndihmëse, mund të ngrihen organizata-bazë. Kurse atje ku ka vetëm një ose dy komunistë, në pamundësi për të krijuar organizatë më vete, anëtarët dhe kandidatët e Partisë mund të bëjnë pjesë në një nga organizatat e tjera që do ta caktojnë vetë rrethet, sipas nevojës. Për të tilla çështje nuk është e mundur të vendosim që këtu nga qendra.

Nuk e di në qoftë se është e drejtë apo jo, por mendoj që në sektor të mos ketë byro. Sipas mendimit tim, puna e Partisë nuk konsiston vetëm në organizimin e një mbledhjeje që bën byroja ose organizata-bazë një herë në muaj. Jo. Puna e Partisë konsiston në zbatimin e vazhdueshëm, të përditshëm, të direktivave të Partisë, të përcaktuara nga kongreset, nga Komiteti Qendror deri edhe nga komitetet e Partisë të rretheve, për një sërë problemesh që kanë të bëjnë me gjithë jetën e vendit, të cilat organikisht nuk mund të bëhen objekt vetëm i mbledhjeve të organizatave-bazë që zhvillohen një herë në muaj. Prandaj, të kuptohet mirë nga çdo anëtar i Partisë nevoja që secili të azhur-

nohet patjetër me të gjitha direktivat e Partisë, të cilat ai duhet t'i dijë në vija të përgjithshme, kurse ato që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me sektorin ku punon, është e domosdoshme jo vetëm t'i dijë e t'i njohë në hollësi, por edhe të punojë pa u lodhur për t'i zërt-thyer e, mbi bazën e tyre, të organizojë punën në sektorin ku derdh përditë djersën e vet, për t'i vënë ato në jetë.

Mbledhjet e organizatës-bazë bëhen për të marrë një direktivë, për të dhënë një udhëzim, për të hequr një vërejtje, kur diçka nuk ecën mirë, për të shqyrtuar një problem preokupant etj., por puna e Partisë as fillon dhe as mbaron me mbledhjen e organizatës-bazë. Prandaj edhe byrotë që zgjidhen, ta kenë parasysh këtë e të mos shndërrohen në udhëheqje burokratike, sepse kështu jo vetëm do të frenojnë iniciativën dhe vetëveprimin e bazës, po me ngathtësinë e tyre, udhëzimet që kërkohen, do t'i çojnë atje të çala.

Pra, jam i mendimit që të mos krijojmë shumë byro në kooperativa, po të kemi vetëm një të tillë, byronë e Partisë të kooperativës së bashkuar. Edhe organizatat e masave, sidomos ajo e rinisë, mendoj të ndërtohen në bazë brigade, se të gjithë anëtarët e tyre marrin pjesë në punë.

Sa për komunistët e sektorit të arsimit, të vatrave të kulturës etj., që punojnë në juridiksionin tokësor të kooperativës, mendoj se duhet të bëjnë pjesë në një organizatë-bazë partie të veçantë. Kur janë shumë arsimtarë komunistë, mund të ngrihen edhe dy organiza-ta, në të cilat, siç thashë, të përfshihen edhe komunistët

e vatrave të kulturës, pa qenë nevoja të ketë organizata të veçanta për këta të fundit.

Edhe unë, ashtu siç thuhet në material, jam i mendimit që kompetencat e byrove të Partisë të shtohen. Byrotë të kenë të drejtën ta thonë fjalën e tyre për punonjësit që propozohen për t'u pranuar si kandidatë apo anëtarë partie, po aprovimin e tyre ta bëjë komiteti i Partisë i rrethit. Po kështu, jam dakord që masat ndëshkimore të propozuara për komunistët t'i shtrohen për diskutim dhe vendim organizatës-bazë ku bëjnë pjesë.

Sekretarët e byrove të Partisë, mund të jenë funksionarë, po për sa i përket shpërblimit të tyre, kjo çështje të shihet me kujdes, se në material thuhet që t'i paguajë kooperativa<sup>1</sup>. Mirëpo ta mendojmë një gikë mirë këtë punë se kooperativa paguan edhe për ndërtimin e veprave socialkulturore dhe mund të rëndohet shumë. E them këtë se shpesh mbyllen sytë dhe krijohet pa vend përshtypja sikur kooperativat notojnë në lekë dhe mendohet: «Oburra, t'ua ngarkojmë atyre edhe këtë apo atë detyrim!». Një gjë e tillë, shokë, nuk është e drejtë, nuk ka baza, sepse tani kooperativat janë akoma të pamëkëmbura mirë. Siç e kam thënë edhe një herë tjetër, çështjet duhet t'i trajtojmë njëlloj si për fshatin edhe për qytetin<sup>2</sup>. Në qoftë se anëtari i kooperativës bujqësore duhet të japë para për të ngritur shkollën, po qytetarët përse të mos ja-

---

1. Sekretarët e byrove të Partisë në kooperativa, ku janë funksionarë, paguhen nga komiteti i Partisë.

2. Shih në këtë vëllim f. 223.



pin ndihma në të holla për të ndërtuar shkollat në qytet? Pse këtyre t'ua ndërtojë shteti shkollat, kurse kooperativistëve jo? Këtë çështje duhet ta shikojmë me kujdes, të kemi një kriter, ose të paguajmë edhe ne, ose edhe për fshatin të veprohet njëllë për të tilla shpenzime, siç bëhet edhe në qytet<sup>1</sup>. Po kështu, dietat për sekretarët e organizatave-bazë të Partisë e të byrove mendoj të kufizohen në minimum. Edhe shteti kur dërgon nëpunësin me shërbim, ka një kufi për dietat. Megjithatë, për to ne përsëri harxhojmë shumë se akoma ka shërbime pa kritere, mbledhje të panevojshme, që zgjatin ditë të tëra dhe gjithë këto dëmtojnë ekonominë tonë. Këto veprime t'i kufizojmë në maksimum, shokë, se na ndodh që sekretarët vijnë një herë në seminar, pastaj në mbledhje të plenumit të komitetit të Partisë, më vonë në një aktiv që bëhet për një problem tjetër, akoma më tutje në një bisedë për propagandën, në një takim me ndonjë shok të qendrës dhe ata mbehen kështu varavingo në qytet. Prandaj duhen përcaktuar mirë këto lëvizje, të dihet kur dhe përse është e domosdoshme të vijnë në rreth dhe shokët sekretarë të organizatave të mos thirren edhe për gjëra fare të vogla. Jo, nuk është e drejtë dhe nuk duhet të vep-

---

1. Me vendimin e KQ të PPSH dhe të Këshillit të Ministrave të RPSH të datës 22 mars 1976, lidhur me ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve thelbësore midis fshatit e qytetit, shteti mori përsipër edhe në fshat shpenzimet për institucionet socialkulturore, duke përfshirë dhe investimet për ndërtimin e shkollave, kopshteve, çerdheve, shtëpive të kulturës etj. (Shih: «Dokumente kryesore të PPSH» vëll. VII, f. 9.)

rohet kështu, shokë. Me një fjalë në këtë drejtim të jemi shumë të shtrënguar.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# PO TË PRITET ÇDO GJË NGA LART, NGADALËSOHET ZBATIMI I DIREKTIVAVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 prill 1971

Le të marrim tash çështjen e dytë të rendit të ditës. Në materialin që na është paraqitur bëhet fjalë për punën që ka bërë aparati, por shokët sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve mund të flasin pak edhe për eksperiencën e tyre e të bazës. Do të ishte me interes që ata të mos kufizohen vetëm duke bërë autokritikë, por edhe kritikë në adresën tonë, se ndoshta ne u dërgojmë këtej shumë materiale. E dyta, të na thonë se mos këto materiale nuk janë në nivelin e duhur nga ana e përmbajtjes ose mos janë të gjata, me qëllim që edhe ne të marrim masa. Në rast se na thoni që këto materiale janë shumë të mira, por anëtarët e

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe se si punohet me dokumentet e Partisë dhe për masat që duhen marrë nga komitetet e Partisë, organet shtetërore e ekonomike, si dhe nga organizatat-bazë për studimin e për zbërthimin e tyre në mënyrë të organizuar.

Partisë nuk i lexojnë, unë mendoj se kjo nuk duhet të ndodhë për mungesë kohe. Anëtari i Partisë duhet të gjejë kohë për të lexuar jo vetëm këto, por edhe shumë të tjera. Në qoftë se në to ka përsëritje, atëherë shokët e bazës kanë të drejtë të thonë se i dinë këto gjëra dhe s'ka arsye përse t'i lexojnë.

*Pasi diskutuan me radhë shokët e tjerë, të pranishëm në këtë mbledhje, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Meqenëse nuk ka më ndonjë shok tjetër për të diskutuar, do të thotë se të gjithë jemi dakord me materialin, natyrisht, duke pasur parasysh që të marrin masa efikase për një organizim më të mirë të punës. Megjithatë unë kisha një vërejtje, lidhur me diskutimet e disa shokëve. Rrethi të mos presë që çdo gjë t'ia përgatitë aparati i Komitetit Qendror të Partisë, pse një pune të tillë jo vetëm nuk i dilet dot, por nuk është as e drejtë, për arsye se tash në rrethet Partia ka shokë dhe kuadro me stazh të gjatë në punë, me eksperiencë shumëvjeçare në jetën e Partisë, prandaj ardhja juaj deri në Komitetin Qendror për zberthim e shpjegim të çdo vendimi apo udhëzimi që lëshohet, nuk më duket me vend.

Përveç kësaj, mbledhjet e organizuara deri tash nga aparati i Komitetit Qendror për probleme të ndryshme nuk bëhen rrallë. Ne thuajse për çdo problem me rëndësi që shqyrton udhëheqja i kemi thirrur në qendër shokët e rretheve dhe jo vetëm pas mbledhjeve, por edhe herë të tjera. Pra, pa lënë mënjanë përgjegjësinë e aparatit tonë për ta organizuar edhe më mirë nga sa e kemi organizuar deri tash ndihmën për rrethet, në të ardhmen duhet të mendoni ju vetë më thellë

për direktivat e Partisë, të punoni për zbërthimin, për organizimin e punës për zbatimin e përpiktë të tyre.

Mua më duket se, po të thelloheni më mirë, pa vëshirësi do të dilni vetë në po ato konkluzione për të cilat na hidhni lule, na lavdëroni në të qendrës. Mendimet që japim në herë pas here, qoftë për një direktivë, qoftë për zbërthimin e saj etj., ju i keni vetë në kokë, megjithëse ndonjëri mund të mos i ketë në atë shkallë të zgjeruar që kërkohet. Kjo varet, natyrisht, nga niveli teorik i secilit dhe nga njohuritë e tij të përgjithshme. Sidoqoftë, shokët që kemi në udhëheqje të organizatave-bazë të Partisë në rrethe me një stazh të vjetër partie, mendoj se janë fare mirë në gjendje ta zbërthejnë vetë një direktivë të Partisë, ta organizojnë mirë punën, pa pritur t'u shkojë «ndihmë» nga lart. Të pritet çdo gjë nga lart, do të thotë të ngadalësohet zbatimi i direktivave dhe nuk do të kemi rezultatet që priten për vënien e tyre në jetë, sidomos në ngritjen e kuadrove të rinj në përgjegjësi, të cilët duhen mësuar dhe avancuar. Ky është një problem serioz ku ne duhet të ngulim këmbë që ata të përgatiten shpejt dhe të ecin me këmbët e veta. Në këtë mënyrë them se duhet të veprohet me kuadrot që kemi në vartësi, me sekretarët e organizatave-bazë, me anëtarët e byrove dhe gjithë të tjerët me radhë. Ne duhet të arrijmë që secili të punojë në mënyrë të pavarur nga këshillimet e përhershme dhe urdhrat e vazhdueshëm.

Në këtë drejtim na vihet detyrë ta lehtësojmë bazën nga materialet e tepërta. Në qoftë se nuk gabohem, buletinet e Komitetit Qendror u dërgohen të gjitha organizatave-bazë të Partisë. Kjo është një punë shumë

e mirë. Por, duke e parë problemin në prizmin që thashë, mendoj se një komunist duhet të jetë në gjendje që, pasi t'i lexojë këto dokumente, të nxjerrë prej tyre disa mendime të vetat, me një fjalë të zhvillojë mendimin e tij krijues. Por, mendoj se jo çfarëdo problemi që shqyrtojmë në këtu është e domosdoshme të shtypet e t'u dërgohet automatikisht të gjitha organizatave-bazë, sidomos kur është fjala për një problem që i përket vetëm një ose dy rretheve.

Dëshiroj të vë në dukje, gjithashtu, se materialet e Komitetit Qendror nuk kanë për qëllim dhe as mundësi ta ezaurojnë problemin një herë e mirë, pra t'i futen atij tërësisht. Çështjet që trajtohen në to janë, si me thënë, orientime vije, orientime politike, ideologjike e organizative. Komunistët dhe sekretarët e organizatave-bazë të Partisë është e nevojshme të dinë dhe të kuptojnë se cilat nga ato orientime lidhen drejtpërdrejt me punën e tyre dhe pikërisht për këto duhet të reflektojnë. Materiali i Komitetit Qendror ndonjërit mund t'i duket i thjeshtë e të mos i shkojë fare në mendje se ajo për të cilën flitet aty lidhet me punën e tij. E keqja është se ka shokë që nuk mendojnë sa duhet dhe nuk bëjnë përpjekje për të ndrequr një situatë jonormale që ekziston në qendrën e punës ku vepron organizata-bazë e Partisë ku ata bëjnë pjesë, edhe pse direktiva i sinjalizon. Në këtë rast, njëri nga komunistët që punon atje ku ekziston kjo situatë jonormale, kur konstaton se disiplina dhe normat e punës nuk zbatohen sipas direktivave, ose se puna politike nuk zhvillohet si duhet, thellohet në gjendjen dhe, duke e ballafaquar atë me direktivën që sapo lexoi bën anali-

zën, nxjerr anët pozitive e negative dhe mendon pastaj edhe për masat që duhen marrë, qofshin ato politike apo organizative, me qëllim që punët të ecin mirë. Pra, si komunist, atje ku e ka ngarkuar Partia, ai porsa merr direktivën nga udhëheqja e Partisë, duhet të mendojë dhe të veprojë pa vonesë. Për këtë ai nuk pret sa të bëhet mbledhja e organizatës-bazë, por me të mbaruar turni, për shembull, merr iniciativën dhe u propozon komunistëve të repartit të qëndrojnë gjysmë ore, duke u thënë se ka një problem shumë të rëndësishëm për të shtruar me ta. Me këtë rast ai i njofton shokët se në materialet e Komitetit Qendror ka lexuar diçka të rëndësishme dhe interesante, e cila lidhet me gjendjen e sektorit ku punojnë. Kështu ai u flet shokëve për gjithë sa ka konkluduar dhe u bën thirrje të mos lejohet më nga ana e tyre situata jo e mirë që është krijuar atje. Ai mund të bëjë dhe propozime konkrete se si të organizohet më mirë puna dhe për masat që duhen marrë. Këtë problem ai jo vetëm e hedh para komunistëve, por mund të kërkojë nga byroja e organizatës-bazë të Partisë, nga drejtoria ose nga shefi i turnit, që të bëhet edhe një mbledhje e kolektivit për diskutimin e këtyre problemeve (duke marrë masa që të njoftohen shokët për problemin që do të diskutohet, me qëllim që të venë të gjithë të përgatitur). Çfarë bëri ky njeri kështu? Natyrisht, me një të thënë të tij çështjet nuk do të ndreqen dot, por ai bëri pikërisht punën e luftëtarit të pararojës, të komunistit. Ai ndoshta nuk pyeti as sekretarin, as byronë, po vuri në zbatim vetëveprimin e komunistit, ashtu siç na mëson Partia.

Çështjen e kam këtu: materialet që dërgojmë japin orientime të përgjithshme, problemet që trajtohen në to mund të mos u interesojnë të gjithëve, po ama atyre që u takojnë, duhet t'u punojë mirë koka, pastaj të veprojnë dhe të marrin masa për të përmirësuar situatën. Vetëm kështu mund të themi se komunisti e kryen detyrën e tij si duhet.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*



# LUFTA KUNDËR KRIMIT TË VRASJES ËSHTË PARA SË GJITHASH SHPREHJE E LUFTËS SË KLASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 prill 1971

Konkluzionet për luftën parandaluese kundër krimit të vrasjes që na paraqiten në këtë relacion për sa u përket disa dobësive të punës së organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe organeve të drejtësisë, më duken të drejta. Nuk është puna se Partia nuk merret me këto probleme, por ajo duhet të jetë e informuar, me qëllim që të nxitet për të bërë një punë më të madhe politike e ideologjike. Në këto informacione është e domosdoshme të analizohen rezultatet e mira, sukseset e mëdha që kemi arritur gjer më sot në këtë fushë, por njëkohësisht të vihen në dukje edhe fenomenet negative që ekzistojnë akoma dhe që bëhen shkas për vrasje, të cilat duhet të na shqetësojnë. Një pjesë e krimeve të shumëllojshme te

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth disa konkluzioneve për luftën parandaluese kundër krimit të vrasjes.

ne kryhen edhe nga njerëzit e klasës sonë dhe nga disa të rinj, megjithëse këto nuk janë karakteristikë as të klasës, as të rinisë, po pasoja të mbeturinave të së kaluarës dhe e influencave të huaja të jashtme, revizioniste e kapitaliste, që gërshetohen me mbeturinat e vjetra. Kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së një pune politike e ideologjike të vazhdueshme, të shëndoshë, të gjallë dhe edukuese nga ana e Partisë dhe e levave të saj.

Vrasja, si akt shumë i rrezikshëm, është një nga krimet më të vjetra dhe ka tërhequr vëmendjen e njerëzve qysh para erës së re. Ajo zë një vend të rëndësishëm në dokumentet e lashta të së drejtës si në ligjet e Hamurabit, në 12 Tabelat, në ligjet Manu etj.

Me studimin e krimit të vrasjes, me përcaktimin e shkaqeve dhe të masave kundër saj, janë marrë shumë mendimtarë, juristë e filozofë të epokave të ndryshme, por edhe interpretimet e fakteve dhe rezultatet e studimeve të tyre kanë qenë të ndryshme, sepse ato varen nga koha dhe vendi ku zhvillohen, si dhe nga pozita klasore e studiuësve.

Në shoqëritë me klasa antagonistë, siç dihet, ligjet në fuqi kanë mbrojtur kurdoherë interesat e klasave sunduese. «Kush vret skllavin e tij, ai, sipas ligjës, nuk ka faj për vrasje» — shkruante Platoni. E drejta e klasave sunduese asnjëherë nuk e ka mbrojtur skllavin, bujkrobin, proletarin. Klasat sunduese, të pasurit, me çdo mjet janë përpjekur të nxitin vrasjet në radhët e të shtypurve. Ky ka qenë mjeti më i mirë gjatë gjithë historisë njerëzore për të përçarë e për të sunduar më lehtë.

Marrëdhëniet patriarkalo-feudale që sunduan shekuj me radhë në Shqipëri, politika reaksionare e feudalëve, e bejlerëve, e bajraktarëve dhe e klerit, si dhe pushtimet e huaja që ka pësuar vendi ynë, kanë ndikuar shumë në ruajtjen për një kohë mjaft të gjatë të krimit të vrasjes.

Të gjithë e dimë se në Shqipëri ka pasur shumë vrasje sidomos për gjakmarrje. Pushtuesit e huaj dhe sundimtarët e vendit i kanë ushqyer ato me zell, me qëllim që të mbanin popullin tonë nën zgjedhën e tyre. Kështu, gjakmarrja trashëgohej brez pas brezi, duke shfarosur familje të tëra. Të mos shkojmë më larg, mjaft të kujtojmë se 30 vjet më parë, në Shqipëri pothuajse s'kishte ditë pa u bërë ndonjë vrasje dhe, megjithatë, në mjaft raste vrasësit bridhnin të lirë pa u ndëshkuar nga regjimi antipopullor në fuqi. Ky qëndrim i shtetit ndaj vrasësve nxiste hakmarrjen në gjirin e popullit. Kjo gjendje ka vazhduar dhe ka qenë karakteristike deri në Çlirimin e Shqipërisë.

Fill pas krijimit të saj, Partia ka zhvilluar vazhdimisht një propagandë të gjerë për pakësimin e hakmarrjeve, që përbënin një faktor negativ për çimentimin e unitetit të popullit në luftë kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve të vendit. Partizanët, kudo që kalonin, duke zbatuar porosinë e Partisë, u flitnin njerëzve edhe për hasmëritë, si mbeturina të një mentaliteti të vjetër, që i shërbenin armikut, i cili dëshironte të na shihte të gjakoseshim me njëri-tjetrin, pse kështu ai do ta kishte më lehtë qëndrimin te ne. Kjo propagandë zinte vend në masat, të cilat pushkën e përdorën kundër armiqve dhe jo për të vrarë vëllai

vëllanë. Si pasojë, në zonat e çliruara vrasjet u kufizuan në mënyrë të ndjeshme.

Punën për pajtimin e gjaqeve dhe për kufizimin e vrasjeve Partia jonë asnjëherë nuk e ka lënë pas dore, sepse vrasjen e ka konsideruar si një ndër krimet më të shëmtuara, më barbare e më të rrezikshme për shoqërinë, si shprehjen më të ashpër të dhunës që drejtohet me tërë forcën e saj kundër unitetit në gjirin e popullit dhe që synon të krijojë në radhët e njerëzve tanë ndjenjën e mosbesimit dhe të pasigurisë për jetën.

Partia e ka konsideruar vrasjen jo vetëm si një akt të egër dhune kundër një personi të vetëm, por edhe si një akt që në të njëjtën kohë godet rëndë marrëdhëniet shoqërore socialiste të vendosura te ne për mbrojtjen dhe për paprekshmërinë e jetës së qytetarëve.

Duke u nisur nga këto vlerësime dhe duke organizuar një punë të dendur, të vazhdueshme e këmbëngulëse, politike dhe ideologjike me njerëzit, pa u gabuar aspak, mund të themi se kemi arritur suksese të mëdha jo vetëm në krahasim me të kaluarën në vendin tonë, por edhe në raportin aktual me vendet kapitaliste e revizioniste.

Megjithatë nuk ka vend për vetëkënaqësi. Detyra e Partisë është forcimi i punës për edukimin ideopolitik të njerëzve tanë, lufta kundër koncepteve të vjetra patriarkale, feudale e borgjeze në mendjen e njerëzve.

Subjekte të krimit të vrasjes nuk janë vetëm armiqtë, por edhe njerëzit tanë, të cilët akoma nuk janë zhveshur nga mbeturinat e së kaluarës. Tek ata nuk ka bërë sa duhet akoma efektin shërues puna e Partisë, prandaj me qëndritet e me veprimet e tyre të shëm-

tuara u kundërvihen jo vetëm normave të moralit, por edhe normave të së drejtës. Kjo, siç na mëson Partia, tregon se lufta e klasave zhvillohet jo vetëm kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, por edhe në gjirin e popullit, prandaj kur studiojmë problemin e vrasjeve dhe përcaktojmë masat kundër tyre nuk mund të injorojmë luftën e klasave, që është një realitet, të cilin jeta e provon çdo ditë.

Këtej del se për të luftuar me sukses kundër krimit të vrasjes, për të mbrojtur interesat e popullit e të Partisë, jetën e njeriut te ne, duhet bërë akoma një punë e madhe, para së gjithash, kundër mbeturinave të huaja në ndërgjegjen e njerëzve tanë, kundër koncepteve të vjetra patriarkale dhe feudale që ekzistojnë akoma, kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste që ushqen çdo ditë kriminalitetin. Kjo luftë natyrisht është e vështirë dhe e ndërlikuar, pse lidhet me procesin e transformimit të ndërgjegjes dhe të botëkuptimit të njerëzve tanë, ka të bëjë pra me përpjekjet e mëdha për të pushtuar mendjet dhe zemrat e tyre. Lufta kundër krimit të vrasjes është para së gjithash shprehje e luftës së klasave që zhvillohet në një terren të gjerë ideologjik dhe politik. Këtej del edhe detyra për organet dhe për organizatat e Partisë, për organizatat e masave dhe për organet e drejtësisë që të forcojnë punën ideopolitike me komunistët dhe me masat.

Për të pasur më shumë sukses në luftën kundër krimit të vrasjes, rëndësi të madhe ka lufta parandaluese. Vrasjet, si fenomen shoqëror, siç thashë, kanë të bëjnë me ndërgjegjen dhe me botëkuptimin e njerëzve, prandaj nuk mund të marrin fund menjëherë,

sepse dihet që ndërgjegjja shoqërore mbetet pas zhvillimit të kushteve materiale të shoqërisë. Vrasje do të ketë edhe për shumë vite, prandaj me luftën parandaluese duhet të kuptojmë atë punë që duhet bërë qysh më parë për kufizimin sa më të madh të tyre.

Të dënosh vrasësin, është vetëm një anë e domosdoshme e kësaj lufte, gjë që ka rëndësinë e vet për edukimin e njerëzve, por nuk është e gjitha. Kryesorja për ne është të ruhen njerëzit për të mos rënë në rrugën e kriminalitetit, sepse kështu, nga njëra anë, mbrohen interesat shoqërorë që mund të jenë objekt i kriminit dhe, nga ana tjetër, shpëtohen disa pjesëtarë të shoqërisë sonë socialiste nga ndëshkimi penal.

Rëndësi të madhe për parandalimin e krimeve kanë zbatimi i direktivave të Partisë që punonjësit tanë të njohin ligjet e pushtetit popullor, të cilat shprehin vullnetin e klasës punëtore që është në fuqi, si dhe interesat e popullit tonë punonjës. Kjo çështje nuk e duron as neglizhencën, as formalizmin. Nëpërmjet njohjes së ligjeve, njerëzit do të formojnë koncepte të drejta mbi atë çka është dhe çka nuk është e drejtë, mbi atë që në bazë të normave të moralit dhe së drejtës sonë, u takon dhe mbi atë që nuk u takon.

Për punimin e direktivave të Partisë dhe për popullarizimin e ligjeve në masat e popullit janë përdorur forma nga më të ndryshmet, si: mbledhje, biseda, seminare etj., por kam përshtypjen se në gjithë këto forma pune ka mjaft formalizëm. Nuk dua të them që në të ardhmen të mos zhvillohen mbledhje e seminare, ato të vazhdojnë, por të bëhen më të gjalla, më të përgatitura e të organizuara mirë. Temat që punohen të mos jenë

standarde, të përgjithshme, të gjata e të mërzitshme, sa për t'i bërë qejfin vetes që bëmë një seminar dhe popullarizuar një ligj, se ndryshe nuk do të arrijmë atë që dëshirojmë me to.

Për parandalimin e krimeve duhet t'i kushtohet më shumë rëndësi se deri tani punës së diferencuar dhe individuale me njerëzit. Partia na mëson që të jetojmë sa më afër me gjendjen shpirtërore të njerëzve, t'u qëndrojmë pranë atyre dhe të krijojmë raporte të përzemërta me ta, me qëllim që të njohim hallet, dëshirat, mendimet, shqetësimet e preokupacionet e tyre. Vetëm mbi këtë bazë mund të dimë se si duhet punuar me njerin e si me tjetrin, ku duhet ta vëmë theksin e punës sonë edukative në një rast dhe ku në një rast tjetër. Ndonjëri mund të flasë shumë mirë në një auditor të madh për të drejtat dhe detyrat e punëtorit ose të nëpunësit, por dikujt që do të vrasë bashkëshorten për shkaqe xhelozie, i punon mendja gjatë. Po edhe kjo mund të nuhatet dhe njeriu të ndihmohet me atë punë të vogël individuale që mund të bëhet me të. Në këtë rast, natyrisht me takt dhe pa e prekur në sedër, duhet biseduar ngrohtë e shoqërisht që njeriu të bindet se s'ka asnjë arsye të jetë xheloz, se llafet e përhapura lart e poshtë s'kanë asnjë bazë etj., etj. Edhe në rastin kur bashkëshorti mund të ketë bërë me të vërtetë një gabim të rëndë, sa marrëdhëniet familjare të jenë tronditur thellë, bashkëshorti tjetër duhet bindur që të heqë dorë nga mendimi kriminal dhe t'i drejtohet gjykatës. Të sqarohet se me këtë rrugë merr fund konflikti bashkëshortor brenda normave të moralit socialist dhe nuk kryhet krimi, që do të kishte pasoja

të rënda për atë vetë, për familjen dhe për tërë shoqërinë. Kjo punë nuk duhet bërë në këmbë, por me durim të madh e me urtësi partie, duke ndenjor gju më gju me atë që ka një shqetësim. Kur nuk u qëndrohet afër njerëzve nuk mund të mësohen as hallet, nuk mund të njihen as konceptet e mendimet e tyre, prandaj kur kryhet vrasja, disave u bie si bombë dhe pastaj thonë: «Çudi, si e kreu ai këtë akt kaq të rëndë?!».

Në punën tonë duhet të ruheni nga nënvleftësimi i disa sinjaleve që duken të vogla e pa rëndësi, por që jeta tregon se ato mund të çojnë deri në vrasje. Shumica e vrasjeve zakonisht nuk ndodhin aty për aty dhe pa pasur asnjë shenjë qysh më përpara. Para se të kryejë aktin më të rëndë kundër jetës së tjetrit, vrasësi e çon mendjen te konflikti që ka me personin të cilin mendon të zhdukë! Konflikti mund të rrjedhë për shkak të interesit për të shtuar padrejtësisht pasurinë, për shkak të koncepteve patriarkale lidhur me marrëdhëniet në familje, në jetë, në shoqëri etj.

Pasi lind ideja e vrasjes, në ndërgjegjen e njeriut zhvillohet një luftë e tërë psikologjie. Në mendjen e tij zhvillohet një luftë e fortë midis dy të kundërtave: «Ta kryejë krimin apo jo?!». Ai ndodhet, pra, në darën e mendimeve kontradiktore. Gjatë periudhës së përpunimit të mendimit kriminal ai shpeshherë rri i mërziur dhe bie në pasivitet. Këto shfaqje jo të zakonshme, që e kanë burimin te gjendja e tij jo e qetë shpirtërore, nuk ka se si të mos bien në sy të pjesëtarëve të familjes së vet, të shokëve të punës etj. Kështu, për shembull, ky person në gjendje emocionale të nderë dhe në përpëllitje mendimesh për të vuarë, diku do të japë



shenja. Ai, fjala vjen, mund të ankohet te njerëzit më të afërt për padrejtësinë që pretendon t'i jetë bërë nga dikush. Sidoqoftë, sado që të mundohet të fshehë mendimin e tij, do të duken shenja të gjendjes shqetësuese para kryerjes së një krimi kaq të rëndë, të cilat mund të kapen nga ambienti përreth tij, në qoftë se tregohemi të kujdesshëm me të. Përkundrazi, kur konsiderohen «të vogla» disa shfaqje të botës së brendshme të njerëzve, disa ankesa të tyre, kur nuk punohet nga afër me ta për t'i sqaruar, për t'i bindur dhe për t'i korigjuar kur e kanë gabim ose për t'i ndihmuar, kur kanë të drejtë, gjendja psikologjike e tyre në vend që të qetësohet, acarohet dhe pastaj nga «gjërat e vogla» shpërthen ai konflikt i madh që çon në një akt fatal, kryhet kështu një vrasje, humbet jeta e një njeriu që është shumë e shtrenjtë për Partinë e për popullin.

Të punohet me këmbëngulje kundër prirjes së disa njerëzve për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet me vetëgjyqësi dhe pa iu drejtuar organeve kompetente. Duhet të krijohet bindja tek të gjithë njerëzit tanë se të drejtat që u janë njohur nga ligji janë të garantuara plotësisht dhe nuk mund të cenohen nga askush; se për realizimin e tyre s'ka aspak nevojë për vetëgjyqësinë e pretenduesit të së drejtës, mbasi janë Partia dhe pushteti popullor ato që i realizojnë plotësisht e gjer në fund. Në këtë drejtim duhet shfrytëzuar patriotizmi i popullit tonë, dashuria e pakufi që ka ai për Partinë dhe për pushtetin e tij popullor, por edhe të punohet që të zgjidhen shpejt e drejt konfliktet nga ana e organeve kompetente.

Kur kryhet një vrasje, nuk duhet të përqendrohet tërë vëmendja vetëm në mbledhjen e provave, sa për ta dënuar rëndë vrasësin, por të na preokupojë dhe të na shqetësojë seriozisht fakti përse ndodhi ajo, cilat ishin rrethanat që e shkaktuan, cilët faktorë e ndikuan autorin e krimit, çfarë mund të bënim që të mos ndodhte, kush mban përgjegjësi për mosmarrjen e masave me kohë që vrasja të evitohet etj. Kjo analizë do të na shërbejë jashtëzakonisht shumë për ta shfrytëzuar si material për edukimin e njerëzve, për të ndërtuar më mirë luftën parandaluese dhe për të kombinuar drejt punën edukative të Partisë me masat shtrënguese në rrugën shtetërore. Puna në këtë drejtim duhet ndërtuar duke pasur parasysh se veprimet kriminale nuk mund të shikohen të shkëputura nga vendet e krahinat ku ndodhin, nga personat që i kryejnë nga objekti që synojnë të dëmtojnë, nga momentet dhe nga rrethanat e kohës kur ndodhin etj.

**Lufta parandaluese do të ketë më shumë sukses vetëm në qoftë se atë e marrin në dorë vetë masat e popullit.** Konflikti lind në lagje, në fshat, në ndërmarrrje, në kooperativë, në brigadë, në apartament, në familje etj., etj. Personat që grinden jetojnë e punojnë me njerëz, me të afërm, me miq e shokë, të cilët dinë shumë gjëra, dëgjojnë shumë fjalë, shikojnë shumë veprime dhe qëndrime të njerëzve në konflikt. Ambienti shoqëror ka mendimin e tij për ngjarjen, për atë që ka të drejtë, për atë që provokon pa shkak, për mënyrën e zgjidhjes së konfliktit dhe për pasojat që mund të rrjedhin në qoftë se çështja lihet zvarrë. Pra njerëzit, opinioni shoqëror, masat, janë një forcë e pa-

llogaritshme që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e konflikteve, para se ato të përfundojnë në vrasje. Për të vënë në lëvizje njerëzit, masat që të japin kontributin e tyre në këtë punë parandaluese është e domosdoshme të jetë në krye Partia, anëtarët e saj, të cilët të veprojnë në çdo rast, të udhëheqin, të punojnë për të mobilizuar masat në përfaqimin e opinionit shoqëror pozitiv. Por mobilizimi i masave nuk mund të bëhet spontanisht, pa i organizuar dhe pa i udhëhequr ato Partia. Prandaj, shokë, për luftën kundër kriminalitetit, duhen shfrytëzuar të gjitha format e punës, të gjitha levat e mundësitë që ka Partia.

Organizatave bashkimeve profesionale, të Frontit, të rinisë, të gruas duhet të kontribuojnë shumë në këtë drejtim dhe të mos e konsiderojnë këtë çështje vetëm si detyrë të organeve të punëve të brendshme, të prokurorisë dhe të gjykatës. Ndihma e tyre nuk duhet të jetë e rastit, ose në formë fushate, por e organizuar mirë dhe e vazhdueshme. Shokët e rinisë dhe të bashkimeve profesionale duhet të shqetësohen seriozisht kur shikojnë në relacion se gjatë pesëvjeçarit janë kryer vrasje nga të rinj, nga persona me gjendje punëtore.

Përveç organizatave të masave Partia nuk duhet të lërë mënjane dhe pa aktivizuar gjallërisht mijëra ndihmësgjyqtarë, prokurorë popullorë, bashkëpunëtorë vullnetarë të policisë e të tjerë, të cilët janë, gjithashtu, një forcë e madhe për mobilizimin e masave të popullit në luftë kundër kriminalitetit.

Në qoftë se Partia do t'i udhëheqë mirë levat e saj dhe popullin në luftën kundër krimit të vrasjes

dhe krimeve të tjera në përgjithësi, në qoftë se, kur është nevoja, do të ngjallet debati publik, do të merret mendimi i popullit dhe do të përdoret forca e ndikimit të tij, jam i bindur se kriminaliteti do të ulet akoma më shumë dhe keqbërësit nuk do ta kenë të lehtë të ngrenë dorë kundër ligjeve të Partisë e të shtetit që mbrojnë me fanatizëm dhe si gjënë më të shtrenjtë, para së gjithash, jetën e njeriut.

*Botuar për herë të parë  
me shkurtime në librin:  
«PPSH për organet e punëve të brendshme», Ti-  
ranë, 1974, f. 571*

*Botohet i plotë sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverbali  
i mbledhjes së Sekretariatit  
të KQ të PPSH, që gjendet  
në AQP*

**TREGUESIT**



## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto-amerikane* — 317-318, 380-382, 402-403, 409-410, 411.

*Arkat e kursimit* — 21.

### B

*Banka; Banka Bujqësore* — 21, 90-91, 144-145.

*Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik*

- degjenerimi i partisë, i shtetit dhe i jetës ekonomike, shoqërore e kulturore; rivendosja e kapitalizmit në BS — 367-375, 380-383, 400;
- politika imperialiste për të ruajtur e forcuar hegjemoninë mbi vendet revizioniste dhe mbi partitë revizioniste — 375-383, 399, 400-407;
- teoritë «partia e gjithë popullit», «sovrانيتeti i kufizuar» dhe kritika kundër tyre — 369, 376-377.

*Blegtoria* — zhvillimi, përmirësimi racor dhe rritja e rendimenteve në blegtoria — 160-167, 169-177, 301, 303-305.

*Bujqësia*

- politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë dhe për kthimin e saj në ekonomi të prodhimit të madh modern — 101-102, 105-119, 128-146, 287, 290-291, 299-302, 305, 316-317, 348-350, 440-441, 448-449, 450-451;
- puna kërkimore-shkencore. Shërbimet agroteknike; rajonizimi, qarkullimi në bujqësi — 112-113, 118, 129-131, 132-135, 289-290, 302-304, 307, 437, 440-442, 445-446;
- organizimi dhe drejtimi shkencor i punës në bujqësi — 82-83, 101-102, 114-115, 303-304, 428-432;
- toka, trajtimi shkencor i saj. Rritja e rendimenteve dhe hapja e tokave

të reja — 81-82, 106-108, 301-302, 306-307, 441-442.  
*Shih edhe: Partia e Punës e Shqipërisë — Letra e KQ të PPSH për bujqësinë...*

### Ç

*Çekosllovakia — pushtimi ushtarak i saj nga socialimperialistët sovjetikë — 376-377, 407-408.*

### D

*Demokracia socialiste — 10, 103, 347.*

*Disiplina e punës dhe ajo financiare; forcimi i pandërprerë i tyre — 76-77, 80, 90-93, 106, 109, 141, 324, 327-328.*

### E

*E drejta penale — zbatimi i drejtë i politikës së Partisë ndaj veprave penale — 97-100, 248-254, 467-478.*

*Edukimi ideopolitik dhe kulturor i masave — 20, 58-60, 65-66, 102-103, 113-114, 136, 252-254, 262, 308, 419-420, 427-428, 451-454, 470-472, 473-475.*

*Efektiviteti ekonomik në bujqësi — 137-138, 144-145, 166-167, 293-300, 317, 433-435.*  
*Ekonomia popullore — orga-*

*nizimi dhe drejtimi shkencor i ekonomisë. Zhvillimi harmonik i degëve të saj — 4. 156-158, 230, 233-234, 286-287, 297, 300-304, 420, 424-425, 448-450.*

*Engels, Frederik — 399.*

*Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 170, 319-320, 338, 389-391, 441.*

### F

*Feja dhe zakonet prapanike — lufta kundër tyre — 61-62, 97-100, 277.*

*Fshatarësia kooperativiste — edukimi ideopolitik i saj — 86-89, 106, 118, 173, 178, 218-219, 224-226, 298, 308, 315, 350-351.*

*Fshati socialist — 107, 270-272, 299.*

*Fuqia punëtore — lëvizja, shpërndarja dhe kualifikimi i saj — 79-80, 256-260, 287-288, 298-299, 320-323.*

### G

*Gruaja — politika e Partisë për emancipimin e saj — 61, 62-63, 329-330, 332-334, 336-338, 443-444, 453-454.*

### GJ

*Gjermania Lindore (RD Gjermane) në pazarllëqet sovjeto-*



-gjermane — 404-407.  
*Gjykatat Popullore, Gjykata e Lartë* — 99-100, 250-251, 252, 474-475, 476, 477.

## H

*Hetuesia* — 250, 474-475, 476.

## I

*Industria — arritje dhe zhvillimi perspektiv i saj* — 73-74, 78, 80-81, 264-265, 423, 450-451.

*Interesi i përgjithshëm dhe ai vetjak* — 297-298, 314, 425.

## J

*Jugosllavia — revizionizmi jugosllav* — 317, 399-400, 415-416.

## K

*Këshillat popullore — roli dhe kompetencat e tyre* — 228-229, 384-387;

— këshillat popullore të rretheve dhe komitetet ekzekutive të tyre — 4, 7, 8, 9, 11-13, 14-16, 140-141, 234-235, 345-348, 384-387, 391-392;

— këshillat popullore të fshatrave dhe të fshatrave të bashkuara — 230-240, 384-387.

*Këshilli i Mbrojtjes, Tezat e*

*Këshillit të Mbrojtjes* — 37, 39, 48.

*Këshilli i Ministrave (Qeveria)* — 6, 89, 124, 213, 217, 218, 223, 229, 263-264, 333, 410, 424, 426, 432.

*Klasa punëtore, kontrolli punëtor* — 10-12, 13, 74, 131, 217-218, 292, 315.

*Klasat dhe lufta e klasave* — 254, 468-471.

*Kodi i ri Penal* — 248-254.

*Koha e lirë dhe përdorimi i kulturuar i saj* — 274-275, 280-285, 451-452.

*Komunisti — cilësitë, edukimi ideopolitik dhe detyrat e tij* — 29-30, 330, 339-342, 395, 419-420, 437-438, 464-466.

*Kooperativat bujqësore*

— politika dhe kujdesi i Partisë për forcimin, konsolidimin dhe shndërrimin e tyre në ekonomi moderne — 94-96, 108-114, 137-138, 144-145, 149-159, 177-178, 180-187, 223-226, 297-298, 333-334, 336-337, 428-430;

— organizimi dhe drejtimi shkencor i punës në kooperativat bujqësore. Sektorët dhe brigadat — 83-96, 109-119, 129-141, 234-238, 240, 305, 307-315, 428-432, 434-437, 440-441, 444-445, 446, 455-456;

- të ardhurat dhe shpërblimi i punës në kooperativat bujqësore, fondet, dita e punës, normat — 87-89, 115-116, 150-154, 180-187, 288-293, 297-300, 304-305, 308-314, 334-336, 444-445;
- sektori i blegtorisë në kooperativat bujqësore — 136, 166-177, 432;
- organet drejtuese, kuadrot dhe kooperativistët — 85-86, 92-93, 94, 109-111, 132-134, 137, 141, 143, 175-176, 219, 230-231, 238-241, 288-290, 292-293, 302, 303-305, 313-315, 319-331, 335-336, 433-436.
- Krimet, shfaqjet e kriminalitetit; shkaqet, parandalimi dhe dënimi i tyre* — 97-100, 248-250, 251-254, 467-478.
- Kuadrot — metoda e punës, përgatitja, kualifikimi i tyre. Marrëdhëniet kuadër-masë* — 5-7, 18-21, 149-150, 153-156, 331-332, 345-347, 394-395, 439-440, 445.
- Kultura dhe institucionet kulturore. Roli i tyre në edukimin e masave. Përhapja e kulturës në fshat* — 270-285.
- Kushtetuta e RPSH* — 228-229, 237.
- Kuvendi Popullor, Presidiumi*

*i Kuvendit Popullor* — 99, 229, 347.

## L

- Lenin, Vladimir Iliç* — 372, 375, 398, 399.
- Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare — forcimi dhe lufta e saj kundër armiqve të marksizëm-leninizmit* — 245-246, 398-399, 408.
- Ligjet, ligjshmëria — njohja dhe zbatimi i tyre* — 210, 250-254, 472.

## M

- Marks, Karl* — 399.
- Mbledhjet, rritja e efektivitetit të tyre* — 2-3, 274-276, 279-280, 284-285, 457, 459.
- Mbrojtja e atdheut, përgatitja e ushtrisë dhe e popullit për mbrojtje* — 26-27, 243, 318-319, 423-424.
- Ministritë — kompetencat, metoda e punës së tyre* — 8, 11-15, 17-21, 169-170, 229; — Komisioni i Planit të Shtetit — 1-2, 7, 286-287, 306, 433;
- *Ministria e Bujqësisë* — 89-90, 109, 110, 115, 118, 141, 164, 169-170, 238, 332-333, 338;
- *Ministria e Mbrojtjes Popullore; kritikë kundër*

të metave dhe gjendjes  
jo të shëndoshë në këtë  
ministri — 26-57.

*Mirëqenia materiale dhe ngri-  
tja e nivelit kulturor të ma-  
save* — 131-132, 190-191, 296-  
-297, 337.

## N

*Ndërmarrjet ekonomike; kom-  
petencat, përsosja e organizi-  
mit dhe e drejtimit të tyre*  
— 3-6, 7-18, 230.

*Ndërtimi i socializmit në Shqi-  
përi* — 242-243, 246-247, 299,  
329-330, 419-423.

*Ngushtimi i dallimeve midis  
fshatit dhe qytetit. Lidhjet  
qytet-fshat* — 22-24, 131-132,  
143, 149-159, 177-178, 180-  
-187, 224-226, 270-271, 297-  
-299, 315-316, 458-459.

## O

*Organet shtetërore dhe ato  
ekonomike; përsosja e orga-  
nizimit, kompetencat, lufta  
kundër shfaqjeve burokratike  
në to* — 3-6, 17-18, 229-241.

*Organizata-bazë e Partisë* —  
264-265, 274-275, 279-280;

— organizatat-bazë dhe by-  
rotë e Partisë në koope-  
rativat bujqësore — 140-  
-141, 145-147, 209-210, 216,  
218, 271-272, 291, 429, 438,  
455-458.

## P

*Partia e Punës e Shqipërisë*

— roli udhëheqës i Partisë.  
Vendime e direktiva të  
saj; njohja dhe zbatimi  
i tyre — 4-5, 6, 123-124,  
150-152, 164, 279-280, 292.  
300-301, 456-457, 462-466,  
472;

— puna ideologjike dhe po-  
litike e Partisë. Qëndri-  
mi ndaj të metave e ga-  
bimeve të njerëzve —  
125-126, 252-253, 337,  
338, 339-341, 344-349,  
395-396, 427-428:

— organizimi dhe drejtimi  
i punës së Partisë dhe  
përsosja e vazhdueshme  
e tyre. Ndhima dhe kon-  
trolli për bazën — 145-  
-148, 322-325, 327-329,  
331-332, 339-340, 384, 461-  
-465;

— pranimet në Parti — 61,  
330, 339-342;

— kritika dhe autokritika.  
— 28-31, 342-343, 344-346;

— Kongresi i 6-të i PPSH  
— 101, 124-125, 243, 421;

— Plenumi i 10-të i KQ të  
PPSH (6-8 qershor 1963)  
— 68;

— Plenumi i 11-të i KQ të  
PPSH (25-26 janar 1971).  
— 188-222, 272;

— Komiteti Qendror, Byro-

- ja Politike dhe Sekretariati i KQ — 3, 27-28, 33-34, 35-36, 37-38, 55, 67-72, 89, 120-124, 146-148; 188-189, 251-252, 313, 320-321, 326, 338, 351-352, 424, 432-433, 447, 462-465;
- Letra e KQ të PPSH për bujqësinë — mendime dhe porosi rreth saj — 105-119, 127-148, 153-154, 305-306, 349, 428-431.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- *organizatat dhe komitetet e Partisë të rretheve* — 322-325, 384, 385, 438-439, 461;
  - Komiteti i Partisë i Rrethit të Elbasanit — 160, 163-164, 178;
  - Organizata e Partisë e Rrethit të Gramshit — 146;
  - Komiteti i Partisë i Rrethit të Gjirokastrës — 91;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Kolonjës — 149-155;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Krujës — 146-147;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Kukësit — 295-297, 300-301, 319-324, 449;
  - Komiteti i Partisë i Rrethit të Lezhës — 146-147, 384;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Lushnjës — 393-395, 438-439, 446-449;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Mirditës — 316-317, 319, 326-352;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Pukës — 295-297, 306, 319-320;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Shkodrës — 215-216, 255-260;
  - Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 127-128;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tropojës — 295-297, 319-320.
- Peshkimi — zhvillimi i tij* — 77-78.
- Planifikimi*
- metodologjia e planifikimit, pjesëmarrja e masave në hartimin e planeve — 4-6, 7-12, 18-21, 74-76, 103-104, 116-117, 142-143, 432-433;
  - kontrolli, ndihma, dhënia e llogarisë për realizimin e detyrave të pla-

- nit — 73-83, 85-86, 91-93;
- planet, planifikimi në bujqësi e blegtori dhe në kooperativat bujqësore — 81, 101-102, 116-117, 129-134, 139-144, 166-168, 424-425;
- plani i pestë pesëvjeçar (1971-1975) — 18, 73-83, 120-121, 305, 421-423.
- Politika e jashtme e RPSH*
- qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj problemeve ndërkombëtare: Lufta kundër imperializmit e revizionizmit — 396-399, 404-407, 414-415;
- rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe RPSH në botë — 396-397, 418-419;
- mbështetja e luftës së popullit vietnamez kundër imperializmit amerikan — 410;
- bisedë me ambasadorin e RP të Kinës — 242-247;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Greqisë — 417-418;
- marrëdhëniet dhe qëndrimi ndaj Jugosllavisë — 415-418;
- qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj koso-
- varëve — 416-417.
- Polonia; lufta e popullit polak kundër shtypjes e shfrytëzimit revizionist* — 377-378, 401-404.
- Prodhimi material; cilësia e produkteve* — 73-74, 80-81, 425-427.
- Prokuroria e Përgjithshme* — 252.
- Prona*
- prona shtetërore — 22-25, 290;
- prona kooperativiste; shndërrimi i saj në pronë të të gjithë popullit — 21-22, 95-96, 108, 135-136, 290;
- oborri kooperativist — 168-169, 226-227, 237.
- Propaganda e prodhimit* — 120-123.
- Puna — normat e punës; detyrat për realizimin e tyre në sasi, cilësi e në kohë. Qëndrimi socialist ndaj punës* — 88-89, 291-292, 308, 309-313, 326-327.

## R

- Rendimenti i punës — rrugët për rritjen e pandërprerë të tij* — 75-76, 79-80.
- Revizionizmi modern — përçarja dhe kriza në gjirin e tij* — 378-380, 397-402, 408-409.
- Rezervat shtetërore* — 78, 318-319, 426-427.

*Rinia dhe BRPSh; cilësitë revolucionare. Edukimi i saj* — 353-357, 358-362, 364-366;  
— organizatat dhe anëtarët e BRPSh — 357-361, 362-365.

## RR

*Rrethimi imperialisto-revizionist i Shqipërisë — lufta për çarjen e tij* — 317-318, 396-397.

## S

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 372, 375.

*Sigurimet shoqërore dhe pensionet për kooperativistët* — 180-187.

## SH

*Shëndetësia në RPSH*

— politika dhe kujdesi i Partisë për shëndetin e popullit — 67-72, 188-191, 193-194, 197-203, 272, 388-391;

— shkenca mjekësore dhe studimet në fushën e mjekësisë — 194, 197-204, 205-206;

— kujdesi për nënën e fëmijën — 204-222;

— institucionet, organet dhe kuadrot e shëndetësisë — 68, 69-72, 190, 193-194, 195-197, 202-203, 210-211.

*Shëndetësia në vendet kapi-*

*taliste e revizioniste* — 191-193.  
*Shfaqjet e luaja, lufta kundër tyre* — 5, 97-100, 343-344, 356-357, 428, 467-478.  
*Shtabi i Përgjithshëm dhe Shtatmadhoria e Ushtrisë Popullore* — 36-37, 54.

*Shtypi dhe propaganda në RPSH* — 202-203, 252-253, 273, 298, 343.

## T

*Tregtia e brendshme — Shpërndarja e produkteve, furnizimi i popullsisë* — 21-25, 74, 80-81, 223-226, 315-316.

## U

*Ushtria popullore*

— roli udhëheqës i Partisë, organizimi i ushtrisë.  
*Kuadrot* — 26-28, 31-32, 38-48, 51-54, 55-57;

— edukimi ideopolitik, përgatitja ushtarake; stërvitjet — 27, 38-39, 41-45, 48-51, 54-57.

## V

*Vendet arabe — synimet imperialisto-revizioniste në këtë rajon* — 413-414.

*Vigjilenca revolucionare, sekreti* — 243, 261-269, 414, 418.

*Vija e masave — këshillimi me masat* — 2-3, 4-6, 10-12, 103-104, 117, 121-122, 387-388, 432-434.

## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 271.

### B

Balluku, Beqir — 26, 30-35,  
37-38, 45.

Beqir Alia — 18.

Bevin, Ernest — 411.

Brand, Vili — 405, 406.

Brezhnjev, Leonid — 370, 374,  
376, 378, 382.

Bullari, Luçiana — 275, 276.

### C

Cami, Tefta — 278.

Cikuli, Zisa — 202.

### Ç

Çarçani, Adil — 188, 320-321,  
338.

Çela, Aranit — 251.

Çela, Fuat — 58-66.

Çako, Hito — 26, 30, 45.

### D

Dubçek, Aleksandër — 403.

Dudi, Mark — 341-342, 344.

Dume, Petrit — 26, 30-31, 32-  
-36, 45.

Dyrmishi, Izet — 295.

### G

Gën Biao — 101.

Gierek, Eduart — 403-404.

Gomulka, Vladislav — 378,  
401.

Gusho, Pirro — 18.

### GJ

Gjermani, Rrapi — 393.

### H

Hazbiu, Kadri — 248, 249.

Hitler, Adolf — 407.

Hrushov, Nikita — 431.

Husak Gustav — 376.

Hysein, Abdullah (mbreti~)  
—413.

Hysollarët (familja~) — 63.

### K

Kapo, Hysni — 127.

Këllezi, Abdyl — 18.

Khan, Jahja — 412.

Kosigin, Aleksej — 370, 374,  
382.

**L**

Ligori, Peço — 149-150, 154,  
155.

Liu Xhen Hua — 242-244.

**LL**

Lleshi, Marta — 333, 334, 336.

**M**

Miska, Pali — 295, 306.

Myftiu, Manush — 127, 128,  
142, 271, 276.

Magjistari, Petraq — 164.

Marshe, Zhorzh — 409.

Menzelxhiu, Jashar — 160-161,  
172.

Mikojan, Anastas — 406.

Mysliu, Emin — 255.

**N**

Nashi, Lipe — 18.

Ngjela, Kiço — 24, 80.

**P**

Perllaku, Rahman — 39.

Plaku, Koço — 18.

Platon — 468.

Podgorni, Nikolai — 374, 412.

**R**

Rahman, Muxhibur — 412.

Roshe, Valdek — 409.

**S**

Saraçi, Sinan — 156, 158.

**SH**

Shehu, Mehmet — 9, 16, 45,  
223, 251.

**T**

Toska, Haki — 71, 127.

Tito, Josip Broz — 407, 415.

**TH**

Theodhosi, Koço — 17, 18.

**U**

Ulbriht, Valter — 405-406, 407.

**V**

Vishinski, Stefan — 401.



## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Afrikë — 398.  
Angli — 408-409, 411-412.  
Azi — 382, 398.

### B

- Bajram Curri (qyteti ~) —  
257, 320, 450.  
«Bashkimi» (gazeta ~) —  
170.  
Berat — 276, 386, 391-392.  
Berlini Perëndimor — 405,  
406-407.  
Bulqizë — 156.

### D

- Dibër — 149, 156-157, 278-279.

### E

- Egjipt — 413, 414.  
Elbasan — 149, 157-158, 160-  
161, 169.  
Evropa Lindore — 376, 398,  
399.  
Evropë — 381-382, 398, 404.

### F

- Fabrika e Frutave — Peshko-  
pi — 157.  
Fakulteti i Mjekësisë — 194.  
Fier — 17, 182.

### G

- Gosë (Durrës) — 443-444.  
Greqi — 417-418.

### GJ

- Gjermania Perëndimore  
(RFGJ) — 404, 405-406.  
Gjirokastër — 201, 389.

### H

- Hidrocentrali i Fierzës — 257,  
320, 322, 450, 451.  
Hidrocentrali i Vaut të Dejës  
— 255-257.

### I

- Indi — 411-412.  
Indokinë — 411.  
Instituti i Lartë Bujqësor —  
137.

Instituti i Studimeve Ekono-  
mike — 287.  
Instituti i Studimeve Mark-  
siste-Leniniste — 286-287.  
Izrael — 411, 413, 414.

**K**

Kalimash (Kukës) — 321.  
KNER — 379.  
Kolonjë — 149, 158.  
Kombinati i Tekstileve — Be-  
rat — 18, 275-276.  
Kombinati Metalurgjik — El-  
basan — 423, 451.  
«Komunist» (revista~) —  
374.  
Kongresi i 23-të dhe i 24-t i  
PK (revizioniste) të BS —  
367-368, 380, 382.  
Korçë — 182.  
Kosovë — 416-417.  
Kooperativa Bujqësore e Kru-  
tjes — Lushnjë — 432.  
Kooperativa Bujqësore e Ku-  
talit — Përmet — 343.  
Kooperativa Bujqësore e Oro-  
shit — Mirditë — 336.  
Kooperativa Bujqësore e Star-  
jes — Kolonjë — 150.  
Kukës — 294-296, 297, 300-301,  
304, 319, 320, 321-325, 449-  
450.  
Kurbnesh (Mirditë) — 328.

**L**

Laos — 410, 411.

Leningrad — 403.  
Lezhë — 391-392.  
Ligjet e Hamurabit, 12 Tabe-  
lat, Ligjet Manu — 468.  
Lindja e Mesme — 413, 414.  
Lushnjë — 182, 393-395, 425,  
430, 432, 438-439, 446-449,  
452-454.

**M**

Maqellarë (Dibër) — 279.  
Mesdhe (rajoni~) — 318,  
414.  
Metoda «Brail» — 59-60.  
Mirditë — 304, 316, 326-352,  
449.  
Moskë — 403, 406.  
NATO — 414, 424.  
NSHRAK — Tiranë — 122.

**P**

Pakistan — 411-412.  
Partia revizioniste e Anglisë  
— 408-409.  
Partia revizioniste e Belgji-  
kës — 408-409.  
Partia revizioniste e Francës  
— 408-409.  
Partia revizioniste e Italisë  
— 408-409.  
Peshkopi — 156, 161.  
Petrelë (Tiranë) — 441.  
«Pravda» (gazeta~) — 374.  
Pukë — 257, 278, 294-296, 397,  
304, 319, 321, 324-325, 349.

**R**

Rubik (Mirditë) — 328.

**S**

Spaç (Mirditë) — 328.

Suez (kanali ~) — 414.

**SH**

SHBA — 380, 411, 413, 414.

Shkodër — 215-216, 257.

Shqipëria e Jugut — 278-279, 296.

Shqipëria e Mesme — 278.

Shqipëria e Veriut — 278-279, 296, 297.

Shtëpia e Arsimit Shëndetësor — 202.

**T**

Tiranë — 61-62, 71, 79-80, 104, 202.

Traktati Moskë-Bon — 381-382, 402, 404, 406.

Tropojë — 294-296, 297, 319, 321, 324-325, 450.

**U**

Universiteti i Prishtinës — 416-417.

Universiteti i Tiranës — 137, 416-417.

Uzina «Enver» — 122.

Uzina e Sodës Kaustike — Vlorë — 76-77.

Uzina e Shkrirjes së Bakrit — Kukës — 323.

**V**

Varshavë — 401-402.

Vatikan — 401.

Vërzhezhë (Skrapar) — 58, 63-65.

Vietnam — 410-411.

Vlorë — 17, 321.

**Z**

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 170, 416.



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 45-TË ..... V—IX

1970

RRITJA E KOMPETENCAVE TË BAZËS KËRKON  
NDRYSHIMIN E METODËS E TË STILIT NË PUNË  
— Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ  
të PPSH (7 dhjetor 1970) ..... 1—25

DREJTUESIT E MINISTRISË SË MBROJTJES JA-  
NË PËRGJEGJËS DIREKT PËR GJENDJEN NË  
USHTRI DHE DUHET TË PËRGJIGJEN PARA  
PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Poli-  
tike të KQ të PPSH (8 dhjetor 1970) ..... 26—57

ËSHTË NDER I MADH TË JESH ANËTAR I PAR-  
TISË — Nga biseda me shokun Fuat Çela (14  
dhjetor 1970) ..... 58—66

ORIENTIMET E DREJTA JEPEN KUR NJIHET  
MIRË GJENDJA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë  
Politike të KQ të PPSH (21 dhjetor 1970) ..... 67—72

PËRSOSJA E ORGANIZIMIT DHE FORCIMI I DI-  
SIPLINËS PËRBËJNË KYÇIN PËR REALIZIMIN  
E DETYRAVE TË PLANIT — Diskutim në mble-  
dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 dhjetor  
1970) ..... 73—96

PUNA POLITIKE ĖSHTĖ EFEKTIVE, KUR PREK MENDJET E NJERĖZVE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (24 dhjetor 1970) .....	97—100
ĖSHTĖ PUNA E PARTISĖ AJO QĖ I BĖN NJERĖZIT TĖ MENDOJNĖ, TĖ KRIJOJNĖ E TĖ ZBATOJNĖ — Nga biseda me ambasadorin e RP të KinĖs në TiranĖ, GĖn Biao (26 dhjetor 1970) .....	101—104

## 1971

PA ORGANIZIM E DISIPLINĖ NUK MUND TĖ KEMI BUJQĖSI MODERNE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 janar 1971) .....	105—119
NĖ MBLEDHJET TONA TĖ SHQYRTOJMĖ PROBLEME KYÇ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (7 janar 1971) .....	120—126
ORGANIZIMI MODERN I BUJQĖSISĖ — BURIM KRYESOR PĖR SHTIMIN E TĖ ARDHURAVE TĖ KOOPERATIVISTĖVE — Nga biseda me shokun Manush Myftiu (14 janar 1971) .....	127—148
MĖSIMET E PARTISĖ TĖ SHPJEGOHEN DHE TĖ KUPTOHEN DREJT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 janar 1971) .....	149—159
TI KUSHTOHET MĖ TEPĖR RĖNDĖSI ZHVILLIMIT TĖ BLEGTORISĖ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (18 janar 1971) .....	160—179
SIGURIMET SHOQĖRORE PĖR KOOPERATIVISTĖT — HAP I RI PĖR NGUSHTIMIN E DALLIMEVE NDĖRMJET FSHATIT E QYTETIT — Diskutim në mbledhjen e ByrosĖ Politike të KQ të PPSH (20 janar 1971) .....	180—187

- TË NGRIHET NË NJË NIVEL MË TË LARTË SHËRBIMI SHËNDETËSOR, SIDOMOS PROFILAKSIA DHE HIGJIENA — Fjala e mbylljes në Plenumin e 11-të të KQ të PPSH (26 janar 1971) ..... 188—222
- MË SHUMË KUJDES PËR FURNIZIMIN E FSHATARËSISË — Shënime (1 shkurt 1971) ..... 223—227
- BASHKIMI I KËSHILLIT POPULLOR ME KRYESINË E KOOPERATIVËS ËSHTË I GABUAR NË PARIM DHE NË PRAKTIKË — Nga një bisedë (13 shkurt 1971) ..... 228—241
- SHOKUT E MIKUT I FLITET KURDOHERË ME ZEMËR TË HAPËT — Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës në Tiranë, Liu Xhen Hua (23 shkurt 1971) ..... 242—247
- NDAJ VEPRAVE TË NDRYSHME PENALE TË ZBATOJMË KURDOHERË DREJT POLITIKËN E PARTISË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 shkurt 1971) ..... 248—254
- KURSET DHE SHKOLLAT PA SHKËPUTJE NGA PUNA T'I MBAROJNË TË GJITHË ATA QË RE-GJISTROHEN NË TO — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 shkurt 1971) ..... 255—260
- TË VENDOSIM RREGULLA TË FORTA PËR RU-AJTJEN E SEKRETIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 shkurt 1971) ..... 261—269
- MË SHUMË TË PREOKUPOHET PARTIA PËR PËRHAPJEN E KULTURËS DHE PËR SHFRYTËZIMIN E KOHËS SË LIRË NGA PUNONJËSIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 shkurt 1971) ..... 270—285
- TË TREGOHET KUJDES PËR KUALIFIKIMIN E PUNONJËSVE DHE PËR VENDOSJEN E NORMAVE KOLEKTIVE NË BUJQËSI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 shkurt 1971) ..... 286—293

- EDHE BUJQËSIA KËRKON ORGANIZIM TË PUNËVE SI INDUSTRIA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 mars 1971) ..... 294—325
- NDAJ NJERËZVE PARTIA VEPRON KURDOHERË ME URTËSI, TAKT E DURIM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 mars 1971) ..... 326—352
- DISA ASPEKTE TË PUNËS SË ORGANIZATAVE TË BRPSH PËR PËRSOSJEN E FIGURËS MORALE TË RINISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 mars 1971) ..... 353—366
- NJË KONGRES REVIZIONIST PËR QËLLIME REVIZIONISTE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (25 mars 1971) ..... 367—383
- KËSHILLAT POPULLORË TË NDIHMOHEN PËR TË ZBATUAR DREJT KOMPETENCAT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (30 mars 1971) ..... 384—392
- ATDHEU NUK MBROHET VETËM ME ARMË, POR EDHE DUKE RRITUR PRODHIMET — Fjala në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës (6 prill 1971) ..... 393—454
- ORGANIZATAT-BAZË TË PARTISË EDHE NË FSHAT TË NGRIHEN NË BAZË PRODHIMI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 prill 1971) ..... 455—460
- PO TË PRITET ÇDO GJË NGA LART, NGADALËSOHET ZBATIMI I DIREKTIVAVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 prill 1971) ..... 461—466



---

LUFTA KUNDËR KRIMIT TË VRASJES ËSHTË PARA SË GJITHASH SHPREHJE E LUFTËS SË KLASAVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 prill 1971) .....	467—478
TREGUESI I LËNDËS .....	481
TREGUESI I EMRAVE .....	489
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA .....	491